



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

TRANSKRIPT

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 17 E 30 MAJ DHE 1, 4 E 5 QERSHOR 2018

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 17. I 30. MAJA I 1, 4 I 5. JUNA 2018. GODINE

MAJ/QERSHOR - MAJ/JUN
2018

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-028 për tatimin në të ardhurat personale,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-029 për tatimin në të ardhurat e korporatave,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-037 për Tatimin në Vlerën e Shtuar,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e konsumatorit,
10. Shqyrtimi i Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2018-2022,
11. Shqyrtimi i Strategjisë Shtetërore të Ujërave në Kosovë, 2017-2036,
12. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për Biodiversitetin 2016-2020,
13. Shqyrtimi i raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2017,
14. Shqyrtimi i raportit vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017,
15. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2017,
16. Propozimi i Grupit Parlamentar të AAK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare,
17. Zgjedhja e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Medieve,
18. Propozim-rezoluta për heqjen e roamingut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë,
19. Propozim-rezoluta për hapjen e tërësishme të kontrollit për hyrje-daljet e shtetasve të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë nëpërmjet pikave të kalimit kufitar në Vërmicë, Qafë Prush dhe Qafë Morinë,
20. Debat parlamentar në lidhje me të drejtat e punëtorëve dhe adresimin e papunësisë në Republikën e Kosovës, sipas kërkesës së GP të LVV,
21. Debat parlamentar në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë për unifikimin e pikave doganore ndërmjet tyre, sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri, i mbështetur edhe nga 11 deputetë,
22. Debat parlamentar në lidhje me Kartonin e Gjelbër, sipas kërkesës së deputetit Faton Topalli, i mbështetur edhe nga 11 deputetë,
23. Debat parlamentar në lidhje me gjendjen jo të mirë të rinisë kosovare, sipas kërkesës së deputetit Fidan Rekalju, i mbështetur edhe nga 5 deputetë.

Dnevni red

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Razmatranje odluke predsednika Republike Kosova za vraćanje Zakona br. 06/L-016 o trgovačkim društvima,
4. Prvo razmatranje Nacrt zakona o statusu albanskih obrazovnih radnika Republike Kosovo od školske 1990-91 do 1998-99 godine,
5. Prvo razmatranje N/zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 05/L-028 o porezu na lične dohotke,
6. Prvo razmatranje N/zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 05/L-029 o porezu na prihode korporacija,
7. Prvo razmatranje N/zakona o izmeni i dopuni Zakona br.05/L-037 o porezu na dodatnu vrednost,
8. Drugo razmatranje N/zakona o glavnom gradu Republike Kosova/Prištini,
9. Drugo razmatranje N/zakona o zaštiti potrošača,
10. Razmatranje Nacionalnog programa o sprovođenju Sporazuma o SP 2018-2022,
11. Razmatranje državne strategije o vodama na Kosovu 2017-2036,
12. Razmatranje Plana delovanja biodiverziteta za 2016-2020. godinu,
13. Razmatranje godišnjeg izveštaja Kancelarije Regulatora za energiju za 2017 godinu,
14. Razmatranje godišnjeg izveštaja Institucije Narodnog advokata za 2017 godinu,
15. Razmatranje godišnjeg izveštaja Agencije za besplatnu pravnu pomoć za 2017. godinu,
16. Predlog Parlamentarne grupe AAK o zameni članova komisije u parlamentarnim komisijama,
17. Izbor dva člana Nezavisne komisije za medije,
18. Predlog rezolucija o ukidanju roaming-a između Republike Kosova i Republike Albanije,
19. Predlog rezolucija o potpunom otvaranju kontrole ulaska/izlaska državljana Republike Kosova i Republike Albanije između tačaka granične linije u Vermici, Qafe Prush i Qafe Morina,
20. Parlamentarna debata na zahtev PG Pokreta Vetevendosje o pravima radnika i adresiranju nezaposlenosti u Republici Kosova,
21. Parlamentarna debata na zahtev poslanika Visar Ymeri i 11 poslanika-potpisnika u vezi primene Sporazuma između Republike Kosovo i Republike Albanije, konkretno unifikacije carinskih punktova između Republike Albanije i Republike Kosova,
22. Parlamentarna debata na zahtev poslanika Faton Topalli i 11 poslanika-potpisnika u vezi Zelenog kartona,
23. Parlamentarna debata na zahtev poslanika Fidan Rekaliu i 5 poslanika-potpisnika u vezi ne povoljnog stanja kosovske omladine.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 14 maj 2018.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në pesë minuta, ndërsa diskutimi i deputetit zgjat deri në tre minuta.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Hykmete Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: I nderuar kryetar,

Të nderuar përfaqësues të Qeverisë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Çështja të cilën do ta ngre sot në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës është Udhëzimi administrativ 02/2018 për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për homologim të mjeteve rrugore, i Ministrisë së Infrastrukturës, i nënshkruar më 12 prill 2018, i cili ka hyrë në fuqi një javë më pas.

Të nderuar deputetë,

Tani kur ka mbetur më pak se një vit që kontrata në mes të kompanisë “EuroLab”, respektivisht Devollëve dhe Ministrisë së Infrastrukturës të përfundojë dhe kur Qeveria do të duhej që përfundimisht të lirohet nga monopoli në këtë fushë, Ministria e Infrastrukturës me Udhëzimin administrativ 02/2018 i siguron jetëgjatësinë monopolit ekzistues në pafundësi.

Edhe pse ky Udhëzim administrativ parasheh futjen e operatorëve të tjerë në treg, kushtet janë të tilla që asnjëherë askush, përveç operatorit aktual, nuk do të mund t’i plotësojë.

Në paragrafin 4 të nenit 7 thuhet që Ministrisë së Infrastrukturës do t’i rekomandohet të autorizojë një subjekt tjetër vetëm atëherë kur sipas një studimi të fizibilitetit dëshmohet që operatori ekzistues shfrytëzon më shumë se 85% të kapaciteteve.

Ky paragraf ia mundëson kompanisë aktuale që të vazhdojë monopolin në pafundësi, duke qenë aktualisht vetëm një kompani e licencuar për homologim. Kjo kompani mund të diktojë vetë vëllimin e punës së saj, duke i ikur pragut prej 85%, ajo thjesht mund t'i rrisë kapacitetet, në mënyrë që gjithmonë 15% të kapaciteteve të mos i shfrytëzojë.

Të nderuar qytetarë,

Imagjinoni, në vend që Ministria e Infrastrukturës të kujdeset për interesin tuaj, ajo krejt kreativitetin e saj e përdor në funksion të ruajtjes së interesave të kompanisë, e cila e ka monopolin qe 10 vjet në këtë treg.

Kështu futja në treg e operatorëve të tjerë sipas këtij Udhëzimi administrativ varet komplet nga vullneti aktual i kompanisë, e cila e ka homologimin.

Neni 7 i këtij Udhëzimi administrativ është në kundërshtim të plotë me nenin 119 të Kushtetutës së Kosovës, i cili thotë se veprimet që kufizojnë konkurrencën përmes vendosjes së abuzimit të pozitës dominuese ose praktikave që e kufizojnë konkurrencën, janë të ndaluara, në përjashtim kur këto lejohen me ligj.

Ky Udhëzim administrativ është edhe në kundërshtim me Ligjin 05/L-132, nga i cili derivon.

Pjesë të tjera të këtij Udhëzimi administrativ i japin detyra shtesë kompanisë, e cila është në treg për momentin. Për shembull, tek neni 4 thuhet që edhe kontrollet teknike për herë të parë duhet të kryhen te kjo kompani, e te paragrafi 1.10 i nenit 4 thuhet që këta mund të kryejnë detyra shtesë nëse kërkohen në bashkëpunim nga Ministria e Infrastrukturës.

Më lejoni t'ju njoftoj, të nderuar kolegë, që qeveritë e rajonit e kanë hapur tregun duke autorizuar deri në shtatë kompani për homologim. Ndërsa Kosova po synon që ta mbajë monopolin në këtë fushë.

Maqedonia i ka pesë kompani të autorizuar dhe çmimi për homologim është 30 deri në 70 euro, varësisht prej llojit të automjetit.

Mali i Zi i ka shtatë kompani të autorizuar, në Britani të Madhe këtë shërbim e ofrojnë 40 kompani, në Finlandë këtë shërbim e ofron shteti me një çmim 30 deri në 60 euro, varësisht nga lloji i automjetit.

Në asnjë vend të rajonit dhe të BE-së nuk ka monopol në këtë fushë, sa herë që ky shërbim ofrohet prej operatorëve privatë, janë disa kompani të autorizuar, e kur ofrohet prej shtetit, çmimi është tepër i arsyeshem, siç ishte te rasti i Finlandës, 38 deri në 60 euro.

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës kërkon nga ministri i Infrastrukturës që menjëherë ta shfuqizojë Udhëzimin administrativ, i cili është antikushtetues dhe ta hartojë një Udhëzim administrativ i cili hap tregun dhe eliminon monopolin, i cili ka mbizotëruar që një dekadë dhe qytetarët e Republikës së Kosovës kanë paguar për këtë. Në rast se kjo nuk ndodh, Lidhja Demokratike e Kosovës do të marrë hapa konform Kushtetutës për ta kundërshtuar një Udhëzim administrativ, i cili është antikushtetues. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sapo morëm lajmin se njëri nga ish-kolegët tanë deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës në legjislaturën e kaluar ka ndërruar jetë, zoti Kujtim Paçaku. Ju kërkoj një minutë heshtje.

(Një minutë heshtje)

Nderim!

Nait Hasani e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përsëritje, kolegë deputetë,

Sot vetëm dua të përkujtoj një ngjarje të rëndë që ka ndodhur 19 vjet më parë në Burgun e Dubravës, një nga masakrat më të tmerrshme që kemi përjetuar të burgosurit, e këtu janë vetëm tre, sa mund ta di, Liburni dhe Rasimi, që kem qenë pjesë e përjetimeve të asaj masakre që është bërë në Burgun e Dubravës nga 19 deri më 24 maj 1999.

Të nderuar deputetë,

Ne mendojmë që qëllimi i kësaj masakre ka qenë i planifikuar dhe i përgatitur mirë nga udhëheqja qendrore e Serbisë, deri te gardianët e Burgut në Dubravë. Këtë e dëshmojnë mbledhjet e të burgosurve në Burgun e Dubravës që na sollën aty nga burgjet e tjera të Mitrovicës së Sremit, Burgu i Nishit, Burgu i Prizrenit, i Gjilanit, i Pejës, Suharekës, Gjakovës, e të tjera.

Kjo mbledhje e të burgosurve në Dubravë ishte, si të themi, mish për top, se ne duhej të sakrifikohej, duhej të vriteshim për të shpëtuar ushtrinë dhe policinë serbe që ishte stacionuar aty.

Me qëllim që t'i mbrojmë infrastrukturën raketore, ata na mblodhën dhe na vranë në Burgun e Dubravës.

Të nderuar deputetë,

Këto data neve na përkujtojnë krimet që ka bërë Serbia në Kosovë, po në Burgun e Dubravës si institucion, si shtet ndaj të burgosurve, të cilët i ka pasur për detyrë t'i mbrojtë.

Ajo çka ndodhi në burgun e Dubravës nuk ka përshkrim, nuk mund ta përshkruajë askush, nuk mund ta përshkruajë as një mendje njerëzore, e as skenaristët e filmave.

Të nderuar deputetë,

Vrasës u bënë ata që kishin marrë përgjegjësi t'i mbrojnë në bazë të konventave ndërkombëtare, për mbrojtjen e të drejtave të burgosurve, pengjeve të luftës, po këta kriminelë na sulmuan dhe na vranë pa pyetur për konventa, ligje, e tjera.

Është edhe një tjetër që duhet theksuar që në burgun e Dubravës dje ishte përvjetori i Ukshin Hotit, i daljes nga burgu dhe zhdukja e tij.

Ishte një rast i veçantë, të cilët e dinë të gjithë, e njohin të gjithë, të gjithë të burgosurit e dinë që është marrë nga gardianët e burgut, ka dalë nga burgu dhe është zhdukur dhe nuk dihet asgjë.

Atë çka mund të dimë ne, e dimë që aty ka qenë drejtori i burgut, Aleksandër Rakoçeviq Aca, ka qenë drejtor edhe në burgun e Beogradit në CZD-e, ku ne e kemi pasur si drejtor kur kemi qenë në burgun e Beogradit.

Të gjithë e dimë se komandat burgu ka qenë Miodrag Vidiq Miki, po ashtu e dinë të gjithë të burgosurit që Ukshinin e ka marrë Branko Komadina dhe është zhdukur edhe nuk dihet më tepër për të.

Gjithë këto çka ka ndodhur janë tmerret e luftës, tmerret që ne i kemi përjetuar, tmerret që edhe sot i përjetojmë kur i mendojmë, ose kur vijnë datat e tilla.

Në këtë Kuvend kemi debatuar sa herë, kemi nxjerrë rekomandime sa e sa herë, asnjë nga rekomandimet nuk është respektuar.

Më 2011 kemi vendosur që të ngrihet aktakuza dhe të tregohen të gjitha ato.

Me nënshkrimet që i kemi marrë nga deputetët po ashtu, edhe rekomandimet që janë dhënë prej të gjithëve, të vetmen gjë që e kemi pasur mundësi Ministria e Drejtësisë na ka ndihmuar ta botojmë një libër për masakrën e Burgut të Dubravës, ku janë përmbledhur deklaratat e të burgosurve që kanë qenë aty, që kanë dëshmuar për krimet që janë bërë.

Atë çka kanë bërë të burgosurit, Shoqata e të burgosurve e ka bërë një kallëzim penal më 19 janar 2007 dhe nga ajo datë asnjëherë asnjë vendim, asnjë veprim nuk është bërë.

Edhe këtu dëshmohet me emra, kemi edhe fotografi origjinale, me ngjyra, që janë bërë vrasje, i kemi me emra, me fotografi, e kemi Aleksandër Rakoçeviqin, Miodrag Vidiqin, Branko Komadinën, Milosh Stoshiqin, Bora Avdullahoviqin Munja, Dushan Antiqin dhe 32 gardianë dhe përgjegjës burgu. E kemi treguar përgjegjësinë penale, vepër penale është bërë, kemi treguar me fotografi se çfarë kanë bërë ata.

Kemi treguar ku janë vrasjet, kemi treguar kush janë të vrarit, me emër dhe mbiemër, por asgjë. Kështu që për hir të atyre që kanë rënë, të burgosurve atje, që janë vrarë, janë masakruar, ku edhe vëllai vëllain e ka parë duke e vrarë drejtpërdrejt, janë vrarë me armë të shkurtra.

Prandaj, po kërkoj që ky dialogu për pajtim, të paktën, t'i kemi ato mundësi që të themi që a ka ndonjë mundësi të ngrihet ndonjë akuzë për këta që janë nëpër Serbi.

Po nuk kemi bërë vetëm kaq, i kemi shkruar edhe Parlamentit Evropian dhe iu kam drejtuar më 22. 2. 2017 Lunaçekut, po ashtu për një veprim ose veprimet për krimet që i ka bërë Serbia në Burgun e Dubravës, po ashtu nuk kemi marrë asnjë përgjigje. I kemi shkruar edhe Këshilli të Evropës, po ashtu, u kam shkruar edhe miqve tanë mjaft të respektuar që na kanë ndihmuar, ambasadorit Dellavi, po ashtu nuk kemi marrë asnjë përgjigje. Do të thotë që një krim kërkohet të heshtet, nga kush po kërkohet të heshtet? Ministria e Drejtësisë nuk ka bërë asgjë, Parlamenti Evropian nuk ka bërë asgjë, miqtë tanë ndërkombëtarë nuk janë duke bërë asgjë, UNMIK-u nuk ka bërë asgjë, EULEX-si s'ka bërë, as sot.

Mund ta falënderoj Fondin për të Drejtat e Njeriut, Fondin Humanitar në Serbi, Natasha Kandiçin, që ka bërë një kallëzim penal në Serbi, ajo vetë, do të thotë vetë Serbia po kërkon të demokratizohet, të gjykojë krimet, ndërsa ne që i kemi edhe mundësitë, edhe bashkësinë ndërkombëtare dhe të gjitha, asnjë veprim nuk e kemi bërë.

Të gjitha këto vetëm janë për të vajtuar në formën tonë, drejtësinë tonë dhe hallin tonë.

Për ata të burgosur që janë vrarë, të martën e kemi përvjetorin, do të shkojmë atje, do t'i përkujtojmë, vetëm mund t'ua qajmë hallin dhe t'u themi: "Pushoni të qetë, pushoni se drejtësia në Kosovë ka dështuar". Ndoshta do të vijë koha kur do ta kemi mundësinë të paktën që drejtësia ta thotë fjalën e vet, sepse e kemi qenë para plumbit, para pushkatimit, kemi qenë para ekzekutimit, e pse nuk na ka rrokur plumbi është një çështje tjetër, prandaj ata që kanë shpëtuar kanë shpëtuar falë Zotit, përndryshe të gjithë kemi qenë para plumbit, 600 të burgosur. Më 22 maj kanë qenë para plumbit, para ekzekutimit, kanë gjuajtur me të gjitha armët, me të gjitha

mundësitë që të na ekzekutojnë. 120 janë vrarë, 300 janë plagosur, të tjerët janë edhe me trauma të ndryshme dhe prapë nuk ka një kujdes të mjaftueshëm.

Prandaj, ky Kuvend, ne që keni nxjerrë rekomandime sa e sa herë kur kërkohej që të paktën edhe një herë ta detyrojmë Ministrinë e Drejtësisë, të kërkojë përgjegjësi, të kërkojë që ky kallëzim penal që është bërë më 19 janar 2007 të ngrihet dhe të dalin para drejtësisë të paktën ata të burgosur atje që janë vrarë ta ndiejnë shfajësimin dhe familjet e tyre të ndihen të shfajësuar të paktën se diku ekziston drejtësia. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Llogaritet se kanë kaluar vetëm 10 minuta të kohës për deklarime jashtë rendit të ditës, pjesa tjetër - 4 minuta ishin shtesë, për shkak edhe të temës, e cila ishte e ndjeshme, e kam vazhduar.

Albulena Haxhiu e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Në vitin 2012, Ministria e Drejtësisë atë kohë e drejtuar nga Hajredin Kuçi, pra nga PDK, e procedoi në Kuvend Projektligjin për procedurën përbarimore.

Menjëherë pas miratimit në parim të Projektligjit për procedurën përbarimore, ne kemi proceduar amendament me qëllim të heqjes së përbaruesve privatë dhe kërkesës për përbarues publikë, të cilët në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore do ta merrnin për bazë interesin publik e qytetarë dhe jo atë privat, siç bëjnë aktualisht përbaruesit privatë. Amendamenti jonë në shqyrtimin e dytë, pati marrë vetëm 11 vota për, pra ato të Lëvizjes Vetëvendosje, ndërsa 46 kundër, pra e kanë kundërshtuar PDK-ja, LDK-ja, AAK-ja dhe minoritetet. Pra, nuk u miratua.

Atë kohë nga Hajredin Kuçi thuhej se kjo do t'i ndihmonte sistemit të drejtësisë, nuk do t'i dëmtonte qytetarët, do t'i reduktonte lëndët, që në atë kohë ishin 150 mijë lëndë të pazgjidhura, ndërsa sot edhe përkundër përbaruesve privatë i kemi më shumë se 300 mijë lëndë të pazgjidhura dhe tani pas 4 vjetëve po del që ne kemi pasur të drejtë. Aktualisht, për shembull janë 140 milionë euro borxhe të pashlyera për rastet e shpronësimeve gjithandej Kosovës, qoftë për komunat, qoftë për qytetarët e Republikës.

Ajo çfarë është e papranueshme është se çështja e përbaruesve privatë problematizohet më së shumti nga një ditë dhe atë shumë rrallë, saktësisht sa herë shohim në medie ndonjë qytetar që vuan nga padrejtësia e vendimeve të përbaruesve privatë. Rasti i fundit ishte para tri ditësh në medie, por janë edhe me mijëra qytetarë që zërin e tyre s'e kemi dëgjuar, e të cilët vuajnë po ashtu nga vendimet e padrejta të përbaruesve privatë. Dhe, unë sot s'e kuptoj se si Ministria e Drejtësisë qëndron e heshtur karshi shkeljeve dhe keqpërdorimeve të përbaruesve.

Përmbaresi privat sot nuk merret me të fortët që e kanë kapur shtetin, por me pensionistin, me të shtypurit, me të varfrit, ata që janë në kategorinë e ndihmës sociale, ose në prag të saj. Koncepti i borxhit që duhet marrë me forcë kur qytetarët i ka braktisur plotësisht Qeveria e institucionet publike, kthehet në kamxhik në kurrizin e atij që, jo vetëm sot, qëndron në kushte të rënda ekonomike, por edhe të ardhmen ia kanë projektuar ashtu. Shteti nëpërmjet Qeverisë ka për detyrë t'i identifikojë nevojat dhe kërkesat shoqërore dhe ta plotësojë rregullimin ligjor në përputhje me rrethanat dhe nevojat shoqërore. E kemi thënë edhe në atë kohë, me anë të këtij ligji janë mbrojtur fundamentalisht interesat e kreditorëve. Sot, në kuptim të situatës socio-ekonomike në Republikën e Kosovës, kreditorët më të fuqishëm vijnë nga sektori bankar ose nga kompanitë private që na e kanë zhvatur shërbimin publik, si për shembull KEDS-i, dhe sigurisht që debitorët në të shumtën e rasteve janë qytetarët e mjerë që shpeshherë nga nevoja ekstreme hyjnë edhe në obligime, të cilat nuk kanë mundësi për t'i përmbushur, apo të cilët në mungesë të punës së rregullt, apo të punës së paguar keq, s'kanë as para për t'i paguar faturat e shtrenjta të energjisë elektrike.

Ministria e Drejtësisë deri më tani ka dështuar t'i evidentojë këto probleme, pra ka lejuar që të keqtrajtohen e të varfërohen edhe më shumë qytetarët e Republikës për shkak të arbitraritetit të tejskajshëm të përmbaresve privatë, e që shumë prej tyre janë pasuruar aq shumë në kurriz të qytetarëve të varfër.

Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, unë do të kërkoj në Komisionin për Legjislacion që të vlerësohet plotësisht gjendja aktuale dhe veprimi i përmbaresve privatë. Si dhe do t'i shohim të gjitha mundësitë si grup parlamentar që ta amendamentojmë ligjin dhe këtë detyrë t'ua kthejmë institucioneve publike, pra me përmbares publikë, pasi të jemi siguruar për kritere krejt të tjera sesi veprohet me sekuestrimin e borxhit të supozuar. Dhe, në fund, e thërras edhe kryeministrin Haradinaj, por edhe ministrin e tij Abelardin, të veprojnë dhe të mos qëndrojnë të heshtur karshi kësaj gjendjeje. Faleminderit!

KRYETARI: Faton Topalli, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate, urdhëro!

FATON TOPALLI: Të nderuar deputetë!

Sot dua të flas për një shkelje ligjore, shkeljen më të madhe që ka filluar menjëherë pas luftës dhe aktualisht përfshin mbi 220 mijë qytetarë, të cilët punojnë në sektorin privat. Nëse këtij numri ia shtojmë pastaj edhe 30 deri 40 % të të punësuarve ilegalë, atëherë kjo shifër do të ishte rreth 300 mijë.

Ata, të cilët kanë kontrata pune, në kontratë u figuron se duhet të punojnë 8 orë, ndërsa punojnë 12 orë në ditë, nuk kanë kompensim për orët shtesë për punën të shtunave dhe të dielave, nuk kompozohen për orët e natës, nuk marrin pushim vjetor sipas kontratës dhe largohen nga puna pa paralajmërim. E, kjo është shkelje e ligjit me dy këmbë. Kjo është fshehje e tatimit. Ky është

pasurim me veprimtari të jashtëligjshme. Ky është diskriminim dhe kjo na kthen në vitin 1886, kur punëtorët e Çikagos demonstrojnë, derdhin gjak më Një Maj dhe vdesin për implementimin e orarit të punës 8-orësh.

Aq më keq që kjo shkelje e ligjit i dëmton edhe ata ndërmarrës të rregullt që e respektojnë Ligjin e punës, por ky fakt i bënë të pabarabartë dhe me pasoja ekonomike në një konkurrencë të padrejtë me ndërmarrjet që e shkelin ligjin. Unë e ngreha sot këtë temë, jo pse është temë e panjohur, sepse kjo është një sekret publik, të cilin e din kryeministri, ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Prokuroria, Policia, Inspektorati i Punës, pra e dinë të gjithë. Po e ngre si temë, sepse kudo që kam kontaktuar me punëmarrës, një prej problemeve kryesore që kanë përveç pagave që nuk sigurojnë mbijetesë, është orari i gjatë i punës.

Tani, nëse një punëtorë punon 6 ditë në javë, nga 12 orë, që i bie 72 orë në javë, respektivisht 288 orë në muaj, atëherë punëtori që e ka rrogën 250 euro fiton 86 centë në orë, por nëse ai e ka rrogën minimale prej 170 eurosh në muaj i bie të fitojë 59 centë në orë. Ky nuk është vetëm trajtim i padinjitetshëm, ky nuk është vetëm diskriminim, ky është skllavërim. Skllavërim në shekullin XXI në vendin i cili pretendon të bëhet anëtarë i Bashkimit Evropian, ndërsa sa i përket respektimit të Ligjit të punës është 132 vjet prapa idesë së Shteteve të Bashkuara për tetorëshin, e lëre më vendeve evropiane, disa prej të cilave janë duke eksperimentuar për ta bërë orarin e punës 6 orë në ditë.

Me respektimin e orarit të punës, sipas Ligjit të punës, ne jo vetëm që do t'ia kthenim punëtorit një të drejtë legjitime dhe pak dinjitet, por do të siguronim edhe rreth 73 mijë vende të reja të punës. Natyrisht që një grup i vogël qytetarësh do të fitonin për 20% deri 30% më pak, megjithatë mjaftueshëm dhe më shumë se 95% e popullsisë në Kosovë.

Arsyeja e dytë pse po e ngre këtë temë është për ta ftuar kryeministrin dhe Qeverinë e Kosovës që të veprojnë. Nuk e di çfarë ndjenje është të jesh kryeministër i një vendi ku 300 mijë qytetarë të tij trajtohen si skllavër. E di që në vendin tonë ka shumë halle, e di që ka shumë punë dhe shumë probleme për t'i zgjidhur, por e di edhe që para bisedimeve me Serbinë, para Zajednicës, duhet të zgjidhen disa probleme elementare për qytetarët e Republikës së Kosovës. Këto kanë prioritet, zonja dhe zotërinj.

Ligji i punës është ligj i cili mbron më shumë punëdhënësit se sa punëmarrësit, prandaj dhe duhet të ndryshohet. Ministri i Punës ka deklaruar se ndryshimi i ligjit është në procedurë e sipër. Nëse ky ligj nuk sillet shumë shpejt, atëherë si Parti Socialdemokrate do ta ndërmarrim iniciativën për ndryshimin e tij. Qytetarët e punësuar kanë nevojë për një gjykatë të punës, e cila i trajton shpejt rastet e shkeljes së të drejtave të punëtorëve. 53 inspektorë të punës janë pak për t'i kontrolluar mbi 70 mijë ndërmarrje ekonomike, por Kosova ka edhe 9 mijë policë. Në Francë, në Gjermani dhe në vendet e tjera, me punësim ilegal nuk merren vetëm inspektorët e punës, por

merret edhe policia. Pra, duhet të mësohemi që t'i shfrytëzojmë burimet njerëzore për t'i realizuar dhe për të siguruar që në vendin tonë funksionon ligji.

Kryeministër, e keni rastin edhe mbështetjen tonë për të bërë diçka të mirë për 300 mijë qytetarë të Kosovës, ose të mbeteni si të gjithë kryeministrat e deritashëm, thjesht një kryeministër më shumë në radhën e kryeministrave të dështuar, çfarë unë nuk do t'jua dëshiroja. Faleminderit!

KRYETARI: Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar, Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Kosova vendi ku shëndetësia e ka koston më të lartë buxhetore për pacientët. Shëndetësia ku shërbimet shëndetësore ofrohen falas, por në fund kur bën llogarinë e një trajtimi, del se ke paguar shifër alarmante të parave.

Institucionet publike shëndetësore edhe më tutje vazhdojnë të përballen me mungesë të theksuar të barnave, pavarësisht se për këtë qëllim nga buxheti i shtetit janë ndarë më shumë se 20 milionë euro. Aktualisht janë duke munguar insulinat, barnat për kimioterapi, por edhe ato më elementaret, që janë në listën esenciale. Institucionet publike shëndetësore po ballafaqohen me mungesë të disa barnave nga lista esenciale, të cilat janë të nevojshme për trajtimin e pacientëve. Buxheti i ndarë për këto barna po del të jetë i pamjaftueshëm për përmbushjen e të gjitha kërkesave, edhe pse sivjet buxheti për barna është 28 milionë.

28 milionë euro, të cilat janë ndarë për furnizim me barna të listës esenciale, nuk janë të mjaftueshme për përmbushjen e të gjitha nevojave me to. Më e keqja është se furnizimi me barna nuk po bëhet me kohë, pra ka vonesa. Ndërsa mungesa e barnave po i shtyn pacientët që t'i blejnë vetë ato në barnatoret private. Prapë, mungesë e insulinave. Dhjetëra qytetarë presin në qendrat e mjekësisë familjare në Prishtinë dhe në qendrat e tjera për të marrë insulinë, të cilën nuk e marrin rregullisht. Ndërsa, barnat kimioterapeutike po ashtu mungojnë dhe çka është më e keqja edhe kur ka pacientët nuk mund ta marrin komplet terapinë, se njëra mungon dhe me koston që kanë këto barna, është e papërballueshme blerja e kësaj terapie nga pacientët.

Sipas ministrit, Ministria është duke bërë përpjekje që t'i parandalojë kontratat me çmime të larta të barnave dhe siç ka thënë ai furnizimi me barna do të stabilizohet. Ashtu edhe po shpresojmë. Ministria bën furnizim çdo javë në bazë të kërkesave të vetë institucioneve të bazuara në listën esenciale në fuqi, varësisht edhe me mundësitë buxhetore. Ministri dhe Ministria duhet të merren seriozisht edhe me raportin e auditimit, ku është gjetur se mungojnë një numër i madh i banderolave të barnave, e që sigurisht janë keqpërdorur. Duhet të saktësohet koha kur kanë

munguar këto banderola, kush ka qenë përgjegjës dhe ai që është përgjegjës duhet të përgjigjet penalisht për këtë abuzim që e ka bërë me banderolat.

Ka edhe të arritura në sektorin e shëndetësisë, sepse në shumë institucione lista e gjatë e pritjeve për trajtim të pacientëve është shkurtuar. Është rregulluar Kardiokirurgjia, po respektohet dukshëm më mirë orari i punës. Një ditë ndoshta ky sektor i shëndetësisë do të jetë mirë ashtu sikur edhe ndonjë sektor tjetër, apo që të krahasohet me vendet e rajonit, e për momentin nuk ka progres, por gjendja është e rëndë, edhe pse ka progres të vogël. Faleminderit!

KRYETARI: Enver Hoti, fjala për ju, në emër të Grupit Parlamentar Nisma.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër, tre ministra qenkan këtu, faleminderit!

Të nderuar qytetarë,

Dola ta ngre një temë, një shqetësim që gjatë këtyre ditëve e kemi hasur në takime me qytetarët. Fjala është konkretisht për prindër të fëmijëve të moshave 17-18-vjeçare, me nxënës të cilët janë në mbyllje të përfundimit të maturës të vitit, të klasës së 13-të, dhe ka të bëjë me gjendjen që është përreth shkollave tona të mesme.

Fjala është konkretisht për lokale dhe për objekte, të cilat funksionojnë dhe janë të licencuara, të cilat i shërbejnë nxënësit e moshave të ndryshme me shërbime të dëmshme, të rrezikshme dhe të jashtëligjshme.

Disiplina zakonisht në fund të vitit bie. Kjo është një çështje, e cila mendoj se duhet të trajtohet nga organet shkollore, por jo vetëm që bie disiplina në shkollë para nxënësve, të cilët e përfundojnë maturën, por ne u kemi ofruar atyre mundësi që të keqen ta zhvillojnë, sepse e keqja zhvillohet nga e keqja dhe atë të keqe ua kemi ofruar në dyert e shkollave, para syve të nxënësve. Aty nxënësit po shërbehen me mundësi jashtëligjore, të dëmshme dhe të rrezikshme, edhe një herë po e përsëris. Prandaj, kisha kërkuar nga kryetarët e komunave, nga inspektorët komunalë, nga Qeveria komunale, në përgjithësi, nga ata që i kanë pajisur ato lokale me dokumente e me licencime për zhvillimin e biznesit të tyre dhe nga Ministria e Arsimit, nga këshillat e bashkësive, që janë për siguri nëpër komuna, ato këshilla kanë detyrë të merren me këto çështje dhe kanë detyrë t'i mbrojnë nxënësit dhe fëmijët tanë para një gjendjeje, e cila me qëllim dhe para syve tanë po e dëmton rininë tonë. Po ashtu, Policia e Kosovës dhe Ministria e Punëve të Brendshme, deri te Ministria e Arsimit, mendoj se duhet ta shtojnë aktivitetin për të marrë aktivitete parandaluese për ta ndaluar këtë dukuri, e cila po i dëmton dhe po i shkatërron fëmijët tanë.

Prandaj, prindërit dhe qytetarët e ndryshëm me të drejtë e kanë ngrehur këtë shqetësim dhe ata kanë kërkuar që të merren masa nga organet kompetente, që nxënësit të jenë të mbrojtur dhe këto dukuri negative të jenë të parandaluara nga institucionet lokale dhe qendrore.

Edhe një herë kërkoj që të shtohet aktiviteti, të shtohet koordinimi i organeve përkatëse, sepse të keqen ua kemi ofruar para syve dhe mundësinë që nxënësit tanë, fëmijët tanë, të hasin në dukuritë negative, që nga pirja e duhanit, e deri te dukuritë tjera, ndoshta edhe alkooli, si dhe dukuritë tjera të cilat janë të dëmshme për nxënësit, që i kanë në derë të shkollës. Ne ua kemi rrasur në deri të shkollës për interesa të një grupi të ngushtë, do të thosha të njerëzve të pandërgjegjshëm dhe të matrapazëve, të cilët bashkëpunojnë me institucionet komunale, ndoshta edhe qendrore, dhe pajisen me licenca të ndryshme në ato lokale dhe objekte, të cilat u servojnë nxënësve mundësi të ndryshme të dukurive devijuese dhe unë mendoj se duhet të merren masa urgjente, që të parandalohen dhe të zhvillohen normat, të mbrohen nëpërmjet normave dhe të zbatohen ligjet në fuqi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në qoftë se e respektojmë kohën, e kemi vetëm edhe një pa grup parlamentar, Islam Pacolli. Të gjithë e keni të rëndësishme, seanca e vendos. Për mua jeni edhe dy, katër, gjashtë, tetë, dhjetë veta, mund të vazhdoni lirisht. Edhe Haxhiu më duket, më thanë, i njëmbëdhjeti. Njëmbëdhjetë janë. Ju e vendosni, unë tash ju pyes.

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, kryesues!

Përshëndetje Kabinet qeveritar!

Kolegë të nderuar,

Medie,

Sot dua ta shfaq një shqetësim sa i përket rrugës që është futur në buxhet prej urës së Veternikut deri në hyrje të Graçanicës.

Tani e kam kuptuar që është ndarë në tri lote, është dhënë një pjesë e rrugës, është filluar aty, punohet shkel e shko, dhe dy lote tjera do të thotë nuk janë fare në konsiderim. Nuk e kuptoj arsyen dhe shpreh shqetësimin për çfarë arsye është ndarë, nuk është dhënë komplet rruga në tërësi që të punohet prej fillimit deri në mbarim, e jo të mos fillohet në fillim, të fillohet në gjysmë e atje. Nuk e di deri ku kemi ardhur ne që po i injorojmë ata qytetarë të asaj ane.

Qeveria njëherë e përgjithmonë duhet ta kuptojë, nëse do ta tregojë veten, ta bëjë punën si duhet, jo t'i shkelë, jo t'i ndajë me lote. Nuk po di, a po bëhet pazar apo po hapet një tender dhe dihet sesi ka funksionuar. Unë me të vërtetë jam shumë i shqetësuar se krejt kjo punë që është dhënë janë 500 e ca metra. Pjesa tjetër, kur bëhet?

Çfarë arsyetimi do të japë ministri, nuk e di! E kisha lutur ministrin që të na japë një sqarim rreth kësaj çështjeje të kësaj rruge. Njëherë është anashkaluar komplet ajo zonë me rrugën kryesore,

tash edhe kjo copë që është duke u tenderuar e shtenderuar prej vitit 2015 deri sot, ende po shkon shkel e shko. Ata qytetarë janë të nënçmuar. Janë të anashkaluar. Unë mendoj se edhe qytetari do ta mbajë në mend këtë trajtim që jemi duke ua bërë. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Për t'i vazhduar diskutimet edhe 11 deputetë, po e shoh reagimin e deputetëve, me shmangie nga Rregullorja, me 2/3-at e të pranishmëve. E vëmë në votim. Ju kisha lutur të përgatitemi për votim, në qoftë se dëshironi... Po e shoh, ka reagime, janë bukur shumë deputetë. Po, ju e vendosni vetë, të mos jetë vetëm përgjegjësi e imja.

Lus regjinë dhe deputetët, a ka mundësi t'i të zënë vendet. Milaim, më fal! Nait! Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, do të thotë për ta vazhduar kohën për diskutime jashtë rendit të ditës, apo jo. Për të gjithë këta deputetë që janë në pritje. Tash... ose të gjithë, s'mund t'ua bëj të padrejtë. Votojmë... Po reagojnë, brenda grupeve ka reagime. Po duan nga dy. Votojmë tash, ju lutem, votojmë tash, po - jo?

Kanë fituar... Nuk mund të kalojë me këtë rezultat. Nga 72 deputetë të pranishëm të cilët kanë votuar, 36 janë për, 34 kundër, 2 abstenime. Do të duhej të ishin 48 për.

Do të thotë, vazhdojmë me pikat e rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare zgjat 60 minuta.

Ju njoftoj se kryeministri Ramush Haradinaj ka njoftuar me shkrim se prej 16-18 maj ndodhet në udhëtim zyrtar në Bullgari, andaj ka kërkuar që pyetjet e deputetëve që i janë parashtruar atij të barten për seancën e radhës.

Do të fillojmë me pyetjet e bartura nga seanca e mëparshme.

Mimoza Kusari-Lila, pyetje për ministrin Bajram Hasani. Urdhëroni, zonja Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Pyetjen e kam bërë edhe në seancën e kaluar. Ministri ka qenë këtu, por ka dalë, nuk e di nëse ia vlen ta lexoj pyetjen edhe një herë! Po pres kur të jetë ministri në seancë.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Avdullah Hoti, pyetje për ministrin Bejtush Gashi. Zoti Hoti, e keni fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Kjo pyetje është shtruar ndoshta para dy muajsh, në bazë të kërkesës së kryetarit të Bashkësisë Islame të fshatit Karaçevë për shqetësimet që ata vazhdimisht ngrenë nga futja në territorin e Kosovës të Policisë serbe. I është drejtuar pyetja ministrit paraprak, mandej është përsëri tek ministri tash ekzistues. E lus ministrin që të japë një sqarim në qoftë se është në dijeni për këtë dhe nëse është ndërmarrë ndonjë masë dhe planet e ministrisë dhe të tij personalisht për këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI BEJTUSH GASHI: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

I nderuar deputet Hoti,

Fillimisht ju falënderoj për interesimin që keni shfaqur lidhur me një problem shumë të ndjeshëm, që lidhet ngushtë me sovranitetin e Republikës së Kosovës, me paprekshmërinë e territorit dhe sigurinë e qytetarëve të saj.

Vëmendja e veçantë që unë i kushtoj kësaj çështjeje lidhet ngushtë edhe me faktin se është një çështje jo vetëm shumë e rëndësishme, por edhe e mbetur e pazgjidhur dhe të cilën unë si ministër e kam trashëguar. Ajo që dua të ju them në fillim të gjithë të pranishmëve të nderuar, është se kjo çështje do ta marrë përkushtimin tim të veçantë, me përpjekjet e mia të palodhura për zgjidhjen e saj përfundimtare.

Më lejoni tani të ju informoj në hollësi lidhur me këtë çështje dhe shqetësimet që lidhen me të.

Paraprakisht, përgjegjësia për mbikëqyrjen e vijës kufitare të Kosovës me Serbinë është ende nën mandatin e KFOR-it, i cili nuk e ka dorëzuar ende këtë mandat te Policia e Kosovës, ashtu siç e ka dorëzuar te pjesët tjera të vijës kufitare, me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi. KFOR-i mendon se pjesa e kontestuar ndërmjet fshatrave Novosellë dhe Karaçevë është nën juridiksionin serb, në bazë të Marrëveshjes Tekniko-Ushtarake të Kumanovës të vitit '99 dhe të nënshkruar ndërmjet KFOR-it dhe Ushtrisë serbe. KFOR-i respekton këtë marrëveshje dhe kërkon që ajo të respektohet edhe nga Policia e Kosovës.

Pavarësisht kësaj gjendjeje praktike, Policia e Kosovës është e pranishme në kufirin me Serbinë dhe e mbikëqyr këtë pjesë të kufirit në bashkëpunim me KFOR-in. Përfundimisht bëni vetëm pjesa e

vijës kufitare pranë fshatrave Karaçevë e Poshtme, Karaçevë e Epërme dhe Buhovitët, e cila është e pamundur të realizohet nga Policia e Kosovës për shkak të urdhëresës së komandantit të KFOR-it, gjeneral-major Salvatore Farina, më 12 maj 2014, e cila e ndalon shfrytëzimin e rrugës by-pas, që e lidh rrugën e vetme, e cila i mundëson Policisë së Kosovës që të ketë qasje në këto fshatra.

Kjo pjesë e kufirit dhe këto fshatra janë pa prani të Policisë së Kosovës që prej urdhëresës së komandantit të KFOR-it, më 12 maj 2014. Në afërsi të fshatit Karaçevë janë të vendosura disa post-bloqe të xhandarmërisë serbe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESEUSI: Faleminderit! Pyetje shtesë? A ke gjatë? Shumë, mësohuni... këtu histori në pyetje-përgjigje s'ka. Konkretizojë, e kontrollojmë atë pjesë, apo jo? Ne e morëm vesh që s'po e kontrollojmë, dhe mirë boll...! Vazhdo, meqenëse e ke si fillim, kryejë këtë përgjigje, por po ju tregoj që tre minuta i ka ministri për përgjigje.

MINISTRI BEJTUSH GASHI: Faleminderit!

Sa i përket pyetjes së dytë, pse s'është marrë asgjë deri më tani, dëshiroj të theksoj se me këtë problem janë marrë edhe ministrat paraardhës. Pra, duhet vënë në dukje se nuk duhet të thuhet se nuk është ndërmarrë asgjë. Ministrat paraardhës janë marrë disa herë me këtë çështje, duke kërkuar nga KFOR-i që t'i dorëzojë kompetencat për mbikëqyrjen e kësaj pjese të kufirit të Policia e Kosovës dhe të mundësojë që kjo e fundit të jetë e pranishme atje.

Gjithashtu, KFOR-i, i cili praktikisht është autoriteti i vetëm, që mirëkujdeset për këtë pjesë të kufirit, nuk u është përgjigjur këtyre kërkesave të kolegëve të mi, ish-ministra të Punëve të Brendshme. Natyrisht, unë si ministër e kam detyrë që të zhvilloj takime të rregullta, pa dyshim në takimin e radhës do ta ngre këtë çështje dhe do të paraqes shqetësimet e qytetarëve të Republikës së Kosovës, duke kërkuar veprime përkatëse nga KFOR-i.

Po ashtu, i ftoj të gjithë qytetarët që nëpërmjet Policisë kufitare t'i drejtohen KFOR-it me ankesat e tyre që kanë rreth këtyre shqetësimeve. Megjithatë, më duhet të ju bëj të ditur dhe të theksoj se anët e veçanta të këtij problemi janë përtej përgjegjësive të mija për trajtimin e tyre, e unë ndiej nevojën për një mbështetje të posaçme politike dhe juridike të institucioneve tjera.

Posaçërisht, pavarësisht mbështetjes në vlerësimet e KFOR-it, se siguria në territorin e Kosovës është në lartësinë e duhur, unë mendoj, po ashtu si kolegët e mi paraardhës, se edhe kjo pjesë e kufirit, sikur pjesët tjera, duhet që sa më shpejt të kalojë në përgjegjësinë dhe autoritetin e Policisë së Kosovës. Unë do të kërkoj nga KFOR-i që t'i kryejë veprimet e duhura për këtë çështje dhe të vazhdojmë bashkëpunimin si deri më tani.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Pyetje shitesë? Jo. Faleminderit! Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministren Albena Reshitaj. Zonja Musliu, e keni fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolege deputete dhe ju deputetë,

Kjo pyetje ka ardhur për herë të dytë në Kuvend, edhe kësaj radhe nuk është ministrja Reshitaj, ashtu siç po na ndodh rëndom të mos jenë ministrat që t'u përgjigjen pyetjeve tona. Unë po dëgjoj lajme e komente nëpër të gjitha mediat e Republikës së Kosovës për pasivitetin e deputetëve, dje e pashë lajmin më të freskët që 62% e deputetëve të Kuvendit të Kosovës nuk kanë bërë fare pyetje parlamentare. Unë mendoj që përfundimisht duhet të tregohet se kjo është një nga arsyet pse deputetët nuk kanë motiv të ngrenë çështje dhe të bëjnë pyetje parlamentare, sepse prej të gjitha pyetjeve parlamentare që i kam bërë gjatë kësaj legjislature, kam marrë përgjigje vetëm në dy pyetje parlamentare.

Kështu që u ka humbur kuptimi edhe pyetjeve parlamentare nga ana e deputetëve të Republikës së Kosovës.

Pyetja ime për zonjën Reshitaj ka pasur të bëjë me degradimin e ambientit në Brezovicë, kur dihet shumë mirë që atje qytetarët e Republikës së Kosovës kanë paguar taksë hyrëse për persona dhe për makina e autobusë, të gjitha çka kanë shkuar. Ndërsa po ta vizitosh Brezovicën sot e shoh se duhet të ecësh në një rrugë plot gropa, në një rrugë e cila të shpie në Brezovicë, por ka rrezik që të mos kthejë mbrapa.

Kështu që pyetja ka pasur të bëjë pikërisht me degradimin e ambientit atje, ndërtimeve pa leje, rrugës së shkatërruar dhe mbeturinave të shumta që janë në Parkun nacional ose në Brezovicë, një zonë me interes për shtetin tonë, Republikën e Kosovës.

Edhe një herë, ftoj ministrat që të jenë më të përgjegjshëm në pyetjet parlamentare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Musliu! Deputetja Besa Baftiu, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Uran Ismajli.

BESA BAFTIU: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër Ismajli,

Këtë pyetje e kam parashtruar edhe në mandatin e kaluar, meqenëse nuk kam marrë përgjigje, e kam përsëritur pyetjen dhe shpresoj që sot jo vetëm të marr një përgjigje pozitive, por edhe të bëni zgjidhje shumë të shpejtë sa i përket kësaj çështjeje.

Çështja ka të bëjë me certifikatat mjekësore që jepen për patentë shofer. Ka 4-5 vjet, ministër, që nuk jepen apo nuk lëshohen në institucionet shëndetësore publike. Gjegjesisht, këto certifikata lëshohen vetëm në institucionet shëndetësore private.

Si pasojë e kësaj, të hyrat në Qendrat e Mjekësisë Familjare kanë rënë për 3-4 fish. Prandaj, ministër, duhet të bëhet një zgjidhje në këtë drejtim. Meqenëse me Ligjin për shëndetësi institucionet shëndetësore publike dhe private janë të barabarta, do të duhej që këto certifikata mjekësore t'u mundësohen qytetarëve të Republikës së Kosovës të jepen edhe në institucione publike. Çka do të bëni në këtë drejtim dhe sa shpejt do ta zgjidhni këtë çështje? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri nuk është i njoftuar me pyetjen paraprakisht, po besoj që do të japë sqarimin e duhur. Faleminderit!

MINISTRI URAN ISMAJLI: Faleminderit!

E nderuar deputete,

Realisht pyetja nuk ka qenë e adresuar, domethënë nuk e kam pasur unë në pjesën e parë, po nuk është problem, po mundohem të jap një përgjigje.

Unë e kam marrë si problem, është ngritur edhe kështu kur kemi biseduar, tregon një lloj mostrajtimi, konsideroj, të barabartë të qytetarët, për arsye se aty janë ngarkuar me një pagesë.

Ne kemi filluar në dy fronte ta shohim këtë problematikë.

E para ka të bëjë me rishikimin e bazës ligjore, se cila çfarë baze ligjore është që e mbulon këtë dhe në qoftë se ajo bazë ligjore realisht bie ndesh me legjislacionin në fuqi, e cila i konsideron institucionet e barabarta, e në anën tjetër, po ashtu kemi kërkuar nga shërbimet mjekësore që të dalim me një plan, në të cilin do të kishim mundur të absorbojmë këtë kërkesë të qytetarëve. Pra, të mos ketë, në njërin anën, në qoftë se bëjmë një ndryshim ligjor, të mos kemi ngecje në hallka të tjera të shërbimit shëndetësor.

Prapëseprapë, këto kanë qenë disa iniciativa që i kemi filluar.

Unë pyetjen nuk e pata, po në qoftë se dëshironi, do të nxjerr material më shumë, në qoftë se kjo nuk është mjaft për ju, tani për tani. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë ka zonja Baftiu.

BESA BAFTIU: Është çudi që pyetja nuk ju ka ardhur, ashtu siç thashë, edhe në mandatin e kaluar nuk kam mundur të marr përgjigje, pse nuk e di, ministër.

Mirëpo është një çështje shumë serioze, sepse institucionet publike po dëmtohen sa u përket të hyrave të tyre.

Në vitin e kaluar, ministër, janë dhënë diku 60 600 certifikata mjekësore, nëse e përlogarisim sa është totali që kanë kushtuar, që i bie se minimumi një certifikatë mjekësore është 20 euro, mirëpo ka edhe të tilla për kategori të tjera që janë edhe më të shtrenjta, atëherë i bie që buxheti është duke u dëmtuar mbi një milion e 300 mijë euro.

Prandaj, ministër, do të duhej të bëhej një zgjidhje në këtë drejtim, ndonëse me një Udhëzim administrativ nuk lejohet që mjekë të profesioneve të ndryshme, gjegjësisht mjekët specialistë të punojnë në Qendrat e Mjekësisë Familjare.

Mirëpo do të duhej të gjendej një bashkëpunim dhe të bëhej një zgjidhje në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Baftiu!
Zoti ministër e keni fjalën prapë.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Faleminderit, deputete!

Realisht, ne jemi edhe dëshmitarë të problemeve të shumta që kanë qenë në sektorin e shëndetësisë, në kuptim qoftë të legjislacionit në fuqi, por në anën tjetër, edhe në mungesë të kësaj rregullative janë shkaktuar dëme të mëdha buxhetore, jo doemos gjithnjë te institucioni, sa janë shkaktuar dëme të mëdha në xhepin e qytetarit.

Për atë jam shumë i vetëdijshëm dhe jam duke punuar çdo ditë që të paktën këto shpenzimet ndaj qytetarëve, të cilat gjithmonë po shkojnë në rritje në shërbime mjekësore, realisht të zvogëlohen. Për këtë thashë se jemi duke bërë një lloj auditimi të legjislacionit në fuqi, në mënyrë që ta shohim se çfarë duhet të ndërrohet.

Prandaj, po ju them që e kam marrë shumë seriozisht dhe do të vazhdoj ta marr me seriozitet, por do të dal me një propozim që të mos kemi mandej ngecje në aplikim ose në zbatim të saj.

Edhe një herë po them, qëllimi im kryesor, përpos shërbimeve mjekësore, është t'i zvogëloj pagesat e qytetarëve për shërbime të cilat i marrin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Zonja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Skender Reçica, ministri nuk është këtu. Dëshironi ta bëni pyetjen?

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Megjithatë, edhe pse nuk është ministri, unë do ta parashtroj pyetjen, sepse mendoj se është e një rëndësie të veçantë.

Komisioni qeveritar ndërministror për përcaktimin e shkallës së invaliditetit ka një sjellje tepër të papërgjegjshme në raport me invalidët e luftës.

Unë si mjeke e luftës kam marrë shumë shqetësime nga bashkëluftëtarët, të cilët vetë i kam trajtuar në luftë, por atë që po e përjetoj në këtë komision, sot nuk po hyj në detaje, po para se të ndodhë ndonjë skandal, unë kisha dashur që ministri të ndërmarrë masa dhe të shohë se çka po bëhet.

Pyetja ka qenë: A po mbikëqyret puna e këtij komisioni nga ministri dhe nga ministria, sepse vërtet të gjitha ato deklarata që i kam dëgjuar nga bashkëluftëtarët po mendoj që nuk është korrekt ky trajtim që po u bëhet ushtarëve dhe në seancat e radhës ndoshta do të marr përgjigje nga ministri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri nuk është këtu. Zoti Haxhi Shala, pyetje për ministrin Reçica. A dëshironi ta bëni pyetjen, Haxhi?

HAXHI SHALA: Në qoftë se është e mundshme të shtyhen të gjitha pyetjet për ministrin, se shumë shpejt do të kthehet këtu dhe, kur të kthehet, në qoftë se ka kohë, i bëjmë pyetjet për ministrin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Albulena Halimaj-Balaj, pyetje për ministrin Reçica.

ALBULENA HALIMAJ-BALAJ: Faleminderit, kryesues!

Meqë ministri është në një aktivitet të rëndësishëm, po konsideroj që pyetjen time duhet ta bëj në seancën e radhës.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Naser Rugova, pyetje për ministrin Pal Lekaj. Pali nuk qenka këtu, as zoti Rugova nuk qenka.

Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Shyqyri Bytyqi, zoti Kurteshi, ministri nuk është këtu si të doni.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit! Unë i kam dy pyetje për ministrin e Arsimit, njëra ka të bëjë me ekskursionin e nxënësve dhe tjetra me çantat e rënda të nxënësve, po meqë nuk është ministri këtu, unë kërkoj që këto pyetjet të përsëriten në seancën e ardhshme, në praninë e ministrit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Nagavci, pyetje për ministrin Bytyqi prapë.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Edhe unë, meqenëse ministri nuk është këtu, do ta shtyj pyetjen për seancën tjetër.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Nagavci, pyetje për ministrin Hamza.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Zoti ministër,

Ashtu sikurse besoj se jeni në njohuri, Kontrata Kolektive e arsimit, e nënshkruar më 18.4.2017 në mes të ish-ministrit Arsimit dhe kryetarit të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit parasheh që zbatimi i nenit 35, pika 8 dhe 9 që ka të bëjë me pagesën e pagës jubilarë dhe tri pagave përcjellëse pas pensionimit, të përfshihen në Ligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018.

Kjo marrëveshje nuk është marrë parasysh kur është planifikuar Projektligji për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018 dhe nuk ishte aprovuar edhe atëherë nga Kuvendi as amendamenti që unë kisha propozuar për këtë çështje.

Përkundër kësaj, mësimdhënësit e pensionuar po e realizojnë të drejtën e tyre ligjore për tri pagat jubilarë pas pensionimit, me anë të vendimeve të gjykatës.

Së fundit, vetëm në Komunën e Ferizajt nëpërmes përmbauesve privatë së paku 20 mësimdhënës i kanë marrë buxhetit të komunës nga tri paga jubilarë pas pensionimit, të cilat në fakt atyre u takojnë me ligj.

Në këtë mënyrë po dëmtohet buxheti i taksapaguesve dhe komuna është e obliguar të paguajë edhe kamatën prej 8% të procedurave të përmbauesve.

Zoti ministër,

A do të parashihni në rishikimin e buxhetit planifikimin e mjeteve për këtë të drejtë që u takon mësimdhënësve të pensionuar, sepse ajo që po ndodh është që po dëmtohet buxheti i vendit për të paguar taksa dhe kamata për përmbauesit dhe po ashtu po i obligojmë mësimdhënësi të pensionuar të ndjekin pa nevojë betejat në komuna dhe gjykata për të realizuar një të drejtë, e cila është e garantuar me ligj.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hamza e keni fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

E nderuar deputete Nagavci,

Sa i përket kësaj çështjeje, edhe në takimet me organizatat buxhetore, kryesisht me komonat, pasi që numri më i madh i punësuarve në arsim është në nivelin komunal, tashmë janë veç edhe dokumente zyrtare.

Ne si Ministri e Financave kemi kërkuar nga ta që t'i reflektojnë fillimisht obligimet e tyre ligjore, në këtë rast edhe për çështjes të cilës ju i referoheni, sepse është obligim ligjor, qysh e thatë edhe ju, ndodhin tri gjëra të këqija.

E para, dëmtohen njerëzit, të cilëve ligji ua ka garantua një të drejtë.

E dyta, dëmtohet buxheti i shtetit, për shkak të shpenzimeve shtesë, dhe

E treta, mbingarkohen gjykatat me lëndë, ku paraprakisht dihet fundi i tyre.

Ne edhe në Komisionin e granteve që është mbajtur për buxhetin e vitit 2019, po edhe për buxhetin e vitit 2018, masa e mjeteve monetare nuk do të jetë problem për asnjë organizatë buxhetore që t'i kryejnë obligimet e veta ligjore për këtë çështje.

Nëse në fund ata kanë edhe për vitin 2018 mungesë të mjeteve buxhetore, si rezultat i këtyre vendimeve, ne si Ministri e Financave obligohemi që t'ua mbulojmë këtë pjesë të masës monetare.

Mirëpo, lutja jonë, po edhe kërkesa jonë në drejtim të organizata buxhetore, në këtë rast kryesisht të komunave, si organizata buxhetore, t'i kryejnë obligimet e veta ligjore. Do të thotë, ky është qëndrimi ynë, në Komision të granteve ekzistojnë edhe dokumentet zyrtare, procesverbalet, ku është kërkuar që t'i reflektojnë edhe t'i prezantojnë kërkesat e tyre sipas nevojave për rastet të cilave po u referohemi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Nagavci? Jo! Zoti Hoti, pyetje për ministrin Bytyqi, ministri nuk është këtu, dëshironi ta bëni?

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

Jo, do ta bëj kur është i pranishëm ministri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Enver Hoti, pyetje për ministrin Bedri Hamza.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër i Financave, zoti Hamza,

Do ta bëj një pyetje që është debatuar bukur shpesh: Pse nuk po realizohet transferimi i inspektorëve komunalë në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë?

Po mendoj se kjo është debatuar edhe në takim që kemi pasur me përfaqësues dhe me kryeshefin e agjencisë dhe mendoj që duhet të na jepni një shpjegim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër Hamza, e keni fjalën.

MINISTRI BEDRI HAZMA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Hoti,

Faleminderit për pyetjen!

Janë disa institucione që përballen me këtë situatë, është Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës, janë inspektorët e tregtisë në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, është çështja e zjarrfikësve. Kjo çështje duhet të adresohet dhe asnjë problem nuk ka që këto organizata buxhetore mes nivelit qendror dhe lokal të kenë memorandume të mirëkuptimit. Kjo çështje pastaj të trajtohet edhe përmes ligjit, sidomos përmes amendamentimit të Ligjit për financat e pushtetit lokal. Mirëpo bartja e punëtorëve nga niveli lokal në nivelin qendror duhet të bartet edhe me buxhet. Nuk mund të bartet numri i të punësuarve në nivel qendror, ndërsa buxheti për ta të mbetet në nivelin lokal, sepse dyfishohen atëherë shpenzimet e buxhetit.

Prandaj, inspektorët e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës të barten në kuadër të Agjencisë, mirëpo për këtë shumë të rritet buxheti i këtij institucioni, ndërsa të zvogëlohet edhe numri i të punësuarve, por edhe buxheti nëpër komuna. Përndryshe, aktualisht kërkesa është kjo. Inspektorët të barten në nivelin qendror, të buxhetohen sipas nevojave dhe masa e pagave dhe të gjitha shpenzimet e tjera, ndërsa buxheti aktual i komunave të mos preket, pavarësisht se këta kalojnë në nivel qendror.

Mirëpo kjo çështje mund të adresohet, siç e potencova, me memorandum mirëkuptimit mes këtyre organizatave buxhetore, por normalisht në një të ardhme kërkon edhe plotësim-ndryshimin e Ligjit për financat e pushtetit lokal. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë?

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar ministër!

Por duke parë gjendjen edhe në Ministrinë e Tregtisë, edhe në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe te zjarrfikësve, po edhe gjendjen e tyre, edhe mosfunksionimi për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive që i kanë këta njerëz, ju e thatë një arsye se duhet një bashkëpunim dhe koordinim për ndryshimin e Ligjit për financat publike, që është në nivel lokal dhe një koordinim, qoftë edhe si bashkëpunim me ndonjë memorandum bashkëpunimi.

Shiko, ministër, do të dal përtej kësaj Qeverie, edhe të kaluarën, po edhe tash. Koordinimi duhet të fillojë nga ju, koordinimi dhe bashkëpunimi duhet të fillojë nga Qeveria, jo konkretisht nga ju si ministër, po nga Qeveria, aty është edhe ministri i Tregtisë, edhe ministri i Punëve të Brendshme, mund të kontaktoni me komunat dhe me agjencitë, të cilat janë direkt në varësi të kryeministrit dhe të Qeverisë. Prandaj,...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Vazhdo, por keni kujdes, koha është e limituar.

ENVER HOTI: Do ta përfundoj, kryesues, kjo i bie që për shkak të moskoordinimit, punët po mbesin pa u kryer, kështu i bie. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, nënkryetar!

Koordinimi duhet të ndodhë mes organizatave buxhetore të nivelit qendror dhe të nivelit lokal.

Ministria e Financave nuk është pengesë dhe nuk do të paraqesë pengesë, e vetmja kërkesë legjitime, jam i bindur, edhe e drejtë është që me bartjen e të punësuarve, të bartet edhe buxheti. Kjo është dhe ne nuk e pengojmë, ekziston zgjidhja ligjore dhe mund të modelohet zgjidhje ligjore për këtë çështje.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Zoti Arbër Rexhaj, pyetje për ministrin Bejtush Gashi.

ARBËR REXHAJ: Faleminderit, kryesues!

Pyetja ime ka të bëjë me një çështje të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian dhe, në këtë kontekst, unë dua të shpreh ngushëllime për ish-deputetin Kujtim Paqaku, i cili ka dhënë një jetë për arsimimin dhe emancipimin e komunitetit rom.

Pyetja ime ka të bëjë me atë se a ka sesione të ndara në Burgun e Dubravës për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian dhe a ka kudo nëpër burgjet e Kosovës qeli ku diferencohet pra komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, sepse mbi bazën e informatave që kam unë, jo që ka, por të burgosurit e këtyre tri komuniteteve në njëfarë forme kërcënohen se do t'i çojnë në qeli të përbashkët, e nga aty edhe nuk mund të lëvizin dhe, nëse është kështu, këto qeli më nuk janë qeli burgu, por vërtet janë kampe përqendrimi!

Dhe se për herë e në vazhdimësi nga qytetarët e burgosur po na tregohen aty brenda dhe po thonë se ky komunitet aty rrihet, maltretohet, diferencohet, qoftë nga të burgosurit, por edhe nga punonjësit.

KRYESUESI: Faleminderit! Arbër, e paske habitur adresën, është dashur ministrit të Drejtësisë t'ia bësh pyetjen, se burgjet i mbulon Ministria e Drejtësisë, jo Ministria e Brendshme.

MINISTRI BEJTUSH GASHI: Faleminderit, nënkryetar!

Ju veç e dhatë përgjigjen, realisht kjo pyetje lidhet me sistemin e burgjeve, nuk hyn në fushëveprimtarinë e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Konsideroj se pyetja duhet të adresohet në Ministrinë e Drejtësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Po nëse do të japë përgjigjen Abelard Tahiri, ministër i Drejtësisë.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Sa i përket dërgimit, pavarësisht çfarë komuniteti, qofshin ata të komunitetit shumicë apo komuniteteve joshumicë, kjo bëhet në bashkëpunim të ngushtë edhe me gjykatat, pra të shumtën e rasteve këto janë vendime të gjykatave.

Nëse jo gjykata, nëse kemi të bëjmë me ndalesa, paraburgime, atëherë është çështje mes Policisë dhe Shërbimit Korrektues.

Deri sot nuk kam marrë vërejtje, qoftë me shkrim, qoftë me gojë, as nga përfaqësuesit e komuniteteve të tjera joshumicë në Kuvendin e Kosovës.

Mirëpo si shqetësim që e ngrite, unë do ta trajtoj dhe do të shoh me drejtorin e ri të Shërbimit Korrektues se vërtet a kemi raste të tilla. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë ka zoti Rexhaj.

ARBËR REXHAJ: Ka ndodhur një gabim teknik i sekretarisë së grupit tonë parlamentar, mirëpo çështja është kjo.

Unë pyeta shumë qartë: a ka seksione të ndara, ku këta qëndrojnë të ndarë dhe madje edhe pushimet ditore i bëjnë mbi baza të ndara? Ajo çfarë po them unë, ministër, është kjo. Ata qëndrojnë të ndarë, ka seksione të veçanta për ta, të cilat mund të konsiderohen edhe kampe përqendrimi. Unë nuk di a ka dërguar komuniteti rom, ashkali edhe egjiptian vërejtje të tilla, por ajo çfarë po them, të gjitha qëndrojnë dhe se kjo nuk ka emër tjetër, përpos që mund të themi janë kampe përqendrimi, pikë.

KRYESUESI: Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Po të siguroj që informatat i ke të gabuara, nuk ka raste të tilla, nuk ka përqendrime, nuk ka koncentrike të tilla, siç i quan ti, as të komunitetit ashkali, as të komunitetit rom, as të komuniteteve të tjera. Në rast se janë 3-4 vetë të komunitetit rom edhe rrinë bashkë qoftë në shëtitore, qoftë në pushimore, ajo është diçka tjetër.

Mirëpo, në asnjë rrethanë kurrë nuk është ngritur një çështje e tillë, asnjëherë si ministër i Drejtësisë tash e tetë muaj nuk kam marrë shqetësime të tilla. Pra, po të siguroj që të gjitha komunitetet, qofshin ata të shumicës, qofshin komunitetet joshumicë, trajtohen njëjtë, në kushte të barabarta. Është hera e parë për mua që po e dëgjoj një shqetësim të tillë.

Madje, kam kontakt të rregullt edhe me Avokatin e Popullit, as ai asnjëherë nuk e ka ngritur një çështje të tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Deputeti Sali Zyba, pyetje për ministrin Bedri Hamza.

SALI ZYBA: Zoti ministër,
Çështja është pagesa e inspektorëve të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në Mitrovicën e Veriut.

Sipas një deklarimi për media të ministrit të Tregtisë dhe Industrisë, zotit Hasani, konfirmon se 30 inspektorë të kësaj ministrie marrin paga pa punuar fare.

Andaj, i nderuar ministër,
Deri kur Qeveria e Kosovës, konkretisht Ministria e Financave do të lejojë dëmtimin e buxhetit të Kosovës, duke dhënë paga për punëtorët që nuk dalin në vendin e tyre të punës?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,
Shumë i nderuar deputet Zyba,
Besoj që pyetja ka mundur të formulohej pak më ndryshe ose në adresë tjetër.

Unë si ministër i Financave nuk e di dhe nuk janë pjesë e punës time deklaratat për media, të kujtudo qofshin ato. Po diçka është e vërtetë dhe faktike.

Secila organizatë buxhetore, në nivel qendror dhe lokal, është përgjegjëse për stafin e vet dhe për menaxhimin e buxhetit të vet.

Ministria e Financave nuk mban përgjegjësi, nuk ka autorizim t'u shkëputë kontrata të punësuarve nëpër organizata të tjera buxhetore, për më tepër, nuk ka evidencë kush vjen në punë edhe kush nuk vjen në punë në një organizatë buxhetore të nivelit qendror apo lokal, se është përgjegjësi e secilës organizatë buxhetore, edhe për ta menaxhuar stafin, edhe për punësime, edhe për zbatim të kontratave, edhe për menaxhim të buxhetit, edhe për përgatitje të listës së pagave. Ministria e Financave në momentin kur e propozon buxhetin, i cili aprovohet në Qeveri dhe në Kuvend, organizata buxhetore është përgjegjëse edhe për staf, edhe për buxhet. Ne si Ministri e Financave e bëjmë ekzekutimin e pagave.

Prandaj, nëse është një diçka e tillë, për sqarime më të hollësishme t'u kisha lutur t'i drejtohesh organizatës buxhetore konkrete, ndërsa Ministria e Financave përgjigjet për të punësuarit brenda Ministrisë së Financave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ka pyetje shtesë?

SALI ZYBA: Faleminderit, ministër!

Edhe për sqarimin, edhe për sugjerimin t'iu drejtuar ministrisë përkatëse, por meqenëse organi ekzekutues i shumë vendimeve kishim nevojë për konfirmimin nga ju për mënyrën dhe për qëndrimin tuaj për vijat buxhetore, mirëpo shqetësimi ynë, i qytetarëve, është për faktin se këta paguhen prej buxhetit dhe ka mundësi dhe jam i vetëdijshëm edhe për pyetjen që kam bërë, se ka mundësi që ministria juaj të kërkojë raporte për persona zyrtarë, sepse janë të Qeverisë, je pjesë e Qeverisë dhe do të duhej të kishim një përgjigje tjetër, qoftë edhe në bashkëpunim, se pyetja ka qenë me shkrim, keni mundur të jeni të informuar edhe për mënyrën edhe ju si ministri, për mënyrën se si do të duhej të ndërpriteshin këto, sepse janë shqetësime të qytetarëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Albulena Haxhiu, pyetje për ministrin Abelard Tahiri.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit! Çështja ka të bëjë me kategorizimin e zyrtarëve korrektues.

Ligji nr. 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale, në nenin 221 thekson: “Zyrtarëve korrektues, për shkak të rrezikshmërisë, rëndësisë si dhe kushteve të veçanta të punës, për çdo 12 muaj pune u llogariten si gjashtëmbëdhjetë muaj stazh i siguar, kurse në llogaritjen e pagave u sigurohet një shtesë e të ardhurave”.

Kategorizimi i zyrtarëve korrektues të cilët do të realizojnë beneficionet e parapara në paragrafin 1 të këtij neni rregullohet me akt të veçantë nënligjor, të cilin e nxjerr ministri.

Gjatë ditëve të kaluara kam pasur takime me shumë zyrtarë korrektues, për shkak të vizitave që i kam realizuar, qoftë në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan, në Pejë, por edhe në Dubravë dhe atje nga zyrtarët korrektues është shprehur shqetësimi që ende ky akt nënligjor nuk është nxjerrë nga ministri i Drejtësisë, në këtë rast nga zoti Tahiri.

Andaj, pyetja ime për ministrin e Drejtësisë është pse ende nuk është nxjerrë ky akt nënligjor? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Tahiri, e keni fjalën.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: E nderuar zonja Haxhiu, Faleminderit për pyetjen,

Ju e dini që prej ardhjes sime si ministër i Drejtësisë kam premtuar ndryshime të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale. Pra, pikërisht tashmë jemi në fund, ka përfunduar edhe afati i konsultimeve paraprake, edhe afati i konsultimeve me publikun dhe brenda dy javësh do ta procedojmë në Qeveri Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Për faktin që kemi punuar në plotësim-ndryshim të këtij ligji, nuk i kam proceduar aktet nënligjore. Pra, do të përfundojnë këto ndryshime që i kemi bërë, besoj që janë substanciale për funksionimin edhe të Shërbimit Korrektues dhe, pasi të miratohet në lexim të dytë, atëherë do t'i nxjerrim këto akte nënligjore që ju i cekët.

Është tejet e rëndësishme të adresohen disa prej çështjeve, pra është edhe çështja e zgjedhjes së drejtorëve të qendrave korrektuese. Tashmë e kemi në nivelin e njëjtë, ashtu siç e zgjedhim drejtorin e Shërbimit Korrektues.

I kemi edhe drejtorët e qendrave korrektuese që realisht nuk u jepet prioritet punëtorëve të Shërbimit Korrektues, të cilët bëjnë karrierë aty. Këtë çështje do ta ndryshojmë. Pra me projektligjin e ri që do ta sjellim në Kuvend, do ta ndryshojmë këtë çështje dhe do t'u japim përparësi zyrtarëve, oficerëve korrektues dhe sa më pak të sjellin parashutistë nga jashtë në këto qendra, sepse pastaj po krijohen edhe probleme.

Në momentin kur do të miratohet ky projektligj, besoj që do të arrijnë ta gjejnë gjuhën e përbashkët me të gjithë deputetët dhe do ta adresojmë çështjen e beneficioneve të të burgosurve, ditët e pushimit, e kam ritheksuar që do t'i kthejmë ashtu siç kanë qenë me projektligjin e mëparshëm. Atëherë do t'i adresojmë këto akte nënligjore që ju i përmendët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë ka Albulena.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale është në fuqi për vite të tëra dhe është e padrejtë që ende nuk është nxjerrë ky akt nënligjor, duke pasur parasysh faktin që zyrtarët korrektues kanë rrezikshmëri të lartë për shkak të punës që bëjnë, kanë trajtim jo të dinjitetshëm, kanë kushte jashtëzakonisht të rënda. Madje, kanë edhe mungesë të uniformave, pra, përballen me kushte jashtëzakonisht të vështira, qoftë në paga, qoftë edhe për shkak të rrezikshmërisë nuk kanë asnjë beneficion apo asnjë shtesë.

Për mua është goxha e çuditshme se si nuk veprohet në kohë të duhur dhe në kohë të shpejtë në këtë drejtim.

Unë shpresoj që Ministria e Drejtësisë do t'i përfshijë këto të gjitha në ligj, jo më në akte nënligjore, sepse po manipulohen, po thuhet që do të nxirren brenda gjashtë muajve, e ato nuk po nxirren fare. Prandaj, është e rëndësishme që...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, fjala është juaja.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Unë po të siguroj që Shërbimi Korrektues i Kosovës ndoshta nuk funksionon në kushtet më të mira të mundshme, mirëpo nëse e krahasojmë me të gjitha vendet e rajonit, është shembull jashtëzakonisht i mirë.

Nuk kemi mungesë të uniformave, nuk kemi mungesë të pajisjeve të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Pra, është e palogjikshme të shkojmë me aktet nënligjore, kur jemi duke punuar në plotësim-ndryshimin e ligjit dhe unë besoj që bashkërisht me juve do ta nxjerrim më të mirë e mundshme edhe për Shërbimin Korrektues të Kosovës, pra edhe për ata zyrtarë, për atë agjenci që zbaton ligjin në qendrat korrektuese. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sami Kurteshi, pyetje për ministrin Abelard Tahiri.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Çështja ka të bëjë me rastin Dehari.

Bazuar në vendimin e Kuvendit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, datës 13.10.2017 për mbulimin e shpenzimeve për një hetim ndërkombëtar të rastit të Astrit Deharit, i cili vdiq në rrethana të dyshimta në Qendrën në Prizren, domethënë edhe të Prokurorisë për krime të rënda, Departamenti për Krime të Rënda në Prizren, të datës 5.2.2018.

Është kërkuar nga Qendra e Mjekësisë Ligjore në Universitetin e Lozanës në Zvicër që të ndërmarrë të gjitha veprimet e tjera të pavarura hetimore, e pastaj të ofrojë mendim profesional në drejtim të zbardhjes së këtij rasti.

Pyetja ime ka të bëjë: Që nga data 16 mars 2018, kur ju keni informuar Kuvendin në lidhje me veprimet e ndërmarra nga Kuvendi, Qeveria dhe Prokuroria kompetente në lidhje me rastin, as familja, as avokati i familjes, por as Kuvendi nuk ka pranuar ndonjë njoftim apo informatë se çfarë është ndërmarrë deri më tani apo çfarë do të ndërmerret në të ardhmen në lidhje me rastin në fjalë. Në cilën fazë janë hetimet, për të cilat në bazë të kompetencave ligjore është e informuar Qeveria, respektivisht ministria juaj, si ministri kompetente për bashkëpunim ndërkombëtar në këtë rast. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Faleminderit për pyetjen, i nderuar zoti Kurteshi!

Unë ju informoj që në këtë javë ka përfunduar përkthimi i lëndës komplet, ashtu siç kam informuar edhe në seancën e marsit të këtij viti, ka qenë një lëndë mjaft voluminoze, me një material pothuajse rreth 3000 faqesh dhe tashmë këtë javë ka përfunduar përkthimi i saj.

Jam i informuar nga Prokuroria e Shtetit që javën tjetër, nga e hëna e tutje, lënda do të dërgohet përmes atashut policor të Ambasadës së Zvicrës që është në Republikën e Kosovës drejt institutit në fjalë.

Pra, Ministria e Drejtësisë nuk është ndërlidhëse në këtë rast, është direkt prokurori i rastit, përmes Prokurorisë së Shtetit dhe atashut policor, në këtë rast Ambasadës së Zvicrës.

Nga java e ardhshme e tutje rasti do t'i bartet konform marrëveshjes që është arritur mes Prokurorisë së Shtetit dhe institutit në fjalë.

Pra, deri tani ka qenë në fazën e përkthimeve, këtë javë ka përfunduar, nga java e ardhshme do t'i shkojë institutit në fjalë, pra në Zvicër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, Sami? Jo! Zonja Drita Millaku, pyetje për ministrin Shyqyri Bytyqi. Shyqa nuk është këtu.

DRITA MILLAKU: Meqenëse ministri nuk qenka këtu, po e lëmë për herën tjetër.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Drita Millaku, pyetje për ministrin Bejtush Gashi.

DRITA MILLAKU: Faleminderit! Çështja është kërkesa e qytetarëve për rikthim të shtetësisë.

Në Prizren ka shumë kërkesa për rikthimin e shtetësisë së Kosovës nga shqiptarët e shpërngulur në Turqi gjatë kohës së represionit të Rankoviqit.

Pyetja, i nderuar ministër, është kështu: A është menduar që t'u krijoni kushte këtyre personave për rikthimin e shtetësisë, sikurse që është me komunitetin serb?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gashi, e keni fjalën.

MINISTRI BEJTUSH GASHI: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

E nderuar zonja Millaku,

Duke ju falënderuar për pyetjen, më lejoni t'ju informoj se Ligji për shtetësinë e Kosovës numër 04/L-2015 e njuh të drejtën e fitimit, natyralizimi i lehtësuar sipas të drejtës ndërkombëtare, të shtetësisë për pjesëtarët e diasporës, konkretisht të gjithë personat që kanë lindur në Kosovë dhe gjeneratës së parë të tyre, fëmijëve të tyre në përgjithësi. Kjo procedurë zhvillohet përmes kërkesës për fitimin e shtetësisë, duke plotësuar dokumentacionin e nevojshëm dhe brenda një periudhe 180-ditëshe kthehet përgjigjja nga e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Kur kemi të bëjmë me pjesëtarët e diasporës nga Turqia, atëherë më lejoni t'ju informoj se pjesa dërmuese e tyre ka të bëjë me një problem që lidhet me ndryshimin e identitetit të tyre në Turqi, si për shembull, emri, mbiemri, data e lindjes, shpeshherë edhe vendi i lindjes, këto të dhëna nuk gjenden në regjistrin e të lindurve në Republikën e Kosovës.

Këto të dhëna duhet të harmonizohen me të dhënat që janë në regjistrat e Republikës së Kosovës dhe pastaj mund të fitojnë shtetësinë e Republikës së Kosovës.

Pyetja e cila i referohet komunitetit serb, ju informoj se nuk kemi të bëjmë me të njëjtën kategori ligjore, pasi që Ligji për shtetësi, përkatësisht neni 32, thotë: "Të gjithë shtetasit e ish-Republikës Federale të Jugosllavisë, të cilët kanë pasur shtetësinë jugosllave me banim deri më 1 janar 1998, konsiderohen shtetas të Republikës së Kosovës dhe i regjistrohen në regjistrin e shtetasve".

Kjo procedurë ndiqet në zyrat e gjendjes civile në komunat përkatëse, në këtë kategori hyjnë: të lindurit në Kosovë, pasardhësit e tyre si dhe personat të cilët kanë pasur shtetësinë jugosllave dhe kanë jetuar pesë vjet në Republikën e Kosovës deri më 1 janar 1998.

Pra, këtu nuk kemi të bëjmë me të njëjtën kategori, kategoria e parë hyn në kategorinë e natyralizimit, ndërsa kategoria e dytë konsiderohen si shtetas.

Një gjë duhet ta kemi parasysh se nuk bëjmë dallime mbi baza etnike e racore, por ndiqen të gjitha procedurat, të cilat përfshihen pa dallim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Pyetje shitesë? Jo! Deputeti Shemsi Syla, pyetje për ministrin Rrustem Berisha. Zoti Syla, a do ta bësh pyetjen apo?

SHEMSI SYLA: Meqenëse nuk qenka ministri, pyetja është me rëndësi, do ta lë kur ministri të jetë këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Aida Dërguti, pyetje për ministrin Bedri Hamza.

AIDA DËRGUTI: Zoti ministër, në vitin 2013 është zyrtarizuar anëtarësimi i Kosovës në Bankën Zhvillimore të Këshillit të Evropës me të drejta të plota. Kosova edhe ka miratuar Ligjin nr. 04/L-222 për ratifikimin e neneve të marrëveshjes themeluese të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe anëtarësimin e Kosovës në Bankën Zhvillimore të Këshillit të Evropës.

Nga informacionet që kemi, Qeveria e Kosovës dhe Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës vite më parë kanë biseduar lidhur me disa projekte prioritare, për të cilat ne nuk kemi informacione zyrtare. Zoti ministër, a mund të na tregoni se a ka dërguar Kosova ndonjë projekt të veçantë për aplikim në Bankën Zhvillimore të Këshillit të Evropës?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Shumë e respektuar deputete Dërguti,

Kosova ka listën prioritare të projekteve, e cila është përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ministria e Integritimit Evropian, nga ku identifikohen projektet për sektorin e transportit, energjisë, mjedisit dhe atij social.

Siç besoj jeni të informuar, Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës është institucion financiar i themeluar nga Këshilli i Evropës dhe mbulon projektet që kanë ndikim socio-ekonomik. Me qëllim të konkurrimit me projekte në këtë institucion, të gjitha projektet duhet të kenë studim fizibiliteti dhe duhet të kenë së paku dizajnin preliminar, prandaj kërkohet nga të gjitha organizatat buxhetore që për projektet, të cilat mendojnë t'i financojnë përmes këtij institucioni, në Ministrinë e Financave të vijnë me projektet që kanë studim fizibiliteti dhe së paku dizajn preliminar. Ministria që drejtoj deri më tani ka përgatitur aplikacione për financim dhe studim nga korniza investuese e Ballkanit Perëndimor, të cilat në vitet e fundit kanë financuar vetëm aplikacionin në sektorin e transportit dhe të energjisë në linjë me politikën e Bashkimit Evropian për të financuar agjendën e ndërlidhshmërisë.

Me insistimin e Ministrisë së Financave, kemi marrë përgjigje pozitive në kërkesën tonë për financimin e projektit për banim social në nivel vendi. Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës pritet të dërgojë ekipin për të filluar studimin, praktikë kjo që është përsëritur edhe në shumë vende të tjera të Ballkanit Perëndimor. Ne jemi të interesuar që të fillojmë sa më shpejt realizimin e projekteve me këtë institucion, mirëpo megjithatë, sa i përket huazimeve jemi të interesuar të procedojmë vetëm për ato projekte, të cilat kanë fizibilitet dhe të jemi të kujdesshëm me rritjen e borxhit publik, jo për të gjitha projektet, por vetëm për projektet që kanë arsyeshmëri dhe kanë kthim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja nënkryetare?

AIDA DËRGUTI: Faleminderit, kryesues!

Ju besoj e dini që Këshilli i Evropës nuk është institucion i Bashkimit Evropian, pra është institucion i ndarë dhe projektet, të cilat i financon Banka Zhvillimore, ka të bëjë me strehimin e personave që bëjnë pjesë në grupet me të ardhura të ulëta ose krijimin e infrastrukturës sociale.

Sidoqoftë, shqetësuese që deri më tani nuk ka pasur ndonjë projekt dhe ju e dini që tashmë po synohet anëtarësimi në Këshillin e Evropës dhe aktualisht në dy institucione të Këshillit të Evropës ne jemi të anëtarësuar, në Komisionin e Venecias dhe në Bankën Zhvillimore. Unë druaj se do të konsiderohen ose do të marrim poenë negative, për faktin se kemi qenë shumë pasivë, duke e pasur këtë mundësi që ta shfrytëzojmë për kreditë që janë shumë të favorshme dhe për projektet, të cilat janë të domosdoshme dhe shumë të nevojshme për Kosovën, prandaj dua ta di cili do të jetë afati më i shkurtër kur ju...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën. Dua dhe unë ta përforcoj atë që e tha Aida, kemi pasur vërejtje dhe kërkesë që ka mungesë të bashkëpunimit në Këshillin e Evropës.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Unë e thashë edhe në paraqitjen time të parë dhe po e përsëris, me insistimin e Ministrisë së Financave kemi marrë përgjigje pozitive në kërkesën tonë për financimin e projektit për banim social në nivel vendi. Pritet që të vijë ekipi i bankës për të biseduar me institucionet tona vendore, me qëllim që të përgatitet marrëveshja për ratifikim. Do të thotë, është përgjigja pozitive dhe unë besoj që do të vijmë shpejt në Kuvend me marrëveshje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Skenda është vonuar, në qoftë se dëshironi, meqenëse u përpoq të mbërrijë më shpejt, ju mund t'i parashtroni pyetjet për zotin Reçica. Atëherë, zonja Time Kadrijaj nuk është këtu. Zoti Haxhi Shala e ka një pyetje.

HAXHI SHALA: Po, kryesues, faleminderit!

Zoti ministër, jemi të vetëdijshëm se respektimi i të drejtave të punëtorëve, kushtet jo të mira në punë, siguria dhe shëndeti mbesin ende ndër sfidat kryesore me të cilat përballen punonjësit në përgjithësi. Pyetja: i nderuar zoti ministër, tashmë ke lansuar strategjinë sektoriale në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin 2018-2022. Më intereson të di nëse keni paraparë hapa konkretë në këtë strategji sa i përket respektimit të të drejtave të punëtorëve, përmirësimit të kushteve të punës, si dhe shëndetin në punë? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër Reçica, e ke fjalën.

MINISTRI SKENDER REÇICA: I nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Faleminderit për mundësinë,

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

I nderuar deputet Shala,

Faleminderit për pyetjen tuaj.

Për informimin tuaj në strategjinë sektoriale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, por edhe në programin qeverisës, dokumente të cilat janë të bazuara dhe në dokumente strategjike për integrimin evropian, për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe dokumente të tjera, si dhe programi për reforma ekonomike të agjendës evropiane janë paraparë një sërë masash për të ngritur dhe garantuar respektimin e të drejtave të punëtorëve, për përmirësimin e kushteve të punës, krijimit të sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.

Ne si Ministri e Punës kemi nxjerrë disa rregullore vitin e kaluar për sigurinë dhe shëndetin në punë, të cilat janë transpozuar disa direktiva të Bashkimit Evropian dhe këto rregullore ndihmojnë në zbatimin e Ligjit për siguri dhe shëndet në punë. Duke qenë të vetëdijshëm se siguria dhe shëndeti në punë janë çështje jetike për punonjësit, por edhe për vetë punëmarrësit, në muajin e kaluar kemi lansuar fushatën për sigurinë dhe shëndetin në punë me moton “Siguria dhe shëndeti në punë, mbi të gjitha”. Kemi filluar fushatën vetëdijesuese këtë vit më herët se rëndomë dhe kemi filluar nga sektori me rrezikshmëri më të lartë, siç është ai i ndërtimtarisë dhe po vazhdojmë edhe në sektorë të tjerë. Në këtë fushatë u kemi kërkuar dhe u kemi përkujtuar punëdhënësve, por edhe punëmarrësve, vendosmërinë tonë në zbatimin e legjislacionit për sigurinë dhe shëndetin në punë, rëndësinë e zbatimit të tij dhe jemi zotuar se ky legjislacion duhet të respektohet nga të gjithë, sepse nuk do të ketë kompromis me të gjithë ata që nuk e zbatojnë.

Për këtë ne kemi kërkuar nga Inspektorati i Punës që të jetë më shumë në terren dhe këtë vit, krahasuar me vitin e kaluar kemi një numër shumë më të madh të inspektimeve. Sa u përket të drejtave të punëtorëve, ato janë të garantuara me ligj dhe Inspektorati i Punës, sikurse për sigurinë dhe shëndetin në punë, është duke u angazhuar edhe në respektimin e të drejtave të

punëtorëve dhe evidentimin e shkeljeve të të drejtave të tyre. Ju njoftoj se ka pasur dhe ka vështirësi në zbatimin e Ligjit aktual të punës dhe për këtë ne kemi filluar reformën e ligjit të marrëdhënies së punës. Kemi përfunduar koncept dokumentin për Ligjin e marrëdhënies së punës, Ligjin për pushimin e lehonisë dhe atë prindëror, i cili pritet të miratohet në Qeveri në një nga mbledhjet e radhës.

Në këtë koncept dokument, ne kemi transpozuar 15 direktiva të Bashkimit Evropian, të cilat rregullojnë marrëdhënien e punës, pushimin e lehonisë dhe atë prindëror. Duhet të jetë një ligj, i cili do të mbrojë të drejtat e punëtorëve, do të mbrojë të drejtat e lehonave dhe do të jetë gjithashtu lehtësisht i zbatueshëm në praktikë. Për të mbikëqyrur zbatimin e këtij legjislacioni, ne tashmë kemi dërguar për miratim në Qeveri edhe Ligjin për Inspektoratin e Punës, i cili po ashtu është një ligj bashkëkohor, i cili avancohet proceset e Inspektoratit dhe avancohet ngritjen profesionale të inspektorëve. Gjithashtu, këtë vit kemi paraparë që numri i inspektorëve të rritet, si dhe jemi duke punuar shumë në krijimin e kushteve më të mira për punën e inspektorëve me qëllim që të mos...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: A ke shumë, a e përfundove? Hajde, përfundojeni!

MINISTRI SKENDER REÇICA: Fare shkurt! Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Përpos të gjitha këtyre që u cekën më lart, ne kemi shtuar kontrollin në Inspektorat dhe jemi duke kërkuar përgjegjësi dhe raporte shumë të shpeshta për punën e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Pyetje shtesë, zoti Shala?

HAXHI SHALA: Jo, zoti kryesues! Faleminderit!

KRYESUESI: Në rregull! Zonja Balaj, e keni fjalën!

ALBULENA BALAJ-HALIMAJ: Faleminderit, kryesues!

Atëherë, unë desha të pyes ministrin për gratë dhe të rinjtë.

I nderuar ministër, nga statistikat që nxirren nga organet kompetente shohim se në listat të të papunëve prijnë gratë dhe të rinjtë. Ata hasin në vështirësi për të gjetur një vend pune dhe nuk janë fatkeqësisht të përfshirë në tregun e punës.

Desha të pyes nëse keni politika, të cilat mund t'i përfshijnë gratë dhe të rinjtë në punë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Reçica, e ke fjalën!

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

E nderuar deputete Balaj-Halimaj, faleminderit për pyetjen,

Përfshirja e të rinjve dhe grave në punësim është një çështje shumë serioze sa i përket vendit tonë dhe në këtë drejtim ne jemi duke punuar me përkushtim shumë të lartë.

Tashmë dihet se kemi një grumbullim të gjeneratave, të cilët kanë diplomuar dhe ende janë në kërkim të një vendi pune të qëndrueshëm, por edhe punësim sezonal. Natyrisht, që kemi edhe të rinj të tjerë, të të dy gjinive, si meshkuj ashtu edhe femra, të cilët nuk kanë ndonjë përgatitje, por janë në kërkim të një vendi pune. Ju njoftoj se në këtë fillim vit ne kemi miratuar Planin e veprimit për punësimin e të rinjve 2018-2021, qëllimi kryesor i këtij plani ndërsektorial është rritja e qasjes së të rinjve në tregun e punës përmes ofrimit të shërbimeve cilësore të punësimin dhe masave aktive të punësimin, rritjen e punësimin ndërmjet zhvillimit të ndërmarrësisë, harmonizimit të arsimit profesional me kërkesa dhe nevoja të tregut të punës, orientimit në karrierë, si dhe ngritjen e cilësisë së mësimin praktik në shkollë dhe praktikës profesionale jashtë shkollës.

Ne tashmë kemi filluar me masat aktive në tregun e punës, si përfshirjen në punë publike, praktikë në punë, subvencionin në paga, si dhe së shpejti në ndërmarrësi, ku të rinjtë tanë do të mund të përfitojnë në bazë të shkathtësive të tyre në grante dhe subvencione, të cilat do të çojnë pastaj në vetëpunësim të qëndrueshëm për ta, por edhe për të tjerët. Në këtë aspekt nga janari i këtij viti e deri më tani në aftësim profesional janë përfshirë 2 mijë e 348 punëkërkues, ndërsa në kuadër të masave të tjera aktive janë përfshirë 1 mijë e 15 punëkërkues, gjysma e këtyre punëkërkuesve janë femra, që është një lajm i mirë.

E nderuar deputete Balaj,

Sa i përket punësimin, dua t'ju informoj se ne tashmë kemi nisur projektin e punësimin të një anëtari të familjeve të cilat nuk kanë asnjë të punësuar. Ky projekt është pjesë dhe objektiv i strategjisë sektoriale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe tashmë kemi filluar t'i takojmë familjet, të cilat nuk kanë asnjë të punësuar. Familje këto të identifikuar dhe të cilat janë në nën asistencë sociale, kategoria e dytë. Jemi angazhuar dhe po punojmë shumë që të paktën një anëtar i këtyre familjeve që është i aftë për punë, i përgatitur me përgatitje shkollore dhe aftësim profesional, të përfshihet në masat aktive të tregut të punës, ndërsa ata të cilët nuk kanë aftësi profesionale do t'i orientojmë në trajnime profesionale, në qendra të aftësimin profesional dhe do të përgatiten ato profesione në bazë të nevojave dhe kërkesave të tregut të punës.

Javë më parë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me Qeverinë Gjermane, përkatësisht GIZ-in gjerman në Kosovë dhe Odën Ekonomike kosovare-gjermane, kemi

organizuar panairin e punës, ku janë ofruar mbi 4 mijë vende pune dhe ne si ministri jemi duke u përpjekur që të jemi ndërmjetës dhe mbështetës që këto vende pune të ofruara dhe të paraqitura nga bizneset vendore dhe ndërkombëtare, nga ato kompani, të cilat ishin të pranishëm jo vetëm nga Kosova të bëhen realitet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Përfundoje fjalën, ministër!

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, nënkryetar!

Një tjetër mundësi që do të hapet për të rinjtë tanë është punësimi sezonal në vendet e Bashkimit Evropian dhe ne tashmë jemi në negociata me disa nga këto shtete të Bashkimit Evropian dhe besoj që në të ardhmen e afërt do të kemi lajme konkrete në këtë drejtim sa i përket punësimit sezonal me vendet e tjera.

Të nderuar deputetë,

Si Ministri e Punës dhe Mirëqenies Sociale jemi duke u angazhuar maksimalisht në disa drejtime për të zvogëluar papunësinë në vend dhe me ndihmën e të gjitha institucioneve të sektorit privat, por edhe të organizatave ndërkombëtare, si GIZ, Zyra e komisionit evropian, USAID, UNDP e tjerë, shpresojmë të arrijmë qëllimin dhe të përmbushim objektivat që i kemi vënë para vetes si institucion për zbutjen e papunësisë në vend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Reçica.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Zoti ministër, pyetja është e tillë: Komisioni qeveritar ndërministror për përcaktimin e shkallës së invaliditetit ka një sjellje tepër të papërgjegjshme në raport me invalidët e luftës.

Unë si mjeke e luftës kam marrë shumë shqetësime nga bashkëluftëtarët, të cilët vetë i kam trajtuar në luftë, për atë që përjetojnë në këtë komision. Unë sot nuk do të hyj në detale, por para se të ndodhë ndonjë skandal, të lutem merrni masa. A po e mbikëqyrni këtë komision për punën që po e bën, për trajtimin që po u bën invalidëve të luftës?

KRYESUESI: Zoti Reçica, e keni fjalën.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

E nderuar deputete Kadrijaj, faleminderit për pyetjen tuaj!

Më lejoni t'ju informoj se sapo kam marrë mandatin e ministrit, kam marrë të gjitha masat që Komisioni mjekësor për përcaktimin e shkallës së invaliditetit për invalidët e luftës së Ushtrisë

Çlirimtare të Kosovës të funksionalizohet. Ky komision tashmë, pas shumë vjetësh është funksional dhe është duke ushtruar detyrën në funksion të zbatimit të Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre dhe në bazë të Udhëzimit administrativ Nr. 08/2012, për vlerësimin dhe ekzaminimin e shkallës së invaliditetit të invalidit të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Për të qenë sa më i rregullt dhe sa më transparent ky proces, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Shëndetësisë si dhe Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi, me qëllim të krijimit të komisioneve mjekësore me nga tre specialistë të kualifikuar të fushave mjekësore nga lëmi i ortopedisë, kirurgjisë dhe neuropsikiatrisë, ashtu siç është përcaktuar në Udhëzimin administrativ të cekur më lart. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale menaxhon procesin në aspektin administrativ, si organizimin e seancave mjekësore, thirrjen e kandidatëve sipas listave dhe çështjeve të tjera administrative. Sa i përket vlerësimit profesional për përcaktimin e shkallës së invaliditetit, kjo është dhe mbetet përgjegjësi e komisioneve mjekësore, të cilët duhet të zbatojnë ligjin dhe etikën profesionale mjekësore.

Unë si ministër kam takuar ekipet mjekësore dhe kam biseduar lidhur me pretendimet e ngritura për sjellje jokorrekte apo të papërgjegjshme, ashtu siç i keni ngritur edhe ju në pyetjen tuaj parlamentare dhe kam kërkuar që këto ekipe mjekësore të jenë profesionale, të zbatojnë ligjin dhe etikën mjekësore, të jenë korrekt me invalidët e luftës, sepse është një kategori që ka dhënë gjithçka për këtë liri që e gëzojmë ne sot.

E nderuar deputete,

Të nderuar deputetë,

Dhe shumë të respektuar luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ne si ministri dhe unë si ministër garantojmë që procesi administrativ për përcaktimin e shkallës së invaliditetit do të shkojë në rregull dhe aty jemi të pakompromis, mirëpo aspekti profesional dhe etika mjekësore mbetet tek ekipet mjekësore, sepse aty nuk kemi mandat për të ndërhyrë dhe nuk është as ligjore, nuk kemi kompetencë dhe njohuri për të ndikuar në këtë proces. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Kadrijaj?

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, ministër!

Por, megjithatë unë po i ngre shqetësimet që më janë adresuar nga bashkëluftëtarët, janë shqetësime që vërtet duhet trajtuar, sepse nëse vazhdon ky komision me këto sjellje të papërgjegjshme, mund të plasë një skandal gjatë trajtimit, sepse komisioni është i autorizuar ta shohë plagën dhe ta përcaktojë shkallën e invaliditetit dhe nuk është i përcaktuar të pyesë: “Ku e

ke plagën”, “Ku e ke marrë”, “T’u paska shëruar plaga”, këto janë pyetje që nuk kanë asnjë etikë, as profesionale, as logjike.

Dhe, kjo çka po bëjnë, unë po them është mirë të trajtohet ky rast, sepse shpejt do të ketë skandale. Unë sot s’po dua të hyj në detale, por kam fakte që ky komision u ka ndarë dhe u ka dhënë shkallë të invaliditetit atyre që nuk janë plagosur në luftë, ndërsa i ka refuzuar luftëtarët e vërtetë të njërive elite të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, unë sot befasohej që ata janë gjallë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Time!

Kjo temë besoj që ka nevojë për diskutim dhe të shihen rregullat qysh janë në të gjitha vendet e botës për shkallën e invaliditetit. Në qoftë se ka shkallë të invaliditetit, duhet shikuar a mund të punojë pastaj prapë me orar të plotë edhe në dy vende të tjera të punës dhe të marrë pensionin e invaliditetit. Zoti Reçica, e keni fjalën.

MINISTRI SKENDER REÇICA: E nderuar deputete Kadrijaj!

Faleminderit dhe jam shumë mirënjohës për temën, për çështjen dhe pyetjen që e keni shtruar.

Mund të ketë raste të tilla, në të cilat Komisioni Mjekësor ndoshta edhe mund t’i kalojë kompetencat nga etika profesionale mjekësore. Unë ju bëj thirrje juve dhe gjithë atyre, të cilët kanë kaluar nëpër këto komisione, në rast se kanë hasur në parregullsi në punën e komisionit mjekësor, me shumë kënaqësi do t’i pres në zyrë, do t’i dëgjoj ankesat e tyre dhe natyrisht nëse ka lëshime procedurale, por edhe lëshime nga etika profesionale, natyrisht që të gjitha rastet do t’i trajtojmë me shumë kujdes. Angazhimi im është që ky proces të jetë sa më transparent dhe sa më i rregullt. Për këtë e kam dhënë zotimin që nga dita e parë, prandaj edhe një herë po e përsëris: Të gjithë ata, të cilët në një mënyrë pretendojnë se u është bërë e padrejtë në trajtimin nga komisioni mjekësor, le të paraqiten te zyrat tona me ankesa, por edhe personalisht, me shumë kënaqësi do t’i pres për t’i trajtuar më tutje ankesat e tyre dhe pretendimet e tyre për shkeljet eventuale që kanë mundur të dalin nga komisioni mjekësor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Halimaj, të mbeta borxh, por u habita. Dëshironi të bëni pyetjen shtesë? Zonja Halimaj e ka fjalën!

ALBULENA BALAJ HALIMAJ: Po e bëj meqë ma dhatë fjalën. Desha të pyes ministrin, i përmendi punësimet sezonale, a ka marrëveshje deri më tani me shtetet tjera për punësime sezonale dhe desha të di nëse në këto punësime do t’u jepni përparësi grave dhe të rinjve? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, nënkryetar!

Faleminderit deputete Balaj!

Unë e ceka edhe në prezantimin tim, jemi duke punuar me disa nga shtetet e Bashkimit Evropian për të parë dhe për ta shikuar mundësinë e një marrëveshje për punësim sezonal të punëkërkesve tanë në vendet e Bashkimit Evropian. Akoma nuk e kemi konkretizuar një marrëveshje të tillë, jemi pranë me disa nga këto shtete, jemi në negociata dhe jemi në rrugë të mirë.

Natyrisht që pas marrëveshjeve me shtetet respektive me të cilat jemi duke diskutuar, natyrisht që në bazë të kërkesave të tyre do të bëhet edhe përzgjedhja e gjithë atyre që do të përfitojnë nga punësimi sezonal. Po e përsëris edhe një herë, një rëndësi të veçantë do t'i kushtojmë që në të gjitha vendet e punës, në të gjitha masat aktive të tregut të punës të jenë sa më lart të përfshira edhe gjinia femërore, gratë në këtë rast. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Pal Lekaj.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar Haliti!

Edhe pse ministri Pal Lekaj nuk është këtu, meqë pyetja është shumë aktuale dhe mendoj që zyrtarët e Ministrisë së Infrastrukturës dhe vetë ministri Lekaj do të merren me çështjen, e ka të bëjë me numrin e madh të aksidenteve me fatalitet, që nga viti në vit po shënon rritje.

Ministria e Infrastrukturës, së bashku me Policinë e Kosovës, kanë hartuar disa herë strategji e aktivitete të përbashkëta për ta rritur sigurinë në komunikacion, por prapëseprapë kemi rritje të aksidenteve me fatalitet. Për mua është shumë brengosëse rritja e aksidenteve me fatalitet, në veçanti kur këto aksidente po ndodhin në vendkalime të këmbësorëve, dhe në vendndalje të autobusëve në rrugët regjionale. Mungesa e vendndaljeve për autobusë në disa rrugë magjistrale të Kosovës dhe rrugët e tjera lokale ka shkaktuar një numër të madh të aksidenteve, e gjithashtu edhe mungesa e shenjzimit të mirë të vendkalimit për këmbësorë ka qenë shkak i shumë aksidenteve. Me qëllim të rritjes së sigurisë dhe zvogëlimit të numrit të aksidenteve, e kam parashtruar pyetjen për ministrin Pal Lekaj dhe ministrinë e tij: A ka planifikuar Ministria e Infrastrukturës që të investojë dhe rregullojë stacionet - vendndaljet për autobus në rrugët lokale dhe magjistrale të Kosovës, pasi Ministria e Infrastrukturës u ka lëshuar licenca kompanive të transportit për t'u ndalur nëpër vendet e tilla, domethënë vendndaljet e autobusëve, por që vend për ndalje nuk ka dhe kjo shpeshherë shkakton aksidente në komunikacion.

Prandaj, pasi Ministria e Infrastrukturës i ka lëshuar licencat për vendndalje apo stacione të autobusëve, a e ka planifikuar një gjë të tillë, si dhe a ka ndonjë strategji që në vendet urbane të këtë një shenjzim më të mirë në vendkalimet e këmbësorëve, duke ngritur këto shenjzime disa centimetra në vendkalimet e këmbësorëve, e disa komuna kanë filluar ta zbatojnë një strategji të tillë, por në shumë komuna të Kosovës kjo mungon dhe kjo është...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Përfundoje pyetjen! OK! Faleminderit! Atëherë, e pate edhe një pyetje?

BEKIM HAXHIU: Po, por ministri i Shëndetësisë, zoti Ismajli, paska ikur, besoj që ka pasur ndonjë agjendë sigurisht të rëndësishme, por po bëhen më shumë se dhjetë muaj që barnat të listës esenciale mungojnë aktualisht në Qendrën Klinike Universitare. Mungesat janë evidente edhe në çdo spital regional dhe në QKUK.

Pacientë të shumtë ankohen se ata duhet t'i blejnë barnat dhe pajisjet tjera duke filluar nga gjilpërat, fashat, dorëzat e deri te citostatikët, të cilët kushtojnë shumë më shtrenjtë dhe të cilat mungojnë tani e disa muaj. Pasi me Ligjin për Buxhetin e vitit 2018 është rritur buxheti për Ministrinë e Shëndetësisë dhe në veçanti për furnizim barna, pyetja ime është: Kur pritet që Ministra e Shëndetësisë të sigurojë furnizimin 100% me barna nga lista esenciale, që është obligim ligjor i Ministrisë së Shëndetësisë dhe besoj që kjo çështje do të duhet të sensibilizohet sa më shpejt, sepse është shumë urgjente.

KRYESUESI: Faleminderit! E kemi përfunduar dhe pikën e dytë që ka të bëjë me pyetjet e deputetëve. Po kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,
Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, në bazë të nenit 61 të Rregullores së Kuvendit, e ka shqyrtuar vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e propozimit të Presidentit për fshirjen e nenit 34, nënparagrafët 2.5.1, 2.5.2, 2.5.3 dhe 2.5.4 të Ligjit për shoqëritë tregtare.

E ftoj zëvendëskryetarin e Komisionit Funkcional, zotin Sejdiu, që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime. Dardan Sejdiu e ka fjalën!

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal me shumicë votash, pra ka pasur edhe vota kundër, ka rekomanduar që të miratohet vendimi i Presidentit të Republikës së Kosovës dhe të fshihen dispozitat e nenit 34, nënparagrafët 2.5.1, 2.5.2., 2.5.3 dhe 2.5.4 të Ligjit nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare.

Unë në cilësinë e zëvendëskryetarit të komisionit po e paraqes këtë rekomandim, por po e bëj të qartë për seancë që ka pasur edhe votë kundër këtij rekomandimi të Presidentit dhe le të jetë në seancë dhe në grupet parlamentare të diskutojmë për këtë temë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në qoftë se e duan fjalën përfaqësuesit e komisioneve të përhershme parlamentare? Ju lus t'i tërhiqni këto paraqitjet tuaja që i keni pasur në pikën e ndryshme, ose le t'i fshijë regjia.

Nuk do askush nga komisionet e përhershme parlamentare që ta marrë fjalën. Përfaqësues të grupeve parlamentare, Grupi Parlamentar i LDK-së kush e do fjalën? Zonja Kusari!

Regjia, fshije emrin e këtyre që janë paraqitur në të ndryshme, hiqi nga tabela.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Në vendimin e datës 4. 4. 2018, Presidenti i Kosovës e konteston propozimin në nenin 34, me nënparagrafët që u cekën.

Presidenti i referohet shprehimisht nenit 24 të Kushtetutës së Ligjit nr. 05/L-020, për barazi gjinore dhe argumenton që vendosja e kuotës gjinore vetëm për shoqëritë aksionare është diskriminuese, sepse nuk zbatohet për format tjera të shoqërive tregtare. Nuk është praktikë që kuota gjinore për bordet drejtuese në shoqëritë aksionare të rregullohet me ligj, që kuota gjinore e cenon parimin e ekonomisë së lirë të tregut dhe që caktimi i sanksioneve me akt nënligjor krijon pasiguri juridike. Argumentet e Presidentit nuk qëndrojnë në pikëpamje kushtetuese dhe ligjore për arsye, si në vijim:

Presidenti i referohet nenit 24 të Kushtetutës, por e bën këtë në mënyrë selektive, duke e injoruar detyrimin kushtetues për veprim pozitiv, siç është përcaktuar në nenin 24, paragrafi 3, i cili i përcakton parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilat janë vënë ato.

Presidenti gjithashtu i referohet Ligjit për barazi gjinore, por po ashtu në mënyrë selektive, sepse nuk merr parasysh nenin 6, i cili shprehimisht kërkon marrjen e masave të veçanta.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës kërkon nga të gjitha institucionet shtetërore që të respektojnë, garantojnë dhe të mbrojnë të drejtat e njeriut, ndër këto edhe të drejtën për trajtim të barabartë. Të drejtat e njeriut të garantuara me Kushtetutë nuk përmbajnë vetëm detyrime negative që e ndalojnë shtetin që të ndërhyjë në këto të drejta, përveç në kushtet e përcaktuara

me Kushtetutë. Ajo përmban edhe detyrime pozitive që përfshin detyrimin kushtetues për të ndërmarrë veprime pozitive, afirmative për të siguruar që individit t'i gëzojë këto të drejta në mënyrë efektive dhe jo vetëm formalisht. Kjo vlen sidomos për lirinë themelore për trajtim të barabartë, kur nga shteti kërkohet që të ndërmarrë masa që një grup shoqëror, në këtë rast gratë dhe vajzat, jo vetëm për barazi formale, por edhe faktike dhe efektive. Kjo pasqyrohet qartë në nenin 6 të Ligjit për barazi gjinore, i cili është në pajtim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut lidhur me marrjen e masave të veçanta pozitive.

Sipas Kushtetutës, në Kosovë zbatohen disa marrëveshje ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndër to edhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Liritë themelore të garantuara me Kushtetutë duhet të interpretohen në pajtim me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjë që është bërë praktikë juridike e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, diskriminimi është kur personat në situatë të ngjashme trajtohen në mënyrë të pabarabartë, pa ndonjë arsye objektive. Mirëpo, e drejta themelore në trajtim të barabartë nuk e ndalon që një shtet ta trajtojë një grup ndryshe dhe më mirë me qëllim të eliminimit të pabarazisë faktike, të cilit i ekspozohet ky grup.

Në fakt, sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kur ka pabarazi faktike, është shteti ai i cili duhet t'i ndërmarrë masat për ta eliminuar këtë pabarazi. Me qëllim të realizimit në mënyrë efektive dhe faktike, në vitin 2012, Komisioni Evropian e inicioi procedurën legjislative për miratimin e një direktive për përmirësimin e barazisë gjinore në radhët e drejtorëve joekzekutivë të ndërmarrjeve private, ku kërkohet një kuotë prej 40% për përfaqësim të grave. Komisioni Evropian ka vlerësuar se një kuotë e tillë është e lejueshme dhe është thirrur në praktikën juridike të Gjykatës së Bashkimit Evropian dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Propozimi i Komisionit Evropian që me ligj ta përcaktojë një kuotë gjinore vjen pas konstatimit se masat vullnetare të bizneseve për ta përmirësuar përfaqësimin e grave në strukturat udhëheqëse nuk kanë funksionuar. Në Strategjinë për barazinë ndërmjet grave dhe burrave 2010-2015, Komisioni Evropian e caktoi realizimin e barazisë faktike ndërmjet grave dhe burrave në strukturat udhëheqëse të ndërmarrjeve private si prioritet politik.

Parlamenti Evropian e miratoi direktivën e propozuar nga komisioni në vitin 2013, e cila është tani në Këshill për miratimin përfundimtar. Debati në Këshill është përqendruar kryesisht në pyetjen nëse duhet të ketë akt legjislativ të Bashkimit Evropian, apo nacional, por asnjë shtet nuk e kundërshton idenë se duhet të ketë veprim pozitiv për të realizuar përfaqësim më efektiv të grave nëpër bordet e ndërmarrjeve. Këto argumente e hedhin poshtë argumentin e Presidentit që kuota gjinore është në kundërshtim me nenin 24 të Kushtetutës, në fakt është për keqardhje se argumentet e Presidentit janë aq selektive, sepse tregojnë qartë se kuota gjinore nuk po kundërshtohet për arsye parimore kushtetuese, por për arsye tjera. Kjo vlen edhe për argumentet tjera të paraqitura nga Presidenti. Nuk qëndron argumenti se diskriminohen shoqëritë aksionare. Shoqëritë aksionare kanë funksion të veçantë në jetën ekonomike dhe për këtë arsye ato

kualifikohen për shërbime të veçanta, siç janë shërbime financiare dhe prej tyre kërkohet përgjegjësi më e madhe shoqërore.

Ka rregulla të veçanta për shoqëritë aksionare, siç është detyrimi ligjor për të pasur një bord të drejtorëve, si dhe trajtimi ndryshe sa i përket raportit financiar dhe tatimit. Nuk qëndron gjithashtu argumenti që caktimi i kuotës gjinore e cenon parimin e ekonomisë së lirë të tregut. Janë shtetet e Bashkimit Evropian që e ndjekin modelin e ekonomisë së lirë të tregut, siç janë Gjermania, Franca, Norvegjia, Italia, Belgjika, Spanja, Holanda, Finlanda, të cilat kanë vendosur kuotë të tillë të sanksionuar me ligj. Kosova nuk mund ta konsiderojë veten se është më e avancuar se këto shtete në parimet e ekonomisë së lirë të tregut. Kur kuota gjinore në Gjermani dhe Francë nuk është në kundërshtim me ekonominë e lirë të tregut, si mund të jetë kuota gjinore sipas logjikës së Presidentit në kundërshtim me ekonominë e lirë të tregut në Kosovë? I vetmi argument që mund të merret në konsideratë është argumenti i pasigurisë juridike për shkak të caktimit të sanksioneve me akt nënligjor, mirëpo edhe ky rast nuk është proporcional që të hiqet i tërë neni, i cili e realizoi një detyrim kushtetues.

Në notë personale, justifikimi i të drejtës ekonomike nuk e mbështetë lirinë e biznesit dhe vendimmarrjes, e vazhdon traditën e mohimit të drejtës së barabartë të grave në politikat zhvillimore të ndërmarrjeve. Beteja e sotme për barazi në bordet e shoqërive aksionare ka vetëm vonesë, nuk ka shpëtim. Sot mund të mos mbështetet, por pas disa vite mund të transponohet, ose duhet të transpozohet me direktivë të Bashkimit Evropian. Pse sot frikësohemi të jemi pjesë e listës së shteteve të avancuara? Pse është aq vështirë të mendohet e të besohet në barazi për politika strategjike të ndërmarrjes? Kjo nuk është beteja ime me Presidentin. Për këtë rrugëtim ne na duhen aleanca, të cilat duhet fituar. Sqarimin e Presidentit e pamë si të përgjysmuar, por jo të plotë dhe jo substancial. Gratë dhe vajzat që duhet të kualifikohen për borde nuk janë gra dhe vajza të papuna. Nuk është argumenti që duhet t'u gjejmë punë grave më tepër. Nuk janë të pashkolluara. Ne flasim për gjithë trurin dhe kapacitetin, i cili po mungon, por duhet të jetë pjesë e zhvillimit strategjik të ndërmarrjeve. Fillojmë me shoqëritë aksionare.

Për ata që më dëshmojnë se në politikat e djathta, ose mbështetin politikat e djathta, ne po flasim për profit ekonomik, po flasim për profilizim të kapacitetit njerëzor në dobi të zhvillimit të sektorit privat. Në sektorin publik jemi shembull i keq i krijimit të politikave të punësimit dhe nuk kemi aftësi të rritjes apo gjenerimit ekonomik. Shpresa e zhvillimit është sektori privat, edhe pse në kundërshtime të gjithë të cilët e kanë parë dhe e ndjekin ndikimin dhe përfshirjen e grave në ekonomi, do të dëshmojmë së shpejti se duhet të flasim për një domosdoshmëri të maksimizimit ekonomik. Nëse dëshirojmë një ekonomi të zhvilluar, nëse dëshirojmë një ekonomi të avancuar duhet ta kemi gjithë potencialin zhvillimor e human të angazhuar në zhvillimin e këtyre ndërmarrjeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Memli Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Besoj që e kemi pasur një debat mjaftë shterues sa i përket kësaj çështjeje në kohën kur është propozuar ky amendament, i cili s'ka pasur mbështetjen as të Komisionit Funkcional dhe për të mos evokuar ndoshta të gjitha ato që janë diskutuar, sepse ma merr mendja që të gjithë deputetët e mbajnë mend këtë debat. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, unë ju njoftoj që ne do ta mbështetim rekomandimin e Presidentit, që në fakt është rekomandim i komisionit, sepse edhe siç e parasheh Kushtetuta, komisioni e ka shqyrtuar dhe i ka dhënë mbështetje këtij rekomandimi që të miratohet sot në seancë.

E ritheksoj se konsiderojmë që ky amendament absolutisht nuk e ka në fokus fuqizimin e grave në biznesin e Kosovës. Mendojmë që në fakt është thjesht një tendencë për të imponuar vendime që nuk i konsideroj të drejta në sektorin privat, nuk e mundëson funksionimin e lirshëm të biznesit dhe të sipërmarrjes në Republikën e Kosovës dhe si i tillë do të duhej të votohej rekomandimi i komisionit, ashtu që amendamenti i propozuar nga zonja Kusari-Lila të hiqej nga ligji i votuar. Vetëm sa për referencë, jua kujtoj një aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese në rastin me nr. KO13/15, kur Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës e ka shqyrtuar një propozim-amendament kushtetues, sipas të cilit është tentuar që të imponohet, jo vetëm në sektorin privat, por në sektorin publik përfaqësimi me kuotë gjinore dhe ky amendament ka thënë: Asnjëra nga gjinitë nuk mund të përfaqësohet më pak se në masën 40% në postet e ministrave dhe të zëvendësministrave të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Gjykata Kushtetuese e ka vlerësuar si kundërkushtetues këtë amendament dhe ju më tregoni tash, nëse Gjykata Kushtetuese një amendament që flet për Qeverinë, që flet për sektorin publik, që flet për institucionet përfaqësuese, e ka vlerësuar që është kundër frymës së Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe është cënues i të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë, me çfarë logjike sot dikush mund të thotë që nuk cenohet Kushtetuta e Republikës së Kosovës nëse ne ua imponojmë bizneseve një gjë të tillë?

Po ashtu, a mund të pajtohemi, së paku, që më mirë sesa ne si deputetë, interesat dhe bindjet e bizneseve i përfaqësojnë interesat dhe bindjet e bizneseve shoqatat e bizneseve? A i keni vërejtur që s'ka shoqatë në Kosovë, odë ekonomike apo sido që të quhen, që nuk ka reaguar kundër këtij amendamenti? Secila prej tyre ka reaguar dhe besoj se kanë qenë edhe në peticionin drejtuar Presidentit për ta kthyer këtë ligj, sepse ata vetë konsiderojnë që është shkelje dhe është ndërhyrje në funksionimin e lirshëm të bizneseve të Kosovës. Me këtë logjikë të imponimit, unë mendoj që ne po bëjmë gabim dhe po e ngushtojmë funksionimin e lirshëm, po e ngushtojmë veprimin e lirshëm të bizneseve të Kosovës, duke u imponuar kuota gjinore, të cilat mbi të gjitha do të duhej të vinin në mënyrë të natyrshme.

E ritheksoj që ne e mbështetim që bizneset e udhëhequra nga gratë dhe vajzat e Kosovës duhet të mbështeten edhe me forma të diskriminimit pozitiv dhe besoj se ne do të kishim mundësi që nëpërmjet Qeverisë, Ministrisë së Tregtisë, në radhë të parë, por edhe ministrive tjera të linjës, të mbështetim projekte dhe programe të dedikuara për fuqizimin dhe rritjen e bizneseve të udhëhequra nga gratë, nga vajzat dhe për gjithëpërfshirjen apo përfshirjen sa më të madhe të tyre në jetën biznesore, sipërmarrëse, afariste në Republikën e Kosovës. Por, nëpërmjet imponimeve të tilla, konsideroj që ne po krijojmë precedentë të rrezikshëm për të ardhmen edhe për sektorët tjerë, dhe mbi të gjitha nuk jam i sigurt që po bëjmë amendamente të implementueshme. Sa herë ka miratuar ky Kuvend ligje, ose amendamente të ligjeve, të cilat sot e kësaj dite nuk zbatohen? Ne s'kemi arritur ta zbatojmë një qasje të tillë as në bordet e ndërmarrjeve publike, ku askush s'mund të na ndalojë, e sot ne po flasim për bordet e ndërmarrjeve private.

Konsideroj që përtej tendencës për të pasur një politizim në kuptimin e cytjes, apo të animimit për votat e grave të Kosovës, kjo realisht nuk e ka në funksion apo në fokus fuqizimin e grave në jetën afariste në Kosovë. Andaj, po e përfundoj duke ripërsëritur që në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe përtej debateve të pastra ideologjike, ne do ta votojmë rekomandimin e komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar Vetëvendosje, zonja Kollçaku e ka fjalën.

FATMIRE KOLLÇAKU: Faleminderit!

U përmend Kushtetuta dhe ligjet. Unë mund të them se edhe Kushtetuta edhe ligjet janë shprehje e vullnetit të atyre që i shkruajnë ato ligje dhe unë mendoj që ne duhet ta kemi vullnetin për pjesëmarrje të barabartë të të dy gjinive, jo pse ne i duam kuotat për të na garantuar diçka, por ne i duam në baza meritore, sepse meritojmë që të jemi të përfshirë çdo kund me 50% së paku.

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje është kundër vendimit të Presidentit dhe ne shprehemi se e përkrahim ligjin ashtu siç është votuar, duke e përfshirë edhe amendamentin në fjalë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate, zoti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Tash po e diskutojmë këtë pikë edhe një herë pas ndërhyrjes që e bëri Presidenti në punën e Kuvendit dhe këtu po flasim për një çështje në të cilën po kërkohet nga disa prej grupeve parlamentare që të mos ndërhyhet në sektorin privat të ekonomisë, ose më saktësisht në shoqëritë aksionare. Dhe, mendoj që ose ka keqkuptim të paqëllimshëm, ose keqkuptim të qëllimshëm të asaj se cili do të duhej të ishte roli i shtetit në ekonomi.

Pra, ata që thonë se shteti nuk ka kurrfarë roli në ekonomi, o janë të verbër, o dashakeqësisht e fshehin një të vërtetë që është e pranishme gjithkund. Natyrisht se shteti ka rol në ekonomi, sepse shteti, në fund të fundit, me institucionet e veta publike, të zgjedhura demokratikisht, e ka për detyrë që ta mirëmbajë kohezionin shoqëror dhe ta ushtrojë, ose të krijojë hapësirë që secili ta ushtrojë lirshëm jetën e vet me dinjitet përbrenda një shoqërie. Dhe, liria, edhe nga perspektiva liberale, por edhe nga secila perspektivë ideologjike, është e mirëmbajtur nëpërmjet ligjeve dhe funksioneve tjera të institucioneve publike, që e garantojnë hapësirën për secilin, të mos jetë as i diskriminuar, e as i shkelur brenda një shoqërie. Dhe kjo, prapë po e them, edhe nga perspektiva liberale, është kështu e kodifikuar dhe kështu edhe e zbatueshme nëpër secilin vend që pretendon të jetë demokratik dhe që pretendon ta vlerësojë lirinë si një vlerë universale dhe të pamohueshme për secilin pjesëtar të shoqërisë.

Ndërkohë që, megjithatë, këtu po flasim edhe për pronën private, natyrisht te shoqëritë aksionare. Dhe, duhet ta kuptojmë edhe një gjë, mendoj unë, edhe në nivelin teorik, por qe besa edhe në nivelin praktik, që pronat private, edhe nga perspektiva e liberalizmit, prapë po e përsëris, është pronë e dobishme për shoqërinë, sepse i shërben interesit publik. Pra, kjo është perspektiva që aplikohet aty dhe theksi këtu është te interesi publik. Sektori privat është i mirë për aq sa i shërben interesit publik. Nëse nuk e ka këtë mundësi, ose nëse nuk i shërben interesit publik, atëherë ai natyrisht se nuk mund të vlerësohet, siç vlerësohet nganjëherë gabimisht, si i shenjtë. Dhe, në këtë drejtim mendoj që duhet t'i kemi parasysh këto dy postulate, që janë edhe teorike, por që pastaj edhe e drejtojnë zbatimin praktik të tyre, kur flasim për këtë çështje të caktuar për të cilën po diskutojmë sot.

Dhe, në këtë drejtim, konsideroj se arsyetimi i Presidentit se përse duhen hequr këto nene dhe arsyetimi që po e dëgjojmë nganjëherë edhe këtu në sallën e Kuvendit, vështirë se mund të kuptohet ndryshe, përveçse ky kuptimi nganjëherë tradicional, patriarkal, që mund ta kenë njerëzit për sa i përket gruas. Pra, gruaja shihet gjithnjë si barrë dhe në arsyetimin e Presidentit mund ta nënlexosh, se pse këto nene janë të dëmshme për ekonominë e shoqërinë e Kosovës, sepse thuhet se me një fjalë, ose tjetër, dhe këtu po e parafrazoj, pra natyrisht po i përdor fjalët e mia për ta shpjeguar leximin që ia kam bërë vendimit të Presidentit, është që të mos i rëndojmë bizneset. Kjo është ajo që përvidhet dhe me të cilën mund të përmbliidhet arsyetimi i Presidentit. Pra, që nënkupton se nëse shoqëritë aksionare obligohen me ligj që të kenë përfaqësim të drejtë gjinor në bordet e tyre, atëherë kjo është rëndesë për ta, që i bie praktikisht që nëse ata duhet domosdoshmërisht që në bordet e tyre të kenë edhe gra, përveçse burra, ata rëndohen, që i bie logjikisht që gruaja është barra të cilën nuk duhet t'ua vendosësh në shpinë këtyre bizneseve, e që mendoj se është qasje absolutisht e gabuar. Mirëpo, arsyetimi i Presidentit është i paqëndrueshëm pastaj edhe ligjërisht, edhe në aspektin kushtetues, siç edhe u përmend këtu.

Nëse vazhdojmë me të njëjtën logjikë, që e ka përdorur në arsyetim Presidenti, atëherë i bie që edhe kuota gjinore, që e përdorim në Kuvendin e Republikës, e që e përdorim edhe në procese

zgjedhore, qofshin ato të përgjithshme, ose lokale, janë shkelje të Kushtetutës. Pra, neni 24, pika 3 e Kushtetutës e thotë shumë mirë, që parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato, siç e tha edhe deputetja Mimoza Kusari më herët. Dhe, në këtë drejtim, konsideroj që jo vetëm se kemi të drejtë, po duke e analizuar dhe gjykuar situatën që e kemi aktualisht, ne e kemi edhe për detyrë që të vendosim masa të tilla, në mënyrë që ta sanojmë këtë problem që e kemi aktualisht në pjesëmarrjen e gruas në vendimmarrjen sa u përket bizneseve të sektorit privat, derisa kjo kuotë nuk ka më nevojë të përdoret, pra derisa të krijohet një situatë tjetër shoqërore, në të cilën kuota më nuk është e nevojshme, siç ka ndodhur për shembull edhe me proceset elektorale.

Natyrisht që sa herë flasim për çështjen e barazisë gjinore, nuk është as e mirë e as e dobishme ta shndërrojmë atë në statistikë, mirëpo nganjëherë edhe është e domosdoshme që ta bëjmë një gjë të tillë, vetëm sa për ta pasur pasqyrën e përgjithshme dhe, po të nisemi nga legjislaturat e Kuvendit të Republikës së Kosovës, e shohim që për shembull në legjislaturën e tretë, pas zgjedhjeve të vitit 2007, nga 37 gra sa ishin atëbotë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, 29,7% e tyre i kishin fituar ulëset e tyre pa ndihmën e kuotave. Ndërkohë që në Legjislaturën e Katërt, pas zgjedhjeve të vitit 2010, nga 40 gra sa ishin në Kuvend, 35% e tyre e kishin fituar ulësen e tyre pa ndihmën e kuotës, dhe pastaj në vitin 2014, nga 39 gra deputete, 36% e tyre e kishin fituar këtë pa ndihmën e kuotës. Pra, kuota në këtë rast ka ndihmuar që gruaja të shihet e denjë për përfaqësim politik dhe kjo kuotë po shihet se me kalimin e kohës do të bëhet e panevojshme, sepse përfaqësimi i grave në Kuvendin e Republikës së Kosovës do të shihet si domosdoshmëri, gjë që kam drojë se nuk do të kishte ndodhur po të mos përdorej kuota fillimisht në procesin zgjedhor.

Ajo që pastaj parashihet edhe me Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, e që është synimi për të siguruar barazinë ndërmjet grave dhe burrave, e nëse kjo është e pamundur, atëherë duhet të sigurohemi që nëpërmjet legjislacionit dhe masave të tjera të përshtatshme, zbatimin praktik të barazisë ta bëjmë nëpërmjet këtyre masave. Paragrafi 2 i nenit 1 të kësaj konvente shprehet qartë se shtetet mund të ndër marrin edhe masa tjera të përshtatshme, përfshirë edhe sanksione, e në këtë rast unë po them “kufizim të pragut minimal”, po që se është e nevojshme, duke e ndaluar çdo formë të diskriminimit ndaj grave.

Dhe, natyrisht që në diskutime të tilla ne edhe duhet të marrim shembuj të mirë nga vende dhe shtete tjera, sepse natyrisht se ka shoqëri në një stad tjetër të zhvillimit, e në një stad tjetër të barazisë, krahasuar me Kosovën, gjë që do të duhej ta ndiqnim edhe në këtu dhe duhet ta kuptojmë që megjithatë një stad i tillë i avancimit e barazisë e drejtësisë në shoqëri, nëpër shoqëri tjera po them, nuk është arritur vetëm si çështje evolucioni, por është arritur vazhdimisht si çështje e ndërhyrjes së shoqërisë duke e ngrëhur çështjen dhe pastaj e ndërhyrjes së

institucioneve publike nëpërmjet masave të caktuara që i kanë marrë për ta arritur atë. Për shembull, nëse e pyet secilin këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës, do të thoshin që po, vendet skandinave janë vende që i kanë shoqëritë më të avancuara, për shkak se ka drejtësi jashtëzakonisht të mirë shoqërore atje, edhe në aspektin e rishpërndarjes së pasurisë, po që besa edhe në aspektin e rishpërndarjes së vendeve vendimmarrëse nëpër shoqëri.

Po ta marrim vetëm një shembull nga këtu, për shembull, Norvegjia në vitin 2003 e ka miratuar ligjin me të cilin obligohet përfshirja prej 40% e grave nëpër borde të kompanive. Pra, ishte pikërisht kjo iniciativë ajo që ndikoi pastaj në përhapjen e kësaj ideje edhe në shtetet tjera të Bashkimit Evropian, siç janë Spanja, Franca, Italia, Holanda, Gjermania dhe Belgjika. Dhe, Norvegjia, duke qenë e para në këtë drejtim, e ka pasur një përvojë sa i përket kësaj dhe e kanë kuptuar nëpërmjet përvojës që masat e tilla, kur janë aplikuar fillimisht në sektorin publik, kanë pasur një domethënie jashtëzakonisht të madhe dhe e kanë shtrirë këtë në një masë për të garantuar drejtësi në shoqëri edhe në sektorin privat dhe me këtë ia kanë arritur që pastaj, jo vetëm ta përmirësojnë jashtëzakonisht shumë gjendjen brenda shtetit të tyre, por edhe të shërbejnë si model pastaj për vendet tjera të Bashkimit Evropian për ta arritur një gjë të tillë. Dhe, sot e kemi një situatë kur në Spanjë me ligj është e sanksionuar që 40% të jenë nëpër bordet e ndërmarrjeve të njëjës gjini, në Francë 40%, në Norvegji 40%, në Belgjikë 33%, në Greqi 33%, në Itali 33%, e kështu me radhë.

Duhet ta kemi parasysh edhe një gjë, që asnjëra prej këtyre masave nuk do të kishin qenë të suksesshme po të mos kishte edhe sanksione karshi moszbatimit të masave të tyre. Për shembull, po e marr prapë rastin e Norvegjisë. Në Norvegji, me ligj është e përcaktuar që nëse bordet ose shoqëritë aksionare nuk arrijnë ta përmbushin këtë kuotë, ose nuk duan ta përmbushin këtë kuotë, atëherë ato rrezikojnë edhe të mbyllën. Pra, këtë duhet ta kemi parasysh, që shteti duhet të ndërhyjë në mënyrë që të krijojë hapësirë të barabartë për të gjithë në shoqëri dhe të krijojë rezult...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muharrem Nitaj e ka fjalën.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ka qenë pikërisht amendamenti i zonjës Kusari-Lila që na ka detyruar ta kundërshtojmë Ligjin për shoqëritë tregtare dhe e kemi votuar kundër në seancën e kaluar. Mirëpo, fatkeqësisht, ligji pati kaluar atëherë. E konsiderojmë ndërhyrje të duhur vendimin e Presidentit dhe vendimin e Komisionit FunkSIONAL. Nuk besojmë, për shembull, që ndoshta janë krahasimet më të mira të Kosovës me shumë vende të Bashkimit Evropian dhe besojmë që vendosja e kuotës në shoqëritë tregtare në rastin e Kosovës më tepër është imponim, sesa barazi.

Prandaj, ne si Grup Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës besojmë që vendimi më i duhur është që të miratohet vendimi i Presidentit dhe i Komisionit FunkSIONAL dhe të hiqet neni 34 me paragrafët që kanë ardhur nga rekomandimi i Komisionit FunkSIONAL. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Balaj-Halimaj, urdhëro!

ALBULENA BALAJ-HALIMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Nisma Socialdemokrate e ka thënë qëndrimin e saj edhe atëherë kur është diskutuar për këtë projektligj. Ne kemi qenë kundër një imponimi, një detyrimi dhe një ndërhyrjeje në shoqëritë tregtare në këtë mënyrë.

Pjesëmarrja e grave në borde mund të jetë më shumë sesa 40%. Konsiderojmë se ne po u bëjmë një kufizim grave. Nëse do të formulohej ndryshe, e të thuhej që 40% do të jenë të njëjës gjini, atëherë ne ndoshta do të pajtoheshim, por jo i grave, sepse duke u munduar t'i ndihmojmë ato, ne po i kufizojmë pa nevojë. Nisma Socialdemokrate e sheh të arsyeshëm rekomandimin e Presidentit dhe do ta miratojë vendimin e tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Faktikisht, Kuvendi e ka shtjerrë debatin pro dhe kontra amendamentit të paraqitur dhe i cili është bërë pjesë e ligjit. Mendoj se ndoshta do të duhej ta kursenim kohën tash se cili është mendimi i Kuvendit. Ne po flasim në aspektin procedural dhe të drejtën kushtetuese, të cilës ia ofron Kushtetuta Presidentit të vendit që të vendosë veto mbi një ligj të proceduar, i cili akoma nuk është shpallur dhe s'ka hyrë në fuqi.

Ne kemi problem me interpretimin kushtetues dhe me rregullat dhe procedurat që i parashtron edhe Rregullorja e Kuvendit dhe unë po e ngre si shqetësim, apo si precedent të së ardhmes, i cili ka shkaktuar dilema në Kuvendin e Republikës së Kosovës sa i përket vendimmarrjes, e cila u lejon dy palëve që të vendosin në këtë drejtim. E para, kemi të bëjmë me një interpretim kushtetues, me një rast të dhënë, apo me pyetjet që janë parashtruar nga Presidentja e vendit dhe e cila, tash, në aspektin procedural dhe përcjelljes së logjikës kushtetuese është keqpërdorur edhe tash nga Presidenti i vendit. Mbi të gjitha, ka tejkalim të kompetencës, i cili drejtohet me amendament shtesë Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe me një shlyerje të një amendamenti brenda këtij ligji.

Për këtë arsye, mendoj se Kuvendi është i shtrënguar të vendosë sipas interpretimit të cilin e ka dhënë vetë Gjykata Kushtetuese dhe atë që e thotë Rregullorja e Kuvendit, të cilën e paraqitën me të drejtë anëtarët e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik.

Këtu duhet të kemi një tërheqje të vëmendjes, sepse këto ndryshime dhe përzjerja e këtyre kompetencave po shkakton shpërprurje ndërmjet autoriteteve kushtetuese, Kuvendit dhe Zyrës së Presidentit. Për këtë arsye, mendoj që këshilla ligjore që i është dhënë Presidentit është e gabuar në interferimin në punën e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kështu që unë nuk po e paragjykoj vendimin tash, sepse vendimi i cili kërkohet është interpretuar saktësisht nga Zyra Ligjore e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe nga komisioni në fjalë, por i cili në të ardhmen do të bjerë ndesh dhe çdokush që këtu mendon se mund ta atakojë vendimin tonë, ka të drejtë që ta atakojë prapë në Gjykatën Kushtetuese, qoftë në aspektin e përafritit apo ndarjes së mendimit, që e kanë edhe tash deputetët në fjalë me kthimin e këtij ligji. Besoj që Kuvendi urgjentisht duhet t'i qartësojë këto çështje, të ketë, më shumë sesa konsensus politik, konsensus profesional të trajtimit të kthimit të ligjit dhe autoritetin që ia ka dhënë Kushtetuta Presidentit të vendit. Faleminderit!

KRYEUSESI: Faleminderit! Zoti Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Në aspektin procedural, ne e kemi shqyrtuar këtë çështje, por përtej këtij aspekti procedural e ligjor dhe kushtetues është një çështje që është hapur në këtë formë. Është fjala për një segment të ekonomisë së Republikës së Kosovës në këtë rast, por ky nuk është thelbi i çështjes.

Është fjala vetëm për shoqëri tregtare, por kemi të bëjmë me zhvillimin ekonomik të një vendi. Kjo çështje është hapur me shumë të drejtë dhe unë e konsideroj një çështje shumë të rëndësishme për diskutim dhe, siç duket, në të vërtetë, vetë gjendja e krijuar, vetë interesimi tregon se ne nuk kemi ndryshuar në mentalitetin dhe që është mentaliteti i botës mashkullore.

Po kthehem te shoqëritë tregtare, në të vërtetë krijimi i një biznesi në përgjithësi, përfshirë edhe shoqëritë tregtare, bëhet me mjete. Ato mjete nuk janë kurrë të gatshme, por duhet të merren, sidomos në kushtet tona moderne nëpër banka. Edhe bankat nuk japin mjete pa pasur garanci në pronë. Ne e dimë se vetëm 2% e pronës në Republikën e Kosovës është në duart e grave. Vetëm 2% e gjithë pronës në Republikën tonë është në duart e grave, prandaj edhe gratë duan të krijojnë biznese, e në kuadër të tyre edhe shoqëri tregtare. Këtë e kanë të pamundur, sepse nuk kanë pronë me të cilën do të garantonin kthimin e mjeteve nëpër banka, që te ne në të vërtetë nuk janë as banka komerciale, por janë zhvatës legalë nëpërmjet kamatave të larta, ashtu siç është vërtetuar shumë herë në Republikën e Kosovës.

Ky diskutim që në thelb e ka embrionin e barazisë në një shoqëri, po e humb kuptimin duke luftuar vetëm për një segment të vogël të ekonomisë, që do të thotë vetëm për shoqëritë tregtare. Çështja thelbore është në të vërtetë përpjekja nëpërmjet një segmenti të ekonomisë dhe po dëshmohet cila është publikja në Republikën e Kosovës. E publikja në Republikën e Kosovës, e

aty bëjnë pjesë edhe shoqëritë tregtare, në të vërtetë është ajo që është mashkullore, dhe nëpërmjet të gjitha formave po përpiqet që kjo barazi që faktikisht shprehet në numër, edhe numër absolut në përqindje duhet të jetë 50:50%, do të shkelet nëpërmjet një rekomandimi të Presidentit që nuk ka mentalitet tjetër, përveçse siç e kemi shumica jonë dhe ai është mentaliteti mashkullor dhe i përjashtimit të gjysmës së shoqërisë nga jeta publike.

Ne kemi të bëjmë me diskutimin për mjetet që tregojnë se cili është personi publik në shtetin e Kosovës, e personi publik në shtetin e Kosovës është mashkulli që e ka pasurinë dhe pronën private, me të cilën është e mundur të krijojë pasuri, qoftë private, qoftë publike.

Ne ende po thirrmi në vendime të Gjykatës Kushtetuese, në dokumente të ndryshme, në vendime edhe kontraverse dhe po duam ta përjashtojmë qëndrimin kryesor, që me çdo mjet përpiqemi, me mentalitetin tonë, ta ndalojmë barazinë thelbore që është në një shoqëri dhe ajo është barazia gjinore. Unë nuk dua të flas as për Ligjin për barazi gjinore, as për Ligjin kundër diskriminimit, unë vetëm po them, ne sot me një diskutim të tillë dhe me një vendim të tillë mund të dëshmojmë se së paku kemi synime që barazinë shoqërore gjinore, dhe nuk po them a është ndërmjet burrave, janë burrat apo gratë në përparësi, ne do të vëmë një shenjë të vogël që mund të jetë një hap i madh në drejtimin e garantimit të një legjislacioni që do të vijë në të ardhmen për shtrimin e rrugës për një barazi shoqërore, që do ta karakterizonte edhe shoqërinë tonë si një shoqëri që synon të ecën me dy këmbët në zhvillimin e saj edhe ekonomik, edhe shoqëror.

Prandaj, unë u bëj ftesë të gjithë kolegëve dhe kolegeve deputetë, që të mos e pranojnë rekomandimin e Presidentit dhe ta votojnë ligjin ashtu siç ka qenë i votuar dhe të dëshmojmë se kemi vendosur që barazinë shoqërore ta konsiderojmë dhe ta shtrojmë në rrugë të drejtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Aida Dërguti e ka fjalën.

AIDA DËRGUTI: Faleminderit, kryesues!

Në Kosovë aktualisht në bordet e ndërmarrjeve publike dhe agjencive të pavarura, përfaqësimi i grave është nën 15%, e me siguri në shoqëritë aksionare është edhe më i ulët.

Përfaqësimi i grave nëpër bordet e ndërmarrjeve publike dhe institucioneve e agjencive të pavarura është shumë i ulët. Nga 159 anëtarë të bordeve në 31 ndërmarrje publike, 135 janë burra dhe 24 gra. Vetëm 5 borde kryesohen nga gratë. Nga 184 anëtarë të bordeve në 31 institucione dhe agjenci të pavarura, 149 janë burra, 30 janë gra dhe për 5 anëtarë nuk ka informacione.

Pozita e kryesuesit/kryesueses së bordit ushtrohet në 23 raste nga burrat, në 3 raste nga gratë dhe për 5 raste tjera nuk dihet, pasi ato borde aktualisht nuk kanë kryesues. Shpesh jepen argumente se gratë nuk janë mjaftueshëm të përgatitura për këtë lloj angazhimi. Studimet e ndryshme kanë treguar se në vendet ku është aplikuar kuota, gratë e caktuara nëpër borde kanë qenë po aq të kualifikuara sa burrat në ato borde. Dallime ka pasur në llojin e kualifikimit dhe të përvojës. Gratë zakonisht kanë pasur më shumë eksperiencë sesa burrat e caktuar nëpër borde. Pra, është detyrë parësore e shtetit që të ndërhyjë për të mundësuar realizimin e një të drejte, posaçërisht aty ku ka pabarazi të thellë.

Sanksionimi me ligj për ta promovuar barazinë gjinore është praktikë e domosdoshme. Kuota gjinore në bordet e shoqërive tregtare është e domosdoshme, sepse vë në shprehje gratë e specializuara në fushat përkatëse. Në anën tjetër, nuk duhet harruar se ky ligj prek një numër dhe një shtresë shumë të vogël të grave. Në këtë mënyrë riprodhohen vazhdimisht kushtet e pabarazisë gjinore, që për bazë e kanë edhe gjendjen ekonomike. Shoqëria tregtare duhet ta parashohë kuotën gjinore brenda ligjit, e cila do të shtrihej deri në nivel të punëtorëve. Nëse duam që t'i prekim cilësisht strukturat shoqërore, ku pabarazia ekonomike më së gjati historikisht dhe më së rëndi aktualisht prek gratë, atëherë duhet që një qeveri ta përdorë kuotën edhe në fushën e ekonomisë. Kuota gjinore mbetet e pabarazuar në tërësi në synimin e saj, nëse ajo reduktohet vetëm në përfaqësim politik.

Për më tepër, çfarë kuptimi ka përfaqësimi edhe gjinor, nëse e ka të pamundur ndikimi në jetën e grave dhe burrave të shoqërisë në përgjithësi. Një ekonomi e qëndrueshme për Kosovën është ajo që ka në plan korrigjimin e padrejtësive sociale nëpërmjet rishpërndarjes, duke e rritur solidaritetin dhe mirëqenien. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Desha vetëm të kyçem pak në debat. Unë parimisht herën e parë kam qenë kundër kësaj, jo pse kam diçka kundër femrave, sepse vetë fakti që jam rritur me 5 motra dhe vetë fakti që nënat tona na kanë lindur ne, e jo baballarët, kjo flet se nënat janë shumë përpara ne meshkujve, domethënë femra si femër. Ne s'kemi arritur ta krijojmë njeriun, e nënat tona janë domethënë ato që na kanë krijuar ne.

Por, kisha pasur dëshirë që nëpërmjet këtij debati të mos abuzohet shumë, se ende s'jemi kështu në prag të zgjedhjeve. S'di a do të shkojmë këtë vjeshtë në zgjedhje të lira, kjo varet komplet prej Lidhjes Demokratike të Kosovës. Kështu që kur të vijmë në zgjedhjet e ardhshme, Zharkut s'po dua t'ia përmend emrin, se do të replikojë me mua. Por, në zgjedhjet e ardhshme tani nga pak na lejohet si deputetë edhe të abuzojmë për shkak të votave. Një shtet, po e përfundoj këtë fjalë time me thënien e Sami Frashërit, që thotë, "tregomë sa femra të shkolluara i ka një komb, ta tregoj

edukatën e atij kombi". Po të kisha unë ndonjë forcë magjike në shëndetësi e në arsim, 85% i kisha lënë vetëm femra, ndërsa në biznes, varet. Unë personalisht e kam drejtoreshë të biznesit gruan time, se po të ma lërë në dorë firmën unë e bankrotoj menjëherë. Por, ajo varet krejt si e shohim ne këtë problem.

Tani jam në dilemë, të votoj për një propozim të Presidentit, po më vjen inat, të votoj për propozimin e Mimosës, po më vjen edhe më inat, se herën e parë e kam kundërshtuar, por t'ia lëmë kështu... do të mendoj, Mimosë, ndoshta votoj pro teje, po s'mund ta anashkaloj ministrin tim atje. Zharku, ta kam përmendur emrin qëllimisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur për të diskutuar.

Nëse dëshironi, një sqarim sa u përket rregullave që kemi për votim. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 80, paragrafi 4: Kuvendi me shumicën e votave të të gjithë deputetëve vendos për miratimin e Ligjit të kthyer nga Presidenti i Republikës dhe ligji përkatës konsiderohet i shpallur. Rregullorja e Kuvendit, neni 61, paragrafi 5: Kuvendi me shumicën e votave të të gjithë deputetëve vendos për miratimin e rekomandimit të komisionit për vërejtjet e Presidentit, që me ndryshimet e miratuara konsiderohet i shpallur. Nëse Kuvendi nuk e miraton rekomandimin e komisionit për vërejtjet e Presidentit, ligji mbetet ashtu siç është miratuar më parë nga Kuvendi dhe konsiderohet i shpallur.

Andaj, vazhdojmë me votimin e rekomandimit të propozuar në raportin e Komisionit FunkSIONAL për vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës. Për miratim kërkohen së paku 61 vota për.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Nuk miratohet. Kanë votuar 67 veta, ndërsa në sallë kanë qenë 83 deputetë. Për kanë votuar 28, kundër 32, 7 abstenim. Megjithatë, nuk është miratuar rekomandimi i Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal në lidhje me vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 06/L-016 për shoqërinë tregtare, andaj ligji konsiderohet i shpallur, ashtu siç ka qenë i miratuar nga Kuvendi. Megjithëse mund të bëhen edhe interpretime të tjera. Faleminderit!

A po marrim pauzë, apo doni të vazhdojmë? Në rregull, vazhdojmë!

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99

Dikush thotë të vazhdojmë, dikush... Mirë, pauzë, Arben... Në rregull! Deri në orën 14 e një çerek, pauzë. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Atëherë, zonja dhe zotërinj deputetë,
Po kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99

Komisioni Funkcional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacione dhe Ndërmarrësi e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, zotin Shyqiri Bytyqi, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin. Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në bazë të legjislacionit në fuqi ka zhvilluar të gjitha procedurat e parapara rreth projektligjit të statutit të punëtorit të arsimit shqip të viteve 1990-1999.

Sigurisht që tashmë i keni informacionet e plota rreth qëllimeve kryesore dhe rëndësisë së këtij projektligji.

Qëllimi i nxjerrjes së këtij projektligji është që njohjen dhe përcaktimin e të drejtave të beneficuarra të punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës që punuan nga viti shkollor 1990-91 deri në vitin shkollor 1998-99.

Përcaktimi i statusit dhe njohja e stazhit me përkrahje financiare përmes pensioneve dhe beneficione të veçanta për kategori që ndërtuar sistemin arsimor shqip të Republikës së Kosovës prej vitit shkollor '91 deri në vitin shkollor '99.

Fushëveprimi i ligjit është i përcaktuar si statut i beneficuar me përkrahje financiare të mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë, personelit menaxhues dhe administrativ e teknik të shkollave dhe të Universitetit të Prishtinës.

Gjithashtu në këtë beneficion përfshihen të gjithë këshillat komunale të arsimit dhe këshillat qendrorë.

Ky ligj nuk zbatohet ndaj kategorive tashmë të trajtuara për këtë periudhë dhe që përfitojnë pensione edhe benificione nga kategoritë e tjera profesionale.

Ky ligj nuk zbatohet ndaj të gjithë punonjësve që kanë kontribuar gjatë kësaj periudhe dhe janë financuar jashtë sistemit të Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Ky projektligj është i rëndësishëm së veçantë për gjithë sistemin e arsimit shqip në Kosovë, e në veçanti për gjithë ata që kontribuuan në mbajtjen e arsimit shqip të viteve '90-'99.

Të nderuar,

Kjo ishte një ekspozitë e shkurtër rreth projektligjit, gjithsesi ne do të jemi të hapur për çfarëdo pyetje dhe sqarim shtesë, ajo çka mbetet nga ana jonë është që qartësimi i implikimit financiar në buxhetin e Kosovës të jetë i definuar saktësisht në projektligj, sepse ka pasur interpretime të dyanshme dhe ne jemi të gatshëm që në bashkëpunim me deputetët ta saktësojmë secilin nen që mund të ketë mundësi dy interpretimesh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Ftoj kryetarin e Komisionit Funkcion, zoti Ismajl Kurteshi, të paraqesë dhe të arsyetojë raportin me rekomandime.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryesues!

Deputetë të nderuar,

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacione dhe Ndërmarrësi, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 4 maj të vitit 2018 shqyrtoi në parim Projektligjin numër 06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/1991 deri në vitin shkollor 1998/1999 dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet në parim Projektligji numër 06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99.

Komisioni vlerësoi se Projektligji numër 06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratimin e tij në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kurteshi! Radha është e kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zonja Valentina Rexhepi-Bunjaku e ka fjalën.

VALENTINA REXHEPI-BUNJAKU: I nderuar kryesues,
Të nderuar kolegë deputetë,
Të respektuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës shpreh shqetësimin për vonesën e këtij projektligji, duke pasur parasysh vonesën e këtij projektligji, ka arsimtarë dhe mësimdhënës të cilët nuk do t'i gëzojnë këto të drejta, sepse tanimë nuk janë në jetë.

Lidhja Demokratike e Kosovës ka adresuar çështjen e statusit të punëtorëve të arsimit të viteve '90-ta kohë më parë, pasi që pikërisht kjo parti e ka mbajtur mbi supë arsimin për kohët më të vështira nëpër të cilën kalonte krejt Kosova, e veçanërisht arsimi.

LDK-ja në atë nuk e shihte arsimin vetëm si një fushë ku zhvillohet profesionalizmi, por e shihte mbi të gjitha edhe një njohje dhe mesazh për botën se shqiptarët e duan arsimin dhe nuk po heqin dorë nga shkolla dhe universiteti, po janë të detyruar dhunshëm të largohen nga to.

Me gjithë dhunën dhe forcat policore serbe, Lidhja Demokratike e Kosovës, gjithë energjinë e saj e kishte koncentruar në shtëpitë shkolla. Madje, do të thosha, se Lidhja Demokratike e Kosovës si parti nga Presidenca e vendit do të duhej të merrte dekoratë për këtë kontribut të organizimit paralel të arsimit në kushte robërie të viteve '90-ta.

Është pikërisht Lidhja Demokratike e cila mbante mobilizimin popullor për arsimin dhe nëse dikush e di rëndësinë, kontributin, vlerat, pasionin dhe motivimin e jashtëzakonshëm të punëtorëve të arsimit, është po vetë Lidhja Demokratike e Kosovës.

Prandaj, në këtë kontest Lidhja Demokratike e Kosovës mirëpret Projektligjin për statusin e punëtorëve të arsimit të viteve të '90-ta dhe konsideron që në fillim se jo vetëm që është i mirëpritur, por është edhe shumë i vonuar.

Fatkeqësisht Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë më së paku është udhëhequr nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Më pak se dekada pas luftës dhe ne jemi të bindur se kjo ministri do të kishte fizionomi dhe cilësi tjetër po të udhëhiqnin intelektualët e Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Në kohën kur LDK-ja inicioi rezolutë dhe pati një iniciativë për mbështetje të këtij projektligji për statusin e punëtorëve të arsimit të viteve '90-ta, ju të tjerët që ishit në pushtet aso kohe nuk e përkrahët.

Dhe, është mirë të kuptojnë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës se në kohën kur Lidhja Demokratike synonte dhe interesohej për këtë kategori të punëtorëve të arsimit të viteve '90-ta, atëherë ishte fjala për financimin dhe për agat retroaktive, e jo vetëm për të shpërblyer këtë kategori me beneficione që ndërlidhen me kontribute dhe përvojën e punës.

Projektligji po vjen nga kjo Qeveri, jo nga vlerësimi i kontributit dhe njohja me vlera të kësaj kategorie, por po vjen si rezultat i dëshirës për të qenë më afër mësimdhënësve si kategoria shoqërore dhe profesionale më e rëndësishme në nivel vendi.

Dhe, pas një serë përpjekjesh dhe grevave të sindikatave, janë sindikatat më meritore që e detyruan Qeverinë që të procedojë këtë projektligj në Kuvend.

Prandaj, ne si Lidhje Demokratike e mbështesim Projektligjin për statusin e punëtorëve të viteve '90-ta, sepse fal kësaj kategorie për një dekadë nuk e kemi ndalur frymën, motivin, dëshirën për arsimin.

Edhe në kushte robërie dhe të rrethuar me ushtri e polici jugosllave.

Po të kishte ndërprerje të arsimit për këto 10 vjet, pasojat do të ishin edhe më të mëdha, por entuziazmi që të mësohet edhe në shtëpitë shkolla ishte mesazh se ne jemi popull liridashës dhe arsimdashës.

Ne vlerësojmë lart kontributin e punëtorëve të arsimit të viteve të '90 dhe ata janë heronjtë dhe heroinat e Kosovës.

Punëtorët e arsimit, pronarët e shtëpive shkolla dhe të gjithë ata që kontribuuan në mbajtjen e arsimit shqip në kushtet e shtypjes sistematike janë edhe kategoria me kontribut të jashtëzakonshëm për lirinë e Kosovës, sikurse dihet që arsimi është i rëndësishëm dhe vendi duhet të ketë arsimim të mirëfilltë, qoftë në robëri apo edhe në liri.

Po e konfirmojmë mbështetjen e këtij projektligji, sepse mësimdhënësit dhe pronarët e shtëpive shkolla si dhe familjet e tyre janë rezistenca për arsimin shqip për një dekadë robërie.

Rezistenca paqësore e presidentit të ndjerë Ibrahim Rugova në aspektin politik dhe diplomatik, si dhe rezistenca e mësimdhënësve për të mos u shkëputur nga arsimi, qoftë edhe në shtëpitë shkolla, janë dy shtylla kryesore të shtetndërtimit dhe të pavarësisë së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zoti Çoçaj e ka fjalën.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke pasur parasysh punën, angazhimin dhe sakrificën e mësuesve të periudhës së viteve '90-'99 dua të shpreh respektin dhe falënderimin për ta, sepse mësuesit e mbajtën gjallë shkollën shqipe dhe pothuajse ishte i vetmi faktor që mbajti dhe ngriti vetëdijen kombëtare të asaj kohe.

Projektligji për statusin e punëtorëve të arsimit shqip nga viti '90-91 deri 98-99 është hartuar vite më parë, po për arsye buxhetore, pra për koston e lartë buxhetore si dhe duke përfillur edhe rekomandimet e partnerëve ndërkombëtarë ka mbetur pa u shqyrtuar deri më tani, po sido që të jetë, më mirë vonë se kurrë.

Të nderuar kolegë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar me kujdes këtë projektligj dhe si të tillë do ta mbështesë, ashtu siç kemi votuar edhe në Komisionin përkatës, ndërsa vërejtjet dhe sugjerimet do t'i japim gjatë leximit të dytë.

Të nderuar qytetarë,

Duke pasur parasysh se shumë kategori të shoqërisë kanë kontribuar në mbajtjen gjallë të shtetësisë dhe çështjes kombëtare, por me shumë bindje e them se asnjë kategori nuk mund të krahasohet me mësuesit e kësaj periudhe.

Fillimisht ky projektligj ka paraparë pensionimin dhe beneficione të tjera për personelin e shkollave, duke filluar nga drejtori i shkollës deri te stafi apo personeli ndihmës, mirëpo në këtë projektligj janë paraparë edhe kategori të tjera.

Ky projektligj ka për qëllim përcaktimin e statusit dhe njohjen e stazhit të beneficuar me përkrahje financiare përmes pensioneve dhe beneficioneve të veçanta për mësuesit, por parasheh edhe kategori të tjera, të cilët edhe mund ta shtojnë shumën buxhetore gjegjësisht të rëndojnë buxhetin e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Vetëvendosje, zoti Mikullovc i ka fjalën.

ADEM MIKULLOVCI: Kam kërkuar të më jepet fjala.

I përshëndes të gjithë,

Mendoj që ky ligj duhet të kalojë, se vërtet kjo periudhë që ka kaluar arsimit në Kosovë ka qenë nga periudhat e papërsëritshme, shumë e vështirë, por më befason që kolegja që e mori krejt organizimin dhe të gjitha lëvdatat e asaj kohe, Lidhja Demokratike, nuk qëndron bash ashtu.

Sikur që e dini, arsimi është organizuar në bazë të Ministrisë së Arsimit të asaj kohe, jam një nga ata që kam marrë pjesë në atë program, në atë planifikim dhe është punuar me Kushtetutën e Kaçanikut dhe nuk është meritë e Lidhjes Demokratike, po e gjithë popullit të Kosovës, këtë desha ta them. Çdo lëvdatë për Lidhjen Demokratike, por Lidhja Demokratike e asaj kohe dhe Lidhja Demokratike e kësaj kohe kanë dallim bukur të madh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të PSD-së, a jeni paraqitur ju partia e re, zoti Sejdiu e ka fjalën.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, meqë është ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale këtu, ndoshta veç le të na tregojë si shpejt sa ligje që trajtojnë tema të pensioneve i kemi në Republikën e Kosovës sot, aktualisht, a janë diku shtatë? Shtatë ligje duhet të jenë.

Faleminderit! Me këtë informacion e kisha nisur edhe fjalën.

Mendoj që Republikës së Kosovës i duhet një kod pensional, pra jo trajtim i veçantë i secilës kategori, ndaras me ligje të veçanta, por një kod pensional tri shtyllash.

Një shtyllë, e cila vije nga kontributi që i bëjmë ne si gjeneratë aktive, gjeneratës e cila është pasive sot, pra pensionistëve, fond pensional.

Shtylla e dytë është ekzistuese, Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe

Shtylla e tretë është shtylla suplementare.

Me kod pensional të trajtojmë edhe mësimdhënësit sot, këtu, që po i trajtojmë me ligj, por jo vetëm këta, të gjitha kategoritë të cilat gjatë viteve për të cilat këtu kemi këtë kod lihen anash dhe duhet t'i trajtojmë, e të mos i trajtojmë me ligje një nga një e veç e veç, me të cilën barra buxhetore, kostoja buxhetore nuk duhet, por të organizojmë si shoqëri një diskutim të mirëfilltë mbi kodin, sistemin pensional dhe kështu të trajtojmë një herë mirë ndërtimin e sistemit pensional, i cili është edhe i qëndrueshëm financiarisht, edhe përfshirës për të gjithë, por të njëjtën kohë, i nderuar ministër, edhe ligj i cili e ka parasysh kapacitetin financiar, mundësitë financiare buxhetore të kësaj Republike.

Nëse duam që secilën grup të interesit ta trajtojmë me ligj partikular, të veçantë dhe asnjëherë të mos futemi në diskutime të vështira të ndërtimit të sistemit pensional, atëherë do të përfundojmë në kesi deklarata popullsitë, ku askush nuk do të merret me temën e vështirë, e që është ndërtim i mirëfilltë të sistemit pensional.

Ndërtohet fondi pensional, i cili paguan pensionet edhe për këtë kategori, por edhe për kategori të tjera, të cilat janë në gjashtë ligje të tjera, por edhe për ato që nuk janë të përfshira në asnjë ligj.

Pra, vitit 1990 deri në vitin 1999, me gjithë respektin, mundin dhe sakrificën e mësuesve, ka edhe kategori të tjera të cilat nuk janë të përfshira këtu, e që gjithashtu kanë qenë pjesë e një sistemi, i cili ka mirëmbajt rezistencën qoftë paqësore, qoftë gjatë luftës, e që nuk po përfshihen. Por nuk duhet ta bëjmë duke e fragmentuar diskutimin e duke fragmentuar ligjin e sistemin pensional.

Pra, mund të bëhet fare e lehtë në bashkëpunim me Ministri të Financave, me bashkëpunim me njerëz të fushës, me Universitetin e Prishtinës që të definohen qartë si e trajtojmë secilën kategori, të definohen kontributet, të ndërtohet sistemi, të definohen benefitet, të hyrat, të caktohet taveni i të hyrave pensionale maksimale.

Nëse e lexojmë këtë ligj mirë këtë që e keni sjellë ju këtu, mund të ndodhë, mund të ndodhë që dikush pagën sot që e ka ta ketë më të ulët se pensioni që do ta marrë dhe kjo është paradoks në veti, sikurse që është paradoks që te ne mosha mesatare e jetës për një mashkull është 63 vjet, e pensioni fillojmë ta gëzojmë me 65.

Pra, duhet trajtuar sistemin pensional në mënyrë të integruar dhe kështu nëse orvatemi që për votë të trajtojmë secilën temë veç e veç, do të përfundojmë me barrë buxhetore, sistem të fragmentuar e qasje karshi pensioneve që nuk siguron as mirëqenie, as barazi, as solidaritet e as qëndrueshmëri financiare dhe më pastaj normalisht që fajtori mbetet jetim.

Dhe unë po sugjeroj këtu sot, ndonëse në parim jemi dakord që të ecim tutje dhe në lexim të dytë t'i sjellim amendamentet.

Unë po propozoj që si shoqëri, si Kuvend, të trajtojmë sistemin pensional në mënyrë meritore, me të gjitha grupet, me angazhimin e secilit, por nuk bëhet kjo në mënyrë të fragmentuar. Na duhet fondi pensional në shtyllë të parë që vije prej një kontributi shtesë.

Ai fond pensional i ka të definuara qartë edhe benefitet për secilën kategori, edhe ato që i kemi deri tash me shtatë ligje të mbuluara, edhe ato që nuk i kemi të mbuluara dhe, në anën tjetër, të kuptojmë se cili është afati kohor në cilin i gjithë sistemi ynë pensional bartet nga shtylla një në shtyllën dy, pra kur bëhet mjaftueshëm fondi i Trustit të Kursimeve Pensionale, i madh, kontributdhënës të mjaftueshëm në te që të mos kemi barrë ose të mos krijojmë barra të tilla financiare buxhetore.

Përfundimisht Grupi ynë Parlamentar i Partisë Social Demokratike në leximin e dytë do të sjellë amendamente sa i përket këtij ligji.

Ky ligj, përveç se në vete ka shumë kategori, ka edhe tema të cilat vlejné të diskutohen edhe sa i përket mënyrës se qysh e interpretojmë trashëgiminë e pensionit, sepse përsëri këtu kemi edhe shpërputhje me idenë se si trashëgohet pensioni, deri në cilën moshë trashëgohet pensioni, kush trashëgon pension?

Jeni futur në diskutime, të cilat krijojnë probleme edhe për shtatë ligje të tjera, sepse atëherë e bëjmë një precedent, të cilin duhet ta vazhdojmë në tema të tjera.

Rrjedhimisht, do të sjellim amendamentet, por sugjeroj e propozoj, ministër, që të angazhoheni dhe këtu do të keni përkrahje për ndërtimin e një sistemi të mirëfilltë pensional, i cili vendoset nën ombrellën e kodit pensional të Republikës së Kosovës dhe jo ligje të fragmentuara, individuale, për benefit apo për interesa votash e popullizëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë dhe ju kolege deputete,

Të nderuar përfaqësues të Qeverisë,

Sot para vetes në leximin e parë e kemi një projektligj, të cilin se jo vetëm këtu në sallë, në praninë e deputetëve që kam nevojë të tregoj për rëndësinë e tij, por jam shumë e sigurt që e gjithë shoqëria është në dijeni se cila është rëndësia e këtij projektligji.

Por, më duhet t'ua rikujtoj atyre që vërtet nuk e mbajnë në mend apo thjesht nuk kanë qenë pjesë e proceseve nëpër të cilat ka kaluar procesi dhe kërkesa e vazhdueshme e Kuvendit të Republikës së Kosovës për t'u sjellë kur projektligj në lexim të parë, pra për t'u sjellë në Kuvend.

Nuk diskutohet pra vota për e grupit tonë si Aleancë për Ardhmërinë e Kosovës dhe jo vetëm që është obligim, por është edhe më shumë.

Prandaj, po jua rikujtoj që në kohën kur Kuvendi i Republikës së Kosovës kishte organizuar një debat dhe kishte rekomandime për Qeverinë, kishte dy takime komisioni në vitin 2013, Komisioni për Arsim, e që e obligonte Qeverinë e Republikës së Kosovës që në afatin prej tre muajsh ta sjellë projektligjin në Kuvend. Dhe, po jua rikujtoj që Qeveria e kaluar Mustafa, që vetëm fotografi bënte me sindikatat dhe nënshkruante, por nuk e merrte mundin për asnjë moment ta bënte hapin e parë për ta sjellë në Kuvend këtë projektligj.

Prandaj, duke e ditur edhe një herë që kjo Qeveri përreth shtatë muaj, duke i harruar edhe përpjekjet e vazhdueshme prej fillimit e ka sjellë në Kuvend projektligjin, por edhe një herë po ju them, Qeveria e kaluar, edhe pse obligohej me dokumente të Kuvendit, të deputetëve, as edhe një herë të vetme nuk e ka bërë përpjekjen më të vogël dhe, mbi të gjitha, nuk po flas për emra të përveçëm, siç është ish-ministri Rexhep Osmani, sepse besoj që krejt e dimë kush është, por nuk po merrem me atë temë, sepse sot konsideroj që vërtet e kemi për nder ta kalojmë në leximin e parë, gjithnjë duke qenë shumë të vetëdijshëm për kontributin tonë në Komisionin Funkcional, por njëkohësisht në mes të dy leximeve duke marrë parasysh edhe rekomandimet e secilit prej deputetëve, ne do ta bëjmë një ligj në bashkëpunim jo vetëm me ministrinë përkatëse, por edhe shumë profesionistë që vërtet të zbatohet dhe më së paku, në fund të fundit, është ajo që ne mund të arrijmë deri në leximin e dytë.

Prandaj, edhe një herë përfundimisht kisha dashur që ky ligj të jetë i fundit që ish- kryeministrat apo edhe kryeministrat e ardhshëm të bëjnë foto sa për të thënë dhe i keqpërdorin sindikatat dhe unë uroj që të gjitha sindikatat vërtet ta luajnë rolin e vet, por të dimë që roli i tyre në kohën kur ata nënshkruajnë memorandume me pushtetarë dhe mosrespekti i tyre, pra edhe një herë tregon pafuqinë politike që e ka pasur Qeveria Mustafa, prandaj edhe një herë, të nderuar, unë vërtet i uroj të gjithë punëtorët, të cilët fatkeqësisht çdo vit numri i tyre po bie dhe unë kam numrin e saktë, por nuk po ju lodhi me shifra për t'ju treguar edhe një herë se sa punëtorë prej vitit në vit, të gjitha të dhënat i kam nxjerr, fatkeqësisht ndodh që brenda vitit një numër shumë i madh i tyre nuk janë më në jetë, por uroj që familjet e tyre, pra të ish-punëtorëve të arsimit t'i gëzojnë benefitet që konsideroj nuk janë të mjaftueshme, por megjithatë më mirë është që ka ardhur ky projektligj në mënyrën se si ka ardhur, se sa të mos vinte fare, pra siç është trajtuar deri më sot.

Prandaj, edhe një herë duke e dhënë kontributin e vazhdueshëm në komision, uroj që vërtet fryma e komisionit ashtu siç ka qenë që ky projektligj të bëhet ligj i zbatueshëm dhe absolut jopolitik, se në fund të fundit, e kam thënë, të gjithë deputetët, por edhe të gjithë ministrat dhe kryeministrat janë në një formë produkt i asaj gjenerate. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kush e do fjalën në emër të Nismës? Zonja Albulena Halimaj.

ALBULENA BALAJ-HALIMAJ: Meqë shkollën e gjetën të mbyllur, nxënësit filluan të brohorisnin: “Mësim, duam mësim”. Derisa shkolla nuk hapej, nxënësve dhe mësimdhënësve filloi t'u bashkohej i gjithë fshati dhe siç pritën edhe ata, erdhën policia. Pa u bërë asnjë minutë filluan të gjuanin breshëri plumbash në turmë. Të guximshëm fshati filluan t'i ndihmonin të plagosurit dhe të vranët, duke mos u frikësuar tashmë as për veten.

Po, kush është ai fëmijë i përgjakur që çanta i kishte mbetur në përrua, nuk po e njihnin, sepse gjaku i kishte mbuluar fytyrën dhe tërë trupin. Njëri nga ta tha: “Ky është Hajrimi i Shabanit të Asllanit, Badallaj”. Ai ishte vetëm një fëmijë, ishte në klasën e pestë. Bashkë me Hajrimin atë

ditë u vra edhe Xhemshit e Xhylbehar Badallaj e u plagosën plotë 52 të tjerë. Por, fshatin nuk e la të vajtonte baca Ahmet, babai i tyre, sepse tha: trimat nuk vajtohen.

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kjo ndodhi në fshatin Zhur të Prizrenit, kjo ndodhi në Kosovë, kjo ndodhi sepse mësimdhënësit, nxënësit, studentët e gjithë populli i Kosovës nuk pranonte të mos mbahej mësimi shqip. Ata nuk pranonin të punohej me plan-programe të Serbisë. Mësuesit tanë punuan vetëm me një kusht, të mbijetonte arsimit shqip që nëpërmjet tij të na mësonin ta duam atdheun dhe t'i dalim zot kurdo që i vije rendi. Tani në këtë kohë është më e pakta që mund të bëjmë për ta, është gjëja më e vogël që ne mund të japim në krahasim me atë që ata e meritojnë. Ne kemi përballë shqyrtimin e një çështje sa të rëndësishme aq edhe të ndjeshme, shqyrtimin që kërkon njohjen institucionale të kontributeve të punëtorëve të arsimit për periudhën më të vështirë që vendi ynë ka kaluar, e ajo është koha e mbijetesës së dijes që konsiderohet një ndër shtyllat fundamentale të ekzistimit të një shteti.

Periudhë kjo që mësimdhënësit, drejtorët, bashkëpunëtorët, punëtorët administrativë e teknikë dhe përkrahësit e tjerë të viteve të '90-ta, si diaspora e të tjerë, e mbajtën gjallë arsimin në gjuhën shqipe, veprimtari për të cilën gjeneratat që i takojnë asaj periudhe gjenden sot në mesin tonë dhe janë pjesë e kësaj shoqërie, me po atë bazë arsimore të avancuar me kohë kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin kontributet e tyre në profesione të ndryshme për një shtet të ndërtuar mbi bazën e demokracisë.

Të nderuar deputetë,

Është debatuar shumë dhe janë dhënë shumë lëvdata nga viti 2013, por asnjëherë nuk i është dhënë prioritet po aq sa duhet zgjidhjes së kësaj çështje. Kohës historike ku është kontribuar në shtetndërtimin e Kosovës që meritojnë trajtim sa më të dinjitetshëm. Falënderojmë ministrin Bytyqi, kryeministrin Haradinaj për zgjidhjen e statusit të punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për periudhën e viteve të '90-ta. Sot ky projektligj është në duart tona, ne deputetët do të vendosim për këtë, duke mos harruar se këtu jemi edhe si rezultat i tyre, sepse çfarë do të ndodhte po të ndalej kontributi i tyre në këtë periudhë, ku do të ishim sot?

Qasja në arsim është meritë e pakontestueshme e mësimdhënësve të asaj periudhe, të cilët kanë vepruar për një perspektivë, duke qenë të vetëdijshëm se arsimimi luan një rol vendimtar në jetën e qytetarëve dhe të shoqërisë në tërësi. Kjo meqenëse arsimimi i parapërgatit të kryejnë role të ndryshme në shoqërinë tonë.

Deputetë të nderuar,

Bëj thirrje që ta votoni këtë projektligj, pasi që është më së paku që mund të bëjmë ne sot për ata patriotë të dijes, është vota jonë ku sadopak iu shpërblehet ai mund i pakusht që në një mënyrë

apo tjetër mbesin shembull të pakrahasueshëm të fuqizimit, të parimit kushtetues të së drejtës për arsim që veçse e kemi me Kushtetutën e Republikës së Kosovës si shtet demokratik.

Nisma Socialdemokrate e mbështet në parim këtë projektligj dhe fton të gjithë deputetët ta votojnë. Kontributin tonë do ta japim në drejtim të qartësimit të implikimeve financiare dhe të përfituesve. Për ta ulur koston financiare, ne do të japim idetë tona mes leximesh, por si ide fillestare mund të jetë e që më pas edhe do ta diskutojmë që kategoria e parë, 70% e pagës bazë, të jetë pensioni i tërësishëm i mësimdhënësve, pra duke përfshirë pensionin e pleqërisë, Trustin pensional, beneficioni i këtij ligji, pra i tëri të jetë 70% i pagës bazë me legjislacionin në fuqi.

Dhe, kategoria e dytë, 65% e pagës bazë të jetë pension i tërësishëm i mësimdhënësve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Mufera Shinik.

MÜFERA SRBICA-ŞINIK: Faleminderit, nënkryetar!

1990/91 ile 1998/99 yılları arasındaki durumu gözönünde bulundurursak, “6+” Parlamenter Gurubu bu Yasa Tasarısının birinci okunuşunu kabul etmektedir. Yasa Tasarısının önemini bildiğimiz için Kosova Bütçesine çok yük olacağını bile bile, Yasa Tasarısına evet diyoruz. İkinci okunuşuna doğru ilgili komisyonlarda katkımızı sunacağımızı bildirir, bu Yasa Tasarısının desteklenmesini bekliyoruz.

Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Ky është mandati im i katërt, por mund të them me përgjegjësi, këtë që po dua ta them s’po e them për votë, si po dëgjojmë prej dikujt këtu, por është projektligji që për mua dhe besoj për shumë deputetë këtu, edhe për të gjithë arsimtarët, të gjithë mësimdhënësit, është projektligj që të krijoj emocion të veçantë, sepse vërtet flasim për një armatë të tërë njerëzve që kanë dhënë shumë, kanë bërë shumë për ne, pse jo edhe kanë mundësuar që të jemi këtu ku jemi.

Unë po mundohem t’i ik asaj, se këtu disa fjalë edhe po keqkuptohen, ne duhet t’ua japim meritën edhe hakun, siç thotë populli, të gjithë atyre që kanë kontribuar në arsim, këtë rast dhe kategoritë e tjera, siç janë punëtorët e shëndetësisë, por edhe atyre që kanë mundësuar organizimin e kësaj. Është shumë e qartë që pa vullnetin e arsimtarëve, mësimdhënësve dhe të gjithë atyre organeve përcjellëse në atë kohë, ka qenë e pamundur kjo të bëhet, sikundër që ka qenë e pamundur pa një organizim politik të asaj kohe dhe institucional. Dhe, këtu nuk duhet t’i vijë kushtimisht kurrkujt keq, pse ne deputetët, qoftë të LDK-së, por edhe ndonjë tjetër e përmend faktin që në atë kohë me gatishmërinë e arsimtarëve, mësimdhënësve, njerëzve të

vullnetit të mirë pa dyshim që ka qenë kënaqësi dhe krenari të bëhej një organizim i tillë dhe po e them e besoj që në mos kolegët e mi, të gjithë këtu që janë edhe të tjerët që s'janë, nëse s'kanë qenë LDK-së, sigurisht kanë pasur familjarë, por kjo pak çon peshë nga ajo se çka është sot me rëndësi.

Sot ne nuk do të flisnim fare për një projektligj të tillë, por të mos ishte ajo periudhë e një organizimi të shkëlqyeshëm institucional, në kohë okupimi, në rrethana jashtëzakonisht të rënda, sepse që të gjithë e dimë cilat do të ishin pasojat. Do të krijohej armatë të tërë e analfabetëve, por fatbardhësisht ekzistimi i vullnetit edhe i institucioneve tona të atëhershme paralele ka bërë të mundur që të ketë një organizim të tillë, të shkëlqyeshëm dhe që s'mbahet mend në këto hapësirat të kësaj pjese të Evropës dhe unë nuk di edhe diku tjetër, nuk kam ndonjë informacion që ka pasur një organizim të tillë të shkëlqyeshëm të njerëzve që kanë dashur me të gjitha angazhimet e tyre të mos mbetemi analfabetë, të mos mbesin fëmijët a gjeneratat tona pa dije dhe pa shkollë.

Pa dyshim që sot të gjithë ata arsimtarë duhet përgëzuar, të gjithë ata mësimdhënës dhe të gjithë ata që e kanë bërë të mundur këtë, siç përmendën disa kategori, asnjëherë nuk mjafton t'u themi "faleminderit", por të themi qartë se ky veprim, ky organizim ka qenë historik, ekzistencial, jo vetëm në aspektin fizik, por shumë e qartë, edhe intelektual. Dhe, ne me këtë angazhim të gjithë popullit në atë kohë, edhe jashtë Kosovës, me ndihmat financiare, me paratë që janë derdhur në komisionet dhe ministrinë përkatëse, këshillat e solidaritetit dhe të gjitha këto kanë bërë të mundur që ne sot jemi këtu ku jemi.

Është shumë e qartë që në vitin 2018 të nxirret një projektligj për këtë kategori kontributdhënës është vonë, ose jeni vonuar, dhe unë e them që të gjithë kemi në një formë apo tjetër përgjegjësi, por duhet parë edhe rrethanat, të cilat kemi vepruar. Këto u përmend edhe viti 2013, Kosova ka Qeveri prej vitit 2001, nuk është vetëm prej vitit 2013 dhe unë nuk dua ta amnistoj as ta mbroj askënd, por s'kemi arritur që nga viti 2001 deri sot, s'kemi pasur fatkeqësisht mundësi të vijmë këtu ku jemi dhe pak a shumë të gjithë kemi përgjegjësi apo merita se pse po ndodh kjo që po ndodh.

Unë dua të përmend edhe një fakt që ne si subjekt politik, edhe në mandatin e kaluar janë bërë përpjekje, flas si kryetar i grupit që kam qenë. Këto takimet me sindikatat nuk kanë qenë sa për fotografi, po ju them me përgjegjësi, por kemi pasur një gatishmëri dhe unë e respektoj mendimin e koleges deputete, gatishmëri që të iniciohet në këtë drejtim diçka dhe të bëhet diçka, e fatbardhësisht atëherë ka filluar. Zoti Rrahman Jashari është gjallë, iniciativat kanë filluar në atë kohë, por ju e dini, ndoshta kjo është kategoria e njerëzve që janë edhe të sjellshëm, edhe të kulturuar, derisa i mbështet për muri, nuk dua të them që kjo është arsyeja se ndoshta edhe paralajmërimet për greva dhe protesta na sollën këtu ku jemi. S'do të duhej absolutisht, s'kam dëshirë kështu ta trajtojmë. Ne duhet të themi që kjo është nevojë, kërkesë dhe jo si pasojë e

presionit, sepse ju e dini, nuk mund të vinim ose s'mund të vihet në rend nganjëherë të nxirren projektligje jetike nga arsyeja se kemi pasur edhe të tjerë që kanë bërë protesta, bile edhe të dhunshme që t'u rregullohet statusi. Dhe, me të drejtë që u është rregulluar statusi, por një dallim i madh është që fatbardhësisht listat e arsimtarëve e punëtorëve arsimorë, e të gjitha atyre kategorive nuk mund të fryhen, sepse nuk mund të thuash ka qenë arsimtar filani e filani, sepse ka dëshmi për këtë. Dhe, po e them me përgjegjësinë e plotë që unë i gëzohem dhe i bashkohem gëzimit të gjithë deputetëve dhe të gjithë qytetarëve që sot më në fund po vjen një projektligj, i cili sadopak e rregullon mirëqenien, nëse mund të themi, të kategorive, të cilët përfitojnë prej këtij projektligji, duke mos anashkaluar në asnjë rrethanë edhe nevojën që edhe mjekët e asaj kohe, edhe të gjithë ata që kanë kontribuar në ekzistencën dhe mbijetesën, pse jo të shtetit të Republikës së Kosovës të asaj kohe, sot t'i gëzojnë këto të drejta.

Nuk mendoj që buxheti duhet të jetë problem, unë i kuptoj edhe rezervat që mund të ketë në këtë drejtim, po ju kisha lutur, jo me 16 milionë e 20 milionë, kjo nuk do të thotë që nëse abuzohet ose kushtimisht po jepen para vend e pavend, duhet të jepen edhe këtu, sepse kjo paralele nuk tërhiqet, këta e kanë plotësisht meritore të përkrahen dhe jo vetëm 16 milionë euro, por të gjithë të bëjmë përpjekje edhe nëse kushton më shumë këtë mundësi t'ua japim kësaj kategorie të njerëzve, sepse e meritojnë. Dhe, fare në fund edhe një herë më duhet ta theksoj kontributin e të gjithë atyre pronarëve shtëpive shkolla, veçmas, në mesin e shumë njerëzve, më lejoni edhe këtë ta them, kam pasur nderin të isha një ndër arsimtarët ose mësimdhënësit e asaj kohe, por nuk ka krenari më të madhe se ata njerëz çfarë pune kanë bërë dhe sigurisht nuk besoj që s'ka krenari dhe nder më i madh për të gjithë neve si deputetë që sot me këtë projektligj t'u dalim atyre njerëzve sadopak përballë në kërkesat e tyre, nevojat e tyre shumë të arsyeshme. Sepse, jo të gjithë prej tyre ose një numër sot janë deputetë, apo janë në vende të tjera, ata e kanë gjendjen më të rëndë se sa të tjerët që ndërkohë e kanë ndërruar edhe profesionin.

Prandaj, faleminderit për mundësinë që t'i them dy-tri fjali!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu ka replikë.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit!

Edhe unë, gjithashtu, respekt ish-shefit e zotit Beqiri, normalisht edhe shumë respekt për punën në atë periudhë, mbi të gjitha, po jua rikujtoj edhe një herë, pse Qeveria e kaluar nuk e solli në Kuvend dhe jo krejt rastësisht e solli kjo Qeveri?

KRYESUESI: Zoti Beqiri, kundër-replikë!

ISMET BEQIRI: Po, mirë, kjo pa dyshim, unë kam respekt jo vetëm për ju, por për çdo deputet të këtij Parlamenti. Por, ajo që e thashë nuk e devalvon rëndësinë e ardhjes sot të këtij projektligji, por çdo punë e ka një historik, asnjë punë nuk është rastësi, asnjë punë nuk del aty

për aty. Prandaj, as nuk mund t'ia merrni ose t'i merrni të gjitha meritat cilido subjekt sot që kjo po bëhet, sikundër që s'mund t'i marrim as ne, por unë e thashë si historik, si zhvillim, si punë që është bërë, ka një kontinuitet dhe fatbardhësisht ka ardhur tash, e thashë edhe një herë, ndoshta kishte ardhur edhe më herët, por ishin protestat, dhuna jashtë që nuk lejonin punë normale edhe për këtë çështje.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Luljeta Veselaj-Gutaj, sipas radhës.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Me të vërtetë sot ndihem jashtëzakonisht mirë që ne po diskutojmë për një projektligj të një rëndësie të veçantë, siç është Projektligji për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti 1990-1999.

Situata e krijuar në arsimin shqip të viteve '90-'99 kishte mobilizuar gjithë qytetarët, po ashtu edhe mësimitdhënësit e Republikës së Kosovës që me organizimin e procesit edukativo-arsimor të realizojnë plan-programet mësimore të Republikës së Kosovës vetëm në gjuhën shqipe. Shumë mësimitdhënës dhe veprimtarë të arsimit shqip u torturuan dhe u keqtrajtuar në forma të ndryshme nga okupuesit serbë, por qëllimi i vetëm ishte mbajtja gjallë e arsimin shqip në këto vite të vështira, të cilat e kishin kapluar vendin. Rezistenca intelektuale ndaj pushtuesit për të luftuar analfabetizmin me shumë sakrificë na bënë ne të gjithëve sot këtu të jemi përgjegjës dhe ta mbështesim këtë projektligj të kësaj rëndësie të veçantë.

Respekt të veçantë për të gjithë ata që dhanë shumë për këtë periudhë të ndritur të historisë së Kosovës. Shpresoj shumë që ne në të ardhmen e afërt do të rregullojmë edhe statusin e punëtorëve të tjerë, të cilët dhanë kontributin e tyre të pakursyer, siç janë punëtorët e shëndetësisë, Policia e Kosovës, minatorët dhe kategoritë e tjera, të cilat janë përjashtuar dhunshëm nga okupuesi serb. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Nagavci e ka fjalën.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Sigurisht se është një lajm shumë i mirë që Projektligji për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e '90-ta tashmë ka arritur në lexim të parë dhe të gjithë mësimitdhënësit që kanë punuar dhe kanë rezistuar në kohën më të vështirë për vendin, në kohën e mbijetesës së sistemit arsimor të këtyre viteve që kanë kontribuar në shtetndërtimin e Kosovës, ashtu si edhe të gjitha kategoritë e tjera që kanë qenë pjesë e këtij sistemi e meritojnë të kenë një trajtim të dinjitetshëm.

Në situatën në të cilën ndodhemi aktualisht, ku cilësia e arsimit lë mjaft për të dëshiruar, jo rrallëherë mësimit kanë qenë të detyruar të merren me çështje teknike e monetare, duke pamundësuar kështu fokusimin dhe përkushtimin e tyre të plotë në punë dhe në mësimit. Gjatë gjithë këtyre viteve partitë që kanë qeverisur me vendin, pa asnjë ndryshim, vazhdimisht kanë bërë kalkulime politike, gjë që po vërehet edhe sot këtu, duke bërë premtime për rritje pagash në kohë fushate, duke marrë merita dhe duke mos i kushtuar fare vëmendje gradimit të mësimit dhe vlerësimit të performancës së tyre bazuar në kritere dhe profesionalizëm.

Shumë pak është përdorur dhe shumë pak jemi marrë me cilësinë e mësimit dhe mësimit dhe pothuajse aspak me monitorimin e punës së mësimit dhe zyrtarëve të tjerë arsimorë. Në këtë drejtim jo rrallëherë të drejtat e kërkuara nga sindikatat nuk kanë arritur të jenë në raport edhe me përgjegjësitë e tyre, e pasojat e betejës në mes të kërkesave të drejta të mësimit dhe premtimeve të pambajtura të të gjitha qeverive deri më tani i kanë bartur nxënësit dhe të gjithë ne. Sigurisht se ky projektligj e ka përkrahjen e plotë të Lëvizjes Vetëvendosje, sigurisht në mes të dy leximeve edhe ne do të japim kontributin tonë, pasi që konsiderojmë që ka disa çështje të rëndësishme që duhet pasur parasysh dhe në të njëjtën kohë është obligim që vëmendja dhe energjia e mësimit, e SBASHK-ut, e Ministrisë së Arsimit dhe Qeverisë, sigurisht dhe të gjithë neve, duhet të orientohet drejt përmirësimit të cilësisë, mbështetjes së mësimit dhe mbikëqyrjes së punës së tyre, instrumenteve dhe mekanizmave për përmirësimin e kësaj gjendje në të cilën jemi sot në sistemin e arsimit.

Andaj, ne besojmë dhe angazhohemi që miratimi i këtij ligji të veçantë në bazë të cilit do të shpaguej puna e këtyre mësimit dhe kontributdhënësve të sistemit të arsimit shqip të viteve '90-ta duhet të bëhet sa më parë, sepse përshtypja është që edhe kësaj here do të hasë në format, të cilat do të pengojë realizimin e plotë dhe meritore të kësaj të drejte të mësimit dhe që ky ligj i premtuar që sa vjet, më në fund të bëhet realitet dhe përfundimisht të rregullohet statusi i këtyre mësimit dhe të gjithë kontribuuesve të tjerë të kësaj kategorie të këtyre viteve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rasim Selmanaj e ka fjalën.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Sot e kemi përpara Projektligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip në Republikën e Kosovës të viteve 90-ta, projektligj ky i cili na e kthen kujtesën e viteve kur përballëshim me vrasje, presionin sistematik dhe me mbylljen e shkollave shqipe nga regjimi serb i Milosheviqit.

Por, shkolla shqipe mbijetoi në saje të sakrificave të mëdha të punëtorëve të arsimit, por edhe të qytetarëve, duke krijuar atë kohë institucionin e parë paralel, i cili do të funksionojë jo vetëm gjatë represionit, por edhe në kohën e luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Mbijetesa e shkollës shqipe në vitet '90-ta pa dyshim që paraqet një nga ngjarjet më të rëndësishme të popullit shqiptar. Ishte kjo periudhë mbijetese që i dha leksion qëndrese Serbisë, duke ia bërë të qartë që nuk ka çmim që mbyll shkollën shqipe, e as që e ndal popullin e Kosovës deri te liria.

Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës,

Po e sjell në kujtesë dëshmorin e shkollës shqipe, Haki Povataj, nga Strellci i Epërm i Deçanit, i cili në vitet '90-ta kishte sjellë në Deçan vulat e para me mbishkrimin "Republika e Kosovës" dhe jorastësisht Haki Povataj do të mbytet me torturë në stacionin e policisë serbe në Deçan në vitin 1992.

Të nderuar kolegë deputetë,

Nga ajo që thashë jo pse desha të bëj histori, por vetëm ta kthej kujtesën për të treguar se mësimdhënësit e viteve '90-ta e kanë merituar dhe e meritojnë rregullimin e statusit të tyre, duka u njohur kështu meritat e arsimit shqip në kushtet e okupimit serb. Prandaj, e përgëzoj Qeverinë Haradinaj që na e sollti këtë projektligj në Parlamentin e Kosovës. Jemi të vetëdijshëm se mësimdhënësit e viteve të '90-ta meritojnë më shumë, por njohja e statusit për ta është më shumë satisfaksion moral për vlerësimin e meritave të tyre.

Të nderuar kolegë deputetë,

Pronarët e shtëpive shkolla ishin pjesë e kontributit dhe sakrificës për të mbijetuar arsimi shqip në Kosovë, prandaj njohja e këtij kontributi përmes Qeverisë, duke ua lëshuar nga një certifikatë, do të ishte një vlerësim real dhe meritore për këta njerëz që lëshuan shtëpitë e tyre që shkolla shqipe ta mbijetonte dhunën serbe.

Kërkoj që ky propozim imi të bëhet pjesë e këtij projektligji, bashkë me aprovimin e ligjit, ndarja e certifikatave do të ishte vlerësim përmbajtjesor dhe gjithëpërfshirës i gjithë asaj sakrifice të mësimdhënësve të viteve '90-ta. E tha Dardan Sejdiu me kod pensional apo çfarëdo zgjidhje tjetër duhet ta pranojmë, se ne jemi vonuar me këtë ligj. Por, edhe një herë, krejt në fund e përgëzoj Qeverinë Haradinaj që më në fund e ka sjellë këtë ligj që ta legjitimojmë dhe ta njohim statusin e punonjësve të arsimit të viteve '90-ta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Dardan Sejdiu e ka fjalën.

DARDAN SEJDIU: I nderuar kryesues!

Nuk kërkoj replikë pa më përmendur, e kam të qartë Rregulloren.

Po i përdor këto dy minuta për të sqaruar edhe një herë pse po insistoje që diskutimi për sistemin pensional të bëhet rreth një kodi pensional.

Mënyra se si po e trajtojmë secilën temë që ndërlidhet me benefitet që duhet t'i gëzojnë njerëzit që kanë kontribuar në këtë sistem, në këtë ekonomi, në këtë shoqëri, nuk duhet të jetë e fragmentuar, sepse duke e trajtuar si të fragmentuar, ndërtojmë ligje, të cilat përveç barrës buxhetore, krijojnë edhe pabarazi. Si do të trajtojmë edhe të tjerët, 70 000 sosh, që e kanë lënë punën për një ditë? Çfarë do t'u themi atyre? Si do t'i trajtojmë ata?

Pra, ne kështu hapim "Kutinë e Pandorës"! Çfarë duhet të bëjmë si shoqëri, si Kuvend, si Qeveri, është që të bëjmë kod të mirëfilltë pensional. Kontribute shtesë dhe të definojmë cili është pensioni minimal dhe cila është përqindja maksimale prej pagës mesatare që duhet të jetë pension. Kështu, me anë të kontributeve të definuara dhe për kategori të ndryshme edhe benefiteve të definuara në një kod të unifikuar pensional të zgjidhim, ministër, problemin, temën, çështjen, nevojën dhe kërkesën e pensioneve njëherë e përgjithmonë në mënyrë të qëndrueshme dhe të sigurojmë barazi për të gjithë ata, të cilët në periudhën kohore 1990-1999 në mënyra të ndryshme, se kush më pak e kush më shumë, kanë kontribuar që të mirëmbajmë një rezistencë, siç e thashë edhe paqësore, por edhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

Kështu që, insistoj që diskutimi për kodin pensional të mos trajtohet si një ide e vonuar, por si ide e kohës dhe e momentit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Selmanaj ka kundër-replikë.

RASIM SELMANAJ: Unë nuk thashë që ideja për kodin pensional është ide e vonuar, po e përsëris, Projektligji për njohjen e meritave punonjësve të viteve të '90-ta është ide e hershme, por si projektligj është i vonuar. Këtë e thashë dhe qëndroj prapa kësaj, mendoj që sot Kuvendi i Kosovës po e bën një punë të mirë, sepse po i njih meritat e njerëzve që me të vërtetë kanë sakrifikuar në atë kohë për ta mbajtur gjallë arsimin shqip në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

Arsyeja pse dola këtu është që nga të gjithë parafolësit e mi nuk është përmendur në asnjë moment, nga asnjë deputet, ata njerëz të cilët e kanë mbajtur gjallë arsimin shqip të Kosovës. Janë dy faktorë: është mërgata dhe është Qeveria në ekzil e Kosovës, e cila e ka pasur aksionin "Ta ndihmojmë arsimin shqip në Kosovë".

Dhe, t'i harrosh kontributet e diasporës, se 90% e kanë mbajtur arsimin përmes Qeverisë në ekzil, përmes mekanizmave të tjerë. Po, popullata po, veç e kanë mbajtur ata, se po të mos dërgoheshin para, Shkumbin, ti s'kishe dhënë mësim, se të gjithë arsimtarët janë paguar. Më fal! Mirë, de!

Unë po ju them që janë faturat, u kërkoj falje pronarëve të shtëpive, ndoshta nuk u është paguar qiraja, por të gjithë arsimtarët janë paguar, janë dëshmitë dhe janë faturat. Dhe, kjo është një fakt i padiskutueshëm dhe i pamohueshëm. Kur edhe arsimi shqip bëhet folklor e bëhet patriotizëm, “e ka hëngër dreqi këtë vend”. Kur Ibrahim Rugova synohet të bëhet pronë private e disa individëve, kur dihet se Ibrahim Rugova është pronë e të gjithë kombit shqiptar, se ka dhënë një kontribut kolosal në rrafshin politik, kur Adem Demaçi ka dhënë një kontribut kolosal, një sakrificë kolosale për të gjithë shqiptarët, pavarësisht pajtohemi apo nuk pajtohemi me idetë politike të njëri-tjetrit. Në qoftë se dikush e harron kontributin e sindikatës së punëtorëve në krye me prof. dr. Hajrullah Goranin, kjo unë nuk di si shpjegohet. Pastaj, kemi pasur LASH-in (Lidhjen e Arsimtarëve të Kosovës) që kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm. Figurat kombëtare, si Adem Jashari, Adem Demaçi, Ibrahim Rugova nuk janë pronë private e askujt. Janë pronë e historisë sonë kombëtare dhe ne individët kot flasim këtu. Prandaj, dola këtu për të thënë diçka, zoti ministër, jo që të përgëzoj, sepse Milosheviqi ka goditur dy segmente kryesore, dy palca kurrizore të kombit shqiptar: e ka goditur arsimin dhe i ka goditur gazetarët, mediet e lira në Kosovë, Radiotelevizionin e Kosovës, Radiotelevizionin e Prishtinës.

Prandaj ju që e keni bërë një veprim të tillë, ju përgëzoj. Ata që nuk e kanë bërë, ju që keni qenë deputetë të mandateve të kaluara, kur e merrni fjalën, bile është një rregull elementare, të thuhet “u kërkojmë falje qytetarëve të Kosovës që ne si deputetë nuk kemi qenë më të zëshëm”. Qe, Arben, po ta përmend emrin, se s’po dua të hyj në akuza përse s’ka ardhur deri sot ligji. Më fal, unë kërkoj falje, në qoftë se dikë e prek pa vend, unë i kërkoj falje. Por, domethënë, përtej asaj duhet pak deputetët të jenë modestë. Ju që keni qenë në legjislaturat e kaluara, duhet të thoni “ngadalë, avash, se ne jemi kontribuues të zvarritjes për mosardhjen e këtij ligji në Parlamentin e Kosovës”. Shyqyr Zoti, që sot jemi bërë bashkë këtu, po e çojmë ligjin përpara dhe po i respektojmë të gjithë baballarët tanë që kanë bërë rezistencën më madhore kundër regjimit të Serbisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka Naser Osmani, s’iu ka përmendur emrin kurrkujt. Jo, jo, hiç!

(Ndërrhyrje nga salla)

NASER OSMANI: Unë e dëgjova Milaimin, por unë thjesht dua ta falënderoj sponsoruesin e këtij ligji, që më në fund ka arritur në Kuvend, sidomos qëndrueshmërinë e Sindikatës së arsimit që ka qenë shumë konsistente që kjo të vijë sot në Kuvend dhe ne të debatojmë për një periudhë shumë të rëndësishme të historisë sonë, sidomos periudhën e deputetit të 2 Korrikut 1990, kur është nxjerrë Deklarata Kushtetuese, kur janë vënë gurthemet e shtetit të Kosovës, kur është bërë organizimi institucional, që e quajmë “Sistemi paralel i Republikës së Kosovës”, i pashmangshëm është emri i presidentit, atëherë ish-kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ibrahim Rugova, i cili me një organizim edhe me subjektet e tjera atëherë që ishin, për shkak të

rrethanave të asaj kohe kanë bërë organizimin më të mirë për të qëndruar, për t'i qëndruar përballë represionit të atëhershëm të Milosheviqit.

Konsideroj që punëtorët e arsimit, të të gjitha niveleve, ata që janë marrë me sport, ata që janë marrë me kulturë, ata që kanë ndihmuar për asistencë sociale do të ishte mirë ta kenë vendin në këtë ligj, meqenëse ky draft-ligj përfshin të gjitha kategoritë që kanë të bëjnë me sistemin e arsimit të viteve të '90-ta, duke përfshirë arsimtarët, profesorët, institucionet, institutet e atëhershme, Institutin Albanologjik, Institutin e Historisë, Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Entin Pedagogjik të Kosovës, Entin për Librin Shkollor dhe institucione të tjera, në veçanti Këshillin për Financim të Kosovës, që në mënyrë të shkëlqyeshme ka arritur të bëjë grumbullimin dhe shpërndarjen e mjeteve për punëtorët e arsimit.

Evidente është se për këtë periudhë punëtorët e arsimit kanë marrë pagë. Kanë marrë pagë varësisht prej viteve kur kemi hyrë në financim të kësaj kategorie, por në fund kemi arritur të sigurojmë një pagë prej 120 euro, është fjala diku rreth 21 mijë punëtorë të arsimit që kanë qenë të kyçur. Për të qenë më konkret, nga këto mjete që janë grumbulluar nga diaspora e Kosovës, që kanë ardhur atëherë nëpërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, respektivisht Ministrisë së Financave, po edhe pjesa dërrmuese e mjeteve që janë grumbulluar në Kosovë nga familjet që kanë ndarë nga pagat, nga të hyrat e tyre, nga arsimtarët që kanë marrë pagë, të cilëve ua kemi ndaluar 5%-shin nga paga e tyre, që e kemi konsideruar atëherë si kontribut, nga donacione të ndryshme, forma të ndryshme të organizimit. Me fjalë të tjera, për këtë periudhë u janë ndarë punëtorëve të arsimit në të gjitha këto nivele 147 milionë e 598 mijë e 584 marka, duke pasur parasysh që janë paguar edhe një pjesë e shpenzimeve të punëtorëve të arsimit, shpenzimet materiale të shkollave, janë ndarë edhe plus 607 901 marka. Gjithsej për këtë periudhë janë grumbulluar 169 990 274 marka, me fjalë të tjera, kjo pjesa tjetër ka qenë e dedikuar për sport, kulturë, asistencë sociale e shëndetësi.

Konsideroj se ligji i tanishëm, që dua ta falënderoj edhe ministrin në fjalë, meqenëse tash më është ngatërruar, më duket ministri Bytyqi a po? Kush e ka sponsoruar këtë ligj? Konsideroj se ne duhet të kemi parasysh që gjatë amendamentimit të bëjmë atë që është e mundur, duke e larguar pak dëshirat dhe egoizmin tonë që të përballemi pastaj me vështirësi të tjera buxhetore. Ajo që në fund kisha dashur ta them si pjesëmarrës i këtij procesi është se kam ndier veten mirë kur në draft-ligjin e propozuar kam parë edhe se do të jetë Këshilli për Financim i Kosovës, i të gjitha niveleve, 29 këshilla komunalë, një armatë e tërë e njerëzve që kanë punuar për këtë sistem dhe diasporën e Kosovës, që vazhdimisht ka mbuluar pjesën e mjeteve financiare, të cilën ne nuk kemi mundur ta grumbullojmë në masën e duhur brenda në Kosovë.

Prandaj, ky është një prej ligjeve më të mira dhe sjell satisfaksion për secilin prej nesh që kemi punuar në atë periudhë. Konsideroj që duhet të jemi modestë, ta shënojmë, ta legjitimojmë këtë

periudhë, nuk është fjala për përfitime, për donacione, për subvencione, por është fjala për një akt moral të asaj periudhe që duhet njohur, sidomos stazhin e punës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Haxhi Avdyli e ka fjalën.

HAXHI AVDYLI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Ligji për statusin e punëtorëve të arsimit shqip në Republikën e Kosovës për vitin 1990/99 është një ligj merititor. U jep një mirënjohje sado të vogël për kontributin e madh që kanë mbajtur mësimdhënësit, të cilët e mbajtën gjallë arsimin, edukimin shqip, por edhe rezistencën popullore ndaj pushtimit, segregacionit racist të Serbisë të viteve '90-ta.

Ky sistem arsimor u mbajt edhe me vullnetin, por edhe thirrjen për rezistencë të mësimdhënësve të kohës, si një rezistencë edhe ndaj pushtimit. Edhe pse tani mund të themi që ky ligj është i vonuar, mund të themi se e konsiderojmë që është i qëlluar dhe i nevojshëm dhe LDK-ja në vazhdimësi ka kërkuar dhe ka ngritur këtë çështje. Konsideroj se ky ligj duhet të votohet njëzëri, por vërejtja ime është te përkrahja e vogël financiare për këtë kontribut, si kjo përkrahje financiare është më se e vogël. Faktikisht, në bazë të kostos financiare të prezantuar nga Ministria e Financave për kontribuuesit mbi 5 vjet në arsimin shqip të viteve '90-ta del se është vetëm 63 euro shtesë, ndërsa ata me më pak se 5 vjet kontribut, del se është vetëm 23 euro shtesë dhe këtë duhet t'ua themi haptas të gjithë mësimdhënësve, se nuk është ndonjë shumë aq e madhe, por është një mirënjohje apo kontribut për gjithë atë punë që e kanë bërë në ato vite.

Mendoj që puna e tyre ka qenë kruciale për mbajtjen gjallë të qëndresës, por edhe edukimit të brezave, prandaj përkrahja e këtij ligji mund të thuhet se është edhe një mirënjohje për të kaluarën, por është edhe një investim për të ardhmen, sepse me këtë, edhe pse është një shumë e vogël, sadopak po ngritet standardi i tyre jetësor. Normalisht, edhe unë u bashkohem të gjithë deputetëve dhe e përsërisht këtë ligj, por të njëjtën kohë pres se do të ketë plotësime që do të avancojmë edhe më tutje, dhe shpresoj që nga kjo seancë do të dalin sugjerime të dobishme, që do ta avancojmë dhe që këto sugjerime të inkorporoheshin në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Një ligj, i cili fillimisht ka filluar për njohjen e kontributit të arsimtarëve të viteve të '90-ta dhe që pastaj me pasuesit edhe në Qeveri, po tash edhe në Kuvend do të thotë, do të avancohet edhe më tutje, do të thotë edhe rregullimi i beneficioneve për ta.

Jorastësisht me vete mora disa dokumente që janë kërkesa të punëtorëve të ish-kombinatit “Ramiz Zadiku”, të cilët padrejtësisht, veç pse kanë qenë shqiptarë, janë larguar prej punës në vitet e ‘90-ta. E dini që “Ramiz Sadiku” është privatizuar dhe disa prej tyre kanë gëzuar disa benefite, disa me të drejtë, disa pa të drejtë dhe këtu kam një regjistër prej 470 prej tyre që u është mohuar e drejta edhe e 20%-shit. Kanë kërkuar, të shkretit, edhe në AKP, edhe në institucione të tjera, të paktën t’i gëzojnë beneficinin, atë të 20%-shin që u ka takuar me ligj, por disa përfaqësues të sindikatave ua kanë mohuar këtë të drejtë, me disa përfaqësues të ndërmarrjeve, edhe me disa të AKP-së.

Këta as nuk e gëzojnë beneficinin e ndërmarrjes, e as nuk kanë ndonjë beneficion prej shtetit. Disa prej tyre kanë dhënë kontribute edhe në sfera të tjera gjatë çlirimit të vendit, por që s’gëzojnë asnjë, si këta janë edhe minatorët, të cilët në vitet ‘90-ta e kanë zgjuar popullin tonë nga ajo fjetja e robërisë. Minatorët, e dini, me 52 euro i trajtojmë sot, kurrfarë beneficioni tjetër s’kanë. Po ashtu, i kemi edhe kategoritë e tjera që kanë kontribuar në këtë periudhë të viteve ‘90-ta, punëtorët shëndetësorë, të cilët u larguan nga puna dhe vazhduan punën e tyre bashkë me mësimdhënësit, për të mbajtur gjallë frymën e atdhedashurisë dhe të lirisë. Kontributi i gjithë popullit shqiptar, jo vetëm në arsim, po në të gjitha sferat e tjera ka qenë i përbashkët.

Mendoj që, ndoshta edhe ky propozimi im konsiston edhe me disa nga folësit e tjerë këtu, që vërtet ne do të duhej t’i trajtojmë të gjitha kategoritë, jo veç një kategori, por sigurisht që kjo të rregullohet në mënyrë shumë më të mirë se sa kjo parçiale, e nëse vërtet ne e përdorim këtë ligj të arsimit, të punëtorëve të arsimit të viteve të ‘90-ta, të cilët në atë periudhë kohore na kanë unifikuar rreth çështjes kombëtare, rreth lirisë sonë, ne sot si deputetë, përfaqësues të tyre këtu të kemi polemika të tilla, është e papranueshme. Ndoshta ka ndonjë deputet këtu që është supremen dhe këto probleme do t’i zgjidhte në mandatin e parë, por që për fat të keq, nuk është kështu.

Gradualisht po vijnë duke u zgjidhur të gjitha problemet që i ka shoqëria jonë, por që të mos i harrojmë kategoritë e tjera, edhe ato janë të rëndësishme. Ju e dini që vonë i kemi rregulluar edhe çështjen e kategorive të luftës. Bile, bile, është abuzuar shumë pastaj me ato hapësira ligjore, të cilat pastaj këtu në Kuvend janë miratuar dhe të tjerë kanë arritur t’i keqpërdorin dhe t’i shfrytëzojnë për vete.

Duke shprehur edhe një herë mbështetjen time për ligjin, por jo vetëm për këtë kategori, edhe për ata që kanë ndihmuar, që kanë liruar shtëpitë e tyre, i kanë bërë shkolla, pastaj disa prej tyre kanë pësuar shumë, kanë pasur pasoja shumë të rënda për shkak të kontributit, të tjerët që kanë ndihmuar edhe në transportimin e nxënësve a të mësimdhënësve pa para, edhe të gjithë ata të tjerët që kanë kontribuar në këto sfera si dhe ata që janë kujdesur për shëndetin e popullatës tonë në shoqatën “Nëna Terezë”. Punëtorët e shoqatës “Nëna Terezë” nuk guxojmë t’i anashkalojmë. Ata kanë pasur pasoja të rënda për punën që e kanë bërë në interesin e popullit tonë, prandaj ne duhet të mendojmë për të gjitha kategoritë.

Dua të kthehem edhe një herë te problemi i punëtorëve të “Ramiz Sadikut”, për çka do të kërkoj mbështetjen tuaj për krijimin e një komisioni hetimor për shqyrtimin e privatizimit të “Ramiz Sadikut” dhe padrejtësisë që u është bërë këtyre 470 punëtorëve, të cilëve nuk u është paguar 20%-shi. Faleminderit!

KRYETARI: Ismajl Kurteshi e ka fjalën. Nga Lëvizja Vetëvendosje, Sami Kurteshi, a bën? Ismajli kur të vijë duhet prapë ta kërkojë fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Këtu u ngrit një çështje edhe kjo ka të bëjë me Projektligjin për pensionet për mësimdhënësit e periudhës '90-'99.

Kjo është një punë e mirë, me vend, megjithëse vonë, por e pjesshme.

Unë do t'i ngre dy çështje që janë të lidhur me pensionet, po kanë të bëjnë me çështjen e pensioneve në përgjithësi.

Së pari, Kosova si shoqëri e organizuar, si shtet, ka dy mungesa themelore që përbëjnë themelin e dinjitetit dhe të shëndetit të njeriut. Ka mungesën pensioneve familjare, shoqërore dhe invalide të të punës, në njërën anë dhe, ka mungesën e sigurimeve shëndetësore, në anën tjetër. Këto janë dy mungesa themelore në një shoqëri që përbëjnë edhe themelin e dinjitetit njerëzor.

Një problem tjetër në vete që paraqet çështja e pensioneve në Kosovë, e që është duke u zvarritur me vite të tëra, është edhe çështja që paraqet pamundësia e përmbushjes së kriterit 15-vjeçar për realizimin e pensionit kontributpagues.

Ky është një problem jashtëzakonisht i madh, ky është një mohim i pronës.

Pensioni kontributpagues është pronë, të cilën nuk mund t'ia mohojë askush një individ. Ky absurd dhe ky paradoks ngjan vetëm në Republikën e Kosovës.

Sigurisht kjo çështje duhet të ngrihet me seriozitetin më të madh dhe nuk mund të ngrihet vetëm me projektligjet e pjesshme.

Një problem tjetër që lidhet me këtë çështje dhe me çështjen e fondit pensional në përgjithësi, në të vërtetë është çështja e vjedhjes së fondit pensional, fondit invalidor, fondit të pensioneve familjare nga Serbia në vitin 1999.

Çka është bërë në këtë drejtim?

Në vitin 2012, në rastin Grudiq, një qytetar nga Kosova, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin 31925/08 e nxjerr një aktgjykim, me të cilin e obligon Qeverinë e Serbisë që qytetarëve të Kosovës, pa diskriminim, t'ua paguajë pensionet nga fondi i vjedhur pensional.

Që atëherë Qeveria e Serbisë ka bërë obstrukcione nga më të ndryshmet dhe ka bërë përpjekje që t'i ikë këtij obligimi dhe zbatimit të vendimit të aktgjykimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ky është një gjykim parimor që e obligon Qeverinë e Serbisë të sillet pa diskriminim në raport me të gjithë pensionistët e tjerë nga Kosova.

Këtë ikje Qeveria e Serbisë është duke e vazhduar pa asnjë pengesë, në të vërtetë kemi edhe tri vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Serbisë, e cila është në frymën e vendimit të aktgjykimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sepse qytetarë të ndryshëm nga Kosova kanë hasur në probleme të jashtëzakonshme për plotësimin, sigurimin dhe kompletimin e dokumentacionit për të dëshmuar për të drejtën e tyre për pensione.

Në vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Serbisë, jo të Kosovës, po të Serbisë, obligohet Fondi Pensional i Republikës së Serbisë që vetë t'i sigurojë dokumentet e qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe të gjithë qytetarëve që kanë figuruar në listat e Fondit Pensional të Serbisë deri në vitin 1999 dhe të mos bëjë obstrukcione, duke e mohuar të drejtën për pensione të qytetarëve të Kosovës.

Në këtë drejtim kemi një varg problemesh, të cilat kanë mbetur të pazgjidhura dhe askund, në asnjë rast, nuk është vërejtur angazhimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i institucioneve të Republikës së Kosovës që nga lufta e këndeje për këtë çështje në lidhje me pensionet. Në këtë kuptim unë dua të ngre këto çështje, dua të ngre çështjen e aktualizimit të vjedhjes së fondit pensional, invalidor, familjar dhe atë të punës nga Serbia.

Dy, dua të ngre çështjen e mosangazhimit të qeverive të Kosovës tani e 19 vjet në lidhje me këtë çështje, po ashtu mosreagimi dhe mosangazhimin e qeverive të deritashme të Kosovës në lidhje me zgjatimin dhe ekzekutimin e vendimeve dhe aktgjykimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me pensionet.

Unë natyrisht e shoh jashtëzakonisht shqetësuese që kjo heshtet, ky mosveprim i institucioneve të Republikës së Kosovës lihet anash dhe nuk përmendet kurrë.

Prandaj, kërkoj nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe nga të gjitha institucionet që në çfarëdo bisedime të ardhshme Kosovë-Serbi, që janë duke u mbajtur herë fshehurazi, herë hapur, që përveç çështjes së të pagjeturve dhe të zhdukurve që duhet të jetë temë kyçe, të ngrihet çështja

e vjedhjes dhe e kthimit të fondit pensional, familjar, invalidor dhe të punës të qytetarëve të Kosovës, të vjedhur nga Serbia në vitin 1999 dhe të fondit të kursimeve që është vjedhur nga Kosova në vitin 1999.

Natyrisht kjo do të ishte në rregull dhe unë kërkoj që qeveritarët tanë, udhëheqësit e institucioneve të mos dalin me kërcënime për padi kur u duhen për vota apo për popullizëm për padi që do t'i bëjnë Serbisë për krimet e gjenocidit dhe krime të luftës dhe të kërkojnë forma të ndryshme të shpagimit pa bërë asnjë punë. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Armend Zemaj e ka fjalën. Armend, kërkoj falje, për besë s'e kam parë, qenka AAK-ja në radhitje. A prish punë? Muharrem Nitaj e ka fjalën.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Përpara se të them çka do qoftë, më duhet ta shpreh zhgënjimin dhe distancimin tim me përplasjen verbale të deputetit të LDK-së me nënkryetarin e Kuvendit, një përplasje aspak dinjitoze.

Ky projektligj rregullon një problematikë dhe unë besoj që nuk duhet të jetë frymëzim e platformë për disa fjalime emocionale, për disa poezi dhe për njëfarë lloj historie se çfarë ka ndodhur në vitin '91 deri në '99. Po e vërej se fjalimet janë emocionale, sikur punëtorët e arsimit kanë bërë mrekulli në kohën e tyre. Ata në realitet e kanë bërë detyrën, siç e kanë bërë edhe shumë punëtorë shëndetësorë, siç e kanë bërë minatorët, siç kanë qenë ish-policët, studentët, 70 mijë vetë të pushuar nga puna.

Të gjithë këta kanë funksionuar në rrethana të një okupimi klasik dhe, bile, për më tepër, punëtorët e arsimit, e përmendi kolegu Zeka, në atë kohë edhe janë paguar.

Mirë që ka ardhur Ligji për trajtimin e punëtorëve të arsimit në periudhën '91-'99 dhe keq që nuk është i plotë.

Unë e mbështes nismën e deputetit Dardan Sejdiu që zgjidhja të mos jetë e pjesshme, por realisht më mirë pak, se hiç.

Qeveria e Republikës së Kosovës e ka sjellë këtë projektligj në sallë të Kuvendit, me sa po shoh unë, të gjithë deputetët dhe të gjitha grupet parlamentare janë pro këtij projektligji, bile shumica prej tyre po thonë që jemi vonuar me këtë projektligj. Prandaj, nuk e kuptoj, për shembull, pse tani secili, pavarësisht se jemi pro këtij projektligj dhe që tani po e shqyrtojmë leximin e parë dhe

që do të mund ta japim kontributin edhe në fazën e mëvonshme, kanë nevojë që domosdoshmërisht të diskutojnë në numër kaq të madh. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Armend Zemaj, tani është radha juaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Kolegë deputetë,

Sa herë që kemi ligje, për mendimin tim, të gjitha janë të rëndësishme së veçantë, por disa që e njohin edhe kontributin e njerëzve që kanë punuar dhe vepruar në të kaluar, e kisha pasur një porosi që të mos harrojmë se ky Kuvend ka memorie institucionale. Mbi të gjitha, vetë e kaluara jonë na krijon mundësinë që të mos mbizotërojë logjika selektive, të mos e quaj primitive nga disa individë, në të kaluarën e afërt, të cilët kanë menduar se jeta fillon me ta apo historia fillon me vitin 1998 e këndej. Kështu që i kanë sfiduar edhe mësimdhënësit, edhe intelektualët, edhe veprimtarët patriotikë, edhe të devotshëm, edhe luftën, edhe luftëtarët. Mbi të gjitha, është tentuar të veprohet në mënyrë selektive me njerëz, në bazë të interesave individuale grupore për përfitime politike edhe partiake.

Pse po e them këtë? Në vitin 2008 ka qenë një vendim, kërkesë jona, e deputetëve të asaj kohe, i cili ka insistuar që Qeveria e Republikës së asaj kohe të pranojë punën dhe përvojën e mësimdhënësve dhe ky konstatim është ardhur si këputje e zinxhirit të realizimit të vendimeve të marra që ky kontribut të njihet me ligj.

Kjo ka vazhduar me vite të tëra, ka vazhduar edhe me debatin, i cili ka nxjerrë rekomandime më 18. 4. 2013. Pse po i përmend këto, kolegë deputetë? Sepse janë vendime, të cilat kanë anashkaluar rekomandimet e Kuvendit, të cilët deputetët e Parlamentit të Republikës së Kosovës, pa hyrë në aspektin individual, me respekt shumë të madh kanë vlerësuar dhe kanë konsideruar punën e arsimtarëve në atë periudhë, të mësimdhënësve në tërësi, edhe stafit, qoftë ai profesional, qoftë ai teknik.

Kështu që tash ne flasim për kontributin për liri dhe pavarësi, i ndërtuar me mund dhe sakrificë, deri në flijim të jetës, sepse kemi 400 mësimdhënës, të cilët kanë humbur jetën në kohën e luftës. Kontribut i çmuar për shtet demokratik, të zhvilluar, duke insistuar që emrat e njerëzve, të cilët kanë qenë veprimtarë, kanë qenë njerëz të dijës, mbi të gjitha intelektualë dhe kanë qenë të rreshtuar mbas idealit të lirisë dhe pavarësisë, jo vetëm që ndërtuan dhe avancuar në atë kohë arsimin e pavarur shqip, po edhe e dhanë jetën në mbrojtje të shkollës shqipe.

Unë po e përsëris, sepse nuk është e tepërt të flitet për Haki Povatën, për Halit Gecin, për prindërit e Uqës dhe deri te akademikët Fehmi Agani, Ukshin Hoti e të tjerë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky angazhim yni është tentuar të futet pjesë e legjislativit edhe në dhjetor të vitit 2014. Në dhjetor të vitit 2014 deputetët e Kuvendit të Kosovës, Armendi, Vjosa, Doruntina, Arben Gashi, kanë paraqitur amendament, i cili është bërë pjesë e ligjit dhe i cili e njeh kontributin e vitet 1989-1999, jo vetëm për punëtorët e arsimit, por edhe për të shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës të asaj kohe. Kjo nuk është zbatuar, nuk ka hyrë në fuqi asnjëherë.

Kolegë të nderuar deputetë,

Për kujtesën tonë dhe tuajën,

Më 22 dhjetor të vitit 2017 po ky Kuvend, po shumica e deputetëve që janë të pranishëm, e kanë refuzuar prapë një amendament të tillë, vetëm për tri vota nuk ka kaluar që të njihet po ashtu kontributi i mësimdhënësve të viteve '90, për të cilën sot po flasim.

Këto i përmenda për të ardhur te një konkluzion që disa kolegë tanë deputetë këtu me të drejtë i shprehën shqetësimet e realizimit të këtij pensioni.

Tash po dal te pjesa kryesore, që është pjesë e ligjit.

A janë të kënaqur ata që do të përfitojnë? Unë nuk besoj që do të jenë të kënaqur, prapa ligjit ka ikje nga faza fillestare e kompensimit shtesë që është kërkuar, sepse me nenin 7, neni 1.3 e lexoi ministri, domethënë e lexoi shumë saktë, për të qenë i sigurtë dhe unë e përgëzoj për sigjeritetin që të jetë transparent edhe me ata që kërkojnë që pensioni meritator është i vetmi pension që marrin këto kategori, duke u bazuar në paragrafin 1, të nenit 6. Tash çka nënkupton kjo? Kjo nënkupton që sipas këtij ligji, ata do të përfitojnë vetëm një pension.

Kështu që rritja dhe kontributi shtesë është minimal, është tepër minimale, është rrezik që dikush mund të përfitojë më pak se sa përfiton në fazën fillestare të daljes në pension, duke marrë parasysh edhe Trustin Pensional, si kontribut, i cili paguhet në mënyrë individuale dhe që konsiderohet edhe private.

Andaj, nëse Kuvendi dhe Qeveria kanë vullnet, mbi të gjitha, nëse ekziston mundësia financiare dhe buxhetore, pa dashur të hyhet te pjesa e dyshimeve që kanë lindur sidomos me kategorinë e keqpërdorimit të veteranëve të luftës dhe të kategorive të tjera, atëherë ne duhet ta konsiderojmë dhe të ulemi të bisedojmë pa ngarkesa politike se a do t'ju afrojmë kompensim shtesë këtyre kategorive. Tek atëherë ne mund të flasim për një beneficium të caktuar.

E vetmja e mirë ligjore që sot po e përfaqon Kuvendi dhe po e përkrah është njohja e kontributit që llogaritet kontributdhënie e viteve, të cilat duhet t'i kenë së paku 15 vjet përvojë pune, sepse mësuesit, të cilët kur janë drejtuar për të marrë këtë të drejtë, është dashur ta kenë të plotë 15-

vjetëshin. Shumica prej tyre, të gjithë keni familjarë, miq, dashamirë, ka edhe të atillë që për 2-3 ditë nuk kanë arritur ta kenë dhe ta gëzojnë pensionin e plotë.

Kolegë të nderuar deputetë,

Unë besoj që Komisioni Funkcional, si përgjegjës jo vetëm në aspektin mbikëqyrës, por edhe të avancimit të kësaj politike që sot e ka afruar Ministria e Arsimit dhe Qeveria, duhet ulur sinqerisht dhe në aspektin konkret të realizimit të kësaj të drejte, jo që të mashtrohen pjesa apo kategoria që ne po e konsiderojmë me të drejtë më e çmuar e periudhës së lirisë dhe të pavarësisë, mësimdhënësit të të gjitha kategorive, njerëzit që kanë punuar, nga sekretaritë deri te ata të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në forma të ndihmës së drejtpërdrejtë dhe të shtëpive shkolla.

Unë do të jem i gatshëm të kontribuoj në dy aspekte.

E para, eliminimin e defekteve dhe dualizmi që ka sjellë dhe mund të sjellë ky projektligj, eliminimin të përkufizimet, që ka të bëjë me moslejimin e keqpërdorimit, sepse ministri i lexoi, unë prapë po e parafrazoj fjalën e tij, dy amendamente. Unë besoj që këto i ka sjellë në vëmendjen e Kuvendit dhe të opinionit publik, me të drejtë, por të cilat duhet të fuqizohen, e cila e konstaton që ky ligj nuk zbatohet ndaj kategorive tash të trajtuara për këtë periudhë dhe të cilët përfitojnë pensione apo beneficione nga kategoritë e tjera pensionale.

Nëse ju kuptova drejt, zoti ministër, kështu ishte.

Dhe, pjesa tjetër, domethënë që duhet të saktësohet që ky ligj zbatohet për të gjithë punonjësit që kanë kontribuar gjatë kësaj periudhe dhe nuk janë financuar jashtë sistemit të buxhetit të Republikës së Kosovës.

Tash e sjell një shembull, i kam drejtuar edhe pyetje ministrit të Punëve të Brendshme për zyrtarët policorë. Paramendoni, kolegë deputetë, zyrtarët policorë, të cilët kanë punuar me sistemin e Serbisë, sot e përfitojnë pensionin e plotë, zyrtarët policorë të cilët nuk kanë pranuar të jenë nën masat e dhunshme dhe janë përjashtuar nga puna, sot nuk e marrin pensionin e plotë.

Andaj, ne duhet të kemi vëmendje, të mos e bëj të tepërt, pa ngarkesa politike që t'i definojmë saktë këto çështje dhe t'u japim të drejtën të gjithë atyre që u takon dhe të cilët janë meritore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Mexhide Mjaku-Topalli e ka fjalën.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Unë i uroj të gjithë punëtorët e arsimit si dhe familjet e tyre për projektligjin në fjalë, i cili sot po merr mbështetje në Kuvend.

Fillimisht mund të them se çështja e kompensimit të mësimitdhënësve është një çështje që duhet të kryhej para shumë kohësh, sepse me këtë projektligj respektohet dinjiteti i tyre personal, profesional dhe njerëzor.

Ata më kohë robërie u ngritën mbi terrin për të dritësuar e ndriçuar rrugën e lirisë, ata bënë punën në mënyrë meritore, në kushte skajshmërisht të rënda.

Lirisht mund të themi se ata kryen misionin e tyre në kohën e duhur, ndërsa në kohë paqeje vazhdojnë rrugëtimin që dituria të jetë themeli dhe bazamenti i shtetndërtimi.

Ata u treguan dhe u dëshmuar qëndrestarë në periudhën e vështirë, por vendimtarë për rininë, për popullin e Kosovës.

Puna përkushtuese, e mundimshme, sakrifikuese e mësimitdhënësve në atë kohë pengoi ikjen e të rinjve jashtë vendit.

Mësimitdhënësit, qëndrestarët e atdheut, mbajtën shkollat hapur edhe jashtë objekteve shkollore, nga të cilat i përzunë shkelësit.

Ata çdo objekt, kthinë, bodrum, e kryen në dritë, në shkollë, vetëm që të mos ndalej shkëndija e dritës së arsimit shqip, ku çdo gjë mbi atdhe ishte mbërthyer nga pesha e territ, frikës dhe tmerrit.

Mësimitdhënësit e periudhës së viteve 1990-99 punuan për kombin dhe atdhe, por sot atyre duhet t'u paguhet, më saktë, t'u shpërblehet sakrifica, nëse për asgjë tjetër, atëherë për t'ua bërë më të përballueshme jetesën atyre personalisht dhe familjeve të tyre.

Në fund, mund të them se ky projektligj është kërkesë e kamotshme e mësimitdhënësve, e dëgjuar kudo, në secilin kolektiv dhe nga ata që tash më janë në pension, edhe nga familjet që u kanë vdekur prindërit e tyre që kanë punuar nëpër shkolla gjatë këtyre viteve.

Ky projektligj është i një rëndësie të veçantë, andaj shpreh gatishmërinë time që të kontribuoj brenda dy leximeve. Faleminderit!

KRYETARI: Ismajl Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryetar!

Edhe kur flasim për çështje shumë serioze, siç është ligji në fjalë, ajo që duhet të na pengojë të gjithëve, e mua po më pengon shumë, është gara për përvetësimin e meritave për punët për të cilat ne, fundi i fundit, jemi këtu, kemi marrë përgjegjësi dhe paguhemi.

Marrim merita dhe mundohemi që për atë që s'e kemi bërë, fajin t'ia lëmë dikujt tjetër.

Unë e di mirë çka ka ndodhur në arsimin e pasluftës dhe e di që së paku kanë qenë dy ministra të LDK-së, tre të PDK-së dhe tash është njëri i Nismës. Nuk po them që ndonjëri prej tyre nuk ka pasur vullnet të bëjë një punë të tillë, po nuk mund tash ta fajësojmë njëri-tjetrin për diçka që është dashur të kryhet, për këta punëtorë, sepse kjo po ndodh për shkak se subjektet e caktuara politike gjatë fushatave po premtojnë, e që do të duhej ndalohet një veprimtari e tillë, një praktikë e tillë, dhe pastaj po kanë presion, sepse po nënshkruajnë dokumente. Edhe Qeveria aktuale në programin e ligjeve nuk e ka pasur fillimisht këtë ligj, po e ka futur pas presionit të sindikatës dhe kërcënimit me grevë. Unë mendoj se ne duhet të jemi realë dhe të themi se punëtorët e arsimit të viteve '90-ta meritojnë përkrahjen e shtetit për këto tri arsye bazë. Së pari, për shkak të kontributit të madh që i kanë dhënë arsimit shqip gjatë viteve të '90-ta. Së dyti, për shkak të kushteve tepër të rënda në të cilat kanë punuar, në kushte të okupimit të vendit dhe pengesave që i kanë pasur nga okupatori serb dhe, së treti, për shkak të mungesës së kompensimit adekuat.

Unë jam njëri nga ata që kam punuar në vitet e '90-ta, ne kemi qenë të kompensuar, por kompensimi nuk ka qenë adekuat dhe nuk ka qenë i rregullt. Por, këtë punë nuk e kemi bërë atëherë as për hatër të LDK-së ose subjekteve të tjera politike, as nuk e kemi bërë për ndonjë shkak të ndonjë përkatësie, të ndonjë organizimi parcial. Unë mendoj që mësimdhënësit në vitet e '90-ta një punë të tillë e kanë bërë për shkak të përgjegjësisë që kanë ndier ndaj shkollës shqipe dhe ndaj atdheut që të ndihmojnë lirinë e Kosovës. Është fakt që nuk janë vetëm mësimdhënësit që kanë kontribuar në atë kohë për lirinë nga Serbi, por po ashtu është fakt që kontributi i mësimdhënësve gjatë viteve të '90-ta është jashtëzakonisht i madh, për arsye se po të kishte ndodhur një ndërprerje për 9 ose 10 vjet, sigurisht që arsimit shqip sot do të ishte në një gjendje shumë më të rëndë se që është, prandaj si një kontribut të tillë mendoj që shoqëria duhet ta gjejë forcën dhe ta ndihmojë në përputhje me mundësitë që i kemi si shtet. Unë jam shumë i vetëdijshëm që mundësitë tona si shtet nuk janë të atilla që t'u dalim haku aq sa e meritojnë dhe të gjithë ata që e meritojnë.

Prandaj, jam që të merren parasysh të gjitha rrethanat dhe mësimdhënësve në radhë të parë t'u njihet si një punë jashtëzakonisht e mirë atdhetare dhe të ndihmohen për aq sa ka mundësi pa e sjellë në pikëpyetje buxhetin, ekzistimin dhe funksionimin e shtetit të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Blerta Deliu-Kodra e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Ndoshta jam prej diskutuesve të fundit dhe vështirë se nuk do të përsëritëm nga atë që e kanë thënë kolegët, por mendoj që është njëri prej projektligjeve më të rëndësishme që na ka ardhur në Kuvend kohët e fundit dhe natyrisht që edhe interesimi i deputetëve për të diskutuar ishte i madh. Besoj shumë që fakti kryesor që e shton rëndësinë e këtij projektligji është njohja e kontributit të arsimit të atyre, do të thotë kategorive që dhanë mësim gjatë viteve '90-'91 dhe '98 -'99. Ndonëse u tha edhe nga kolegët që projektligji në fjalë është i vonuar, sidomos kur kemi parasysh kontributin e mësimdhënësve të asaj kohe. Janë mbi 22 mijë mësimdhënës të të gjitha niveleve dhe mbi 3 mijë qytetarë, të cilët asokohe do të thotë kanë hapur shtëpitë e tyre, duke kontribuar që në këtë mënyrë të mbajnë gjallë arsimin shqip në atë kohë, si deputete e konsideroj shumë të rëndësishme një projektligj të tillë. U tha me të drejtë që krahas kësaj kategorie, ne si institucione nuk duhet të harrojmë edhe kontributin e kategorive të tjera, të cilat kanë kontribuar gjatë asaj kohe, siç janë një numër i konsiderueshëm i mjekëve, i gazetarëve, si dhe aktivistëve të tjerë, përfshirë edhe minatorët që u përmendën këtu me të drejtë.

Prandaj, na mbetet neve institucioneve të gjejmë metoda që të kemi parasysh edhe kontributin e këtyre kategorive, natyrisht në koordinim me ministrin, duke u munduar që t'i ruajmë linjat buxhetore të shtetit të Kosovës.

Sidoqoftë, projektligji mendoj se është vlerësim i punës e kësaj kategorie. Pra, e thashë edhe një herë që asokohe është vënë në pikëpyetje arsimi shqip dhe ishin mësimdhënësit bashkë me kategoritë e tjera që krijuan mundësinë për vazhdimin e arsimit shqip në kushte të jashtëzakonshme. Prandaj, mendoj që mbajtja e mësimit gjatë viteve të '90-ta do të thotë çoi në krijimin e një institucioni paralel me atë të pushtetit serb në atë kohë dhe, krejt në fund, konsideroj që është kontributi i të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe i atyre të diasporës, të cilët kanë mundësuar që të mbahet arsimi gjallë në atë kohë dhe assesi që ne si Kuvend ta lëshojmë nivelin dhe të ndahemi në çështje të partive politike dhe gjykimeve politike. Janë qytetarët e Republikës së Kosovës, përfshirë edhe mërgatën tonë, të cilët kanë kontribuar që arsimi shqip në vitet '90-'91 dhe '98 dhe '99 të jetë gjallë dhe ne sot duhet që ta rregullojmë këtë çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Arban Abrashi e ka fjalën!

ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Edhe unë po kyçem në këtë debat dhe diskursi i cili po ndodh sot vetëm me një shpjegim të thjeshtë se kjo është një punë edhe një përpjeke, të cilën e kanë bërë një numër i madh i atyre që

kanë punuar, duke përfshirë edhe vetë sindikatën, edhe ministrin e tanishëm, edhe ata të kaluarit që të arrijmë deri te kjo pikë, në të cilën jemi sot. Një projektligj, i cili sadopak kthen dinjitetin për të gjithë ata punëtorë të arsimit të viteve '90-ta.

Në Qeverinë e kaluar jemi angazhuar fuqishëm për të gjitha këto kategori sipas mundësive buxhetore, posaçërisht për shkak të një marrëveshjeje, të cilën e kemi pasur me FMN-në. Sidoqoftë, kemi filluar dhe kemi ndërmarrë hapa edhe të mëdhenj, edhe radikalë, le të themi. Në Ministrinë të cilën unë e kam udhëhequr, në dy vjet e gjysmë buxheti është rritur për dhjetëra milionë euro vetëm për këto kategori. Kemi filluar me pensionistët kontributdhënës, me pensionet familjare, pensionet e invalidëve, paraplegjikë, e kështu me radhë. Prandaj, kemi bërë aq sa kemi mundur në atë kohë. Një reformë e madhe që i ka kontribuar edhe kursimit të buxhetit në atë periudhë ka qenë edhe pastrimi i listave të gjithë atyre që kanë marrë pensione në mënyrë të pamërituar dhe vetëm në një vit prej se ka hyrë në fuqi Udhëzimi administrativ, ne kemi pastruar diku rreth 17 mijë persona nga lista, të cilët kanë marrë pension në mënyrë të padrejtë.

U ngrit debati pse nuk është bërë më herët, gjatë dy vjetëve kemi pasur diskutime të shumta me sindikatat, edhe të arsimit, edhe sindikatat e tjera dhe kemi bërë të pamundurën. Ajo çka u përmend edhe po e shoh që një numër i madh i deputetëve, po edhe publiku nuk janë në njohuri, ne e kemi njohur përvojën e viteve të '90-ta për punëtorët e arsimit. Prandaj, kemi qenë ne si ministri, Ministria e Arsimit, Qeveria dhe sindikatat që bashkë kemi hartuar një Udhëzim administrativ, një vendim, me të cilin i kemi gjetur të gjitha shënimet dhe kemi njohur përvojën e viteve të '90-ta për punëtorët e arsimit. Prandaj, unë përgëzoj ministrin edhe Qeverinë që kanë arritur deri në këtë pikë, ne do të japim kontributin tonë pas leximit, domethënë edhe punës tonë në komision dhe shpresoj që edhe ne si Kuvend, edhe Qeveria të gjejmë forma të tjera t'i trajtojmë edhe të gjithë ata punëtorët, jo vetëm të arsimit, por edhe të shëndetësisë, edhe ata që kanë punuar me financa dhe të gjithë ata, të cilët janë larguar nga vitet e '90-ta nga puna.

Prandaj, faleminderit, ne do të përkrahim dhe do të japim kontributin tonë gjatë punës në komisione. Faleminderit!

KRYETARI: Zenun Pajaziti dhe nuk ka deputetë të tjerë të lajmëruar për diskutim në bazë të kësaj çka po shoh.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Ministra,

Kolegë deputetë,

Meqenëse jam i fundit dhe meqenëse shumëçka u tha, po mundohem shumë shkurtë të nxjerr vetëm idenë e asaj çka mund ta kemi edhe si mesazh.

E para, duhet të jemi të gjithë të kënaqur që më në fund po trajtohet një kategori që është dashur të trajtohet edhe më herët. Nuk është se s'është trajtuar, ky Kuvend ka debatuar, ka pasur debate, ka pasur iniciativa edhe nga qeveritë, edhe nga deputetët për të trajtuar një kategori që kanë bërë një punë brilante në kohë më të vështira të vendit tonë. Ky ligj vjen tash si një diçka që nuk e dimë a është vetëm për shkak të asaj që duhet t'i kompensojmë ata materialisht, apo ta njohim statusin e tyre që thuhet në titullin e këtij ligji në mënyrë eksplicite. Mendoj që duhet t'i përfshinte të dyja, por në fakt, as njëra, as tjetra nuk plotësohen krejt. Debati ynë i sotshëm, edhe më herët që ka qenë, shkon përtej atij, ky entuziazëm shkon përtej asaj që është në materien e këtij ligji. Pra, pritjet e punëtorëve të arsimit mund të jenë më të mëdha, ose mund të jenë në përputhje me këto që po i themi ne, por në fakt, ky projektligj është më i matur. Kjo që është këtu tregon diçka pak më ndryshe, por është shumë mirë më në fund që kjo trajtohet.

Unë kërkoj, mendoj që është një moment i mirë, meqenëse u tha që kemi shumë kategori të tjera të merituar që duhet të trajtohen, që gjatë leximit deputetët e partive politike të kenë qëndrime të sakta dhe të arrijmë njëfarë konsensusi, sepse do të përballemi me sfida të tjera. Ne si Parlament kemi votuar edhe një projektligj të ngjashëm për ta kompensuar një kategori edhe më të ndjeshme ose shumë të ndjeshme, të burgosurve politikë dhe e mira e asaj pune ka qenë që gjatë implementimit të ligjit nuk kemi pasur abuzime. Nuk kam dëgjuar që ka pasur ndonjë shkelje, sikur ka qenë me listat e veteranëve, por ajo që është vështirësi, është që ky ligj ka vështirësi të implementohet, sepse s'ka buxhet. Pra, duhet të sqarohet qartë që tendencat për të realizuar këtë obligim tonin moral ndaj këtyre kategorive ka pasur probleme buxhetore, edhe partnerët tanë që kanë qenë me Qeverinë tonë, me institucionet tona: Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar kanë sugjeruar në mënyrë të përsëritur të jemi të matur në shpenzimin e mjeteve tona.

Ka ardhur ky projektligj jo për shkak të insistimit të dikujt, por po shpresojmë sepse kemi kushte pak më të mira ndoshta buxhetore. Besoj ministri i Financave e di këtë punë më mirë, por ajo që po insistoj ta them është që gjatë këtij leximi të arrijmë në njëfarë mënyre të kemi njëfarë marrëveshje, njëfarë konsensusi që edhe çështjet e tjera t'i trajtojmë, sepse çështjet e buxhetit janë çështje me interes vital të shtetit tonë.

Edhe një herë i përgëzoj të gjithë ata që kanë punuar, por më shumë ata që kanë kontribuar në këto vite të vështira dhe mendoj që po e bëjmë një punë tonën, sado të vogël, në trajtimin e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Ndërkohë, Vjosa Osmani-Sadriu e ka kërkuar fjalën.

VJOSA OSMANI-SADRIU: Vetëm disa saktësime, meqenëse këtu u diskutua nga shumë kush çfarë ka bërë. Natyrisht që për një kategori të tillë secila parti politike, secili që ka përgjegjësi politike duhet të japë kontributin e vet që më në fund t'u njihet puna që e kanë bërë, por

saktësimi duhet të bëhet rreth faktit të njohjes së përvojës së punës, e cila është bërë qysh në mandatin apo legjislaturën 2010-2014, me Ligjin për skemat pensionale.

Pra, qysh atëherë me ligj u njihet ajo përvojë e punës, pastaj është nxjerrë edhe Udhëzimi administrativ, siç u përmend më herët. Problemi gjithnjë ka konsistuar te buxheti. Ajo që dua ta them unë, shpresoj që sot nuk po miratojmë edhe një ligj, i cili në fund nuk do të ekzekutohet. Kemi pasur edhe ligje të tjera, edhe skema të tjera, e kemi pasur, për shembull, edhe Ligjin për personat paraplegjikë, tetraplegjikë, ku miratohen ligjet, po pastaj në Ligjin për buxhet, i cili miratohet në fund të vitit, nuk ndahen mjetet buxhetore që kërkohen me ligj. Pra, Ligji për skema pensionale që një kohë të gjatë, në mos gabofsha, qysh nga 2012-ta, me një amendament i cili atëherë ishte propozuar nga LDK-ja e ka njohur këtë përvojë të punës, por në fund kur ndahej buxheti për pensionistët kontributdhënës nuk përfshihej kjo në buxhet, në mënyrë që atyre të ju numërohet edhe kjo përvojë e punës. Prandaj, përkundër vështirësive të mëdha, përkundër kundërshtimeve të mëdha në aspektin buxhetor, është me rëndësi që sot të kemi një konfirmim edhe nga ministri i Financave, edhe të tjerët, që sot po e miratojmë një ligj për të cilin në fund të këtij viti, kur ta miratojmë buxhetin, por në fakt edhe tash në qershor, kur vjen rishikimi, do ta kemi edhe koston buxhetore të mbuluar. Përndryshe, po e prodhojmë edhe një copë letër, të cilën po ua shtojmë atyre 7 a 8 më herë, nëpërmjet të cilave kemi njohur këtë përvojë të punës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka deputet të lajmëruar, ministri i Financave e ka kërkuar ndërkohë fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari kryetar i Kuvendit,

I nderuari nënkryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Me vëmendje e përcolla debatin sa i përket këtij ligji. E vlerësoj lart kontributin e secilit prej jush, e vlerësoj shumë lart, deri në përlujtje, kontributin e të gjithë atyre që kanë punuar gjatë viteve të '90-ta në sektorin e arsimit dhe kanë kontribuar për mbajtjen në jetë të sektorit të arsimit në kushte shumë të vështira.

Mirëpo, përveç tjerave, duhet ta kemi parasysh edhe parimin e barabarësisë. Unë si ministër i Financave, në zyrën e ministrit të Financave janë minimumi edhe 4 kërkesa të njëjta, të ngjashme: çka me punëtorët e shëndetësisë? Çka me punëtorët e Policisë? Çka me minatorët? Çka me shërbyesit civilë? Dallimi është, nëse flasim dhe e përkthejmë gjithçka në votë, nëse dëshirojmë ta ruajmë stabilitetin e këtij vendi, nëse dëshirojmë që në një periudhë, ku unë apo kushdo të kishte qenë në vendin tim, s'po flas për një mandat, por po flas për një periudhë afatmesme, e vijmë në një situatë ku vendi nuk ka kapacitete për t'i kryer të gjitha faturat që

është duke i prodhuar, për t'i dhënë dikujt. Është një parim elementar, duhet të merren diku, për t'i marrë diku, për ta respektuar dikë, unë ju siguroj, të gjithë e dini që përmes Tatimit në Vlerën e Shtuar, përmes tatimit në të ardhura individuale, por sidomos përmes Tatimit të Vlerës së Shtuar do të paguajë edhe ai qytetari që jeton me 75 euro, edhe ai pensionisti që jeton me 75 euro.

Kush nuk ka qejf t'u ngrihet standardi qytetarëve të vet? Kush nuk ka dëshirë t'u njihet kontributi një kategorie shumë të çmueshme? Mirëpo, jam i bindur që e ndaj mendimin edhe prej jush që e para është shteti, e dyta dhe pas shtetit dhe interesit shtetëror është interesi politik, i partive politike dhe pastaj i individëve. Ju lus, deputetë të nderuar, të mos prodhojmë situata, të mos bëhemi më gjenerozë, përkundër nevojave shumë të arsyeshme dhe shumë të drejta, përkundër kontributit që nuk ka para që e paguan. Janë disa kontribute që s'paguhen me para: nuk e paguan paraja vuajtjen dhe kontributin e të burgosurve politikë, nuk i paguan paraja gjymtyrët e invalidëve të luftës, nuk e paguan paraja kontributin e arsimtarëve, mirëpo pas pesë vjetëve, pas katër vjetëve, edhe atëherë duhet të mendojmë, kur unë ndoshta s'jam as pjesë e politikës, çka do të ndodhë me shtetin? Ku vjen borxhi publik? Cila është fatura dhe presioni i çështjeve sociale? Çfarë niveli? Ne po themi që një kategorie ia kemi njohur stazhin, i kalkulohet në pagë, i kalkulohet edhe në pension. A nuk po mendojmë për ata që jetojnë me 75 euro, disa njerëz, disa nëna tona, disa baballarë tonë, që nuk kanë pasur shans, as s'kanë pasur rast asnjëherë në jetën tonë t'ua krijojmë mundësinë të punojnë. Atëherë s'kanë pasur punë, sot jetojnë me 75 euro dhe dikujt i themi që, unë e di, edhe 300 euro janë pak për pension. Këto janë mundësitë tona, ky është shteti ynë. A duam t'i rrisim tatimet? A e bëjmë TVSH-në 30%? Nuk besoj që është e mirë dhe e drejtë, prandaj duke e vlerësuar kontributin tuaj, duke besuar në korrektësinë tuaj, duke besuar në përgjegjësinë e juve si deputetë, e pata shumë të vështirë të flas. E kam pasur shumë të vështirë të flas edhe në Qeveri, e di, po ky është roli i ministrit të Financave, jo i lehtë, jo popullor, jo i këndshëm, por qëndrimi im i vetëm i drejtë është që t'u lutem për kujdes, se nuk e di, nuk jam i sigurt sa do të mund t'i qëndrojmë presionit të kategorive të tjera?

Sa është e drejtë më të rezistojmë në raste të tjera? Prandaj, duke e përmbyllur këtu, duke ju falënderuar të gjithëve për kontributin, duke ju lutur të gjithëve për kujdesin, ju lutem kujdes në ruajtjen e stabilitetit makrofiskal të vendit. Më mirë është t'ia japim dikujt 200, 300, 500 euro, për t'ua japim non stop, pa rrezik, se t'ia japim nja 2-3 muaj ditë e të vijmë në situatë që s'do të mund t'i paguajmë pagat, s'do të mund t'i japim pensionet, nuk ke më vend për të akomoduar projekte kapitale. Faleminderit dhe besoj, fort besoj që gjatë punës mes dy leximeve ligji në segmente të caktuara, në pjesë të caktuara, ka nevojë të shikohet, të rishikohet dhe të korrektohet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Jemi në proces të votimit. Zonja Haxhiu, bile, ti je kryetare e Komisionit të Legjislacionit, Rregulloren duhet ta mbrosh ti më shumë se çdokush. A shkojmë në votim, ju e keni ndërtuar mendimin tuaj, kot, vetëm mund ta zgjasim.

Shkojmë në votim, ju kisha lutur, regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. 79 deputetë janë aktualisht në sallë. Jemi te pika: Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990-'91 deri në vitin shkollor 1998-'99. Votojmë tash!

74 deputetë kanë votuar. 71 për, 1 kundër, 2 abstenime.

Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990-1991 deri në vitin shkollor 1998-1999. Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Do të shkojmë në dy, pasi kemi prani të deputetëve, po shkojmë në dy. Naser, urdhëro, ndërkohë ka sigurisht jashtë për pikat e rendit të ditës. Naser Osmani, fjala për ju!

NASER OSMANI: Po, kryetar faleminderit!

Desha nja dy-tri fjalë lidhur me rendin e ditës, që ka të bëjë me pikat e 5, 6 dhe 7, ku në emër të sponsoruesit kërkoj që për pikën e 5-të, që ka të bëjë me Ligjin për tatimin në të ardhura personale, në pikën e 6-të, që ka të bëjë me Ligjin për tatimin në të ardhura të korporatave dhe në pikën e 7-të, që ka të bëjë me Ligjin për tatimin në vlerën e shtuar, të tërhiqen nga rendi i ditës për sot dhe të shtyhen për ditë të tjera, që të koordinohemi me Ministrinë e Financave për ndryshimet, të cilat janë paraparë nga ministria, që të jenë të inkuorporuar dhe këto, të cilat ne i kemi sponsoruar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sigurisht edhe me Qeverinë keni bashkëbiseduar. Urdhëro, ministër, po e shoh reagimin tuaj! Pikat 5, 6 dhe 7 propozuesi kërkon tërheqjen e tyre nga rendi i ditës për sot.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

Duke shprehur vlerësimin dhe duke falënderuar edhe propozuesin për mirëkuptimin, ne si Ministri e Financave e kemi aprovuar koncept-dokumentin. Këto amendamente të propozuara janë më se të vlefshme, të domosdoshme, për krijimin e një ambienti më të mirë për biznesin dhe ne jemi këtu në një pikë të përbashkët, mirëpo për shkaqe procedurale që të mos i trajtojmë të njëjtat dy herë dhe me qëllim të harmonizimit, këto amendamente do të jenë të reflektuara dhe do të jenë pjesë e draft-ligjeve, të cilat do të vijnë përmes ministrisë, domethënë amendamentet e

propozuara nga Grupi Parlamentar i LDK-së dhe do të jemi të harmonizuar dhe do t'i finalizojmë bashkarish. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, edhe në bazë të Rregullores i tërheqim pikat e rendit të ditës 5, 6 dhe 7. Unë dal menjëherë te pika e 9-të. Pika e 8-të ka më shumë diskutim, po e kryejmë pikën e 9-të, është leximi i dytë, se është për kryeqytetin, sigurisht do të ketë debat, jam i sigurt. Ta kryejmë një herë pikën e 9-të, pastaj kthehemi në pikën e 8-të.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e konsumatorit

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj zëvendëskryetarin e komisionit, zotin Dardan Sejdiu, për arsyetimin e raportit me rekomandime. Nuk është këtu! Kush mund?

Shkojmë drejtpërdrejt në votim! Janë gjithsej të propozuara 38 amendamente, 73 deputetë janë në sallë. Nga 1 deri 38 janë me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Deputetë të nderuar, a ka mundësi të votojmë vetëm për amendamentet me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

70 deputetë kanë votuar, 67 për, 3 kanë abstenuar. Kalojnë të gjitha amendamentet, miratohen.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

74 deputetë kanë votuar. 74 janë për. Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-012 për kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinën

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj kryetarin e Komisionit për Administratë Publike, zotin Nait Hasani, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Është me rëndësi të ceket që pas shumë vjetësh në Kuvendin e Kosovës e kemi ligjin për kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinën, komisioni ka mbajtur mbledhje, ka bërë hulumtime, shqyrtime, analiza të këtij projektligji, ka bërë edhe vizita studimore në qendrat e

rajonit dhe ka ardhur në përfundim që ky projektligj i plotëson kushtet për miratim në Kuvendin e Kosovës.

Ne i kemi shterur të gjitha debatet në komision. Kemi edhe rekomandimet, kemi amendamentet e bëra dhe kërkojmë nga deputetët që ta miratojnë këtë projektligj, i cili do ta mundësojë që kryeqyteti ta ketë statusin e beneficuar, që është edhe me anë të Kushtetutës i përcaktuar. Prandaj, kërkoj nga deputetët ta votojnë dhe t'i votojnë amendamentet e propozuara nga komisioni dhe të miratohet në lexim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Janë gjithsej 12 amendamente. Të gjitha amendamentet kanë përkrahjen e Komisionit Funkcional, a i votojmë të gjitha bashkë, dymbëdhjetë. Amendamentet, jo a?

Po shkoj një nga një, po e shoh se ka reagime.

Amendamenti 1, me përkrahjen e Komisionit Funkcional. Vetëm pak, 74 deputetë janë në sallë. Kush është kundër?

Amendamenti 1. Vetëm kundër, në qoftë se s'ka kundër, e kalojmë, të mos futemi në procedurë elektronike. S'ka kundër, e marr të mirëqenë. Kalon amendamenti 1.

Amendamenti 2. Ndërkohë, administratë, na e jep prania e deputetëve në sallë.

Amendamenti 2. A ka dikush kundër? S'ka kundër. Të gjithë janë për.

(Reagime)

Atëherë, tërhiqet, nuk është në votim. Urdhëroni, zonja Osmani, fjala për ju.

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Meqenëse ligji është për Prishtinën, pyetja është... Megjithatë, po kryeqyteti i Kosovës në Kushtetutën e Republikës së Kosovës është i definuar të jetë Prishtina, prandaj ligji është për Prishtinën. Përkundër faktit që kam vlerësime të njëjta apo të ngjashme rreth Prizrenit, pyetja është çka kërkon një vlerësim i tillë për Prizrenin në ligjin për Prishtinën, pse ka nevojë? Si sqarim po e kërkoj, çfarë çështje ka marrë parasysh komisioni kur e ka vendosur një dispozitë të tillë në ligjin për Prishtinën?

Ndoshta mund ta fusim diku tjetër, mirëpo pyetja është kështu. Tash kualifikime të ngjashme mund të bëjmë për Vushtrinë, për Mitrovicën e... secili qytet ka një vlerësim për një fushë të

caktuar. Por, ndoshta komisioni mund ta sqarojë pse është bërë neni i tillë, që edhe Prizreni të përmendet këtu? Faleminderit!

KRYETARI: 77 deputetë janë në sallë. Do të thotë, Nait Hasani, a ka mundësi për qartësim?

NAIT HASANI: Patjetër!

Faleminderit, kryetar!

Në bazë të Kushtetutës që përcakton se kryeqyteti i Kosovës është Prishtina, ne kemi të bëjmë me një ligj për kryeqytetin, nuk kemi të bëjmë për Prishtinën. Prandaj, kemi të bëjmë për kryeqytetin dhe kryeqyteti i Republikës së Kosovës është Prishtina, ndërsa kryeqyteti historik është Prizreni. Kjo ka qenë. Po të lutem, më 1945 Prizreni ka qenë kryeqytet administrativ i Kosovës. Prizreni ka qenë edhe kryeqytet i shqiptarëve më 1878, Prizreni ka qenë kryeqytet tërë kohën, prandaj është një kryeqytet historik.

Përndryshe, shumë shtete të vendeve të rajonit dhe të botës kanë kryeqytetet historike. Një ndër to i kanë çuar edhe drejtoritë e kulturës, ose ministritë e kulturës, të cilët e prezantojnë kulturën, trashëgiminë dhe vlerën e kombit të vet në atë pjesë.

Prandaj, unë kërkoj që të miratohet ky amendament për kryeqytetin historik, Prizrenin dhe për kryeqytetin e Kosovës, Prishtinën.

KRYETARI: Shkojmë në votim. Shumë bindës ishte kryetari i komisionit.

Amendamenti 2. Kush është kundër vetëm, përndryshe shkojmë, në qoftë se s'ka kundër. Urime! Kaloj amendamenti numër 2.

A dëshironi diskutim ende për amendamentin nr. 2?

Driton Selmanaj, Arben Gashi. Po, atëherë dëgjoni, ju kisha lutur, mundësisht me dorë për amendamente, se do të shkojmë një për një, pastaj unë nuk po e di në cilin e keni interesin specifik. Asnjë amendament nuk kalon pa folur secili deputet i interesuar.

Urdhëro, Driton Selmanaj. Arben Gashi u lajmërua.

DRITON SELMANAJ: E para, unë kam një shqetësim me mënyrën si po i trajtojmë disa çështje që mund të jenë sensitive dhe po i kalojmë, hajt kështu. Prizreni meriton respektin më të madh të mundshëm. Unë jetoj në atë qytet. Ne kemi Ligjin për mbrojtjen e Qendrës Historike të Prizrenit. Ne mund të nxjerrim edhe ligje të tjera, nëse keni nevojë, por në Ligjin për kryeqytetin e Prishtinës të futet edhe qyteti historik, nesër mund të kërkohet të bëhet pjesë edhe diçka tjetër.

Kam përshtypjen se pa një analizë të mirëfilltë po ju kap njëfarë euforie kështu e popullizmit e nacionalizmit dhe dikur do të qeshim edhe me veten se çfarë ligje po aprovojmë. Kurrkush nuk është kundër që Prizrenin ta trajtojmë si super qytet historik, po nuk e ka vendin këtu. Prandaj, unë mendoj se duhet një trajtim pak më serioz, pak më ndryshe, ndoshta edhe me konsulta përtej Kuvendit të Kosovës, edhe me historianë, edhe me njerëz të tjerë, por, jo kështu, dikujt i teket dhe hajt tash shpejt e shpejt “s’ka kundër e hajt shkojmë tutje”, sepse kam përshtypjen që dikur dikush do të kërkojë llogari, e madje edhe do të përqeshemi për mënyrën se si po votojmë këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Amendamentin do ta vendos në mënyrë elektronike për votim. Arben Gashi e ka kërkuar fjalën, pastaj Arbër Rexhaj e keni fjalën për këtë amendament.

Amendamenti 2 kalon në mënyrë elektronike në votim në fund.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Nuk e di a jeni i njoftuar me rekomandimin e Komisionit për Legjislacion dhe po më vjen keq që kryetarja e komisionit nuk e lexoi rekomandimin e Komisionit për Legjislacion. Ose, le ta lexojë kryetarja e komisionit rekomandimin e Komisionit për Legjislacion, ose dikush nga nënkryetarët, ose nëse s’e lexon kurrkush, po e lexoj unë.

KRYETARI: Urdhëro, lexoje! Kryetarja e komisionit reagoi, edhe pse pa protokoll, unë po e them se ajo të autorizoi ty.

Regjia, Arbenit, në qoftë se ka mundësi, Arben Gashit, në mënyrën që ta lexojë për deputetët.

ARBEN GASHI: Unë po e lexoj rekomandimin dhe arsyetimin. Komisioni nuk përkrah raportin me amendamente në Projektligjin 06/1-012 për kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinën. Arsyetimin në raportin në Kuvend do ta paraqesë deputeti Hajdar Beqa, nënkryetar i komisionit, i cili sot nuk është këtu.

Arsyetimi: Komisioni për Legjislacion, Mandat, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit para shqyrtimit të dytë të Projektligjit në mbledhjen plenare për të vepruar në pajtim me nenin 57, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 24.04.2018 shqyrtoi projektligjin me amendamentet e propozuara. Komisioni vlerësoi se amendamenti 2 është në kundërshtim me nenin 13 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Po ashtu, ky amendament është në kundërshtim me projektligjin, sepse ky projektligj rregullon statusin dhe funksionet e kryeqytetit, pasi që gëzon status të veçantë sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Për më tepër, në asnjë dispozitë të projektligjit nuk është e përfshirë ndonjë normë që flet për kryeqytetin historik të Republikës së Kosovës, Prizrenin dhe si i tillë nuk mund të përfshihet në normë brenda dispozitave të këtij projektligji.

Po ashtu, komisioni vërejtje paraqet për amendamentet 3, 4 dhe 11. Në lidhje me përmbajtjen e këtyre amendamenteve u konstatua se nuk e kanë qartësinë e duhur dhe përmbajtja e amendamentit 3 nuk është në përputhje të plotë me nenin 128, paragrafi 4 i Kushtetutës së Kosovës, e po ashtu, bie në kundërshtim me Ligjin 04/L-067 për Policinë, pasi që me ligj përcaktohet struktura organizative, mënyra e propozimit, mënyra e zgjedhjes së drejtorëve të drejtorive, që funksionojnë sipas Ligjit për Policinë, ndërsa amendamenti 11 është i panevojshëm dhe si i tillë lë mundësinë e arbitrazhit që komunat të caktojnë, siç thuhet, ‘taksa shtesë’. Prandaj, duke u bazuar në konstatimin e komisionit, nuk përkrahen këto amendamente dhe Projektligji 06/L-012 për kryeqytetin e Republikës së Kosovës Prishtinën.

Edhe një element tjetër shtesë, i kemi parasysh dy elemente në këtë projektligj, që janë jashtëzakonisht të rrezikshme. Elementi i parë ka të bëjë me Policinë e Kosovës. Sipas Kushtetutës së Kosovës, neni 124, pika 6 thotë: “Policia e Kosovës është...”

KRYETARI: Është e ndjeshme, më mirë e flet si të veçantë,... tash si këshillë, nuk do t’i fusja të dy gjërat në një moment. Unë ta jap fjalën në momentin adekuat, kur të jesh i gatshëm për këtë çështje. Po ta kryejmë vetëm një herë amendamentin 2. Arbër Rexhaj e ka fjalën.

ARBËR REXHAJ: Faleminderit! E kemi të qartë që ne edhe mund të bëjmë ligj të veçantë për Prizrenin, por të mos harrojmë që kemi shtete të ndryshme nëpër botë, ku megjithatë njihen për qytetet e tyre administrative, njihen për qytetet e tyre kulturore dhe njihen edhe për qytetet e tyre me bazë fetare. Sigurisht në ato shtete ku ekziston një fe e vetme, ose disa.

Në fakt, unë e mirëkuptoj komisionin, ose iniciativën e disave aty që krahas Ligjit për kryeqytetin, pra Prishtinën, ta vendosin edhe Prizrenin si kryeqytet historik i shqiptarëve, sepse përnjëmend ka qenë i tillë. E kemi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe të mos flasim për vlerat kulturore, ku gërshetohen edhe elementet fetare. Sigurisht, që edhe si deputet i asaj zone, unë do të dëshiroja, pra nëse në Kushtetutën e Kosovës do të ishte e mundur që Prizreni të parashihej si kryeqytet historik, sigurisht se ne do të votonim pro kësaj. Sigurisht, se kjo do të bëhej në plotni me ligjet në fuqi dhe nëse ekziston një gjë e tillë, sigurisht se edhe si Vetëvendosje do të ishim në përkrahje të saj, sepse Prizreni shënjon jo vetëm histori, por shënjon edhe diskursin e politikës shqiptare, edhe si histori e kulturë. Prandaj, është mirë pa dashur të shesim popullizma e partikularizëm këtu, që nëse përnjëmend ne mund ta emërojmë kryeqytet administrativ Prishtinën dhe Prizrenin kryeqytet historik, unë i ftoj të gjithë deputetët që të jenë në mbështetje të kësaj, sepse neve të gjithëve na lidh edhe kombi, edhe historia me Prizrenin. Fundja, gjeneza e formimit të kombit shqiptar është te Lidhja Shqiptare e Prizrenit, ndërsa pavarësia e Shqipërisë është në Vlorë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Jemi në fazën e fundit të votimit. Bekim Haxhiu, Nait Hasani si kryetar i komisionit e përfundon, në ndërkohë edhe Muharrem Nitaj. Po frikohem se po zgjatemi. Ne do të votojmë në fund.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Faleminderit edhe për fjalën. Nuk e kisha në plan të diskutoj, por duhet ta kuptojmë një çështje. Ligjet bëhen për të rregulluar një fushë të caktuar dhe tentativa e vazhdueshme që të shkruhet historia në ligje është e gabueshme. Nëse vërtet dëshirojmë ta shpallim një vend historik që i ka premisat edhe të kiblës, edhe të Jerusalemit, atëherë kryeqyteti historik i shqiptarëve është Prekazi. Më shumë se Prekazit për të marrë epitetin e vendit historik nuk ka asnjë vend tjetër në Republikën e Kosovës, prandaj ta bëjmë ligjin në shërbim të fushës që jemi nisur e të mos tentojmë të bëjmë histori me anë të ligjeve. Faleminderit!

KRYETARI: Kjo bën pjesë në kuadër të kreativitetit. Tash do të futemi në fushën e kreativitetit. Zafir Berisha, deputet i Prizrenit, kërkoj falje.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Fillimisht dua ta përgëzoj për qëndrimin tepër korrekt, ose më shumë se korrekt ministrin për pikën e kaluar, për të cilën kryetari më kurseu dhe nuk ma dha fjalën pas ministrit. I vetmi fjalim që ia ka vlejtur, katër deputetët e Nismës kur kemi parë folklorin patriotik për vota që u bë, i kemi tërhequr fjalët, por ministër, megjithatë ke përmbushur qëndrimin tonë kështu.

Sa i përket kësaj teme, në legjislaturën e tretë unë me ndihmën dhe të nëntë kolegëve deputetë atëherë kisha kërkuar që me Kushtetutë Prizreni të jetë kryeqytet, jo veç historik, por edhe kryeqytet administrativ. Atëherë, tash bashkëpartiaiku ynë, baca Jakup, thoshte nuk është në frymën e Kushtetutës dhe ka ngecur.

Mendoj se për çështje të kësaj natyre është mirë pak të jemi të përmbajtur. Natyrisht, se përfaqësuesi ynë në komision e ka lënë që deputetët të vendosin veç e veç, por gjithsesi Prizreni, me ligj apo pa ligj, është kryeqytet shpirtëror i shqiptarëve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Muharrem Nitaj, pastaj Bilall Sherifi.

MUHARREM NITAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit të Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky është projektligj për kryeqytetin e Republikës së Kosovës. Mos bëni hajgare me kryeqytete historike, nëse Prizreni realisht është kryeqytet historik, ne nuk mund ta fusim në këtë projektligj edhe Prizrenin, sepse kjo është kundërkushtetuese.

Unë ju lus që të jeni të arsyeshëm dhe të bëni numra dhe të mos bëni popullizëm. Është kundërkushtetuese që të futet emri i qytetit të Prizrenit në projektligjin për kryeqytetin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Bilall Sherifi e ka fjalën. Bëhu gati, Nait si kryetar i komisionit dhe shkojmë në votim në fund.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Unë vetëm desha të pyes kryetaren e komisionit, zonjën Albulena Haxhiu, a ka dhënë dorëheqje nga komisioni apo çka është bërë që nuk po flet në emër të komisionit, sepse është zakon që nënkryetari apo një anëtar i komisionit të flasë në emër të komisionit, kur mungon kryetari apo kryetarja. Unë nuk po kuptoj pse ajo s'po i paraqet qëndrimet e komisionit.

Po, në komision të gjitha partitë kanë qenë unike, meqë mandati i komisionit nuk ka tjetër detyrë, pos të përcaktojë a janë amendamentet konform ligjeve dhe Kushtetutës në fuqi apo nuk janë dhe, meqë në komision është parë që ato nuk janë, disa amendamente e prishin, ndërhyjnë në ligj, në Kushtetutë, keni thënë që në komision nuk mund të japim rekomandim pozitiv, duhet të japim rekomandim negativ, pastaj le t'u mbetet deputetëve veç e veç të vendosin se a duhet ta mbështesin një amendament, për të cilin komisioni ka pasur rekomandim negativ apo jo? Komisioni nuk mund të vendosë në emër të seancës, pra atë që ka pasur për detyrë e ka bërë, e ka sjellë në Kuvend me amendamentet e miratuara dhe me amendamentet e pamiratuara në komision. Tani e ka seanca në dorë, e kanë deputetët dhe nëse vota në seancë do të reflektonte qëndrimin e anëtarëve të komisionit të partive politike në komision, atëherë ky amendament nuk do të kalojë. Nëse nuk reflekton vota e anëtarëve të komisionit edhe në seancë, atëherë mund edhe të kalojë, nuk është problem. Por, unë më duhet të konfirmoj që në komision nuk kanë marrë mbështetje, jo vetëm kjo, por disa nga amendamentet për të cilat ju i thatë, zoti kryetar, Arben Gashit që të flasë më vonë, kur të vijë amendamentet në fjalë. Faleminderit!

KRYETARI: Ilir Deda e ka kërkuar fjalën. Por, kishim shkuar drejt votimit...

ILIR DEDA: Faleminderit!

E kam vetëm një sugjerim, se e kemi një problem, kryetar!

Nëse Komisioni për Legjislacion thotë që 4 nene janë kundërkushtetuese, atëherë a duhet t'i trajtojmë një nga një apo të katërtat në të njëjtën kohë?

Ama, të katërtat kanë thënë që të mos aprovohen, sepse janë kundërkushtetuese. Tash, ne nuk mund të votojmë diçka kundërkushtetuese këtu, kolegë.

KRYETARI: Do të shkojmë në mënyrë elektronike, do të votojmë një nga një. Unë e dija, kur e kaluam pikën para kësaj, që ishte pas saj me rend dite, e dija se do të kemi diskutime. Një nga një, përgjegjësinë e merr seanca.

Nait, si kryetar i komisionit, të kisha lutur ta përmbledhësh shkurt si qëndrim të komisionit dhe shkojmë në votim drejt.

I nderuar kryetar,

Në komisionin tonë kemi votuar këto amendamente në mënyrë unanime, kështu që në mënyrë unanime, ose gjithë komisioni kanë votuar pikërisht për këto amendamente. Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Medie ka votuar për amendamentin 1, 2, 3, 4, 5 rend amendamentet.

Për amendamentin 3, nëse më lejohet të them që ky amendament është bërë bashkë me Policinë e Kosovës. Ata kanë qenë pjesë e komisionit, ata kanë qenë pjesë e amendamentimit, prandaj nuk është në kundërshtim asnjë amendament me Kushtetutën, sepse kemi një ligj, që është i përcaktuar me Kushtetutë. Këtu nuk kemi ndryshim, ose shkelje të Kushtetutës. Ata që mendojnë se po shkelet Kushtetuta, ata e kanë gabim, se nuk e kanë lexuar Kushtetutën fare.

KRYETARI: Naiti veç e pasuron Kushtetutën. Shkojmë në votim. Jemi te amendamenti i dytë.

Memli, për këtë çështje? Po, mos po riciklohemi. Nuk e vërejtja, atëherë pra Memli Krasniqi, e pastaj Ismet Beqiri e ka kërkuar ndërkohë fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

U thanë disa fjalë në lidhje me këtë amendament dhe kryesisht u diskutua a është kushtetuese apo jokushtetuese, a është popullist apo s'është popullist? Për fat të keq, ne u mbytëm këtu duke votuar veç popullizëm. Ne veç sa e votuam një ligj për shkak të popullizmit. 71 vota a sa i mori ligji që veç sa e kaluam dhe krejt diskutimet 80 % qenkan folklor dhe popullizëm. Edhe ajo mbështetje gati unanime është reflektim i popullizmit. Tash, nuk është keqe për shkak të popullizmit nëse e votojmë edhe këtë amendament.

E dyta, ne sot e votuam një amendament, që edhe unë po besoj se është kundërkushtetues, në Ligjin për shoqëri tregtare. E patëm letrën qysh e parashih Kushtetuta, e ka kthyer presidenti, që amendamenti është kundërkushtetues dhe deputetët që tash po shqetësohen për Kushtetutën e kanë votuar atë amendament. Këtu standardi i dyfishtë është bërë normë në këtë Kuvend. Popullizëm pika 7, jo popullizëm pika 8. Kushtetues pika e kaluar, tash kjo pikë nuk është kushtetuese.

Komisioni për Legjislacion, unë po mendoj që me të vërtetë ka dhënë rekomandime që duhet t'i trajtojmë seriozisht, po nuk e ka kompetencën të vlerësojë a është kushtetues apo jo. As Kushtetuta s'ia jep atë kompetencë, as Rregullorja e Kuvendit. Mendoj që edhe nëse votohet ky ligj, kush ka shqetësime për kushtetutshmërinë e tij duhet ta çojë në Gjykatë Kushtetuese dhe Gjykata Kushtetuese mund pastaj të na tregojë me të vërtetë nëse Prishtina është bërë me një autonomi funksionale që ndërlidhet me kompetencat për Policinë, për rendin për sigurinë, për shëndetësinë, për arsimin, që janë kompetenca të zgjeruara, granti shtesë prej së paku 6% e të tjerë.

Por, edhe nëse kemi vendos ta bëjmë Prishtinën një rajon autonom brenda sistemit të Kosovës, ndoshta nuk është keq, nuk duhet ta shohim domosdoshmërisht me sy negativ.

Në anën tjetër për sa i përket kryeqytetit historik, as unë nuk jam i sigurt që e ka vendin këtu, e nëse e përfshinë si kryeqytet historik, nëse pajtohem i ne që është kryeqytet historik, mund ta votojmë. Nëse nuk pajtohem që Prizreni e meriton këtë epitet, atëherë nesër le ta ndërrojë dikush, ose të mos e votojë sot. Nuk jam i sigurt që e ka vendin, po e ripërsëris, mendoj që Prizrenin kemi mundur ta trajtojmë edhe me ligj të veçantë, jo me Ligjin për Zonën Historike. Por, amendamenti është, një komision e ka mbështetur, dy komisionet tjera funksionale nuk e kanë refuzuar, nuk e kanë kundërshtuar, Komisioni për Legjislacion e ka kundërshtuar, prandaj është në dorën e deputetëve të vendosin. Mund ta hidhni në votim, i merr votat kalon; s'i merr votat nuk kalon. Po edhe nëse nuk kalon, kush ka shqetësime kushtetuese mendoj që është e drejtë, për ta hequr mjegullën ose shqetësimin e kujtdo çoftë, e çon në Gjykatë Kushtetuese dhe pastaj e kemi qartësimin e plotës. Nëse na e kthen Gjykata Kushtetuese, mbledhemi prapë, i heqim ato amendamente ato kompetenca ose çka do tjetër që mund të vlerësohet si e tillë, por pa e paragjykuar unë besoj që duhet shkuar në votim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Unë, me të vërtetë, tash po e them personalisht, nuk e kam besuar që kur nxirret Projektligji për kryeqytetin, në këtë rast është shumë e qartë cili është kryeqyteti i Kosovës sipas Kushtetutës, e futet edhe një amendament që, për mendimin tim, absolutisht nuk e ka vendin në këtë projektligj.

Nëse projektligji flet për Prishtinën, për kryeqytetin e Kosovës, nuk kontestohet në asnjë rrethanë nga askush prej nesh edhe vlerësimi që Prizreni është kryeqytet historik, ama ky projektligj me futjen e atij amendamenti bash nuk ka lidhje dhe pikërisht këtu nëse dikush po do që në këtë mënyrë, është shumë e qartë që nuk bëhet kështu duke tentuar që na po e duam më shumë Prizrenin sesa dikush tjetër. Kjo nuk qëndron.

Mos harroni, në Ligjin për përcaktimin e kufijve territorialë dhe administrativë, që e kemi, përcaktohet shumë saktë cili është territori administrativ, cilët janë kufijtë komunalë të secilës komunë, përcaktohen edhe të Prishtinës, edhe të Prizrenit.

Po si është e mundur që tash të futet një amendament në këtë projektligj, i cili kryesisht dhe kryekëput flet për kryeqytetin e Kosovës, për Prishtinën.

Prandaj, cilëndo projektligj ose formë që ju deputetë, kolegë, insistoni të futet këtu, mendoni diku tjetër dhe ta vlerësojmë ashtu qysh e vlerësojmë të gjithë si kryeqytet historik, askush prej nesh nuk ka kundër. Por, të thuhet se e ka vendin këtu, dhe e votoni apo se votoni, unë nuk po adresoj në emër të askujt, por “e votoni apo nuk po e votoni se është apo nuk është kryeqytet historik”, kjo është absurde. Nuk po votojmë për kryeqytet historik, por nuk e ka vendin ky amendament në këtë projektligj.

Pra, kolegë, mos se seanca vendos, e veç të themi po e dërgojmë në gjykatë, e Gjykata Kushtetuese le të vendosë, por është absurde ne të vendosim diçka që është joligjore kur thotë edhe Komisioni për Legjislacion. Atëherë nuk e di pse ekziston Komisioni për Legjislacion, apo komisionet adekuate. Nuk ka nevojë të ekzistojnë nëse ata e kanë vlerësuar keq, e ne tash, këtu sipas lagjeve, dikush ma përmendin se di pse ma përmendi Vranjevcin, ne këtu nuk po vendosim me mëhallë. Mos flitni këso farë banalitetesh, ne po flasim për kryeqytetin e Kosovës që është me Kushtetutë dhe unë jam për atë që ky amendament të mos përfshihet në këtë projektligj. Nuk e ka vendin, kuptojeni drejtë. Nuk është a është Prizreni historik apo nuk është. Askush nuk e konteston, por ky amendament nuk ka lidhje me këtë projektligj.

Ky projektligj e rregullon statusin juridik të Prishtinës. Çka ka lidhje në statusin juridik të Prishtinës futja e amendamentit për Prizrenin? Mos se për mendimin tim, në këtë mënyrë e devalvoni Prizrenin. Është devalvim që në statusin juridik të Prishtinës të futet një amendament për Prizrenin. Çka rregulloni me këtë? Është gabim juridikisht.

Çdo jurist le ta analizojë, është absolutisht joligjore. Është gabim.

KRYETARI: Në ndërkohë ka kreativitet Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Nuk do të duhet paraparë ndoshta të diskutojmë kaq shumë për një amendament dhe në rast të procedimit të ligjeve ose projektligjeve në leximin e dytë zakonisht e kërkojnë fjalën ata që janë kundër një amendamenti. Nëse e mbaj mend, kështu ka qenë zakonisht.

Por, shqetësimet që po ngrihen rreth këtij amendamenti mua po më duken pa vend nga pak. Të gjithë ata që kanë shqetësime, kanë edhe rrugë tjera, nuk e prish strukturën e ligjit as natyrën e

ligjit ky amendament, prandaj po mendoj që jemi duke folur pak si gjatë, jemi duke folur pak si më shumë. Jemi të shqetësuar po më duket më shumë sesa kur ka qenë Qendra Historike e Prizrenit, që ndoshta në atë ligj është dashur të diskutojmë kaq gjatë e me kaq përkushtim.

Kështu që po ju propozoj që le të mbyllet debati këtu dhe nëse ka dikush të përcaktohet për këtë ligj, le të përcaktohet me votë, unë votën time e deklaroj për këtë amendament dhe mendoj që Qendra Historike, ose historia e Prizrenit nuk do të duhej ta pengonte askënd, këdo që e pengon ka rrugë të tjera pasi të aprovet ligji. Kjo nuk është e fundit. Prandaj kërkoj që të hidhet në votim dhe të mos ndalemi më tepër në këtë amendament, sepse Prizreni meriton të quhet edhe me ligj qoftë me këtë ligj, qoftë me ligj tjetër, si historia e shqiptarëve dhe si kryeqytet historik i shqiptarëve.

KRYETARI: Edhe nënkryetari Kujtim Shala e ka kërkuar fjalën dhe jemi në votim. Në qoftë e nuk lajmërohet tjetër kush, se unë po them çdo herë jemi në votim, për ta nxitur votimin.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë mendoj që ky diskutim është i dobishëm, por ky projektligj ka pika tjera, mënyra tjera që janë shumë më të ndjeshme sesa kjo.

Unë vërtet dua t'i jap të drejtë kolegut Hasani, sepse praktika të tilla ka, ta kini parasysh, dhe meqë ka edhe kur ekzistojnë evidenca duhet t'i themi, sepse ato ndihmojnë.

Tash ne e kemi përpara Projektligjin për kryeqytetin e Republikës së Kosovës, që lidhet me të gjitha problemet për të cilat po flasim kolegët, por në radhë të parë është çështja e administrimit, jo vetëm e territorit, por edhe e disa shkallëve tjera, përfshirë edhe një tip administrimi politik.

Ndërkaq amendamenti për kryeqytetin historik është një përcaktim onorifik, që s'i jep fuqi ligjore, s'i jep fuqi ekzekutive, s'përcakton çështje që kanë të bëjnë me administrimin e territorit, e tjera.

Unë do të dëshiroja që të sqarohem më tej, sepse ky nuk më duket problemi, mendoj që duhet të sqarohet, sepse as ai nuk është problem, por duhet të sqarohet, ta dimë pastaj se çfarë do të rregullojmë plus, me çfarë do të shoqërohet ky përcaktim për Prizrenin si kryeqytet historik, sepse me një dokument të kësaj natyre, ne vërtet e kthejmë në një normë dhe në një tip neonorifik ose nderues një praktikë - histori të shqiptarëve dhe të tjerëve në Prizren dhe histori kulturore, të trashëgimisë e të tjera.

A duhet Nait që të shoqërohet me dokumente tjera përcjellëse, akte nënligjore ose nëse duhet edhe një ligj i ri? Por, për kështu si është, unë besoj që kjo s'e cenon pjesën tjetër dhe pjesa tjetër nuk obligon dhe s'mund të aplikohet te Prizreni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të lajmëruar, shkojmë në votim. Nait Hasani e ka dhënë propozimin në emër të Komisionit Parlamentar, qëndrimet e kolegëve deputetë ishin të qarta, shkojmë në votim.

Amendamenti 2, përgatitemi për votim, votojmë tash në mënyrë elektronike!

64 deputetë kanë votuar, 47 për, 7 kundër dhe 10 abstenime. Kalon amendamenti 2.

Amendamenti 3

Regjia, a ka mundësi zonjës Kusari-Lila fjalën?

MIMOZA KUSARI-LILA: Po kryetar, ju kisha lutur ta verifikoni çka kemi votuar, se në ekran ka qenë amendamenti 1 deri 9, nuk ka qenë amendamenti 2. Domethënë siç e ka prezantuar regjia, shkruan në ekran, shkruante, ose le të përsëritet mund ta shihni, amendamentet 1 deri 9. Nuk ka shkruar amendamenti 2.

KRYETARI: Megjithatë vlen vetëm ajo çfarë flas unë. Unë do ta vërtetoj tash, protokollohet kjo çfarë e them unë, dhe për atë arsye isha i qartë disa herë - amendamenti 2, pavarësisht çfarëdo që ka shkruar. Ne ishim duke folur vetëm për amendamentin 2 dhe votimi ishte vetëm për të.

Unë do të shkoj kujdesshëm në secilin amendament.

Amendamenti 3

81 deputetë janë në sallë. Votojmë po ashtu në mënyrë elektronike, Ilir Deda e ka fjalën për amendamentin 3.

ILIR DEDA: Faleminderit!

Koleg të nderuar,

Amendamenti 3 ka të bëjë me sigurinë publike, me një lloj policie të kryeqytetit, e cila nuk e ka asnjë lloj baze ligjore dhe është jashtëzakonisht i paqartë.

Është e paqartë çka është Drejtoria e Policisë së Kryeqytetit? Pse nëse është e barabartë me kompetenca si drejtoritë e tjera, duhen të jenë dy kandidatë të propozuar? Domethënë, a është kjo drejtori si drejtoritë e rregullta, apo ka të bëjë me një strukturë të sigurisë e cila nuk është e bazuar në ligj, apo duam që nëpërmjet këtij amendamenti ne ta ndërrojmë Ligjin për Policinë? Pastaj nuk specifikohet a ka polici lokale, apo jo.

Ndërsa neni 1.1.5 thotë që “Policia e Kosovës në pajtim me Ligjin për Policinë mbështet policinë lokale të kryeqytetit në rastet emergjente”. Më falni, por me ligj nuk ekziston policia lokale e kryeqytetit. A po themelohet kësso mënyre? Në qoftë se po themelohet, pse nuk e kemi këtu të

proceduar edhe Ligjin për Policinë. Njëjtë në dy nenet e para të sigurisë publike flitet për këtë farë lloj drejtorie, ndërsa pastaj kemi prapë pjesë kundërkushtetuese dhe kundërligjore, për shembull “organizimi, detyrat dhe përgjegjësitë e policisë të kryeqytetit më hollësisht rregullohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Pushtetit Lokal, imagjinoni, dhe Ministria e Punëve të Brendshme”.

Nuk mund ta kuptoj qysh mund të vendoset Policia e kryeqytetit me udhëzim administrativ!

Dhe çfarë precedenti ne po krijojmë për komunat tjera në qoftë se Prishtina e merr policinë e vet në këso lloj mënyre? Atëherë edhe komunat e tjera kanë të drejtë të kërkojnë polici lokale njësoj. Dhe mua po më vjen shumë keq që ne masë 10 vjetëve jemi duke e përmbushur më në fund obligimin kushtetues për Ligjin për kryeqytetin. Ne për 10 vjet nuk e kemi përmbushur këtë pjesë të Kushtetutës së Kosovës, e tash në fund të na vijë një ligj kaq diskutabil, është për keqardhje të madhe.

Unë ju kisha lutur, kolegë deputetë, ne kemi biseduar shumë, që ta diskutojmë ta shtjerrim debatin për sigurinë publike në kryeqytet, sepse është e paqartë, edhe një herë po them, është kundërkushtetuese, mund të jetë precedent i rrezikshëm dhe nuk ka bazë juridike.

Nuk mund që shkel e shko, një pasdite të enjte, të bëjmë shpejt një thyerje ligjore në qoftë se e aprovojmë këtë nen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ndërkohë është lajmëruar Arben Gashi, pastaj do të shkoj në bazë të partive politike siç janë lajmëruar.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Për hir të korrektësisë, unë po e lexoj nenin 128 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Pika një, Policia e Republikës së Kosovës mban përgjegjësinë për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Pika dy, Policia e Kosovës është profesioniste dhe pasqyron shumëllojshmërinë etnike të popullit të Republikës së Kosovës.

Pika tre, kryeministri e emëron drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Republikës së Kosovës me rekomandimin e Qeverisë, në pajtim me ligjin. Organizimi i brendshëm i Policisë rregullohet me ligj.

Pika katër, më e rëndësishmja, Policia e Kosovës ka zinxhir të unifikuar komandues në tërë territorin e Republikës së Kosovës, me stacione policore, të cilat korrespondojnë me kufijtë

komunalë. Policia e Kosovës e lehtëson bashkëpunimin me autoritetet komunale dhe udhëheqësit e bashkësive nëpërmjet themelimit të këshillave lokalë, sikur është miratuar me ligj. Përbërja etnike e Policisë brenda një komune duhet ta pasqyrojë deri në shkallën më të lartë të mundshme përbërjen etnike të popullsisë brenda territorit të komunës.

Pika e pestë, Policia e Republikës së Kosovës mban përgjegjësi për kontrollin e kufirit në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me autoritetet vendore dhe ndërkombëtare.

Tani po e lexoj amendamentin 3, neni 7, paragrafi 1, ndryshon si në vijim:

“Kryeqyteti, përveç kompetencave të përcaktuara në Ligjin për vetëqeverisjen lokale, ushtron edhe këto kompetenca:

1.1.1 Kryetari i kryeqytetit, pas aprovimit nga Kuvendi i kryeqytetit, e themelon Drejtorinë e Policisë së kryeqytetit në kuadër të strukturave organizative të kryeqytetit me detyrat dhe përgjegjësitë vetëm për kryeqytetin.

1.1.2 Kuvendi i kryeqytetit i propozon kryetarit të kryeqytetit dy kandidatë për drejtor të Drejtorisë së Policisë së Kryeqytetit, i cili e emëron njërin nga ata për drejtor të Drejtorisë së Policisë së Kryeqytetit.

1.1.3 Kuvendi i kryeqytetit ushtron mbikëqyrjen e politikave të Policisë së Kryeqytetit, të cilat bien në kompetencë të kryeqytetit.

1.1.4 Kuvendi i kryeqytetit ka të drejtë të kërkojë nga drejtori i drejtorisë i Policisë së Kryeqytetit të raportojë lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e policisë lokale të kryeqytetit.

1.1.5 Me kërkesën e kryetarit të kryeqytetit, Policia e Kosovës, në pajtim me Ligjin për Policinë, mbështet policinë lokale të kryeqytetit në raste emergjente.

1.1.6 Organizimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Policisë së Kryeqytetit më hollësisht rregullohen me akt nënligjor, të nxjerrë nga Ministria e Pushtetit Lokal dhe Ministria e Punëve të Brendshme.

1.1.7 Këshilli i kryeqytetit për siguri është organ këshillues i kryesuar nga kryetari i kryeqytetit dhe anëtarë janë përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve brenda kryeqytetit”.

E patë amendamentin, po e përsëris edhe një herë, neni 128, pika 4, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “Policia e Republikës së Kosovës ka zinxhir të unifikuar komandues në tërë

territorin e Republikës së Kosovës me stacionet policore të cilat korrespondojnë me kufijtë komunalë”. Pikë!

Unë mendoj se këtu nuk ka nevojë as për argumentim, as për diskutim, edhe në ligj, edhe në amendament në frymë dhe në germë është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës. Prandaj, mendoj se nuk guxojmë ta bëjmë këtë gabim, sepse do të ketë kosto jashtëzakonisht të madhe në pjesë tjera në territorin e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

E kisha ndërmend të thosha diçka nga këto që u thanë nga parafolësit për t’u identifikua qartësimi i çështjeve të sigurisë së policisë me Kushtetutë dhe me ligj.

Ideja për ta pajisur kryeqytetin, të bëhet diçka më shumë që ka të bëjë me siguri nuk është e keqe, por aspak e nevojshme tash.

Mendoj që do të duhej t’i kishte paraprirë një lloj vlerësimi se pse na qenka e nevojshme që kryeqyteti ta ketë një formacion të tillë? Asnjëherë në çdo debat që është bërë nuk ka dalë si diçka që është sfiduese, se po i mungon ky segment kryeqytetit, se mund të avanconte, qoftë te ndërtimet, qoftë te siguria, qoftë te ndonjë lagje specifike.

Mendoj që Policia e Kosovës e ka me ligj të rregulluar rolin e kryetarit të komunës në zgjedhjen e komandantit të Policisë. Kryeqyteti e ka një shtrirje të mirë me ligjin aktual dhe në praktikë dhe mendoj që vetëm e komplikojmë, jo vetëm sa i përket këtij procesi të pajisjes të kryeqytetit, ose të bashkëngjijtes së Ligjit të kryeqytetit, ose kryeqytetit me një informacion të tillë, por mund të nxjerrim komplikime edhe në procese tjera me komunat e reja, me proceset tjera politike.

Prandaj, mendoj që komisioni është dashur ta mendojë mirë këtë propozim dhe mendoj që votimi duhet të jetë shumë i kujdesshëm në këtë rast. Faleminderit!

KRYETARI: Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Për gjithë ju që e dini pak a shumë edhe punën e Policisë në Kosovë, edhe punën që ka Policia e Kosovës në kryeqytet, e dini që tash nëse kërkohet asistencë e Policisë për çfarëdo situatë dhe mbështetje që do të ketë kryeqyteti, atëherë saktësisht, ose marrim si shembull po t’i drejtohem stacionit numër 4, shumica e policëve në stacionin numër 4 janë të angazhuar, dikush duke e ruajtur një të arrestuar në spital, dikush duke e ekzaminuar një ngjarje të një vendi të vjedhur dhe ndonjë polic tjetër duke e ruajtur një restorant ku mund të jetë një pushtetar.

Dhe, të gjithë ju besoj që po ta mendoni kaq drejtpërdrejt dhe kaq qartë, e duhet ta dini që kryeqyteti ka nevojë për mbështetje policore, të cilën asnjëherë nuk ka mundur ta gjejë brenda stacioneve të Policisë dhe në kuadër të Policisë dhe strukturës organizative të Policisë së Kosovës.

Dhe, po ashtu, siç edhe është diskutuar për pikën paraprake për amendamentin paraprak, unë mendoj që jemi në lexim të dytë dhe përcaktimin tonë duhet ta shprehim me votim, për ose kundër.

Prandaj, unë mendoj që në këtë rast vota për nuk e prish për asnjë gjë strukturën e ligjit, përkundrazi do të jetë vota për këtë amendament do të jetë në shërbim të këtij ligji dhe të sigurisë në kryeqytet.

Kryeqyteti ka specifika të veçanta kundrejt qyteteve tjera, prandaj kjo nuk e dëmton.

Por, prapë dua ta kujtoj aktivitetin dhe shqetësimet tona të deputetëve në legjislacionet e kaluara, kur ne do të duhej të ishim shumë, e theksoj shumë më të shqetësuar, kur në strukturën e Policisë është krijuar një regjion i veçantë që de facto është krejt gati pothuajse jashtë kontrollit të strukturës komanduese të Policisë dhe ne do të duhej të ishim të shqetësuar sesi funksionon kjo hierarki karshi këtij regjioni siç është regjioni i veriut, e jo të ishim kaq të shqetësuar sesa do të funksionojë hierarkia në Policinë e Kryeqytetit.

Prandaj, mendoni pak për nevojat e kryeqytetit, për nevojat e qytetarëve të kryeqytetit dhe për specifikat që ka një kryeqytet, sepse një kryeqytet nuk është kryeqytet vetëm nëse quhet i tillë, por duhet t'i ketë të gjithë mekanizmat tjerë përcjellës, e në këtë rast edhe Policia, e cila është e dedikuar për nevojat e pushtetit lokal në kryeqytet do të jetë e mirëseardhur.

Prandaj, mendoj që nuk prish asnjë gjë punë, përkundrazi është pozitive nëse e mbështesim këtë amendament.

KRYETARI: Faleminderit! Dardan Sejdiu e ka fjalën.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, i nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Në fakt, unë po dua të adresoj këtë diskutimin për amendamentin në fjalë, që ka të bëjë me sigurinë publike.

E kam të qartë brengën e deputetëve në lidhje me idenë që duke e bërë një gjë të tillë mos po e hapim një derë, ose një deriçkë për diçka tjetër. Por Ligji për Prishtinën është kategori kushtetuese tashmë. Tash është kategori kushtetuese. Është në kushtetutë. Deriçkat nuk hapen

duke e plotësuar Kushtetutën, deriçkat hapen nëse fillojmë të diskutojmë për Kushtetutën ekzistuese.

Pra, ky ligj është në përputhje dhe është kërkesë e Kushtetutës sonë.

Tjetra? Zinxhiri komandues nuk cenohet fare. Besoj mund ta konfirmojnë edhe ata që merren me temën e sigurisë nga Ministria e Punëve të Brendshme e deri te Drejtoria e Policisë. Pra, nuk sfidohet zinxhiri komandues fare. Zinxhiri komandues mbetet i njëjtë, pot themelohet Drejtoria për Policinë e Kryeqytetit, e cila është një domosdoshmëri.

Sa për informacion, po e konkretizoj diskutimin, meqë mendoj që është tepër e rëndësishme. Nëse argumenti për sfidë sa u përket organizimeve të ndryshme që mund të jenë për komunitat tjera, kjo nuk qëndron, sepse në Kushtetutë e kemi Ligjin për kryeqytetin. Praktikisht, sot në kryeqytet, nëse duam ta ndalim një aktivitet, i cili të themi ka të bëjë me një ndërtim pa leje dhe ai ndërtues është si të them agresiv karshi inspektoratit, ndihma e Policisë duhet të organizohet, e shpesh di të marrë edhe dy ditë. Shumë prej jush e dini që për dy ditë lirisht mund t'i ngrehim dy kate.

Pra, kemi nevojë që, përveç rendit publik, rendit sa i përket organizimit të trafikut, e tjera, e tjera, t'i kemi në situatë të kontrollit dhe të punës së përditshme, e cila mund të bëhet në kryeqytet dhe kjo nuk sfidohet me këtë amendament. Përkundrazi, veçse e bën punën më efektive. Dhe, zinxhiri komandues nuk sfidohet, përndryshe secilit ligj mund t'i bëhet edhe udhëzimi administrativ dhe secili ligj mund të ketë edhe udhëzime administrative, të cilat edhe më mirë e shoshitin këtë brengë, nëse ekziston te deputetët. Kështu që unë, me aq sa mund, do të insistoja që të ecim me votë, i kemi mendimet e komisionit. Ata që mendojnë që komisioni e ka të drejtë ose gabim, votojnë për ose kundër dhe vazhdojmë tutje. Nuk mendoj që kemi këtu ndonjë orvatje për të ndryshuar diçka sa i përket qoftë Ligjit për Policinë, qoftë zinxhirit komandues. Përkundrazi, thjesht kemi të bëjmë me organizim më të mirë në kuadër të një ligji, i cili buron prej kërkesave kushtetuese.

KRYETARI: S'të ka përmendur emrin, Ilir! Blerim Kuçi, bëhet gati Milaim Zeka.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryetar!

Edhe pse parafolësit, e sidomos zoti Gashi i tha ato elementet kryesore që pata për t'i thënë, unë po them edhe një herë që varianti i sjellë nga Qeveria është shumë më mirë i analizuar sesa tash pjesë e draftimit nëpërmjet amendamenteve. Po frikësohemi që çdo ndryshim në sektorin e sigurisë do ta sjellë efektin "domino". Për këtë, për variantin e sjellë nga Qeveria nuk duhet frikësuar, sepse i sjell kompetenca të mjaftueshme edhe Komunës, edhe nuk ka ndërhyrje në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Pra, drafti i sjellë nga Qeveria unë mendoj që duhet të votohet pa hezitim, kurse amendamenti jo, sepse e ka efektin “domino” tash dhe në të ardhmen. Faleminderit!

KRYETARI: Milaim Zeka, urdhëro!

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Më fal se u konsultova pak me kryetarin tim, Nait Hasani, se e kemi kryetar të Komisionit dhe e pyeta nëse është për apo kundër amendamentit. E, unë personalisht jam për dhe palca kurrizore e Ligjit për kryeqytetin e Kosovës dhe për Prishtinën është pikërisht ky amendament. Nuk ka kryeqytet në botë që s’ka polici bashkiake, po flas për në Evropë, se në krejt botën s’kam qenë. S’kam qenë në Afrikë. Por, edhe këtu në Ballkan e ka Maqedonia, e ka Mali i Zi, e ka Shqipëria dhe ne si komision, duke iu falënderuar krejt anëtarëve të Komisionit për Administratë Publike, e veçanërisht edhe kryetarit, kemi organizuar disa vizita pune, ku kemi marrë sugjerime dhe ndoshta guxoj që edhe në emrin e Nismës ta mbështes. Nuk e di kolegët e mi, te vota e dëshmojnë, por unë në emrin tim personal e mbështes këtë në mënyrë absolute dhe ju bëj thirrje që ta votoni këtë amendament.

KRYETARI: Faleminderit! Vjosa Osmani-Sadriu e ka fjalën!

VJOSA OSMANI-SADRIU: Faleminderit!

Në radhë të parë, unë e kuptoj shumë mirë që Komuna e Prishtinës për vite me radhë mund të ketë pasur probleme në realizimin e detyrave të veta në fushën e sigurisë publike, qoftë për shkak të mungesës së përgjigjes nga Policia, qoftë për shkak të mungesës së kapaciteteve njerëzore që të merren në baza ditore me çështje që kanë të bëjnë me sigurinë publike në kryeqytet.

Megjithatë, në mënyrën siç është paraqitur në amendament, ashtu siç e thanë edhe shumë kolegë, për ne që jemi në institucione një kohë të gjatë na kthen në situata të ngjashme kur është tentuar që të krijohen polici vetëm për territore të caktuara, e rrjedhimisht edhe të dalin në kundërshtim me sistemin unitar të Republikës së Kosovës, qoftë në fushën e gjyqësisë, qoftë në atë të sigurisë dhe në veçanti të Policisë. Besoj shumëkujt i kujtohet edhe Gjashtëpikëshi i Ban Ki-Munit, që në pikën e parë të vetë e ka pasur Policinë, duke synuar që të bëhet diçka e ngjashme për veriun e Kosovës, së paku kështu arsyetohej. Ka pasur edhe raste të shumta të tilla, prandaj në qoftë se sipas amendamentit ne e japim një kompetencë të tillë për kryeqytetin, atëherë natyrisht që mund të ketë kërkesa dhe do të jetë e vështirë që të mbyllet pastaj vetëm me këtë ligj cikli, apo të mbyllet mundësitë e tjera që edhe komunat tjera të kërkojnë që të formohet polici vetëm për ato qytete.

Prandaj, në qoftë se e lëmë nenin 7 ashtu siç është në ligj, e jo në amendament, ekziston mundësia që kjo çështje të rregullohet më mirë, duke qenë në përputhje me Kushtetutën. Më herët u tha që Policia ka qenë në rregull, mirëpo vlerësimin rreth kushtetutshmërisë së një ligji

apo një neni nuk mund ta bëjë Policia, përkundrazi Komisioni për Legjislacion e ka këtë mandat me Rregullore të Kuvendit, që ta shqyrtojë edhe bazën juridike, edhe kushtetuese të një ligji apo neni të caktuar, dhe ne duhet ta marrim seriozisht një vlerësim të tillë.

Prandaj, mendoj që assesi nuk mund ta votojmë amendamentin në këtë format, por mund të mbetet në fuqi pastaj neni 7 ashtu siç është propozuar nga Qeveria, në mënyrë që mos të krijohet një precedent i keq edhe për pjesët të tjera të Kosovës dhe të keqpërdoret në të ardhmen. Faleminderit!

KRYETARI: A të përmendi? Po shkojmë, i kemi edhe pesë deputetë, pastaj nga fundi edhe një herë e shohim. Zenun Pajaziti e ka fjalën. E ka tërhequr! Fisnik Ismajli, urdhëro!

FISNIK ISMAJLI: Po tërhiqem, kryetar!

KRYETARI: Edhe Fisniku u tërhoq. Bilall Sherifi, u tërhoq?

BILALL SHERIFI: Jo, jo kryetar!

KRYETAR: Më fal, Bilall, këtu jemi ende!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Jo, jo nuk po tërhiqem.

Shiko, unë do të përpiqem që këtë debat, të cilin vetëm ne këtu në sallë po e marrim vesh ta kuptojnë edhe shikuesit se për çka jemi duke biseduar.

Qytetarët, në përgjithësi, të cilët janë duke e përcjellë këtë debat, jemi duke debatuar për një çështje, të cilën edhe sponsorizuesi, pra Qeveria e Republikës së Kosovës e ka paraparë, por e ka paraparë pak më ndryshe. Të mos krijohet përshtypja që vetëm amendamenti tre, i propozuar nga deputetët, po e trajton këtë temë. Pra, amendamenti, neni nga Qeveria thotë kështu: “Policia e themelon Drejtorinë e Policisë, pra Policia për kryeqytetin, organizimi dhe funksionimi i së cilës rregullohet me Ligjin për Policinë, e cila do të ketë kompetencë vetëm në territorin e kryeqytetit”. Amendamenti thotë pak më ndryshe, por në esencë është pak a shumë e njëjta, që vjen nga komisioni. Nëse më lejon, unë dua ta çojë deri në fund idenë time. Kryetari i kryeqytetit, pas aprovimit nga Kuvendi i kryeqytetit, e themelon Drejtorinë e Policisë së Kryeqytetit në kuadër të strukturës organizative të kryeqytetit me detyra dhe përgjegjësi vetëm për kryeqytetin. Pra, përderisa nga sponsorizuesi nuk shkëputet zinxhiri komandues dhe zinxhiri, i cili e rregullon punën e Policisë, këtu e kemi një shkëputje sa i përket asaj kush e themelon. Pra, këtu është problemi, nuk e kemi problemin, së paku unë nuk e kam problemin me ekzistimin e Policisë të Kryeqytetit, por mënyra sesi do të krijohet ajo. Dhe, unë mendoj që materia që e trajton amendamenti 3, është kryesisht, për mendimin tim, temë që do të duhej të rregullohej me

ndonjë udhëzim administrativ se kush do të ketë rol në Polici dhe çfarë roli do të ketë rol do të ushtrorë në Policinë e Kryeqytetit, të cilën do ta themelojë Policia e Republikës së Kosovës, si një degë të saj, si një pjesë të saj.

Prandaj, mendoj që Ligji për Prishtinën nuk varfërohet sa i përket kësaj çështjeje nëse mbetet neni i propozuar nga sponsorizuesi, pra nga Qeveria. Prandaj, ne në Komisionin për Legjislacion kemi qenë në favor të asaj që të mbetet kështu siç ka qenë, jo se jemi kundër Policisë, por se mendojmë që nuk e përjashtojmë, nuk e privojmë kryeqytetin nga e drejta për të pasur polici, por këtë çështje e lëmë ta rregullojë Policia nëpërmjet Ligjit për Policinë. Duke e pasur parasysh këtë, mendoj që materia që derivon nga amendamenti 3, është mirë t'i lihen udhëzimit administrativ, që Komuna, Kuvendi Komunal, kryetari i kryeqytetit së bashku me Policinë ta shohin mënyrën se si do ta operacionalizojnë Policinë. Duke pasur parasysh pra këto, ne mendojmë që se si duket komisioni ynë paska qenë shumë më dorështrënguar, nuk paska dhënë leje, apo s'ka miratuar shumë amendamente, të cilat komisionet tjera dhe kolegu Nait Hasani, dhe kolegu Milaim nga Komisioni për Administratë i paskan miratuar kështu pa asnjë vërejtje. Në fund të fundit, kjo është edhe detyra e Komisionit për Legjislacion, jo të zëvendësojë, siç e thashë më herët, dhe më mbështeti edhe kolegu Memli Krasniqi, jo ta zëvendësojmë seancën, por të japim këndvështrimin tonë në funksion të ndihmës së deputetëve, të cilët nuk kanë mundësi që në detaje të informohen për ligjin gjatë punës që bëhet në komision.

Pra, ne i kemi dhënë sugjerimet tona, por nuk mund ta zëvendësojmë seancën. Po të dojë seanca e voton edhe kështu siç e kanë sjellë amendamentin, por nuk mendoj që do të duhej të votohej në këtë mënyrë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Driton Selmanaj e ka fjalën.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit!

Unë në fakt kam qenë kritiku më i madh pse i merrnim ligjet e përkthyer në të kaluarën, por sot po bindem që shumë më mirë paskemi qenë kur i kemi marrë ligjet duke i përkthyer sesa kur provojmë të bëjmë vetë ligj, e duke e përçudnuar këtë dhe secilin ligj që ne po provojmë ta bëjmë.

Çka po dua të them? Ne sot jemi në lajthitje totale. Në njërin anë, e kemi një punë jo profesionale të komisionit, sepse disa amendamente që na kanë ardhur janë shumë kontradiktore. Në anën tjetër, s'e kemi Qeverinë fare si sponsorizuese e këtij projektligji, me të cilin krenohet shumë që ja "unë e bëra, unë e bëra", tash s'vjen së paku për t'u ballafaquar me argumentet dhe që ne ta kuptojmë se çfarë po ndodh. Ne kemi prekur, veç një sekondë, mos u ngut Dardan, sepse je duke folur si militant. Veç një sekondë! Ti nuk mund, përkundër që Kushtetuta ta jep të drejtën ta nxjerrësh një Ligj për kryeqytetin, ta nxjerrësh një ligj i cili e shkel Kushtetutën dhe shkel ligjet tjera. Veç një sekondë! Nëse ne duam ta rregullojmë strukturën e Policisë, e kemi

Ligjin për Policinë. Nëse mendoni që me këtë ligj kryetarit të Komunës t'ia jepni të drejtën ta zgjedhë komandantin e Policisë, e keni gabim, sepse këtë e bëjmë me Ligjin për Policinë. Jo, jo, me këtë ligj po. Nëse mendoni që me këtë ligj t'i jepni të drejtë Komunës të licencojë spitale, e keni gabim, sepse kjo bëhet me Ligjin për shëndetësinë.

Prandaj, duke e parë mënyrën se si po diskutojmë këtu, unë më mirë them të shkojmë në lexim të tretë dhe ta kthejmë edhe një herë këtë ligj. Më mirë ta sakrifikojmë kohën dhe ta nxjerrim një ligj të mirë, sepse të bëjmë kështu militantizëm, pse i ka thënë Shpend Ahmeti dikujt "shpejt bëma atë ligj". Mos gaboni kështu, sepse unë po e shoh që kemi dallime konceptuale dhe gabime, të cilat nuk guxojmë të na ndodhin.

KRYETARI: Faleminderit! Dardanit i është përmendur emri, replikë!

DARDAN SEJDIU: I nderuar kryetar!

I nderuar koleg,

E kam jashtëzakonisht si të them me militantizëm kryeqytetin, ashtu qysh u shprehe edhe ti. Sa i përket licencimit të spitaleve, është amendamenti pikërisht i komisionit, i cili atë e rregullon, pra që thotë që kjo mbetet në kuadër të ligjeve ekzistuese dhe hiqet komplet gjuha sa u përket licencimeve. Propozimi im, në mënyrë që kjo temë, e cila ka zgjatur me vite dhe ka kaluar nëpër qeveri të ndryshme, pra në këtë ligj ka dorë edhe ish-kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Mustafa, sepse një pjesë e madhe e shkruar në këtë ligj është punë me Qeverinë e kaluar. Qeveria e tashme e ka proceduar për ta sjellë në komision. Unë propozoj që për hir të ecjes tutje për kryeqytetin, t'i votojmë amendamentet kush është për, kush është kundër dhe të mos e zgjasim. Gjithkush ka botëkuptime të ndryshme sa i përket një fjale apo dy, dhe këtu nuk jemi për ta bindur as njëri-tjetrin se cili amendament është i duhuri. Unë besoj që amendamenti i propozuar është në rregull dhe do të votoj për. Ata të tjerët le të votojnë kundër dhe qëndrojmë në kuadër të nenit ekzistues pa amendamentim.

Po propozoj që të jemi më efektiv dhe t'i vendosim në votë. Faleminderit!

KRYETARI: Ka një propozim konkret, por ka deputetë për fjalë. E dëshironi tërheqjen, a të vazhdojmë? Atëherë unë po pres pesë-dhjetë sekonda, është radha te PDK-ja. Nuk tërhiqeni asnjë? Atëherë, Memli Krasniqi!

MEMLI KRASNIQI: Zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Çështja për të cilën po flasim - amendamenti 3, realisht subjekti ka të bëjë me themelimin e një policie për kryeqytetin, me kompetenca në kryeqytet, qofshin ato për rendin dhe qetësinë, për ofrim mbështetjes së inspektorateve, për sigurinë publike, për sigurinë në trafik çështje të tilla, dhe edhe amendamenti, të cilin e kanë propozuar si komision pak a shumë e rregullon këtë

çështje, edhe teksti origjinal që ka ardhur prej sponsorizuesit po ashtu, por ka një dallim esencial. Unë konsideroj që teksti i propozuesit, i Qeverisë, e rregullon në mënyrë shumë të drejtë dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi, duke mos rrezikuar prishjen e hierarkisë dhe strukturës së Policisë së Kosovës, ndërsa propozimi, amendamenti që kemi para nesh, në botëkuptimin dhe këndvështrimin tim e rrezikon këtë çështje, sepse jep kompetencë, jo më Policisë së Kosovës, por Kuvendit Komunal dhe kryetarit për të themeluar polici.

Problemi është sesi mund të keqpërdoret, apo a ka rrezikim për ta keqpërdorur në të ardhmen një precedent të tillë. Kështu që unë sinqerisht mendoj që Prishtinës i duhet një polici e kryeqytetit, i duhet një polici që ka kompetenca vetëm për këtë kryeqytet dhe që merret me problemet, të cilat ndërlidhen me qeverisjen brenda Komunës së Prishtinës. Por, nëse e refuzojmë amendamentin dhe nëse e votojmë kundër, nuk e pamundësojmë këtë gjë, përkundrazi e mundësojmë që të bëhet në mënyrë më të mirë sesa nëpërmjet amendamentit. Andaj, ju ftoj që ta votojmë edhe këtë amendament. Unë propozoj që të votohet kundër amendamenti e të kthehet teksti origjinal, prapë do të kemi Polici të Kryeqytetit, prapë do të ketë kompetenca të shtuara vetëm për këtë, por që besoj ruhet edhe Ligji për Policinë, edhe struktura hierarkike ekzistuese dhe të kalojmë edhe te amendamentet tjera, të cilat janë po ashtu të rëndësishme, e ta votojmë sot këtë ligj, këtë projektligj ta kthejmë në ligj, sepse janë bërë vite e vite që e diskutojmë, ndërsa qytetarët e Prishtinës e meritojnë që më në fund ta kenë një ligj të mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ismet Beqiri e ka fjalën, ju kisha lutur deputetë kush e ka fjalën le të flasë, në fund fjalën e merr komisioni.

ISMET BEQIRI: Faleminderit!

Kolegë, me të drejtë nuk po e kontestoj nevojën, domosdoshmërinë për ta pasur një polici kryeqyteti, fundi i fundit nëse nuk janë edhe disa elemente që e dallojnë kryeqytetin prej komunave tjera, atëherë s'ka nevojë të ketë fare ligj, dhe këtu disa prej kolegëve e thanë - vetëm ata që të mos më keqkuptojnë të tjerët, kanë punuar në çfarëdo niveli në Komunë, e dinë se çfarë problemesh ka Komuna e Prishtinës në ekzekutimin e vendimeve.

Absolutisht nuk krahasohet, por është absurde për ta krahasuar e për të thënë njësoj vepron Policia si në Novobërdë, si në Prishtinë, por nuk vepron. Ka jashtëzakonisht probleme të mëdha. Prandaj, këto mospërputhje eventualisht ndërmjet amendamentit dhe sponsorizuesit janë temë tjetër që duhet parë mirë edhe s'e di pse ka ardhur në një situatë të tillë, por një gjë po dua të jua rikujtoj. Në vitin 2005, 2006 dhe 2007, unë vazhdimisht kam kërkuar nga UNMIK-u në atë kohë, komisar i Policisë dhe UNMIK-u, zoti Petersen dhe Joakim Ryker, që Prishtina ndërkohë të ketë polici komunale. Po flas për para 12-13 vjetësh, dhe nuk është bërë kurrë dhe është rast që nuk guxojmë në asnjë mënyrë ta lëshojmë që Prishtina të mos e ketë policinë, e mënyra sesi rregullohet kjo është çështje që ndoshta është hapur dhe unë po e shoh që ka divergjenca, e thanë edhe disa prej kolegëve të mi, ndërmjet amendamentit dhe asaj çfarë thotë sponsorizuesi. Por,

është absurde të mendohet që Prishtina, ose po hap derë për të tjerët, jo jo s'ka kurrfarë dere, sepse Prishtina është Prishtinë, është kryeqytet dhe të tjerët mund të kenë dëshirë të kenë polici të vetën, por s'mund ta kenë.

Prandaj, unë jam mbështetës i fuqishëm që në kuadër të Komunës së Prishtinës të ketë kompetenca, pse jo. Edhe në atë kohë UNMIK-u ka propozuar tre emra, në të vërtetë kanë ardhur tek kryetari i Komunës tre emra, unë e kam dhënë mendimin për njërin. Pse të mos e japë edhe sot kryetari i Komunës? Emrat vijnë prej Policisë. Mos se kryetar i Komunës, sot është dikush, nesër është dikush tjetër, nuk duhet parë ndryshe, përpos asaj si nevojë që Prishtina të funksionojë më mirë. Ne shumëkush i kemi pasur duart e lidhura, sot mund t'ia lirojmë pak duart nëse ai që është aktualisht do të punojë.

KRYETARI: Faleminderit! Para votimit, a ka ndonjë deputet tjetër? Do të flasë edhe kryetari i komisionit përkatës. A është dikush prej deputetëve? Nuk ka! Nait Hasani, në emër të komisionit, pastaj shkojmë në votim.

NAIT HASANI: Edhe një herë kryetar, mund të them që amendamenti është bërë bashkë me zyrtarët, juristët e Policisë, që kanë qenë pjesë e komisionit. Policia e Kosovës e ka kundërshtuar pjesën e ligjit, nenin, dhe prandaj është kërkuar që të bëhet ky amendament. Për mua personalisht, unë mendoj që amendamenti i plotëson kushtet, sepse është një amendament që ia jep kryeqytetit mundësinë e një policie lokale që merret me emergjencat dhe nevojat e kryeqytetit, ndërsa Policia e Shtetit është jashtë, e cila merret me rregullimin e Policisë. Prandaj, nuk kemi asgjë në kundërshtim me Kushtetutën. Një themelim është që për herë të parë themelohet në çdo vend, shkruhet ashtu, prandaj nuk kemi kundërshtim.

Unë kërkoj që të votohet amendamenti dhe t'ia japin mundësi kryeqytetit për sigurinë, mirëqenien dhe mirëmbajtjen, apo plotësimin...

KRYETARI: Faleminderit! I kemi qëndrime që janë. Shkojmë te amendamenti numër 3, votojmë në mënyrë elektronike. Regjia, deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 63 deputetë, 27 për, 32 kundër, 4 abstenime. Nuk kalon amendamenti 3, mbetet ai i propozuesit.

Amendamentet 4 deri në 12. A ka vërejtje, apo shkojmë për të gjithë bashkë? Bashkë, në qoftë se ka dikush vërejtje, ju lutem veç pak, që doni ta ndajmë ndonjërin, ngriheni dorën! Nuk ka! Jemi te amendamentet nga 4 deri në 12, i votojmë të gjithë bashkërisht në mënyrë elektronike. Votojmë tash!

Kanë votuar 67 deputetë, 64 për, 1 kundër, 2 abstenime. Amendamentet 4 deri 12 kalojnë.

Tani e votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 67 deputetë, 66 për, 1 abstenim.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-012 për kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinën. Urime ligji i ri kryeqytetit dhe kryeqytetaseve!

10. Shqyrtimi i Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, 2018-2022

Komisioni Funkcional për Integritime Evropiane, në bazë të nenit 62, paragrafi 1 i Rregullores së Kuvendit, e ka shqyrtuar Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit 2018-2022 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij. Përfaqësuesi i Qeverisë së Kosovës, nuk është askush për ta paraqitur e për ta arsyetuar Programin Kombëtar. E ftoj Komisionin për Integritime Evropiane. Nga Komisioni për Integritime Evropiane, në fakt zonja Blerta Deliu-Kodra tani e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Ministrja e Integritimit na ka informuar që nuk do të jetë në seancë, meqë ka udhëtuar për në Sofje.

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Integritime Evropiane, në mbledhjen e mbajtur më 19. 4. 2018, e ka shqyrtuar dhe miratuar Programin Kombëtar për zbatim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe të njëjtin e ka rekomanduar për miratim në seancën e sotme.

Më lejoni fillimisht të paraqes një rezymë të Programit Kombëtar për zbatim të MSA-së, që paraqet një kornizë gjithëpërfshirëse të reformave konkrete afatshkurtra dhe objektivave afatmesme për periudhën 2018 - 2022 për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Struktura e Programit Kombëtar për zbatim të MSA-së është zbatuar në ndarjen e kriterëve të Kopenhagës, pra është bërë ndarja e masave dhe prioriteteve në tri blloqe, si vijon: kriteret politike; kriteret ekonomike dhe kriteret apo standardet evropiane, përafrim i legjislacionit të Kosovës me ‘acquis communautaire’ . Programi është ndarë në dy pjesë, në pjesën përshkruese apo pjesën narrative, si dhe në pjesën tabelare, ku janë përfshirë masat afatshkurtra në matricë.

PZKMZ-ja si një dokument mjaft i rëndësishëm rishikohet në fund të vitit me qëllim të përditësimit të masave afatshkurtra dhe një pjese të tekstit, kur është edhe e nevojshme. Miratimi dhe zbatimi i këtij dokumenti nënkupton dhe përcakton prioritetet dhe masat, jo vetëm për

përafrim të legjislacionit, por edhe të zhvillimit dhe të zbatimit të politikave. Bazuar në ecurinë e deritashme, jo vetëm të zbatimit, por edhe të planifikimit të masave dhe të prioritetëve, qasja e tanishme e rishikimit të PKZMSA-së ka pësuar ndryshime. Këto ndryshime reflektojnë në përcaktimin e masave afatshkurta bazuar në reformat në kuadër të strukturave të stabilizim-asociimit, duke bërë kështu ndërlidhjen me dokumente tjera të politikave, duke i postuar ato, si dhe duke i konfirmuar ato.

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që në pika të shkurtra ta paraqes përfshirjen e fushave sipas ndarjes strukturore të këtij dokumenti. Blloku i parë janë kriteret politike, ku përfshihet kryesisht funksioni ligjvënës, ekzekutivi, reformat kushtetuese, reforma e sistemit zgjedhor, si dhe administrata publike, bashkëpunimi rajonal dhe pjesërisht sundimi i së drejtës, sistemi gjyqësor, të drejtat themelore dhe mbrojtja e minoriteteve. Ky bllok është i ndarë në pesë kapituj, si vijon: Kushtetuta; Parlamenti dhe sistemi zgjedhor; Administrata Publike; Avokati i Popullit; mbikëqyrja civile e Forcave të Sigurisë dhe bashkëpunimi rajonal.

Blloku dy - kriteret ekonomike të harmonizuara me programin për reforma ekonomike përmban dy kapituj: ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut; kapaciteti për t'u përballur me presione të konkurrencës dhe forcat e tregut brenda vetë unionit.

Blloku i tretë përfshin standardet evropiane për afrim të legjislacionit të Kosovës me 'acquis communautaire', i cili ndërlidhet me kapitujt e AKI-së, gjithsej 33 kapituj.

Në fund fare, të nderuar kolegë deputetë, bazuar në rëndësinë e këtij dokumenti kërkoj nga ju që ta miratoni Programin Kombëtar për zbatim të MSA-së dhe njëherësh ne si Komision për Integritet Evropian, në veçanti, si dhe komisionet tjera, në përgjithësi, do ta kemi prioritet mbikëqyrjen e zbatimit në përpikëri të këtij programi. Përveç kësaj, Komisioni për Integritet Evropian do të jetë edhe partner mbështetës i të gjitha institucioneve për zbatim sa më efikas të Programit Kombëtar të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, njëherësh duke e ruajtur konsensusin e nevojshëm politik për agjendën e integritetit evropian.

KRYETARI: Faleminderit! Tani e kanë radhën përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Armend Zemaj nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Më duhet të theksoj që detyrimisht ne jo vetëm që e përkrahim, por kërkojmë llogari nga Qeveria e Republikës së Kosovës në trajtimin edhe të masave dhe prioritetëve të të gjitha institucioneve shtetërore, që janë të obliguara për zbatimin e marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Andaj, në këtë përkrahje, kritika jonë shkon në mospërbushjen e aktiviteteve, sidomos në fundvitin e kaluar dhe në fillimvitin 2018 dhe kjo brengë del edhe nga takimet dhe nga vlerësimet dhe nga raporti i ministrave apo ministrive të linjës, si pjesëtarë apo obligues të përmbushjes së obligimeve dhe detyrimeve që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit.

Unë sot para jush do ta kisha theksuar një numër të aktiviteteve të papërbushura, që në përqindje rezulton në masën nën 30% të plotësimit të të gjitha aktiviteteve të parapara në vitin 2017 dhe në fillimvitin 2018. Kryetarja e komisionit me të drejtë i elaboroi obligimet që dalin, sidomos ato që kanë të bëjnë me kriterin politik, kriterin ekonomik dhe standardet evropiane. Në këtë aspekt nuk duhet të anashkalohet edhe përgjegjësia e Kuvendit të Republikës së Kosovës në mosmiratimin dhe mosprocedimin e ligjeve sipas afateve të përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit dhe kërkesave që dalin, qoftë në përafrimin e legjislacionit me BE-në, qoftë me përmbushjen me agjendën evropiane.

Kështu që Grupi Parlamentar i LDK-së i jep përkrahje këtij Programi Kombëtar për vitet 2018-2022 dhe do të jemi këmbëngulës në zbatimin e saj në përpikëri, duke i krijuar Kosovës mundësi të shpejtë në integrimin evropian dhe ecjen më tutje në strukturat euroatlantike. Faleminderit!

KRYETARI: I kisha lutur grupet parlamentare në qoftë se ka, le të lajmërohen në emër të grupeve. PDK-ja nuk u lajmërua askush. Lëvizja Vetëvendosje, Sami Kurteshi apo Fatmire Kollçaku. Kush flet në emër të grupit? Fatmire Kollçaku, urdhëro!

FATMIRE KOLLÇAKU: Faleminderit, kryetar!

Shqyrtimi i një çështjeje kaq të rëndësishme, siç është shqyrtimi i Programit Kombëtar për zbatimin e MSA-së pa praninë e kryeministrit dhe ministres së Integritimeve Evropiane mendojmë që nuk është serioz. Për më tepër, besoj se ishte dashur të jetë tërë Kabineti këtu para nesh për të dëgjuar, prandaj ne propozojmë që kjo pikë të shtyhet për një ditë tjetër, sepse të flasim ne pa praninë e Kabinetit mendojmë se është joserioze. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Shqipe Pantina e ka fjalën, nga Partia Socialdemokrate.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryetar!

Programi Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për vitet 2018-2022 në fakt është një dokument i mirëpritur dhe ne në parim do ta përkrahim. Megjithatë, si Program Kombëtar edhe në programin e vitit 2016, edhe në vitin 2018, vazhdon të thuhet, “në përgjithësi, nevojiten përpjekje të mëtejme për ta depolitizuar administratën dhe për t’i zbatuar plotësisht dispozitat relevante për parandalimin e korrupsionit”. Pra, thuhet se Qeveria është e përkushtuar në përmbushjen e kritereve.

Megjithatë, në praktikë dhe në raportin e Komisionin Evropian, që tani quhet raporti i vendit, në vazhdimësi marrim kritika për moszbatimin e reformës në administratë, si dhe në veçanti për mosdepolitizimin e administratës. Ndërkohë që edhe në vitin 2016, edhe në vitin 2018, sërish theksohet se Kosova do të ketë nevojë për t'i shtuar më tej përpjekjet për ta përmirësuar profesionalizmin dhe llogaridhënien e Administratës Publike në të gjitha nivelet. Qeveria në periudhën afatmesme planifikon ta krijojë një shërbim civil apolitik, profesional, të bazuar me merita. Kjo është planifikuar të arrihet nëpërmjet një organizimi të ministrive dhe organeve vartëse të tyre. Thuhet pra, në faqet 26 dhe 21, “Qeveria i riorganizon ministrinë duke bërë emërimet politike që vetëm sa e kanë rritur edhe numrin e ministrive, por edhe numrin e zëvendësministrave”. Pra, përderisa në një anë zotohet për ta riorganizuar Qeverinë dhe për ta zvogëluar Administratën, në praktikë ka ndodhur e kundërta. Kështu që, ne sugjerojmë dhe i kërkojmë Qeverisë që ta zbatojë strategji-dokumentet që ajo vetë i harton.

Pra, në njërin anë, sa u përket marrëdhënieve me Serbinë, në vitin 2016 thuhet se në kuadër të dialogut, që thuhet se është tregues pozitiv në këtë aspekt, është zbatimi i marrëveshjeve për menaxhimin e integruar të kufirit ndërshtetëror, por po ashtu në vitin 2018 thuhet se lidhur me menaxhimin e integruar të kufijve pala e Kosovës është duke e zbatuar në tërësi këtë marrëveshje dhe është pala serbe ajo që po bën pengesa. E tash, çështja është a “zbatuar” apo marrëveshja për menaxhim të kufijve është duke u penguar nga Serbia? Pra, ka një paqartësi rreth kësaj.

Po ashtu, në vitin 2016 është thënë dhe sërish thuhet në vitin 2018 se në periudhën afatmesme do të hiqen strukturat paralele të Serbisë, që vazhdojnë në fakt të shtohen, siç theksohet në faqen 41 dhe në faqen 37. Më 8 shkurt 2017, në Komisionin për Punë të Jashtme, ministrja e atëhershme, Edita Tahiri, pati deklaruar se strukturat paralele janë shuar. Nëse janë shuar, atëherë pse është pjesë e këtij programi, që këto struktura duhet të hiqen?

Në programin e vitit 2018, po ashtu thuhet se Kosova është një ndër vendet më të pasura në Evropë me pasuri nëntokësore. Prioritetet do të jetë shfrytëzimi i potencialeve të brendshme, përkatësisht resurseve njerëzore dhe programi parasheh politika fiskale të favorshme dhe përmirësim të mjedisit afarist, nëpërmjet politikave konkurruese të tregut, luftimit të ekonomisë joformale dhe eliminimit të barrierave për biznes. Dhe, thuhet se zhvillimi i sektorëve me rëndësi janë ata ekonomikë dhe këta janë prioritarë. Mirëpo, sipas programit të vitit 2018, shkalla e papunësisë vazhdon të mbetet e lartë, pra është 30,2%, që është 27% te meshkujt, 27,8 në fakt, përderisa te gratë ajo është edhe më e lartë, deri në 30% dhe kjo shkallë e papunësisë është më e lartë te moshat e reja, përkatësisht prej moshës 15-24-vjeçare.

Prioritetet për popullsinë që mosha e punës të rritet shpejt gjatë dekadës së ardhshme, pasi Kosova është ndër vendet me popullsinë më të re në Evropë. Pra, në parim ne i japim mbështetje agjendës, por kërkojmë që kjo të zbatohet, sepse siç ka ndodhur edhe me shumë dokumente dhe strategji të tjera, ndonëse ato kanë qenë të mira të shkruara në letër, zbatimi i tyre në përgjithësi

dhe në vazhdimësi ka ngecur dhe ne do ta mbajmë përgjegjëse Qeverinë për zbatimin e këtij programi. Faleminderit!

KRYETARI: Ahmet Isufi, fjala për ju!

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar Programin Kombëtar për MSA-në dhe njëkohësisht konsiderojmë që Qeveria duhet t'i përmbushë të gjitha obligimet të cilat i ka për ta përmbushur programin. Njëkohësisht, ne si Kuvend duhet të jemi të angazhuar në një kontroll parlamentar që të përmbushet sa më mirë ky program. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Milaim Zeka, urdhëro!

MILAIM ZEKA: Kryetar!

Për të qenë shumë i shkurtër, pajtohem në mënyrë absolute me ato që tha Blerta Deliu, edhe Ahmeti, edhe Armendi, pjesërisht me Shqipen, kështu që ne jemi për. E mbështetim.

KRYETARI: Faleminderit! Avdullah Hoti, urdhëro!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Ne e dhamë qëndrimin tonë në emër të Grupit Parlamentar. Sigurisht që do ta mbështesim, por më lejoni të shpreh më shumë një shqetësim për mungesën e zyrtarëve të Qeverisë, ministrave, të kryeministrit. Ky është dokumenti më i rëndësishëm i reformave në tre vjetët e ardhshme. Ne ia kemi kushtuar gjithë vëmendjen e nevojshme gjatë mandatit të kaluar që të përgatiten programe, sepse nga këtu burojnë reformat, projektligjet, nismat e ndryshme, strategjitë e ndryshme gati në të gjithë sektorët.

E tash mungesa komplet e Qeverisë dhe shqyrtimi nga grupet parlamentare dhe deputetët veç sa për ta kaluar këtë pikë, unë mendoj që nuk na bën nder dhe nuk e tregon seriozitetin tonë si institucione karshi reformave për integrim evropian. Prandaj, propozimi im do ishte me mirëkuptimin e të gjithëve, që këtë pikë ne ta shtyjmë për një seancë tjetër, kur e kemi praninë e Qeverisë dhe të gjithë deputetëve në sallë për të dhënë secili vlerësimet e veta dhe për ta dëgjuar qëndrimin e Qeverisë karshi këtij dokumenti kaq të rëndësishëm. Faleminderit!

KRYETARI: Xhavit Haliti, urdhëro!

XHAVIT HALITI: Zoti kryetar!

Zonja dhe zotërinj,

Unë... çfarë të ju them? Ne po diskutojmë për Programin e Stabilizim-Asociimit, por dua të shpreh shqetësimet e mia nga përvoja ime që kam pasur gjatë dy legjislativave të kaluara, pikërisht në Programin për Stabilizim-Asociim.

Realisht, në të gjitha legjislativat dhe për çdo vit ka ardhur programi pothuajse i njëjtë për detyrat që kemi, por diçka nuk ka funksionuar. Dhe, ajo që s'ka funksionuar ka qenë përgjegjshmëria e institucioneve, së pari e Kuvendit të Kosovës dhe pastaj e Qeverisë dhe institucioneve ligj-zbatuese në Kosovë.

Dihet rrugëtimi i të gjithë atyre që kanë hyrë në Bashkimin Evropian, dihen praktikat e shteteve të veçanta, të cilat më me sukses i kanë kapërcyer vështirësitë që u dalin institucioneve të vendit, që i dalin vendit për çështjen e integritit të Kosovës. Ne nuk e kemi një institucion të përbashkët dhe nuk e kemi një marrëveshje të përbashkët pozitive-opozitive dhe, përveç asaj që na monitoron BE-ja, ne nuk kemi monitorim për veten tonë. Ne themi që Parlamenti e monitoron Qeverinë, diçka që s'është e vërtetë. Qeveria ka opionencë në Parlament, por s'ka kontroll dhe s'ka kompetenca pa Parlamentin. Qeveria ka bërë shumë angazhime, por, në fund, duke mos qenë të koordinuara, veprimet janë kontestuar po nga ky Parlament që e ka autorizuar Qeverinë.

Prandaj, unë mendoj që duhet të ndiqet rruga më e mirë deri sot që unë e kam parë sa i përket integritit të vendit tonë në BE, mënyra sesi kroatët e kanë pasur komisionin e stabilizim-asociimit, sesi u ka funksionuar atyre dhe sesi janë marrë vesh pozita dhe opozita sa u përket çështjeve që kanë të bëjnë me procesin e stabilizim-asociimit dhe po them - njëra nga marrëveshjet ka qenë që palët të mos e kontestojnë agjendën. E për të mos e kontestuar agjendën duhet të ketë një komision të përgjegjshëm të përbashkët ndërmjet institucioneve. Kur them ndërmjet institucioneve, them ndërmjet Qeverisë, Parlamentit dhe organeve të tjera ligj-zbatuese. Nëse këtë s'e bëjmë, jam i bindur 100% që edhe kolegët e opozitës, edhe pozita, një pjesë e madhe, do të merren me kritika të ministrave të veçantë, me kritika kryeministrit, me kritika presidentit, me kritika komisioneve përkatëse këtu të Kuvendit dhe do ta quaja politikë shtetërore të Kosovës sa i përket çështjes së integritit nuk do të ketë, sepse deri tash nuk ka pasur.

Nuk mund të ketë politikë shtetërore me një dokument që ne e miratojmë, ose nuk e miratojmë. Politika shtetërore bëhet në mënyrën që e kanë bërë të tjerët dhe kanë qenë të suksesshëm. Nuk mjafton të jesh në politikë dhe politikan dhe të jesh deputet a ministër që vetëm të merresh me njërin palë, ose me palën tjetër, duke kritikuar njërin, ose tjetrin.

Unë mendoj që Qeveria duhet të ketë nisma për t'u konsultuar me grupet parlamentare në vend. Edhe kjo tryeza që po bëhet, por edhe këtu në Parlament, që ta gjejmë dhe ta zgjedhim formulën më të mirë dhe formulën më e mirë është, po e përsëris, formula kroate, e cila ka qenë më e shpejta dhe më e suksesshme, duke e krahasuar me shtetet tjera që e kanë pasur rrugëtimin e njëjtë sikur ne. Faleminderit!

KRYETARI: Sami Kurteshi, urdhëro!

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Gjendja këtu në sallë tregon se cili është interesimi. Unë i kam shpërndarë këtu shumë dokumente, kam bërë përpjekje ta lexoj shumë seriozisht këtë dokument dhe po e shoh që është Program Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Kjo është ndër hallkat kryesore, s'po them për integrimin evropian, sepse jemi shumë larg, por për këtë liberalizimin e vizave, që na i këputët veshët nja 10 vjet dhe s'ka kurrëgjë. Këtë dokument duhet ta zbatojë Qeveria, e Qeveria nuk është këtu. Qeveria e ka bërë këtë dokument dhe unë e lexoj, sepse propozimi im në të vërtetë përputhet me atë që e tha zonja Kollçaku, por edhe zoti Hoti, që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për atëherë kur të jenë këtu kryeministri dhe Qeveria, sepse shkruan gjëra që nuk janë hiç të vërteta.

Te kriteret politike, po e lexoj veç një pjesë, sa për ta parë si është gjendja, te korniza institucionale bëhet fjalë për një nivel të koordinimit, nivel administrativ të Kuvendit me Qeverinë. Edhe këtu është një trup që thotë, përveçse i informon anëtarët e Qeverisë, Kabineti qeveritar e ka edhe një obligim dhe thotë që i informon ministrat, anëtarët e Kabinetit Qeveritar në raport me obligimet ndaj Kuvendit. Pastaj, pas këtij konstatimi shkon më larg dhe thotë, "Kuvendi ka bërë progres në mbikëqyrjen e Ekzekutivit dhe konsultimet me shoqërinë civile". E në të vërtetë, Raporti i Progresit, siç e quajmë ne, thotë që pikërisht kjo është njëra nga pikat e dobëta. Ata e lexojnë edhe këtë raport, edhe raportin e vet dhe thonë "more, dikush këtu po rren, por kush po rren nuk po e dimë. Po, dikush është duke rrejtur".

Dhe pastaj thotë, "praktikat e raportimit të ministrave në komisionet e Kuvendit është rritur". Unë po i pyes krejt kolegët këtu, a është e vërtetë kjo? Në të vërtetë, raportimi i ministrave në seancë është i mangët, s'i kemi këtu. Ky është dokumenti kryesor sa i përket raportit Kosovë - Bashkimi Evropian. I kemi dy ministra që janë disiplinuar, në të shumtën e rasteve vijnë këtu, e të tjerët nuk i sheh. A po e miratojmë një dokument Program Kombëtar, që ka të bëjë me Bashkimin Evropian, apo jemi duke miratuar diçka tjetër? Bile, as ministri apo ministrja përgjegjëse për zbatimin e këtij programi nuk është këtu.

Prandaj, unë propozoj dhe pajtohem me propozimin e koleges Kollçaku, edhe kolegut Hoti, që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një seancë tjetër, kur Qeveria edhe ministrat kompetentë, apo ministrja përgjegjëse të jetë këtu edhe të përgjigjet në pyetjet e deputetëve, apo deputeteve në lidhje me gjërat që janë këtu dhe për të cilat konsiderojmë se nuk janë të qarta apo nuk janë të vërteta. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! A ka të tjerë deputetë? Fatmir Xhelili, urdhëro!

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Përsëritje për ministrat dhe të gjithë deputetët e pranishëm!

Më pëlqeu shumë diskutimi i zotit Haliti. Unë kam qëndruar në Komisionin për Integritet Evropian një periudhë bukur të shkurtër, por jam familjarizuar bukur shumë me Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe besoj që shtetit tonë dhe zbatimit të aktiviteteve të planifikuara në Programin Kombëtar për zbatimin e MSA-së i nevojitet një monitorim shumë më adekuat dhe më rigoroz për zbatimin e aktiviteteve të të gjithë resorëve të ministrave tona. Besoj se vetëm Ministria për Integritet nuk e ka autoritetin e mjaftueshëm për t'i motivuar, angazhuar në zbatimin e aktiviteteve resorët tjerë të Qeverisë. Andaj, formimi i një trupi të përbashkët, çfarëdo që ajo të quhet, ndërmjet Kuvendit dhe Ekzekutivit do të jetë domosdoshmëri e kohës dhe gjithëherë ato aktivitete të prezantohen dy herë në vit edhe para Kuvendit, në mënyrë që të kërkohet llogaridhënie e mirëfilltë pse disa aktivitete po ngecin, pse nuk po zhvillohen, pse nuk po zbatohen, a po mungojnë resurset njerëzore, resurset financiare, apo po neglizhohen si aktivitete që donë një përkushtim edhe një domosdoshmëri, që është faktikisht projekti kryesor i shtetit tonë në dhjetëvjeçarin e ardhshëm.

Edhe unë kisha propozuar që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet dhe të trajtohet shumë seriozisht në praninë e kryeministrit dhe në praninë e ministrave të resorëve që janë më së shumti të involvuar në këto aktivitete të planifikuara.

Gjithashtu projekti parasheh ndryshime, reforma, avancime në gjyqësi, prokurori e të tjerë.

As Kuvendi nuk e ka atë mekanizëm për të ndikuar te gjyqësori dhe te prokuroria, por sa Qeveria si institucion i pushteteve të ndara, për këtë arsye këtë rol mund ta luajë vetëm një komitet apo një komision i përbashkët i të gjitha trupave në këtë drejtim.

Kështu që propozoj që kjo pikë të shtyhet për një ditë tjetër, kur do të jenë të disponuar të merret seriozisht trajtimi i këtij programi kombëtar.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Vjosa Osmani-Sadriu e ka fjalën.

VJOSA OSMANI-SADRIU: Faleminderit, shumë shkurt!

Këtij dokumenti po i mungon një deklaratë politike që rikonfirmon orientimin strategjik të Republikës së Kosovës, por mbi të gjitha rikonfirmon se cili është synimi i Republikës së Kosovës në momentin e zbatimit të MSA-së.

Ne kemi dëgjuar nga zyrtarë të lartë shtetërorë të thonë që në momentin që ndodh kjo, Kosova duhet ta ketë të drejtën që të aplikojë për statusin e kandidatit në Bashkimin Evropian dhe kjo mendohet do të duhej të reflektojë në këtë dokument, meqenëse ky është plan kombëtar, nuk është

vetëm i Qeverisë, pra, tregon synimin e tërë Republikës së Kosovës për hapin e ardhshëm që pason në momentin që të zbatohet Marrëveshja për Stabilizim-Asociim.

Çështja e dytë sa i përket rolit të opozitës. Unë pajtohem që në agjendën evropiane Republika e Kosovës shumë shpesh ka ngecur në krijimin e një konsensusi në praktikë, edhe pse retorika ka qenë plot me deklarata rreth nevojës së konsensusit.

Por ne duhet të shikojmë pak edhe te vendet e rajonit dhe shembujt e mirë që ka ndërtuar rreth involvimit të opozitës.

Nuk mund të dalim dhe të ankojemi pse po kritikon opozita, pse po kërkon veprime konkrete opozita, ndërkaq të mos marrim shembuj të mirë, sikur ajo që e ka Kroacia, ku Këshilli Kombëtarë për Integrim Evropian i cili e koordinon punën e të gjitha institucioneve gjithnjë është udhëhequr nga opozita. Pra, edhe de fakto e ka bërë opozitën pjesë të çdo procesi gjatë gjithë negociatave që Kroacia ka pasur me Bashkimin Evropian, rrjedhimisht edhe e ka përshpejtuar procesin e krijimit të konsensusit nacional për një çështje të tillë.

Pra, ka mundësi që të bëhet një involvim më i mirë i opozitës, më aktiv, mirëpo deri tani, përkundër zërave të shumtë që kemi kërkuar që këta shembuj të rajonit të merren parasysh, ata nuk janë marrë parasysh, sepse është konsideruar se duhet të monopolizohet me një fjalë nga persona të caktuar i tërë procesi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryetarja e komisionit, në fakt tash si deputete, Blerta Deliu-Kodra e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Vetëm shkurt, meqë diskutimi i kësaj pike shumë të rëndësishme ka koiciduar edhe me samitin e Sofjes dhe zyrtarët e lartë institucionalë nuk kanë mundur të jenë në një seancë të rëndësishme, besoj shumë nga ajo që e thanë edhe kolegët deputetë, zbatimi i programit të MSA-së e meriton një trajtim pak më të veçantë dhe më të detajuar, meqë ministrat përkatës mund të raportojnë në një tërësi prej seancave se sa është zbatuar ky program në veçanti dhe i mbetet seancës të vendosë nëse ne do ta shtymë trajtimin për një tërësi prej seancave të radhës apo do të vendosim që ta miratojmë në parim sot.

KRYETARI: Faleminderit!

52 deputetë janë në sallë, a ka tjetër të lajmërohet për diskutim? Nuk ka.

Atëherë në proces të votimit nuk mund të futemi, 54 deputetë, e lëmë për votim kur jemi 61 deputetë.

11. Shqyrtimi i Strategjisë Shtetërore të Ujërave në Kosovë, 2017-2036

(Reagim nga salla)

KRYETARI: Ju veç më tregoni si e merrni ju vendimin kur jemi 54 deputetë në sallë.

Vetëm për korrektësi, 54 deputetë jeni në sallë. Ju edhe në qoftë se e shtyni, edhe në qoftë se nuk e shtyni, unë kurdo që dëshironi ju s'mund t'ju garantoj se mund të marrin fjalën të tjerë përveç këtyre që e kanë marrë. Ata që kanë pasur interesimin në këtë temë, jam shumë i sigurt që kanë qëndruar.

Ne edhe ashtu nuk mund ta votojmë sot, kjo mbetet në momentin kur janë 61 deputetë, në qoftë se bartet, atëherë mund ta hapni ju, seanca e vendos, 61 deputetë, ju e vendosni prapë, nuk e vendos unë.

Vazhdojmë me pikën e radhës.

Komisioni Funkcional për Bujqësi e ka shqyrtuar Strategjisë shtetërore të ujërave në Kosovë 2017-2036 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Përfaqësuesi i Qeverisë, ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, zoti Reçica, e ka fjalën.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar koleg ministër,

Në emër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe në emër të Qeverisë paraqes para jush strategjinë e ujërave në Kosovë 2017-2036.

Kjo strategji bazohet në nenin 1, të Ligjit për ujërat e Kosovës numër 04/L-147 me qëllim që të sigurojë zhvillimin e shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve ujore, të përcaktojë procedurat dhe parime udhëheqëse për shpërndarje optimale të resurseve ujore, të sigurojë mbrojtje për këto resurse, të përcaktojë strukturat institucionale dhe administrative të resurseve ujore, të integrojë objektivat që rrjedhin prej politikave ekzistuese të Kosovës, duke marrë parasysh rreziqet që vijnë nga ndryshimet klimatike.

Strategjia e ujërave në Kosovë siguron kornizën për adresim efektiv dhe të qëndrueshëm të çështjeve kryesore në sektorin e ujërave në Kosovë dhe ky dokument paraqet bazën për menaxhimin e integruar të ujërave, e cila bazohet në disa objektiva, si në vijim: shfrytëzimit të ujërave, mbrojtjen e ujërave, qeverisjen si dhe përafrimin e legjislacionit të Kosovës me direktivat e Bashkimit Evropian.

Elementet kryesore të planit ose politikës së propozuar në këtë strategji janë arritja e menaxhimit të integruar dhe gjithëpërfshirës të resurseve ujore për të siguruar plotësimin e kërkesave për të gjithë aktorët në këtë sektor dhe përmirësimin e gjendjes aktuale të menaxhimit të ujërave duke ndërtuar konceptin e drejtë dhe modern për menaxhimin e tyre.

Kostoja financiare për implementimin e strategjisë gjatë kësaj periudhe është vlerësuar të jetë mbi 1.5 miliard euro për implementimin e projekteve, masave dhe veprimeve të planifikuara në këtë strategji.

Gjatë hartimit të strategjisë janë konsultuar të gjithë aktorët e lihen me direkt apo indirekt me ujërat në Kosovë.

Të nderuar deputetë,

Meqë kemi të bëjmë me një resurs jetik, pra ujërat, kërkoj nga ju që ta miratoni këtë strategji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Daut Haradinaj, nga komisioni, nuk është i pranishëm. Salih Salihu, në emër të komisionit.

SALIH SALIHU: Faleminderit, kryetar!

Pra, në emër të kryetarit të komisionit, pasi nuk është këtu, po e lexoj rekomandimin.

Komisioni për Bujqësi dhe Mjedis në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 24. 4. 2018 shqyrtoi strategjinë shtetërore të ujërave në Kosovë 2017-2036 dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë rekomandimin që të miratohet dokumenti Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036.

Ky është rekomandimi i komisionit, ndërkaq nëse me lejohet të paraqes edhe mendimin e grupit tonë për strategjinë.

Në përgjithësi mund të them se strategjia nuk është e strukturuar mirë, ka gabime shumë të mëdha. Është një material shumë voluminoz, janë diku rreth 370 faqe. Ndërkaq në qoftë se e shihni përmbajtjen, mund të shihni se përmbajtje ka vetëm deri në faqen 170, kjo tregon se me të vërtetë është i punuar keq.

Gjithashtu është një problem që ujërat nuk janë trajtuar qysh duhet, sidomos ujërat rezervë në Kosovë.

Në përgjithësi këtu nuk ka ndonjë plan të qartë për ngritjen e akumulimeve të ujit në Kosovë. Kosova ka shumë pak resurse ujore për kokë banori, duke e ditur që Kosova gjithashtu ka edhe

sasi shumë të vogla të reshjeve, rreth 600 milimetra në vit, dhe këto sasi zakonisht janë të shpërndara shumë keq kur bie shi, zakonisht në vjeshtë e vonshme dhe në pranverën e hershme, ndërkaq pikërisht në kohën kur bimët kanë nevojë për ujë gjatë vegjetacionit të tyre, mungojnë.

Prandaj, këtu shihet nevoja e krijimit të akumulimeve dhe ndërtimit të sistemit të ujitjes për rritjen e rendimentit të njësisë së sipërfaqes.

Unë veç ju kujtoj juve që, për shembull, një hektar me misër në kushte pa ujitje në Kosovë arrin rendiment deri 3 deri në 3.5 tonë, ndërkaq po të kemi sistem të ujitjes rendimenti i misrit mund të arrijë deri 10 tonë për hektar. Po ashtu në këtë mënyrë mund të ndihmohet zhvillimi i bujqësisë si degë e ekonomisë.

Pra, me këtë mund të them se Qeveria do të duhej që në këtë mandat t'u kushtojë më shumë rëndësi resurseve ujore, akumulimit dhe ruajtjes së tyre dhe shfrytëzimit racional të ujit, sepse sot në përgjithësi në botë lufta është për ujë.

Ju e shihni se të gjithë qytetërimet e mëdha janë të ndërtuara rreth lumenjve të mëdhenj, rreth hapësirave ku ka ujë, sepse ne në shkencë them “uji nuk është ujë, por uji është bukë”. Pra aty ku ka ujë, ka edhe bukë dhe sot e shihni se gjithandej nëpër botë lufta është duke u bërë për ruajtjen e resurseve ujore.

Pra, Qeveria jonë në të ardhmen duhet të bëjë plane, të ndajë buxhet dhe paralel ndërtimit të autostradave, të investojë edhe në drejtimin e pendave apo akumuluesve të ujit që do të ndihmonin zhvillimin ekonomik të Kosovës përmes zhvillimit të bujqësisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Lutfi Zharku, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, kryetar!

Ministra,

Kolegë deputetë,

Strategjia e ujërave është dokument i planifikimit afatgjatë dhe i përcakton objektiva strategjike dhe drejtimet e zhvillimit të resurseve ujore dhe është punuar në përputhje me obligimin sipas Ligjit për ujërat e Kosovës.

Rëndësia e strategjisë rritet duke marrë parasysh se Kosova ka resurse të pamjaftueshme ujore dhe në të ardhmen do të jetë faktor kufizues në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.

Strategjia ofron zhvillim të integruar dhe të qëndrueshëm për të përmbushur nevojat e furnizimit me ujë të pijshëm, ujit për prodhimin e ushqimit, për ujitjen e tokave bujqësore, për industri, sport dhe rekreacion si dhe gjenerim të energjisë elektrike.

Sa u përket ujërave të ndotura, strategjia ofron gjithnjë për trajtimin e tyre përmes zhvillimit të projekteve në ndërtimin e infrastrukturës për grumbullimin dhe trajtimin e këtyre ujërave.

Plani për investime përmbledh projekte prioritare të përcaktuara nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikim Hapësinor, në bashkëpunim dhe në koordinim me sektorë të tjerë që në mënyrë direkte apo indirekte janë të lidhur me sektorin e ujërave.

Strategjia bazohet në qasje multisektoriale dhe orienton çështjet e shfrytëzimit të ujërave, mbrojtjen e ujërave dhe mbrojtjen nga ujërat.

Strategjia shoqërohet edhe me planin e veprimit dhe investimeve në ujëra, i cili identifikon projekte specifike, të cilat planifikohen të realizohen në periudha afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata.

Çështje për brengosje paraqesin investime të nevojshme në këtë sektor që kapi shumën mbi një miliard euro dhe kufizimet buxhetore për realizimin e tyre.

Sipas strategjisë, deri më tash $\frac{3}{4}$ e këtyre investimeve janë kryer nga donatorë të jashtëm.

Ky trend parashihet të zbutet, por megjithatë prapëseprapë mbetet që gjysma e investimeve të kryhet nga grandet qeveritare, kurse gjysma tjetër nga donatorët e jashtëm që shpreh pasiguri në realizimin projekteve dhe rrjedhimisht edhe të kësaj strategjie. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ganimete Musliu, nga Partia Demokratike e Kosovës, e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolege dhe ju kolegë deputetë,

Pa dashur që të përsëritëm në ato çka u tha nga parafolësit, me të cilët jemi bashkë edhe në komisionin parlamentar, por edhe si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ne e kemi shqyrtuar Strategjinë shtetërore të ujërave për Kosovën 2017-2036. Pajtohem plotësisht me të gjeturat që u përmendën nga kolegët paraprakë, konkretisht zoti Zharku dhe zoti Salih Salihu dhe gjithashtu mund të themi se edhe Këshilli Ministror, i cili ka të bëjë me Këshillin Ndërministror për Ujërat në Kosovë, ka paraqitur edhe sfidat edhe rekomandimet që duhet të marrim si shtet.

Pajtohemi të gjithë se kapacitetet ekzistuese ujore nuk i plotësojnë nevojat e tanishme dhe zhvillimore të Kosovës dhe, për më tepër, nuk mbrohen.

Unë dua të them që është mirë në të ardhmen t'i përkushtojmë shumë rëndësisë zbatueshmërisë së ligjeve, sepse thjesht kemi hapësira ligjore, të cilat nuk po gjejnë zbatim në terren, duke filluar nga inkasimi, pastaj keqpërdorimi i ujit, e kështu me radhë.

Në përgjithësi, pa dashur të ndalem tek anët teknike të përpilimit të kësaj strategjie, ftoj deputetët që ta miratojnë këtë strategji.

KRYETARI: Faleminderit! Time Kadrijaj, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Meqenëse kjo strategji është trajtuar edhe në komisionin përkatës parlamentar dhe në seancën e Kuvendit është sjellë me rekomandime për t'u votuar, edhe ne si grup parlamentar e kemi shqyrtuar, është trajtuar dhe do ta përkrahim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Enver Hoti, nga Nisma Social Demokrate.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryetar!

Ne e kemi trajtuar me kujdes strategjinë shtetërore të ujërave të Kosovës për vitin 2017-2036 dhe të gjithë ato që i ngritën kolegët e mi, i kemi trajtuar edhe në komisionin përkatës.

Ne do ta përkrahim, Grupi Parlamentar i Nisma Social Demokrate, por deri më tani si ka ndodhur menaxhimi i ujërave në Kosovë është jashtëzakonisht në pikëpyetje edhe zbatimi i kësaj strategjie.

Ne e mbështesim si të tillë, por kërkojmë që implementimi të bëhet në përpikëri, duke marrë të gjitha vërejtjet që i kanë dhënë deputetët edhe në komision. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka deputet të tjerë të paraqitur. Zonja Kusari-Lila e ka fjalën, nuk jeni paraqitur, keni menduar, e s'ka punuar teknika.

MIMOZA KUSARI-LILA: Kërkoj ndjesë, kryetar!

Së pari më duhet të them se sado që është ora e pasdites dhe në sallë nuk ka kuorum, po mendoj që për një dokument ose koncept-dokument, i cili është shumë i rëndësishëm për të ardhmen e vendit, por edhe për të sotmen dhe ka ankesa të shumta si është strategjia e ujërave, e të mos jetë as përfaqësuesi i Komisionit Funkcional, gjegjësisht kryetari i komisionit, as ministrja dhe të merret ose të kalojë veç shkarazi një dokument i cili ka peshë, së pari, e dyta, nuk e ka përmbajtjen që duhet ta ketë.

Unë po i them disa prej qëndrimeve që derivojnë nga trajtimi i strategjisë së ujërave në Kosovë, por mendoj dhe jam kundër asaj që vetëm të kalohet ose të procedohet më tutje në votim një dokument i rëndësisë së veçantë.

Që në fillim, në vendimin e kryeministrit Haradinaj, në pikën 4 ceket se strategjia e ujërave në Kosovë integron të gjitha objektivat e vendit, duke marrë parasysh rrezikun që vjen nga ndryshimet klimatike.

Ne të gjithë pajtohemi se ka efekt fenomeni i ndryshimeve klimatike, edhe pse në Kosovë impakti është më i vogël, por rreziku më i madh për ujërat në Kosovë është dhe ka qenë keqmenaxhimi dhe krimet që ndodhin në këtë sektor.

Prandaj, edhe në këtë vendim dhe në gjithë strategjinë duhej të futej edhe fjala “rreziku” nga keqpërdorimi, keqmenaxhimi dhe krimi.

Strategjia e ujërave në Kosovë në shikim të parë duket dokument shumë voluminoz dhe për shumë qytetarë dhe deputetë mund të duket edhe kualitativ, por pas leximit shihet se kjo strategji më shumë i ngjan një kronologjie me listime, me qindra lista dhe numërime të çështjeve dhe dëshirave të pafundme, se sa një dokument përmbajtjesor.

Fjalët veprim, ndalim, parandalim, menaxhim në formë copy-paste përsëriten gati në çdo dy faqe, pa dhënë asnjë shpjegim për mënyrën se si duhet të zgjidhen këto probleme.

Memorandumi shpjegues parasheh në pikën 7 se investimet në periudhën 2015-2034 në sektorin e ujit do të jenë 1,5 miliard euro.

Në faqe 187-2017, në analizën financiare dhe ekonomike janë të dhënat me mënyrën se si Qeveria mendon që këto investime t'i realizojë. Megjithatë në kalkulime parashihet që pjesëmarrja e donatorëve të jetë 50 deri në 65%.

Askund nuk shpjegohet se si Qeveria e Republikës së Kosovës duhet t'u qaset donatorëve, si do të jetë strategjia e Qeverisë që sektorin e ujit ta bëjë atraktiv për donatorë të huaj apo vendorë?

Nuk është përmendur asnjë partner strategjik, përveç Bashkimit Evropian dhe dëshirës së Kosovës që në perspektivë të jetë pjesë e Bashkimit Evropian, apo ndonjë institucion financiar ndërkombëtar, shtete, banka investive apo kompani ndërkombëtare që punojnë në industrinë e ujërave.

Strategjia e ujërave nuk mund të bazohet në donator ad hoc, sepse është vështirë të realizohet synimi mbi 50% të 1,5 miliard eurove të paraqitura në strategji.

Gjithashtu identifikohen edhe institucionet, siç janë ministria, komunat, Këshilli Ndërmintor për Ujëra, apo siç ishte task-forca, Instituti i Ujërave, Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore.

Shumica e dimë se këto pesë institucione apo tri prej tyre kanë pasur pak funksione apo aspak.

Këshilli Ndërmintor për Ujëra apo task-forca ka qenë dhe është një trup që shumë pak ka funksionuar si duhet dhe me vite nuk ka pasur bashkëpunimin që duhet me Ministrinë e Mjedisit për çështjet ujore.

Si mund të futet një organizëm si ky në listë, me kaq rëndësi, me shumë pak punë deri më tani.

Instituti i Ujërave dhe Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore ose nuk janë funksionale, ose shumë pak punë kanë bërë, e deri më tani nuk kemi hasur në ndonjë aktivitet të mirëfilltë të tyre.

Si mendohet të shkohet përpara me strategjinë e ujërave, nëse shumica e institucioneve kryesore të caktuara me ligj janë jofunksionale?

Në këtë strategji përmenden me qindra masa dhe veprime, mirëpo mënyra dhe fjalori si paraqiten në këtë dokument më shumë ngjason në një libër të shkollës fillore të gjeografisë, biologjisë apo njohuri natyrore. Vetëm një shembull nga shumë, në disa faqe masat nga vërshimet dhe erozioni listohen, si: mbjellja e drurëve, mbjellja përgjatë brigjeve, mbrojtja e pyjeve, krijimi i brezave të gjelbër, e tjerë, duke mos cekur askund se si shpjegohet mënyra teknike ose shkencore, arsyeja pse dhe benefitet e këtyre veprimeve apo masave.

Një element tjetër që mungon në strategji është roli dhe performansa e bordeve të kompanive rajonale të ujit që është shumë pak i theksuar, duke marrë parasysh rolin më tepër negativ të këtyre bordeve në punën e kompanive rajonale, tani dhe në të kaluarën. Kjo ceket shkurt në faqen 174, furnizimi me ujë në Kosovë mbetet një prej çështjeve substanciale për qytetarët dhe çdo pengesë që u bëhet kompanive rajonale nga ana e bordeve duhet të definohet mirë në strategji. Gjithashtu, shumë pak është përmendur puna e dobët dhe keqmenaxhimi me vite të tëra edhe i njësive më të vogla që bëjnë furnizimin e ujit në Kosovë. Edhe pse është strategji, nuk mund të veprohet në të ardhmen, nëse në mënyrë të qartë nuk ceken dobësitë, keqmenaxhimet në të gjithë sektorët e ujit në Kosovë. Gjithashtu, kjo strategji është e mbipopulluar me faqe me formularë dhe tabela mbi masat, veprimet dhe aksionet që duhet të ndërmerren si pjesë e paramasave dhe fizibilitetit në kuadër të strategjisë. Krejt do të ishte në rregull nëse këta formularë do të ishin komplet dhe përmbyljesor. Për fat të keq, janë të mangët, nuk janë të unifikuar, ka disa vlera të kostove të rrumbullakuara, në disa fare s'ka kosto, kurse disa janë paraqitur si minitabela.

Këto më tepër i ngjasojnë ndonjë vlerësimi nga OJQ-të e vogla vendore, sesa një dokumenti strategjik me karakter nacional. Për strategjinë e ujërave duhet të kishim një dokument që ka një plan të qartë për zhvillim, një restaurim dhe rikthim të mirëfilltë të rrjedhës së lumenjve, qasje dhe përbushje të nevojave të ujit të pijes, si dhe një qartësim në rregullimin administrativ të menaxhimit të ujërave në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka deputet për diskutim, as përfaqësues të Qeverisë. Duke e pasur parasysh se janë vetëm 51 deputetë, votohet kur të jemi 61 deputetë.

12. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për Biodiversitetin 2016-2020

Komisioni Funkcional për Bujqësi e ka shqyrtuar Planin e Veprimit për Biodiversitetin 2016-2020 dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Punës të paraqesë Planin e Veprimit për Biodiversitetin, 2016-2020. Zoti Reçica, fjala për ju!

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

Në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe në emër të Ministrisë së Mjedisit paraqes para jush Planin e Veprimit për Biodiversitetin 2016-2020.

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011-2020 paraqet dokumentin bazë planifikues të politikave për ruajtjen e biodiversitetit në Republikën e Kosovës. Zbatimi i Planit të Veprimit për Biodiversitetin është proces përsëritës dhe ciklik, ku gjendja dhe tendencat e humbjes të biodiversitetit, kërcënimet ndaj të mirave të natyrës dhe shërbimeve të ekosistemit, vlerat ekonomike dhe sociale, si dhe korniza politike mund të ndryshojë gjatë viteve, prandaj, ka nevojë për rishikim dhe përshtatjen e këtij instrumenti të politikave. Hartimi i këtij dokumenti është realizuar në pajtim me nenin 141, paragrafi 5 i Ligjit për mbrojtjen e natyrës, Ligji nr. 03/L-233. Theksoj se Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2016-2020 paraqet një dokument tejet të rëndësishëm për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor këtë dokument e ka në të gjitha agjendat, si në planet e punës, ashtu edhe në planin e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Bazuar në këtë konstatoj se ky plan është në harmoni të plotë me programin kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, politikat dhe strategjia për zhvillimin e sektorit të pylltarisë 2010-2020, strategjinë kornizë për ndryshimet klimatike 2014-2024, strategjinë e Kosovës për mjedisin 2013-2023, strategjinë kombëtare për zhvillim 2016-2021, si dhe kornizën afatmesme të shpenzimeve. Duke u nisur nga ky konstatim, edhe Kosova si shtet i ri dhe në

përmasa globale relativisht i vogël ka obligime që të kontribuojnë në ndaljen e humbjes së biodiversitetit në territorin e vet, duke zbatuar politikat efikase, si dhe duke ndërmarrë masat që biodiversiteti i Kosovës, i cili është unik dhe shumë i pasur, të mbrohet dhe të ruhet për mirëqenien e popullatës së saj.

Dëshiroj të nënvizoj se ky plan i veprimit nuk përmban projekte të mëdha, sepse dihen mundësitë financiare, por duhet filluar me gjërat më pak të kushtueshme, sepse nga përvoja e viteve të kaluara, projektet më tepër i kanë ngjarë një liste të dëshirave se sa kanë qenë të realizueshme. Plani i Veprimit për Biodiversitetin ka kaluar nëpër të gjitha procedurat e parapara ligjore, duke filluar nga faza e përgatitjes përmes një procesi transparent të konsultimeve publike, deri te marrja e opinionëve pozitive nga Ministria e Financave, Ministria e Integritetit Evropian, si dhe Zyra për Planifikim Strategjik pranë Kryeministrit. Bazuar në këtë, propozoj që të miratoni këtë Plan të Veprimit për Biodiversitetin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Salih Salihu e ka fjalën, në emër të komisionit përkatës.

SALIH SALIHU: Komisioni për Bujqësi dhe Mjedis në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 7.05.2018 e shqyrtoi Planin për Biodiversitetin 2016-2020 nga Ministria e Mjedisit dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim që të miratohet Plani i Veprimit për Biodiversitetin, 2016-2020.

Ndërkaq, duke folur në emër të grupit tonë, pra në fakt, dokumenti është i shkruar mirë, është shumë përmbajtësor dhe i përpunuar, mirëpo dokumente të shkruara po krijojmë shumë mirë, bukur, ndoshta kësaj radhe me përmbajtje, por problemi është se në praktikë këto plane të veprimit nuk po zbatohen. Ne e dimë se sot kemi në Kosovë mijëra e mijëra hektarë pyje të shkatërruara, kemi kodra të shkatërruara nga gurthyesit, kemi lumenj të shkatërruar nga shfrytëzimi i paligjshëm, domethënë i zhavorrit dhe kemi lëvizje të rinjve nga fshati në qytet dhe krejt këto ndikojnë në prishjen e biodiversitetit në Kosovë.

Pra, krejt ky dokument, ky Plan i Veprimit të Biodiversitetit tenton që thjesht përmes krijimit të zonave të mbrojtura të ruhet biodiversiteti, por biodiversitetin nuk mund ta mbrosh vetëm kur krijon zona të mbrojtura, sepse është pjesa më e madhe e territorit, e cila nuk është zonë e mbrojtur dhe, në qoftë se nuk ka një funksionim të ndërsjellë, ndërministror për të zbatuar ligjin, për të mbrojtur pyjet, lumenjtë, për të mbrojtur kodrat, atëherë natyrisht që në praktikë do të kemi një shkatërrim të biodiversitetit dhe kjo natyrisht që është shumë e dëmshme, nuk do të kemi as florë, as faunë, domethënë aty ku ka qenë për shkak se, për shembull, nga prerja ilegale e drurëve më nuk do të kemi faunën në ato vende, por sot pyjet e Kosovës janë shndërruar më tepër në kullosa, por për fat të keq, pa blegtori. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, Lutfi Zharku.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, kryetar!

Ministër,

Kolegë deputetë,

Ato që i përmendi kolegu Salihu, në realitet pra plani i veprimit është bërë në përputhje dhe është pjesë e strategjisë, por që në parim është bërë me një bazë që nuk ekziston, apo me një bazë shumë të dobët, për shkak që nuk ekziston inventarizimi i florës dhe faunës në vendin tonë.

Në anën tjetër, gjatë shqyrtimit në komision është paraqitur dilema se a duhet Plani i Veprimit të aprovohet apo jo si i tillë, për shkak se ligji nuk e përcakton në mënyrë të qartë aprovimin e tij, duke marrë parasysh se në vitin 2011 është aprovuar strategjia për biodiversitet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Musliu e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Planin e Veprimit për Biodiversitetin për vitin 2016-2020 dhe vlerëson se ky plan është i hartuar mirë. Krejt çka kërkojmë si grup parlamentar është, meqë zoti Reçica na e lexoi raportin e këtij Plani dhe na rekomandoi për ta votuar, edhe unë i kërkoj zotit Reçica që t'ia bartë porosinë ose selamin ministres së Ambientit dhe Mjedisit, do të thotë zonjës Reshitaj, që këto çështje çka janë të shkruara këtu, t'i implementojë në realitet, sepse fatkeqësisht natyra në Kosovë ka degraduar, duke filluar nga mbeturinat e shumta që përballemi çdo ditë, prishja e shtretërve të lumenjve, gurthyesit ilegalë, e të mos i përmend me rend tash, sepse me të vërtetë realiteti në të terren qëndron krejt ndryshe nga ky plan i shkruar që na u ka ofruar neve për ta votuar.

Si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës do t'i japim mbështetje këtij plani, por megjithatë kërkojmë zbatimin në praktikë të këtij plani në përgjithësi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Time Kadrijaj, nga Grupi Parlamentar i AAK-së.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Ashtu qysh e thanë edhe parafolësit, ky Plani i Veprimit të Biodiversitetit është shqyrtuar në komisionin parlamentar, ka marrë dritën jeshile me notë pozitive që të silltet në seancën e Kuvendit të Kosovës, por të gjithë anëtarët e komisionit kanë ankesa për moszbatim të këtij plani. Është mënyra që deputetët, komisionet parlamentare e mbajnë dhe e mbikëqyrin, përpos amendamentimit të ligjeve, e kanë për detyrë edhe mbikëqyrjen e implementimit të ligjeve në praktikë dhe ka forma që edhe ky plan i veprimit të mbikëqyret se a po zbatohet apo nuk po zbatohet.

Aleanca e ka shqyrtuar dhe do ta përkrahë këtë plan.

KRYETARI: Faleminderit! Enver Hoti, nga Nisma Socialdemokrate!

ENVER HOTI: Faleminderit, kryetar!

Planin e Veprimit për Biodiversitetin 2016-2020 e kemi trajtuar, po ajo çka është me rëndësi ndoshta që mendoj ta theksoj në Kuvend është se në këtë paraqitje janë disa informacione jo shumë të plota për neve. Bie në sy që ky plan dhe strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitet 2016-2020 është miratuar në vitin 2011 dhe nëse shikojmë ashtu, në implementimin e kësaj strategjia dhe planit të veprimit kemi pasur vështirësi ligjore. Bie fjala, diku një grup e ekspertëve e cek atje shkakun që korniza afatmesme e shpenzimeve është trevjeçare. Si të realizohet një plan i veprimit për dhjetë vjet me radhë? Kjo ndoshta ka qenë njëra prej pengesave që është shfaqur në këtë strategji.

Po ashtu, kemi edhe çështje të tjera ligjore, siç është Ligji për pyjet, Ligji për gjueti dhe moszbatimi i ligjeve në fuqi në mbrojtjen e kësaj çështje dhe kësaj strategjie dhe planit të veprimit. Prandaj, parafolësja më herët lidhur me strategjinë për ujërat pati të drejtë deri diku në strategjinë, por vetëm dua ta kujtoj se do të ishte në qeveri atëherë kur është miratuar kjo strategji dhe ky plan i veprimit, i cili dua të them sinqerisht këtu, anëtarët e komisionit që kemi qenë në komision, deputetët e dinë, përfaqësuesi i Qeverisë apo i ministrisë në fjalë na tha që këtë plan e keni votuar vetë në vitin 2011 dhe ia pafshi hairin, edhe pse ka pasur disa gabime dhe nuk kanë qenë syçelë deputetët. Prandaj, unë dua t'i ngre këto çështje, të cilat po e bëjnë vështirë të zbatueshëm këtë plan të veprimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, kolegë deputetë për kontributin!

Nuk ka deputetë të paraqitur, përfaqësuesi i Qeverisë nuk e ka kërkuar fjalën. Në momentin kur jemi 61 deputetë, e vëmë në votim.

13. Shqyrtimi i raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2017

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim. Ftoj zëvendëskryetarin e Komisionit Funkcional, zotin Dardan Sejdiu, për arsyetimin e raportit me rekomandime. Nuk qenka, përfaqësues të grupeve parlamentare, Dardan Sejdiu erdhi, ju lutem!

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar raportin në fjalë dhe i kemi dhënë dy rekomandime, të cilat po besoj i keni edhe ju përpara.

Rekomandimi i parë është që në raportet vijuese të përfshihen detaje për afatet e kohëzgjatjes së licencave dhe kapaciteteve të instaluara. Dhe, rekomandimi i dytë është të shtohet kontrolli i licencave preliminare. Në parim, ne si komision jemi dakord me raportin i cili është dorëzuar dhe i kemi dhënë këto dy rekomandime. Faleminderit!

KRYETARI: A ka mundësi edhe për qëndrimin e partisë suaj, në të njëjtën kohë!

DARDAN SEJDIU: Atëherë, faleminderit!

Viti 2017 është karakterizuar me një situatë dramatike sa i përket sektorit të energjisë, edhe pse në momentin e fundit janë bërë disa zgjidhje ad hoc, nuk është se kjo situatë pasqyrohet qartë në raport. Raporti ka të dhëna që përgjithësisht lidhen me aktivitetet dhe raportimi i këtyre aktiviteteve është në rregull, por mungon analiza më e gjerë lidhur me vendimet e marra dhe ndikimin që ato do të kenë në veprime për përmirësimin e tregut të energjisë.

Edhe në këtë raport shihet fatkeqësisht që politikat që i ka ndërmarrë kjo zyrë kanë vazhduar t'i shërbejnë më shumë një kompanie private, se sa interesit publik. Me privatizimin e rrjetit të shpërndarjes premtosej furnizim i rregullt me energji elektrike, investime në rrjet, ulje të humbjeve teknike dhe ulje të çmimit. Por, pak nga këto janë realizuar dhe pas shumë vjetësh ende kemi vazhdimësi të ndërprerjeve dhe rritje të humbjeve. Shihet se humbjet teknike për vitin 2017 arrijnë vlerën prej 12.28%, që është rritje. Gjithashtu vërehet që shumë punë kanë mbetur pezull për shkak të mungesës së vendimmarrjes, pra kemi pasur vonesë të votimit të Bordit të ZRRE-së, dhe meqë Bordi i ZRRE-së nga maji i vitit 2017 ka mbetur vetëm me dy anëtarë, vërehet ulje drastike e lëshimit të autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese sa u përket burimeve të ripërtrishme në energji.

Do të ishte jashtëzakonisht e rëndësishme që në këto situata të mos na përsëriten në të ardhmen, sepse po kemi dëme. Te burimet e ripërtërishme të energjisë krejt janë investitorë privatë, pra krejt janë fonde private dhe sa më shumë kemi zvarritje në vendime, aq më shumë ka potencial që këta investitorë të mos qëndrojnë dhe të lypin hapësira të tjera për të investuar mjetet e tyre. Për shembull, në vitin 2016 ZRRE ka lëshuar 23 autorizime preliminare, kurse në vitin 2017 vetëm 7. Pra, po ashtu në raport thuhet që në mungesë të Bordit nuk ka pasur mundësi të vendoset për tarifën e energjisë elektrike për sezonin 2017-2018 dhe rrjedhimisht ato kanë mbetur të njëjta. Unë mendoj që ky raport gjithashtu duhet të përfshijë një tabelë të detajuar të licencave, në të cilën përfshihen kohëzgjatja e afateve të secilës prej licencave dhe kapacitetet e instaluara dhe kjo është një prej rekomandimeve që e kemi dhënë edhe si komision.

Në përmbajtje të raportit apo edhe në shtojcat e këtij raporti duhet paraqiten të gjitha licencat aktive të lëshuara. Pra, kohëzgjatja e tyre dhe koha kur do të skadojnë. Gjithashtu, për operatorët, të cilët janë në fazën preliminare të marrjes së licencës duhet cekur në raport kur priten dhe çfarë pritet të kenë megavat orë të prodhuara. Pra, sa do të futen në sistemin energjetik. Besoj që këto

informata janë tepër të rëndësishme, meqë këtu e shohim saktë se ku qëndron sektori në përgjithësi, dhe se a ka nevojë të bëhen ndryshime të atilla që të mundësojnë zhbllokimin e kapaciteteve në fushën e energjisë të ripërtëritshme. Gjatë muajit prill të vitit 2017, ZRRE ka ndryshuar strukturën tarifore me pakicë në sektorin e energjisë elektrike, kjo strukturë apo ky propozim bën heqjen e tarifave sezonale dhe bllok tarifave dhe mbajtjen e tarifave të larta dhe të ulëta ditë dhe natë. Hulumtimet nga organizatat e shoqërisë civile kanë treguar që struktura e re e propozuar rrit çmimin e energjisë për shtresën më të ndjeshme të shoqërisë, të cilat në mungesë të kushteve financiare kujdesen që të kursejnë energjinë elektrike. ZRRE nuk është treguar aq e sinqertë sa u përket kategorive të varfra të shoqërisë dhe nuk ka treguar se cilat do të jenë efektet në tarifa.

Gjithashtu, struktura e re tarifore nuk ofron insentiva për bizneset e vogla dhe të mesme, një pjesë e madhe e të cilave kryejnë aktivitetin e tyre biznesor kryesisht gjatë muajve të verës dhe me tarifa të reja pritjet që një pjesë e madhe e bizneseve të ketë rritje të faturës sa i përket energjisë elektrike. Pra, një kosto shtesë për bizneset e vogla dhe të mesme, prej të cilave ne presim rritjen e tyre dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Me ndryshimin e strukturës tarifore është rritur edhe çmimi mesatar i energjisë elektrike, këtë shqetësim e ka vërtetuar edhe raporti vjetor. Çmimi mesatar i energjisë elektrike për konsumatorët familjarë është ngritur nga 5.71 në 6.04 cent për kilovat orë dhe për konsumatorët jofamiljarë nga 7.92 në 7.94 cent për kilovat orë. Në faqen 62 të raportit përgëzohet nënshkrimi i kontratës për termocentralin e ri, që konsiderohet një kontratë shumë e dëmshme për shtetin e Kosovës.

Në fakt, në këtë raport është vetëm një paragraf sa i përket termocentralit “Kosova e Re” dhe në mbledhjen e fundit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, e këtë po e them për diskutim dhe për hir të informacionit të publikut, unë kam kërkuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë që të na sjellë një analizë mbi implikimet e termocentralit të ri, kontratës së nënshkruar për termocentralin e ri në tarifat e energjisë elektrike. Dhe, për të qenë korrektë, ata na e kanë dorëzuar këtë raport dhe raporti konstaton që me kontratën e nënshkruar me Contour-Global, çmimi i energjisë elektrike ngrihet për 51,9%. Pra, në vitin 2023, edhe ZRRE-ja e konfirmon që çmimi i energjisë elektrike rritet për 51%.

Përfundimisht, raporti i ZRRE-së përmban informacione, por këto informacione nuk e pasqyrojnë situatën e qartë dhe të saktë energjetike. Ka përshkrim të licencave, por asnjëherë nuk ka raportim të saktë për MWh, sa zgjasin këto licenca, kur do të implementohen këto licenca dhe kur shndërrohen këto licenca, apo kur futen këto licenca si MWh faktike në tregun energjetik të Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, ne si grup parlamentar, pra Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate do të votojmë kundër raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Lidhja Demokratike e Kosovës nuk është lajmëruar askush. Nga Partia Demokratike e Kosovës, Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Raporti vjetor i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë përmban informata për aktivitetet e ndërmarrja dhe rezultatet e arritura në lidhje me fushëveprimin e këtij rregullatori, si dhe analizën rreth aktiviteteve të ndërmarrjeve nga fusha e energjisë, sipas të dhënave të të licencuarve. Po ashtu, ky raport e pasqyron zhvillimin e përgjithshëm të tregut të energjisë në Kosovë.

Në vijim unë do t'i theksoj vetëm disa nga pikat e trajtuara në këtë raport. Siç shihet këtu, edhe pse në Kosovë për furnizim të konsumatorëve me pakicë ka të licencuar tre furnizues, i tërë furnizimi i konsumatorëve në vend është bërë vetëm nga KESKO, ndërsa furnizuesit e tjerë të licencuar gjatë tërë vitit kanë qenë pasivë sa i përket furnizimit të konsumatorëve.

Ne e mirëpresim hapjen e tregut me shumicë, megjithatë edhe hapja apo zgjerimi i tregut me pakicë do të ishte i mirëseardhur dhe në funksion të krijimit të mundësive më diverse për furnizim të konsumatorëve. ZRRE-ja duhet të angazhohet që të krijojë një hapësirë konkurruese edhe në këtë drejtim. Një element pozitiv që ceket në raport lidhur me sektorin e energjisë është interesimi për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme, edhe pse shikuar në përqindje gjenerimi i tillë është shumë i paktë dhe larg nga objektivat e parapara në dokumentet strategjike të miratuara nga Qeveria dhe Kuvendi.

Një sfidë shumë e rëndësishme që ka pasur Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka qenë ballafaqimi me vendimin për masën e përkohshme të Gjykatës së Apelit lidhur me trajtimin e energjisë së pafaturuar në katër komunat në veri të vendit. ZRRE e ka respektuar vendimin në fjalë, por që ende nuk është gjendur një zgjidhje ligjore afatgjatë për adresimin e duhur të kësaj çështjeje, për çka besojmë se kërkohet një përfshirje më e gjerë institucionale.

Konsiderojmë se ndryshimi i strukturës tarifore nga 1 prilli 2017, kur është bërë largimi i tarifave sezonale dhe bllok-tarifave, duke mundësuar një tarifë të njëjtë për tërë vitin, ka qenë vendim i duhur, gjë që është reflektuar edhe në fatura më të përballueshme për qytetarët, pa dallime të mëdha në stinë të ndryshme, siç ka pasur në të kaluarën. Rënia e numrit të ankesave të konsumatorëve për rreth 20,6%, sipas raportit në vitin 2017 krahasuar me vitin paraparak, është një tregues i përmirësimit të furnizimit me energji elektrike. Megjithatë, ZRRE-ja edhe më tutje duhet të angazhohet që të minimizohen arsyet për ankesa të konsumatorëve, gjë që ndërlidhet me një mbikëqyrje më efektive ndaj operatorëve të energjisë në vend.

Sipas raportit, humbjet në rrjetin e transmetimit janë në nivel të pranueshëm, ndërsa humbjet në rrjetin e shpërndarjes janë mjaft të larta. Zyra e Rregullatorit të Energjisë duhet të angazhohet që

të zvogëlohen humbjet teknike dhe komerciale, pasi kostoja e humbjeve mbulohet nga konsumatorët që janë pagues të rregullt të energjisë elektrike dhe e paraqesin një ngarkesë shtesë për këta konsumatorë.

Si përfundim, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, ju njoftoj se ne do ta mbështetim raportin e ZRRE-së për vitin 2017, por gjithsesi duke përfshirë edhe rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL.

KRYETARI: Faleminderit! Nga Lëvizja Vetëvendosje, Arbërie Nagavci, në emër të grupit.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar qytetarë,

Kolegë deputetë,

Edhe sivjet, sikur viteve të kaluara, raporti i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë po e ndërron formatin e raportimit. Kështu mundësohen dhe sigurohen që krahasimet vjetore të bëhen gjithnjë e më të pamundura dhe jo vetëm më të vështira. Kjo veçanërisht vihet re te paraqitja e humbjeve teknike e komerciale, por edhe te monitorimi i punës së KEDS-it dhe zbatimi i detyrimeve që Limak&Çalik ka ndaj qytetarëve.

Në asnjë raport, e as në këtë, nuk ka një listë të qartë e të vërtetueshme për investimet sipas kontratës që Qeveria e Kosovës e bëri kur e shiti për 26 milionë euro KEDS-in. Ne, pra Lëvizja Vetëvendosje, vazhdimisht ka raportuar se në terren punonjësit e KEDS-it po njoftojnë që investimet e supozuara janë vetëm një sajim, diku me pajisje thjesht të riparuar, e diku vetëm si investim, të cilave u rritet artificialisht kostoja. Por, ZRRE-ja asnjëherë dhe as në kërkesat tona publike nuk u përpoq as të hulumtonte për këtë dhe as të kërkonte përgjegjësi ndaj KEDS-it, e as të raportonte në Kuvend në mënyrë të qartë se çfarë po ndodh.

ZRRE-ja për gjithë këto vite e ka mashtruar Kuvendin dhe ka shkelur ligjin dhe Kushtetutën sa i takon vendimit për të na shpërndarë të gjithë neve që paguajmë rrymën ato që quhen në mënyrë absurde “humbje komerciale”, pra vjedhjet dhe mospagimi i rrymës nga qytetarët serb të Kosovës në komunat e veriut të vendit. Përgjatë këtyre viteve, në mënyrë të vazhdueshme kemi kërkuar në takime publike e zyrtare nga ZRRE-ja që të shpjegojë sesi e ka marrë këtë vendim. Ata janë përgjigjur se Kuvendi ia ka miratuar dhe kryesisht i janë referuar këtij votimi që ndodh për raportin e tyre.

Kjo, jo vetëm se është një shkelje e rëndë, e cila tashmë është vërtetuar edhe nga Institucioni i Avokatit të Popullit dhe nga gjykata, por po tentohet që sërish të kalohet në këtë raport. Pse ka kategori “humbje komerciale”? Ato thjesht janë vjedhje. Pse duhet t’ia paguajmë ne KEDS-it rrymën që e vjedhin jo qytetarët e thjeshtë dhe ata me gjendje të vështirë ekonomike, por ata që janë uzurpatorë apo abuzues, pra të fortët e privilegjuar nga vetë KEDS-i? A nuk na u tha që

prandaj po privatizohet KEDS-i, në mënyrë që çdo borxh të mblidhet dhe që humbjet të reduktohen? Si u bë tash, që 17,03% e rrymës që shpërndan KEDS-i, e që vidhet, e paguajnë të gjithë qytetarët që paguajnë rrymën rregullisht? Po e citoj një paragraf nga raporti për vitin 2017, “Humbjet në rrjetin e transmetimit janë në nivel të pranueshëm, ndërsa humbjet në rrjetin e shpërndarjes janë mjaft të larta, humbjet teknike arrijnë vlerën 12,28%, kurse konsumi i paautorizuar i energjisë (më tutje në tekst: humbjet komerciale) përbëjnë 17,03% të kërkesës në shpërndarje, prej të cilës energjia e pafaturuar në pjesën veriore të Kosovës përbën 5,31%”. Pra, ceket qartë që konsumi i paautorizuar i energjisë, përkatësisht vjedhja, është emërtuar me emrin “humbje komerciale”.

Nëse i krahasojmë tabelat që janë paraqitur në të dhënat kryesore të realizuara në vitin 2017, nëse e krahasojmë me bilancin e vitit 2017 dhe me realizimin në vitin 2016, vihet re se ndër vite energjia e faturuar ka pasur një rritje të vazhdueshme, e posaçërisht rritjen më të theksuar e ka pasur në arkëtim, që arrin në 99,09% për konsumatorët e kyçur në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes.

Njëjtë edhe për humbjet teknike, ZRRE-ja ende nuk ia lejon në normë të lartë justifikimin e humbjeve teknike KEDS-it. Pra, edhe sa vite i duhet KEDS-it që ta riparojë rrjetin dhe të sjellë në gjendje e në kuota normale e të pranueshme humbjet teknike? Së pari, ia keni siguruar fitimin abuziv Limak&Çalikut me shitjen arbitrare të gjitha asetëve të KEDS-it, përfshirë këtu edhe hidrocentralet, për të cilat ish-ministrat janë deklaruar se nuk e dinin që po shiten edhe hidrocentralet.

Së dyti, ia keni siguruar rritjen e çmimit për katër herë gjatë kësaj kohe, së treti ia kemi miratuar kërkesën që në bilancet e tyre mos të ketë asnjë shenjë të humbjeve teknike të ashtuquajturave “humbje komerciale”, duke ua marrë të gjithë qytetarëve tjerë në fatura. Së katërti, keni lejuar që investimet privatizuesi t’i bëjë vetëm ty ku ka interes komercial, duke lënë kështu në mëshirë të fatit qindra familje në zona të largëta, ku ata nuk kanë parë interes për veten e tyre. Së pesti, i keni lejuar që ta ndërpresin rrymën me justifikimin fals gjithandej Kosovës, pikërisht në muajt më të vështirë të dimrit. Së gjashti, as nuk ka një penalitet të vetëm nga ZRRE-ja për Limak&Çalik për mospërbushje gati totale të kontratës dhe detyrimeve që ka pasur për investime. Së shtati, punëtorët e mbetur në ndërmarrjen e privatizuar kanë gjashtë vjet që shantazhohen vazhdimisht me largim nga puna, e shumë prej tyre tashmë edhe janë larguar arbitrarisht, e askush nga kjo qeveri dhe as nga e kaluara nuk është shqetësuar për ta, ani pse ministri asokohe i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj, i cili edhe sot është ministër në këtë Qeveri, përmendte vazhdimisht dhe thoshte se i siguruan punëtorët dhe se asnjë nga punëtorët nuk do të ketë pasoja.

ZRRE-ja do të duhej të kishte paraqitur në raport që ky shërbim jetik për Kosovën nuk po funksionon me kompaninë private në asnjë nga termet e kontratës. Por, në këtë raport janë vetëm

sqarimet formale për përparime formale për një gjendje anormale të situatës në sektorin e energjetikës. Njëjtë në raport nuk vërehet të adresohet problemi i shkaktuar nga nënshkrimi i marrëveshjes me Contour-Global. ZRRE-ja duhet të raportojë në këtë Kuvend për këtë çështje dhe duhet të marrë qëndrim në favor të interesit publik. Përndryshe, pse është e nevojshme të ekzistojë ky rregullator nëse nuk e ka parasysh interesin publik?

Do ta citoj edhe një pjesë nga raporti për gjendjen e investimeve në KEK. Për KEDS-in nuk ka vërejtje për investime, ndërkaj për KEK-un paraqiten të gjitha problemet. Të dhënat e dërguara nga KEK-u paraqesin një gjendje jo të kënaqshme të investimeve të realizuara për periudhën katërvjeçare. Nga vlera e përgjithshme e lejuar e investimeve për KEK-un në të gjitha divizionet janë realizuar 101,4 milionë euro, apo të shprehura në përqindje 48,7%. Dhe tabela e paraqet periudhën njëvjeçare, prej 1 prillit 2013 - 31 mars 2017, dhe shihet se pas llogaritjeve për këto vite, pas përshtatjes nga mosrealizimi i investimeve rezulton se duhet kompensuar konsumatorët në vlerën prej 21 534 381 euro.

ZRRE-ja i ka analizuar disa mënyra të përshtatjes së kostos kapitale të KEK-ut, në mënyrë që të kompensohen të gjithë konsumatorët që e kanë paguar këtë kosto përgjatë viteve 2013-2016 nëpërmjet faturave të energjisë elektrike. ZRRE-ja ka vlerësuar se mënyra më e drejtë e kompensimit të konsumatorëve është nëpërmjet sistemit të transmetimit, me ç'gjë do të përfitonin të gjithë konsumatorët, pavarësisht nivelit të tensionit dhe nivelit të rregullimit. Ashtu pra siç u cek, tashmë veç ka filluar derregullimi i çmimeve me pakicë të konsumatorëve të kyçur, si dhe konsumatorëve të tjerë. Kompensimi nëpërmjet furnizuesit do të jetë shumë i vështirë të realizohet, edhe pse është planifikuar dhe është përshkruar këtu.

Duhet theksuar se KEK-u do të duhej t'i kthejë të hyrat për pjesën e zhvlerësimit dhe kthimit të pranuar për investimet e parealizuara të përshtatura për normën e interesit për periudhën prej dy vjetësh. KEK-u do ta furnizojë KOST-in me energji për nevojat e sistemit të transmetimit pa kosto si formë e kompensimit për konsumatorët. Sasia e parashikuar e nevojave të sistemit të transmetimit për mbulimin e humbjeve për energji për vitin rregullativ 2017-2018 është e parashikuar të jetë 360 MW, ndërsa KEK-u duhet të furnizojë të paktën 302 MW për KOST-in, në mënyrë që të kompensojë 10,7 milionë euro në vitin e parë, pra në periudhën prill 2017 - mars 2018, nga shuma e përgjithshme që duhet të kthehet. Ndërsa, pjesa e mbetur nga vlera prej 21,5 milionë euro do të kthehet në vitin e dytë, duke marrë parasysh sasinë e energjisë dhe çmimet e tregut për blerjen e energjisë në tregun me shumicë.

Kështu, duke filluar nga 1 prill 2017, KEK-u ka pasur disa opsione të shitjes së energjisë elektrike në tregun vendor. Shitjet e energjisë elektrike të prodhuara nga KEK-u janë realizuar me këto çmime të tregut. Shitjet e energjisë për furnizimin e konsumatorëve me shërbim universal me çmim prej 28,6 euro, ato të konsumatorëve të kyçur në nivelin e tensionit 110 Kv me çmim prej 35,4 euro dhe shitje të energjisë së KOST-it dhe KEDS-it për mbulimin e

humbjeve në rrjetin e tyre me çmim prej 35,4 euro. Ndërkaq, shitjet si eksport i energjisë me çmim prej 37,8 euro. Pra, këto shifra flasin vetë, andaj Lëvizja Vetëvendosje nuk e mbështet këtë raport dhe do të votojë kundër dhe do të vazhdojë të kërkojë përgjegjësi edhe prej ZRRE-së për mosmbrojtjen e interesit publik. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Muharrem Nitaj nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, dhe pastaj Bilall Sherifi.

MUHARREM NITAJ: Zoti kryetar, a jeni lodhur, a jo?

Unë nuk e kam ndonjë fjalë të shkruar prej specialistëve të energjisë për t'i shpenzuar dhjetë minuta këtu. Por, e kemi diskutuar në grup raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2017 dhe ne e mbështetim.

Por, kjo nuk ishte arsyeja kryesore, sepse kjo është bërë tashmë si një kornizë e paracaktuar se secili grup parlamentar i ka shqyrtuar në zyrat e veta këto raporte dhe të gjithë e kanë përgjigjen që është uniforme, që i mbështetin, e do ta japin kontributin e tyre më vënë a më herët, në komision, e tjerë, e tjerë... Por, arsyeja ime pse e mora fjalën më tepër, zoti kryetar, është nëse po e vazhdojmë mbledhjen apo e ndërpresim, sepse po më duket që s'ka asnjë kuptim në këtë përbërje që ta vazhdojmë. Deputetët po ikin njëri pas tjetrit. Ndoshta dikush është me ramazan, dikush ka obligime tjera. E kam përshtypjen që nuk po dalim shumë seriozë me këtë formë të punës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Bilall Sherifi, fjala për ju!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Sa u përket raporteve që vijnë nga agjenci të tilla të pavarura, siç është ZRRE-ja, më shumë do t'i quaja informata sesi ata e kanë zhvilluar aktivitetin e tyre, se cila është gjendja e vendit në rrafshin e energjisë elektrike, se çka kanë bërë ata në rrafshin e kompetencave që i kanë, se sa një raport të cilin ne duhet ta shqyrtojmë dhe pastaj të japim rekomandime se si të dilet nga gjendja, sidomos në rrafshin e humbjeve, siç u tha teknike, për të cilat kostoja fatkeqësisht shkon te konsumatorët.

Unë mendoj që ne informatën e kemi lexuar, e kemi analizuar në grup dhe e miratojmë ne këtu apo jo, atyre nuk u bëhet shumë vonë, sepse nuk ka një relacion të tillë që nëse nuk e miraton do të kishte pasoja pastaj. Nuk ka askush pasoja nga këto raporte, të cilat vijnë në Kuvend. Ne i dëgjojmë, i themi mendimet tona, i themi këndvështrimet tona, por ata vazhdojnë pastaj sërish të funksionojnë si një mekanizëm i pavarur, siç kanë dëshirë ta quajnë veten të gjitha agjencitë, dhe duke e pasur këtë parasysh që thashë, mendoj që informatën e kemi marrë. Nuk jemi të kënaqur me gjendjen në të cilën është energjia elektrike, për aq sa ka të bëjë me furnizimin me energji elektrike, me mënyrën si ata e kanë kryer punën e tyre, por tash krejt çfarë ne mund të bëjmë

këtu, është të themi se është keq apo është mirë gjendja. Fatkeqësisht, është e keqe, të gjithë e dimë.

Në emër të Nismës, unë vetëm mund të konkludoj që raportin e kemi marrë, deputetët e kanë lexuar. Nuk di nëse ia vlen këtu të themi se e mbështetim apo nuk e mbështetim këtë raport. Krejt çfarë mund të them është se ashtu siç konstaton raporti, gjendja në këtë fushë nuk është e mirë. Duhet të punojmë më shumë, në veçanti Qeveria, që të dalim nga kjo gjendje e rëndë që ka të bëjë me energjinë, edhe pse 18 vjet pas luftës nuk kemi arritur ta krijojmë një pavarësi të qëndrueshme në prodhimin e energjisë elektrike. Kështu që në emër të Nismës mund të konstatoj që e kemi marrë raportin dhe po u besojmë atyre që gjendja është e rëndë. Kaq! Dhe, nuk kam parë që ata kanë dhënë në raport ndonjë sugjerim se çka kërkojnë nga ne. Ata thjesht na e kanë sjellë raportin si informatë, në daçit merreni, në daçit mos e merrni, por gjendjen nuk mund ta ndryshojmë sa i përket së kaluarës. Ajo që ne mund të bëjmë është si t'i qasemi kësaj çështjeje për të tashmen dhe të ardhmen e energjisë, prodhimit dhe distribuimit të energjisë elektrike në vend. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka deputetë të tjerë të lajmëruar për diskutim. Përfaqësuesi i Qeverisë nuk e ka kërkuar fjalën.

Edhe këtë pikë të rendit të ditës do ta hedh në votim në momentin kur t'i kemi 61 deputetë në sallë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Jemi në momentin deri kur kemi punuar goxha shumë. Në qoftë se dëshironi, mund ta bëjmë ose një pauzë, ose e ndërpresim për sot. E vazhdon pastaj Kryesia. Ju e vendosni, kjo është vendimmarrja juaj. E shohim nesër, në qoftë se dëshironi vendos seanca.

Jo, nesër para orës 16:00 nuk kemi mundësi, se Kuvendi do të jetë për Diasporën, ta kini parasysh është një organizim i Kuvendit me Diasporën. Në orën 16:00 e kemi seancën, pastaj kur të jemi në seancë vendosim bashkërisht për vazhdimin e seancës menjëherë pas saj. Do të ishte ideale t'i përfundojmë edhe këto që na kanë mbetur.

Do ta vë në seancë si vazhdim, në qoftë se ju vendosni. Faleminderit për kontributin dhe durimin. Atyre që kanë agjësuar, Zoti ua shpërbleftë! Faleminderit!

* * *

E mërkurë, më 30 maj 2018

Vazhdimi i mbledhjes, e filluar më 17 maj 2018

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk ka qeveritarë,

I hap punimet për vazhdimin e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës me pikat e papërfunduara nga seanca plenare, më 17 maj 2018, si në vijim:

10. Votimi i Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, 2018-2022

Të nderuar deputetë,

Diskutimet për pikat e rendit të ditës 1, 2, 3 dhe 4 kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur 17 maj 2018, por për mungesë të kuorumit nuk kanë përfunduar procedurat për votim.

Vazhdojmë me votimin e Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, 2018-2022.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Edhe një herë, kolegë deputetë,

Janë 59 deputetë, dy nuk kanë votuar, 67 deputetë janë në sallë.

Një me dorë, a kemi të tjerë me dorë?

Ka përfunduar debati, i kemi rreth 70 pika, të cilat janë duke pritur, ne vetëm po riciklojmë, duhet t'i përfundojmë në bazë të Rregullores, flisni pastaj. Zoti Kurteshi, urdhëro, po e kemi përfunduar debatin.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Në seancën e fundit ne kemi filluar një diskutim për këtë çështje, edhe nëse unë e kam kuptuar drejt, nga të gjitha grupet parlamentare, gati pa asnjë përjashtim, tash nuk i mbaj në mend të gjitha, është kërkuar që diskutimi për këtë çështje të shtyhet për seancën e radhës.

Na i jepni procesverbalet, na i jepni të gjitha dokumentet, t'i dëgjojmë dhe të shohim që diskutimi për këtë çështje nuk ka përfunduar. Nga të gjithë është kërkuar, meqenëse kjo është një çështje shumë serioze që diskutimi të vazhdojë edhe për shkak të mungesës së kuorumit në mbledhje. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Në seancën e fundit është e vërtetë se ka pasur propozime të tilla, për aq sa është e vërtetë që kemi shkuar deri në fund me debatin për çështjen e votimit të Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshje së Stabilizim-Asociimit, dhe në bazë të procedurave, Rregullores dhe me vendimin e kësaj seance kjo çështje ka përfunduar në seancën e kaluar. Në qoftë se është qëllimi të mbajmë me çdo kusht, publikisht po e them, të bllokohet agjenda përmes debateve e interpelancave, siç është duke ndodhur, ne mund të qëndrojmë, përgjegjësia u bie atyre që iniciojnë.

Aktualisht në Kuvendin e Republikës së Kosovës janë diku rreth 75-76 pika. Në momentin kur futemi në seancë, deputetët lodhen e largohen, thonë nuk ka kuorum. Në moment kur fillojmë të marrim vendime, nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje, në momentin kur mbajmë seanca shumë, thonë jemi lodhur, se shumë seanca, në momentin kur nuk kryhet asnjë çështje, thuhet se s'po mund të kryejmë asgjë. Kjo është vendimmarrje e këtij Kuvendi.

Seanca e përcakton, tek e fundit, me gjashtë nënshkrime ose 40, edhe një herë e fillojmë, e riciklojmë debatin për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

Zoti Hoti e ka fjalën, zoti Sejdiu pastaj.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Lidhur me këtë pikë ka qenë kërkesë e grupit tonë parlamentar që në mungesë të Qeverisë, ministres për Integrim dhe të kryeministrit për të diskutuar në detale këtë Program Kombëtar për MSA-në, ju nuk e keni nxjerrë në votim atë ditë. Pra, keni të drejtë, është përmbyllur debati, e keni përmbyllur debatin për këtë dhe sot është veç votimi.

Unë ju informoj që ne tashmë e kemi dorëzuar kërkesën për interpelancë me ministren e Integritimeve Evropiane për të shqyrtuar zbatimin e MSA-së në tremujorin e fundit të vitit të kaluar dhe në tre muajt e parë të këtij viti.

Kështu që besoj që këtë debat do ta zhvillojmë prapë, kur t'i vijë radha asaj interpelance. Po ajo që ka plotësisht të drejtë deputeti parafolës, është që një çështje kaq e rëndësishme është kaluar në Kuvend në mungesë të plotë të Qeverisë. Faleminderit!

KRYETARI: Para se ta marrë fjalën zoti Sejdiu, pak sqarim.

Nuk është çështje se unë nuk e kam hedhur në votim, po në momentin kur unë e shoh se në seancë nuk janë 61 deputetë, i nderuar kryetar i grupit parlamentar, kot votojmë, se nuk ka vlerë.

Edhe ajo çfarë po dëshiroj edhe një herë ta ritheksoj, pasi jemi në fillim të seancës, shqetësimi im është se nga ora 15:00-16:00 ne prapë edhe sot nuk do t'i gjejmë 59-60 deputetë në këtë sallë,

përmes të cilës do të më bënte të mundshme si kryesues i kësaj seance t'ju veja propozimet tuaja në votim, kjo është e gjitha, po në fund të fundit, sot jeni 75 deputetë.

Zoti Sejdiu, le të bëhet gati zoti Konjufca dhe zoti Sherifi, në fund.

DARDAN SEJDIU: Kryetar, faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë,

Unë për hir të korrektësisë më duhet të potencoj që interpelancat janë që një kohë të gjatë në rend të ditës dhe, në fakt, interpelancat nuk po mbahen sepse kryeministri nuk po vjen në seancë, jo për shkak të mungesës së deputetë.

Pra, ka një kohë e gjatë që disa prej interpelancave, tri janë në fakt, secila më e rëndësishme se tjetra, janë tema akute, tema të cila duhet trajtuar dhe tema të cila sa më shumë zgjatet mosardhja e kryeministrit, ngarkohen mbi buxhetin dhe financat e kësaj Republike.

Pra, mosprania e kryeministrit dhe shtyrja e interpelancave tash e një kohë e bën agjendën kështu.

Sa u përket temave të tjera, është e qartë se deputetët e kanë shprehur mendimin e vet edhe sa i përket pikës së parë të rendit të ditës.

Po e them këtë për hir të korrektësisë, sepse në fjalën tuaj ju adresuat si të thuhet, përgjegjësinë kryesore për këtë akumulim të temave të deputetët dhe, në fakt, për interpelancat, së paku, e vërteta është tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Konjufca, zoti Sherifi bëhesh gati.

GLAUK KONJUFCA: Këtu të gjithë ia filluan nga kjo pika e MSA-së, por unë mendoj që seanca është problemi, jo kjo pikë e MSA-së në veçanti. Pse? Sepse kjo seancë më së pari është thirrur në mënyrë të parregullt, është thirrur me postë elektronike.

Prej kur, unë nuk e di, e mail-i e ka zëvendësuar Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës, ky është suspendim i institucioneve, të cilat i kemi krijuar vetë.

Kurse sa i përket agjendës së ngarkuar të Kuvendit të Republikës së Kosovës, përgjegjësinë kryesore e mban mazhoranca, e mbi të gjitha kryeministri dhe Qeveria, për shkak që kryeministrit më e rëndësishme i duket të shkojë e të shohë si po ndërtohet një rrugë, se sa të vijë në Parlamentin e Kosovës e të japë përgjegjësi. Pa le ta çojë një ministër atje, i cili është

përgjegjës për ato rrugë, e çka po di, ato aktivitetet e tjera. Ai e ka keqkuptuar rolin e kryeministrit, po mendon që krejt punët e ministrave duhet t'i bëjë kryeministri.

E dyta, e ka keqkuptuar, apo nuk e kupton fare rolin e Kuvendit. Përgjegjësia kryesore e tij është kur jo për çdo ditë të vijë në Kuvend, po aty kur shkruan interpelanca për kryeministrin, ajo është përgjegjësia e tij kryesore kushtetuese.

Se roli kryesor i Kuvendit është të marrë llogaridhënie prej kryeministrit dhe kryeministri t'u japë përgjegjësi deputetëve kur ata e kërkojnë, e forma më specifike kur deputeti kërkon llogari prej kryeministrit është interpelanca, si kategori me Rregullore të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ai thotë nuk jam deri pas 10 ditësh këtu. Për shembull, më 14 maj tha nuk jam deri më 24 maj, pastaj nuk vjen sërish. Ndonjëherë dy ditë mund të vijë rend, pastaj dy javë nuk vjen, domethënë është totalisht kaotik për nga organizimi i përgjegjësive që i ka dhe kjo mendoj, dhe në anën tjetër, përgjegjësit që i ka mazhoranca janë ato 70 pika, të cilave t'i po u referohesh sikur thuajse nuk ka përgjegjësi askush. Këtu përgjegjësia është shumë e qartë edhe të gjithë po e dimë ku është përgjegjësia.

KRYETARI: Faleminderit! Lista po zgjatet, s'po mund të futemi në seancë. Zoti Sherifi, fjala për ju, zoti Krasniqi bëhet gati.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përsëritje edhe për kolegët,

Unë kam një propozim për të dalë nga kjo gjendje në të cilën është futur Kuvendi me 75 pika, siç thatë, në rend të ditës që nga sot të shpallim gjendje të vazhdueshme të seancave, derisa të përfundojmë, sot seancë, nesër seancë, veç të shtunën e të dielën nëse nuk është e detyrueshme. Po edhe të shtunën dhe derisa të përfundojnë pikat e rendit të ditës mund të jemi në seancë të vazhdueshme, përndryshe me nga një herë në javë apo një herë në 10 ditë seancë, unë besoj që për këtë vit do të mjaftojnë këto pika të rendit të ditës. Faleminderit!

KRYETARI: Një propozim brilant, zoti Krasniqi, kryetar i Grupit Parlamentar të PDK-së.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Besoj që ne të gjithë e dimë realisht si e kemi situatën në Kuvend, pse na janë grumbulluar kaq shumë pika. Është përgjegjësi edhe e Qeverisë, edhe e Kuvendit, pra nuk kemi një situatë bardh e zi, se prej 75 pikave i kemi nja 5 pika që i drejtohen kryeministrit, ato interpelanca që me të vërtetë janë stërvonuar, sepse janë planifikuar të mbahen diku para një muaj, po kjo s'do të thotë që për pjesën tjetër që është përgjegjësi e ne deputetëve dhe veçanërisht gjatë këtij viti kemi

pasur situata, ku në përfundim të seancës, pa dallim, shumica e opozita, kemi pasur mungesën e deputetëve që na kanë pamundësuar finalizimin e pikave të cilat i kemi shqyrtuar.

Unë propozoj të vazhdojmë seancën, se deri tash sikur t'i kishim kursyer njëri-tjetrin dhe qytetarët prej ligjëratave, i kishim votuar nja pesë pika. Jemi shumica e nevojshme për të votuar, i nxjerrim pikat në votim, për pikën e parë ka përfunduar debati.

Zoti Hoti tha që kanë kërkuar interpelancë për këtë çështje, do ta diskutojmë kur t'i vijë radha edhe asaj, edhe ajo besoj që është në mesin e 75-76 pikave që po i përmendin.

Kështu që unë propozoj të vazhdojmë me seancën, kemi shumë pika të mbetura, të cilat unë kam dyshime që edhe mund t'i përfundojmë sot, se së paku janë katër debate të parapara sot, po ashtu kemi edhe nesër seancat e mbetura më herët, janë interpelancat e kryeministrit.

Kisha propozuar të vazhdojmë dhe po ashtu e mbështes parimisht edhe propozimin e zotit Sherifi që realisht të mos themi po punojmë vetëm të mërkurën e të enjten, po ta kemi ndoshta një tip të seancës të gjatë deri sa t'i shterim të gjitha pikat që kanë mbetur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kisha kërkuar mirëkuptimin e zonjës Haxhiu dhe zotit Topalli, se po flasim vetëm deputetët, të flasim vetëm kryetarët e grupeve parlamentare. Jam i sigurt se ato çka keni për t'i thënë në këto debate, e kemi shumë, pa i thënë edhe në pikat e tjera s'e leni.

Nuk po hiqni dorë? Atëherë zoti Isufi, fjala për ju!

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë mendoj që ne duhet t'i kryejmë detyrat tona si Kuvend këtu, i kemi pikat e përcaktuara për sot, t'i kryejmë këto, nesër do të jetë kryeministri në interpelancat e thirrura dhe i kryejmë punët si Kuvendi i Kosovës. Prandaj të mos i ngarrojmë çështjet. Nuk e di çka i ka marrë malli kaq shumë kryeministri, kryeministri, kur mund t'i kryejmë këto pika pa kryeministrin, sepse janë pika të debatuar më herët.

Nuk ka kuptim, vërtet, 74 pika na presin, hajde prej sot fillojmë e i përfundojmë të gjitha pikat në ditët në vijim dhe e mbyllim punën tonë si Kuvend.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Balje, fjala për ju!

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Hoću da predložim da se sa današnje tačke koje smo planirali za danas odloži tačka broj pet Razmatranje godišnjeg izveštaj Institucije Narodnog advokata zbog toga što naša Komisija za

ljudska prava se bavila ovim izveštaj, međutim Narodni advokat nije prisutan, pa ako može da se skini. Hvala!

KRYETARI: Zoti Topalli, zonja Haxhiu në fund, më nuk kemi deputetë, ju lutem!

FATON TOPALLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe ashtu kam pasur dëshirë të flas shkurtimisht një herë rreth kësaj teme.

Fillimisht dua të them që e përkrah tërësisht propozimin e zotit Bilall Sherifi dhe kërkoj që të votohet propozimi i tij, që t'i kryejmë të gjitha pikat, të cilat ky Kuvend nuk i ka përfunduar deri më tani, edhe në qoftë se ka nevojë të qëndrojmë gjatë gjithë javës në këtë Kuvend.

Tjetra që dua të adresoj ka të bëjë me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, është që puna e Kuvendit dikur kishte një strukturë javore, të premtën diheshin pikat e rendit të ditës për mbledhjen e Kryesisë, e cila mbahej zakonisht të hënën, të martën dhe të mërkurën mbaheshin mbledhjet e komisioneve, ndërsa të enjten, respektivisht të premtën mbledhjet e Kuvendit, kishte çdo javë mbledhje të Kuvendit.

Nëse vazhdojmë kështu pa strukturë javore, është e pamundshme edhe për të planifikuar, sepse përveç punëve që i kemi këtu në sallën e Kuvendit, kemi edhe punë të tjera, kështu që unë kisha apeluar edhe te Kuvendi, edhe te ju, zoti kryesues i Kuvendit, që t'i kthehemi një strukture të caktuar, ku është e mundur edhe për të planifikuar, pastaj për të mbajtur 7-8 pika, 10 pika të rendit të ditës, po jo një mbledhje me 24 pika të rendit të ditës nuk përfundon kurrë. Shikoni dy mbledhjet e fundit dhe do të shihni që janë tubuar shumë pika dhe fillon njëra seancë, nuk përfundon; fillon tjetra dhe nuk ka përfunduar prapë tjetra. Faleminderit!

KRYETARI: Zonja Haxhiu, fjala për ju!

ALBULENA HAXHIU: Unë s'e kam kërkuar fjalën, për qëndrimin e grupit ka folur shefi i grupit!

KRYETARI: Kërkoj falje! Zonja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Se pa rend nganjëherë, kujtojmë që krejt i kemi të drejtat e pafundme. Por, megjithatë, për korrektësi mbi korrektësinë, pikërisht Grupi Parlamentar i PSD-së ka qenë kërkues për t'u shtyrë interpelanca. Kryeministri e ka shtyrë me kërkesën e tyre, sepse ka qenë në njërin prej seancave, për korrektësi mbi korrektësinë po e tregoj.

KRYETARI: Faleminderit! A shkojmë kështu, keni dhënë disa propozime, të cilat janë publike. Zoti Sejdiu po insiston replikë, urdhëro!

DARDAN SEJDIU: Jo, është tepër e rëndësishme, besoj që është tepër e rëndësishme të jemi korrektë edhe me qytetarët, edhe me deputetët, edhe me kryeministrin, i cili nuk është i pranishëm.

Kërkesa për interpelancë sa i përket marrëveshjes komerciale të nënshkruar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Contour Global është bërë më 15 mars 2018. Dhe, po është e vërtetë që i kemi thënë kryeministrit që kjo interpelancë nuk duhet të mbahet në mbrëmje, por duhet të mbahet ditën kur e gjithë salla është këtu e pranishme, të gjitha mediet e shohin se çfarë marrëveshje komerciale keni nënshkruar dhe me padurim jemi duke e pritur, sepse është tepër e rëndësishme që së paku 81 deputetë në këtë sallë t'i kuptojnë dëmet komerciale. Arsyeja pra ka qenë kjo. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, e kemi një propozim konkret për t'i ikur debatit dhe kundërthënies. Ne po mundohemi, jo po mundohemi por në bazë të Rregullores, si Kryesi e Kuvendi dhe si kryesues i Kuvendit çdoherë mundohem t'i mbaj, kështu po kanë qejf, kështu qysh ka qejf secili, dhe t'i mbajmë këto mbledhjet edhe ta kemi parasysh mbarëvajtjen e punës së Kuvendit.

Ndonjëherë, nuk i bie tamam se deputetët s'janë, ndonjëherë s'janë qeveritarët, ministrat. Ju jeni seancë, aktualisht jeni 76 deputetë në sallë. Unë do ta vë në propozim që nëse dëshironi ju, derisa t'i kryejmë këto pika të rendit të ditës, janë diku, besoj që me javën e ardhshme afrohen tek 80-shi. Në qoftë se ju i jepni autorizim kryesuesit dhe Kryesisë, por veçanërisht kryesuesit, që deri t'i kryejmë këto 80 pika të mbajmë seancë edhe çdo ditë. Edhe këtë seancë, ta keni parasysh që është thirrur sot e nesër, i falënderoj përfaqësuesit, përkatësisht kryetarët e grupeve parlamentare, për arsye se një pjesë e madhe e Kryesisë nuk është në Kosovë. Nuk janë zyrtarisht, ta keni parasysh. Do të mbetet pa u mbajtur fare edhe seanca e sotme, edhe e nesërme. Kisha pasur dëshirë që ky autoritet të kalojë deri t'i përfundojmë këto pika, të cilat janë të rendit të ditës. Të gjitha janë të njëjta, të barabarta për të gjithë ne, janë në interesin e qytetarëve, kanë të bëjnë me Agjendën e Reformave Evropiane që edhe javën e ardhshme t'i jepni autorizim kryetarit të Kuvendit që të thërrasë seanca, qoftë të hënën, të martën, të mërkurën deri të enjten, që t'i përfundojmë dhe me javën e ardhshme të jemi vërtetë në përfundim, se unë e di që edhe për deputetët është lodhje. Po e di, dhe kjo nuk është shumë e lehtë, pastaj barra po u bie gjithmonë deputetëve, të cilët janë më aktivët.

Po të futemi në seanca, në qoftë se dëshironi e vë në votim, po e shoh ka reagime nga propozimi, po jua jap fjalën. Por, kisha pasur dëshirë kryetarët e grupeve parlamentare, ose përfaqësuesit.

Zoti Hoti, nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

AVDULLAH HOTI: Kryetar!

Thashë në bazë të Rregullores së Kuvendit dhe në bazë të Kushtetutës ju i keni autorizimet e plota që tri ditë përpara kurdo që e shihni të arsyeshme që ka pika për diskutim të thirrni seancë dhe t'i shqyrtojmë ato pika. Unë kërkoj që ju ta thirrni mbledhjen e Kryesisë, t'i shohim cilat pika janë, t'i renditim nëpër seanca nëse ka nevojë një javë rresht të mbajmë seancë. Por, të jemi të qartë, nuk janë shtyrë këto pika për shkak se deputetët e opozitës s'kanë qenë në sallë, por janë shtyrë më shumë për shkak të agjendës së Qeverisë dhe agjendës suaj personale, sepse në masë të madhe gati Kuvendi është duke punuar sipas agjendës suaj. Gjithë javën e kaluar s'kemi mbajtur seanca, dje është caktuar përmes e-mailit një seancë, krejt në rregull, por ta kemi të qartë - ky është si rezultat i menaxhimit edhe të punës së Kuvendit, edhe i përgjegjësisë totale Qeverisë për të qenë këtu në Kuvend, kurdo që Kuvendi kërkon, e jo kur ka kohë kryeministri dhe Qeveria, por kur Kuvendi kërkon që kryeministri dhe ministrat të jenë në seancë për t'u përgjigjur në debate dhe në interpelanca. Faleminderit!

KRYETARI: Për mirëkuptim, për ndihmesë të kësaj çka e tha edhe zoti Hoti, nuk është çështja e autoritetit, të cilën ia jep Kushtetuta, të cilën s'e kemi përdorur, të paktën unë është hera e parë këtë herë, dhe kemi biseduar me kryetarët e grupeve parlamentare, është çështje e mirëkuptimit të përbashkët që ta kryejmë këtë agjendë, të cilën e kemi para nesh. Kjo është.

Unë nuk mund të garantoj se deri të premten do të vijë Kryesia, ta mbledh Kryesinë, se nuk do të jenë. Pastaj, të hënën nuk mund të kem seancë, pastaj ta kini parasysh që Kryesia e Kuvendit e ka marrë edhe një vendim, sipas të cilit një pjesë e madhe të deputetëve do të jenë në agjendë për liberalizimin e vizave, do të jenë në vizita jashtë vendit. Është shumë e rëndësishme të jemi më specifikë, që deri të mërkurën ta kemi një agjendë të intensifikuar që t'i përfundojmë këto pika, të cilat janë në pritje, për arsye se pastaj futemi drejt normalizimit të agjendës. Ne sot, nesër, dhe besoj shumë se edhe pasnesër do të kemi seancë, e më vjen keq në qoftë se ju dekurajoj, për arsye se pikat e rendit të ditës - nesër interpelancat janë bukur të gjata - marrin kohë, e pastaj do të kishim futur edhe në një seancë tjetër nga dita e hënës. Kryesinë nuk e kam në Kosovë që të marr vendim të premten për të hënën. Kjo është arsyeja.

Kështu që vendimmarrja duhet të jetë, edhe një herë zoti Hoti, të vazhdoj te përfaqësuesit e grupeve parlamentare për të hënën, po flas për seancë të re. Për të hënën seancë e re me pikat, të cilat janë në pritje. Unë prapë do t'i konsultoj, përkatësisht Administrata, çdo kryetar i grupit parlamentar, e çdo vërejtje në qoftë se grupi parlamentar e ka një pikë të rendit të ditës që të largohet, do ta largoj. Por të paktën të kemi seanca me pikat e rendit të ditës, për të cilat kemi konsensus të përbashkët. Do të thotë, nesër është kryeministri, më lejoni të ju lajmëroj, ka paralajmëruar se gjithë ditën do të jetë këtu. I kemi interpelancat. Zoti Hoti, zoti Shala dhe nënkryetar i Kuvendit, urdhëro! Po flasim gjithmonë nënkryetar edhe për të hënën, në qoftë se ka mundësi...

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Për procedurën e mora fjalën, unë besoj që është e rëndësishme të flasim për mënyrën e punës, por do të mund ta përdornim këtë kohë që të vazhdonim punën. Proceduralisht, seanca nuk mund të vendosë, as s'ka të drejtë ta autorizojë askënd që të thërrasë seancë të re. Për atë vendosin Kryesia ose kryetari, sepse Kushtetuta ia lejon, ta caktojë rendin e ditës dhe të thërrasë seancë. Nëse është kaq e rëndësishme, ju mund ta bëni, por jo seancë. Kështu që unë ju kërkoj që nëse e keni, ose e kemi ndërmend të vazhdojmë punën, të vazhdojmë, sepse ky debat është pa funksion. E kemi rendin e ditës dhe të ecim më tutje.

KRYETARI: Zoti Nitaj e ka fjalën.

MUHARREM NITAJ: Zoti kryetar i Kuvendit të Kosovës!

Propozimi i zotit Sherifi ishte shumë konkret. Gatishmëria e deputetëve është që të vazhdojnë me seanca derisa të përmbillen të gjitha pikat që janë në rendin e ditës. E përmendi zoti Shala, juve proceduralisht ju mundëson Kushtetuta e vendit që të thërrisni seanca kur është e nevojshme, prandaj unë besoj për shembull që është e panevojshme që ne ta vazhdojmë debatin, kryetar, por të vazhdojmë me agjendën që e kemi sipas rendit të ditës. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Sherifi, do të shkojmë në bazë të atij propozimit tuaj. Po, por e vazhdojmë seancën pastaj shpejt ju njoftojmë, para të premtës. Atëherë, e kemi:

10. Votimi i Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, 2018-2022

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

85 deputetë janë në sallë, 76 kanë votuar, 71 për, 1 kundër, 4 abstenime.

Kuvendi e miratoi Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, 2018-2022.

11. Votimi i Strategjisë Shtetërore të Ujërave në Kosovë, 2017-2036

Vazhdojmë edhe me votimin e Strategjisë Shtetërore të Ujërave në Kosovë 2017-2036. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

74 deputetë kanë votuar, 66 për, 5 kundër, 3 abstenime.

Kuvendi e miratoi Strategjinë Shtetërore të Ujërave në Kosovë, 2017-2036.

12. Votimi i Planit të Veprimit për Biodiversitetin, 2016-2020

Vazhdojmë me votimin e Planit të Veprimit për Biodiversitetin, 2016-2020. Votojmë tash!

77 deputetë kanë votuar, 71 për, 1 kundër, 5 abstenime.

Kuvendi e miratoi Planin e Veprimit për Biodiversitetin.

13. Votimi i raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2017

Vazhdojmë me votimin e këtij raporti. Votojmë tash!

79 deputetë kanë votuar, 47 për, 24 kundër, 8 abstenime.

Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2017.

13. Shqyrtimi i raportit vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017

Zonja Duda Balje e dha një propozim, por ne mund të vazhdojmë ta kryejmë raportin sot. Nuk shohim asnjë pengesë procedurale.

Komisioni Funkcional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, me nenin 72 të Rregullores së Kuvendit, e ka shqyrtuar raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017, dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandim për miratim.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Në mungesë të Avokatit të Popullit, zonja Duda Balje e paraqet arsyetimin me raportet me rekomandime? Në emër të komisionit, të lutem, veç arsyetoje raportin me rekomandime.

DUDA BALJE: Ja sam vas zamolio na početku seanse, ako ovo može da se odloži s obzirom da je Narodni advokat opravdan odsutan, jer otišao na sastanak svih regionalnih narodnih advokata, i mi smo smatrali da je jako važno da predstavlja Kosovo na tom sastanku.

U slučaju da ne može, Komisija za ljudska prava je gledala ovaj raport, i svi smo glasali za to, iako smo zadovoljni sa njegovim radom i molim poslanike da glasaju za ovaj raport.

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, zoti Lumir Abdixhiku tash e arsyeton raportin me rekomandim lidhur me raportin vjetor financiar.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017 dhe ka vlerësuar se i njëjti e ka menaxhuar buxhetin mirë, nuk ka pasur tejkalime të planifikimeve dhe si i tillë raporti i përmbush obligimet ligjore për raportim që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Komisioni ia rekomandoi Kuvendit raportin financiar për miratim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Lirije Kajtazi, në emër të LDK-së.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Raporti i Avokatit të Popullit për vitin 2017 i prezanton të gjeturat, të cilat natyrisht që për shumicën, por për Lidhjen Demokratike të Kosovës, vazhdojnë të jenë shqetësuese, ngase barten shumë rekomandime nga viti në vit, duke mos pasur përkuqdesjen e shumë institucioneve që t'u përgjigjen atyre në mënyrën qysh edhe i obligon ligji.

Shqetësim vazhdon të jetë zvarritja e procedurave në gjykata me një mesatare tejet të theksuar deri në tetë vjet, e cila flet edhe për nivelin e zbatimit të Ligjit në Kosovë dhe po ashtu Avokati evidenton çështjet, të cilat edhe më herët në diskutimet tona i kemi prezantuar si domosdoshmëri e punës dhe obligimeve edhe të këtij Kuvendi, edhe të institucioneve, evidentohet nevoja apo domosdoshmëria për nxjerrjen e projektligjit për të drejtat apo mbrojtjen e fëmijëve, ngase për ditë e më shumë vërehet se kjo kategori është mjaft e atakuar nga shumë çështje devijuese, të cilat në mungesë të zbatimit të ligjit vazhdojnë ta atakojnë këtë kategori.

Për fat të keq, vitin e kaluar janë evidentuar se të rinjtë, fëmijët në këtë rast, janë prekur nga narkomanët edhe në moshën 12-vjeçare dhe fatkeqësia tani është më e thellë që del edhe 9-vjeçarët janë atakuar nga narkomanët, nga substancat narkotike, e të mos flasim për pjesën tjetër edhe të lypësisë dhe çështjet tjera, me të cilat ata detyrohen të bëjnë punë të detyrueshme. Po ashtu, ajo që trandë është edhe vetë esenca e familjes është dhuna në familje, e cila intensifikohet më shumë, prapë po them në mungesë të seriozitetit në gjykata për ta trajtuar drejt këtë dukuri dhe shumë gjëra tjera, të cilat Avokati i sheh me shumë kujdes dhe për këtë arsye vazhdon të vlerësohet si institucion mjaft kredibil edhe nga institucionet ndërkombëtare.

Por, ajo çfarë kishim dashur të përmendim kësaj here si Grup i Lidhjes Demokratike të Kosovës është shqetësimi ynë se vite me radhë, përkundër se UNMIK-u raporton në OKB për progresin i cili është bërë në trajtimin e viktimave të dhunës seksuale, del që në raportet e OKB-së, përkundër insistimit edhe të ambasadores sonë në Uashington që të trajtohen si duhet dhe të përmendet dhuna që është shtruar, dhuna seksuale gjatë luftës, po ashtu ambasadorja në Nju-Jork, zonja Sahatqija, ka ndikuar me të madhe që ambasadorët të vendeve tona mike ta ngrenë

këtë shqetësim, megjithatë mbetet një çështje, e cila vazhdon të kamuflohet edhe tutje. Ne do të kërkojmë nga Avokati i Popullit që t'i bëjë shkresë edhe zotit Guterres që këtë çështje ta marrë më me interes, në mënyrë që Kosova të trajtohet ashtu siç duhet, të mos vazhdohet të përmenden atje çështjet që janë vetëm farsë, e të përmenden çështjet të cilat vërtet janë shqetësim për popullatën e këtushme.

Ka shumë çështje që kërkojnë vëmendje institucionale, e Qeveria prin për moszbatim të rekomandimeve, andaj si Lidhje Demokratike e Kosovës e vëmë theksin në një seriozitet dhe detyrim për zbatimin e ligjit edhe në vazhdim. Përndryshe, ne e përkrahim raportin, është i përgatitur mirë, por me insistimin tonë që në tryezat që i kemi organizuar edhe ne si Komision i të Drejtave të Njeriut, aktorët të cilët janë thirrur për t'iu përgjigjur rekomandimeve, të cilat u adresohen, është parë se edhe ministrat dërgojnë njerëz me kompetencë të pamjaftueshme, nuk them ndoshta jo edhe përgjegjës, se ata mund ta mbulojnë një fushë, por jo krejt ajo çfarë u adresohet si rekomandim dhe detyrim për ta zbatuar ligjin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Mexhide Mjaku-Topalli, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin vjetor të Avokatit të Popullit dhe konsideron se ky raport është instrumenti më i rëndësishëm i Avokatit të Popullit nëpërmjet të cilit ai e informon Parlamentin çdo vit, në mënyrë që ne deputetët ta realizojmë funksionin e tij si kontrollues të Qeverisë.

Edhe këtë vit, me këtë raport paraqitet para Kuvendit një pasqyrë analitike ndaj ankesave të popullit në vend. Synimi është ndikimi për realizimin e standardeve të larta në mirëqeverisje. Fokusi i punës së Avokatit të Popullit ka qenë dhe është praktika e përditshme e marrëdhënieve individ-shtet dhe niveli i mirëqeverisjes si e drejtë e njeriut. Me këtë angazhim konstatohet krijimi i një kulture të të drejtave të njeriut në Kosovë, kërkohet pjesëmarrje aktive dhe bashkëpunim i ngushtë me organet e Administratës Publike, shoqërisë civile, institucionet ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit, qarqet akademike, medie, si dhe rritje të njohurive dhe vetëdijes së publikut rreth të të drejtave të tyre.

Në rastet e paraqitura në këtë raport është pasqyruar puna e Institutit të Avokatit të Popullit, sikundër edhe të vëmë gishtin mbi dukuritë abuzive. Përtej kësaj, Avokati i Popullit synon t'i qartësojë rrugët që duhen ndjekur për ta krijuar kulturën e shërbimit cilësor dhe të ndershëm ndaj qytetarëve. Raporti vjetor përmban refleksionet tona për çështjet më të rëndësishme të prezantuara gjatë vitit, si dhe identifikon problemet të cilat kanë nevojë për përmirësime në të

ardhmen. Ka edhe raste që rekomandimet e Avokatit të Popullit, ndonëse mirë të argumentuara, nuk pranohen për zbatim, sidomos në rastet e zbatimit të vendimeve gjyqësore, zvarritja e padrejtë e procedurave gjyqësore, kthimeve në punë, fillimin e hetimeve për veprat penale, e tjera.

Ky raport përfshin një sërë rekomandimesh për ndryshime legislative dhe masa konkrete të drejtuar Qeverisë, Kuvendit, komunave apo institucioneve të Administratës Publike për vënien në vend të së drejtës së shkelur. Andaj, kërkohet një angazhim më serioz për zbatimin e këtyre rekomandimeve të propozuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sami Kurteshi nga Lëvizja Vetëvendosje.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Para se të fillojmë ta trajtojmë raportin e Avokatit të Popullit, unë po e citoj paragrafin 1 të nenit 135 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili thotë: “Avokati i Popullit paraqet raport vjetor para Kuvendit të Republikës së Kosovës”. Ky është një institucion i veçantë dhe kjo është një kërkesë e veçantë e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që e obligon Kuvendin që të kërkojë, t’i lejojë dhe t’i mundësojë Avokatit të Popullit që të paraqesë raportin në mënyrë të veçantë nga të gjitha institucionet tjera të pavarura para Kuvendit, që Avokati i Popullit të jetë i pranishëm në seancë dhe të jetë i gatshëm të përgjigjet edhe në pyetjet, edhe në kërkesat, edhe në sugjerimet e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kjo nuk është duke ndodhur tani. Është hera e parë prej se përcjell unë dhe mbaj mend që seanca për raportin e Avokatit të Popullit të mbahet pa praninë e personit që duhet të raportojë këtu. Kjo është fatkeqësi. Unë mendoj se kërkesa e kryetares së Komisionit për të Drejtat e Njeriut ishte me vend dhe ishte e drejtë, sepse mungesa e Avokatit të Popullit, pa marrë parasysh cilat janë arsyet, një nga to është e paparashikuar, domethënë seancat e Kuvendit mbahen në mënyrë të paparashikuar dhe ai nuk mund të qëndrojë tërë kohën, nëse nuk njoftohet, në gatishmëri që të raportojë vetëm këtu, sepse ka edhe obligime tjera. Këto janë probleme që ne duhet t’i theksojmë.

Natyrisht që kjo vërejtje duhet të vlejë dhe të kërkohet nga Avokati i Popullit që të vijë këtu dhe të raportojë sipas obligimit kushtetues të nenit 135, paragrafi 1, të cilin e citova pak më herët. Prandaj, kërkoj edhe një herë që kjo seancë t’ia mundësojë Avokatit të Popullit të vijë këtu dhe ta paraqesë raportin vjetor, sepse është institucioni që ka të bëjë me gjetjet e shkeljes së shtetit të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës. Nuk kemi mundësi tjetër që ne si Kuvend dhe institucione të Republikës së Kosovës të ballafaqohemi me të gjeturat për shkeljet. Ky është thelbi i gjithë sjelljes shtetërore në raport me njeriun, me të drejtat dhe me liritë e tij.

Kjo do të ishte kërkesë që Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje e ka ndaj seancës, ndaj kryesuesit, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Natyrisht që ne si grup parlamentar e kemi analizuar raportin e Avokatit të Popullit në hollësi dhe natyrisht që jemi të interesuar që ai të jetë këtu dhe të ballafaqohet me Kuvendin e Republikës së Kosovës lidhur me të gjeturat e këtij raporti.

Kjo është ajo çështje që ne e kërkojmë dhe e kërkojmë me ngulm. Për raportin, do të flasim kur të na vijë radha. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Seanca e vendos, e voton - s'e voton... Frashër Krasniqi, nga Partia Socialdemokrate.

FRASHËR KRASNIQI: Për mendimin tonë, një indikator shumë i rëndësishëm për gjendjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut në Kosovë është vetë fakti që kjo fushë i është lënë ekskluzivisht Institucionit të Avokatit të Popullit, i cili e vëren edhe vetë që ka një mosinteresim të theksuar të institucioneve shtetërore për t'i mundësuar dhe respektuar të drejtat e njeriut në Kosovë. Madje, një pjesë e madhe e rasteve shumë të rëndësishme që janë ngrehur prej Institucionit të Avokatit të Popullit dhe që kërkojnë përfshirjen e Qeverisë, Kuvendit, ose ndonjë ministrie të caktuar, Avokati i Popullit është injoruar tërësisht deri në pikën kur shpeshherë nuk merr as përgjigje për pyetjet, ose komentet, që ua dërgon institucioneve të caktuara. Të mos flasim pastaj për realizimin e rekomandimeve që ky institucion ua ka drejtuar institucioneve shtetërore. Shumica prej tyre nuk realizohen dhe kjo është vërejtur edhe në Raportin e Progresit 2017, i cili kërkon nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që të luajë rol më të madh e të ndikojë te Qeveria për realizimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

Institucionet shtetërore publike, siç e vërejmë në këtë raport të Avokatit të Popullit, jo veç që nuk i përfillin rekomandimet e tij, por marrin pjesë aktive në shkeljen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Për shembull, e kemi rastin flagrant të detyrimit të qytetarëve për t'i paguar shpenzimet e energjisë elektrike edhe për veriun e vendit, ose për faturat e ujit. Po ashtu, nëpërmjet buxhetit paguhen edhe për veriun nga vetë qytetarët.

Edhe në këtë raport vërehet ajo që është përsëritur bukur shumë nga plot prej nesh që realizimi i të drejtave të njeriut nuk mund të ketë, as realizim të të drejtave të njeriut, as respektim të tyre, në një vend ku sistemi i drejtësisë është pranë falimentimit, sepse lidhja dhe respektimi i të drejtave të njeriut me funksionin e mirë dhe efikas të sistemit të drejtësisë është e pashkëputshme. Siç theksohet në këtë raport, Kosova e ka një sistem të drejtësisë të fundosur në numër të madh të dosjeve, ku mesatarja arrin në një mijë raste për një gjykatës. Pra, kjo ka ndikuar që komplet procesit të vënies së drejtësisë t'i humbë kuptimi. Nuk ka kuptim të vihet drejtësia, nëse kjo bëhet pas dhjetë vjetësh, që është paraqitur një rast në gjykatë.

Prandaj kemi situata kur zyrtarë shtetërorë, që janë dënuar për krim të organizuar, kanë ikur jashtë vendit, janë strehuar, pas tre vjetësh kthehen pa asnjë ferrë në këmbë, për shkak se lënda e tyre është parashkruar. Merreni me mend, derisa shpenzojmë miliarda euro për ndërtim të autostradave, Këshillit Gjyqësor të Kosovës ia kemi caktuar një buxhet prej vetëm rreth 22 milionë euro, që i bie veç 1,2% të Buxhetit. Vetëm 40 bashkëpunëtorë profesionalë i ka sistemi gjyqësor i Kosovës. Pra, paramendojeni, i kemi mbi 400 mijë raste të pazgjidhura nëpër gjykata, kurse numri i bashkëpunëtorëve profesionalë është përgjysmë më i vogël se numri i zëvendësministrave. Pra, kjo është gjendja e sistemit tonë të drejtësisë dhe ky është prioriteti që kjo Qeveri ia ka vënë drejtësisë.

Hartimi i ligjeve të mira, që janë në përputhje me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, siç edhe vërehet në këtë raport, nuk është dëshmuar që është i mjaftueshëm, nëse përkitazi me këtë nuk e kemi edhe vullnetin për zbatim efikas të këtyre ligjeve. Siç theksohet në këtë raport, edhe ky proces i hartimit dhe modifikimit të ligjeve megjithatë ka shënuar rënie për vitin 2017, sepse e kemi një Kuvend gati jofunksional dhe po duket sikur tashmë kemi hequr dorë edhe nga përpilimi i ligjeve, sepse po e dimë se nuk po kanë kurrfarë vlere dhe zbatueshmërie. Kemi, ta zëmë, në anën tjetër, mungesë të efikasitetit shtetëror në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, e cila në fund u është bartur edhe përmbauesve, të cilët bëjnë shkelje të tilla sikur, ta zëmë, ua ndalojnë komplet pagat dhe të hyrat e vetme qytetarëve që kanë borxhe.

Të nderuar deputetë,

Nëse e shohim këtë raport, do ta kuptojmë që jemi duke e ndërtuar një shtet, i cili nuk ua garanton qytetarëve të vet as të drejtën për mjedis dhe ajër të pastër, për shkak se degradimi i tokës bujqësore, shkatërrimi i sipërfaqeve pyjore, ndotja e ujit të pijes, mungesa e qasjes në sistemin publik të ujërave të zeza, mosmenaxhimi i duhur i mbeturinave, ndotja alarmante e ajrit, e tjera, po e rrezikojnë edhe të drejtën për jetë të shëndetshme të qytetarëve të Kosovës, që është e drejtë bazike. Dhe, shumica e këtyre problemeve vijnë si rezultat i veprimeve institucionale, e në rastin më të mirë si rezultat i mosndërhyrjes së shtetit. Jemi duke e ndërtuar një shtet, në të cilin mungojnë kushtet elementare për mësim në shkollë, një shtet që ua cenon që në fëmijëri qytetarëve të vet të drejtën për arsim cilësor.

Në vitin 2018 kemi raport të Avokatit të Popullit, i cili përmend rastet kur fëmijët janë detyruar ta braktisin shkollën për shkak të mungesës së transportit. Merreni me mend çfarë problemesh elementare nuk kemi arritur t'i zgjidhim deri tash, pra 20 vjet pas përfundimit të luftës. Kemi raste kur nxënësit detyrohen të paguajnë për riparimin e shkollës. Në vitin 2018, ende flitet në raportet për të drejtat e njeriut, se qysh 75,6% të fëmijëve të moshës 12-16 vjet e kanë parë dikë duke u grushtuar, e 33% të tyre janë ndier të ngacmuar. Pra, kjo është gjendja e të drejtave të njeriut në Kosovë.

Jemi duke e ndërtuar një shtet ku nuk ka vend për personat me aftësi të kufizuara dhe krejt çfarë bëhet për ta janë strategjitë e njëpasnjëshme, që përfundojnë nëpër sirtarët e Qeverisë. Ata nuk punësohen siç e kërkon, për shembull, Ligji për aftësim, i cili e specifikon që një në pesëdhjetë të punësuar duhet të jetë person me aftësi të kufizuara. Pastaj nuk ka edukatorë e asistentë personalë nëpër shkolla, nuk ka kushte fizike nëpër objekte për lëvizjen e tyre, e kështu me radhë. E ky mosvullnet institucional, që është vënë re edhe nga Institucioni i Avokatit të Popullit, është shfaqur po ashtu edhe me mosmiratimin e propozimeve për ta rritur buxhetin për personat me aftësi të kufizuara, e të mos flasim pastaj që edhe tekstet shkollore japin ta zëmë definicione fyese për personat me aftësi të kufizuara dhe skandaloze.

Jemi duke e ndërtuar një shtet ku pjesa më e madhe e punëtorëve të sektorit privat punojnë pa kontrata, me orare të stërzgjatura, e me vetëm një ditë pushim, e shpeshherë pa asnjë ditë. Ku i kemi vetëm 50 inspektorë që monitorojnë respektimin e të drejtave të punëtorëve për rreth 50 000 biznese. Pra, merreni me mend, një inspektor për njëmijë biznese e kemi të caktuar! Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës ka veshë dhe dëgjon për punëtorët e këtij vendi, vetëm kur ata vdesin në vendet e punës dhe me kaq përfundon interesimi i tyre.

Të nderuar qytetarë të Kosovës dhe ju deputetë të këtij Kuvendi, Mendoj se duhet lexuar dhe trajtuar ky raport për ta kuptuar që jemi duke ndërtuar një shtet ku ta zëmë personat e prekur nga HIV dhe AIDS nuk guxojnë as të paraqiten në spital. Një shtet ku ka qytetarë që jetojnë në kampe, në geto, pa kushte elementare higjienike e shëndetësore, fëmijët e të cilëve nuk e gëzojnë as të drejtën e vaksinimit të rregullt dhe askush nuk shqetësohet për ta, thjesht sepse këta janë romë, ashkalinj, ose egjiptianë. Ka qytetarë që shteti i Kosovës i ka lënë në kushte aq të mjerueshme, sa detyrohen t'ua ndërpresin fëmijëve shkollimin për të punuar për mbijetesë. Qytetarët e komuniteteve rom, ashkalinj dhe egjiptian ballafaqohen me mungesën e kushteve elementare, më bazike, siç është mungesa e strehimit, papunësia është shumë e lartë, mungesa e kujdesit shëndetësor, e tjera.

Lexojeni pra këtë raport! Do ta kuptojmë se po e ndërtojmë një shtet ku qytetarët e komunitetit LGBT nuk guxojnë as të flasin hapur për vete, ku gjykatat refuzojnë që dhunën ndaj tyre ta gjykojnë si dhunë të kryer mbi bazën e urrejtjes kundër orientimit seksual dhe identitetit gjinor dhe ku gjykatat refuzojnë të marrin qoftë edhe një vendim lidhur me dhunën e ushtruar ndaj rasteve të këtyre qytetarëve të këtij komuniteti.

Dhe, në fund, por më e rëndësishmja, jemi duke e ndërtuar një shtet që u takon vetëm burrave, një shtet ku vetëm 2% e pronave janë të regjistruara në emër të grave, ku gjykatat i favorizojnë gjithmonë burrat në rastet e ndarjes së pasurisë, ku gratë nuk shihen si trashëgimtare legjitime, ku gratë paguhën më pak se burrat edhe në ato rastet kur punësohen, ku dhuna ndaj grave trajtohet me cinizëm e diskriminim, madje edhe në organet e sigurisë, e lëre më diku tjetër. Kështu që, të nderuar deputetë, ky raport i Institucionit të Avokatit të Popullit është alarm për

gjendjen e të drejtave të njeriut në shoqërinë tonë. Të drejtat e njeriut nuk mundësohen dhe as respektohen asnjëherë në Kosovë, nëse motiv për këtë është vetëm përmbushja e kriterëve të Bashkimit Evropian. Nëse institucionet e Kosovës nuk duan që nga brenda me vullnet ta rritin mirëqenien dhe barazinë e qytetarëve, që t'i respektojnë të drejtat e njeriut, atëherë kjo nuk do të bëhet asnjëherë.

Kështu që deputetët e Partisë Socialdemokrate do të votojnë për dhe ju ftoj të gjithë deputetëve tjerë që ta mbështetni këtë raport. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Teuta Haxhiu e ka fjalën, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju kolege deputete,

Para vetes e kemi shqyrtimin e raportit vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017, si institucion që është kategori kushtetuese.

Të flasim për raportin e një institucioni, e që materiali dhe raporti në fjalë është shpërndarë te deputetët me kohë, por mua më duhet të them se sinqerisht prej kur është zoti Jashari në krye të këtij institucioni e kemi një bashkëpunim me Komisionin për të Drejtat e Njeriut, por mbi të gjitha ajo që vërehet në raportet e këtij institucioni është rritja e rekomandimeve, e unë konsideroj se rritja e rekomandimeve të Avokatit të Popullit drejtuar institucioneve është një vetëdije e ngritur për t'i besuar këtij institucioni dhe për t'iu drejtuar, qoftë qytetarët, apo edhe grupe qytetarësh. Por, ajo që mbetet shqetësuese është moszbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga cilido institucion. Ky është shqetësimi që duhet parë dhe unë i ftoj të gjitha institucionet që mbi të gjitha duhet ta shohin me seriozitet dhe t'i zbatojnë rekomandimet e këtij institucioni, ngase nëse nuk zbatohen këto rekomandime, sinqerisht unë them se bëjnë shkelje të dyfishtë të të drejtave të njeriut.

Më duhet ta përmend që në mandatin e kaluar, në një debat të thirrur nga një grup deputetësh që më kanë mbështetur, pra debatin për moszbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga Qeveria. Në një prej pikave të rekomandimeve që i kemi nxjerrë si Kuvend është edhe mosvotimi i raportit. Pra, po e përmend edhe një herë, sepse ndonjëherë kur e kemi me interes të themi se rekomandimet e Kuvendit nuk po zbatohen, qoftë nga Qeveria apo kushdo tjetër, por ndonjëherë edhe ne si Kuvend nuk i marrim seriozisht ato. Pra, po e përmend edhe një herë, rekomandim është që ky raport të mos votohet dhe e tregoj edhe një herë arsyen pse. Si kategori kushtetuese që flet për shkeljen e të drejtave të njeriut, hedhja në votim dhe krahasimi me institucionet tjera, nuk po flas për nga rëndësia, por nuk mund të krahasohen me këtë institucion, thashë edhe një herë, si kategori kushtetuese, atëherë vota për apo kundër dhe këtë,

me sa e kemi parë gjatë vizitave nëpër vendet tjera, nuk ndodh, nuk ndodh as në Shqipëri, shqyrtohet raporti në komision, por nuk votohet në Kuvend.

Prandaj, unë konsideroj edhe një herë që votimi, ose hedhja në votim nuk do të duhej të ndodhë dhe unë uroj që kolegët deputetë, që po punojnë në Rregulloren e Kuvendit, ta rregullojnë këtë çështje, se ky raport nuk duhet të hedhet në votim. Pra, edhe një herë, në qoftë se themi po e hedhim në votim, ne nuk po i besojmë Avokatit për shkeljen e të drejtave të njeriut që ai po i prezanton në raport, po flas për atë në qoftë se është një votë kundër apo në qoftë se dikush voton kundër.

Pra, shqetësuese dhe çdo herë dritë e kuqe e ndezur për të gjitha institucionet është zbatimi i këtyre rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

Prandaj, edhe një herë ne si Aleancë i japim mbështetje këtij raporti dhe sinqerisht me atë që e tha kryetarja e komisionit, më vjen keq që nuk është Avokati këtu, por uroj që të vazhdojë me punën dhe bashkëpunimin jo vetëm me komisionin, por edhe me institucionet e tjera dhe rekomandimet të jenë të vazhdueshme dhe publike, ashtu siç janë nëpër raporte, pra që ato institucione të cilat nuk i zbatojnë rekomandimet të kenë edhe më shumë, të mos them, publicitet, por të dalin më tepër edhe nëpër media dhe të dihet kush nuk po i zbaton këto rekomandime. Faleminderit!

KRYETARI: Nga grupet parlamentare është vetëm edhe Nisma, zoti Zafir Berisha. Nuk ka të lajmëruar, pasi ta përfundojmë këtë pjesë, vazhdojmë me një formë tjetër.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Fillimisht duhet të rikujtoj një fakt se unë jam deputet në këtë Kuvend në mandatin e tretë dhe me mungesën e Avokatit të Popullit për të raportuar para Kuvendit po dyshoj se po krijohet një praktikë jo e mirë, kur kemi parasysh se pozita e Avokatit të Popullit, siç thanë edhe kolegët, është kategori kushtetuese dhe si institucion mendoj se e ka obligim, por edhe ne si Kuvend duhet t'i respektojmë rregulloret, Kushtetutën edhe ligjet.

E di që prania dhe shpjegimi i raportit nga vetë Avokati do ta sqaronte edhe më tej situatën jo të mirë në Kosovë dhe besoj që kjo gjë nuk do të përsëritet në të ardhmen.

Natyrisht se Avokati i Popullit, si organi i pavarur, bashkë edhe me Auditorin e Përgjithshëm, paraqesin situatën jo të mirë që është në Kosovë dhe kjo situatë jo e mirë po mendoj se është përgjegjësi shtesë për ne deputetët dhe Kuvendin që të thërrasim mendjen, bile së paku, edhe pse është vonë që thjesht, me autoritetin dhe me autorizimet e Kuvendit të ndërhyjmë që raportet e organeve të pavarura, veçanërisht të Avokatit të Popullit, të merren parasysh, sepse nga viti në vit na bie shpesh të dëgjojmë që rekomandimet e Avokatit të Popullit nuk zbatohen nga organet

shtetërore, veçanërisht nga gjykatat dhe kjo është shqetësuese dhe alarmante për gjendjen në të cilën gjendet Kosova.

Fal angazhimit dhe punës së Avokatit të Popullit, thjesht edhe opinioni i gjerë e ka kuptuar që dikush e ka ditur se në mënyrë sistematike qytetarët janë vjedhur nga një kompani publike, siç është KEDS-i dhe natyrisht gjykatat janë obliguar nga presioni i arsyeshëm dhe faktet që të pranojnë këtë vjedhje, mirëpo rekomandimet shtesë të Avokatit të Popullit në këtë drejtim nuk janë zbatuar dhe nuk janë marrë parasysh.

Po mendoj që Kuvendi, deputetët, edhe në mënyrë individuale, duhet të jenë më të përgjegjshëm në qëndrimet e tyre dhe të kërkojnë, duke u nisur edhe nga vetë Qeveria, ministrat, veçanërisht gjyqësia, ku lidhen shumë shkelje të të drejtave të qytetarëve dhe të potencohen në këtë raport.

Po shpresoj se lëshimet e kësaj seance nuk do të ndodhin në të ardhmen, jo vetëm me Avokatin e Popullit, por edhe me organet e tjera që janë kategori kushtetuese dhe që i raportojnë Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka përfaqësues të grupeve parlamentare.

Edhe një herë, ditën e hënë e kemi përcaktuar këtë seancë për të vazhduar, po e shoh reagimin, nganjëherë edhe s'po mund ta kuptoj këtë reagim, duhet të respektohet institucioni më i lartë, Kuvendi i Republikës së Kosovës, kur nuk është kryeministri ka kritika, në të njëjtën kohë jo pse nuk ka ardhur dikush tash duhet ta ndalim seancën, për arsye që ta bartim si pikë e rendin të ditës herën e ardhshme çështjen e Avokatit të Popullit. Nuk e di se ka institucion më të lartë në Republikën e Kosovës se Kuvendi, çështja e udhëtimeve jashtë, pavarësisht konferencave, të cilat janë të rëndësishme, aq më tepër kur ne si kolegë deputetë, edhe pesë nënkryetarë të Avokatit të Popullit i kemi për t'i çuar për dy orë nga Shkupi e të vijnë në Prishtinë nuk do të kushtonte asgjë.

Unë do ta ndal, në kuptimin do ta bartim deri në këtë pjesë për t'i dhënë mundësi Avokatit të Popullit të vijë në seancë, por në qoftë se e vazhdojmë këtë formë, atëherë do të jetë ashtu secili si të vendosë, kush do, vjen, pastaj e presim, pastaj votojmë, kush na pëlqen, nuk e kritikojmë, kush nuk na pëlqen, e kritikojmë se s'po na respekton si Kuvend, kjo është situata, të keni parasysh, nga dita e hënë është ditur, Shkupi me Prishtinën i ka një orë e gjysmë, dy orë punë kanë qenë për të ardhur në Kuvendin e Republikës së Kosovës për ta paraqitur një raport, tri ditë konferencë, kjo është çështje, e cila le të vazhdojë, por të mos mbajë dikush moral brenda kësaj seance se po thuhet Rregullorja, s'po respektohet, po thuhet standardet, s'po respektohet Kushtetuta. Edhe ne jemi Kosovë, edhe ne i dimë këto pjesë.

Kjo pjesë kalon për pikën e radhës. Ishte edhe kërkesë, vjen Avokati i Popullit. Grupet Parlamentare e kanë përfunduar, vjen Avokati i Popullit, në qoftë se ka pyetje, pastaj lidhet edhe

me deputetë, gjashtë deputetë ishin të lajmëruar më herët për të pasur diskutim lidhur me këtë pikët të rendit të ditës.

Më tepër reagimi ishte te pjesa e respektimit të institucionit si Kuvend i Republikës së Kosovës, ja ku është Shkupi, dy orë, një orë, në fakt.

15. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2017

Komisioni për Legjislacion, në pajtim me nenin 72 të Rregullores së Kuvendit e ka shqyrtuar raportin e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Nuk kam emër nga përfaqësuesi i Komisionit Funkcional për Legjislacion, zoti Hajdar Beqa, paraqite raportin e komisionit. I kisha lutur komisionet parlamentare para seancës le ta sjellin kush e ka përgjegjësinë. Faleminderit!

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

I nderuar kryetar,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitet, Rregullore të Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsion, duke vepruar në pajtim me nenin 72, paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 24 prill 2018 e shqyrtoi Raportin e punës së Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2017 dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë rekomandim:

- Të miratohet raporti i punës së Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2017.

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas me rihapjen e zyrave rajonale në Ferizaj dhe në Gjakovë ka përmbushur shtrirjen rajonale në shtatë qendrat më të mëdha të Kosovës, por nuk e ka përmbushur me mënyrë të plotë nenin 22 të Ligjit për Ndihmë Juridike Falas ku për të bërë mbulueshmëri të plotë në tërë territorin e Kosovës parashihen të hapen zyra mobile në të gjitha komunat e Kosovës.

Përkundër nevojës së kërkesave buxhetore të agjencisë, nuk ka hasur në përkrahje dhe konsiderohet se moshapja e këtyre zyrave paraqet situatën ku të gjithë qytetarët e Kosovës nuk

kanë mundësi të barabartë të realizojnë të drejtat për t'iu qasur në mënyrë efektive sistemit të drejtësisë për shkak të mungesës së mjeteve financiare.

Do të thotë, në mungesë të mjeteve financiare agjencia nuk ka pasur mundësi të hapë zyra mobile në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Ka shumë sfida mbi të cilat ballafaqohet kjo agjenci, por sfida kryesore mbetet sigurimi i buxhetit të qëndrueshëm për t'i plotësuar nevojat e qytetarëve dhe në lëmin penal.

Pastaj sigurimi i një objekti publik për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, në mënyrë që me mjetet e qirasë të paguhen avokatë në lëmenj të caktuar.

Sfidë tjetër u tha se është edhe shtrirja e drejtë dhe e barabartë e agjencisë në të gjitha regjionet, përkatësisht në të gjitha komunat e Kosovës.

Sensibilizimi dhe vetëdijesimi i publikut, veçmas i grupeve të interesit për shërbime që i janë ofruar agjencisë si dhe implementimi efektiv i Planit strategjik për vitin 2015-2019.

Si përfundim, agjencia çdo vit që raporton kërkon t'iu sigurohet një objekt për zyrë që janë me qira dhe nuk kanë kushte të mira të punës dhe të njëjtën kohë kërkon që t'iu rritet buxheti nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Andaj ne si Komision për Legjislacion kemi bërë raportin, u kemi rekomanduar deputetëve për të miratuar sot në Kuvend dhe ju ftoj të gjithëve që ta miratoni këtë raport të agjencisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zotin Lumir Abdixhiku, për arsyetimin e raportit me rekomandime në lidhje me raportin vjetor financiar, nuk qenka kryetari i komisionit.

Përfaqësuesit e grupeve parlamentare, Korab Sejdiu, nga Lidhja Demokratike e Kosovës është lajmëruar.

KORAB SEJDIU: Të nderuar qytetarë,

Kryetar dhe kolegë të nderuar,

Grupi ynë parlamentar e ka shqyrtuar këtë raport dhe ne i përkrahim rekomandimet e komisionit. Besoj që çështjet dhe problematikat kryesore që ndërlidhen me Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas lidhur me vitin 2017, po edhe vitet paraprake, si dhe në vitin 2018 besoj që janë identifikuar në arsyetimin e raportit që është dhënë nga komisioni ynë dhe jemi në përkrahje të tyre.

Mirëpo, edhe pse ne e përkrahim këtë raport, mbesim kritik ndaj mungesës së mbështetjes buxhetore që i jepet këtij institucioni jashtëzakonisht të rëndësishëm, i cili thjesht nuk ka kapacitete financiare dhe njerëzore që t'i mbulojë të gjitha kompetencat, sfidat si dhe nevojat që ekzistojnë në terren lidhur me veprimtarinë që e ka kjo agjenci.

Kështu që ne do ta përkrahim këtë raport, mirëpo bëjmë thirrje që vërtet në rishikim të buxhetit të rritet buxheti i këtij institucioni, me qëllim që të përmbushen të gjitha ose së paku shumica e kërkesave, të cilat janë paraqitur si sfida në raportin e kësaj agjencie. Faleminderit!

KRYETARI: Sami Kurteshi, nga Lëvizja Vetëvendosje, nuk ka as deputetë. Nëse ka, lajmërohuni! Nezir Çoçaj, nga Partia Demokratike e Kosovës, më falni, kolegë deputetë, lajmërohuni se nuk e di kush e kërkon fjalën pa e kërkuar.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar i vetmi ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i PDK-së e ka shqyrtuar raportin e Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas dhe ka arritur në këtë përfundim.

Raporti i agjencisë për vitin 2017 pasqyron në detaje punën e kësaj agjencie, rezultatet në afrim e ndihmës juridike falas për qytetarët sipas ligjit dhe sfidat me të cilat vazhdon të përballet kjo agjenci.

Raporti pasqyron faktin se pothuajse të gjitha rastet, për të cilat qytetarët kanë kërkuar ndihmë juridike ose kanë përfunduar me sukses ose janë në procedurë, gjë që tregon për punën dhe efikasitetin e agjencisë në interes të qytetarëve.

Në raport pasqyrohet edhe bashkëpunim i mirë me Odën e Avokatëve.

Rihapja e zyrave për rajonin e Ferizajt dhe të Gjakovës ka dhënë rezultate të mira dhe ka treguar domosdonë për rihapjen e këtyre zyrave.

Vlen të ceket po ashtu se kontributi i mirë që agjencia po jep edhe në punën praktike të studentëve, të cilat faktohen nëpërmjet memorandumeve të bashkëpunimit me universitetet dhe kolegjet.

Në fund, duke pasur për bazë faktin se ndihma juridike falas për qytetarët është kategori kushtetuese dhe duke pasur për bazë se neni 22 i Ligjit për Ndhimë Juridike Falas parasheh hapjen e zyrave mobile në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, me qëllim të krijimit të

mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët për qasje në ndihmë juridike falas, Qeveria të shqyrtojë mundësitë buxhetore dhe të fillojë hapjen e zyrave mobile nëpër komuna.

Në fund fare, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah dhe e voton raportin e Agjencisë për Ndihmë Juridike falas për vitin 2017 dhe njëherësh i fton të gjithë kolegët e tjerë që ta votojnë këtë raport. Faleminderit!

KRYETARI: Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, për fjalën e dhënë, zoti kryesues!

Unë i kam dy çështje që megjithatë dua t'i ngre.

Trajtimi i çështjes pak më herët nga pozita e kryesuesit në lidhje me raportin e Avokatit të Popullit rreth moralizimeve dhe demoralizimit që janë këtu, mendoj se ishte e padrejtë, sepse kërkesa për ta pasur këtu Avokatin e Popullit për të raportuar është kërkesë kushtetuese, nuk e kam bërë unë personalisht, një.

E dyta, mungesa e Avokatit të Popullit këtu, në të vërtetë unë mendoj se arsyeja është se ne kemi marrë një njoftim për vazhdimin e seancës përmes emailit, nuk e di a ia keni dërguar Avokatit të Popullit?

Po të ishin seancat e parashikuara kohë më parë, sigurisht edhe ai do t'i përshtatej agjendës së Kuvendit të Kosovës, sepse ai ka obligim kushtetues që t'i raportojë Kuvendit të Kosovës.

Prandaj, nuk e di cila ishte arsyeja e moralizimit tuaj nga ajo pozitë.

Po t'i kthehem raportit të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas.

Unë pajtohem edhe me raportin e komisionit, pajtohem edhe me kërkesat e kolegëve të mi parafolës nga grupet parlamentare në lidhje me gjendjen e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas.

Ne po ashtu e kemi shqyrtuar këtë raport, kemi dëgjuar edhe udhëheqësin e agjencisë, kemi diskutuar gjerë e gjatë me të dhe unë nuk do të përsëris të gjeturat apo kërkesat konkrete në lidhje me këtë çështje, po unë dua ta hap një çështje tjetër.

Kjo agjenci ka disa vjet që ekziston, është ndër agjencitë kryesore për ndihmë juridike të qytetarëve të Republikës së Kosovës, sidomos qytetarëve në gjendje jo të mirë ekonomike dhe qytetarëve të varfër, që nuk janë në gjendje të mbrojnë të drejtat e tyre pranë institucioneve shtetërore.

Agjencia për Ndhimë Juridike Falas është në të vërtetë pjesa tjetër, faja tjetër e institucionit të Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit e ka për obligim gjetjen e shkeljeve dhe raportimin e tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe njoftimin e të gjitha organeve për gjetje të tillë dhe shkeljet, sidomos e ka për detyrë dhënien e rekomandimeve të cilat duhet të zbatohen.

Agjencia për Ndhimë Juridike është faja tjetër e kësaj pune. Meqenëse Avokati i Popullit nuk e ka të drejtën ligjore që t'i ndihmojë qytetarët e veçantë në mënyrë konkrete, përmes kërkesave, shkresave pranë institucioneve, këtë punë e bën Agjencia për Ndhimë Juridike Falas.

Lënia anash e Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas nga të gjitha institucionet, sidomos nga Qeveria dhe nga Kuvendi, është pasqyra e drejtë e qasjes që kanë institucionet e Republikës së Kosovës ndaj personave në gjendje të rëndë ekonomike, në gjendje të rëndë shoqërore, të komuniteteve, të komuniteteve jo vetëm etnike, gjuhësore e fetare, po edhe të komuniteteve të tjera, sidomos të personave me aftësi të kufizuar, për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre.

Një kërkesë që duhet ky Kuvend ta ketë parasysh t'ia përcjellë edhe Qeverisë, e këtu kemi vetëm një ministër të Qeverisë, është që t'i mundësohet Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas stabilizimin në aspektin financiar, në aspektin infrastrukturor dhe në aspektin profesional, me kuadro, që të ofrojnë ndihmën e domosdoshme për persona, për njerëz, për qytetarë të Republikës së Kosovës, po edhe për të gjithë personat që gjenden në territorin e Republikës së Kosovës dhe kanë nevojë për ndihmë juridike falas.

Ne duhet ta dimë që ndihmën juridike falas e kërkojnë vetëm njerëzit që s'kanë kah t'ia mbajnë, i pasuri nuk kërkon ndihmë juridike në Agjencinë për Ndhimë Juridike Falas. Kjo është thjesht një obligim për gjithë ata persona që këto institucione, këto qeveri pas luftës e këndej i kanë sjellë në gjendje që të mos kenë mundësi të angazhojnë mbrojtës, avokat, për mbrojtjen e çështjeve të tyre ligjore, të drejtave të tyre ligjore dhe kushtetuese.

Prandaj, edhe një herë po them, pa hyrë në strukturën e raportit, edhe unë do të kisha dëshiruar që raporti i Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas të kishte një kualitet më të mirë në aspektin gjuhësor dhe në aspektin profesional, këtë ua kemi përcjellë edhe atyre, po ndryshe në aspektin përshkruar, deskriptiv, Agjencia për Ndhimë Juridike Falas është një raport i mirë që u është dorëzuar deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim, për marrje seriozisht dhe për trajtim të kërkesave që i bën kjo agjenci.

Kjo agjenci ka një rëndësi të veçantë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njerëzve që nuk kanë mundësi financiare dhe shoqërore të mbrohen vetë nga shkeljet e mundshme të institucioneve.

Prandaj, edhe një herë, edhe në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, edhe në emrin tim personal, si një njeri që angazhohet për të drejtat dhe liritë e njeriut, kisha kërkuar që Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës t'i kenë parasysh kërkesat e drejta dhe të ligjshme të Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas për ndihmë në stabilizimin edhe infrastrukturor, edhe financiar, edhe me burime njerëzore, me njerëz profesionistë, sepse kjo është e domosdoshme.

Natyrisht që Lëvizja Vetëvendosje do ta përkrahë raportin, do të votojë për dhe do të vazhdojë të kërkojë që kësaj agjencie t'i ofrohet çdo ndihmë e kërkuar, sepse kjo është pjesa, faqja tjetër e institucionit të Avokatit të Popullit. Faleminderit!

KRYETARI: Sami Kurteshi, më imponove, duhet të reagoj.

Je një nga njerëzit më të qëndrueshëm në kohën më të rëndë, po flas për periudhën e rëndë, si personalitet. Nuk kisha dëshiruar, pavarësisht politikës, kurrë mos e tjetërso, bile një qëndrim për të cilin je njohur gjithmonë, tash vetëm për hir të politikës nuk jam as ta mbroj, as ta akuzoj Avokatin e Popullit. Në qoftë se dikush duhet ta mbrojë e ta akuzojë, ti duhet, se ke qenë aty, po unë thashë, e kemi ftuar Avokatin e Popullit, e kemi ftuar ditën e hënë, ai na e ka sjellë një shkresë ditën e martë, ka shkuar në Maqedoni për 20-vjetorin e Ombudspersonit, të jem më specifik. Unë nuk e thashë këtë pjesën, e përgëzoj për punën profesionale të cilën e bën, po të paktën sot ka mundur të vijë një orë, dy, kjo ishte ajo pse unë ndoshta, siç po thua ti, si kryesues i kësaj seance, insistova të dërgoj një mesazh jo për shkak të kryesuesit, për shkak tuajin si deputetë, të respektohet Kuvendi, kjo është. Urdhëro, fjala për ju!

SAMI KURTESHI: Faleminderit, për përgjigjen!

Unë nuk i di arsyet, as nuk kam komunikuar me Avokatin e Popullit, natyrisht që kam një respekt dhe interesim të jashtëzakonshëm për institucionin, të mos them se kam konflikt interesi në atë drejtim që kam interesim të jashtëzakonshëm, është e arsyeshme, e kuptueshme. Unë vetëm u thirra në obligimin kushtetues dhe moslejimin për krijimin e precedentëve që raporti kryesor që ka të bëjë me të drejtat dhe liritë e njeriut në Republikën e Kosovës të shqyrtohet pa praninë e personit kryesor që duhet të ishte këtu dhe të orientonte seancën dhe deputetët në lidhje me të gjeturat edhe në lidhje me gjendjen e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës.

Unë megjithatë, respektoj vendimin që diskutimi të kryhet pasi të bëhet raportimi nga Avokati i Popullit, pa marrë parasysh cilat janë arsyet. Çështja tjetër është se kryetarja e komisionit kërkoi shtyrjen e seancës me këtë arsye. Unë nuk e di këtu, nuk ka gjë politike ose jo politike, kërkesa ishte e bazuar në Kushtetutë dhe në ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë me kryetarët e grupeve parlamentare, Frashër Krasniqi nga Partia Socialdemokrate e ka fjalën.

FRASHËR KRASNIQI: Edhe në bazë të raportit vjetor prej Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas mund ta vërejmë që kjo agjenci ka kryer një punë bukur të mirë në ofrimin e kësaj ndihme. Mendoj që do të ishte e rëndësishme që agjencia të na përfshinte në raport, mbase kjo për herën tjetër ose përmes ndonjë raporti ose shtese, se sa raste janë detyruar që t'i refuzojnë nga ana e qytetarëve, për shkak të mungesës qoftë të aspektit buxhetor, qoftë resurseve në përgjithësi të kësaj agjencie. Kjo do të na jepte një pasqyrë më të qartë se a ka mbështetje të mjaftueshme institucionale për punën e agjencisë, edhe buxhetore, përndryshe edhe Partia Socialdemokrate është për miratimin e këtij raporti dhe, në të njëjtën kohë, e përgëzojmë Agjencinë për Ndhimë Juridike Falas për punën e mirë që e kanë bërë dhe bëjmë thirrje po ashtu, që institucionet e Republikës së Kosovës ta mbështesin edhe më shumë këtë agjenci sipas kërkesave të vetë Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Muharrem Nitaj, nuk ka tjetër, as deputetë, as grup parlamentar të paraqitur.

MUHARREM NITAJ: Zoti kryetar!

Me aq sa unë pashë, pika e shqyrtimit të raportit vjetor të institucionit të Avokatit të Popullit përfundoi pak më herët. Unë nuk po arrij të kuptoj pse po i kthehem edhe një herë të njëjtës pikë dhe ju si kryesues i kësaj seance po lejoni, për shembull, të kalojmë nga pika në pikë.

Më falni për injorancën, por unë kam një pyetje për të gjithë deputetët: çka ndodh nëse ne nuk e votojmë raportin vjetor të institucionit Avokatit të Popullit? Punë e madhe fort, nuk ndodh asgjë. Nëse nuk ndodh asgjë, atëherë prej nga gjithë kjo energji, për shembull, që të shpenzojmë orë në debate që nuk prodhojnë kurrgjë. Ju lutem, që të procedoni me pikat e tjera të rendit të ditës. Thatë edhe vetë, janë 70 e sa, t'i përfundojmë, të jemi të efektshëm dhe të mos bëjmë hajgare në këtë sallë. Faleminderit!

KRYETARI: Jemi në procedim, kemi kaluar në pikën tjetër tash. Zoti Sherifi, jemi në procedim, por vetëm për korrektësi se njoftimi ka ndodhur. Tash për korrektësi, zoti Nitaj, unë nganjëherë kisha harruar t'ju ftoj, po Administratën dua ta përgëzoj edhe publikisht, është shumë profesionale. Ftesa ka qenë, kjo ishte temë diskutimi. Zoti Sherifi, fjala për ju. Milaim Zeka, më falni, jo zoti Sherifi, mendova në emër të Nismës ta kryesh edhe për Milaimin.

MILAIM ZEKA: Kryetar,

Vetëm desha të them që Muharrem Nitaj ma ka vjedhur fjalimin tim, kështu që jam në mënyrë absolute dakord me të, kaq desha të them, vërtet nganjëherë jemi shndërruar në sallë cirkusi.

Edhe Dauti, kështu po do të replikojë, më duket, Daut Haradinaj.

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka fjalë të paraqitur më askush.

Vazhdojmë me votimin e raportit vjetor të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2017. Qenkan vetëm 58 deputetë, ja erdhën kolegët. 60, ju kisha lutur edhe një deputet na duhet, 61. Ka deputetë në ambiente të sallës, por është normale largimi në moment, po, tani jemi 61.

Përgatitemi për votim. Jemi te votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2017. Votojmë tash!

Faleminderit! 53 deputetë, 52 kanë votuar për. 1 abstenim.

Nuk ka kaluar ende, por ne po vazhdojmë te pika e shtatë, kjo mbetet ta votojmë në momentin kur i kemi 61 deputetë.

16. Propozimi i Grupit Parlamentar të AAK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Grupi Parlamentar i AAK-së ka propozuar zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare, si vijon: Donika Kadaj-Bujupi propozohet anëtare në Komisionin për Integritet Evropian, në vend të deputetit Ahmet Isufi, ndërsa deputeti Ahmet Isufi propozohet anëtar në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në vend të deputetit Muharrem Nitaj. Kërkohej nga ju vetëm deklarimi me dorë. A jemi 61 deputetë në rend të parë? Në mënyrë formale të aprovohej ky propozim. Sa vota jemi në sallë? 64 deputetë. Votojmë vetëm me ngritje formale dore. Ju lutem, vetëm ngritje formale.

Kuvendi e miratoi propozimin e Grupit Parlamentar të AAK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Edhe një herë kthehemi te pika e mëhershme: *Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2017*. Deputetë të nderuar votojmë edhe një herë, votojmë tash!

Kuvendi me 64 deputetë që kanë votuar, 56 për, 1 kundër, 7 abstenime e miratoi raportin vjetor të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2017.

17. Zgjedhja e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Medieve

Këtë pikë po e lëmë kah pjesa e fundit, në momentin kur mendojmë të shkojmë në pauzë, se na shkëputet seanca, ta keni parasys.

18. Propozim-rezoluta për heqjen e romingut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë

Deputeti Dardan Molliqaj, mbështetur edhe nga 11 deputetë i kanë propozuar Kuvendit për miratim rezolutën për heqjen e romingut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë. Ftoj propozuesin, deputetin Dardan Molliqaj, që në emër të propozuesit ta paraqesë dhe ta arsyetojë propozim-rezolutën. Zoti Sejdiu, fjala për ju.

DARDAN SEJDIU: Ju faleminderit!

Për hir të korrektësisë, zoti Molliqaj vjen për dy minuta, unë po e mbaj fjalën time, më pastaj ai. Ju faleminderit!

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar qytetarë të Kosovës, që po na përcillni sot këtu.

Sot tarifata e romingut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë janë shumë të larta, siç e dini të gjithë, janë të larta në krahasim me ato të BE-së, përkundër mobilitetit të madh të qytetarëve që i kanë këto dy vende, e sidomos sa u përket edhe diskutimeve dhe teknologjisë që përdoren nga këto dy vende për interaksion me njëri-tjetrin.

Miratimi i rezolutës që do ta propozojë zoti Molliqaj shpreh një vullnet politik dhe shtetëror tonin. Sot, kur dy shtetet i kemi me qëllime të përbashkëta drejt BE-së, tarifata e largëta të romingut paraqesin edhe pengesë për përdorimin e telefonisë mobile, jo vetëm sa i përket, të themi kështu, diskutimeve të thjeshta, por për studentë, afaristë e turistë. E dimë se Bashkimi Evropian edhe me agjendën digjitale për Evropën ka paraparë që të ndodhë një ulje apo heqje e tërësishme e romingut dhe kjo ka për qëllim mbrojtjen e konsumatorit, e ul koston e komunikimit dhe rrit bashkëpunimin tregtar. Në fakt, të nderuar deputetë, me Rregulloren e Bashkimit Evropian 2016/2286, e kam këtu me vete, të adaptuar më 15 dhjetor të vitit 2016, trajtohet çështja e heqjes së tarifave të romingut dhe që nga 15 qershori i vitit 2017, me zbatimin e politikës “Roam like home”, pra “Roming si në shtëpi” qytetarët e 28 vendeve të Bashkimit Evropian, përfshirë Norvegjinë, Islandën dhe Lihtenshtajnin, nuk paguajnë fare tarifa të romingut në kuadër të BE-së.

Heqja e romingut do të thoshte dikush që do t’u kushtojë operatorëve publikë dhe privatë, por në fakt në këtu nuk jemi për kompani, por për qytetarët. E sa për humbjet e tyre, konsideroj se rritja e komunikimit, domethënë i zgjerimit të trafikut të telefonisë mobile, do t’i kompensonte shumëfish më shumë humbjet e mundshme nga tarifata që vijnë nga romingu. Pra, logjika është e thjeshtë: me heqjen e romingut intensiteti i komunikimeve mes qytetarëve të dy shteteve do të rritej dhe kështu do të rritej edhe tregu, e pra edhe të hyrat nga tarifata e rregullta.

Për mua si deputet, por në rend të parë si qytetar i këtij vendi janë shumë arsye për ta hequr përfundimisht romingun. Ky rregullim i telekomunikimit është korrekt politikisht, sepse dy qeveritë kanë shprehur vullnetin e tyre. Politikat e Bashkimit Evropian nuk e kundërshtojnë standardizimin e tarifave, në fakt, ky standardizim ka ndodhur më 15 qershor të vitit 2017 dhe këto dy pjesë janë të rëndësishme të parashihen edhe me legjislacionin kombëtar të këtyre dy vendeve. Është thënë fatkeqësisht jashtë kësaj salle, në disa tryeza e në televizione, por po thuhet edhe sot që çështja e romingut e tarifave rregullohet kur të hyjmë në BE dhe që, si duket, mund të ketë edhe pengesa të ndryshme. Humbin kompanitë publike, e humbin kompanitë private që operojnë në Kosovë e në Shqipëri, e pra kjo, në fakt, i bie që edhe Shqipëria nuk dëshiron të hyjë në këtë marrëveshje me neve. Në fakt, kjo nuk është e saktë dhe po e lexoj një pjesë të raportit të strategjisë të Agjencisë së Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Shqipërisë.

“Të gjithë qytetarët që përdorin një kartë sim të lëshuar nga një operator në tregun shqiptar, sipas Agjencisë së Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Shqipërisë, nuk do të kenë tarifa të romingut në vendet e rajonit të Ballkanit”. Këtë e ka parashikuar pra Agjencia e Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Shqipërisë, e ka parashikuar në Planin e veprimit të vitit 2018. Ky dokument i lëshuar nga AKEP thotë: “Qasje e preferuar e AKEP-it, pra Agjencia e Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Shqipërisë, është nënshkrimi i marrëveshjeve dypalëshe me secilin vend të rajonit”. Normalisht, procesi do të kërkojë konsultime me secilin aktor dhe një vlerësim të ndikimit që do të ketë reduktimi i tarifave për ofruesit e telefonisë celulare. Pra, ekziston një vendim i Bashkimit Evropian për heqjen e tarifave të romingut për 28 vendet, plus tri vendet shtesë. Ekziston një vullnet i AKEP-it, pra Agjencia e Komunikimit të Shqipërisë dhe besoj që këto dyja janë si shtylla të mjaftueshme që ne me vullnetin tonë politik të ecim përpara që të heqim tarifat e romingut edhe në mes të Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës.

Por, në anën tjetër, më duhet t’i kthehem kujtesës institucionale, marrëveshjes së Brukselit për çështje të telekomunikacionit të nënshkruar më 8 shtator 2013, dhe pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje Planit të zbatimit, më 25 gusht 2015. Dua të shpërfaq një paradoks: marrëveshja parasheh regjistrimin e një kompanie të re tek Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Ministri të Tregtisë dhe Industrisë, e kjo duhet të bazohet në këtë kornizë ligjore: 1. Marrëveshja për Telekom, të nënshkruar mes Republikës së Kosovës, Republikës së Serbisë dhe Bashkimit Evropian në Bruksel më 8 shtator 2013. Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, më 11 shtator të vitit 2013, për miratimin e marrëveshjes së telekomunikacionit, Ligjit 04/L-199 për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullon normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, të shpallur më 17 shtator 2013.

Pra, kompanisë së re, në kuadër të kësaj marrëveshjeje i sigurohet një licencë e plotë për shërbimet e telefonisë fikse dhe kjo kompani do të jetë degë e një kompanie të Serbisë, të regjistruar në

përputhje me kornizën rregullatore të Kosovës. Ndërsa, sa i përket telefonisë mobile, autoritetet e Kosovës do t'i lëshojnë një kompanie të re një autorizim të përkohshëm, sipas kornizës rregullatore të Kosovës për operime të tashme të kufizuara në infrastrukturën aktuale në terren. E kemi thënë disa herë e vite më parë se kjo marrëveshje e ka një element jashtëzakonisht problematik, e ajo është legalizimi i ndërhyrjeve ilegale të Serbisë në sektorin e telekomunikacionit të Kosovës. Dhe, kjo marrëveshje betonon Kosovën në një rajon që formalisht gjendet në sovranitetin e Serbisë.

E pra, duke pasur këtë paradoks, duke pasur një marrëveshje, një Rregullore të Bashkimit Evropian, e cila e heq fare romingun prej 28 shteteve, përfshirë këtu edhe Islandën, Norvegjinë dhe shtete të tjera, si dhe duke e pasur angazhimin e Republikës së Bullgarisë që në kuadër të kryesimit të saj që e ka në BE që të hiqen edhe tarifat e romingut me shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe duke pasur strategjinë e Agjencisë së Komunikimeve Elektronike Postare të Shqipërisë që i heq dhe tenton t'i heqë me marrëveshje bilaterale të gjitha tarifat e romingut, ne kemi përballë nesh një rezolutë, e cila i shfrytëzon këto tri momente dhe nuk futet në marrëveshje paradoksale me shtetet fqinje, duke ngarkuar edhe më shumë e duke betonuar edhe më shumë telekomin tonë në kuadër të marrëveshjeve të përçudta, e që krijojnë edhe varësi, edhe mospasje të aftësisë për të hyrë në marrëveshje bilaterale me shtete të tjera.

Meqë rregullatorët kombëtarë të telekomunikacioneve janë përgjegjëse për zbatimin e rregullave të romingut, pra AKREP në Kosovë dhe AKEP në Shqipëri, atëherë përmes kësaj rezolute ne duam të bëjmë thirrje që marrëveshja me specifikat e veçanta të nisë përpilimi i këtyre marrëveshjeve mes dy shteteve dhe të nënshkruhen e të zbatohen.

Të nderuar deputetë,

Kolegu im, zoti Molliqaj, do të paraqesë rezolutën, por është tepër me rëndësi që të potencohet që nisje të tilla kemi prej qershorit të vitit 2017 në Bashkim Evropian, kemi iniciativa të Agjencisë së Komunikimeve Elektronike Postare të Shqipërisë që të nënshkruajnë marrëveshje bilaterale me shtetet e rajonit, pra që të hiqen tarifat e romingut dhe, në anën tjetër, gjithashtu kemi edhe ministrin e Jashtëm të Republikës së Bullgarisë, i cili po insiston në kuadër të kryesimit që tarifat të hiqen për të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor. E, meqë ne kemi dy agjenci, pra AKREP-i dhe AKEP-i, që munden shumë lehtë të nënshkruajnë një marrëveshje të tillë dhe të hiqen tarifat e romingut, kërkojmë që të përkrahni këtë rezolutë dhe të ecim përpara me heqjen e tarifave për qytetarët e këtyre dy vendeve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ftoj deputetin Dardan Molliqaj ta paraqesë dhe ta arsyetojë propozim-rezolutën.

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit, kryetar!

Së pari kërkoj falje që s'isha i pranishëm, por rendi i ditës kishte ndryshuar.

Të nderuar deputetë,
Qytetarë të Republikës
Kabinet qeveritar,

Ekziston një marrëveshje mes Kosovës dhe Shqipërisë, e cila është bërë në mars të 2013-ës sa i përket komunikimeve elektronike, me funksion të veçantë edhe çështjes së komunikimeve telefonike. Marrëveshje, e cila pastaj është ratifikuar nga ish- presidentja e Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga.

Pas nismës së grupit tonë për këtë çështje, kam pasur rastin edhe nderin të takoj kryetarin e Bordit të Agjencisë Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Kosovës për të diskutuar në detaje se si është e mundur që kjo nismë të bëhet edhe realitet. Pas informatave shtesë që i kam marrë nga kjo agjenci, edhe rezoluta ka pësuar disa ndryshme, të cilat besoj që edhe me kontributin e deputetëve sot mund të vijmë te një draft i saj i fundmë.

Sipas asaj që kemi marrë të dhëna, flitet për mbi 1 milion thirrje prej telefonave të Kosovës ose prej kompanive të Kosovës në drejtim të Shqipërisë dhe mbi 1 milion pranim të thirrjeve të qytetarëve të Republikës së Kosovës gjatë kohës që qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë. Dallimi në çmim është diku 3 deri në 8 herë më i madh se sa komunikimi mes operatorëve vendorë. Pra, qysh e tha edhe Sejdiu, edhe pse ka tash një agjendë ndërkombëtare edhe për vendet e rajonit, e tash së fundi në Sofje u bë një marrëveshje, po e cila ishte marrëveshje për uljen e tarifave, nuk ishte për heqjen e tarifave, prej agjencisë së ARKEP-it kam mësuar se komunikimet që i bën Kosova dhe Shqipëria, respektivisht qytetarët e Kosovës dhe të Shqipërisë, bëjnë 90% të komunikimeve ndërkombëtare.

Pra, komunikimi është shumë i madh dhe interesi është jashtëzakonisht i madh mes Kosovës dhe Shqipërisë, në krahasim edhe me vendet e tjera. Më lejoni të tregoj që sipas nesh, nisma rrit mobilitetin edhe komunikimin mes vendeve, por edhe njerëzve që janë nëpër pushime ose për punë, po ashtu besojmë që e ul koston jashtëzakonisht të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Pra, bëhet fjalë për më shumë se miliona euro sa i përket kësaj shume që ne paguajmë dhe, në anën tjetër, diskutimi është bërë se si do ta përballojnë kompanitë një veprim të tillë. Ndonëse, në fillim ka një rënie të të ardhurave, shumë shpejt kjo kompensohet për shkak të sasisë së rritur të komunikimeve.

Pra, secili qytetar, kur e ka çmimin më të lirë, e përdor më shumë telefonin se sa në këtë që është duke e përdorur tani. Me të gjitha grupet parlamentare e kam diskutuar projekt-rezolutën, i falënderoj të gjitha grupet parlamentare për diskutimet që i kemi pasur, po ashtu pres që grupet parlamentare, deputetët veç e veç të japin kontributin, vërejtjen dhe sugjerimet dhe, në fund, shpresoj fuqishëm që Kuvendi sot do të miratojë këtë rezolutë, e cila do të hapë rrugën për një marrëveshje të re ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë:

REZOLUTË

Për heqjen e romingut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në kuadër të integritit ekonomik me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, të nisë procedurat për arritjen e marrëveshjes për heqjen e tarifave të romingut në telefoninë mobile ndërmjet qytetarëve të dyja vendeve respektive.
2. Të themelohet komisioni i përbashkët Qeveri-Kuvend, për thellimin e bisedimeve për eliminimin total të tarifave të romingut ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, anëtarët nga Kuvendi, pjesë e këtij komisioni, janë përfaqësuesit e secilit grup parlamentar në legjislaturën aktuale.
3. Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare i Kosovës dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare i Shqipërisë të përkujdesen për implementimin e marrëveshjes.
4. Të thellohet bashkëpunimi në fushën e komunikimeve elektronike, me theks të veçantë dhe të posaçëm në shkëmbimin e trafikut të internetit drejtpërdrejt ndërmjet nyjave shkëmbyese të internetit të dy vendeve.
5. Komisioni i përbashkët të raportojë në Kuvend për arritjen e marrëveshjes dhe ecurinë e eliminimit të tarifave jo më larg se dy muaj nga miratimi i kësaj rezolute.

Faleminderit! Kjo ishte pjesa e rezolutës, të cilën besoj që në fund të debatit edhe do ta votojmë.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Zemaj është lajmëruar.

Ju kisha lutur, në qoftë se ka të interesuar, lajmërohuni. Në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zonja Mimoza Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Mendove në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, si deputete e Alternativës. Faleminderit, ne si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike mbështesim iniciativën e Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate. Është shumë e rëndësishme që në aspektin e shtyrjes dhe vullnetit politik brenda shteteve të Bashkimit Evropian, Bullgaria, si udhëheqëse prej janarit deri në qershor të vitit 2018, ka qenë një shtet që e ka shtyrë përpara heqjen e romingut edhe të vendeve të Ballkanit me vendet e Bashkimit Evropian, duke e marrë shembull se komunikimi midis shtetasve të Bashkimit Evropian mes vete për një minutë është i barabartë me zero, ndërsa me shtetet e Ballkanit mundet të shkojë minuta 2 deri tri euro. Megjithatë, në krejt këtë unë uroj që kjo iniciativë dhe ky bashkëpunim të mos jetë në mesin e iniciativave dhe bashkëpunimit të vullnetit të mirë, të cilat zakonisht janë shprehur në raportet ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. T'i kujtojmë vetëm disa prej marrëveshjeve që janë nënshkruar ndërmjet dy

qeverive dhe gjithashtu vullnetin e mirë që e kanë shprehur qeveritë, por i cili nuk ka zënë vend në realitet. Marrëveshjet tregtare, ose marrëveshjet e tregtisë së lirë, të cilat ekzistojnë për qarkullimin e lirë të mallrave ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë përcillen me parregullsi dhe pengesa të shumta, duke filluar nga ndalesat sezonale të produkteve të prodhuara, kryesisht prej Kosovës për në Shqipëri. E dimë, tashmë janë të njohura sagat e patateve, qumështit, miellit... Gjithashtu e kemi problemin e vazhdueshëm të moskomunikimit të mirëfilltë me çështje që janë substanciale në raport me lëvizjen e lirë dhe natyrisht edhe me funksionimin e mirëfilltë të qarkullimit të lirë. Të mos harrojmë, kohë më parë Republika e Shqipërisë ka vendosur, ose Qeveria e Republikës së Shqipërisë e ka vendosur tarifën e rrugës pa asnjë konsultim me Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Domethënë, me atë çfarë e theksojmë është që më tepër shtyhen interesat ekonomike, të bizneseve dhe kompanive sesa interesat ekonomike kombëtare. Ajo çfarë duhet të ekzistojë për implementimin e suksesshëm të heqjes së romingut ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë është natyrisht përgatitja e agjencive relevante shtetërore dhe gjithashtu bashkëpunimi edhe i kompanive të telefonisë mobile.

Është gjithashtu për brengosje shtyrja e zbatimit të kodit telefonik 383 të Kosovës për më 31 tetor me kërkesën e operatorëve të telefonisë mobile në Kosovë, gjë që tregon se edhe në këtë aspekt mund të ballafaqohemi me shtyrje, apo mund të arrijmë deri te pika kur do të kemi heqjen e romingut në momentin kur të jemi pjesë e një strukture më të madhe të Bashkimit Evropian. Edhe një herë e theksoj që Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështet rezolutën, gjithashtu do t'i mbështetë edhe aksionet të cilat dalin nga zbatimi i kësaj rezolute, por shtyn përpara që kjo rezolutë të mos mbetet vetëm një vullnet, apo një dëshirë e mirë politike, por të ketë edhe zbatimin nga institucionet relevante përkatëse. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

MEMLI KRASNIQI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Sot para nesh e kemi një projekt-rezolutë që ka për qëllim eliminimin e kostove të romingut në telefoninë mobile për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe Shqipërisë.

Ishte koincidençë interesante fakti se kjo pikë ishte paraparë të shqyrtohej pikërisht në ditën kur u nënshkrua dokumenti ndërmjet gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Evropian në Samitin e Sofjes për heqje të romingut ndërmjet gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor, pra përfshirë Republikën e Kosovës, si dhe më tutje të bëhen hapa në drejtim të largimit të romingut edhe me shtetet e Bashkimit Evropian.

Intervenimi për uljen e tarifave të romingut është një praktikë e Bashkimit Evropian që ka për qëllim mbrojtjen e konsumatorit dhe promovimin sa më të madh të përdorimit të teknologjisë. Praktika e BE-së për uljen graduale të tarifave të romingut deri në heqjen e tërësishme të tij brenda vendeve të BE-së ka rezultuar të jetë mjaft e suksesshme. Është me rëndësi të ceket se një praktikë e tillë do t'i afronte edhe operatorët tanë drejt euro-tarifave, që do të duhej të aplikoheshin nga secili shtet me rastin e anëtarësimit eventual në BE.

Në bazë të të dhënave të ARKEP-it, aktualisht në Republikën e Kosovës tarifat e terminimit të thirrjeve lokale dhe atyre ndërkombëtare dallojnë ndjeshëm, sepse tarifat ndërkombëtare janë deri në dhjetë herë më të mëdha se ato kombëtare. Në rastin konkret, pasi kemi të bëjmë me një marrëveshje potenciale ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, duke pasur parasysh se natyrshëm qytetarët e këtyre dy vendeve lëvizjet më të shpeshta i kanë ndërmjet tyre, çështja e heqjes së tarifave të romingut është edhe më e rëndësishme. Edhe në bazë të studimeve të ndryshme për thirrjet në roming dhe shfrytëzimin e të dhënave, për shembull studimi i RCC-së në vitin 2016, nga vendet e Ballkanit numri i atyre që përdorin roming është më i madhi në shkëmbimin ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë.

Duke pasur parasysh faktin se tarifat e romingut janë dukshëm më të larta se ato të thirrjeve kombëtare, atëherë është më e përshtatshme që të ketë zvogëlim të vazhdueshëm të këtyre thirrjeve edhe me shtetet tjera, me të cilat Kosova ka shkëmbime më të shpeshta.

Në bazë të të dhënave të Komisionit Evropian, me largimin e tarifave të romingut në Evropë është shtuar përdorimi i të dhënave gjatë qëndrimit në roming të përdoruesve për tre deri në gjashtë herë dhe është e qartë se një gjë e tillë do të ndodhë edhe për lëvizjen ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. Kjo do të thotë, se me gjithë faktin se mund të ketë një ulje fillestare të fitimit të operatorëve të telefonisë nga ky segment i telefonisë, në afat më të gjatë benefiti për qytetarët është i madh, por edhe për operatorët po ashtu, sepse me rritjen e përdorimit të trafikut, shembujt e Bashkimit Evropian kanë treguar se shtohet edhe fitimi i operatorëve gradualisht.

Sa i përket rezolutës, me gjithë faktin se ne si grup parlamentar e mbështetim këtë iniciativë, konsideroj se në rast të implementimit të marrëveshjes multilaterale të Samitit të Sofjes, me mbështetjen edhe të euro-komisionares për ekonominë digjitale, zonjës Maria Gabriela, në lidhje me tarifat e romingut në regjion dhe më gjerë, kjo do të vlejë automatikisht edhe për Kosovën, edhe për Shqipërinë, si dhe do ta zgjidhte këtë çështje me automatizëm. Po ashtu, duke pasur parasysh faktin se Ligji për komunikime elektronike e parasheh Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik si përgjegjëse për hartimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dypalëshe dhe shumëpalëshe në fushën e komunikimeve elektronike në emër të Republikës së Kosovës, si dhe Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare si zbatues të këtyre marrëveshjeve, mendoj se hartimi i marrëveshjes në fjalë, por edhe i masave për heqje të

romingut dhe mbikëqyrja e implementimit të kësaj marrëveshjeje duhet të bëhet nga këto institucione.

Pa dyshim, është e qartë se një rol me rëndësi në këtë drejtim ka edhe përkushtimi nga pala tjetër, pra Republika e Shqipërisë, për jetësimin e kësaj marrëveshjeje, për çfarë ne mund të paragjykojmë pozitivisht, por ende nuk kemi ndonjë qëndrim zyrtar prej tyre.

Ne besojmë se me heqjen e barrierave të lëvizjes së lirë të qytetarëve të Kosovës do të bëhet edhe më i rëndësishëm eliminimi i romingut për qytetarët që lëvizin në drejtim të Bashkimit Evropian, e në veçanti eliminimi i romingut edhe për diasporën tonë gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë.

Në fund, konsiderojmë se integrimi i tregjeve të komunikimit elektronik duhet të ndodhë, si ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, ashtu edhe me Ballkanin Perëndimor dhe Bashkimin Evropian në tërësi.

Prandaj, si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i mbështetim të gjithë hapat afirmativë në këtë drejtim, duke përfshirë edhe projekt-rezolutën e propozuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Muharrem Nitaj, urdhëro!

MUHARREM NITAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne deputetët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës i kemi dhënë mbështetje nismës së kolegut Dardan Molliçaj me një lloj merak, nëse realisht kjo çështje i takon Kuvendit të Republikës së Kosovës, apo jo. Për fat të keq, Kosova dhe Shqipëria, ose Prishtina dhe Tirana, nuk janë një palë, por janë dy palë. Unë akoma nuk e kam të qartë sesa eventualisht do të mund të ishte obligative miratimi i një rezolute që të shtyhej kjo çështje përpara.

E përmendi kolegu Memli Krasniqi se ka pasur një nismë, faktikisht është nënshkruar një marrëveshje në Samitin e Sofjes për zvogëlimin e romingut, me aq sa unë kam kuptuar, deri në heqjen e plotë.

Realisht, për të pasur një sukses kjo nismë unë besoj, për shembull, që do të duhej të kishte një koordinim ndërmjet Parlamentit të Kosovës dhe Qeverisë së vendit, sepse, siç jeni në dijeni, Qeveria e Republikës së Kosovës disa herë ka provuar që këtë çështje ta shtyjë edhe në kohë të mëhershme. Sidoqoftë, ne si grup parlamentar do ta mbështetim këtë nismë dhe do të kërkojmë që përfaqësuesit e grupeve parlamentare ta harmonizojnë tekstin e kësaj rezolute, në mënyrë që kjo rezolutë të mos jetë një lloj ndërhyrje në një marrëveshje, e cila, megjithatë, duhet të jetë dypalëshe.

Për fat të keq, kjo çështje është e lidhur edhe me biznesin e kompanive të ndryshme dhe unë besoj që pa dakordimin e plotë të Republikës së Shqipërisë, rezoluta do të miratohet, por nuk do të ketë asnjë fuqi imponuese, ose asnjë fuqi në arritjen e një marrëveshjeje për heqjen e romingut. Sidoqoftë, thashë edhe një herë, ne e mbështetim nismën, sepse besojmë që qytetarët e Kosovës janë të goditur në mënyrë specifike me tarifa të larta të komunikimit, sa herë që janë në Shqipëri, ose anasjelltas. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar Nisma, Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Meqenëse kjo rezolutë është një lloj fontanë dëshirash, asgjë më shumë, por që është një iniciativë shumë me vend. Edhe unë po dua të ndërlidhem në atë që e tha Muharrem Nitaj, por pa replikë. Nuk e di, sinqerisht nuk e di a ka ndonjë praktikë të ndonjë vendi tjetër të Bashkimit Evropian, në qoftë se një parlament ka të drejtë të ndërhyjë në marrëveshjet e tilla të kompanive të telefonive mobile, e para.

E dyta, ajo që do ta mbështetim ne si Nismë nuk diskutohet, sepse unë kam interes të dyfishtë, ngaqë jam dhëndër i Shqipërisë, dhe harxhoj shumë duke folur me vjehrrën, edhe me vjehrrin, por unë i kisha sugjeruar Dardanit dhe kolegëve të tjerë, që bashkë me këtë rezolutë t'i bëjmë thirrje Qeverisë shqiptare që të lehtësojë kalimin e qytetarëve të Kosovës, të cilët çdo vikend presin me orë të tëra, e para. Dhe e dyta, nuk po zbuloj diçka por po ia rikujtoj Dardanit dhe kolegëve të tjerë, që ndoshta do të ishte në të mirën e shtetit të Kosovës që të bëjmë një hetim se çfarë ka ndodhur me një investim shumë të madh të para disa viteve ndërmjet Valës dhe një kompanie të telefonisë mobile në Shqipëri, sepse kam informacion se ajo marrëveshje është bërë vetëm për shpëlarje të parave dhe janë vjedhur milionë euro. Nuk e di, zoti Sejdiu a e di apo jo, , apo s'ke dëgjuar për këtë, po flas shumë-shumë seriozisht, ekziston një marrëveshje në mes telefonisë mobile të Kosovës dhe një kompanie të telefonisë mobile në Shqipëri, prandaj do të ishte mirë qa ta mbani shënim këtë informacion që po jua jap. Dhe, Qeveria shqiptare, domethënë Qeveria e Shqipërisë i ka dhënë licencë asaj kompanie dhe kompanisë së Kosovës dhe krejt këta milionë janë avulluar. Prandaj, unë e shoh si të pakuptimtë edhe reagimin e Sindikatës së Postë-Telekomit të Kosovës, të cilët janë bashkëfajtorë për të gjitha ato që kanë ndodhur në Valë dhe në Telekomin e Kosovës.

Tani po dalin ata si "sejmenë" se gjoja po i mbrojnë të drejtat e punëtorëve, e që në këtë rast pakkush në këtë kompani i ka mbrojtur ato të drejta. Prandaj, unë bëj thirrje si Kuvend i Kosovës që pas miratimit të kësaj rezolute të fillojmë me hetimin e kësaj kontrate, të cilën unë mund t'ua ofroj kolegëve të mi deputetë. Është me të vërtetë një skandal për të cilin do të duhej të interesohet Prokuroria e Kosovës.

Ne kemi pasur deklarata edhe nga Pandeli Majko, edhe nga Edi Rama, që thoshin se më 1 janar nuk do të ketë kontroll ndërmjet dy shteteve, gjë që nuk po funksionalizohet. Unë vetë pres çdo të premtë nga dy orë, edhe pse jam deputet, se të dal pa rend pastaj qytetarët po thonë “Ej, ku po shkon ti?”, por kjo do të duhej të merret si një vërejtje dhe një thirrje për Qeverinë shqiptare, sepse është absurde dhe është gjest kriminel që njerëzit që shkojnë për t’i lënë paratë e veta në bregdetin shqiptar me familje e me fëmijë të presin nga dy-tri orë në kufi për të hyrë në Shqipëri.

Si përfundim, Dardan, ne do ta mbështetim këtë iniciativë dhe faleminderit për iniciativën që e keni marrë.

KRYETARI: Faleminderit! Pa grup parlamentar, Islam Pacolli.

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, kryetar!

Përshëndetje kolegë të nderuar,

Kabinet qeveritar, s’është hiç këtu,

Medie,

Kor diplomatik,

Sigurisht që si AKR konsiderojmë që është një rezolutë e qëlluar. Pjesën juridike nuk e dimë saktësisht si mund të zgjidhet, por ne si AKR e mbështetim dhe është e nevojshme dhe e dobishme për qytetarin e Republikës së Kosovës, por besoj edhe të Republikës së Shqipërisë.

Kolegu që e përmendi çështjen e marrëveshjeve më herët, që ka mundësi të ketë keqpërdorime. Kisha bërë thirrje që të shqyrtohet mirë dhe të hulumtohet nëse ka pasur keqpërdorim, për arsye se taksa e qytetarit është taksë e shenjtë, nuk është buxhet i Qeverisë së Kosovës që ka pikur prej diku, por është një buxhet që është pikërisht nga qytetari i Kosovës. Prandaj, është e rëndësishme që edhe ajo të shqyrtohet.

Megjithatë, e përgëzoj Dardanin për fillimin e kësaj rezolute. Ne do ta mbështetim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Grupet parlamentare e përfunduan. Armend Zemaj, urdhëro!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Është e vërtetë që fuqia e rezolutave shpeshherë është zbehur me veprimet, apo ta quaj asht mosveprimet e autoritetit, i cili është i obliguar sipas raportit kushtetues që t’i respektojë, ajo është Qeveria e Republikës së Kosovës. Por, nuk do të thotë që pengesat ligjore mund të jenë barrierë e lehtësimit e zhvillimit ekonomik të Republikës së Kosovës, mbi të gjitha përfaqësimit të interesave të qytetarëve të vendit tonë, qoftë edhe jashtë kufijve të saj.

Rezoluta e ka qëllimin fisnik, ta quaj kështu. Është e përmbledhur në atë dhe në kërkesat të cilat i kanë pasur qytetarët tanë, sidomos në lëvizjen dhe në përdorimin e telefonisë në Republikën e

Shqipërisë. Besoj se ajo çfarë i mungon është vetëm propozimi për ndryshimet legjislative dhe kompetencat që i ka Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare i Kosovës dhe tek atëherë mund ta autorizojmë Qeverinë e Republikës së Kosovës, sepse edhe ashtu e autorizon ligji, i jep autoritet dhe autorizim të përgjithshëm edhe kësaj agjencie dhe e obligon në njëfarë forme që këto vendime lidhur me përcaktimin e tregjeve të përbashkëta të implementohen në bazë të marrëveshjeve, të cilat mund dhe duhet t'i arrijnë dy qeveritë përkatëse.

Kështu që e kisha lutur edhe propozuesin, por edhe anëtarët të cilët i ka menduar që të jenë pjesë e grupeve parlamentare, që të kenë parasysh apo më mirë të them t'i hulumtojnë ndryshimet legjislative që duhet t'i përshtaten kësaj rezolute dhe në kuadër të kompetencave tona si Kuvend, por edhe të dhënies së përgjegjësisë së Qeverisë mbi Autoritetin Rregullator, atëherë edhe kjo mund të bëhet e implementueshme në kuadër edhe të asaj që disa kolegë këtu me të drejtë e përmendën edhe marrëveshjen tash që ka dalë kornizë nga Samiti i BE-së në Sofje, ku kërkohet ulja e tarifave deri te eliminimi në total të romingut në Evropën Juglindore. Kështu që ne i japim përkrahje, sigurisht që në bazë edhe të përgatitjeve dhe njerëzve që janë më të afërt profesionalisht, por pjesa legjislative duhet të përmbushet, nëse dëshirojmë që këtë ta rikthejmë në diçka të implementueshme. Nëse mbetet kështu siç është, është më shumë deklarative dhe qytetarët tanë, që lëvizin në Republikën e Shqipërisë dhe ata që lëvizin këtu, vetëm do ta dëgjojnë si propozim të mirë të Kuvendit dhe vullnet i mirë i deputetëve të Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! I kërkoj falje Grupit Parlamentar Lëvizja Vetëvendosje. Ka ndodhur një gabim. Në radhën e grupeve parlamentare e kemi tejkalluar Lëvizjen Vetëvendosje. Glauk Konjufca, fjala për ju!

GLAUK KONJUFCA: Natyrisht që këto tarifat e romingut ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë janë bile aq të larta, saqë është e paprecedent të ndodh edhe ndërmjet dy shteteve që janë kontinente të ndryshme. Edhe shtetet që janë krejt në kontinente të ndryshme kanë tarifa më të ulëta, e lëre më të themi, shqiptarët ndërmjet vete. Kjo është e pakuptueshme dhe ka qenë gjithmonë e patolerueshme.

Nëse hiqen tarifat e romingut ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, unë mendoj se kjo do të kishte vetëm të mira, do të kishte efekte pozitive për qytetarët, edhe në Kosovë, edhe në Shqipëri. Pra, nëse bëhet një marrëveshje e tillë, kjo nuk do të kuptohet kundër askujt. Kjo nuk është marrëveshje kundër dikujt, është thjesht marrëveshje për të mirën tonë. Qytetarëve ua lehtëson komunikimin dhe prej kësaj nuk ka asgjë të keqe, vetëm të mira. E aq më tepër, kur kjo është si njëfarë lloj tendence e qartë që po ndodh edhe brenda shteteve të Bashkimit Evropian dhe jo vetëm shteteve që tashmë janë pjesë e Bashkimit Evropian. Kjo po ndodh edhe ndërmjet shteteve

që po bëjnë marrëveshje bilaterale, e të cilat janë ende të paintegruara në Bashkimin Evropian, siç po bën Serbia, Mali i Zi, Maqedonia, edhe Bosnja bile, e kyçur në këto iniciativa.

Dhe, kur e kemi parasysh edhe vetë relacionin historik të Kosovës me Shqipërinë, si dy shtete të cilat për çdo vit qeveritë e këtyre shteteve mblidhen dhe me shumë pompozitet po nënshkruajnë me dhjetëra e dhjetëra marrëveshje, që ta lehtësojnë bashkëpunimin me njëra-tjetrën, atëherë është me të vërtetë e pakuptueshme qysh deri tash qeveritë e të dyja vendeve nuk e kanë marrë një iniciativë të tillë për t'i hequr këto tarifa, të cilat janë aq të larta, e i dëmtojnë aq shumë qytetarët e të dyja vendeve kur i shfrytëzojnë shërbimet e telefonisë mobile në të dyja vendet respektive.

Prandaj, duke i pasur parasysh të gjitha këto, do të ishte shumë mirë heqja e romingut dhe ne do të jemi në përkrahje të këtij propozimi.

KRYETARI: Faleminderit! Hajdar Beqa dhe s'ka të tjerë të lajmëruar prej deputetëve.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Propozimi i rezolutës për heqjen e romingut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë konsideroj që është një ide e mirë, është në interes të qytetarëve të të dyja vendeve, por mendoj se ne duhet ta analizojmë sa mund ta implementojmë këtë ide, duke pasur parasysh që veprime të tilla kanë ndodhur edhe në të kaluarën. Ndoshta propozuesi e ka bërë para datës 17 maj, por ne e kemi pasur edhe në Samitin e Sofjes, shtetet e Ballkanit e kanë nënshkruar një marrëveshje për uljen e tarifave, që është një ide e mirë, por që nuk e parandalon një marrëveshje ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

Ne duhet ta dimë se për të ndodhur një marrëveshje e tillë duhet të ketë vullnet të dy shteteve, jo vetëm i Republikës së Kosovës, por edhe i Republikës së Shqipërisë. Ne si Kuvend kemi të drejtë t'i rekomandojmë Qeverisë, ta bëjmë një rezolutë që Qeveria t'i iniciojë bisedimet nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, se ajo është kompetente t'i iniciojë bisedimet me Shqipërinë, kurse ARKEP e bën vetëm implementimin. Por, duhet ta bëjmë të qartë edhe për qytetarët se nuk është një ide e re. Me sa di unë, edhe në të kaluarën, Kuvendi i Republikës së Kosovës e ka nxjerrë një rezolutë të tillë për heqjen e romingut.

Qeveritë e dy shteteve, respektivisht ish-Qeveria e Republikës së Kosovës, diku në vitin 2012 apo 2013 e kanë mbajtur një mbledhje të përbashkët, me të cilën janë pajtuar në parim për një marrëveshje të tillë, e cila nuk është zbatuar. Andaj, është mirë t'i shohim të gjitha mundësitë, t'i bëjmë hulumtimet dhe t'i shohim të gjitha mundësitë ligjore që një marrëveshje e tillë të jetë me të vërtetë rezolutë implementuese, e jo vetëm rezolutë dëshiruese. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka deputetë të tjerë të lajmëruar. Atëherë, është propozuesi i propozim-rezolutës. Urdhëro, zoti Molliçaj, fjala për ju!

DARDAN MOLLIÇAJ: Faleminderit, kryetar!

Faleminderit të gjithë deputetëve dhe grupeve për ato që i thanë.

Megjithatë, po përpiqem që disa prej adresimeve që i patën t'i diskutoj edhe një herë. Pasi e kam marrë nismën, Zoti Beqa, ajo ka ndodhur më 20 prill, pra para Samitit të Sofjes. Shumë mirë që ka ndodhur edhe kjo në Sofje, por është para saj kërkesa, e kam takuar agjencinë, e cila e ka përgjegjësinë për këtë punë, për të kuptuar se si realizohet një nismë e tillë.

Pra, pikërisht për të mos mbetur çështje e një vullneti politik, kam dashur të di se cilët janë hapat që e bëjnë rezolutën të implementueshme dhe përmirësimet që janë bërë në rezolutë janë edhe sugjerimet e agjencisë, në bazë të asaj që ata e njohin fushën shumë më mirë se sa secili prej nesh.

Kështu është rregulli, Kuvendi ka të drejtë ta obligojë Qeverinë, ashtu qysh e dini ju, në bazë të ligjit dhe Kushtetutës, për çfarëdo veprimi, i cili është në interes të qytetarëve.

Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Zhvillimit Ekonomik është përgjegjëse për nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale me një shtet tjetër, në këtë rast, me Republikën e Shqipërisë, përkatësisht ministrinë respektive në Shqipëri.

Pra, Kuvendi sot e shpreh një vullnet politik, e obligon Qeverinë për të bërë një marrëveshje të re, se ne e kemi një marrëveshje me Shqipërinë dhe marrëveshja e re implementohet nga agjencitë, agjencitë nuk bëjnë marrëveshje, agjencitë i implementojnë marrëveshjet dhe, në këtë kuptim po shpresoj që edhe shqetësimi i deputetit Nitaj po mundohem t'i përgjigjem, sepse i kam pyetur institucionet.

Pra, rregulli është ky: Kuvendi e shpreh një vullnet politik që i bën thirrje Qeverisë të bëjë marrëveshje të re, marrëveshjen e re Qeveria duhet ta sjellë ose në Kuvend ose sikurse ka bërë herën paraprake, presidenti ta nënshkruajë si marrëveshje ndërkombëtare dhe prej atij momenti agjencitë përkatëse të dy vendeve e implementojmë marrëveshjen e re. Kështu që nuk ka shkelje, përkundrazi është në përputhje me procedurat.

Ajo që u tha më herët, unë nuk jam përfaqësues i Shqipërisë dhe nuk e di, por Agjencia për Rregullimin e Komunikimeve Elektronike në Shqipëri në planin e strategjisë, të cilin e theksoi Dardan Sejdiu, po e theksoj edhe një herë, e ka shprehur se gjatë vitit 2018 synon t'i largojë tarifën e romingut në rajon dhe ka synim të ketë marrëveshje dypalëshe, sepse këto marrëveshje që janë në regjion, që janë bërë edhe në Sofje, janë marrëveshje të ngadalshme dhe i ulin tarifën,

po siç e thamë edhe më herët, edhe zoti Krasniqi, edhe unë, edhe të tjerët, sasia e komunikimeve mes Kosovës dhe Shqipërisë është e pakrahasueshme me krejt vendet e tjera dhe kjo është prioritet.

Po ashtu, po e konfirmoj këtu që agjencia jonë që është për këtë punë, ARKEP-i, kryetari i Bordit në takim që e kam pasur, sikurse këta të Shqipërisë preferojnë marrëveshje dypalëshe. Pra, për këta është më lehtë e implementueshme dhe më e mirë nëse marrëveshjet bëhen në mes të dy vendeve, një herë me Kosovës, pastaj me Shqipërinë, pastaj me Maqedoninë, e kështu me radhë.

Pra, është në interesin edhe të agjencisë së Shqipërisë, edhe të Kosovës që marrëveshjet të jenë dypalëshe dhe kjo, që ta dini, nuk po bëhet veç me Shqipërinë, ne tashmë e kemi me Serbinë. Marrëveshja për telekomunikacionin që është bërë në Bruksel, Kosova dhe Shqipëria llogariten edhe më keq se sa po e bëjmë ne këtu. Kosova dhe Serbia, më falni, llogaritet si thirrje lokale, thirrja prej Beogradi në Prishtinë është thirrje lokale.

Pra, ne me Serbinë tashmë e kemi, ndonëse ende nuk është e implementueshme për shkak të problemeve, kështu që pasi që e kemi me Serbinë, mendoj me disa defekte goxha të mëdha, ajo çka ne sot po synojmë është të kemi me Shqipërinë, për shkak se është interes i madh, siç e thatë të gjithë ju.

Unë po lexoj edhe një herë tekstin e rezolutës, të cilën po e them, e kam konsultuar me Agjencinë e Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Kosovës dhe pas konsultimit me ta dhe pas idesë se është i pranueshëm, është i kuptueshëm dhe është i ligjshëm, e kemi vendosur përmirësimin.

Megjithatë nëse ka dikush tutje prej grupeve parlamentare edhe ndonjë plotësim, sigurisht që jemi të hapur.

Përndryshe, rezoluta është kjo:

REZOLUTË

për heqjen e romingut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në kuadër të integritit ekonomik me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, të nisë procedurat për arritjen e marrëveshjes për heqjen e tarifave të romingut në telefoninë mobile ndërmjet qytetarëve të të dy vendeve respektive.
2. Të themelohet komision i përbashkët Qeveri-Kuvend për fillimin e bisedimeve për eliminimin total të tarifave të romingut në Kosovë dhe në Shqipëri.

3. Anëtarët nga Kuvendi, pjesë e këtij komisioni, janë përfaqësues të secilit grup parlamentar në legjislaturën aktuale.

4. Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare i Kosovës dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare i Shqipërisë të përkujdesen për implementimin e kësaj marrëveshje.

5. Të thellohet bashkëpunimi në fushën e komunikimeve elektronike, me theks të veçantë dhe të posaçëm në shërbimin e trafikut të internetit drejtpërdrejt ndërmjet nyjave shkëmbyese të internetit të dy vendeve.

6. Komisioni i përbashkët të raportojë në Kuvend për arritjen e marrëveshjes dhe ecurinë e eliminimit të tarifave, jo më larg se dy muaj nga miratimi i kësaj rezolute. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim i propozim-rezolutës për heqjen e romingut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

Jemi 70 deputetë në sallë.

Për këtë çështje. Jemi në proces të votimit.

Urdhëro, zëvendëskryeministri na ka nderuar me praninë e vet.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit, kryetar!

Pa protokoll të lartë, mbështetje të plotë në emër të Qeverisë, veç votoni dhe zbatim sa më të shpejtë.

KRYETARI: Kjo është përkrahja.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

70 deputetë kanë votuar, 69 për, një abstenim.

Kuvendi e miratoi rezolutën për heqjen e romingut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

19. Propozim-rezoluta për hapjen e tërësishme të kontrollit për hyrje-dalje të shtetasve të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë nëpërmjet pikave të kalimit kufitar në Vërmicë, Qafë Prush dhe Qafë Morinë

Deputeti Dardan Molliqaj, mbështetur edhe nga 11 deputetë i kanë propozuar Kuvendit për miratim rezolutën për hapjen e tërësishme të kontrollit për hyrje-dalje të shtetasve të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë nëpërmjet pikave të kalimit kufitar në Vërmicë, Qafë Prush dhe Qafë Morinë.

E ftoj deputetin Dardan Molliqaj që në emër të propozuesit ta paraqesë dhe ta arsyetojë propozim-rezolutën.

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit, kryetar!

Së pari i falënderoj të gjitha grupet parlamentare dhe të gjithë deputetët për mbështetjen që dhanë me votë rezolutës për heqjen e tarifave të romingut mes Kosovës dhe Shqipërisë.

Në vazhden e disa prej nismave që e kemi marrë si Parti Social Demokrate në Kuvendin e Republikës së Kosovës që ka të bëjë me bashkëpunimin në mes të Republikës së Kosovës dhe Shqipërisë është edhe nisma e dytë, po jo e fundit, sepse është edhe një nismë tjetër që ka të bëjë me unionin doganor mes Kosovës dhe Shqipërisë.

Po mundohem të paraqes një arsyetim pse kjo rezolutë është e rëndësishme dhe pse ne duhet të marrim edhe një vendim si Kuvend sa i përket lëvizjes së lirë mes Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

Republika e Kosovës me Republikën e Shqipërisë ka nënshkruar me dhjetëra marrëveshje ndërkombëtare, e kanë mbajtur edhe takime ndërmjet të dy qeverive dhe ky është një fakt pozitiv, por konsideroj se për plot marrëveshje aspektet profesionale janë vonuar shumë, siç u tha edhe më herët nga shumë deputetë.

Marrëdhëniet tona duhet të themelohen mbi respektin dhe bashkëpunimin, ne duhet t'i përmbushim shpresat dhe pritjet e qytetarëve tanë, ne duhet të përmbushim parimin bazë të demokracisë, atë të lëvizjes së lirë dhe të pakufizuar.

Vlerat tona themelore janë të përbashkëta, ndërsa sfidat duhet t'i përmbushim me veprime të përbashkëta bashkëpunimi dhe solidariteti.

Hapja e kufijve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë do t'i eliminonte të gjitha vështirësitë dhe pengesat administrative, me të cilat ballafaqohen qytetarët e të dyja vendeve.

Konsiderojmë që hapja e kufijve nuk i zhvillon krimet transnacionale, të dy shtetet u sigurojnë qytetarëve kursime të mëdha të kohës, të dy shtetet kanë standarde të përafërta jetese, të dy shtetet nuk janë të rrezikuara nga ndonjë valë e madhe e refugjatëve.

Sipas Vjetarit të statistikave të Republikës së Kosovës, partneri kryesor i Kosovës nga viti 2014-2016 renditet Shqipëria si e para.

Po ashtu turistët nga Kosova në vitin 2016 kanë përbërë 45% të vizitorëve të huaj nga 37 që vlerësohej në vitin 2014.

Ndërsa sipas statistikave zyrtare raportohet se në qershor të vitit 2017 pjesa më e madhe e vizitorëve, 31% janë, nga Kosova, 12% nga Maqedonia, 6.5% nga Mali i Zi.

Kurse sipas INSTAT, gjatë vitit 2016 nga Kosova drejt Shqipërisë u shënuan diku rreth 220 mijë hyrje, ndërsa në vitin 2017 u shënuan 175 mijë hyrje. Pra, rreth 40 mijë hyrje më pak.

Kosova është i vetmi vend që ka shënuar bilanc negativ të hyrjeve.

Pra, krejt kjo vjen si rezultat i vonësive të mëdha, siç e tha edhe deputeti Zeka dhe të gjithë ju që jeni dëshmitarë në kalimin kufitar Kosovë-Shqipëri.

Prandaj, për arsye të lartcekura propozoj që Kuvendi i Republikës së Kosovës, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 65, paragrafi 1 i pikës 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 6, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, të nxjerrë rezolutë.

Para se ta lexoj rezolutën, edhe disa arsyetime.

Njëjtë sikur për rezolutën e parë, edhe për këtë rezolutë e kam takuar ministrin e Punëve të Brendshme për të diskutuar se a është e mundshme kjo rezolutë, cilat janë pengesa që mund të ketë në implementimin e saj dhe rrethanat politike.

E falënderoj publikisht ministrin e Punëve të Brendshme për kohën që ka ndarë dhe për bisedën që kemi pasur.

Në kuadër të diskutimeve që i kemi pasur, edhe ministri ka shprehë vullnetin dhe interesimin që të kemi një lëvizje në këtë drejtim.

Ministri po ashtu ka treguar që gjatë muajve të verës, me vendim të ministrive respektive, bëhet një lehtësim në kalimin, duke mos u kontrolluar secila veturë, po pesë vetura jo, një po, dhe po

ashtu ka treguar për patrullimin e përbashkët të Policisë së Kosovës dhe Policisë së shtetit shqiptar në territorin e Shqipërisë, për të lehtësuar sa më shumë kontrollin e ndryshëm andej.

E kemi shqyrtuar në ka praktika ndërkombëtare për çështje të tilla. Pra, a mundën dy shtet t'i hapin kufijtë për qarkullim të lirë të njerëzve. Ajo që kemi parë nga praktika është që shumë para se të ekzistonin zona të tjera të lirisë së lëvizjes, si Shengeni, e të tjera, ka pasur marrëveshje bilaterale mes shteteve skandinave, ku kalimi i pikave kufitare për njerëz ka qenë i lirë, ose koncepti i kufijve të hapur.

Pra, ajo që ne sot po propozoj është një praktikë e vendeve perëndimore, përkatësisht vendeve tashmë në Bashkimin Evropian dhe po ashtu ka qenë praktikë mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kanadasë.

Pra, është një rregull, i cili është praktikuar edhe është një precedent, i cili është realizuar.

Të gjithë e dimë që orë të tëra të pritjes janë të panevojshme, janë të padrejta. Madje, në bazë të hulumtimeve që ishin bërë në këto vende që i përmenda më herët sa i përket krimit dhe rritjes së krimit përmes metodës së mostrës së përzgjedhjes së rastësisë së kontrollit, pra shumë rrallë, rezultatet tregonin që shumë më pak ka pasur krim dhe korrupsion, si të thuhet, ose trafikim të çështjeve përmes kufirit pikërisht kur është bërë koncepti i kufijve të hapur.

Në anën tjetër, të gjithë e dimë që pjesa më e madhe e krimit dhe kriminaliteti çfarëdo qoftë, ndërmjet vendeve, nuk bëhet përmes kufirit, ajo është nëpërmjet rrugëve ilegale. Kështu që ky nuk është një argument, të cilin do ta presim.

Pyetja tjetër që e kemi pasur ka qenë: a e pengon kjo Kosovën dhe Shqipërinë, njëra është në prag të hapjes së negociatave për anëtarësim në BE dhe tjetra është në prag të vendimit për liberalizim të vizave, që të gjithë po presin të ndodhë këtë vit.

E kemi parë korpusin e ligjeve të BE-së, se a është në kundërshtim dhe a ka ndonjë pengesë.

Po ashtu, me përgjegjësi të plotë e themi që kjo gjë nuk e pengon asnjërin nga vendet, për shkak se edhe Shqipëria, e cila e ka liberalizimin e vizave, dalja nga shteti si saj shkon përmes pasaportave. Pra, ne nuk po hyjmë në një territor Shengen, si të themi, nuk po hyjmë në një territor ku lëvizet pa pasaportë kur e lëshon, për shkak se kanë liberalizimin e vizave.

Po ashtu, ajo që unë mund të them është që me ministrin kemi rënë dakord që nëse rezoluta merr mbështetje nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, pra ky është vullnet politik i përfaqësuesve të qytetarëve të Republikës së Kosovës, Kuvendi bashkë me ministrinë përkatëse dhe Qeverinë t'i marrë parasysh të gjitha sfidat që janë dhe të mos marrë asnjë veprim, i cili në çfarëdo mënyre do

të pengonte vendimin për liberalizim të vizave apo pengimin për fillimin e negociatave mes Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian.

Pra, kalimi i rezolutës sot e shpreh një vullnet politik, bazohet në precedent ndërkombëtar të vlerave perëndimore, është interes jetik për qytetarët e Republikës, sepse kalojnë diku mbi 800 mijë njerëz nga Kosova në Shqipëri në vit dhe nuk e dimë për pjesën sa nga Shqipëria në Kosovë, kjo lehtëson edhe biznesin, kjo lehtëson të gjitha shkëmbimet e tjera.

Kështu që besojmë që është shumë me rëndësi dhe jemi të bindur po ashtu që nuk paraqet kurrfarë pengese as politike, as gjeostrategjike.

Në kuadër të kësaj, për këtë rezolutë i kemi dy pika:

REZOLUTË

për hapjen e tërësishme të kontrollit për hyrje dalje të shtetasve të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë ndërmjet pikave të kalimit kufitar në pikat kufitare Vërmicë, Qafë Prushi dhe Qafë Morinë

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të nisë procedurat e domosdoshme kushtetuese ligjore për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare për hapjen e kufijve për qarkullimin e lirë të njerëzve, të cilët janë shtetas të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës.

2. Të gjitha procedurat e nevojshme në lidhje me këtë çështje të nisen menjëherë, me miratimin e kësaj rezolute.

Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet marrëveshjen bilaterale, e cila heq detyrimin për qytetarët e dy shteteve për të udhëtuar me letërnjoftim dhe pasaportë, duke lejuar që shtetasit të dy shteteve respektive të udhëtojnë drejtpërdrejt dhe pa u penguar ndërmjet pikave të kontrollit kufitar, duke përfshirë moskontrollin e automjeteve me shpejtësi të reduktuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Bilall Sherifi është i vetmi që e ka kërkuar fjalën. Po e përfundojmë edhe këtë pikë të rendit të ditës, pastaj menjëherë kthehemi te pika e tetë, pasi kemi deputetë, e shkojmë në pauzë, po tash të mos e lë të hapur pikën e rendit të ditës, ta përfundojmë këtë pjesë.

Bilall Sherifi, grupet parlamentare dhe deputetët, kush dëshiron diskutim, se mos nuk po bashkohemi.

BILALL SHERIFI: Kryetar!

Kur unë e kërkoja fjalën, mendova që do të flasim njëherë të gjithë shefat e grupeve parlamentare, e kur të më vijë radha, do ta merrja fjalën, po si duket vetëm unë paskështa kërkuar.

Pra, nuk kam çka i shtoj kësaj, pos të them që po e mbështesim këtë ide dhe shpresoj që propozuesit të ketë harmonizuar me Qeverinë e Republikës së Kosovës se si do të implementohet kjo në praktikë, se deri ku mund të shkojmë, çka mund të bëjmë.

Sa i përket Nismës, po, ne e mbështesim idenë. Faleminderit!

KRYETARI: Zonja Hykmete apo zoti Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar. Në emër të grupit, zonja Hykmete Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah projekt-rezolutën për një hapje të tillë, megjithatë desha të theksoj disa gjëra lidhur edhe me marrëveshjet e shumta, të cilat janë nënshkruar në mes të dy qeverive dhe ajo se çka u bisedua edhe gjatë diskutimit për projekt-rezolutën, të cilën sapo e kaluam për romingun.

Në mandatin e kaluar qeverisës janë mbajtur dy mbledhje të përbashkëta në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe janë arritur një numër i madh i marrëveshjeve, qoftë për bashkëpunim ekonomik, qoftë për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë së kontrolleve kufitare dhe shumë marrëveshje të tjera.

Ajo çfarë desha të theksoj dhe t'ua bëj me dije përfaqësuesve të kësaj Qeverie është që nënshkrimi i marrëveshjeve nuk do të thotë që ato natyrshëm do të implementohen.

Në fakt, edhe pas nënshkrimit të marrëveshjeve, sidomos atyre për lehtësimin e tregtisë në mandatin e kaluar, ne disa ministra jemi angazhuar shumë që ato marrëveshje të zbatohen.

Nëse ju kujtohet, gjatë mandatit të kaluar, me insistimin tonë dhe me takimet që i kemi pasur, duke filluar prej presidentit të Shqipërisë, në atë kohë zotit Nishani, kryeministrit Rama dhe kryeparlamentarit Meta, kemi ndikuar që Republika e Shqipërisë ta ndryshojë ligjin, i cili ka ndaluar pasimin e produkteve farmaceutike të prodhuara në Kosovë në tregun shqiptar. Ky problem ka qenë që nga viti 2013, mirëpo ne në vitin 2016 kemi arritur që ta adresojmë një problem të tillë dhe sot kompanitë farmaceutike nga Kosova mund t'i regjistrojnë dhe t'i certifikojnë produktet e veta farmaceutike në tregun shqiptar.

Ka pasur edhe probleme të tjera, të cilat i kemi adresuar, mirëpo kjo ka kërkuar punë dhe angazhim të vazhdueshëm nga ana e ministrave të Kosovës, të cilët është dashur që të insistojnë në zbatimin e marrëveshjeve me Shqipërinë.

Edhe unë, si shumë të tjerë, kam frikë që kjo do të mbetet një iniciativë e njëanshme, në qoftë se nuk ka vullnet politik.

Ne kemi parë reagimet për taksën në Rrugën e Kombit, të cilat kanë munguar pothuajse komplet nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Kemi parë reagimet e shoqatave të biznesit, të deputetëve individualisht, të grupeve parlamentare, po nuk kemi parë asnjë iniciativë konkrete nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të ulet në tavolinë me kryeministrin Edi Rama dhe të diskutojnë për taksën në Rrugën e Kombit.

Mos harroni që përpos një zvatjeje nga ana e qytetarëve, atyre 800 mijë që u përmendën, që kalojnë kufirin Kosovë-Shqipëri dhe shkojnë për të shpenzuar dhe për të kaluar pushimet e tyre në bregdetin shqiptar, është barrierë tepër e madhe taksa rrugore, e cila është pezulluar vetëm përkohësisht, për shkak të kërkesës së banorëve të Kukësit, është barrierë shumë e madhe për bizneset shqiptare, në të dy anët kufirit, të cilat dëshirojnë të rrisin bashkëpunimin ekonomik edhe tregtar.

Më lejoni t'ju informoj që përpos taksës rrugore, ata paguajnë edhe një taksë tjetër, e cila ka të bëjë me skanimin e kamionëve, të cilët transportojnë mallra në Kosovë dhe Serbi dhe në shumicën e pikave kufitare, në fakt, këta skanerë nuk janë fare funksionalë, mirëpo për shkak të një kontrate koncesioni me një kompani private, kompanitë edhe sot e kësaj dite paguajnë deri në 25 euro për një gjë të tillë.

Kur jemi të unifikimi i pikave kufitare, ne përkrahim një gjë të tillë, normalisht Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht doganat e Kosovës duhet të kujdesen shumë që të mos ketë evazion fiskal dhe të mos ketë evazion doganor.

Në qoftë se kjo do të parashikohet mirë dhe do të preventohet kontrabanda, atëherë jemi në përkrahje të plotë të kësaj, sepse mendojmë që kështu do të rritet edhe bashkëpunimi ekonomik me Shqipërinë, i cili është tepër i nevojshëm dhe, në fakt, ne konsiderojmë që tregu i Serbisë në Kosovë është potencial shumë i madh për Shqipërinë, megjithatë presim të ketë një mikpritje të kompanive kosovare edhe në tregun e Shqipërisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nait Hasani, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Ne e mbështesim këtë rezolutë, unë mendoj që populli ynë ka bërë një luftë të jashtëzakonshme, edhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës për t'i hequr këto pika kufitare.

Prandaj, edhe ne e mbështesim këtë rezolutë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Lëvizja Vetëvendosje, Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit! Është e kuptueshme që qëndrimi i Lëvizjes Vetëvendosjes është për të hequr çdo lloj barrierash dhe çdo lloj pengesash të komunikimit të lëvizjes dhe të raporteve në mes të Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

Prandaj, në këtë rast, ne vetëm e përsërisim qëndrimin tonë që do ta mbështesim këtë rezolutë.

Por, duhet thënë në ndërkohë që Kosova e rrethuar me katër shtete ose katër republika të tjera, ka tre lloj kufijsh deri tash.

E ka kufirin me Shqipërinë, e ka të ndryshëm prej kufirit që e ka me Serbinë, e po ashtu këto të dyja dallojnë në mënyrën e lëvizjes apo llojit të menaxhimit të kufirit me Maqedoninë dhe Malin e Zi.

Kështu që me katër shtete rreth e rreth Kosova ka tre lloj kufijsh që ka krijuar një lloj të kontrollit të kufijve të ndryshëm dhe jounik të Republikës së Kosovës. Kuptohet për cila specifika bëhet fjalë, por s'mund të mos themi që problemi i kontrollit të kufirit mbetet ai me Serbinë, më shumë se sa cilido menaxhim tjetër, për shkak se ne mendojmë kufiri mes Kosovës dhe Serbisë edhe nuk është i trajtuar si duhet, por edhe nuk kontrollohet në mënyrën si duhet nga ana e institucioneve të sigurisë së Kosovës, në këtë rast policia kufitare e Kosovës.

Pasi po flasim për raportet ndërmjet kufirit Kosovë-Shqipërisë apo raportet mes lëvizjeve ndërkufitare mes Kosovës dhe Shqipërisë, në fakt ky kufi nuk do të duhej fare të ekzistonte, e aq më tepër siç ka ekzistuar deri më tash me pengesa shumë të mëdha, e dihet se qytetarët e Kosovës, Shqipërisë dhe qytetarët tjerë, të cilët kanë lëvizur në këtë aks kanë qenë qytetarët më të kontrolluarit dhe më të penguarit për lëvizje të dyanshme dhe kjo tashmë kuptohet pse. Por, kemi të drejtë ta kemi një lloj rezerve që kjo rezolutë mund të mbetet thjesht një rezolutë dhe një dëshirë, qoftë edhe e Parlamentit të Kosovës dhe e deputetëve të Kosovës, gjithsesi edhe një dëshirë e qytetarëve të Kosovës dhe rezervën tonë që Qeveria e Kosovës nuk do ta implementojë këtë rezolutë, ose nuk do ta jetësojë vullnetin e qytetarëve dhe të deputetëve është e qëndrueshme, duke iu referuar edhe rezolutave të kaluara, të cilat kanë ngelur vetëm në nivelin e rezolutës.

Duke e ditur qasjen sesi Qeveria e ka trajtuar këtë çështje, ne, për fat të keq, kemi të drejtë dhe qëndron shqetësimi ynë që Qeveria nuk do ta çojë më tutje, por do të mbetet vetëm një votim në Parlament dhe uroj që të mos jetë kështu. Pra, uroj që qytetarët e Kosovës dhe të Shqipërisë të lëvizin ashtu siç e meritojnë dhe ashtu siç e dëshirojnë pa pengesa ndaj njëri-tjetrit, edhe për arsye të lëvizjes së lirë, por edhe për arsye tona historike, sepse jemi një komb, të cilit i janë bërë shumë padrejtësi, edhe në këtë rast, po ashtu siç është i padrejtë edhe ky kufi, edhe pengesat janë të padrejta të lëvizjes së qytetarëve me njëri-tjetrin.

Sido që të jetë, ne e mbështetim këtë rezolutë, vota jonë do të jetë në mbështetje të kësaj rezolute, duke kërkuar që Qeveria e Kosovës ta miratojë, ta implementojë këtë rezolutë dhe qytetarëve t'u lejohet lëvizje e lirë ndërmjet dy republikave në këtë rast. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Muharrem Nitaj, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Po dua të them për propozuesin e kësaj rezolute që ka një paqartësi në kreun e tekstit të kësaj rezolute. Është për hapjen e tërësishme të kontrollit për hyrje-daljet të shtetasve të Republikës së Kosovës, e tjera. Nuk besoj që është formulim i saktë, ose duhet të jetë “për heqjen e tërësishme të kontrollit”, ose duhet të jetë “për hapjen e tërësishme të kalimit”.

Mendoj që kjo duhet të korrigjohet. Tema është bukur sensitive, pak a shumë është e njëjta sikur edhe me rezolutën që e miratuam për heqjen e romingut ndërmjet shtetasve të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë. Për fatin e keq, edhe në këtë rezolutë të dytë janë dy palë: është Republika e Shqipërisë dhe është Republika e Kosovës. Janë paragjykime pohimet se kjo rezolutë nuk do të shkojë tutje, sepse Qeveria e Kosovës nuk do ta shtyjë tutje. Unë besoj që Qeveria e Kosovës e ka interesin që eventualisht ta lehtësojë kalimin ose qarkullimin e qytetarëve dhe të njerëzve me Republikën e Shqipërisë dhe me të gjitha shtetet. Por, për këtë, unë besoj që duhet përpara se të marrim ndonjë vendim, ky është një sugjerim për propozuesin, të ketë një koordinim të plotë me Qeverinë e Republikës së Kosovës, në mënyrë që të procedohet tutje, ose le të themi që fjalia e parë, pika e parë që - Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të nisë procedurat e domosdoshme kushtetuese dhe ligjore për lidhjen e një marrëveshjeje ndërkombëtare për këtë materie me Republikën e Shqipërisë. Atëherë, në një situatë të tillë, nëse nuk do të ketë një koordinim paraprak me Qeverinë e Republikës së Kosovës, kjo rezolutë vërtet do të mund të mbetet e perealizueshme, ose vetëm si dëshirë.

Thashë që për jetësimin e saj kërkohet dakordimi i të dyja palëve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, zoti Zemaj dhe zoti Pajaziti nga deputetët, dhe s'ka të tjerë. Fjala për ju, zoti Zemaj!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë e dëgjova me vëmendje edhe propozuesin e rezolutës, mbi të gjitha mënyrën sesi e shpjegoi dhe bashkëbisedimin që ka pasur me njërin prej ministrave sa i përket implementimit të kësaj rezolute.

Është evidente që vullneti i Kuvendit dhe i deputetëve është që të lejohet apo të mundësohet lëvizja e lirë. Tash, nuk e di në mbamendjen institucionale të cilit ministër, por ky kontroll është rikthyer në vitin 2016, për shkak të procesit të liberalizimit të vizave, në të cilin po kalon Republika e Kosovës. Tash nuk e di sesi e keni shpjeguar dhe cili është interpretimi kur BE-ja ka kërkuar vëzhgim më të rreptë ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës. Sesi interpretohet vëzhgimi dhe kontrolli, atëherë ne duhet të jemi të kujdesshëm dhe këtë raport mendoj që Ministria e Punëve të Brendshme duhet ta qartësojë dhe Ministria e Punëve të Jashtme sigurisht për shkak të sensibilitetit që e kemi në procesin e liberalizimit të vizave.

Si pjesë procedurale dhe kërkesa në rezolutë, edhe ashtu siç duket ndërmjet rreshtave, ka nënkuptuar që kërkesa për nisje të kësaj procedure e kërkon edhe këtë shpjegim. Ne në këtë proces duhet ta kemi një qartësim të saktë se mos po kemi ndonjë problematikë në këtë procedurë, sidomos tash në këtë hapjen përfundimtare për procesin e liberalizimit të vizave dhe pikërisht ky kontroll për memorien tonë institucionale është rikthyer në janar të vitit 2016, nëse nuk jam i saktë me data, por ka qenë fillimi i vitit 2016, kur është rikthyer kontrolli në pikat kalimtare ndërmjet kufijve të Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

Kështu që unë këtë e përmenda si fakt që duhet të jemi të kujdesshëm. Tash nuk e di për Ministrinë e Punëve të Brendshme, sepse ata e menaxhojnë, janë të autorizuar me ligj për ta menaxhuar kufirin dhe kjo pjesë e bashkëbisedimit dhe implementimit dhe nga Kuvendi nëpërmjet kërkesës së rezolutës e kërkon edhe shqyrtimin e këtij fakti. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Pajaziti dhe pastaj propozuesi edhe një herë.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ministër, kolegë deputetë,

Nuk është hera e parë që ky Kuvend merret ose ka pasur iniciativa të tilla që janë të nevojshme, janë të mira. Qytetarët e Kosovës dhe të Shqipërisë besoj i mirëpresin iniciativat e tilla. Mendoj që në këtë rast nuk do të ketë asnjë pengesë, as administrative, as shtetërore nga dy ministratë e vendeve, ose qeveritë e vendeve përkatëse. Por, ajo që dua të shtoj dhe pa dyshim e mbështes edhe unë, por dëshiroj ta bëj një propozim sot këtu, meqenëse edhe ne si vend që aspirojmë ose synojmë në BE jemi në një proces të ndjeshëm, edhe ne, edhe Shqipëria po ashtu, që avancohet në këtë drejtim. Ju rikujtoj Raportin e fundit të Progresit dhe po ashtu raportet e Komisionit Evropian, që në vendet e caktuara theksojnë pikërisht çështje të tilla të bashkëpunimit ndërkufitar të vendit tonë edhe me Shqipërinë.

Kisha propozuar sot, meqenëse agjenda jonë evropiane, është prioritet, mendoj edhe për Shqipërinë po ashtu, Komisioni ynë për Integritime ta bëjë urgjentisht një takim me Komisionin për Integritime të Kuvendit të Shqipërisë, t'i trajtojnë të gjitha këto tema dhe hapat dhe propozimet tona t'i bëjmë të koordinuara. Të mos i bie pastaj që rezolutat e tilla të mos respektohen ose të mos zbatohen, por ta kemi një përgatitje, një dakordim paraprak edhe me Kuvendin e Shqipërisë, dhe po ashtu të bëjmë diçka që është në përputhje edhe me agjendën tonë, prioritetet tona, që janë edhe tonat, edhe të Shqipërisë në raport me BE-në. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tash u lajmëruan ende deputetë tjerë, por a dëshironi për temë? Mirë, kjo është taktikë e mirë për kryetarin, si “macja me miun”. I kemi edhe tre deputetë, ndërkohë sa të duan, të gjithë do të flasim, propozuesi në fund pastaj, se më herët s’pati të paraqitur. Arben Gashi!

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Unë po e ndiej si obligim, meqenëse mandatin e kaluar kam qenë anëtar i Komisionit për Integritime Evropiane. Në Raportin e Progresit për vizat ka qenë njëra prej pikave, e cila është kërkuar në mënyrë eksplicite - kthimi i kontrollit kufitar ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, edhe në hyrje, edhe në dalje. Ju e dini se ka një marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës që kontrollet kufitare të jenë hyrje-hyrje. Pra, të gjithë shtetasit që hyjnë në Republikën e Shqipërisë kontrollohen gjatë hyrjes në Republikën e Shqipërisë, jo gjatë daljes nga Republika e Kosovës, dhe anasjelltas.

Të gjithë kalimtarët që hyjnë nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Kosovës nuk kontrollohen në dalje nga Republika e Shqipërisë, por kontrollohen në hyrje nga Republika e Kosovës. Ka pasur një kërkesë eksplicite prej Bashkimit Evropian që të rritet kontrolli kufitar për shkak të dyshimeve për aktivitete kriminale dhe për një kohë u kthye kontrolli në hyrje dhe në dalje në të dyja shtetet, pastaj u arrit një marrëveshje, e cila e tejkaloi këtë çështje. Pra, unë mendoj që në argumentin, i cili u diskutua edhe më herët këtu, duhet të jemi të kujdesshëm dhe të mos bëjmë dëm në këtë periudhë të shkurtër që ka mbetur deri në ditën e rekomandimit pozitiv apo negativ, cilido qoftë ai, për liberalizimin e vizave, të mos e japim një argument shtesë panevojshëm. Pra, të mos ngutemi në këtë çështje. Unë mendoj se është ide e mirë dhe praktikë e mirë, e cila përkrahet edhe nga Bashkimi Evropian, menaxhimi i përbashkët i pikave kufitare, ka Shqipëria me Malin e Zi në pikën e Muriçanit, pra “one stop shop”, në një stacion kufitar kryhen të dyja procedurat. Pra, duhet të ketë një marrëveshje ndoshta edhe me Republikën e Shqipërisë që kjo procedurë të kryhet në një stacion kufitar dhe jo me dy stacione, por duhet më shumë angazhim edhe me faktorët tjerë, sepse në këtë çështje nuk jemi vetëm dy palë, ose vetëm një palë në këtë rast, sepse ne po e trajtojmë vetëm nga këndvështrimi i Kosovës.

Ky është këndvështrim unilateral, të paktën duhet të jetë bilateral, por duke pasur parasysh se çështja e kufijve, çështja e menaxhimit të integruar të kufijve është edhe politikë evropiane, kjo

bëhet çështje multilaterale. Pra, edhe të trajtohet si e tillë nëse ka hapësirë në rezolutën e propozuar nga PSD-ja, që kjo çështje të trajtohet në aspektin multilateral dhe të mos bëhen dëme të panevojshme. Pra, krejt çka pata me thënë unë është që të jeni të kujdesshëm në mënyrën sesi e trajtojmë këtë çështje. Nuk është çështje e emocionit momental, personal, patriotizmit deklarativ, por është çështje e trajtimit bilateral dhe multilateral të kësaj çështjeje, sepse duhet të jemi të vetëdijshëm se është çështje kufitare dhe çështjet kufitare në këtë rast janë edhe bilaterale, por edhe multilaterale, sepse është edhe Bashkimi Evropian, që i përkrah çështjet e menaxhimit të integruar të kufirit dhe plot elemente tjera, të cilat duhet të trajtohen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Faton Topalli, më herët PSD-ja nuk pati të lajmëruar. Urdhëro!

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryetar!

Çështja e lëvizjes së lirë, pra lëvizjes pa pengesa, është një prej vlerave kryesore evropiane. Pikërisht duke u mbështetur në këto vlera evropiane është diskutuar dhe është bërë shumë që të bëhet edhe liberalizimi i vizave me Kosovën.

Pra, nuk mund të përdoret si argument që kjo rezolutë nuk mund të aprovohet për arsye hipotetike apo të supozuara se Bashkimi Evropian mund të jetë kundër. Unë jam i bindur se Bashkimi Evropian nuk është kundër, përderisa vetë është i gatshëm t'i hapë kufijtë dhe nuk ka asnjë kuptim që gjatë të njëjtës kohë të kërkohet mbyllja e kufijve, aq më shumë kur kemi jashtëzakonisht shumë qytetarë që lëvizin nga të dyja anët e kufirit, të cilët kanë interes të madh që kjo çështje të rregullohet për të kursyer kohë. Kështu që unë i ftoj deputetët e Kuvendit të Kosovës ta miratojnë këtë rezolutë, duke pasur parasysh edhe bisedimet që janë bërë me ministrin e Punëve të Brendshëm, duke pasur parasysh edhe praktikën në vendet e tjera. Kështu që nuk ka asnjë arsye që Kuvendi thjesht ta shprehë vullnetin e tij për ta rregulluar këtë çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Për temën në fjalë besoj që kanë folur kolegët e mi, flet edhe Muharremi, por e dëgjova me vëmendje zotin Rexhep Selimi, i cili pothuajse gjatë gjithë kohës është shumë skeptik për punën, angazhimin dhe vendimet e kryeministrit Haradinaj. Unë i them që për shumë tema dhe për shumë vendime, të cilat kanë qenë në sirtarë për shumë vite, besoj që këtë e dinë të gjithë qytetarët, është zoti Haradinaj që po merret çdo ditë dhe po i nxjerr ato tema në tavolinë dhe po i zgjidh. Por, po më habit fakti që për çdo detyrë, për çdo angazhim të zotit Haradinaj, skepticizmi i Rexhep Selimit është më se injorues. Prandaj, edhe një herë po i them që vërtet çdo Qeveri nuk i ka zbatuar rezolutat e Kuvendit, por për të gjitha angazhimet dhe të gjitha detyrat nga kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Ramush Haradinaj, zoti Rexhep Selimi është shumë

skeptik, prandaj po i them që kurrkush më mirë ndoshta se ti nuk e njeh, por injoranca juaj po tregon diçka tjetër këtu në seancat e Parlamentit të Republikës së Kosovës, zoti Selimi.

KRYETARI: Faleminderit! Replikë ka kërkuar Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Teutë, kjo çka unë e thashë ka të bëjë më së paku me zotin Haradinaj, sepse nëse zoti Haradinaj ose Aleanca i merr përsipër ato çfarë nuk i kanë bërë qeveritë e mëhershme, është çështje tjetër, por unë s'folja për Qeverinë Haradinaj, e cila nuk e ka pasur rastin deri më sot ta implementojë ose jo një rezolutë të ngjashme dhe unë iu referova rezolutave të kaluara.

Tash nëse ju e merrni përsipër edhe atë çfarë nuk kanë bërë ose kanë bërë qeveritë paraprake, është çështje tjetër. Kam të drejtë të jem skeptik ose dyshues në implementimin e rezolutave të Kuvendit të Kosovës nga qeveritë në vazhdimësi. S'kam pse të mos e përjashtoj edhe Qeverinë aktuale, por nuk po e kuptoj, kur e kërkoja fjalën, do të ishte e mjaftueshme njëherë të përmendet emri dhe të merret fjala, ju e përmendët shumë shpesh, por ta keni parasysh që unë nuk jam kujdestar i përmendjes së emrit të zotit Haradinaj qysh ju e interpretuat, as skeptik. Unë jam deputet i opozitës, sillem si i tillë dhe do të vazhdojë të sillem si i tillë dhe po ashtu, as nga këndi i deputetit të opozitës nuk do të jem lojal i asnjë keqqeverisjeje, në këtë rast as i Qeverisë Haradinaj, për të cilën normalisht që kam shumë vërejtje, kam shumë kritika dhe, po ashtu, kam edhe shumëçka për të thënë, jo vetëm deri tash, por edhe në të ardhmen për Qeverinë Haradinaj, e cila po del të jetë vazhduese e denjë e qeverive paraprake kur bëhet fjalë për keqqeverisje dhe për këtë unë nuk kam faj.

KRYETARI: Kundër-replikë, zonja Teuta Haxhiu!

TEUTA HAXHIU: Vetëm sa e konfirmoi edhe një herë skepticizmin zoti Rexhep Selimi, edhe një herë po i them që me të gjitha temat me të cilat po merret kjo Qeveri, kryeministri i Republikës së Kosovës, nuk po mbeten në sirtar, nuk po hidhen, por po kryhen dhe është mirë për të treguar edhe një herë që ka shumëçka me të cilat preket interesi i Republikës së Kosovës, preket interesi i qytetarit dhe në këtë interes po punon Qeveria Haradinaj, sado që për rezolutat, të cilat nuk respektohen nga qeveritë, pa marrë parasysh cilado qeveri, edhe unë do të jem opozitë, por skepticizmi i zotit Rexhep Selimi edhe një herë u konfirmua në fjalën, ose në replikën që e bëri.

KRYETARI: Faleminderit! Milaim Zeka, nga Nisma, bëhet gati zoti Nitaj.

MILAIM ZEKA: Kryetar!

Arsyeja pse dola në foltore është kjo: Jemi në vitin 2018, edhe po shesim patriotizëm banal - kush kujt t'i kallëzojë kush është më patriot se kush këtu në sallë. Krejt ky diskutim për mendimin tim personal është diskutim koti.

Sepse, ky është një ekskluzivitet absolut ndërmjet Brukselit, Qeverisë Haradinaj dhe Qeverisë së Edi Ramës. Nuk është punë jona që të bëjmë rezoluta të hapet a të mbyllet kufiri. Po të duan të hapet ose të mbyllet kufiri, vendosin ministrat e Punëve të Brendshme dhe çështja e parë që do të duhej bërë me këtë rast do të ishte këshillimi me zyrtarët ligjorë të Kuvendit të Kosovës. Ne si deputetë të Parlamentit të Kosovës nuk e kemi guxim për t'i ndryshuar rregulloret dhe udhëzimet administrative që na i ka pjellë UNMIK-u në vitet 2001, 2002, 2003, 2004.

Të nderuar deputetë,

Shikojeni këtë udhëzim administrativ të UNMIK-ut për udhëtimet zyrtare të vitit 2004, e ne jemi në vitin 2018, dhe ky udhëzim është nënshkruar në atë kohë nga ministri i Shërbimeve Publike, zoti Jakup Krasniqi. Domethënë, me këtë udhëzim ne shkojmë në Shqipëri, se i marrim nga 209 euro për mëditje.

Prit kryetar të flasë, është në fuqi e me këtë vazhdojmë, me këtë udhëzim, e tash do të kthehem te udhëzimi, sepse kryeministri i Kosovës..., Profesor, dëgjomë tash, kryeministri i Kosovës dje e ka nxjerr një urdhëresë, me të cilën i urdhëron të gjithë ministrat të bëjnë raport se me kë po udhëtojnë, ku po udhëtojnë dhe ku po shkojnë. Domethënë, urdhëresë për një rregullore ekzistuese që veç ekzistoi. Kjo është sikur kryetari i Kuvendit ta nxjerrë një urdhëresë që të na urdhërojë ne që ta zbatojmë Rregulloren. Kryetari i Kuvendit, Qeveria duhet të marrin masa disiplinore ndaj atyre që i shkelin rregulloret ekzistuese. Shkruan fort qartë se çdo ministër, çdo zëvendësministër, çdo zyrtarë që do të udhëtojë, t'i vjedhë paratë e popullit duke shkuar nëpër hotele të shtrenjta, minimum pesë ditë paraprakisht duhet ta lajmërojnë vizitën e tyre. Unë, meqenëse kryetari është këtu, se shumë vështirë po e zëmë, po e them që ditën e premte kam shkuar në Kabinetin e kryetarit dhe nuk e kam gjetur asnjë njeri në zyrë, se me këshilltarë e me të gjithë kishin shkuar në Lutjet e Sabahut në Shqipëri. Çka po lypin vëlla të shkojnë nga 20 veta nëpër delegacione?! 20 veta ia sheh Enver Hoxhës në delegacion, 20 veta atij! Urdhëroni, merrini e shikoni se cilët anëtarë të Kryesisë së Parlamentit të Kosovës porositin bileta për të udhëtuar jashtë Kosovës dhe i djejin biletat dhe nuk udhëtojnë me ato bileta!

Hajt, tregomëni ju kush po udhëton nga një javë jashtë Kosovës me paratë e buxhetit të popullit? Hajde! Ne hajnin e kemi këtu, e këtu mundohemi që të nxjerrim rezoluta, "jo të hapet, jo të mbyllet kufiri". Nuk ta lejojnë të hapet kufiri me Shqipërinë as Bashkimi Evropian, as Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Po, a e keni dëgjuar more që pardje Uashingtoni i dha urdhër Qeverisë së Shqipërisë që ta forcojë kontrollin e kufirit ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, e ndërmjet Shqipërisë e Kosovës. Prandaj, e përshëndes edhe fjalën e zotit Gashi, edhe të Armendit, edhe të atyre që diskutuan, ne nuk mund ta bëjmë një veprim këtu, i cili do ta dëmtonte procesin e liberalizimit të vizave. Ja ku është zonja Deliu, që është kryetare e Komisionit për Integritet Evropian, le të dalë në foltore dhe le të tregojë se çfarë këshillash ose vërejtjesh i kemi marrë ne si Komision për Integritet Evropian që nuk guxojmë t'i shkelim këto rregullore.

Prandaj, të nderuar deputetë, hajde të diskutojmë rreth ndryshimit të rregulloreve. Hajde të diskutojmë rreth keq menaxhimit dhe keqpërdorimit të parasë publike. I kemi bash 2 milionë probleme tjera, për të cilat diskutojmë ,para se të flasim për rezoluta të tilla. Prandaj, unë po e përfundoj fjalën time me këtë: e thatë të gjithë - ideja është brilante, por ka qenë ide brilante kur ne në vitin '81 jemi ngritur dhe kemi bërë bashkim me Shqipërinë. Po, bota trak tha “s’ mund të bashkoheni”. Çka bëmë ne? Tak, u tërhoqëm dhe thamë duhet ta bëjmë një republikë të shtatë në kuadër të Federatës jugosllave.

Është ide brilante që ne ta bëjmë një rezolutë dhe të themi “pse t’i kemi ne dy kombëtare në futboll dhe të harxhojmë para, do ta kemi vetëm një kombëtare. Por, këto janë vetëm ide, në praktikë nuk funksionon një gjë e tillë ashtu sikur nuk mund të kalojë një vetëm pse është ide, është ide brilante, tash ne ta kalojmë si rezolutë. Ky është mendimi im personal. Nuk fola në emrin e Nismës, as nuk fola për ta fyer askënd, as për ta matur në peshore patriotizmin e atyre që e kanë propozuar dhe të këtyre që e kundërshtojnë, por fola si një gjysmëjurist, kështu për t’ia marrë rrogën Armend Zemajt. Faleminderit!

KRYETARI: Zotëri Nitaj, fjala për ju.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, kryetar!

Sa desha të them që Milaim Zeka ma ka vjedhur fjalimin, por i rashë pishman, se e teproi pak.

Realisht, e përcolla me vëmendje propozimin e zotit Pajaziti dhe angazhimin e Zemajt dhe të Gashit. Unë e lus propozuesin për mirëkuptim. Nuk është këtu çështje e mbështetjes së kësaj rezolute, ose e kundërshtimit, por e lus që ta ketë parasysh dëmin eventual që do të mund ta shkaktojë me miratimin e kësaj rezolute. Nuk po them që propozim-rezoluta duhet të tërhiqet, po të zhvillohen konsultimet e nevojshme. Atë që e tha edhe zoti Pajaziti me komisionet përkatëse për integritet dhe konsultimet e domosdoshme me Qeverinë e Kosovës.

Prandaj, e lus propozuesin që t’i japë vetes edhe një kohë që të kryejë këto konsultimet e nevojshme dhe pas tyre ta risjellë edhe një herë në Kuvendin e Kosovës. Frikohem se nëse tani do ta miratojmë një rezolutë të tillë, pavarësisht prej efektit që ajo do të mund ta ketë, mund të shkaktojë më tepër dëm se sa dobi.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Në fillim kur e mora fjalën u mendua që veç unë po flas dhe po shkojmë në pauzë dhe dhashë një ekspozë krejt të shkurtër, që idenë e mbështesim, idenë për të liberalizuar qarkullimin e njerëzve me Shqipërinë e mbështesim, mirëpo kjo duhet të bëhet në harmoni me Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe të Shqipërisë, natyrisht.

Ajo që sot mund të bëjë Kuvendi është të bëjë një rekomandim, të bëjë një rezolutë, t'i japë një mbështetje idesë për, ta quaj ashtu, më shumë ka të bëjë me liberalizim të kufijve, se sa me heqjen totale, sepse kufiri është aty. Unë veç po ju tregoj një shembull se si e ka Zvicra, apo si e ka pasur Zvicra me Bashkimin Evropian, përmes marrëveshjes bilaterale BE-Zvicër, ku në çdo 100 vetura, kontrollohen 3 vetura, ajo që e shpjegoi Dardani në kontrollin aksidental.

Unë dhe të gjithë ne qarkullojmë, lëvizim në atë kufi dhe e kemi parë që aty nuk bëhet fjalë për luftën kundër krimit, nuk ka mekanizëm që lufton krimin, sepse aty krejt çfarë bëhet është kontrolli i identitetit të njerëzve që kalojnë. Pra, veturat nuk hapen, nuk kontrollohet se çfarë ke brenda, krejt çfarë bëhet është se futet në sistem qoftë letërnjoftimi apo pasaporta e atyre që kalojnë dhe vazhdojmë më tej. Në kohë të pushimeve verore ajo bëhet vetëm nga një anë, pastaj kur kalojnë ato, me sa di unë, pastaj bëhet kontrolli i dyfishtë.

Pra, Nisma Socialdemokrate e mbështet idenë me plotësimet që i thashë në fillim, se për t'u shndërruar kjo ide në një rezolutë dhe në një ligj nesër, sepse duhet të bëhet edhe një marrëveshje në mes dy vendeve, natyrisht se qeveritë duhet të përfshihen dhe qeverive nuk duhet t'u tregojmë ne se duhet të harmonizohen me Zyrën e BE-së, sepse besoj që Qeveria e ka parasysh. Besa, edhe po të mos e ketë parasysh, nga përvoja sa herë që këtu marrim një vendim që është në kundërshtim me Bashkimin Evropian, ata vijnë vetë lajmërohen, thonë: "Jo, jo, jo, këtë s'bën ta bëni". Mos u shqetësoni shumë ju që ju ka kapur sikleti se qenka shumë në kundërshtim me BE-në, sepse besoni, sapo ajo të jetë në kundërshtim me BE-në, ata vetë, zonja Apostolova, sepse ajo për gjëra edhe më të vogla po lajmërohet te ministrat, te kryeministri, me shkresa, me takime urgjente dhe i sugjeron, i këshillon, shpeshherë edhe kërkon nga ata të mos e bëjnë një veprim.

E dimë këtë, në Kosovë po jetojmë edhe ne. Të jeni të sigurt, që nëse rezoluta miratohet me kushtin që kjo të harmonizohet me qeveritë e dy vendeve dhe t'i shtohet rezolutës që e tërë kjo të bëhet edhe në harmoni me Bashkimin Evropian, nuk do të ketë asnjë telashe sa i përket rrugëtimit të kësaj ideje, nga ideja në rezolutë, nga rezoluta, rekomandime, si të doni mund ta quajmë, nesër në një ligj përmes një marrëveshjeje në mes dy vendeve, në bashkëpunim, po e përsëris, të përfaqësueses së Bashkimit Evropian, në bashkëpunim edhe me shtetet mike, aleate, si të doni i quajmë, të Kuintit, të cilët besoj se për këtë çështje do të ndjeheshin të përfaqësuar edhe nga qëndrimi i Zyrës së BE-së.

Nëse të gjithë këto hapa ndërmerren dhe në fund ka një dakordim të të gjithë aktorëve që do të duhej të përfshiheshin derisa të vijë te ne dhe ta votojmë si marrëveshje në mes dy vendeve, nuk do të kemi telashe. Nuk po bëhet sot këtu fjalë për një vendim të njëanshëm, që nesër do të duhet të hapen kufijtë dhe pastaj të vijë Brukseli e të tjerët dhe të na gjuhën në qafë e të na kërkojnë ta tërheqim. Është një fillim i një procesi, do ta quaja unë, të cilin edhe po të donim ta bënim njëanshëm, nuk do të mund ta bënim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit. Zonja Blerta Deliu-Kodra dhe pastaj propozuesi e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Atëherë, meqë jemi në fund të diskutimit, natyrisht që në emër të Grupit Parlamentar ne e kemi mbështetur propozim-rezolutën për hapjen e tërësishme të kontrollit për hyrje-daljet e shtetasve të Republikës së Kosovës dhe të Shqipërisë.

Në cilësinë e kryetares së Komisionit për Integritet dua të potencoj dy argumente, që neve na janë përmendur vazhdimisht, që është kërkuar në raportin për vendin një kontroll i rreptë në pikat kufitare, sa i përket procesit të liberalizimit të vizave, po ashtu edhe menaxhimi i integruar i kufirit, që ne si përfaqësues të Republikës së Kosovës duhet të jemi të përgjegjshëm. Prandaj, vetëm që ky proces duhet të bëhet me një kujdes dhe maturi, natyrisht me harmonizim ndërmjet dy parlamenteve, dy komisioneve dhe me ministrat e punëve të brendshme.

Unë e mbështes atë që e tha edhe kolegu im, Pajaziti, që ne duhet të bisedojmë edhe me Shqipërinë, edhe me përfaqësues të Bashkimit Evropian, në mënyrë që të kemi qartësi në proces.

KRYETARI: Faleminderit! Ndërkohë është lajmëruar edhe nënkryetari Kujtim shala, i fundit.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë, tani diskutimi në fund nuk është si në fillim, sepse dolën katër-pesë çështje, të cilat janë të rëndësishme. Tani, ky do të duhej të ishte një problem i pastër i menaxhimit, por derisa po flasim këtu, derisa po bisedojmë këtu, i bie që është pak më shumë.

E para, unë mendoj që në këtë rast, si dhe në rastet e tjera të ngjashme, Kuvendi ligjërisht mund të miratojë rezoluta të kësaj natyre. E kam fjalën si procedurë. Por, duhet të kemi parasysh edhe diçka tjetër, raportet tona jo vetëm me Republikën e Shqipërisë, sepse në këtë rast po bisedojmë për atë, por edhe për proceset tona të integritetit edhe të Kosovës edhe të Republikës së Shqipërisë.

Mua më duket që kjo është një çështje e rëndësishme, është tepër e ndjeshme dhe si rast është tipik i asaj natyre, i cili s'mund të kundërshtohet, që do të thotë se ne e dimë që do të votojmë për, por po ashtu e dimë që s'mund të implementohet. Dhe, ky është problemi themelor.

Jo, Rexhep, s'jam skeptik, e di. Domethënë, s'kam dyshime. Ato që i tha deputeti Gashi, Arbeni, janë plotësisht të sakta. Në disa variacione i përsëritën edhe kolegët e tjerë, kështu që më duket se është e domosdoshme që në fund të këtij debati ne të kemi një ekip, i cili duhet të përpiqet që së paku të harmonizojë tekstin e rezolutës. Unë nuk po kërkoj që të relativizohet, por që të saktësohet, që së paku në rrafshin politik të mos dëmtojë procese, të cilat janë të natyrës politike.

Në fund, dëshiroj të theksoj që propozimi i Arbenit është dhe propozim i grupit tonë parlamentar dhe ne kërkojmë që ai të përfshihet në tekstin e rezolutës. Faleminderit!

KRYETARI: Bekim Haxhiu e ka fjalën dhe pastaj Dardan Molliqaj është në fund.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Aida Dërguti.)

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kisha në plan të diskutoj, edhe pse një pjesë të diskutimit e përfshiu edhe vetë Milaimi.

A duhet të hapet tërësisht kufiri me Shqipërinë? Po, sigurisht se po. Nuk besoj se ka ndonjë shqiptar në Kosovë, i cili nuk e dëshiron një gjë të tillë, si në këtë anë, ashtu edhe në atë anë të kufirit.

A duhet të hapet edhe me Maqedoninë? Po, se edhe atje ka shqiptarë.

A duhet edhe me Malin e Zi? Po, duhet edhe me Malin e Zi, ka shqiptarë edhe atje, bile-bile kanë probleme shqiptarët e Plavës dhe të Gucisë edhe të lëvizin e të vijnë në Kosovë, sepse kanë shumë afër pjesën kah duhet kaluar, që ka qenë pjesë edhe kontestuese, sepse kemi debatuar shumë këtu për demarkacionin, se ku po mbetet kufiri, a në Plavë e Guci, apo te Rrafshi i Dukagjinit, por janë troje tonat që padrejtësisht janë ndarë shumë vjet më parë.

Ideja e bashkimit, do të thotë ajo që konsiderohet në Konferencën e Bujanit në fund të vitit 1943 dhe në fillim të vitit 1944 ka pasur për pasojë edhe vrasjen e disa patriotëve shqiptarë të asaj kohe. Pra, nuk është e sotshme. Po e them që një prej familjarëve të mi, Halil Haxhiu, pjesëmarrës i Konferencës së Bujanit, për shkak të kërkesës së tij për bashkim me Shqipërinë është ekzekutuar më vonë nga Ali Shikriu dhe grupi i tij, për shkak të asaj.

Pra, ideja për bashkim është e kamotshme, nuk është e sotme. Por, a do ta bëjmë bashkimin duke bërë këso rezolutash? Të fillojmë me Kushtetutën, e ndërrojmë Kushtetutën, po e bëjmë bashkë me të Shqipërisë nëse duam vërtetë të bëjmë popullizëm, a? Atëherë, po fillojmë nga Kushtetuta. Kemi pasur debate në atë që tha Milaimi, edhe për kombëtaren, a duhet ta kemi një kombëtare a dy kombëtare në futboll, e tjera.

Përderisa e kemi një shtet, domethënë tonin, Kosovën, atëherë duhet të punojmë për shtetin tonë, ta forcojmë, për rend dhe ligj, për arsim më të mirë e shëndetësi shumë, shumë më të mirë se kjo që është, nëse duam shtet. Jo pse këto janë kritere për të hyrë në Bashkimin Evropian, por sepse këto janë të domosdoshme për jetën tonë, për jetën e qytetarëve tanë. Nuk duhet ne ta kemi arsimin më të mirë, pse u dashka të shkojmë në Bashkimin Evropian, ne duhet ta kemi arsimin më të mirë, sepse është interes i fëmijëve tanë. Ne duhet ta kemi një shëndetësi më të mirë, sepse është për interesin e qytetarëve tanë, jo pse ne duhet të shkojmë në Bashkimin Evropian. Ne

duhet ta kemi një siguri dhe një ligj më të mirë, jo pse duhet të shkojmë në Bashkimin Evropian, por është e domosdoshme për të ecur shteti dhe për të qenë një shtet i të së drejtës.

Këto popullizma, të nderuar kolegë deputetë, përmes të cilave keni filluar t'ia merrni kohën Kuvendit, për të larguar nga temat kryesore me të cilat mendoj se duhet të merremi, e janë ato që i theksova, mendoj se do të duhej vërtet të rezononi më ndryshe dhe të bashkëpunojmë shumë më shumë mes vete, të mos shikohemi këtu si armiq, por vërtet të punojmë bashkë me njëri-tjetrin për të arritur synimet tona. Pra, mendoj se kjo është OK, nëse mund të bëhet, por se a do të jetë pengesë në një rrugëtim tjetër, a ndihmesë, do të thotë, le ta vlerësojë vetë kryesuesi. Unë po kërkoj gjithashtu që nga iniciuesi që të ketë një konsensus brenda partive politike sa u përket pikave rreth kësaj rezolute. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Tani fjalën e ka propozuesi i rezolutës, Dardan Molliqaj.

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit, nënkryetare!

Faleminderit të gjithë deputetëve, sidomos atyre që dhanë vërejtje dhe sugjerime!

Dua të them që një pjesë të mirë të shpjegimit e bëri shefi i Grupit Parlamentar të Nismës Socialdemokrate.

Unë nuk e di pse po shkojnë debatet në një drejtim të caktuar, sa i përket rezolutave të Kuvendit! Rezoluta e Kuvendit është një mjet, të cilin e parashihet Rregullorja e Kuvendit për të shprehur vendime dhe vullnete politike Kuvendi për një çështje. Edhe në të parën, edhe në të dytën, e sqaruam shumë saktë. Marrëveshja e re që duhet të bëhet për romingun, që tashmë kaloi, ose eventualisht kalimi i kësaj çështjeje është marrëveshje që e bëjnë Qeveria e Republikës dhe Qeveria e Shqipërisë. Ne nuk jemi duke votuar Ligjin për ratifikimin e marrëdhënies në mes Kosovës dhe Shqipërisë sa i përket lirisë së lëvizjes.

Pra, ne jemi duke thënë si Kuvend, po supozojmë nëse e kalojmë, se për qytetarët e Republikës së Kosovës është me interes hapja e kufijve, përkatësisht liria e lëvizjes pa kontroll. Nuk jemi duke i hequr kufijtë, se edhe kjo u keqkuptua këtu. Kufijtë do të ekzistojnë, se duhet të bëhet bashkim, të bëhet konfederatë, të bëhet shtet i përbashkët, çfarëdo tjetër. Ne po kërkojmë që kufijtë të jenë të lirë për lirinë e lëvizjes së njerëzve, pa kontroll. Ka një dallim thelbësor në mes të menaxhimit të integruar të kufijve dhe ajo që unë kam propozuar. Është koncepti i kufijve të hapur.

Më 1957 e ka bërë Suedia, Norvegjia dhe Danimarka. Në vitin 2000 e kanë rigjeneruar këtë marrëveshje edhe me Finlandën. Mos i përzieni menaxhimin e integruar të kufijve me konceptin e kufijve të hapur për njerëz, janë dy gjëra krejtësisht të ndryshme. Ju lutem, urdhëroni dhe lexojeni, do ta shihni që këto dy koncepte janë ndryshe prej njëra-tjetrës.

Po ashtu, unë e thashë në fillim, e kam takuar ministrin për këtë çështje, në fakt, e kam takuar edhe kryeministrin dhe kam folur edhe për çështjen e romingut, edhe për çështjen e kësaj që po flasim, për hapjen e kufijve, sa i përket lirisë së lëvizjes, edhe për çështjen e Unionit Doganor. E kam takuar edhe ministrin e Financave për ta pyetur se ku janë problemet dhe ku janë përfitimet. Nuk është duke u bërë këtu diçka, as për popullizëm çka po flitet, është nevojë se diku 870 000 njerëz e kalojnë kufirin me Shqipërinë dhe presin me orë të tëra. Ku është popullizmi këtu? Unë s'po e kuptoj! Nuk e di ku është ai popullizëm! As nuk jam duke thënë kushdo që e voton që është jokombëtar dhe kushdo që e voton automatikisht kombëtar. Njerëzit votojnë në bazë të asaj që besojnë.

Por, në anën tjetër, për ju që jeni te përfaqësimi i Komisionit për Integritime Evropiane, unë nuk jam në atë komision por e kam përcjellë procesin e integritimeve evropiane bukur mirë. Me sa di unë, Kosova i ka dy kushte për liberalizimin e vizave. Njërin tashmë e ka kryer, është demarkacioni me Malin e Zi dhe i dyti është format e prera të vendimeve të gjyqësorit për krim dhe korrupsion. S'ka të bëjë me menaxhimin e integruar të kufijve. Pra, mos i përzieni çështjet që nuk janë.

E thashë në fillim e po e përsëris prapë, unë besoj që Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet ta miratojë këtë rezolutë, duhet ta shtyjë Qeverinë që të gjejë marrëveshjen, e cila është marrëveshje e kufijve të hapur, jo e menaxhimit të integruar, një model që ekziston. Norvegjia nuk është në BE dhe e ka këtë marrëveshje që quhet "Konventa nordike e pasaportave", është diçka krejt tjetër, e cila nuk ka kontroll mes vendeve edhe përkundër që nuk janë në të njëjtin organizëm, siç është BE-ja.

Unë atë që e thashë është se gjatë rrugës ministria, që e ka përgjegjësi këtë punë, që është ministri i Punëve të Brendshme, le të vijë dhe le t'i thotë këtij Kuvendi: "E keni miratuar një rezolutë që është e drejtë", por "për këto, këto arsye, kjo rezolutë nuk bëhet". Nuk jemi duke e qitur në pushkatim as Qeverinë, asnjë tjetër. Ideja është ta shprehim një vullnet, për të cilin po më duket se të gjithë po pajtohemi, për të ecur tutje. Ajo që unë po shoh, është njëfarë vetëcensure e panevojshme. Unë do ta kuptoja edhe skepticizmin, edhe hezitimin e secilit prej nesh, sikur të ishim duke miratuar ligj për përcaktimin e marrëdhënieve ndërfqinjësore me Shqipërinë, sepse ajo është ligj pastaj. Por, rezoluta është diçka tjetër, rezoluta është shprehje e vullnetit politik, siç e tha edhe zoti Kujtim Shala.

A kemi ne vullnet, si Kuvend i Republikës së Kosovës, për këtë çështje? Po. Ia bartim Qeverisë. Qeveria vjen na thotë: "Nuk është mundur, sepse nëse ne duam ta bëjmë këtë, kjo është pengesa". Dhe, jemi si Kuvend që e rivlerësojmë. Kurrkush nuk po dëshiron ta heqë kontrollin në kufij, e ta humbim liberalizimin e vizave. Asnjëri s'dëshiron, as qytetarët e Republikës që presin atje. Nuk është kërkesë eksplicite, nuk është, kështu që mund ta diskutojmë sa të doni.

Arben, ta japim fjalën prapë ndoshta, nëse bën ta kryej. Ajo që unë po sugjeroj është që rezoluta të votohet me vetëdijen e plotë të secilit prej nesh, që rezoluta nuk bën ta rrezikojë asnjërin prej proceseve dhe kurrkund në raportet e Komisionit Evropian e të tjerëve nuk janë pengesë rezolutat e Kuvendit të Kosovës.

Sinqerisht, dua të pajtohem me atë që bëri sugjerim në tekst, zoti Muharrem Nitaj, te hyrja e asaj që në vend të fjalës “hapje” është “heqje”. Kështu që, ka absolutisht të drejtë.

Kujtim, nuk e mora vesh se cili ishte propozimi i Arbenit saktë për t’u përfshirë në rezolutë. Nëse edhe dikush tjetër prej grupeve ka propozime konkrete për përfshirje në rezolutë, jam i hapur, nëse s’ka propozime konkrete, atëherë e ftoj nënkryetaren ta hedhë në votim dhe shpresoj që të gjithë së bashku do ta votojmë.

KRYESUESJA: Fjalën e ka kërkuar deputeti Kujtim Shala.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zonja nënkryetare!

Tani, Dardan, besoj që kolegët e kanë të qartë. Domethënë, s’po ngatërrohen çështjet, është tepër e qartë.

Tani janë të vetëdijshëm që po flitet për heqje të kontrollit, jo për zhbërje të kufijve dhe kjo është elementare. Po ashtu, është e qartë se ne kemi vullnet që të votojmë këtë rezolutë dhe kemi të drejtë, por kemi edhe vetëdijen për kushtet, për kërkesat. Duhet të kenë parasysh, Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë kanë kërkesë të drejtpërdrejtë jo për heqje kontrolli, kështu si po kërkohet, po për kontroll të dyfishtë. S’diskutohen kufijtë, është çështje e menaxhimit, kontroll të dyfishtë.

Ajo që po propozojmë ne është që t’i shtohet tekstit dhe koncepti i menaxhimit të integruar, si një variacion dhe pastaj, kjo i jep pak më shumë mundësi Qeverisë që të negociojë e të bisedojë me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë dhe që njëkohësisht të mund ta diskutojë edhe me partnerët, nëse çështja paraqitet si problematike. Domethënë, dhe një pikë që është një variacion tjetër, një mundësi shtesë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Fjalën e ka propozuesi.

DARDAN MOLLIQAJ: Për mua janë rezolutat e para. Por, ajo që mund të them është se jam i hapur absolutisht për ta diskutuar tekstin e rezolutës dhe për ta plotësuar, sepse ajo është edhe ideja. Pra, as nuk ka këtu ekskluzivitet, as përjashtim. Ideja është për të qenë sa më unikë në të gjitha çështjet që janë interes i përgjithshëm dhe jo i një subjekti politik.

Nëse ka propozim konkret, e përfshijmë menjëherë dhe e qesim në votim. Pra, ftoj deputetin Shala ta propozojë fjalinë dhe besoj se biem dakord. Nëse ka praktika të tjera, atëherë flasim si të doni. Por unë jam i interesuar që qysh tani propozimin ta përfshijmë.

KRYESUESJA: Atëherë, derisa të dakordoheni për tekstin, meqë u pa vullnet dhe gatishmëri prej propozuesit që të bëhet ndërhyrje në tekstin e rezolutës, po kalojmë te pika tjetër.

17. Zgjedhja e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Medieve

Fjalën e ka Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Në fakt, unë besoj që u bë pak një nguti, se hymë në këtë pikë të rendit të ditë, që tashmë e përfunduam, sepse ideja ishte që të kalohet pikërisht te pika numër 8 para kësaj. Por, meqenëse pika filloi, tash e përfunduam debatin, besoj që pajtimin e kemi pasur qysh në fillim që të shkojmë në votim sipas pikës 8, para se të shkojmë në pauzë. Ma merr mendja që kuorumi është, deputetët janë, kanë ndenjur ndoshta një pjesë pikërisht për ta kryer këtë pjesë të obligimeve dhe pastaj e kryejnë detyrën dhe vazhdojnë.

Pauzën mund ta shpallni menjëherë pas votimit ndoshta, edhe mund të kthehemi këtu në orën 15:00, ose 15:15, por do të ishte mirë që të hyjmë në proces të votimit të pikës 8. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Zoti Kujtim Shala.

KUJTIM SHALA: Faleminderit për procedurën. Në këtë rast, domethënë rastin e rezolutës për harmonizimin e tekstit, grupet parlamentare duhet t'i kenë përfaqësuesit, duhet të caktohen përfaqësuesit dhe ata pastaj ta sjellin tekstin e harmonizuar ose jo të rezolutës.

Unë meqë e kam fjalën në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, ju njoftoj që në atë grup do të jetë deputeti Armend Zemaj. Faleminderit!

KRYESUESJA: Propozuesit i kërkoj që të na tregojë nëse pajtohet me harmonizimin që t'i caktojmë përfaqësuesit.

DARDAN MOLLIQAJ: Po, pajtohem me propozimin për ta harmonizuar tekstin e rezolutës, besoj që për pesë minuta e kemi gati.

KRYESUESJA: Atëherë secili grup parlamentar le t'i dërgojë përfaqësuesit e vet, në mënyrë që të harmonizohet teksti.

17. Zgjedhja e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Medieve

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy anëtarë të Komisionit të Pavarur të Medieve i ka shqyrtuar nominimet e kandidatëve dhe Kuvendit i ka rekomanduar emërimin e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur të e

E ftoj kryetarin e Komisionit ad hoc, zotin Rasim Selmanaj, që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin e komisionit.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit!

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarit të Komisionit të Pavarur për Medie, në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2018, pas shqyrtimit të biografive dhe intervistimit të kandidatëve të nominuar për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Medie, ka vendosur që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Për emërimin e dy kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Medie nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar

Komisioni ad hoc i propozon kandidatët, si në vijim:

1. Muja Ferati,
2. Jeton Mehmeti
3. Anita Muriqi dhe
4. Adem Lushaj.

Anëtarët e KPM-së emërohen nga Kuvendi i Kosovës me mandat dyvjeçar në bazë të nenit 13.1.1 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Medie. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! I ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të propozojnë nga një anëtar për Komisionin votues.

Grupi Parlamentar i LDK-së?

AVDULLAH HOTI: Fidan Rekaliu.

KRYESUESJA: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PDK-së?

MEMLI KRASNIQI: Ne propozojmë në Komision deputetin Andin Hoti.

KRYESUESJA: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje?

GLAUK KONJUFCA: Salih Zyba.

KRYESUESJA: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PSD-së?

DARDAN SEJDIU: Driton Çausi.

KRYESUESJA: Faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-së?

AHMET ISUFI: Rasim Selmanaj.

KRYESUESJA: Faleminderit! Grupi Parlamentar Lista serbe? Nuk qenkan këtu. Grupi Parlamentar Nisma? Nuk qenkan këtu. Grupi Parlamentar “6+”?

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, e nderuar kryesuese!
Grupi Parlamentar “6+” e propozon deputetin Bahrim Shabani.

KRYESUESJA: Faleminderit! Lus anëtarët e Komisionit që të dalin këtu përpara.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)

KRYESUESI: Atëherë, i ftoj deputetët sipas radhës:

Abdyl Salihu, Adem Hoxha, Adem Mikullovc, Ahmet Isufi, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Balaj-Halimaj, Albulena Haxhiu, Ali Lajçi, Allbert Kinolli, Andin Hoti, Anton Quni, Arban Abrashi, Arben Gashi, Arbër Rexhaj, Arbërie Nagavci, Armend Zemaj, Avdullah Hoti, Bahrim Shabani, Bekë Berisha, Bekim Haxhiu, Besa Baftiu, Besa Gaxherri, Bilall Sherifi, Blerim Kuçi, Blerta Deliu-Kodra, Danush Ademi, Dardan Molliqaj, Dardan Sejdiu, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Drita Millaku, Driton Çausi, Driton Selmanaj, Duda Balje, Dukagjin Gorani, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Etem Arifi, Evgjeni Thaçi-Dragusha, Fadil Beka, Fatmir Xhelili, Fatmire Kollçaku, Faton Topalli, Fidan Rekaliu, Fikrim Damka, Fisnik Ismaili, Fitore Pacolli-Dalipi, Flora Brovina, Frashër Krasniqi, Gani Dreshaj, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Haxhi Shala, Haxhi Avdyli, Hykmete Bajrami, Igor Simiq, Ilir Deda, Imet Rrahmani, Islam Pacolli, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivkoviç, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Korab Sejdiu, Kujtim Shala, Labinot Tahiri, Liburn Aliu, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Lumir Abdixhiku, Lutfi Zharku, Memli Krasniqi, Mërgim Lushtaku, Mexhide Mjaku-Topalli, Milaim Zeka, Miljana Nikoliq,

Për procesverbal, ju njoftoj që anëtar i Komisionit si përfaqësues i Grupit Parlamentar Lista serbe është deputeti Adem Hoxha. Vazhdoj t’i thërras deputetët sipas radhës që të votojnë:

Mimoza Kusari-Lila, Mirjeta Kalludra, Mufera Srbica-Shinik, Muharrem Nitaj, Nait Hasani, Naser Rugova, Naser Osmani, Nezir Çoçaj, Ramiz Kelmendi, Rasim Selmanaj, Rexhep Selimi, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Salih Salihu, Sali Zyba, Sami Kurteshi, Saranda Bogujevci, Sasha Milosavljeviq, Shemsi Syla, Shkumbin Demaliaj, Shqipe Pantina, Slavko Simiq, Slobodan Petroviq, Sërgjan Mitroviq, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Time Kadrijaj, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Valon Ramadani, Verica Qeraniq, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani-Sadriu, Xhavit Haliti, Xhelal Sveçla, Xhevahire Izmaku, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti, Zoran Mojsiloviq.

KRYESUESI: Të nderuar kolegë,

Ju informoj që pas përfundimit të procesit të votimit dhe shpalljes së rezultatit të këtij votimi, do të shkojmë në pauzë deri në orën 15:30.

Pyes kolegët nëse ka mbetur ndonjë pa votuar, pa marrë pjesë në proces të votimit? Meqë s'është lajmëruar askush, konstatoj se është mbyllur procesi i votimit.

* * *

KRYESUESI: Regjia, atëherë ju lutem t'ia jepni fjalën deputetit Hoti, si raportues në emër të komisionit.

ANDIN HOTI: Faleminderit!

Ju njoftoj se ka përfunduar votimi për anëtarë të KPM-së. Kështu që po e bëjmë numërimin e votave:

Jeton Mehmeti,
Muja Ferati,
Anita Muriqi,
Muja Ferati,
Anita Muriqi,
Jeton Mehmeti,
Anita Muriqi,
Muja Ferati,
Jeton Mehmeti,
Anita Muriqi,
Adem Lushaj,
Jeton Mehmeti,
Anita Muriqi,
Muja Ferati,
Jeton Mehmeti,

Jeton Mehmeti,
Anita Muriqi,
Adem Lushaj,
Muja Ferati,
Anita Muriqi,
Jeton Mehmeti,
Anita Muriqi,
Muja Ferati,
Jeton Mehmeti,
Jeton Mehmeti,
Adem Lushaj,
Muja Ferati,
Anita Muriqi,
Muja Ferati,
Adem Lushaj,
Adem Lushaj,
Muja Ferati,
Muja Ferati,
Jeton Mehmeti,
Muja Ferati,
Jeton Mehmeti,
Jeton Mehmeti,
Adem Lushaj,
Muja Ferati,
Jeton Mehmeti,
Muja Ferati,
Anita Muriqi,
Muja Ferati,
Anita Muriqi,
Muja Ferati,
Anita Muriqi,
Muja Ferati,
E pavlefishme,
Jeton Mehmeti,
Adem Lushaj,
Muja Ferati,
Jeton Mehmeti,
Muja Ferati,
Jeton Mehmeti,
Muja Ferati,

Anita Muriqi,
Jeton Mehmeti,
Jeton Mehmeti,
Jeton Mehmeti,
Muja Ferati,
Adem Lushaj,
Anita Muriqi,
Adem Lushaj,
Muja Ferati,
Adem Lushaj,
Anita Muriqi,
E pavlefshme,
Muja Ferati,
Jeton Mehmeti,
Muja Ferati,
Jeton Mehmeti,
Anita Muriqi,
Adem Lushaj,
Jeton Mehmeti,
E pavlefshme,
Anita Muriqi,
Adem Lushaj,
Muja Ferati,
Anita Muriqi,
Adem Lushaj,
Muja Ferati,
Jeton Mehmeti,
Anita Muriqi,
Muja Ferati,
Anita Muriqi,
Muja Ferati,
Muja Ferati,
Anita Muriqi,
Muja Ferati,
Anita Muriqi,
Anita Muriqi,
Adem Lushaj,
Muja Ferati,
Anita Muriqi,
Jeton Mehmeti,

Muja Ferati,
Jeton Mehmeti,
Muja Ferati,
Anita Muriqi,
Muja Ferati,
Adem Lushaj,
Jeton Mehmeti,
Jeton Mehmeti,
Muja Ferati,
Jeton Mehmeti,
Muja Ferati,
Anita Muriqi,
Anita Muriqi,
Adem Lushaj,
Jeton Mehmeti,
Jeton Mehmeti,
Anita Muriqi,
Muja Ferati,
Jeton Mehmeti,
Jeton Mehmeti,
Muja Ferati,
Adem Lushaj,
Anita Muriqi,
Adem Lushaj,
Muja Ferati,
Anita Muriqi,
Muja Ferati,
Anita Muriqi,
Muja Ferati,
Anita Muriqi,
Muja Ferati,
Anita Muriqi,
Muja Ferati,
Jeton Mehmeti,
Anita Muriqi,
Adem Lushaj,
Jeton Mehmeti,
Muja Ferati,
Anita Muriqi,
Muja Ferati,

Anita Muriqi,
Muja Ferati,
Anita Muriqi,
Muja Ferati,
Anita Muriqi,
Jeton Mehmeti,
Adem Lushaj,
E pavlefshme,
Muja Ferati,
Adem Lushaj.

Komisioni votues për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Medie paraqet këtë:

R a p o r t

Për rezultatin e votimit për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Medie

Në mbështetje të neneve 65 dhe 141 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të neneve 11 dhe 13 të Ligjit nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur të Medieve, si dhe nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni votues, i formuar me vendim të Kuvendit, më 30 maj 2018, në përbërje nga një përfaqësues i secilit grup parlamentar, Komisioni votues pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Medie, në seancën plenare, të mbajtur më 30 maj 2018, konstaton:

- Në votim kanë marrë pjesë 83 deputetë,
- të pavlefshme janë 4 fletëvotime,
- votat e fituara për kandidatët e propozuar për dy anëtarë të Komisionit të Pavarur për Medie nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar janë, si në vijim:

- Muja Ferati i ka fituar 46 vota,
- Jeton Mehmeti i ka fituar 35 vota,
- Anita Muriqi i ka fituar 38 vota dhe
- Adem Lushaj i ka fituar 21 vota.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, në bazë të këtij raporti, ose të këtij rezultati, Kuvendi e ka zgjedhur kandidatin Muja Ferati për anëtar të Komisionit të Pavarur të Medieve.

Ndërkaq, në një rund të dytë do të jenë kandidatët Anita Muriqi dhe Jeton Mehmeti. Këtë rund të votimit do ta zhvillojmë pas pauzës, do të thotë në orën 15:30. Mirupafshim!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Para se të fillojmë votimin, në qoftë se bëhemi 61, a e votojmë projekt-propozimin e rezolutës për bashkim kombëtar.

Po e fillojmë votimin se nuk janë deputetët, 54-55. Fillojmë me këta deputetë, të cilët janë, unë i lexoj të gjithë, e mundësisht, mos e humbin rendin, votoni një nga një. Unë po i lexoj të gjithë:

Abdyl Salihu, Adem Hoxha, Adem Mikullovc, Ahmet Isufi, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Balaj-Halimaj, Albulena Haxhiu, Ali Lajçi, Albert Kinolli, Andin Hoti, Anton Quni, Arban Abrashi, Arben Gashi, Arbër Rexhaj, Arbërie Nagavci, Armend Zemaj, Avdullah Hoti, Bahrim Shabani, Bekë Berisha, Bekim Haxhiu, Besa Baftiu, Besa Gaxherri, Bilall Sherifi, Blerim Kuçi, Blerta Deliu-Kodra, Danush Ademi, Dardan Molliqaj, Dardan Sejdiu, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Drita Millaku, Driton Çausi, Driton Selmanaj, Duda Balje, Dukagjin Gorani, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Etem Arifi, Evgjëni Thaçi-Dragusha, Fadil Beka, Fatmir Xhelili, Fatmire Kollçaku, Faton Topalli, Fidan Rekalio, Fikrim Damka, Fisnik Ismaili, Fitore Pacolli-Dalipi, Flora Brovina, Frashër Krasniqi, Gani Dreshaj, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Haxhi Shala, Haxhi Avdyli, Hykmete Bajrami, Igor Simiq, Ilir Deda, Imet Rrahmani, Islam Pacolli, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivkoviç, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Korab Sejdiu, Kujtim Shala, Labinot Tahiri, Liburn Aliu, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Lumir Abdixhiku, Lutfi Zharku, Memli Krasniqi, Mërgim Lushtaku, Mexhide Mjaku-Topalli, Milaim Zeka, Miljana Nikoliq, Mimoza Kusari-Lila, Mirjeta Kalludra, Mufera Srbica-Shinik, Muharrem Nitaj, Nait Hasani, Naser Rugova, Naser Osmani, Nezir Çoçaj, Ramiz Kelmendi, Rasim Selmanaj, Rexhep Selimi, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Salih Salihu, Sali Zyba, Sami Kurteshi, Saranda Bogujevci, Sasha Milosavljeviq, Shëmsi Sylë, Shkumbin Demaliaj, Shqipe Pantina, Slavko Simiq, Slobodan Petroviq, Sërgjan Mitroviq, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Time Kadrijaj, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Valon Ramadani, Verica Qeraniq, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani-Sadriu, Xhavit Haliti, Xhelal Sveçla, Xhevahire Izmaku, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti, Zoran Mojsiloviç.

Të gjithë janë thirrur, po në qoftë se nuk e kam thirrur ndonjërin, a s'e ka dëgjuar, është i thirrur prapë.

Të nderuar deputetë,

Kryetarët e grupeve parlamentare, a ka mundësi për 2-3 emra, nuk janë 60, a ka mundësi të shikoni për kolegët tuaj, për kolegët tanë, të mos dështojë procesi për 2-3, dy erdhën, edhe 1 a 2, në qoftë se ka mundësi.

Në qoftë se ka edhe ndonjë kolegë deputetë që nuk ka votuar, e ftoj për votim para se të përmbillet procesi i votimit.

Komisioni, në qoftë se ka nevojë të numërohen a janë 61, sa kanë marrë pjesë? Nëse ka mundësi ndonjëri prej jush.

* * *

KRYETARI: Komisioni e ka fjalën, ju lutem, për raportin.

ANDIN HOTI: Faleminderit, kryesues!

Më lejoni t'ju informoj që ka përfunduar votimi dhe votat të cilat i kanë marrë kandidatët janë këto:

Anita Muriqi,
Anita Muriqi,
Jeton Mehmeti,
Anita Muriqi,
Jeton Mehmeti
Jeton Mehmeti
Jeton Mehmeti
Anita Muriqi,
Anita Muriqi,
Jeton Mehmeti
Anita Muriqi,
Jeton Mehmeti,
Jeton Mehmeti,
Anita Muriqi,
Jeton Mehmeti,
E pavlefshme,
Anita Muriqi,
Jeton Mehmeti,
Anita Muriqi,
Jeton Mehmeti,
Jeton Mehmeti,
Jeton Mehmeti,
Anita Muriqi,
Jeton Mehmeti,
E pavlefshme,
Anita Muriqi,

Anita Muriqi,
Anita Muriqi,
Anita Muriqi,
Jeton Mehmeti,
Anita Muriqi,
Anita Muriqi,
Anita Muriqi,
Jeton Mehmeti,
Anita Muriqi,
Anita Muriqi,
Anita Muriqi,
Jeton Mehmeti,
Jeton Mehmeti,
Jeton Mehmeti,
Anita Muriqi,
Anita Muriqi,
Anita Muriqi,
Anita Muriqi,
Jeton Mehmeti,
Anita Muriqi,
Anita Muriqi,
Anita Muriqi,
Anita Muriqi,
Anita Muriqi,
Anita Muriqi,
Jeton Mehmeti,
Anita Muriqi,
Anita Muriqi,
E pavlefshme,
Jeton Mehmeti,
Anita Muriqi,
Anita Muriqi,
Jeton Mehmeti,
Anita Muriqi,
Anita Muriqi,
Anita Muriqi,
Anita Muriqi,
Anita Muriqi,
Anita Muriqi,
Jeton Muriqi,
Jeton Mehmeti,

Anita Muriqi,
Anita Muriqi,
Jeton Mehmeti,
Jeton Mehmeti,
Anita Muriqi,
Anita Muriqi,
Jeton Mehmeti,
Jeton Mehmeti,
Anita Muriqi,
Anita Muriqi,
Jeton Mehmeti,
Anita Muriqi,
Anita Muriqi,
Jeton Mehmeti,
Jeton Mehmeti,
E pavlefshme
Anita Muriqi,
Anita Muriqi,
Jeton Mehmeti,
Jeton Mehmeti,
Anita Muriqi, dhe e fundit
Anita Muriqi,

Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, raportuesi i komisionit i jep rezultatet.

ANDIN HOTI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni votues për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Media paraqet këtë raport.

Rezultatet e votimit për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Media, në mbështetje të neneve 65, 141 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të neneve 11 dhe 13, të Ligjit nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur të Mediave, si dhe nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni votues i formuar me vendim të Kuvendit më 30 maj 2018, në përbërje nga një përfaqësues të secilit grup parlamentar.

Komisioni votues, pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Media në seancën plenare të

mbajtur më 30 maj 2018, në rundin e dytë të votimit konstaton: në votim kanë marrë pjesë 88 deputetë. Të pavlefshme janë 4 fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar për një anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave nga radhët e komunitetit shumicë shqiptarë janë si në vijim:

Anita Muriqi i ka fituar 51 vota dhe
Jeton Mehmeti i ka fituar 33 vota.

Urime, fituesve!

KRYETARI: Faleminderit! Në bazë të raportit të Komisionit votues konstatoj se Muja Ferati zgjidhet anëtar i Komisionit të Pavarur të Mediave nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar dhe zonja Anita Muriqi zgjidhet anëtare e Komisionit të Pavarur të Mediave nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar.

Të nderuar deputetë, në vazhdim ftoj propozuesin e një drafti për projekt-rezolutës për hapjen e tërësishme të kontrollit për hyrje-daljet e shtetasve të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë mes pikave kufitare të lartcekura, zotin Dardan Molliqaj ta marrë fjalën.

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit, kryetar!

Edhe një herë faleminderit të gjitha grupeve parlamentare dhe deputetëve, të cilët dhanë kontribut në diskutimin e kësaj pike të rendit të ditës. Me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate dhe të harmonizuar me grupet e tjera parlamentare, Kuvendi i Republikës së Kosovës, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 65, paragrafi 1, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Neni 6, paragrafi 1 i Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës nxjerr këtë rezolutë për heqjen e tërësishme të kontrollit për hyrje-daljet të shtetasve të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë ndërmjet pikave të kalimit kufitar në pika kufitare Vërmicë, Qafë Prush, Qafë Morinë.

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të nisë procedurat e domosdoshme kushtetuese dhe ligjore për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare për hapjen e kufijve për qarkullimin e lirë të njerëzve, të cilët janë shtetas të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës. Të gjitha procedurat e nevojshme në lidhje me këtë çështje të nisin menjëherë me miratimin e kësaj rezolute.

Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet marrëveshjen bilaterale, e cila heq detyrimin për qytetarët e të dy shteteve për të udhëtuar me letërnjoftim dhe pasaporta, duke lejuar që shtetasit e të dy shteteve respektive të udhëtojnë drejtpërdrejt dhe pa penguar nëpërmjet pikave të kontrollit kufitar, duke përfshirë moskontrollin e automjeteve me shpejtësi të reduktuar. Realizimi i kësaj

rezolute do të bëhet duke marrë në konsideratë praktikat më të mira evropiane dhe direktivat e Bashkimit Evropian për këtë çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë, tani përgatitemi për votim. Aktualisht në sallë janë 72 deputetë. Votojmë tash!

71 deputetë kanë votuar. Edhe Adem Mikullovc i me dorë. Zoti Mikullovc, a je për? 72 deputetë me elektronikë e me dorë janë për bashkim, në fakt, edhe unë s'kam votuar. Edhe unë me dorë, në qoftë se ka mundësi.

Kuvendi e miratoi rezolutën për hapjen e tërësishme të kontrollit për hyrje-dalje të shtetasve të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë nëpërmjet pikave të kalimit kufitar në Vërmicë - Qafë Prush - Qafë Morinë.

20. Debat parlamentar në lidhje me të drejtat e punëtorëve dhe adresimin e papunësisë në Republikën e Kosovës, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje

Kryetari i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, zoti Glauk Konjufca, i mbështetur edhe nga 7 deputetë të tjerë ka parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me të drejtat e punëtorëve dhe adresimin e papunësisë në Republikën e Kosovës.

Zoti Konjufca, fjala është për ju!

GLAUK KONJUFCA: Po, të gjithë e dimë që punëtorët janë kategoria më e diskriminuar në Kosovë. Të drejtat e tyre shkelen në mënyrë sistematike, shkelen për çdo ditë edhe Qeveria, institucionit, shteti i Kosovës nuk është shumë aktiv në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve. E thirrëm këtë debat parlamentar sepse është shumë aktual për nga aspekti tematik, e dihet shumë mirë që shtetet antidemokratike, në njëfarë mënyre, të cilat janë kundër të drejtave të njeriut, i vendosin të drejtat e punëtorëve kundër zhvillimit ekonomik, kishe sa më pak kanë të drejta punëtorët, është ambienti më i favorshëm për t'u zhvilluar biznesi dhe për të ndodhur njëfarë zhvillimi ekonomik.

Mirëpo, të gjitha shtetet demokratike evropiane i vendosin në përpjesëtim të drejtë të drejtat e punëtorëve me zhvillimin ekonomik. Nuk mund të kesh ekonomi të shëndoshë nëse ke punëtorë të shkelur, edhe atyre u shkelen të drejtat në çdo aspekt, janë të diskriminuar. E thirrëm këtë debat parlamentar edhe për një arsye tjetër. Ka kaluar më shumë se një vit kur në Kuvendin e Kosovës ishte miratuar një rezolutë për të drejtat e punëtorëve. Unë desha ta risjell në kujtesën tuaj, ta risjell edhe një herë në vëmendjen tuaj qysh asnjë pikë nuk po zbatohen rezolutat e këtij Kuvendi të Kosovës. Atëherë, nuk është çështja më as te disiplina, as a po vinë, e a s'po vinë, kush po mungon e kush po vjen, se këtu edhe ata që po vijnë e po miratohen dokumente në

mënyrë legale, këtu në Parlamentin e Kosovës, ato nuk po zbatohen. Atëherë duhet ridefinuar edhe një herë ekzistenca dhe kuptimi i Parlamentit të Kosovës.

Çka nëse dokumentet që po i miratojmë ne vetë nuk po zbatohen, e ironia edhe më e madhe është që këtë dokument e ka propozuar mazhoranca atëherë. Domethënë, mazhoranca e mandatit të kaluar qeveritar. Kjo rezolutë është miratuar në Kuvendin e Kosovës më 19 prill të vitit të kaluar, i ka nëntë pika. E para, e obligon Inspektoratin e Punës që të kryejë inspektimin në të gjithë sektorët. Të bëjë monitorimin dhe respektimin e të drejtave të punëtorëve në të gjitha ndërmarrjet publike dhe private. Deputetët e Kuvendit të Kosovës janë kundër largimit kolektiv nga puna, siç ka bërë KEDS-i, për shembull, që ka shpunësuar punëtorët në vitin 2016 me masa kolektive, domethënë, të shpunësimit. Të respektohet Kontrata kolektive në të gjithë sektorët dhe në të gjitha ndërmarrjet. Të respektohet Ligji i punës dhe Ligji për sigurinë e shëndetit në punë dhe ligjet e tjera që i rregullojnë të drejtat e punëtorëve; Të funksionalizohet Këshilli Ekonomik Social i Kosovës dhe Këshilli Kombëtar për Siguri dhe Shëndet në Punë; Ministria e Punës të aprovojë strategjinë për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve; Të obligohet kjo ministri që t'i rrisë kapacitetet e Inspektoratit të Punës, (nuk ka ndodhur, nuk e kanë bërë), dhe e fundit: Inspektorati i Punës për çdo tre muaj të raportojë në komisionin parlamentar për gjetjet nga inspektimet në nivelin e shkeljes së të drejtave të punëtorëve dhe të gjitha këto t'i raportojë përpara komisionit parlamentar.

Shumica e pikave të miratuara nga kjo rezolutë fatkeqësisht nuk janë zbatuar dhe unë këtu desha të ngre edhe një problem tjetër që po na përcjell neve si shtet. Është ai problemi, që thonë i kontinuitetit institucional. Pra, diqysh kjo Qeveria e tanishme as që i shkon mendja që disa dokumente të mandatit të kaluar, nuk ka lidhje që janë të mandatit të kaluar, ato kanë efektivitet juridik dhe edhe Qeveria e tanishme ka obligime për rezolutat që janë në fuqi në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Asnjë qeveri nuk e fillon punën prej pikës zero. Diqysh sikur të thuhet tash erdhëm ne dhe prej dhjetorit a nëntorit të vitit të kaluar fillon gjithçka prej zeros. Janë disa rezoluta ekzistuese dhe disa ekspertë të Qeverisë duhet treguar Qeverisë se ato që janë në fuqi dhe që janë miratuar në Kuvend të Kosovës janë votuar prej nesh, duhet parë dhe duhet zbatuar ato rekomandime. Se, a e patë, pak më herët, para dhjetë minutash sa shumë u gëzuam që u hoqën ato, e mund të harrojmë e të kthehemi pas një viti këtu, siç jam kthyer unë tash që po i lexoj këto, e të bëjmë veç një konstatim. Jemi takuar para një viti dhe kurrjë kurrkujt!

Kështu në Kuvendin e Kosovës shpesh ka ndodhur, kjo praktikë dhe fatkeqësisht nëse duam me të vërtetë të bëhemi seriozë institucionalisht, në baza mujore Qeveria duhet t'i shikojë obligimet e veta, me të cilat e ka ngarkuar Kuvendi i Kosovës. Qeveria po e mendon vetveten sikur njëfarë lloj institucioni, i cili duhet të punojë veç me projekte të vetat. Domethënë, nuk e ka konceptin që këto janë marrëdhënie mes Kuvendit, Qeverisë, sidomos raporti në mes të Kuvendit dhe të

Qeverisë është boshti i një shteti demokratik. Dhe, kurrizi i shtetit është relacioni ndërmjet Kuvendit dhe Qeverisë.

Tash, Ministria e Punës nuk ka paraqitur as në publik, as zyrtarisht ndonjë strategji apo fillimin e punës për çështjen e respektimit të të drejtave të punëtorëve, edhe pse Kuvendi ia ka kërkuar me rezolutë. Kontrata kolektive, edhe pse në çdo fushatë elektorale është bërë rregullisht temë e premtimeve, nuk ka gjetur zbatim dhe po vjen të shpërfillet si kërkesë e sindikatave nga ana e Qeverisë, edhe e Qeverisë aktuale, po edhe e të gjitha qeverive deri më tash.

Funksionalizimi i Këshillit Social Ekonomik ka ndodhur, por kërkesa e parë e këtij këshilli, rritja sipas legjislacionit në fuqi e pagës minimale u shpërfill nga Qeveria e Kosovës, si dhe kjo mazhorancë në Kuvendin e Republikës së Kosovës e refuzoi të votonte mocionin e opozitës, përfshirë edhe pikën e propozuar nga Lëvizja Vetëvendosje për rritjen e pagës minimale dhe heqjen e dallimit të moshës në këtë pagë.

E dimë që ekzistojnë nja dhjetë ligje në Kosovë, të cilat drejtpërdrejt u qasen të drejtave të punëtorëve, mundohen t'i rregullojnë dhe t'i mbrojnë të drejtat e punëtorëve: Ligji i punës, Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë, Ligji për Inspektoratin e Punës, Ligji për Këshillin Ekonomik Social, Ligji për organizimin sindikal, Ligji për aftësimin, riaftësimin dhe punësimin e personave me nevoja të veçanta, Ligji për grevat, si dhe Ligji për dhënien e lejes për punë dhe punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës.

Ne mendojmë që punëtorëve t'u ndihmojmë sadopak me përmirësimin e kornizës ligjore në Kosovë dhe ne e kemi një rezolutë, të cilën unë do ta prezantoj në fund të këtij debati. I ka pesë pika. Një e kemi hequr, me siguri materiali ju ka ardhur edhe juve, ju ka ardhur me gjashtë pika, por kemi vendosur ta heqim pikën e katërt, pra këtë pikën që thotë “të përshpejtohet puna e Komisionit të Shëndetësisë dhe e Mirëqenies Sociale në procedimin e Ligjit për biznes social”, sepse njëri prej ligjeve bazike tashmë ka kaluar në lexim të parë dhe nuk ka nevojë. Pritet leximi i dytë të vijë dhe ligji faktikisht bëhet ligj dhe shpallet në Gazetën Zyrtare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Përndryshe, sa u përket këtyre pesë pikave të tjera, ndoshta më mirë është të prezantohen në fund të debatit. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)

KRYESUESI: Faleminderit! Para se të deklarohen përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ia jap fjalën kryetarit të Kuvendit, zotit Kadri Veseli.

KADRI VESELI: Faleminderit! Ka të bëjë pikërisht me temën, të cilën e ka iniciuar Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, për të cilën foli Glauku.

Është një temë që ka filluar edhe një vit më herë, më duket, e pati iniciuar Grupi Parlamentar i PDK-së. Sido që të jetë, tash flet Xhevairja dhe Bekimi, ka mbetur pjesa e rezolutave, por unë do ta them vetëm atë pjesën për të cilën unë dola tani për ta marrë fjalën më drejtpërdrejt, për arsye se është një nga temat më të ndjeshme.

Nuk ka rast ku futem në ndonjë dyqan, ose që takoj edhe në rrugë punëtorë, që nuk e përmend çështjen e të drejtave të veta, po flas për punëtorët. Kjo është arsyeja pse më bëri më obligativ, pikërisht në bazë të pozitës të cilën e mbaj ndoshta si kryetar i Kuvendit dhe shpresa të cilën e kanë punëtorët që t'u mbrohen të drejtat e tyre. Po flas për disa ankesa të tyre, të cilat i kanë përmendur.

Nuk ka të bëjë vetëm me çështjen e orëve të punës që i kanë tejkaluar, ka të bëjë me ditë të tëra që nuk u paguhen brenda një muaji. Ata nuk dinë, punëtorët në sektorin privat, me respektin e madh, ne jemi parti e djathtë dhe e përkrahim, qëndrojmë fuqishëm iniciativës private, por të njëjtën kohë duhet pasur parasysh se duhet mbrojtur të drejtat e punëtorëve. Për vetë faktin, se nuk mund të kesh kapital të mirë, në qoftë se s'e mbron djersën e tjetërkujt. Do të thotë, nuk e dinë kur e kanë ditën e pushimit, kjo është më e rënda. E të njëjtën kohë, i dënojnë, kjo është edhe një pjesë të cilën shumë punëtorë në supermarkete ma thonë, i dënojnë në qoftë se diçka mund të ketë mangësi në punë. E paguajnë si kompensim pagën e vet, në qoftë se i merr 200 - 250 euro rrogë, ia ndal edhe deri në 100 euro, ka mundësi, në muaj, ia ndalin për shkak të dëmit që ka mundur t'i shkaktohet pronarit të një supermarketi.

Të njëjtën kohë, në ndërtimtari, po ashtu nuk është gjendja ashtu siç duhet, Ligji i punës duhet të respektohet më shumë, ndoshta si Kuvend kjo është pjesa të cilën do t'i propozoja propozuesit të kësaj seance, do të ishte mirë që të mos përfundojë me ditën e sotme kjo çështje, për arsye se zakonisht ne mund të nxjerrim edhe ndonjë rezolutë dhe pastaj mbetet po ashtu një rezolutë e cila nuk implementohet, por të jetë një task-forcë, e cila ndoshta në një periudhë deri në tre muaj, po tash edhe pse futemi në pushim veror, nuk prish punë edhe në periudhën e vjeshtës pastaj kur të vijmë në seanca parlamentare, të kemi të mbledhura, t'i inkurajojmë punëtorët që të vijnë, të sjellin informacione në mënyrë konfidenciale te ne, në mënyrë që të veprohet. Pastaj, t'i obligojmë edhe mekanizmat relevantë në mbrojtjen e ligjshmërisë, në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, në mënyrë që saktësisht të dihet gjendja.

Kemi shumë raste kur nuk guxojnë punëtorët të denoncojnë punëdhënësit. Kjo është një situatë e cila është reale, ne flasim sot shumë gjatë, ata kërcënohen me largimin nga vendi i punës. Kontratat i kanë, ende nuk i kanë të kualifikuar në mënyrën e duhur. Por, në këtë drejtim, veçanërisht në sektorin privat, duke e fuqizuar sektorin privat do të ishte mirë që pas kësaj

seance të mos përfundojë me një rezolutë. Të ketë një task-forcë, e cila do të jetë tre muaj deri në gjashtë muaj dhe pastaj takohemi prapë nga pjesa e tetorit a nëntorit edhe një herë, pikërisht rreth të njëjtës temë. Do të jetë task forcë, shumëpartiake, me rol edhe investigues, ta vejmë një situatë në të cilën duhet të jetë edhe shteti ynë në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve. Kjo ishte më tepër obligim ndaj gjithë atyre dhe falënderim si besim ndaj të gjithë atyre, të cilët edhe në rrugë e në çdo dyqan, në pikat e furnizimit të karburanteve, të cilët i shprehin shqetësimet e tyre për të drejtat e tyre, të punëtorëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës e vlerësoj si mjaft të vlefshme dhe të dobishme që sot po debatojmë dhe po e trajtojmë një temë prej më të rëndësishmeve në vendin tonë.

Kjo odise e problemeve të punëtorëve me punëdhënësit, po edhe me gamën e legjislacionit, i cili është legjislacion konkretë, është legjislacion modern, por që vite të tëra disi si klasë politike, qoftë si organi më i lartë legjislativ apo edhe linja të caktuara të ekzekutivit të vendit, nuk po mund ta jetësojmë këtë gamë legjislative dhe realisht ky mbetet një problem serioz për mbarëvajtjen edhe të zhvillimit ekonomik në vendin tonë.

Situata nuk është e mirë në të dy këto fushat, për të cilat po debatohet sot.

Andaj, duhet angazhim i secilit prej nesh, i secilit institucion kompetent që të ndryshojmë situatën për të mirë, në fakt, duhet edhe një ndryshim kulturor i qasjes së institucioneve karshi sektorit privat. Duhet një emancipim, i një logjike të re ekonomike, një akomodim për ekonominë e tregut që nganjëherë di të jetë edhe pamëshirshme me ata që e bëjnë atë fuqinë punëtore, apo që është ai sistemi lokomotor i mbajtjes së jetës socio-ekonomike në një shtet.

Mirëpo duhet ta vlerësojmë sektorin privat me ekonominë e tregut dhe duhet të jemi falënderues për hapjen e vendeve të reja të punës, për krijimin e një jete më cilësore në Republikën e Kosovës, edhe pse ky trend duhet të rregullohet, duhet të monitorohet, duhet të inspektohet dhe dora e shtetit definitivisht duhet të jetë e pranishme në kuptimin e respektimit të legjislacionit aktual në fuqi.

Tek e drejta e punëtorëve dhe siguri në punë mund të debatojmë me orë dhe me ditë të tëra, por duhet të veprohët urgjentisht në ngritjen e domosdoshme të nivelit të zbatimit të kësaj pakoje legjislative, e cila edhe një herë po e nënvizoj, është një pako legjislative optimale që korrespondon edhe me nevojat e gjendjes aktuale në Kosovë, edhe me etapat e transicionit, por

që përkon edhe është në përputhje edhe me legjislacionin e shteteve që janë anëtare të BE-së dhe i kanë kaluar këto faza nëpër të cilat ne jemi tani.

Mirëpo, si bëhet kjo? Kjo bëhet në qoftë se përmes monitorimit të vazhdueshëm, inspektimit në vazhdimësi dhe për me sjelljen të praktikave më të mira nga vendet të cilat i kanë kaluar me sukses dhe i kemi shifrat, shembujt, statistikatat dhe eksperiencat. Pse të mos e përcjellim edhe ne një mostër të një rrugëtimiti të tillë që në një masë të madhe e kanë rregulluar këtë çështje. Të mos harrojmë, as në shtetet me demokraci më të zhvilluar nuk është balanca e mirëfilltë e rregullimit të këtyre fushave, sepse është ai antagonizmi punëdhënës - punëtorë, por edhe antagonizmi i këtyre dy segmenteve të rëndësishme me shtetin, me qeverinë apo me mekanizmat kushtetues që e mbikëqyrin realizimin e këtij legjislacioni.

Inspektoratit të Punës në vendin tonë i duhet një strukturim efikas, sigurim të pajisjeve dhe infrastrukturës për mbledhjen, monitorimin e të dhënave dhe, mbi të gjitha, nuk ka staf të mjaftueshëm.

Ne si Kuvend çfarë mund të bëjmë? Mund të alokojmë buxhet të mjaftueshëm konform nevojave dhe statistikave zyrtare dhe mund ta rrisim stafin e inspektorëve të punës, sepse vetëm muajve të fundit jemi dëshmitarë që mjaft punëtorë në punishte, qoftë të sektorit privat, po edhe të atij publik, janë lënduar apo edhe e kanë humbur jetën.

Për këtë arsye dhe shumë të tjera, duhet të shtojmë kapacitetet institucionale.

Rritja e numrit të inspektorëve dhe, gjithashtu edhe vetëdijesimi dhe trajnimi i punëtorëve në aplikimin e kriterëve të mbrojtjes në punë, sepse kur kërkojmë emancipim dhe trajnim të vazhdueshëm, edukim edhe punëdhënësve, respektim të ligjit, të njëjtën gjë duhet ta kërkojmë edhe nga të punësuarit në sektorin qoftë publik, publiko-privat apo edhe privat.

Sistemi tani për tani ballafaqohet me shumë mangësi, si legjislacioni i pamjaftueshëm, mungesa e trajnimeve, mungesa e planit të punës, kushtet jo të mira për inspektorët e punës, por gjithashtu edhe buxheti i pamjaftueshëm dhe te sektori publik, edhe ndërhyrja shpesh e pamëshirshme e politikës në këto ndërmarrje dhe në këto politika.

Në emër të Grupit Parlamentar vlerësojmë se Ligji i punës, Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë, Ligji për Inspektoratin e Punës janë një trinom i rëndësishëm i kësaj game legjislative, i masave dhe i veprimeve ekzekutive që duhet të ndërmerren dhe në bashkëpunim me Këshillin Ekonomiko-Social duhet t'i adresojmë dhe t'u japim përgjigje adekuate këtyre problematikave që janë akute, por edhe vazhdojnë ta kenë kronicitetin e pamëshirshëm pothuajse për dy dekada.

Te papunësia kemi lëvizje negative. Papunësia sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës e ka kaluar shifrën 30%, e posaçërisht për femrat që e arrijnë shifrën 38%. Vërtet ky do të duhej të jetë një alarm edhe për Legjislativin, edhe për Ekzekutivin, edhe për shoqërinë civile, edhe për mediat, edhe për punëdhënësit, sepse vërtet edhe qarku akademik universitar duhet ta thotë fjalën, mendimin e vet dhe t'i ndihmojë institucionet me hartimin, menaxhimin dhe implementimin e këtyre politikave.

Spektori privat duhet të afrojë programe dhe oferta gjithëpërfshirëse, në mënyrë që në mes këtij trinomi: Këshillit Ekonomiko-Social dhe shtetit të krijohet një lidhje strategjike e veprimit.

Jo vetëm një task forcë, jo vetëm kjo rezolutë që besoj do ta marrë miratimin e të gjithë deputetëve, por duhet të jemi kompetentë si institucione, t'i obligojmë institucionet që janë kategori kushtetuese dhe i subordinohen secilës rezolutë që votohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës që atë edhe ta implementojë në praktikë.

Prandaj, duhet një rishikim i gjithmbarshëm i politikave tona edhe në fushën e arsimit dhe shpërndarjen e fondeve publike, edhe pse kemi ligje dhe iniciativa që e përkrahin, edhe grupe të ndryshme të cënueshme, por vërtet duhet të jemi të kujdesshëm me ata 30 mijë maturan të që e kalojnë moshën 18-vjeçare dhe janë fuqi punëtore në këtë treg të vrazhdë të punës.

Skemat pasive, të cilat implementohen në Kosovë, e tejkalojnë shumë prej 370 milionë eurove, kurse skemat aktive ato që gjenerojnë vende të reja të punës dhe që ndërlidhen me rininë, me ndërmarrësin, me inovacionin, arrijnë vetëm disa milionë apo vetëm 5% të këtij 370-milionëshi. Këtë disbalancë duhet ta analizojë dhe t'i japë zgjidhje edhe Kuvendi, por ta obligojnë ministrinë kompetente që t'i realizojë këto politika.

Kjo gjendje duhet të ndryshojë, nëse e kemi seriozisht e kemi seriozisht uljen e papunësisë dhe krijimin më të mirë edhe për kushtet e punës, edhe për të bërit biznes, edhe për një perspektivë më të mirë ekonomike për vendin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka deputetja Xhevahire Izmaçu.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Përsëndetje për kolegë deputetë,

Për qytetarët, të cilët na përcjellin,

Fillimisht më lejoni që të sqaroj një informacion, zoti Konjufca e përmendi që rezoluta është miratuar, unë desha vetëm si informacion që është e vërtetë që është përpunuar rezoluta, mirëpo nuk ka arritur të miratohet në Kuvend, për arsye që në momentin kur ne kemi debatuar për këtë temë, Komisioni Parlamentar për Punë Sociale dhe Shëndetësi e ka pasur në monitorim Ligjin e

punës. E në këtë drejtim ka mbetur rezoluta të harmonizohet, pastaj Kuvendi ishte shpërbërë, kështu që sot kemi mundësi t'i vejmë disa pika që kanë qenë në atë rezolutë, sigurisht ne do të propozojmë si PDK. Po këtu nuk ka asgjë të keqe, sepse mendoj që qëllimi i përbashkët yni është që të diskutojmë për një temë të rëndësishme dhe jo të marrim ndonjë meritë.

Fillimisht falënderoj iniciuesin dhe të gjithë deputetët nënshkrues, po edhe deputetë që do të angazhohen në diskutime sot për një pikë kaq të rëndësishme për të drejtat e punëtorëve në punë. Fokusi dhe shqetësimi ka qenë i vazhdueshëm i Grupit Parlamentar të PDK-së dhe gjithmonë, kushdo që merr një iniciativë të tillë, ne do ta mbështesim, kudo qofshin si PDK-në, tani si mazhorancë, edhe në të kaluarën si mazhorancë, po edhe në rrethana të tjera, sigurisht që është një temë për të cilin ne s'do ta neglizhojmë asnjëherë.

Asnjëherë pra nuk është e mjaftueshme beteja për avancim të së drejtës së punëtorit, ku edhe në vendet me demokraci më të zhvilluar bëhen debate mbi nivelin e realizimit të të drejtave në punë, por edhe zbatueshmëria dhe ligjshmëria në këtë drejtim.

Në çdo moment kontributi ynë si PDK nuk ka munguar, pra s'do të mungojë kur atakohen këto të drejta elementare të këtyre njerëzve që bëjnë përpjekje maksimale të mbijetojnë nga djersa e vet, duke mos zgjedhur asnjë punë, por duke duruar edhe 12 orë punë, edhe pa pushim vjetor, por edhe me një pagë minimale që siguron veç mbijetesë ndoshta, por jo edhe mirëqenie në familjet e tyre.

Ne si Kuvend viteve të fundit jemi përpjekur të bëjmë ligje të mira që mbështesin sektorin privat dhe u japin mundësi kompanive tona të zhvillohen në bizneset e tyre.

Meqenëse në momentin kur flasim për të drejtat në punë, e tha pak më parë edhe kryetari i partisë sime, kryetari i Kuvendit, menjëherë mendja na shkon te punëtorët e sektorit privat, sepse realiteti është që shumë më pak kemi pasur mundësi t'i mbrojmë, edhe deri tani mendoj që nuk e kemi dhënë maksimumin dhe ka shumë punë për të bërë, kështu që nuk do të amnistojmë asnjë pozicion zyrtar, qoftë edhe si mazhorancë, për persona të cilët nuk e kryejnë punën e vet, pra gjithmonë do të flasim për të drejtën dhe do të punojmë për të drejtën e punëtorëve dhe jo të flasim dhe të punojmë si mazhorancë, të mbrojmë ata që si realizojnë këto.

A mjaftojnë këto ligje dhe këta mekanizma? Si grup i PDK-së mendojmë se ende jo, nuk mjaftojnë, ende ka punë për të bërë edhe Qeveria, edhe shteti në përgjithësi, me të gjithë mekanizmat dhe instrumentet e veta në avancim të së drejtës dhe në implementim të këtyre ligjeve që i kemi bërë vetë.

Por, a duhet të kenë shkas këto kompani që sot një punëtor ta trajtojnë si një fuqi fizike ose veç vegël pune, pra ky nuk është shkas, sepse ne kemi dëgjuar shumë raste kohët e fundit për trajtim,

por edhe për fatkeqësi, për të cilat nuk kemi asnjë rezultat, nuk e dimë nëse është dënuar dikush apo jo.

Veçanërisht do të ndalem te punëtorët në sektorin e ndërtimeve. Pra gjatë ditëve të verës i kemi parë në temperatura mbi 30 gradë celsius, gjatë dimrit me minus 20, sigurisht edhe pa siguri në punë, me rroga minimale, me një ditë pushim në javë dhe me paga që u jepen kryesisht në dorë dhe për këtë gjendje kemi diskutuar shumë herë në Kuvend edhe deputetët e PDK-së e kanë pasur si trajtim këtë çështje.

Janë raportuar raste të shumta në Inspektoratin e Punës, në momentin kur ne kemi kërkuar që të marrin një raport nga Inspektorati, ata justifikojnë punën e tyre dhe ne nuk mund t'i kritikojmë pafundësisht, sepse shpesh lëndën e tyre shkojnë në gjykata edhe mbesin me vite, këtu kemi nevojë ta ndihmojmë Inspektoratin.

Pra, nëse ata nuk arrijnë që ta kryejnë punën e vet, së paku ne sot, pas këtyre diskutimeve mund të propozojmë edhe në rezolutë që të kemi një, jo vetëm momentale, mirëpo ta kemi një lloj agjencie që do të merret kryesisht me monitorimin, me kujdesin e të drejtave të punëtorëve në sektorin privat, sepse ne konsiderojmë që, megjithatë punëtorët në sektorin publik i kanë disa mundësi që t'i atakojnë padrejtësitë e tyre.

Nuk është që ne nuk i shohim, pra si deputetë, si grup parlamentar, si qytetarë i shohim shumë mirë gratë edhe vajzat tona të punësuar në marketet gjigante si trajtohen. Punë që zgjat 12 orë, ku ato përdoren edhe për pastrim, edhe për palosje, jo vetëm për punën e tyre që e kanë detyrë, me një ditë pushim në javë, me vetëm 10 ditë pushim vjetor, pa asnjë ditë kompensim jashtë orarit të punës, duke mos i lënë asnjë karrige derisa ato llogarisin faturat e gjata të blerësve. Kjo pra nuk duhet më të qëndrojë dhe nuk mund t'i mbyllim sytë para saj.

Shoferët e taksive, të cilët po ashtu na drejtohen edhe neve si deputetë, shumica e tyre punojnë pa kontrata, paguhen me para kesh, sepse ne e dimë që kemi shumë më shumë punëtorë që punojnë në sektorin privat, edhe pse nuk janë të lajmëruar, shumica janë të angazhuar në sektorin privat.

Do të përmend edhe një rast, qindra vajza dhe gra, kryesisht pra në bankat tona në vend, kryesisht private, punojnë me shumë presion, largohen nga puna pa ndonjë shkas dhe u kërkohet edhe dorëheqja si një marrëveshje që pronarët të ikin nga përgjegjësitë që mund t'u dalin prej proceseve gjyqësore.

Po mendoj që këtë problematikë kemi mundësi tani ta drejtojmë edhe te guvernatori i ri, ku unë kam besim shumë që do të ketë një monitorim shumë më shumë të përgjegjshëm.

Të gjithë punëtorët në sektorin privat që sot punojnë në Kosovë, në fabrika dhe kudo që janë të angazhuar, për të siguruar një mirëqenie për familjet e tyre, kanë nevojë për kujdesin tonë si deputetë. Kanë nevojë për mbrojtjen e sigurinë e këtij shteti, pra në këtë drejtim sigurisht që nuk do ta kursejmë asnjë zyrtar, asnjë ministër, qoftë edhe ministrat e partisë sime dhe të gjithë ministrat, edhe zyrtarë të tjerë, të cilët nuk do të jenë në krye të obligimeve në raport me mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve.

Më lejoni të theksoj që tani ne si deputete shpeshherë po marrim edhe ankesa nga gratë që i kemi në sektorë publikë, që kanë pozita të rëndësishme, e të cilat nuk trajtohen njëjtë si burrat zyrtarë në organizata, pra po flas për sektorin publik, se këta shefa nuk sillen si eprorë, mirëpo marrin një rol, rol të bosëve.

Dhe jemi duke marrë shënime për këta njerëz. Unë ju garantoj tash si deputete, bashkë me koleget e mia që nëse pas ditës së sodit, pas rezolutës, nuk do të ndryshohen rrethanat, sigurisht që ne do të dalim me emrat e tyre edhe këtu në Kuvend.

Të theksoj edhe një kategori tjetër, ka të bëjë për gazetarët.

Në vendin tonë, ku ende nuk kemi një ligj të mirëfilltë për media, kemi me qindra gazetarë që punojnë në portale të ndryshme, të cilat nuk janë as të regjistruara, që punojnë nga tre muaj e s'kanë paga dhe nuk ka kush i monitoron, sepse Komisioni i Pavarur për Media nuk është i autorizuar për këtë çështje, Inspektorati i Punës nuk ka qysh e monitoron kur nuk janë të regjistruara.

Pra, pas diskutimeve do ta përfshijmë edhe këtë, shpresoj me mirëkuptim me kolegë.

Më lejoni të theksoj që ne si grup parlamentar, pra jo veç sot, do të kontribuojmë çdo herë, kushdo qoftë që merr iniciativë, edhe pse qëndrojnë në mazhorancë, kjo nuk është justifikimi që ne nuk shohim drejt, kur është një çështje që nuk shkon mirë, do të themi dhe do të punojmë që ajo të përmirësohet.

Për çështjen e papunësisë kolegët e mi do të më plotësojnë në vazhdim me fjalime.

Unë ju falënderoj për vëmendjen dhe do të vazhdojmë të marrim pjesë në përpilimin e rezolutës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e ka Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, deputetja Fatmire Mulhaxha-Kollçaku.

FATMIRE MULLHAXHA-KOLLÇAKU: Faleminderit!

Të jetosh në një shtet ku kemi një papunësi kaq të lartë, në një shtet që është larg anëtarësimit në Bashkësinë Evropianë, a nënkupton kjo që ne nuk duhet të brengosemi për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Në fakt, është krijuar një bindje që mjafton të kemi mundësi që diku të punësohemi, nuk do të thotë që të jetë adekuat me kualifikime që i kemi, por vetëm ta sigurojmë një punë, ku as paga minimale nuk është e sigurt, ku kushtet e punës mungojnë dhe që të kënaqemi, sepse radha për punë është aq e madhe sa që ne nuk kemi guxim ta ngremë asnjë çështje, se mund ta rrezikojë atë punë që e kemi siguruar.

Unë do të fokusohem në sigurinë dhe shëndetin në punë.

Disa ditë më herë patëm rastin e një aksidenti në punë, me fatalitet, ku një i ri, i cili kishte diplomë universitare nuk arriti të punësohet adekuat përgatitjes së vet profesionale dhe përfundoi si punëtor në ndërtimtari, ku edhe në bazë të fjalëve të familjarëve të tij, ai nuk kishte kurrfarë sigurie në atë vend punës, nuk ishte as i lidhur në momentin e aksidentit dhe kishte rënë nga kati i tretë i atij objekti dhe mund të themi se një aksident, për të cilin askush nuk do të japë përgjegjësi.

Pse nuk do të japë përgjegjësi? Sepse ne fillimisht nuk e kemi krijuar një besueshmëri të lartë në raport me Inspektoratin e Punës, nuk kemi numër të mjaftueshëm të inspektorëve të punës, të cilët kryesisht përfundojnë duke i gjobitur bizneset. Mirëpo fillimisht duhet ta kryejnë punën e vet, për të cilën janë të thirrur që është edhe këshillimi dhe informimi i subjekteve afariste, të cilët punësojnë njerëz, po nuk i respektojnë parakushtet që janë për të parandaluar aksidentet dhe vdekjet në punë.

Të mos flasim për sëmundjet profesionale që është shumë vështirë të evidentohen dhe të kemi një numër të saktë të sëmundjeve profesionale, sepse ato kryesisht mund të paraqiten pas disa vjetëve në atë punë dhe është vështirë të përcillen.

Çfarë bënë një subjekt, i cili sot, për shembull, ka veprimtari me rrezik të lartë, siç janë, për shembull, subjektet që merren me ndërtimtari.

A hartojnë ato një udhëzues, një dokument udhëzuar, për të punësuarit e tyre, ku paraqiten të gjitha rreziqet, me të cilat mund të ballafaqohet një punëtor, i cili nuk është në shumtën e rasteve i kualifikuar për punën që e bën, sepse e dimë që tashmë shumë punëtorë janë të detyruar të kryejnë punë, për të cilët nuk kanë përgatitje adekuate profesionale, siç e cekta edhe në rastin ku një person me diplomë universitare për mësimdhënie është detyruar të punojë në ndërtimtari dhe

rrjedhimisht nuk i ka informatat bazike për rreziqet me të cilat do të ballafaqohet në punën që e kryen.

Do të thotë obligimi i një subjekti për të hartuar dokumentin e vlerësimit të rrezikut, sa kompani e kanë hartuar një dokument të tillë, ku paraprakisht informojnë punëtorin për të gjitha masat parandaluese që i kanë ndërmarrë për të siguruar integritetin fizik dhe mendor, për t'ia siguruar shëndetin atij punëtori, të mos themi, për t'ia siguruar jetën. Deri tani kemi gjashtë raste me fatalitet vetëm për këtë viti, vitin e kaluar kemi pasur 11 raste të vdekjes në punë, mbi 33 lëndime vetëm që janë raportuar, se të jemi të sigurt që nuk raportohen të gjitha rastet e lëndimeve në punë, ndërsa këto me fatalitet kryesisht raportohen nga mediat, të cilat marrin informatën dhe pastaj bëhet e madhe.

Ndërsa çka po ndodh me ato kompani ku kemi raste të përsëritura? A po ndalohet veprimtaria e këtyre kompanive, ku kemi raste të përsëritura të lëndimeve në punë apo rasteve të vdekjeve.

Duhet të rritet besueshmëria në mes të Inspektoratit dhe kompanive dhe punëmarrësve, është një trekëndësh shumë i rëndësishëm në këtë rast, ku në qoftë se Inspektorati do ta kryejë punën si duhet, ku do të kemi një dialog social, ku do të veprojnë Këshilli Ekonomik-Social, ku do të zbatohet Kontrata kolektive edhe në sektorë publikë, të mos harrojmë se kryesisht flitet për sektorin privat, ku kemi punësim informal, nuk ka sigurim shëndetësor për punëtorë, po kjo nuk ka sigurim shëndetësor për krejt popullatën dhe është vështirë dihet se disa kompani ua bëjnë sigurimin punëtorëve të vet, po janë numerikisht shumë pak.

Prandaj, në qoftë se krejt popullata nuk ka sigurim shëndetësor, mund ta dimë se si është fati i një punëtori, i cili lëndohet në punë, i cili ka pasoja apo sëmundje profesionale dhe të mos flasim çfarë ndodh me një familje pas përfundimit me fatalitet të një familjari të tyre, i cili pas një aksidenti në punë ka vdekur.

Obligimi ligjor i të gjitha kompanive të zbatojnë dispozitat e ligjit aktual për sigurinë dhe shëndetin në punë, ku mund të themi se përqindjen më të madhe nuk zbatohen dispozitat, nuk respektohen dispozitat e këtij ligji.

Dhe ne ftojmë Inspektoratin që përveç gjobave, të cilat edhe ashtu nuk vendosen gjithnjë në raste të tilla, fillimisht të bëhet kontakti me të gjitha kompanitë që veprojnë dhe kanë veprimtari me risk të lartë, sepse nuk trajtohen të gjitha kompanitë në këtë rast njëjtë. Ndryshe duhet të trajtohet një kompani që ka veprimtari me rrezik të lartë dhe ku kemi pasur raste të përsëritura të aksidenteve, ndërsa nuk janë marrë masa adekuate dhe këto kompani operojnë të papenguara, pa dhënë përgjegjësi para ligjit dhe kryesisht fati i personave të lënduar mbetet pa i adresuar dhe ata mbeten me invaliditet. Të mos harrojmë se personat që lëndohen në punë, një pjesë e madhe e

tyre pastaj e ka një përqindje të invaliditetit dhe ky problem duhet të trajtohet. Edhe ky problem mund të themi mbetet jetim.

Sa i përket të drejtave në punë, në momentin kur punëtori punon pa një kontratë, ne mund ta dimë se ai nuk ka përshkrim të punës, obligohet të kryejë edhe punë të tjera, për të cilat ai nuk është i thirrur, dhe në atë moment rritet edhe rrezikshmëria, meqenëse ai, përveç punës për të cilën është pranuar, shpesh detyrohet nga punëdhënësi që të kryejë edhe punë të tjera, për të cilat jo vetëm se nuk ka përgatitje profesionale, por nuk ka as kondicion fizik që t'i kryejë ato dhe rrjedhimisht është shumë më i rrezikuar për një lëndim potencial. Do të thotë, kërkesa ime, përveç asaj që edhe kompanitë e mëdha nuk kanë as mjekë, përpara kanë qenë të obliguar ta kenë një mjek që ka qenë me një specializim të mjekësisë së punës, sot kryesisht nuk kanë mbrojtje shëndetësore, d.m.th. nuk është e adresuar fare siguria dhe shëndeti, që është parakusht për çdo kompani që licencohet dhe vepron në çdo shtet, atëherë edhe ne do të detyrohemi, edhe pse po rikthehem edhe një herë asaj siç thashë, e fakti që e kemi një papunësi aq të lartë dhe që nuk jemi as afër anëtarësimit në Bashkësinë Evropiane, ku kërkohen standarde të caktuara të mbrojtjes dhe sigurisë të shëndetit në punë, nënkupton që ne në shkëmbim të një vendi të punës duhet pajtohemi që të punojmë pa kurrfarë sigurie, por vetëm të kënaqemi, të punojmë pa kontratë të punës dhe të heshtim për ta ruajtur atë vend të punës.

Këtu sidomos bëhet fjalë për grupet e rrezikuara, për fëmijët nën moshën 18-vjeçare, për gratë shtatzëna dhe për personat me aftësi të kufizuar që nuk u respektohet e drejta, kur çdo kompani që ka mbi 50 të punësuar është e obliguar që ta punësojë një person me nevoja të veçanta, e kjo nuk po respektohet. Do të thotë, për kategoritë e rrezikuara nuk bëhet fare fjalë, kur edhe tërë popullata faktikisht punon në kushte ku nuk ka siguri në punë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Para se të vazhdojmë me përfaqësuesit ose kryetarët e grupeve tjera parlamentare, deputeti Glauk Konjufca e ka kërkuar fjalën për replikë, ose për një sqarim.

GLAUK KONJUFCA: Jo, vetëm sqarim, se me të vërtetë u desh para Fatmires ta e marr fjalën ndërsa, por m'i mori disa minuta për ta verifikuar problemin, të cilën e ngrehu Xhevahirja me plot të drejtë. Por, pasi e verifikova, ajo është e saktë, domethënë kjo rezolutë është në fuqi, nuk është miratuar më 19 prill at ditë kur e diskutuam, por qenka miratuar 2 javë prapa. Mirëpo, është dokument zyrtar i Kuvendit të Kosovës, unë hyra dhe e nxora. Domethënë, është me ato që i ka propozuar si rekomandime dhe është votuar në Kuvendin e Kosovës, por nuk ka problem nëse bëhet le të themi edhe një tjetër rezolutë dhe ato rekomandime, të cilat natyrisht që Qeveria duhet t'i zbatojë, t'i shtohen edhe disa të tjera, të cilat do t'i propozojë tash Lëvizja Vetëvendosje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate, deputeti Faton Topalli. Urdhëro!

FATON TOPALLI: I nderuar kryesues!

Të nderuara deputete dhe deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kuvendi i Kosovës ka debatuar për herë të fundit për shkeljen e të drejtave të punëtorëve më 19 prill 2017, me kërkesën e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

Më 3 maj të vitit të kaluar, me mbështetjen e Lëvizjes Vetëvendosje dhe partive tjera opozitare janë aprovuar në Kuvendin e Kosovës 9 rekomandime, për të cilat dihet se asnjëra prej tyre nuk është implementuar. Edhe më herët, por edhe pas debatit të datës 19 prill 2017, janë shtruar pyetje parlamentare dhe janë shprehur opinione për shkelje të rënda në tregun e punës. Megjithatë, deri më tani nuk ka pasur asnjë ndryshim. Duke pasur parasysh kulturën e debateve dhe të formulimit të rekomandimeve, jam shumë skeptik që ky debat i sotëm do të sjellë ndonjë ndryshim për gjendjen e krijuar në tregun e punës së Kosovës. Unë sot dua qëllimisht të flas pak për të drejtat e punëtorëve, sepse për to para pak ditësh kam folur në një deklaram jashtë rendit të ditës. Thelbi është ky, sektori privat vazhdon të mbetet shkelësi kryesor i të drejtave të punëmarrësve. Ky sektor është bartës i zhvillimit ekonomik, kontribuuesi kryesor për mirëqenien sociale që e kemi sot në Kosovë dhe kontribuuesi kryesor i zhvillimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të reja të punës.

Megjithatë, sektori privat, përkundër kontributit të madh ekonomik, nuk duhet të jetë një sektor jashtë sundimit të ligjit. 288 orë në muaj, në vend të 160 orëve, sa parasheh ligji, ky nuk është pra përjashtim, ky orar është rregull në sektorin privat. Secili punëtorë që punon sipas modelit 12-orësh në ditë i jep punëdhënësit 128 orë në muaj pa pagesë. Nëse punëtori me rrogë minimale prej 170 eurosh në muaj, punon në këtë orar, ai fiton 59 centë në orë. Nëse nga rroga vjetore heqim paratë që nuk paguhen për punën gjatë vikendeve, orëve të natës, ditëve të festave dhe moskompensimi i pushimit vjetor, atëherë fitimi në orë është më shumë se 40 dhe më pak se 50 centë në orë. Pra, një orë pune për gjysmë litri qumësht apo për 800gr. bukë. A është kjo e drejtë dhe humane, le ta mendojë secili për vetveten. Kur kësaj ia shton edhe masat e pamjaftueshme të sigurisë në punë, nganjëherë i bie që për gjysmë litri qumësht të humbësh jetën. Kështu ndodhi së paku në 90 raste pas luftës.

Sidoqoftë, nuk i kemi kontribuar aspak këtij debati, nëse sot flasim vetëm për shkeljen e të drejtave të punëtorëve. Para një viti folëm të gjithë për shkelje, të gjithë u pajtuam se shfrytëzimi i punëtorëve dhe keqtrajtimi i tyre janë rast i paprecedent në Evropë. Ashtu siç të gjithë u pajtuam, përfshirë këtu edhe iniciuesin e debatit të sotëm, Lëvizjen Vetëvendosje, se shkelja e të drejtave të garantuara me ligj janë rregull dhe jo përjashtim, ashtu u pajtuam të gjithë edhe për rekomandimet e Kuvendit, të cilat nuk sollën asnjë ndryshim. Pyetja e sotme për diskutim nuk është se cilat të drejta të punëtorëve po shkelen, sepse këtë e dinë të gjithë qytetarët, por pse nuk po respektohen vendimet e Kuvendit nga institucionet dhe çfarë duhet të ndërmarrim si Kuvend, si organi më i lartë legjislativ, që propozimet dhe vendimet që i marrim të implementohen?

Konstatimi im i parë është që debati parlamentar, përfshirë këtu edhe këtë debat, pra po përdoret kryesisht për t'i sensibilizuar të goditurit së një partie, cilado qoftë ajo, po interesohet për të drejtat dhe interesat e tyre. Pra, debati në thelb i shërben partisë dhe jo qëllimit për të cilin është thirrur. Ky konstatim vjen nga analiza e rekomandimeve që sillen në debate, të cilat në shumicën e rasteve janë të përgjithshme, pa adresues të përcaktuar qartë, pa afate kohore dhe pa qëllime reale dhe të implementueshme. Unë i kam shikuar me shumë kujdes rekomandimet e datës 3 maj 2017. Sa për ilustrim, dua të marr për shembull rekomandimin numër 1, i cili thotë "Obligohet Inspektorati i Punës që të kryejë inspektime efektive në të gjithë sektorët", pra pa e përcaktuar se çfarë janë inspektimet efektive dhe, e dyta, duke përcaktuar një detyrë të përcaktueshme, sepse kërkon që Inspektorati të kryejë punë në të gjithë sektorët. Njësoj edhe rekomandimi i dytë, "Inspektorati i Punës të bëjë monitorimin e respektimit të të drejtave të punëtorëve në të gjitha ndërmarrjet publike", theksi "në të gjitha, edhe private", dhe të gjitha raportet e inspektimeve dhe masat e shqiptuara t'i publikojë në ueb-faqen e Inspektoratit të Punës.

Pra, nëse kërkojmë monitorim në të gjitha ndërmarrjet private dhe publike, dhe kemi vetëm 53 inspektorë të punës, dhe ky numër i inspektorëve të punës të ishte rritur edhe në 100%, siç kërkohej me rekomandimin numër 8, kjo detyrë do të ishte prapë e përcaktueshme. Pra, si Kuvend jemi treguar joserioz, kemi bërë rekomandime joserioze dhe të përcaktueshme dhe po përsëritemi përsëri një vit më vonë, tani jo me nevojën e Partisë Demokratike të Kosovës, por atë të Lëvizjes Vetëvendosje.

I kam shikuar me shumë kujdes edhe rekomandimet e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje. Mjerisht, nuk ka ndonjë ndryshim në logjikën e rekomandimeve të deritashme në Kuvend. Të gjitha rekomandimet janë të drejta, por të papërcaktuara në afate kohore, ndonjëherë u mungon adresuesi institucional, pra nuk përshkruhet se kush duhet t'i realizojë rekomandimet, kush është përgjegjës për implementim dhe kush konkretisht e monitoron zbatimin dhe kur i raportohet Kuvendit.

Kështu siç janë përpiluar rekomandimet, në thelb dhe në logjikën që ndiqet, nuk dallojnë nga rekomandimet e 3 majit 2017. Pra, e kemi një debat më shumë për të drejtat e punëtorëve, por asnjë hap përpara në drejtim të implementimit të tyre. Për të qenë shumë i sinqertë, pritja ime që një qeveri e djathtë do të merret me mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, e sidomos me një pako të ligjeve është shumë e vogël, edhe pse nuk e përjashtoj si mundësi. Ajo në të cilën jam i sigurt është se deputetët e Kuvendit të Kosovës, në këtë rast të Lëvizjes Vetëvendosje, të Partisë Socialdemokrate, Nismës Socialdemokrate, por edhe ndonjë subjekti tjetër të interesuar mund të bëjnë më pak debate dhe më shumë iniciativa ligjore, ndryshime të neneve të caktuara të ligjeve ekzistuese për të ndërhyrë drejtpërdrejt në sigurimin e normave ligjore, të cilat e zbutin dhe japin fund diskriminimit të punëtorëve, respektivisht sigurojnë zbatimin e ligjit.

Ndryshe, edhe ky debat nuk do të jetë asgjë më shumë se një debat pas një debati. Natyrisht, dhe këtu po i drejtohem zotit Glauk Konjufca, kritika është një sport i lehtë zoti Konjufca, por ndryshimi i ligjeve një maratonë e rëndë, e cila i kalon caqet dhe përkushtimet e një debati parlamentar. Sot kemi dhjetëra e mijëra dosje të pazgjdhura për raste në të cilat është shkelur Ligji aktual i punës. Për shkak të grumbullimit të lëndëve, zgjatjes në pakufi të vendimeve gjyqësore, një masë e shpejtë do të ishte krijimi një i gjykate të punës, e cila do të merrej ekskluzivisht me rastet e shkeljeve të të drejtave të punës. Rritja e numrit të inspektorëve të punës është një masë e domosdoshme, por ajo nuk i zgjedh problemet e shkeljes të drejtave të punëtorëve në situatën në të cilën ndodhemi ne. Sot e kemi një informalitet ndërmjet 30 dhe 40% në ekonomi, pra mijëra punëmarrës ilegalë që nuk janë të regjistruar askund, që nuk kanë asnjë të drejtë, që nuk janë siguruar, por edhe që nuk i paguajnë taksat shtetit. Me punën ilegale në shumë vende të Bashkimit Evropian, edhe në Zvicër, merret edhe policia. Ne kemi 9 mijë policë të Kosovës, të cilët për mendimin tim do të mund të merreshin fare lehtë me një pjesë të punës që ka të bëjë me luftimin e informalitetit në ekonomi dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve.

Pra, nëse dëshirojmë t'i mbrojmë të drejtat e punëtorëve duhen veprime konkrete, veprime të cilat ne si parti jemi të gatshëm t'i bëjmë dhe t'i mbështetim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për replikë, fjalën e ka kërkuar deputeti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Po, është shumë lehtë ta shpjegoj sulmin e Fatonit se qysh të them, kur del prej Vetëvendosjes më problem duket Vetëvendosja se Qeveria. Domethënë, ky është ligji kryesor, kush ka dalë prej Vetëvendosjes më problem i është dukur Vetëvendosja se kjo Qeveri, e cila i ka ato përgjegjësi për t'i mbrojtur punëtorët, e jo Vetëvendosja. Vetëvendosja i ka propozimet për t'i bërë dhe aq sa mundet ato propozime t'i shtyjë, aq sa ka vota e fuqi në Parlament dhe qysh i dimë ne sesi shkojnë rregullat e demokracisë.

Por, për mendimin tim, te pesë propozimet tona që i kemi në rezolutë, dy janë esenciale dhe Fatoni mund t'i mbyllë sytë edhe veshët, qysh të dojë ai, por këto janë esenciale dhe pa ato s'bën. Është e para Kontrata Kolektive, dhe është paga minimale. Si të mos e kesh Kontratën Kolektive të zbatueshme, e cila e mbron punëtorin deri në fund, dhe si të mos e kesh pagën minimale të dinjitetshme, pa të cilën ai nuk mund të jetojë, këto tjerat janë pallavra. E, unë e kuptoj që Fatonit dhe shokëve të tij e vetmja që u ka mbetur është të krijojnë njëfarë dallimi artificial me Vetëvendosjen, që kjo të jetë temë elektorale, por mua tash për këtë moment nuk po më duket aktuale. Ajo vjen më vonë.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, deputeti Faton Topalli!

FATON TOPALLI: Jo, në fakt nuk është kundër-replikë, sepse si duket zotit Konjufca po i intereson më shumë të merret me PSD-në sesa me PDK-në, të cilën e ka kritikuar përpara shumë

herë, por kritika ime në fakt nuk ishte për Lëvizjen Vetëvendosje, përkundrazi ishte mbështetje për Lëvizjen Vetëvendosje në rekomandimet që ka bërë, duke kërkuar që të saktësohen me data, me afate kohore, në mënyrë që rezoluta të jetë obligative për Qeverinë. Pra, në mënyrë që, jo të flasim për të drejtat e punëtorëve e të bëjmë debate të njëpasnjëshme, por thjesht të arrijmë që si Kuvend t'i përcaktojmë normat e duhura që këto të drejta të punëtorëve pastaj të realizohen.

Unë e di që Lëvizja Vetëvendosje, respektivisht disa përfaqësues të saj më me qejf merren me neve në Facebook sesa në Kuvendin e Kosovës, por mendoj që këtu është vendi ku ne duhet të debatojmë për dallimet politike, dhe jo ashtu siç keni organizuar dhjetëra e qindra aktivistë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën ia jap deputetes Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Në fakt, debati është i një rëndësie të veçantë, sepse po flitet për të drejtat e punëtorëve dhe adresimin e papunësisë në Kosovë, që vërtet unë mendoj që është shqetësues për të gjithë deputetët, por edhe për shoqërinë, në përgjithësi. Mirëpo, ne e kemi një rezolutë në fuqi, një rezolutë në të cilën Qeveria ka të drejtë dhe është obligative për zbatim të asaj rezolute.

I treti mandat që unë kam qenë edhe anëtare e Grupit të Komisionit për Punë dhe Mirëqenie Sociale, dhe njëkohësisht ne si komision parlamentar e kemi bërë monitorimin e Ligjit të punës, Ligjit të Inspektoratit Shëndetësor, pra kemi bërë edhe monitorimin e Ligjit të Këshillit Ekonomiko-Social, që gati ngjashëm me këto rezoluta kanë dalë rekomandimet në bazë të konstatimeve dhe punës që e kemi bërë edhe në terren, por edhe punës që e kemi bërë duke filluar prej nivelit qendror në nivelin lokal, vizitat në institucionet publike, në institucionet private dhe në fakt kemi parë se sa po zbatohen këto ligje në tërësi. Dhe një prej rekomandimeve për Ligjin e punës, duke parë që ka shkelje të drejtave të punëtorëve, ka qenë edhe kërkesë e Komisionit Parlamentar që është votuar në këtë Kuvend, që Ligji i punës të sillet për plotësim-ndryshim.

Për shembull i kemi problemet e identifikuar në Inspektoratin e Punës. Ka qenë numri shumë i vogël i inspektorëve të punës, disa komuna nuk kanë fare inspektorë të punës, mungesa e kushteve të punës, zyrat, makinat, pajisjet teknike edhe nuk u është paguar rrezikshmëria në punë. Domethënë, ne i kemi ngrehur këto shqetësime dhe Qeveria vërtetë ka qenë obligative në zbatimin e të gjitha këtyre rekomandimeve. Këto ishin disa të gjetura në monitorimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës. Ndërsa, rekomandimet që kanë dalë nga Komisioni Parlamentar për Punë dhe Mirëqenie Sociale, për monitorimin e Ligjit të punës, kanë qenë konkrete.

Qeveria e Kosovës është dashur ta plotësojë dhe ndryshojë Ligjin e punës në çështjet, si vijon: të përcaktohet afati minimal për kontrata, qartësimi i dispozitave ligjore për punën gjatë festave, përcaktimi me ligj i lidhjes së kontratave për punën praktike dhe vullnetare, përcaktimi me ligj i klasifikimit të rrogës minimale për profesione dhe lloje të ndryshme të punës.

Në planifikimet buxhetore është paraparë dhe i është rekomanduar Qeverisë që të parashihet rritja e buxhetit në favor të zbatimit të Ligjit të punës. Ka qenë kërkesë që Ministria të ndërtojë kapacitete për informim të punëdhënësve dhe punëmarrësve në lidhje me Ligjin e punës. Po ashtu, është kërkuar që të thjeshtohen procedurat për aplikimin për tremujorin e tretë të pushimit të lehonisë, sepse në gjatë monitorimit të Ligjit të punës, që po ashtu është një shkelje e të drejtave të punëtorëve, kemi hasur që pushimi i lehonisë respektohet në institucionet publike, por nuk respektohet në institucionet private. Dhe, është kërkuar nga gjykata që lëndët që janë dhe që lidhen me Ligjin e punës të kenë prioritet dhe të trajtohen me prioritet.

Desha t'i referohem tash sa i përket papunësisë, një raporti - prirjet e tregut të punës në Ballkanin Perëndimor 2018, që është bërë publik nga Banka Botërore dhe Institutit për Studime ekonomike Ndërkombëtare në Vjenë. Dhe, më ka ardhur mirë, që sipas këtij raporti, Kosova këtë vit është cilësuar si vendi që më së shumti ka punësime në rajon, jo veç në Kosovë. Vendi kryesues në rajon sa i përket punësimit është Kosova, që ka një rritje prej 9,2%, ndjekur nga Serbia, Mali i Zi, Shqipëria, Maqedonia dhe Bosnjë-Hercegovina. Rritja e punësimit për 3,9% gjatë vitit të fundit ka sjellë hapjen e 231 000 vendeve të reja të punës në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor. Këto, sipas raportit, janë prirjet e tregut të punës që e thashë më lart.

Shkalla e papunësisë ka pësuar gjithashtu rënie nga 18,6% në 16,2%, duke arritur nivele të ulëta historike në disa vende. Vendi kryesues në rajon sa i përket punësimit, thashë është radhitur Kosova. Me gjithë progresin e bërë, shkalla e ulët e veprimtarisë, sidomos ndër gra dhe të rinj, kombinuar me shkallën e lartë të papunësisë afatgjate dhe mbizotërimin e punësimit informal, vijon të paraqet sfida për rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike në rajon. Papunësia e të rinjve në nivelin e 37,6% është një sfidë themelore për rajonin.

Dhe, në fund, ne si grup parlamentar do të konsultohemi edhe me grupet e tjera nëse është e nevojshme ose ta japë dikush ligjshmërinë, a është e domosdoshme që të bëjmë rezolutë mbi rezolutë, ose të kërkojmë që të zbatohet rezoluta paraprake, që e obligon Qeverinë për zbatimin e të gjitha atyre rekomandime, e po ashtu e kemi monitorimin e Ligjit të punës, monitorimin e Ligjit të Inspektoratit Shëndetësor dhe Këshillit Ekonomiko-Social, që dalin me rekomandime të qarta, që e obligojnë Qeverinë po ashtu për implementim, apo ndoshta të votohet edhe një rezolutë të re dhe të bëhet një rezolutë, meqë është në fuqi prapë një rezolutë tjetër. Thjesht, nuk e di se qysh është ligjshmëria në këto raste. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e ka përfaqësuesi i Listës serbe, por unë s' shoh asnjë përfaqësues të këtij grupi parlamentar në sallë. Nga Grupi Parlamentar Nisma, deputeti Enver Hoti.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Në fillim dua ta përshëndes iniciativën e Vetëvendosjes për ta debatuar për çështjen e shkeljes të të drejtave të punëtorëve dhe gjendjen në përgjithësi të punëtorëve në Kosovë.

Kjo është një iniciativë e mirë shumë dhe është dashur të ndodhë, por edhe ky debat ose kjo nismë siç është marrë kështu përcillet me disa defekte, të cilat ne duhet t'i trajtojmë. Por, fillimisht do të flasim për gjendjen e të drejtave të punëtorëve në vend.

Siguria në punë dhe të drejtat e punëtorëve, sidomos në sektorin privat, shkelen në mënyrë të vazhdueshme, të pandalshme dhe të përditshme dhe në aspekt të shumëfishtë, shumëdimensional, do të thosha. U tha edhe nga parafolësit që nga kontratat, nëse punëtorët kanë kontrata, të cilët punojnë edhe ofrojnë shërbime të ndryshme, qoftë në kompani shërbyese, qoftë në sektorin e industrisë së ndërtimit, shkelen në vazhdimësi që nga stërzgjatja e afatit, nga siguria në punë, nga shkelja e të drejtave të tyre, qoftë në të drejtën e pushimit javor apo vjetor, edhe gjatë festave, dhe deri te ato maltretimet psikike, të cilat mund të quhen për shkak të gjendjes së tyre të rëndë familjare dhe në aspektin social.

Të gjitha këto shihen si moszbatim i ligjeve në fuqi dhe për këtë nuk duhet asnjë konstatim tjetër dhe mendoj që nuk duhet të elaborohen më tutje. Janë më se 8 ligje, të cilat i adresojnë në mënyrë të qartë të drejtat e punëtorëve, por ato ligje nuk po zbatohen dhe mendoj që këtu duhet ta vëmë theksin se çka po ndodh me ligjet e aplikueshme. Nuk mendojmë se ka nevojë që ne të shkojmë në vazhdimësi duke sjellë rezoluta, apo duke tentuar të krijojmë edhe task-forca të ndryshme, të cilat prapë do ta vazhdonin agoninë edhe më tutje dhe do të vazhdonin vetëm burokratizimin e këtyre çështjeve, dhe nuk do të adresohen çështjet. Ne duhet të kërkojmë pse nuk po implementohen ligjet? Pse nuk po zbatohet ligji në punë? Masat e sigurisë, të cilat janë ligjore, dhe ato nuk po zbatohen.

Sa u përket çështjeve tjera të te rezoluta që e ka propozuar Lëvizja Vetëvendosje, unë mendoj që kjo rezolutë do të ishte dashur të trajtohet, pse jo? Por, nuk e di si e tillë a mund të kalojë dhe kemi dilema për ta mbështetur. Për shembull, në pikën e parë kërkohet që të procedohet Ligji për... Ligji është në procedim, e di edhe përfaqësuesi i Lëvizjes Vetëvendosje që është në komisionin tonë për Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Ka disa pika të tjera, që nuk do të ndalesha shumë, por mendoj se kjo si rezolutë duhet të harmonizohet, ose të ndryshohet rrënjësisht, e që do ta ndryshonte edhe përmbajtjen, edhe formën çfarë e ka shtruar këtu. Kjo si çështje e tillë, me keqardhje, edhe pse tema është shumë

serioze, mua personalisht më lë ta kuptoj si një rezolutë me përmbajtje elektorale, por jo që ka për qëllim në vetvete masat që cilat janë parashtruar si rezolutë për mbrojtjen e të drejtave të punëtorit, ose për barazi në punë, që nuk shkon drejt atij qëllimi. Ne do të dëshironim, siç u theksua edhe më herët, nga vazhdimësia institucionale. Po, Kosova dhe institucionet e saj në formë kronologjike vuajnë nga mosvazhdimësia e institucionit me institucion, ose bartësve të institucionit nga ata që kanë qenë më herët dhe nga ata që i marrin.

Unë dëshiroj dhe kërkoj mirëkuptimin edhe të parashtruesit të këtij debati, që ndoshta do të ishte dashur të konsultohemi më gjerësisht, sepse ministri për Punë dhe Mirëqenie Sociale, zoti Reçica, gjendet në një udhëtim zyrtar në Maltë dhe do të kishte qenë mirë që ai të ishte këtu dhe t'i jepte edhe statistikën, qoftë edhe për këtë pikë që e kanë kërkuar këtu, që të kërkojnë sqarime rreth projektit "Një anëtar i punësimit - një familje", siç është këtu. Por, ky është një projekt afatgjatë, i cili nuk mund të arrihet në një kohë kaq të shkurtër e të sillen raportimet e tilla, por sigurisht se kur ministri të jetë këtu do ta sqarojë edhe më tutje gjithë masën e aktiviteteve që ka ndërmarrë për masat që nga koha që e ka pranuar detyrën si ministër, qoftë në mbrojtjen dhe sigurinë e punëtorëve, qoftë në avancimin e punësimit të atyre familjeve që nuk kanë të punësuar.

Unë do të doja që sigurisht të ishim konsultuar më herët dhe që ministri të ishte i pranishëm. Sigurisht se do të ishte pjesë e debatit, i cili do t'i ndihmonte jashtëzakonisht shumë këtij debati, që është aq i nevojshëm dhe të cilin e mirëpret edhe opinioni publik, por jo që tani të shfrytëzojmë dhe të bëjmë gara elektorale sa për ta tejkaluar një debat. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar "6+", po ashtu s'e ka asnjë përfaqësues në sallë, kështu që kalojmë te radha e deputetëve sipas paraqitjes. Fjalën e ka deputeti Lumir Abdixhiku.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë besoj se debati i sotëm me siguri është një ndër temat më të rëndësishme që mund t'i trajtojmë në legjislaturën e tanishme. Ndoshta nuk duhet t'i trajtojmë bashkë papunësinë dhe punësimin, por sipas matjeve më kredibile vendore e ndërkombëtare, të drejtat e punëtorëve, pra njerëzve që punojnë në Kosovë, respektivisht respektimi i Ligjit të punës në sektorin privat përbën një ndër fushat më me interes për qytetarët tanë. Pra, jemi duke folur për një prej temave më me interes për qytetarët tanë, përfshirë edhe lëvizjen e lirë.

Vetëm në pesë muajt e parë të këtij viti kujtoj se gjashtë punëtorë e kanë humbur jetën në vendpunishte. I fundit ishte rasti i Valon Berishës, një djalë 30-vjeçar, baba i dy fëmijëve, i diplomuar në Fakultetin e Edukimit Fizik, por që ishte detyruar të gjente punë jashtë profesionit të tij, në ndërtimtari. Mjafton të bëhet një shëtitje e thjeshtë nëpër vendpunishtet e ndërtimtarisë për ta kuptuar pasigurinë ekstreme që ato kanë. Rastet e tilla të humbjes së jetëve të dërrmojnë

dhe në të njëjtën kohë bëjnë thirrje që në rolin tonë politik që kemi të marrim masa dhe unë besoj që ne e kemi në dorë marrjen e masave dhe zgjidhjen e këtij problemi për më pak se një vit.

Më duhet të them se siguria për jetë s'është e vetmja brengë. Sot pjesa më e madhe e punëtorëve në sektorin privat punojnë nga shtatë ditë në javë, me mbi dhjetë orë në ditë, pa pagesa shtesë, pa kushte bazë, pa siguri për jetë dhe në fund e marrin një pagë që mezi ua siguron mbijetesën. Tash ky relacion është problematik më vete, edhe në aspektin human, edhe nga aspekti social, por mbi të gjitha nga ai ekonomik, sepse kushte të tilla s'janë të drejta as nga prizmi i njerëzores, as efiçiente dhe nga prizmi i produktivitetit.

Sa për krahasim, në Kosovë janë 90 000 punëtorë në sektorin publik, por janë edhe 300 000 tjerë në sektorin privat, formal dhe joformal, pra janë trefish më shumë. Duhet thënë se gjatë gjithë kohës së institucioneve të kohës, pjesa më e madhe e Legjislativit, që e ka rregulluar këtë fushë, e ka presupozuar si të mirëqenë implementimin e ligjeve në sektorin privat. Pjesa më e madhe e ligjeve kanë supozuar, me ose pa dije, kjo pak ka rëndësi, se implementimi i tyre do të ndodhë me automatizëm në sektorin privat. Në fakt, praktika ka treguar se pjesa më e madhe e ligjeve që ky institucion i ka nxjerrë kanë qenë të paimplementueshme, as ai i të drejtave të punës, as ai pagës minimale, as i pagesës së pensioneve, e kjo do të na vijë si problem 20-30 vjet prej sot, kur këta njerëz do ta mbërrijnë moshën e pleqërisë, do të jenë barrë të mbahen prej shoqërisë, sepse s'paguajnë pensione, as i festave zyrtare, as i pagesës mbi normë hiç se hiç, e as i pushimit të lindjes të gratë.

Asnjëri prej këtyre ligjeve nuk ka gjetur aplikim në sektorin privat dhe të tillat janë injoruar dhe ligjet, kolegë deputetë, rëndom injorohen në shoqëri e vende ku nuk ka mekanizma të diferencës, pra kur s'ka forcë të shtetit. Ligji nuk implementohet prej vullnetit të mirë, por prej obligimit të fortë.

Unë dua të propozoj një zgjidhje dhe këtë zgjidhje nuk do ta bëj mbi premisa populliste, as të majta, as të djathta. Unë tash sa për korrektësi besoj që ligjërimet e majta bëjnë punë si moralizime të mira, por në aspektin teorik-ekonomik dështojnë. Besoj se supresimi i sektorit privat, pra shtrydhja e sektorit privat, përtej kapaciteteve të tij s'prodhon rezultat dhe jo pak herë institucionet e Kosovës e kanë bërë këtë shtrydhje. Por, ja që për rastin në fjalë, për relacionet e biznesit privat me punëtorë, korniza ligjore, për mendimin tim të djathtë, është e drejtë. Pra, ligjet janë modeste, janë të përballueshme dhe si të tilla meritojnë respektim të plotë. Pra, nuk po flasim për kornizën rregullore që e rregullon sektorin privat. Në letër çështjet i kemi në rregull shumë, por në thelb të respektimit të plotë, unë e shoh dështimin e shtetit për t'i implementuar mekanizmat. Pra, nuk po e shoh, Glauk, rekomandim-kontratën kolektive, as rritjen e pagës minimale. Prapë do të mbeten në letër.

Unë po e shoh hapin e kalimit të këtyre letrave në implementim, edhe këto që i kemi tani. Tash paramendoni, Kosova sot, ministrin nuk e kemi këtu, i ka 41 inspektorë të punës. Llogariteni tash, 65 mijë biznese, 400 000 punëtorë formalë e joformalë janë në dorë të 41 njerëzve. 41 njerëz edhe po të ishin 41 supermenë s'mund t'i mbikëqyrin 400 mijë punëtorë.

Në njërën prej pyetjeve parlamentare, që dikush prej kolegëve tanë e kishte drejtuar drejt ministrit, përgjigjja e ministrit kishte qenë që do t'i shtojnë edhe dhjetë të tjerë. Pra, edhe në qoftë se shtohen 10, prapë s'do të ndodhë ndryshimi, dhe unë s'e fajësoj ministrin, sepse i shkreti s'ka para më shumë në buxhetin e ministrisë së tij për të shtuar inspektorë. Kaq para ka!

Por, ja që për të thënë drejt dhe pa dashur ta bëj politike këtë temë, kjo qeveri ka dëshmuar se ka para. Pra, të mos harrojmë, i ka 80 zëvendësministra, e tash ka filluar edhe koordinatorë, a po, shtesë. Pra, ne kemi para se kemi dyfish më tepër zëvendësministra sesa inspektorë të punës. Kemi më shumë para për 80 zëvendësministra që rrinë nëpër zyra, se sa për Inspektoratin e Punës që do të ishte dashur ta sigurojë të drejtën e 300 mijë punëtorëve të punësuar në sektorin privat, brengës kryesore të qytetarëve tanë. Unë sot e shikova një analizë të Organizatës Botërore të Punës, ku krahasoheshin të dhënat për inspektorë, për Inspektoratin e Punës nëpër vende të ndryshme, dhe kishte parametra sesi bëhet përcaktimi i normës së inspektorëve.

Për një vend si Kosova me këta parametra që i ka, me karakteristika ekonomike, sociale e besa edhe informale, sepse informalitetin e kemi më të theksuar, do t'i duheshin një numër prej 400 inspektorëve të punës, pra dhjetëfish më shumë. Dhe, a e dini sa i kushtojnë 400 inspektorë të rinj Kosovës me një pagë 500 euro mesatare? Dy milionë euro në vit. Pra, po flasim për dy milionë euro për ta arritur normën e Inspektoratit të Punës në nivelin e vendeve më të zhvilluara evropiane për punëtorë. A e dini sa para, ne i japim dy milionë nëpër agjenci të ndryshme e institucione të ndryshme dhe nuk i kursejmë për qytetarët tanë. Prandaj, unë propozoj që pjesë të rezolutës, 80 zëvendësministra kushtojnë 3 milionë euro me gjithë ekipet përcjellëse, pra në qoftë se duam t'i rritim kapacitetet tona, hajde të propozojmë që pikë e rishikimit buxhetor të jetë shtimi edhe i 400 inspektorëve të rinj.

Hajde t'i lëshojmë 400 inspektorë të rinj në terren, le t'i inspektojnë këto 65 000 biznese, 400 000 njerëz në punë, në sektorin publik s'ka nevojë, 300 000 të tjerë në sektorin privat, dhe po ju garantoj që për një vit, po qenë të punësuar mirë, po s'qenë politikisht të involvuar, po s'qenë rehatime militante partiake, këto ligje që i kemi, që i kemi miratuar në këtë Parlament do të respektohen. Do të ketë të paktën njerëz që punojnë më së paku 8 orë në ditë e 5 ditë në javë dhe që paguhen për secilën punë shtesë. Kjo punë është e bëshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Pothuajse u bë një vit nga debati parlamentar, të cilin e kemi thirrur bashkë me deputeten Xhevahire Izmaqi dhe me të cilën po ashtu, njëjtë sikur sot, kemi debatuar për shkeljen e të drejtave të punëtorëve në të gjithë sektorët, edhe në atë publik, e me theks të veçantë në shkeljen e të drejtave në sektorin privat.

Kur edhe sot po e debatojmë kërkesën e njëjtë për të drejtat e punëtorëve, janë të freskëta lajmet për vdekjen e punëtorëve në vendet e tyre të punës për shkak të mosrespektimit të Ligjit të punës dhe të Ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë, për shkak të mosrespektimit të atyre rekomandimeve që i kemi votuar si Parlament një vit më parë. Disa prej atyre rekomandimeve për shkak se kemi pasur të bëjmë edhe me shkeljen e të drejtave kolektive për punëtorët e KEDS-it, pothuajse u ka skaduar aktualiteti dhe lënda për të drejtat e tyre ka përfunduar në sirtarët e gjykatave dhe vështirë se do të nxirret nga aty për ta realizuar të drejtën e atyre punëtorëve të KEDS-it, të cilët në mënyrë antikushtetuese janë larguar nga vendet e tyre të punës në mënyrë kolektive.

Sot nuk do të doja që ky debat të vazhdojë tutje pa praninë e ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe të kryeinspektorit, dy personat përgjegjës të cilët do të duhej t'i zbatonin fillimisht ato rekomandime që i kemi votuar si Kuvend më herët dhe pastaj për t'u dhënë detyra të reja nga rekomandimet e debatit që do të dalin nga sot. Ne bëjmë muhabet këtu, flasim për të drejtat e punëtorëve, por ata që duhet t'i ndjekin edhe penalisht ata që i shkelin të drejtat e punëtorëve nuk janë këtu të pranishëm. Ku e di nëse na dëgjojnë fare, ose a do të arrijnë ta kenë ndonjë transkript, apo t'u shkojë ndonjë rezolutë në zyrat e tyre për ta respektuar.

Po, i kemi kërkuar të drejtat e punëtorëve në të gjithë sektorët, edhe publik, edhe privat, sepse ligji thotë ashtu. Ligji i punës nuk i ndan punëtorët në zbatimin e të drejtave vetëm në njërin sektor, privat apo publik. Inspektorët janë të obliguar ta bëjnë monitorimin e shkeljes së të drejtave të punëtorëve në të gjithë sektorët dhe ju e dini fare mirë që kemi shkelje të të drejtave të punëtorëve edhe në sektorin publik, mosrespektimin e të drejtave të tyre, në Trepçë, në KEK, në spitale, aty ku punon klasa jonë elite. Ta zëmë, në emergjencë mjekët nuk paguhën për punën e tyre me rrezikshmëri të lartë, ata paguhën njësoj si një mjek i mjekësisë së përgjithshme, që punon në mjekësi familjare, sikur ai që punon në emergjencë. Njësoj! Sikur mjeku që punon në Infektivë, edhe në Intensivë, sikur ai që bën operacione, njësoj paguhën me atë të mjekësisë familjare, ose ndoshta ndonjë jurist në ndonjë ndërmarrje publike paguhet shumë më mirë dhe e ka orarin e përcaktuar, sesa ata që punojnë në sektorin e shëndetësisë.

Po, kemi kërkuar funksionalizimin e Këshillit Ekonomiko-Social. Pse funksionalizimin e Këshillit Ekonomiko-Social dhe Këshillin për Siguri dhe Mbrojtje në Punë? Nëse duam ta bëjmë përcaktimin e pagës minimale, s'ke sesi ta bësh përcaktimin e pagës minimale, nëse Këshillin

Ekonomiko-Social e ke jofunksional, sepse është pjesë e ligjit, ajo bëhet bashkë me sektorët dhe punëdhënësit dhe me Këshillin Ekonomiko-Social.

Çka ka bërë ministria për një vit pas atyre rekomandimeve? Bash kurrë! As që është marrë me funksionalizimin e këtyre dy këshillave që kanë qenë të domosdoshëm.

Respektimi i Ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë, sikur ta kishim një respektim të normave të përcaktuara për mbrojtje dhe siguri në punë, sigurisht se nuk do t'i kishim këto vdekje të punëtorëve në vendet e tyre të punës. Kur e kemi bërë debatin e kaluar kanë qenë brenda pesë vjetëve të fundit 61 raste të vdekjeve në punë, pa rastet pas, dhe mbi 220 lëndime në punë. Inspektorët e punës sot nuk e kanë në monitorimin e tyre, për të qenë efektivë, një protokoll, nëpërmjet të cilit gjatë monitorimit të tyre do ta përcaktonin se cilat norma duhet t'i përmbushin kompanitë kur rrezikohet jeta drejtpërdrejt dhe cilat pastaj janë ato normat dhe kriteret ku mund të ketë lëndime në punë. Dhe, një monitorim, një inspektor, sikur ta kishte një protokoll të tillë të monitorimit të ndërmarrjeve, sigurisht se do të kishte qenë shumë efektiv dhe efikas në monitorimin e ndërmarrjeve të caktuara. Nuk do të thotë që ndoshta të gjitha 91 000 biznese do të mund t'i kontrollonte, por të jeni të bindur që po që se do të hynte, ta zëmë, në një zonë që është në ndërtim e sipër, ta zëmë në Fushë-Kosovë, ku kanë ndodhur rastet e fundit, të jeni të bindur që tre inspektorë do ta monitoronin Fushë-Kosovën në të gjitha kantieret e ndërtimit dhe të bënin raporte për tri ditë. Për tri ditë do ta kryenin e ta përfundonin dhe të gjithë ata që nuk i respektojnë këto norma t'i dënonin dhe ndëshkonin.

Prandaj, kemi kërkuar për të qenë efektivë dhe efikas, dhe raportet të publikohen në ueb-faqe. Pse në ueb-faqe? Sepse, kemi pasur raste të korrupsionit të inspektorëve. Ata që kanë shkuar për t'i monitoruar ndërmarrjet e caktuara kanë gjetur parregullsi, pastaj kanë hyrë në allishverishe me ndërmarrësit. Kjo është tejet shqetësuese. Ka ndodhur që kryeinspektorët janë marrë me të drejtat e drejtorëve, kush ka pasur të drejtë të zgjidhet drejtor, ose shef, në Kirurgji a Kardiologji. Janë marrë me çështje që s'janë fare domen i tyre, e s'janë marrë me shkelje të të drejtave të punëtorëve në pjesën e sektorit që u takon të merren. Pra, devijim komplet nga aspekti, të cilin ata e kanë në monitorim.

Prandaj, punëtorët kanë mbetur në të gjithë sektorët, duke përfshirë edhe sektorin publik, edhe atë privat, të gjithë sektorët, pa një mbrojtje institucionale nga përgjegjësit. Unë nuk besoj, sigurisht se është e mirë t'i kemi 400 inspektorë, por unë mendoj se edhe gjysma e tyre do të kryenin punë. Do të ishin shumë efektivë edhe efikas dhe do ta kishim mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve. A ia vlen ne për një milion euro t'i lëmë punëtorët e shkretë pa mbrojtje? Pajtohem plotësisht me ato që u thanë edhe nga parafolësit, por ne vërtet duhet të jemi edhe më efikas, edhe më konkretë sa i përket mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve.

Pse i kemi kërkuar raportet dhe raportimin tremujor? Ndryshe nuk kemi menduar, sepse u kërkuam këtu që të ketë afate kohore. Po, kemi vënë afate kohore. E kemi votuar këtu që Inspektorati të vijë dhe të raportojë çdo tre muaj në Komisionin Parlamentar për Punë dhe Mirëqenie Sociale. S'ka ardhur asnjëherë, s'ka asnjë raportim, s'ka asnjë raport të inspektimit të një ndërmarrjeje të caktuar. Unë po i përmend vetëm nja dy në Trepçë, ndërmarrje publike ndër më të mëdhatë, ku rreziku në punë është permanent. Ka shkuar inspektori, ka bërë monitorimin, ka gjetur me dhjetëra shkelje dhe ka me dhjetëra minatorë të lënduar në vendet e tyre të punës, të cilët nuk kanë guxuar as ta raportojnë lëndimin në punë, sepse pastaj do të ketë hakmarrje prej punëdhënësit, edhe pse janë në ndërmarrje publike mund të largohen nga vendet e tyre të punës.

Këto janë probleme, sepse ata i kanë fshehur pastaj ato raporte. Ato kanë mbetur një raport inspektimi i thjeshtë dhe ka mbetur pastaj njëjtë. Paramendojeni kur një gjë e tillë ka ndodhur në ndërmarrje të nivelit qendror, si mund të mbyllet këto raporte pastaj në nivelin apo te sektori privat, në ndërtimtari e te bizneset tjera. Si do të mund të mbylleshin këto raporte, kur nëse shkoni në mëngjes për të blerë bukë e gjeni një punëtor, e kur shkoni në mbrëmje për të marrë edhe ndonjë gjë, e gjeni prapë të njëjtin punëtor në dyqanin më të afërt dhe ne si deputetë nuk e paraqesim rastin në Inspektorat. A kemi ne besim në Inspektoratin e Punës? A kemi ne besim që ata inspektorë, numrin e të cilëve do ta shtonim, do ta bëjnë punën si duhet? A ne duhet t'i çojmë në trajnime edhe ata inspektorë që vërtet ta kryejnë punën si duhet për të qenë vërtet në shërbim dhe në mbrojtje të jetës së çdo punëtori në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, deputeti Albin Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Republikës,

Qytetarë të Kosovës,

Respektimi i të drejtave të punëtorëve dhe shkalla e papunësisë nuk janë dy çështje të pavarura prej njëra-tjetrës. Kur ka shumë papunësi, sindikatat mbeten të dobëta dhe rrjedhimisht të drejtat e punëtorëve nuk respektohen.

Sigurisht që është më mirë t'i kemi 100 inspektorë se 40 dhe më mirë se 100 inspektorë të punës është t'i kemi 200 inspektorë të punës, e 1 000 inspektorë të punës për afro 400 mijë të punësuar është edhe më mirë se 40. Mirëpo, duhet ta themi të vërtetën që të gjithë hapur e zëshëm, që me këtë shkallë të papunësisë kaq të madhe e me sindikata kaq të dobëta nuk do të ketë asnjëherë garanci nëpërmjet ligjit që do të mbrohen të drejtat e punëtorëve.

Ta luftosh sot papunësinë në Kosovë kontribuon edhe më shumë në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve sesa të përpiqesh t'i mbrosh të drejtat e punëtorëve pa e luftuar papunësinë. Agjencia e Statistikave e Kosovës konsideron se gati 2/3-at e popullsisë dhe 4/5-at e grave janë ekonomikisht joaktive dhe se vetëm një në 8 gra janë të punësuar. Natyrisht që shkalla e

papunësisë, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, del shumë më e vogël pastaj, sepse 2/3-at e popullsisë i kanë përfunduar komplet nga të papunët.

Në Kosovë, vetëm çdo i katërti qytetar i aftë për punë është i punësuar, ndërkaq dy prej 3 të rinjve nuk janë të punësuar dhe 40% të të rinjve që janë të punësuar janë pa kontrata pune. Në vitet e fundit, shkalla e punësimit vazhdimisht ka rënë, 28,4%, 26,0% dhe 25,2%. Në Kosovë nuk ka kuptim të flasësh për shkallën e papunësisë, duhet të flasësh për shkallën e punësimit. Dhe, ¾-at e të papunëve janë të papunë afatgjatë për më shumë se 12 muaj. Një pjesë e mirë e tyre nuk figurojnë më fare si të papunë, për shkak se në Kosovë duhet të jesh aktivisht i papunë në mënyrë që të jesh i papunë. Duhet vazhdimisht të regjistrohesh, rregullisht të regjistrohesh si i papunë, përndryshe të çregjistrojnë.

E pse të papunët të regjistrohen si të papunë në Kosovë, se mos po presin që do t'i thërrasë një ditë dikush në telefon e t'u thotë "Ejani, se jua gjetëm vendin e punës". Jo! Ata fare nuk do të regjistrohen dhe bëhen popullsi ekonomikisht joaktive. Por, edhe shkelja e të drejtave të punëtorëve, edhe papunësia, që në Kosovë janë shumë të larta, vijnë nga struktura e socio-ekonomisë tek ne e ajo është Dogana, remitanca, asfalt edhe zyra. Kaq!

Pra, derisa ta kemi këtë qerthull (Dogana, remitanca, asfalti dhe zyra) ne nuk do të mund të dalim nga kjo gjendje, pavarësisht sa të bukura i shkruajmë ligjet dhe sa e rritim numrin e inspektorëve.

Rritja ekonomike në Kosovë, të gjithë e dimë që është sasiore, e jo cilësore, meqenëse nuk është e shoqëruar nga drejtësia sociale.

Mirëpo edhe si rritje sasiore, ajo është rritje e paktë, rreth 3% mbi bazën që është e vogël, bruto-produkti vendor i Kosovës është rreth 6 miliardë euro.

Rritja ekonomike sasiore është parakusht, e jo qëllim, pa drejtësi e luftim të pabarazisë, ai u shërben pak vetave dhe rrezikon shumë demokracinë.

Drejtësia sociale vjen nga sigurimi shoqëror dhe tatimi i përshkallëzuar, ne nuk i kemi asnjërin në Kosovë.

Drejtësia sociale e bën rritjen të qëndrueshme dhe zhvillimin në progres, zhvillimi vetvetiu nuk është progres.

Përqendrimi i Qeverisë në autostrada është sikur të shesësh shtëpinë për të blerë veturë, për të blerë automjet. Pra, s'ka më progres në Kosovë, sepse nuk synohet dhe për pasojë s'ka punësim, siguri, arsim e shëndetësi, por ka mundësi qarkullimi e udhëtimi, pra ne jemi transit në vendin tonë.

Dhe, posa e kalojmë kufirin, kollaj edhe bëhemi refugjatë pastaj.

Kosova është shtet i kapur, është shtet i privatizuar nga kapësit e shtetit. Nuk është e mundur që 20 vjet të privatizohen fabrikat, arat, pyjet e lumenjtë pa u privatizuar Qeveria e shtetit. Kur ti kaq kollaj i shtet kaq shpejt kaq shumë fabrika, nuk mund të thuash pastaj pse e shiti postin një ministër ose pse u shit një inspektori i punës? Po, normalisht, kur t'i shesësh krejt fabrikat, shitet edhe inspektori i punës, kur shitet ministri, pse nuk shitet inspektori i punës? Kur shitet deputeti, e shet votën e vetë, pse të mos shitet inspektori i punës? Çfarë shembulli i jep deputeti e ministri inspektorit të punës?

Pra, ne duhet të bëjmë ligj të fortë për inspektorin e punës, në ndërkohë që deputeti e ministri shiten, kryeministrat, presidenti, e kështu me radhë.

Të drejtat e punëtorëve janë interes publik, por Kosovën e dominoi privatizimi në këto 20 vjet. Në vend të pronësisë publike të gjithë qytetarëve, gjithnjë më shumë kemi politikanë pronarë të mëdhenj.

Ashtu sikurse akti 'Gle Stigl' që i ndau bankat komerciale prej atyre investive në vitin 1933 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kemi nevojë për një lloj ndarje të politikës nga biznesi, kjo e ka shkatërruar ekonominë në Kosovë.

Sot bizneset kryesore janë të politikanëve. Njerëzit që kanë hyrë në politikë, ndoshta kanë qenë në fillim 2% biznesmenë, sot janë veç 2% politikanë, se janë bërë 98% biznesmenë.

Senatori Senatori Carter Glass, ish-sekretar i Thesarit, dhe kongresmeni Henry Steagal, kryetar i Komitetit për Banka dhe Valutë në Kongresin Amerikan, e kanë sjellë këtë ndarje të bankave komerciale nga ato investime. Edhe neve na nevojiten ligje që në fakt e ndajnë politikën nga biznesi. Politikanët, më mirë të them, nga biznesi edhe nga biznesmenët. Nuk po them tash ta vendosim aty një mur kështjelle midis tyre, po tash nuk ka as perde, as perde s'ka midis politikanëve dhe biznesmenëve, e mandej ne ankohe mi se u shit atje një inspektor i punës, ku di unë, poshtë, pasi që qëndroi nja 4-5 vjet pa u shitur.

Në këtë vend janë shitur gjërat më të mëdha, është absurde të flasim për atë se si korruptohet dikush atje poshtë.

Dhe, të mos harrojmë që nuk ka shanse të barabarta, që u themi ne të gjithë qytetarëve se ligji është i barabartë për të gjithë, të gjithë i keni shanset e barabarta, vetëm me liri negative, si liri nga ndërhyrja arbitrare e autoritetit, nevojiten edhe liritë pozitive që të mos përfundosh i varur, i nënshtruar e në kushte çnjerëzore të punës.

Pabarazia në Kosovë unë besoj që është pabarazia më e madhe në Evropë. Ligji vlen për të gjithë, po ligji është i pazbatueshëm kur ke kaq shumë kontraste në shoqëri. Me një kësi lloj pabarazie, ligjet mbetin gjithnjë në letër.

Edhe një numër i konsiderueshëm i të punësuarve, edhe shumica e të rinjve të punësuar, kanë më shumë shkollim se sa pagë në Kosovë. Po edhe shumica dërmuese e të punësuarve në përgjithësi sërish nuk punojnë në profesionin e tyre, se nuk ekziston ndërlidhja e arsimit me ekonominë, që është një temë tjetër jo më pak e rëndësishme.

Ka raste që i kanë nga 4-5 vende të punës, mirëpo ne e dimë që personi duhet edhe të flejë gjatë 24 orëve, ne nuk e dimë kur i bënë ato punë të 4-5 vendeve të punës që i ka, edhe një herë vijmë te varfëria e mjerimi që kanë si shkak këtë pabarazinë enorme.

Por, ne duhet të ndryshojmë konceptin tonë mbi të punësuarin dhe punën, në mënyrë që të mund t'i respektojmë të drejtat e punëtorëve e të angazhohemi për ta.

Përderisa nuk besojmë që pasuri vjen nga puna dhe natyra, nuk mund të kemi respekt për punëtorin.

Përgjithësisht në Kosovë besohet që pasuria vjen nga shkathtësia dhe një farë lloj gjindshmërie, që është gjysmë hapi larg hajnisë. Në Kosovë nuk besohet që pasuria vjen nga puna dhe nga natyra, besohet që vjen nga shkathtësia. Prandaj, nga ky perceptim, nga ky botëkuptim, është shumë vështirë që të mbrosh të drejtat e punëtorëve. Madje, është e pamundur edhe t'i kuptosh ato.

E unë po e bëj një përshkrim të shkurtër se si do të dukej ky botëkuptim i ri mbi punëtorin, në mënyrë që ne të jemi kredibilë e legjitimë të flasim për të drejtat e tyre.

Në vendin e punës njeriu duhet ta ngrëjë veten dhe shoqërinë, të krijojë marrëdhënie solidare dhe të dinjitetshme me punëtorë të tjerë dhe jo konkurrencë deri në luftë për mbijetesë, të jetë njeri punëtor, por edhe të jetë njeri duke qenë punëtor, të mos i merren frytet e punës dhe as raportet njerëzore me të tjerët. Nuk mund të jenë rezultatet, frytet dhe meritat të pronarit e të menaxherit, kurse kostoja e jetës, si banimi, shkollimi, arsimimi, përgjegjësi e vetë punëtorit. Në punë punëtori edhe merr pjesë në betejën për të drejtën e punëtorëve, si dhe për drejtësi, barazi e liri në shoqëri.

Vendi i punës nuk duhet të varet nga vullneti a dëshira e menaxherit, profiti i pronarit apo fluktuimet në treg. Punëtori duhet të paguhet sa më shumë për punën që bën, e jo fare pak vetëm atë sa të vijë edhe nesër në punë. Punëtori nuk është as mall, e as hamall.

Pa e ndryshuar botëkuptimin se prej nga vjen pasuria dhe çka është punëtori, ne nuk jemi as legjitimë të flasim...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Frashër Krasniqi e ka fjalën.

FRASHËR KRASNIQI: Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Siç u tha edhe më herët nga disa prej nesh, është e rëndësishme të kuptohet lidhja në mes të shkeljes së të drejtave të punëtorit dhe papunësisë së lartë. Është shumë e thjeshtë, papunësia e lartë shkakton konkurrencë të lartë brenda punëtorëve për të fituar një vend të punës, gjë që u jep komoditet të jashtëzakonshëm bizneseve private për t'i larguar nga puna ata punëtorë që ankohen ose që kërkojnë t'u respektohen të drejtat.

Pra, nëse sot në Kosovë nuk do të punosh mbi tetë orë ose më shumë se pesë ditë të javës ose kërkon të të rritet paga, pronari i vendit të punës të largon menjëherë, sepse ka mjaftueshëm të papunë që do ta zinin vendin tënd menjëherë.

Në këtë kontekst, është hipokrizi e madhe të flitet për shkeljen e të drejtave të punëtorëve ata që e kanë sjellë vendin në këtë gjendje të papunësisë dhe të rrënimit ekonomik, ata që kanë qenë bartës të procesit të privatizimit të Kosovës, domethënë të ekonomisë së Kosovës, nga i cili 80 mijë punëtorë e kanë humbur vendin e punës, sot të flitet qysh punëtorëve po u shkelen të drejtat, thuajse nuk është ditur kjo punë më herët. Kur e ka marrë vesh kryeparlamentari Kadri Vesli që punëtorëve po u shkelen të drejtat: qe një vit? Qe një muaj? Kjo është hipokrizi, u kanë qëndruar punëtorët gjatë mandatit të qeverisjes së PDK-së 500 ditë nëpër shtatorë duke kërkuar të kompensohen punëtorët e Fabrikës së Tubave, ende sot po vdesin pa i marrë kompensimet e tyre.

Pse nuk është rritur asnjëherë numri i inspektorëve që janë angazhuar për monitorim të Ligjit të punës gjatë qeverisjes së kaluar, e as gjatë kësaj që e kemi sot? Në të dyja këto, edhe kryeparlamentari Veseli, edhe Bekim Haxhiu që foli më herët, kanë qenë pjesë e Qeverisë ose partia e tyre ka qenë pjesë e Qeverisë.

Derisa jemi duke folur në këtë seancë, në Republikën e Kosovës janë qindra-mijëra punëtorë e punëtore të sektorit privat që punojnë me nga 10 deri 12 orë në ditë e më tepër, që e kanë vetëm një ditë pushim në javë, e shpeshherë as atë ditë, bile, nuk kanë pushime vjetore, nuk kanë pushime lehonie, e humbin vendin e punës nëse sëmuren më gjatë, nuk kanë kontrata e siguri në punë, e kështu me radhë dhe në fund paguhen aq sa ne marrim mëditje për pjesëmarrje në vetëm dy seanca në muaj. Bile, jo për pjesëmarrje, veç të nënshkruhesh, s'ke nevojë të qëndrosh as deri në fund, deputeti i Kuvendit të Kosovës i merr 240 euro mëditje vetëm për këto dy nënshkrime,

aq sa merr pagë një qytetar ose një qytetare që punon në sektorin privat shtatë ditë në javë nga 12 orë në ditë.

Të nderuar deputetë,

Taksistët që na vozitin neve sa herë që kemi nevojë punojnë 12 deri 13 orë në ditë, në veç një ditë pushim në dy javë, jo në javë, një të diele në dy javë.

Kamerierët që na shërbejnë nëpër restorante në lokale ku hamë dhe pimë ne, punojnë 10 orë në ditë, veç një ditë në javë pushim, pa kontrata dhe mezi i marrin 200 euro në muaj.

Punëtorët që i ndërtojnë shtëpitë tona punojnë deri 10 orë në ditë punë të rënda fizike, pa siguri në punë, pa kontrata, pa pushime dhe mezi i marrin 200 apo 300 euro në muaj.

E kryeministri ynë, nën presionin e bizneseve private, nuk pati guxim që as pagën minimale në sektorin privat ta rrisë.

Nuk ka kjo Qeveri vesh, po as qeveritë para kësaj, që t'i dëgjojnë punëtorët dhe punëtoret e këtij vendit, eventualisht dëgjojnë për ta veç kur këta punëtorë vdesin në vendin e punës, nja 2-3 ditë kur bëhet e madhe kjo punë nëpër media dhe nuk ka kurrfarë interesimi të Qeverisë më tutje për punëtorët e këtij vendi.

S'ka si i ndalon shkeljet kjo Qeveri, nëse për 50 mijë biznese private i kem veç 50 inspektorë të punës.

Së paku e kam një propozim konkret që mund ta bëjë menjëherë kryeministri, këta zëvendësministra, edhe ashtu s'po di qysh t'u gjejë punë, le të bëjnë inspektim bizneseve të Ligjit të punës dhe në këtë mënyrë, e kishte dyfishuar zbatimin e këtij ligji, se prej 50 inspektorëve, bile i kishim bërë nja 150 sish edhe me siguri do të funksiononte më mirë. Faleminderit!

KRYETARI: A ta ka përmendur emrin? Frashër, a ia ke përmendur emrin? Urdhëro! Po vazhdojmë, se i kemi edhe 18-20 deputetë. Urdhëro, replikë, e ke fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar koleg deputet,

Jam munduar të jem shumë realist në diskutim pa kurrfarë konotacioni politik dhe përmbajtje politike, po realist në atë çka është problemi.

Mua po më vjen mirë që këshillën e Glaukut e ke marrë shumë shpejt para sysh, që ju duhet të merreni me PDK-në, nëse doni të jeni 'in', mirë është.

Kur fol për hipokrizinë, ti sigurisht mendon që e ke pasqyrën përpara. Faleminderit!

KRYETARI: Kundër-replikë!

FRASHËR KRASNIQI: Unë nuk e dëgjova asnjë këshillë, për shkak se faktikisht Fatoni e tha çka e pati me një hipokrizi të llojit tjetër, unë fola për një hipokrizi tjetër, hipokrizinë e PDK-së, edhe është hipokrizi të flasësh për moszbatim të Ligjit të punës, të flasësh për gjendjen e rëndë të shkeljes së drejtave të punëtorëve në Kosovë dikush, i cili ka qeverisur në këtë vend tash e 10 vjet pothuajse dhe nuk ka bërë asnjëherë asnjë veprim, qoftë së paku pagën minimale keni mundur ta rritni, së paku numrin e inspektorëve keni mundur ta dyfishoni, prej 50 ta bënit 100, e tash unë nuk po e kuptoj a është PDK-ja opozitë, çka është puna, se komplet ligjërimit e ka si të jetë opozitë, jo pjesë e Qeverisë. Kjo është hipokrizia që po e them unë.

KRYETARI: Pagat i ka rritur PDK-ja, për atë kritikohet, për infrastrukturë dhe paga, dy fish, tre fish. Po, mirë e ke, duhet të ketë më shumë punësim, kjo është pjesa që është kryesore, se pak janë, është e vërtetë.

Shkumbin Demaliaj e ka fjalën.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, kryetar!

Në dokumentin që e mora s'kam asgjë më shumë, përpos rendin e ditës, të jem i sinqertë, sepse nuk kam ditur ç'të përgatitem lidhur me këtë çështje, për shkak se kjo lidhur me gjithë ato që po themi ne këtu, të gjitha grupet parlamentare, është e rregulluar e ligjet më të avancuara që i ka dynjaja, duke filluar nga ligji bazë, për shkak se duhet t'ju njoftoj se lidhur me çështjen e Ligjit të punës në Kosovë ka shumë subjekte që janë ardhur më vonë në Kuvend, ka një historik.

Duhet ditur se Ligji i parë i punës në Kosovë ka qenë rregullore e UNMIK-ut, e ardhur pikërisht nga Përfaqësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, menjëherë pas Rezolutës 1244, që edhe ajo është në fuqi, po ne nuk po e zbatojmë atë rezolutë, sikur po kërkohet të zbatohet secila rezolutë që ka dalë në Kuvend, edhe nuk janë të obligueshme.

Me rendin e ditës kjo nuk përkon asgjë çka po flasim të gjithë ne, sikurse edhe unë që po flas tash. Është në pyetje rendi i ditës: debat parlamentar në lidhje me të drejtat e punëtorëve dhe adresimin e papunësisë në Republikën e Kosovës, ne çajmë kryet për tema krejt të tjera për të rregulluar ndoshta ndarjen e thellë të Lëvizjes Vetëvendosje me Partinë Socialdemokrate, apo të një mekanizmi tjetër politik, sepse ju e keni kuptuar më së miri atë ndarje. Nuk e kupton dikush tjetër...

KRYETARI: Deputet, të lutem, kjo është gjuhë parlamentare, nuk është personale.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Edhe pjesa tjetër.

Ligjet i ka Kosova lidhur me këtë çështje, sa janë të implementueshme? Ndoshta më mirë është dashur të thirret debat për të folur për implementimin e rezolutës, jo si pikë e rendit të ditës, por e implementojmë rezolutën, debatojmë mbi rezolutën, dalim me rekomandime, t'i drejtohem Qeverisë për implementimin e rekomandimeve që burojnë nga rezoluta e vitit të kaluar, kur unë nuk kam qenë pjesë e këtij Kuvendi dhe ta ndërpremë këtë debat bosh.

Flasin për numrin e inspektorëve, për Inspektoratin, për mekanizma të tjerë, të gjitha janë të rregulluara me ligj.

Këtë debat edhe këto kërkesa për rritje, edhe për rritje buxhetore, edhe për përkrahje të këtyre mekanizmave implementues flisni në nëntor kur të vijë buxheti, jo, e ka fajin Qeveria.

Bile ky Inspektorati është me një nënkod buxhetor në një departament të Ministrisë së Punës, nënkod buxhetor, lidhur me krejt çështjen e implementimit, dua ta theksoj dhe ta falënderoj që foli për mundësitë e mira dhe në mënyrë profesionale, kanë folur edhe të tjerët, por duke përdorur terminologji politike dhe elementin e fjalorit popullist, vetëm zonja Fatmire Kollçaku. Kjo ka folur në mënyrë profesionale sot, pa politikë, çka është lypur. Jo hajde ta bimë kryeinspektorin e punës, se ai duhet të vijë gjithqysh të raportojë në komision parlamentar. Pse komisioni parlamentar nuk duhet të shkojë t'ia këqyrë zyrat atij qysh funksionon, atje duhet këqyruar implementimin. Në qoftë se mendojnë për funksionim, jo t'i thuhet ti je i obliguar të vish çdo tre muaj te unë, kush jemi ne? Ne jemi ata që aprovojmë ligje, duhet mbikëqyruar implementimin e tyre, jo të kërkoen periudha raportuese. Atje ka më shumë inspektorë, 61 kanë qenë më 2007, dhe nuk është pyetje numri i inspektorëve, por është rritja e fuqizimit të atij mekanizmi. Ai mekanizëm do mbështetje, rrezikshmëri në punë, e kanë rregulloren e hartuar vetë prej ministrisë dhe nuk ua implementojnë. Gjithë natën duhet dalë rrugëve, bashkë me mekanizma të tjerë institucionalë, policinë, e të tjerë dhe nuk janë të mbrojtur. Më shumë janë të mbrojtur këta të tjerët, mirë është kjo, por inspektori e ka vetëm dokumentin paraprak në dorë dhe i duhet të dalë gjithë ditë e gjithë natën lokaleve dhe t'i mbikëqyrë lëndimet në punë, rrezikshmërinë në punë, vdekjet në punë.

Vdekjet në punë janë si rezultat i kushteve që ne ua kemi mundësuar këtyre njerëzve që sot kanë kompani në Kosovë. Këto kompani në Kosovë, a ka dikush statistika qysh i rregullon dhe sa është numri ku ekzistojnë këto punë të rënda? Këto punë të rënda ku dëmtohen punëtorët dhe ato kompani a u kanë dhënë kontrata atyre punëtorëve, ka punëtorë, dihet, e thamë më herët, ndoshta është dashur edhe një interpelancë nga opozita në këtë rast. Lidhur me vdekjen e këtij punëtori në punë, Valon Berisha, a i ka plotësuar ajo kompani kushtet, me rrethoja dhe kushtet e tjera ligjore që ai punëtor të mos dëmtohet së pari, e jo më të vdesë në punë. Nuk merremi me atë, se po na intereson nga pak ta shpërndajmë përgjegjësinë politike, është e kuptueshme, edhe vetë e përdori fjalorin popullist, kemi nevojë, se këto politika i bën.

Gjithmonë e marrim peshën poshtë te qytetari lidhur me politikën, e nuk po duam të bëjmë dallim se ne i paskemi 240 euro për mëditje, ai e ka rrogën aq. Sa është numri i të papunëve? Po flasim veç për sektorin privat dhe publik, e hiq gjendja më e mirë nuk është as në shërbimin civil të Kosovës, në sektorin e punësimit civil hiq më e mirë, përpos që këtu duhet lënë fajin inspektorit të punës, atje duhet fajësuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, se ai duhet të dijë kah duhet lëvizur.

Hiç, ka abuzim në shërbimin civil, bile me kontrata mbi vepër nuk dihet njerëzit as çka punojnë.

Në radhë të parë rasti i Valon Berishës, një njeri i diplomuar krejt për diçka tjetër, a ka qenë i trajnuar për të punuar në atë kompani, ku e ka hupur edhe jetën. Kjo është natyra jonë institucionale e mbikëqyrjes të implementimit të ligjit.

E flas tjetrën, kushtimisht, se nuk po dua të lëshohem në kuptimin historik, duhet njohur rrethanat qysh janë krijuar këto ligje, edhe sa ka hapësirë që këta të mund të veprojnë, cila është mbështetja që ne e japim, këtë e kërkoj unë personalisht nga opozita, se u tha duhen 2 milionë euro të ndahen për inspektorë, e të bëhen 400 inspektorë, duhet ditë ku të gjenden ato mjete, janë në kuadër të Komisionit për Buxhet, edhe ne do t'i aprovojmë, pse jo, gjithçka të jetë e implementueshme, le të rregullohet edhe ky sektor, që është më i rëndësishmi në Kosovë, po nuk është fuqizuar kurrë. Krijon të hyra buxhetore për buxhetin e Republikës, mekanizmi i Inspektoratit, krijon të hyra e ne nuk e mbështesim! Mbështesim mekanizma, organizata që veç harxhojnë buxhet, ndihmojeni një mekanizëm që krijon buxhet, edhe këshillon krejt këtë fenomen për çka ne po flasim.

Unë mendoj se debati duhet të ndërpritet menjëherë, fillojmë me ndonjë pikë të rendit të ditës tjetër, të kërkojmë nga propozuesi që edhe atë pjesën tjetër të rekomandimeve të dalë t'i lexojë edhe t'i drejtohem Qeverisë ta implementojë rezolutën e vitit të kaluar me rekomandimet që i afrojnë, ato rekomandime që kanë qenë, edhe nëse ka shtesë.

Mund të flasim për politikë sa të duam, ndarje të thella, lëvizje, as unë nuk jam më mirë se ju, deputet jam, njëjtë e tregojmë fytyrën kur dalim diku, po kur është në pyetje për mekanizmin që duhet mbështetur, debat, debat, pa prodhuar asgjë hiç. Unë mendoj se duhet të shteret ky debat në këtë rast dhe ato rekomandime shtesë t'ia drejtojmë Qeverisë t'i implementojë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! A ka mundësi një propozim ta jap. 17 deputetë janë lajmëruar për fjalë, në qoftë se e kishim bërë nga 5 minuta, mundemi para kohës së iftarit, për 85 minuta, e kryejmë. A ka mundësi për marrëveshje të përbashkët nga 5 minuta dhe të kufizohemi? 85 minuta dhe shkojmë në pauzë të iftarit? Po shoh, atëherë përmbajuni, ju lutem, regjia, pesë minuta fjalën për secilin koleg deputet. Me aq sa po shoh, ka pajtueshmëri.

Atëherë, Milaim Zeka nga Nisma, pesë minuta!

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Bile pesë minuta janë shumë, arsyeja e krejt padrejtësive që krijohen në raport me punëtorët në Kosovë është mosfunksionimi i sindikatave, në radhë të parë.

Të nderuar qytetarë,

Në Kosovë bëhen shkelje flagrante të të drejtave të punëtorëve, po koncentrohem në temë, Shkumbin, edhe po flas shumë konkretisht.

Në radhë të parë nga “Bechtel-Enka” që diskriminohen punëtorët dhe vdesin në vendet e punës.

Kompanitë e derivateve në Kosovë çdo punëtori ia shkruajnë 8 orë, e çdonjëri punon 12 orë, kamerierët e kanë të njëjtën situatë.

Kompanitë e taksive jo që diskriminohen, po çdo taksist paguan 20 euro për sigurimin e makinës ‘full kasko’, domethënë 20 euro i ndalen nga rroga e vet për makinë ‘full kasko’.

Gazetarët, të mos flas, janë kategoria më e diskriminuar, po pse askush nuk po i përmend këto motelet e pushimit ditor, që faktikisht janë motele të maltretimt ditor, ato nuk janë fare të regjistruara, janë vende të prostitucionit, ata janë bërë milionerë, janë bërë njerëz të pasur e të fuqishëm në shoqëri se sa ne deputetët, se atje shkon një hetues i policisë me femër të vet, ky incizon, tani luan me ta qysh t’i teket. Unë e ti, Glauk, nuk kemi qenë, por po flas për hetues të tjerë.

Shkojmë te Postë-Telekomi i Kosovës, praktikantët i mbanë nga gjashtë muaj pa pagesë. Po cili është fajti? A e di ti, Glauk, që Qeveria që u jep tenderë kompanive të ndryshme, për shembull, për seminare, a e dini ju që nuk ua lëshojnë paratë dhe u kanë borxh këtyre hoteleve, dhe kur shkon te Thesari për të kërkuar para, duhet çuar një ‘msit’ për t’ia ndalur ky i Thesarit përqindjen dhe t’ia lëshojë paratë. Kështu luhet ‘loja e bixhozit’ në Kosovë! Vetëm mbrëmë, të nderuar deputetë, nga një kontroll i policisë sonë në 28 lokale të natës janë arrestuar 200 femra shqiptare, vetëm mbrëmë 200 femra janë arrestuar pa leje të punës, të fyera, të maltretuara e të poshtëruara. Po çka ndodh, për shembull, me policinë tonë që punojnë nga 10 orë dhe kur dalin nga puna, askush nuk ua siguron transportin. Domethënë, të shkretit, duhet pritur me orë të tëra dhe kurrkush nuk merr pagesa shtesë.

Çka ndodh me femrat shtatzëna? Për shembull, sektori privat nuk do t’i pranojë në punë femrat e martuara, se thonë ajo lind dhe u nxjerrin vetëm probleme. Edhe ky është një diskriminim i jashtëzakonshëm. Kështu që krejt këtë po e them, në fund, të mos flas për kompanitë e sigurimeve, e për të tjera, e tjera. Problemi kryesor është se në Kosovë nuk ekzistojnë sindikatat

për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve. Sindikatat e punëtorëve janë komplet politike, sikur organizatat studentore nëpër universitetet tona që janë krijesa të partive politike, çdo sindikatë në Kosovë anon kah një parti politike. A i keni parë sikur para iftarit kur vijnë zgjedhjet, qysh bëjnë marrëveshje. Ku keni parë, more, që sindikata të bëjë marrëveshje me politikanë e me qeveritarë! Kjo është blerje publike e kryesive të sindikatave. Prandaj, këtu është defekti, përndryshe ligjet i kemi shumë të mira, si tha Shkumbini, Inspektoratin e kemi shumë të mirë, po hajde ta rrisim Inspektoratin, ta bëjmë nga 42, minimum 400. A kemi para? Kosova është më e pasur se Kuvajti, në qoftë se nuk e vjedhim buxhetin edhe paranë publike, kaq. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Ne kur komunikojmë, sigurisht që komunikojmë nëpërmjet seancave publike me qytetarët e Republikës së Kosovës për të adresuar edhe çështjet e mendimet që i kemi.

Mediumi, i cili është i autorizuar t'i shfaqë seancat, Radio Televizioni i Kosovës, e ndërpreu transmetimin para pak kohësh, sepse ishte promovimi i librit të presidentit në Vjenë. Tash nuk e di edhe sa herë do ta promovojë atë libër fantastik-shkencor. Kështu që unë po e shpreh fjalën time sa i përket debatit, i cili është thirrur me të drejtë, edhe një kërkesë, të mos e quaj që është pjesë e përditshmërisë sonë, kur flitet për të drejtat e punëtorëve në sektorin publik, por edhe në atë privat. Është më se evidente që përpos legjislacionit në fuqi, akoma ka mangësi, të cilat nuk janë në përputhshmëri me standardet dhe konventat ndërkombëtare, sepse vetë situata, sidomos në sektorin privat, është shumë e rëndë, duke marrë parasysh që shumica e të punësuarve në sektorin privat janë pjesë e ekonomisë joformale, ekonomisë së zezë, të cilët janë të dëmtuar në çdo rast, edhe nga shmangiet që ne i quajmë tatimore apo fiskale. Shumica e punëtorëve në Kosovë, duke mos qenë pjesë e ekonomisë formale, bëhen pjesë e ekonomisë joformale, kjo është e evidentuar edhe me Trustin Pensional të Kosovës, edhe me shifrat dhe analizat e Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës.

Dhe, kur e kemi këtë gjendje, punëtorët tanë punojnë pa kontrata, me orare të stërzgjatura të punës, pa të drejtë për pushim ditor, javor apo edhe vjetor, pa kompensime dhe ndëshkime për punën jashtë orarit, pa asnjë sigurim në punë, pa pajisje mbrojtëse, ku kemi humbje jete të të rinjve, atëherë cili është respektimi i instrumenteve legale ndërkombëtare dhe ligjeve në fuqi, të cilat janë në Republikën e Kosovës! Kjo situatë është e pasigurt për punëtorët tanë. Dhe, me këtë kompleksitet të ligjeve çfarë është në Republikën e Kosovës, me një implementim të dobët në të gjitha anët, domethënë jo veç që kemi konflikt edhe të normave ligjore, pengesa, por kemi edhe neglizhenca të qëllimshme dhe afera korruptive nga institucionet përgjegjëse, të cilat aty ku munden, ndëshkojnë organizata private për mosrespektim të të drejtave të punëtorëve dhe aty ku nuk munden, e këtu duhet të thuhet publik ku janë të ndikuar drejtpërdrejt dhe mbështeten nga

politika, atëherë janë dhe qëndrojnë larg tyre dhe nuk mund të sigurojnë të drejtat e punëtorëve dhe krijojnë pasiguri në punë.

Institucionet përgjegjëse, edhe Inspektorati i Punës, edhe Bordi Mbikëqyrës i Pavarur për Shërbimin Civil, gjykatat, edhe këta që quhen partnerë socialë, edhe shoqëria civile mendoj që bashkarish, edhe me njerëzit e vullnetit të mirë të politikës, duhet të jenë më aktivë në këtë drejtim. Jo vetëm të kërkojnë implementim të ligjit, apo përshtatshmëri të legjislacionit me aktet ndërkombëtare, por të bëjnë presion publik, mbi të gjitha mbi prokurorinë dhe gjykatat, të cilët janë të obliguar që të jenë në përkrahje në anën e të drejtës të punëtorëve tanë, të cilët në çdo moment, në çdo kohë dhe në çfarëdo rrethane janë të shkelur, jo nga të gjithë, nuk mund t'i përgjithësojmë, por nga raportet dhe nga raportet personale shihet që mungesa e ushtrimit të ligjit është e madhe në këtë drejtim.

Kolegët e përmendën edhe mungesën e kapacitetit të sindikatave për ta ushtruar mandatin e tyre dhe nuk janë në gjendje ta mbikëqyrin implementimin e Ligjit të punës. Andaj, mbetet sfida për Kuvendin, mbetet obligim që jo vetëm rekomandimet, por mbikëqyrja e plotë e zbatueshmërisë së Ligjit të punës në institucionet tona vendore, bashkarish edhe me shoqërinë civile dhe me partnerët e tjerë socialë të jetë më efikase dhe më e shtuar. Andaj, unë mendoj që krahas rekomandimeve që janë për t'i përcjellë, për t'i implementuar, qoftë edhe kjo gjuha jonë që nganjëherë lë shijen e popullizmit, por ne këtu po jetojmë.

KRYETARI: Faleminderit! Hajdar Beqa e ka fjalën.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Realisht tash jam në mandatin e dytë si deputet dhe për këtë temë kemi diskutuar disa herë. Ne si shtet, si Republikë e Kosovës, e kemi një infrastrukturë të mirë të ligjeve që i mbrojnë punëtorët në të drejtat e tyre, por sa zbatohen këto ligje, varet edhe prej institucioneve, të cilat janë të thirrur që t'i zbatojnë.

Nëse e marrim vetëm gamën e ligjeve që kanë të bëjnë me Inspektoratin e Punës, do të thotë është një gamë shumë e gjerë, nga Ligji i punës, Ligji për mbrojtjen e të ushqyerit me qumështin e gjirit, Ligji për aftësimin dhe riaftësimin e profesioneve dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, Ligjin për të huajt, Ligjin për ndërmarrje publike, Ligji për mbrojtje nga diskriminimi, Ligji për sportin, Ligji për përdorimin e gjuhëve, Ligjin për greva, Ligjin për sigurime dhe shëndeti në punë, kemi Ligjin për kontrollin e duhanit, Ligjin për mbrojtjen nga rrezatimet dhe sigurimi nuklear, Ligjin për zjarrin, do të thotë, pa i marrë edhe udhëzimet e tjera që i ka Inspektorati.

Ne kemi pasur kërkesa në vazhdimësi që të rritet numri i inspektorëve. Nëse e krahasojmë me regionin, Republika e Kosovës ka më së paku inspektorë. Duke pasur parasysh që Inspektorati i ka në kompetencat e veta edhe sektorin privat, edhe sektorin publik, mund të them lirish që sektori privat është njëfarë forme i pamundshëm për t'u kontrolluar në tërësi. Kjo ndikon direkt edhe në rritjen e numrit të punësuarve, ndoshta në bazë të informatave që i kemi, janë mbi rreth 30 mijë të punësuar në Republikën e Kosovës që nuk janë deklaruar apo nuk u paguhet trusti, apo nuk u paguhet tatimi në pagë. Të gjitha këto ndikojnë direkt edhe në buxhetin e Kosovës dhe në kushtet më të mira për punëtorët. Ne realisht sot kemi diskutuar shumë interesant në këtë Kuvend, kemi folur për tema nga më të ndryshmet për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve. Ne e dimë që qytetarët tonë, rinia jonë pret krijime të vendeve të punës, përveç që në të njëjtën kohë edhe mbrojtjen e të drejtave të tyre elementare në punë, por nuk është mirë të flasim të paktën njerëzit që kemi udhëhequr institucionet dhe nëse kemi pasur skandale në ato institucione, ku ne kemi udhëhequr.

Unë po e shoh që Vetëvendosje vazhdon me avazin e vjetër, edhe kryetari i saj, zoti Kurti, po në të njëjtën kohë edhe anëtarët e tjerë që me njëfarë forme janë shumë të "interesuar" për mbrojtjen e punëtorëve, kur po harrojnë se para pak ditësh për një administratë të partisë që është një numër shumë i vogël i të punësuarve, para se të ndahej Vetëvendosja në dy pjesë, kemi pasur shumë akuza mes tyre, publike, edhe nga nivelet më të larta, edhe të deputetëve e të zyrtarëve më të lartë për shkelje më elementare që u janë bërë në punë, deri në ato abuzive. Andaj, është mirë ne t'i përmirësojmë nga ato subjektet tona, e deri aty ku ushtrojmë kompetencën tonë si shtet.

Ne jemi të gjithë të interesuar që të luftojmë ekonominë joformale, jemi të interesuar që të respektohen në tërësi ligjet, që të mos lejohet të tejkalohen ditët e punës pa pagesë apo orët e punës, që gratë që lindin apo lehonat, edhe në sektorin privat, të respektohet ligji në mënyrë që t'i realizojnë të drejtat, por nuk është mirë ne të japim këtu deklarata, çdo vite ta bëjmë nga një temë. Kjo është ndoshta njëra prej tyre debateve që jemi duke i bërë ne, në shumicën prej tyre po e humbim kohën dhe nuk po e realizojmë agjendën e Kuvendit, objektivat tona. Andaj, është mirë të jemi më konkretë, më precizë dhe t'i pranojmë edhe gabimet nëse i kemi në shtëpinë tonë apo në oborrin tonë, flas në spektrin politik.

Si Parti Demokratike këtë temë e kemi ngritur, e thanë edhe parafolësit, edhe në të kaluarën, kemi parë se për shkak të ligjit që ishte në procedurë, kemi parë se nuk ka kaluar rezoluta dhe tash është ligji në procedurë. Në Qeveri është Ligji për Inspektoratin e Punës, është mirë që ai ligj sa më shpejt të vijë në Parlament dhe të kalojë nëpër komisione, sepse në bazë të informatave që i kemi, me këtë ligj u garantohen më shumë të drejta të punëtorëve, por ka të bëjë edhe me rrezikshmërinë, duke pasur parasysh që në vendin tonë kemi humbur shumë jetë të njerëzve në vendin e punës dhe nuk kemi pasur ndonjë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Arbër Rexhaj e ka fjalën.

ARBËR REXHAJ: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë,

Në këtë krizë ekonomike, në të cilën po ndodhet Kosova, ku për çdo ditë e më shumë qytetarët e shtetit tonë po e lëshojnë vendin drejt shteteve perëndimore për një jetë më të mirë, të gjesh një vend pune është bërë luks, sepse jo të gjithë mund të punojnë, jo të gjithë, edhe nëse punojnë, mund të kenë një pagë të mirë, e për të drejtat e tyre të mos flasim, ku duke filluar nga orari i punës, siguria në punë, e të drejtat e tjera të përcaktuara me Ligjin e punës në Republikën e Kosovës.

Në gjithë këtë grumbull padrejtësish që po i bëhen punëtorit në Kosovë, më së keqi qëndrojnë punëtorët në sektorin privat. Punëtorët e këtij sektori, përveç që paguhen pak, shpeshherë ka raste që paguhen edhe me vonesa, ka raste kur edhe nuk paguhen fare, madje edhe maltretohen. Shkelja më e madhe dhe më e rëndomtë që u bëhet punëtorëve të sektorit privat është orari i punës. Sipas nenit 20 të Ligjit të punës, orari i punës për një javë duhet të jetë 40 orë dhe po t'i shohësh kontratat e punëtorëve në to, ju shkruan se do të punojnë 40 orë në javë, por në realitet, secili punëtor në sektorin privat punon 48 orë në javë, ka raste që orët e punëtorit për një javë të arrijnë deri në 60 apo 72 orë në javë, kundrejt pagesës së njëjtë.

Shkelje tjetër që u bëhet punëtorëve të këtij sektori janë edhe pushimet, javor dhe ai vjetor. Sipas nenit 31, çdo punëtor ka të drejtë në pushim në kohëzgjatje 24 orësh brenda një jave, ndërsa sipas nenit 32 të Ligjit të punës, secili punëtor ka të drejtë në pushim të paguar vjetor në kohëzgjatje së paku 4 javë. Punëdhënësit këtu në Kosovë sa herë që i shtohet puna, qoftë gjatë sezonit apo ndonjë gjë tjetër, u hiqet punëtorëve të tij pushimi javor dhe nuk u kompensohen sipas dispozitave ligjore. Kjo është po ashtu, një shkelje e madhe. E për pushim vjetor të mos flasim, ku pothuajse secili punëtor në sektorin privat asnjëherë nuk mund të shfrytëzojë të gjitha ditët e parapara me ligj, por vetëm aq ditë sa ia lejon korporata ku punon.

E nëse flasim për kushtet e punës dhe sigurinë në punë, ky problem është temë në vete. Punëtorët në Republikën e Kosovës sigurinë në punë e kanë minimale, të mos themi fare. Së pari ata nuk kanë sigurim shëndetësor, pastaj asnjë punëdhënës nuk mërzhitet që punëtorët e tij të krijojnë një ambient dhe një strukturë të sigurt. Halli më i madh i tyre është se si t'i mashtrojnë inspektorët me pak harxhime, e në anën tjetër, punëtori nuk guxon të flasë, sepse shantazhohet me humbje të punës. Nene të tëra të Ligjit të punës flasin për mbrojtjen e punëtorit dhe sigurimin në punë, por sa zbatohen në realitet kjo, lë shumë për të dëshiruar, e këtu faji bie drejtpërdrejt mbi mekanizmat shtetërorë përkatës, bie fjala, Inspektorati dhe institucionet e tjera relevante, të cilët bëjnë punën e tyre me neglizhencë të plotë.

Nëse flasim për punëtorët e sektorit publik, as këta nuk qëndrojnë më mirë, veçse ndoshta paguhen pak më rregullisht, e pak më mesatarisht, por për punën që e bëjnë dhe rrezikun e përgjegjësinë që bartin në vete këto profesione, përsëri paga është shumë e vogël. Nëse bëjmë një përmbledhje të gjithë kësaj, të jesh punëtor në Kosovë është shumë e vështirë, pasi që në fillim ke problem të punësohesh, nëse punësohesh, e ke problem të paguhesh me kohë, e nëse paguhesh, e mban dert pra në mos po të largojnë nga puna e për orarin e punës të mos flasim fare, sepse për këtë e kanë ditur qysh në fillim, sepse ua kanë thënë në intervistë. Prandaj, ky shtet, kjo Republikë, duhet të krijojë mekanizma që një herë e përgjithmonë t'u thotë 'ndal' bizneseve të lara me gjakun e punëtorëve të pambrojtur, duhet të ndalet robëria e këtyre korporatave që ua bëjnë punëtorëve dhe një herë e përgjithmonë pra duhet t'i themi 'mjaft' degradimit të dinjitetit të qytetarëve dhe të punëtorëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Partia Socialdemokrate, nuk ka. Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, zonja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Të nderuar kolegë deputetë!

Është më se e vërtetë që ka kaluar një vit kur ne kemi diskutuar gjerë e gjatë në një debat të thirrur po me të njëjtën temë, por asnjëherë nuk është mjaft për të diskutuar për temat e njëjta, sepse çdo ditë po shohim, fatkeqësisht, edhe humbjen e jetës së punëtorëve që kryesisht punojnë në sektorin privat, që po del që edhe numri është më i madh po në sektorin privat, por po del që ky sektor është njëkohësisht edhe shkelësi më i madh i të drejtave të njeriut.

E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit është parim bazë i përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 49. E drejta e punës garantohet me këtë Kushtetutë dhe secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës. Kjo bazë paraqet një nga të dhënat më të rëndësishme ekonomiko-sociale të njeriut dhe parimin themelor të legjislacionit të punës. Një të drejtë të jashtëzakonshme për çdo individ dhe si e tillë është parakusht dhe garanci e lirë dhe e realizimit të zhvillimit të personalitetit.

Ne e përmendëm që kemi një legjislacion vërtet të shumtë, por në fakt, sa po zbatohet ai legjislacion është krejt një pyetje tjetër. Por, për të mos i përsëritur shumicën e atyre që i kanë thënë deputetët, sepse na bie që po i përsëritim edhe fjalët tona nga debati i vitit të kaluar, por me gjithë këtë kornizë legjislative, pra të mirë, Ligjin e punës dhe shëndetit në punë, siguria e punëtorëve në vendin e punës në Kosovë mbetet mjaft shqetësuese. Për të mos i përmendur rastet që fatkeqësisht i kemi të freskëta, edhe të humbjes së jetës së punëtorëve, pra, e kjo po ndodh shumë shpesh, por janë shumë e shumë lëndime të tjera të punëtorëve që nuk raportohen, edhe pse numri i atyre që janë të raportuara është shumë, shumë i madh. Megjithatë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Inspektorati i Punës do të duhej që sa më parë të dalin me raporte dhe statistika të publikuara rreth gjendjes së punëtorëve në vendin e punës. Gjithashtu,

duhet të kenë vendime të publikuara rreth institucioneve dhe ndërmarrjeve që nuk i zbatojnë kushtet e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Gjithashtu, Këshilli Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë të dalë me raporte të publikuara rreth punës së tyre apo rekomandimeve për përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Për më tepër, duhet të ketë adresë të saktë për t'u drejtuar në këtë Këshill. Por, çka po bëjmë ne si deputetë dhe çka në fund të debatit?! I kishim rekomandimet e vitit të kaluar, sinqerisht secili prej tyre është me interes të jetë prapë edhe në këto rekomandime, por në fund të fundit, a përfundon puna jonë si deputetë këtu? Nuk do të duhej të përfundojë, edhe pse nuk po jemi kritikë ndaj vetë pozitës tonë si deputetë. Në radhë të parë do të duhej që komisionet përkatëse t'i thërrasin, më herët u tha që nuk ka raportuar Inspektorati, por nuk e di se sa herë i kanë thirrur dhe pse nuk kanë ardhur, apo i kanë thirrur apo jo? Unë jam për t'u rritur numri i inspektorëve dhe jo vetëm numri i inspektorëve, por jam për t'iu rritur pagat atyre inspektorëve, krahas përgjegjësisë dhe sigurimit, pra për rrezikshmërinë.

Do të duhej gjithsesi, por krahas kësaj nënkupton përgjegjësi shumë të madhe. Dhe, kur flasim për punësimet, do të duhej prapë shembull të jetë Kuvendi i Republikës së Kosovës, të tregojmë ne si deputetë, pikërisht në këtë Kuvend, se sa supermenë punojnë në dy e tri vende të punës dhe fluturojnë prej një komune në një komunë tjetër dhe nuk janë efektivë, normal se nuk janë as fizikisht në Kuvend, por mbi të gjitha, nuk e di sa mund të jenë efektivë nëpër institucione që janë të shumta. Ishte dashur të dalë pikërisht në Kuvend me raportime të sakta se sa deputetë i kanë dy e më shumë vende të punës, nëse po flasim për punësime. Këtu nuk përjashtohet asnjë parti politike. Unë mund të flas për grupin tim parlamentar, sa unë e di, asnjë prej deputetëve tonë nuk është edhe një vend tjetër pune, sa unë di. Por, po them që secili subjekt ka dhe, fatkeqësisht, kjo është më e keqja që nuk po u japim një shembull të mirë gjeneratave, se s'po ia lejojmë mundësinë për t'u punësuar ata.

KRYETARI: Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Së pari, ideja e pesë minutave ishte brilante, meqë edhe unë pata një ide brilante sot këtu. Mendoj që kur e lexojmë pikën e rendit të ditës, ku thotë debat parlamentar në lidhje me të drejtat e punëtorëve dhe adresimin e papunësisë në Republikën e Kosovës, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, menjëherë, së paku, unë nga këndvështrimi im, e shoh që kemi ardhur sot të flasim për kornizën ligjore, përmes të cilës i rregullojmë të drejtat e punëtorëve.

Ky do të ishte kuptimi i parë i kësaj pike të rendit të ditës, por këtu çka dëgjuam? Këtu dëgjuam një pikë tjetër të rendit të ditës, sa po mbrohen të drejtat e punëtorëve, të cilat janë të

sanksionuara me kornizën ligjore? Me tetë ligje, që u tha më herët, të cilat rregullojnë marrëdhëniet e punës, punëdhënës-punëmarrës, e kështu me radhë.

Unë mendoj që në Kosovë sa i përket rregullimit të kornizës ligjore për të drejtat e punëtorëve, pak ka debat për të majtën dhe të djathtën. Kemi ligje të mira, si e majta, si e djathta, si socialdemokracia në Parlament, sikur qendra e djathtë promovojnë mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve me ligje në fuqi. Tash, këtu kemi ardhur në një pikë kur ku po flasim, a po zbatohet apo nuk po zbatohet korniza ligjore. Pra, jemi në pikën e krimit të organizuar që bëhet, që ushtrohet mbi punëtorët. Nëse të gjithë sot po e themi këtë sekret publik, se ka shkelje masive të të drejtave të punëtorëve, pra mund të vijmë në përfundim se këtu kemi një krim të shumëfishtë. Krim, se kur shkelet e drejta e një punëtori kemi krimin që i shkelet e drejta ligjore e një punëtori. Kemi në anën tjetër që ka evazion fiskal, sepse një kategori e madhe e punëtorëve punësohen pa kontrata të rregullta pune dhe ata shfrytëzohen, paratë që do të duhej të paguheshin në Trust, që do të duhej të paguheshin në Buxhet për tatimin në fitim nuk i shkojnë shtetit, pra kur ta analizosh këtë këndvështrim të shkeljes së të drejtave të punëtorëve dhe të ligjeve në fuqi, del se nuk kemi të bëjmë vetëm me aspektin human, por kemi të bëjmë edhe me krime të shumëfishta përmes mosrespektimit të ligjeve.

Unë këtu vetëm një element e pash nga rezoluta, që flet për pagën minimale dhe kontratën kolektive. Nuk pash, as nuk dëgjova një vërejtje, një kritikë, për një ligj në fuqi, përmes të cilit nuk po mundësohet ushtrimi i të drejtave të punëtorëve, nuk po u mundësohet me ligj punëtorëve mbrojtja e tyre ligjore. Duke pasur parasysh këtë që po them, mendoj që debati sa i përket aspektit të shkeljes së ligjeve duhet të ndahet nga debati për avancimin e kornizës ligjore. Nëse dikush ka diçka rreth ligjeve në fuqi, që duhet të përmirësohen, duhet të ndryshohen në funksion të përmirësimit të pozitës së punëtorëve, pa marrë parasysh a janë në sektorin privat, pa marrë parasysh a janë në shërbimin civil shtetëror, le të urdhërojnë. Kjo tjetra është proces, të cilin gjithsesi duhet ta ndjekim, duhet ta monitorojmë si deputetë zbatimin e ligjeve. Por, të gjithë jemi të vetëdijshëm që kërkon një proces, për faktin se u tha edhe nga kolegë tjerë, ka një mungesë të ushtrimit të detyrave nga sindikata.

Mos harroni, edhe njëmijë le ta kryejnë, nuk do ta mbrojnë punëtorin mjaftueshëm, nëse sindikatat e tyre të cilat janë për nga natyra të thirrur që t'i mbrojnë të drejtat e punëtorëve dhe nuk e bëjnë atë. Nëse punëtorët, saktë që kanë frikë, megjithatë nuk raportojnë shkeljet e të drejtave të tyre, do të jetë problem se si me një veprim përnjëherë do të mund t'i evitonim të gjitha këto shkelje të ligjeve.

Natyrisht, se Ministria e Punës duhet ta bëjë punën e vet, Inspektorati duhet ta bëjë punën e vet, por duhet të angazhohemi që me një vister më të madh masash, me një fushatë më të madhe, edhe deputetët, edhe Qeveria, të angazhohemi që në planin e zbatimit të ligjshmërisë të ligjeve në fuqi të kërkojmë një rezultat dhe angazhim më të madh. Faleminderit!

KRYETARI: Imet Rrahmani e ka fjalën.

IMET RRAHMANI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Thirrja e këtij debati për një temë të tillë po del që edhe nga vetë fakti i të lajmëruarve të shumtë për diskutim të jetë i rëndësishëm së veçantë dhe po merret seriozisht nga kolegët deputetë.

Duke e ditur që sot në Kosovë, përpos vështirësive shumë të shprehura për gjetjen e një pune dinjitoze gjithnjë kemi të shprehur edhe dukurinë e mosrespektimit të të drejtave të punëtorëve të garantuara me Ligjin e punës, kontratën kolektive dhe me aktet tjera, përfshi edhe kontratën e punës.

Edhe pse, u tha që ligjet në fuqi janë shumë të mira dhe në ligjin bazë, domethënë Ligjin e punës, parashihet që dispozitat të zbatohen njëjtë si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat, realiteti flet pak më ndryshe. Përderisa në sektorin publik, duhet pranuar, ka përparime, në sektorin privat ende mbetet për të punuar shumë në mënyrë që të gjitha obligimet ligjore që dalin të implementohen dhe të garantohen të drejtat e punëtorëve, të cilat, u tha këtu nga kolegët parafolës se po shkelen, duke filluar nga mosrespektimi i orarit të paraparë me ligj, deri te lëndimet që po ndodhin te distrikte të ndryshme në orar dhe lëndime trupore deri edhe me humbje fatkeqësisht të jetës. Dhe, derisa qytetari i Kosovës konsideron veten të punësuar vetëm nëse ka fatin të punësohet në sektorin publik e ndjen veten shumë të rrezikuar dhe tërësisht të nëpërkëmbur në sektorin privat, flet se ne jemi larg në implementimin e Ligjit të punës, jemi larg në garantimin e respektimit të të drejtave dhe obligimeve, që dalin në relacionin punëdhënës - punëmarrës dhe jemi larg në krijimin e mirëbesimit të këtyre partnerëve, që bashkëpunimin e fillojnë me lidhjen e një kontrate.

Lidhja e kontratës paraqet avancim, sikur kjo të ndodhte në të gjitha rastet. Por, askush nga ne sot nuk është në gjendje që të thotë një shifër përafërsisht të saktë, se sa punë bëhen nga kosovarët pa kontratë pune e si rrjedhojë sa janë shkelje e të të drejtave të punëtorëve si mungesë e kontratës.

Pra, sot kemi një situatë ku sektori privat konsiderohet i pasigurt, i padrejtë, diskriminues dhe jo i preferuar për t'u punësuar. Sot kemi një situatë ku sektori publik, edhe pse i stërngarkuar, synohet nga të gjithë. E ata që kanë pasur fatin të zënë një vend dhe të marrin një kontratë pune në sektorin publik, kontratë me afat të pacaktuar, shpejtë harrojnë dhe nuk çajnë fare kokën për përmbushjen e obligimeve që dalin nga marrëdhënia e punës, duke u bërë abuzues direkt me fatin e mirë, ose lidhjet e forta që kanë pasur për të siguruar një pagë nga Buxheti i Kosovës.

Një situatë, ku organizimi sindikal, që në të shumtën e rasteve është tërësisht i komanduar nga politika dhe Qeveria e që gati asnjëherë nuk u shërben objektivave që do të duhej të arriheshin

përmes dialogut social, shërben vetëm për të mashtruar anëtarësinë dhe për të realizuar interesa të një grupi të vogël njerëzish apo duke u shërbyer instancave të caktuara politike, sa herë që u duhen atyre.

Sot e kemi një situatë ku të gjithë rriten papunësinë e shumë biznese të mëdha e të vogla nuk mund të gjejnë punëtorë, ku shumica nuk punojnë e të gjithë kanë e të gjithë harxhojnë. Kjo është Kosova e paradoksit.

Prandaj, unë dua të jem shumë konkret dhe nëse duam që të përçojmë mesazhin se e kemi seriozisht këtë debat, propozoj që brenda rekomandimeve të futet edhe një rekomandim që do të obligojë Qeverinë të nxjerrë një vendim, i cili do të implementohet natyrisht nga instanca të ndryshme, i cili ditën e diele e cakton si ditë të detyrueshme pushimi, duke përfshirë edhe ditët e festave shtetërore.

Besoj se ky veprim sado pak do të krijonte një situatë normale, do të vendosej një rregull, do të dihej kur është pushim, do të krijohej mundësi për realizimin e të drejtës së pushimit javor, deri te zvogëlimi i diskriminimit në orar dhe puna e detyrueshme, që po ndodh çdo ditë. Unë besoj shumë, se edhe shumë pronarë biznesesh do të ndjeheshin të lumtur, sepse më në fund do të kenë një ditë kur do të pushojnë, relaksohen e të mos i mbajnë mend të biznesi dhe konkurrenca.

KRYETARI: Mërgim Lushtaku e ka fjalën.

MËRGIM LUSHTAKU: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Është biseduar mjaftë për këtë temë. Sigurisht se është temë e rëndësishme së veçantë dhe sigurisht, se secili nga ne kemi për të thënë në këtë drejtim dhe për të shtuar ndonjë propozim konkret.

Punëtorët në sektorin privat trajtohen në mënyrë të padrejtë dhe të pabarabartë. Ky është një vlerësim që është bazuar në fakte, në hulumtime dhe në shembuj, që i dimë dhe informohemi çdo ditë, kush më shumë e kush më pak. Punëtorët në sektorin privat punojnë me orar të stërzgatur e për të cilin as që bëhet fjalë të kompensohen, disa madje punojnë edhe pa kontrata pune, herë-herë edhe me pagesë jo të rregullt.

Të drejtat e këtyre punëtorëve shkelen në mënyrë flagrante nga punëdhënësit e tyre. Shkelen edhe marrëveshjet kolektive e konventat e ndryshme ndërkombëtare mbi të drejtat e punës. Ligji i punës dhe Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë nuk respektohen në sektorin privat. Institucionet dhe mekanizmat shtetëror, qofshin ato qendrore apo lokale, duhet përfundimisht të marrin masa mbi abuzuesit e të drejtave të punëtorëve në sektorin privat, të cilët me djersën e tyre nën padrejtësinë e punëdhënësve të tyre fitojnë bukën e gojës për veten dhe familjet e tyre.

Mosrespektimi i kontratës së punës në këtë sektor është faktori kyç që bën të pasigurt vendin e punës për punëtorët, sepse për një fjalë goje punëtori në sektorin privat mund të fluturojë nga vendi i tij i punës. Për çka sa ka një kontratë e cila mund të duket e bukur edhe elegante në letër, por në praktikë nuk respektohet aspak.

Në sektorin e ndërmarrësisë dhe industrisë së rëndë punëdhënësit nuk ofrojnë kushte që garantojnë mjedis të sigurisë për punëtorët e tyre. Ka raste të shpeshta kur jemi dëshmitarë se punëtorët në sektorin privat vdesin në vendin e punës, sepse ata nuk pajisen me pajisje personale të mbrojtjes në punë, u mungon mbrojtja, mungojnë trajnimet për punë që janë të rrezikshme. Kemi edhe rastet më të fundit, siç e patëm rastin e Valon Berishës, por edhe shumë të tjerë, e që nuk është vetëm faji i Inspektoratit të Punës në nivel qendror, po edhe i vetë komunave, të cilat i japin lejet e ndërtimit dhe nuk i mbikëqyrin se si zbatohet Ligji i punës.

Bashkërisht duhet të angazhohemi dhe me çdo kusht të kërkojmë disiplinimin e sektorit privat përmes respektimit dhe zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë këtë fushë. Inspektorati i Punës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe mekanizma të tjerë duhet të inspektojnë në terren dhe të zbatojnë normat e parapara për parregullsitë eventuale, të penalizojnë bizneset në sektorin privat.

Një çështje tjetër që nëpërkëmb dinjitetin e punëtorit në sektorin privat është çështja e pagës, e cila nuk është në nivelin e kënaqshëm dhe shpeshherë ndodhë që punëtorët nuk i marrin me kohë pagat e tyre. Ndër rastet tjera është ai i femrave shtatzëna, që punojnë në sektorin privat. Ka raste kur largohen nga puna para lindjes, sepse punëdhënësit s'duan që të paguajnë pushimet e lehonisë. Personalisht e konsideroj si të panjerëzishëm dhe të pamoralshme kur punëdhënësit e shefat e bizneseve në sektorin privat jetojnë në një luks, e bëjnë kokrrën e qejfit, kur çdo muaj ndërrojnë veturat dhe telefonat e tyre e në anën tjetër, punëtorët e tyre trajtohen si skllëvër.

Kjo duhet të marrë fund njëherë e përgjithmonë. Nëse ne si ligjvënës që kemi marrë votëbesimin e qytetarëve, pjesë përbërëse e të cilave janë punëtorët e sektorit privat, nuk u dalim në mbrojtje atyre me të gjitha mjetet dhe mundësitë, atëherë ne po shkaktojmë padrejtësi.

Është përmendur edhe paga minimale. Sigurisht se edhe ne si Grup Parlamentar, por edhe unë personalisht besoj se duhet të rritet rroga minimale në lartësi 250 euro minimalja. Gjithashtu mbështetja e Inspektoratit të Punës me staf mbështetës, i cili është theksuar edhe nga kolegët deputetë, mendoj edhe unë se kjo është e domosdoshme nëse duam të vëmë në fuqi zbatimin e ligjit. Besoj që ligji vetëm se është korrekt në këtë drejtim. Gjithashtu, është përmendur edhe task-forca nga vet kryetari i Parlamentit të Kosovës, pasi që edhe unë mendoj që kjo task-forcë është e domosdoshme për zbatimin...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTERSHI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

U dëgjuan shumë gjëra që nuk dua t'i përsëris, por kishte edhe vërejtje për mungesën e ministrit e diçka... edhe se nuk është teksti... Unë vetëm po them, se kërkesa për debat parlamentar është bërë më 20 prill për 1 maj, por tash ka kaluar gati një muaj e gjysmë dhe veç tash është bërë debati parlamentar. Kështu që tekstin dhe të gjitha i kanë pasur të gjithë parasysht.

Do të koncentrohem në dy çështje themelore, që kanë të bëjnë me ligjin. Ne diskutuam shumë edhe për orarin, edhe për punën jashtë orarit, edhe për mbrojtjen e të drejtave të punësuarit, që nuk zbatohet, edhe për gjrobat, për inspektoratin dhe këto ishin të gjitha gjërat që i dëgjuam, nuk po i përsëris. Unë po i theksoj dy gjëra:

1. Se problemi është te Ligji i punës. Ligji i punës që është në fuqi, në të vërtetë është krejtësisht diskriminues, sepse ky ligj edhe pse e ka fushëveprimin për të dy sektorët, në të vërtetë vlen vetëm për sektorin publik dhe jo për atë privat.

Po të shihet në nene të caktuara, për shembull ta shohim nenin 11, paragrafin 2, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka për detyrë që të bëjë mostra të kontratave të punës, që hartohen dhe u dërgohen punëdhënësve. Kjo është vetëm për sektorin publik, jo për atë privat. Unë nuk kam dëgjuar që kanë marrë mostra të tilla. Domethënë, diskriminimi është i plotë

2. Në sektorin privat në të vërtetë nuk ka thuaja se kurrfarë kontrolli. Çka është në pyetje?

Në të vërtetë, krejt Ligji i punës është i hartuar në frymën e tregut të lirë të punës, por të parregulluar, të egër dhe të karakterit liberal, diku të shekullit XVIII, XIX apo fillimshekullit XX, që nuk ka të bëjë madje as me politikën neoliberale të krijimit të kontratës së punës në vendin e punës në ekonominë dhe në tregun e një vendi të caktuar.

Pse po e them këtë? Në të vërtetë unë e marr me mend se e djathta e ka për qëllim deregulimin ekonomik, mirëpo deregulimi ekonomik nuk nënkupton edhe diskriminimin e plotë midis sektorëve të punës e kjo është bërë me Ligjin e punës në Kosovë. Për ta ilustruar më së mirë këtë diskriminim ideologjik dhe mangësinë që bartë edhe Ligji i punës bashkë me Udhëzimin administrativ unë po ndalem vetëm te rrogat minimale për të treguar se ky është një ligj krejt diskriminues, liberal domethënë, i fillimshekullit 18-19, po ndalem te neni 57 te pagat minimale.

Dëgjoni kriteret se si rregullohet paga minimale.

1. Në paragrafin 2 thotë: “Kostoja e shpenzimeve jetësore që ka karakter social...” dhe pastaj vjen, thotë: “te përqindja e shkallës së papunësisë, gjendja e përgjithshme në tregun e punës dhe shkalla e konkurrencës dhe produktivitetit në vend”. Këto të tri kriteret e mëvonshme janë kritere liberale, madje as liberale, sepse nuk kanë të bëjnë asgjë me shtetin ligjor edhe nëse këto të tri kritere merren parasysh edhe caktohet paga minimale, unë mendoj se kurrë kjo pagë minimale në Kosovë nuk do të rritet, sepse përjashton të gjitha kriteret sociale dhe të një barazie sociale e një shpërndarje të drejtë në një shoqëri të civilizuar dhe ligjore.

Prandaj, unë propozoj që në mesin e masave të ndryshme ky Kuvend dhe Qeveria e Republikës së Kosovës të marrë Ligjin e punës si ligjin bazik, që është bazë për të gjitha ligjet tjera, ta rregullojë dhe ta bëjë të obligueshëm për të dy sektorët në masën e njëjtë. E këtu mandej luajnë rol të gjitha institucionet publike në Republikën e Kosovës, sidomos Inspektorati i punës i cili kontrollon këtë. Faleminderit!

KRYETARI: Daut Haradinaj. Nuk është. Atëherë, kthehemi prapë te LDK-ja, Korab Sejdiu.

KORAB SEJDIU: Të nderuar qytetarë,

Kryetar dhe kolegë të nderuar që kemi mbetur këtu,

Ne po diskutojmë sot një çështje shumë të ndjeshme, veç pak një kritikë lidhur me temën për këtë debat parlamentar, sepse unë besoj që është pak si temë e gjerë, ngërthen në vete dy çështje edhe pse të ndërlidhura, që janë tejet të rëndësishme me u adresua ndaras nga njëra tjetra.

E para, po flasim për të drejtat e punëtorëve dhe po shpresoj që nënkupton edhe sa zbatohen ato të drejta dhe e dyta, çështja e papunësisë. Më lejoni fillimisht të adresoj të parën, që ka të bëjë me atë se çfarë të drejtash dhe sa respektohen të drejtat e punëtorëve në Republikën e Kosovës. Unë nuk besoj që mund ta diskutojmë këtë çështje edhe gjendjen e rëndë në të cilën gjendet ky sektor, pa i analizuar arsyet dhe shkaqet që e kanë prurë punëtorin në Republikën e Kosovës në këtë gjendje.

E para është rregullativa ligjore. U përmendën disa ligje, por vlen të potencohen dy që janë pak më të rëndësishmet, besoj, Ligji i punës dhe Ligji për Inspektoratin e punës, të cilat si kornizë ligjore kanë të meta të shumta. Dëgjova kur thanë se janë ligje të mira, po në fakt në vete për ata që kanë punuar me këto ligje e kanë parë shumë qartë, që përkundër faktit që është kaluar një kohë e gjatë duke i hartuar ato kanë mbetur të meta jashtëzakonisht të mëdha, të cilat keqpërdoren nga të gjithë ata që synojnë t'i keqpërdorin këto ligje, përfshi këtu edhe punëdhënësit edhe punëtorët.

Dhe, po flasim për rregullativë ligjore e cila përveç faktit që ka të meta natyrisht edhe nuk është duke u zbatuar. Mund të them se nuk është duke u zbatuar në mënyrë uniforme tek punëdhënësit edhe tek punëtorët e veçantë, varësisht se për kë bëhet fjalë. Arsyetja pse nuk ka batim uniform

dhe nuk ka zbatim të plotë të kësaj rregullative ligjore është pikërisht inspektorati i punës. Dëgjova sot që kemi nevojë për më shumë inspektorë. Edhe kjo qëndron, por inspektorë çfarë i kemi aktualisht, në fakt do të duhej të kishim edhe më pak, sepse inspektorati i punës ashtu si qëndron është një rrjet i kriminalizuar, i cili merret me “miza”, mirëpo lejon që të kalojnë “elefantët”. Kjo tërësisht me qëllim që të përdoret edhe Ligji për inspektoratin e punës, edhe Ligji i punës edhe ligje tjera të aplikueshme si pretekst, jo për të mbrojtur punëtorët në vendin tonë, por për të shfrytëzuar si mundësi për zhatje të punëdhënësve dhe ndërmarrjeve të ndryshme në Republikën e Kosovës dhe për keqpërdorimin e pozitës së tyre zyrtare për pasurim personal.

Ka një numër të madh prej tyre të cilët i shantazhojnë dhe i kushtëzojnë bizneset, që ata vetë t’ua hartojnë dokumentacionin e nevojshëm vetëm e vetëm që t’u shmangen gjobave të ndryshme. Ka sosh që lëshojnë vendime preliminare, të cilat i tërheqin pastaj, vetëm pasi që u kërkojnë miton atyre subjekteve të cilat janë në anën e kundërt të ligjit. Arsyeja pse lejohet kjo shkelje kaq drastike dhe ky mosfunksionalizim dhe moszbatim i ligjit dhe të drejtës së punës nga Inspektorati një pjesë e fajit bie edhe tek gjyqësori, sepse sfida e vendimeve të inspektoratit merr një kohë jashtëzakonisht të gjatë.

Edhe kontestet e punës, të cilat edhe pse konsiderohen prioritare marrin vite të adresohen që të adresohen nga gjykatat tona, janë pikërisht arsye pse shpeshherë edhe punëtorët po edhe punëdhënësit janë të dekurajuar që t’i ndjekin të drejtat e tyre nëpër institucione gjyqësore. Një çështje tjetër, ose një problematikë tjetër ka të bëjë me sindikatat, të cilat janë të politizuara dhe nuk janë në përfaqësim të punëtorëve por të interesave të tyre të ngushta, si dhe sektori publik që është një temë tërësisht tjetër, ku që nga konkursi e deri tek çdo veprim tjetër ka shkelje të dukshme të drejtave të punës. Ne këtu duhet të vendosim se çfarë mund të bëjmë në këtë drejtim.

Në anën tjetër, nuk dua të flas për papunësinë, sepse do të duhej të kishim një qeveri e cila është partnere e denjë e opozitës, gjë që nuk është, prandaj edhe nuk mund të flasim me ata, as për ide për sundim të së drejtës, zhvillim ekonomik, zhvillim në arsim, e kështu me radhë. Do të presim derisa të jetë këtu edhe Kabineti qeveritar që t’i japim idetë tona. Faleminderit!

KRYETARI: Luljeta Veselaj-Gutaj e ka fjalën.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë që po na përcillni në këto orë të vona,

Trajtimi i një çështjeje të një rëndësie të veçantë, siç janë të drejtat e punëtorëve dhe papunësia në vend mbetet sfida. Problemi kryesor në sferën e ushtrimit të marrëdhënieve të punës kryesisht në sektorin privat dhe atë në sektorin e hotelarisë, ndërtimit, tregtisë e industrisë, vazhdon të jetë problem më vete.

Punëtorët të cilët janë pjesë e këtyre sektorëve ballafaqohen me probleme të ndryshme, duke filluar nga puna që e bëjnë pa kontratë, punë jashtë orarit të paraparë me ligj, dhënie jo e rregullt e pagave, pamundësia për të përdorur pushimin vjetor, javor, si dhe pushimin mjekësor. Për shkak të shkallës së lartë të papunësisë në Kosovë punëtorët në sektorin privat janë të gatshëm të pranojnë me vetëdije kompromise të ndryshme, ku shpesh e kanë edhe burimin e vetëm të ekzistencës familjare.

Ata shpesh janë të detyruar të punojnë me orar të stërzgjatur, të punojnë edhe gjatë ditëve të pushimit, edhe të dielave, edhe gjatë festave dhe kjo punë të mos evidentohet nga punëdhënësit e tyre.

Trajtimi i pabarabartë në baza gjinore fillon nga niveli i pagesës, ku shpesh kemi parë dhe kemi dëgjuar kur një grua e bën punën e njëjtë me një burrë dhe nuk kanë paga të njëjta. Mënyra e trajtimit jo të drejtë të grave në vendet e punës, largimet joligjore nga puna, mosdhënia e mundësive për aftësime profesionale dhe avancim në punësim.

Po ashtu sfidë dhe problem në vete mbeten ngacmimet seksuale në vendet e punës, edhe në sektorin publik, edhe në sektorin privat.

Edhe pse me legjislacion të punës parashikohen standardet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në një vend të punës, si dhe përcaktimi i përgjegjësive dhe detyrimeve të punëdhënësit lidhur me të drejtat e punëtorëve, situata në vend nuk është e kënaqshme.

Ne jemi dëshmitarë të rritjes së numrit të aksidenteve në vendet e punës, për shkak të mosrespektimit të standardeve të sigurisë. Inspektorati i Punës është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të diapozitivave ligjore dhe nënligjore në fushën e punës.

Pra, mbikëqyrja inspektuese duhet të veprojë në parandalimin e këtyre problemeve në fushën e punës. Po ashtu mendoj që nga bashkëpunimi më i thellë i sindikatave që merren me çështjet e punës dhe Inspektoratit të Punës, të angazhohen bashkërisht në forma të ndryshme që të arrijnë zbatueshmërinë e ligjeve, të cilat sigurojnë të drejtat e punëtorëve në sektorin publik dhe në sektorin privat. Faleminderit!

KRYETARI: Drita Millaku e ka fjalën.

DRITA MILLAKU: Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Çështja e trajtimit të të drejtave të punëtorëve në vend, si në sektorin publik, ashtu edhe në sektorin privat, është temë mjaft e ndjeshme, duke marrë parasysh realitetin ku jetojmë, pasi që mjaft mirë dihet që kundër shkallës së lartë të papunësisë në vend, edhe ajo pjesë e shoqërisë dhe

e qytetarëve e cila e gëzon një vend pune, është mjaft e diskriminuar sa i përket aspektit të të drejtave dhe kushteve minimale që duhet t'i gëzojë në vendin e tij të punës.

Hulumtimet e shumta të bëra nga agjencitë e ndryshme dhe shoqëri të ndryshme pasqyrojnë një gjendje mjaft të brishtë socio-ekonomike, duke vënë një theks të veçantë të shifrave mjaft të larta të personave të papunë dhe atyre që janë në kërkim të një pune.

Po ashtu duhet potencuar se edhe pjesa tjetër e qytetarëve që janë të punësuar në të dy sektorët, sidomos në atë privat, në shumicën dërmuese të rasteve trajtohen në mënyrë të pabarabartë dhe të padinjitetshme nga pronarët e tyre, ata mbingarkohen me orë shtesë pa pagesë dhe pa kontrata të punës, pra nuk respektohet Ligji i punës.

Realiteti i krijuar në vend le të besosh se liberalizimi i vizave ka mbetur e vetmja shpresë jo vetëm për qytetarët tanë, po edhe për vetë këtë Qeveri, e cila shpreson shumë që premtimet e saj të bëra gjatë fushatës elektorale t'i realizojë përmes Perëndimit, pasi që e di mirë që nuk ka as vullnet, as kapacitet e as forcë për të bërë shumë në këtë drejtim.

Çështje tjetër e një rëndësie mjaft të veçantë duhet përmendur edhe ish-punëtorët e ndërmarrjeve shoqërore, të cilët me privatizimin e tyre të ndërmarrjeve tani bredhin rrugëve dhe nuk kanë as më të voglën shpresë për t'u punësuar apo mbështetje institucionale, pasi që shumë mirë dihet se kjo kategori ka qenë edhe kontributdhënëse shumë dekadave të kaluara. Kontribute të cilat janë grabitur nga regjimi i atëhershëm serb i viteve të '90-ta.

Kjo kategori, përveç që e ka gëzuar vetëm një shumë solide prej 20%, e disa prej tyre as ato, që është dhënë vetëm prej Agjencisë së Privatizimit, asgjë tjetër nuk ka arritur të gëzojë nga ky proces mjaft i dëmshëm i privatizimit që ka ndodhur në ekonominë e Kosovës.

Shumica dërmuese e këtyre punëtorëve të ish-ndërmarrjeve shoqërore gjenden mbi të 50-at dhe larg gëzimit të pensioneve të tyre, të cilët ballafaqohen me vështirësi të shumta edhe në pamundësi për të pasur një punë të vetme, nuk është vetëm sfidë e atyre familjeve.

Mirëpo realiteti se çfarë ka ndodhur nga ky proces është mjaft i dhimbshëm, sepse shumica dërmuese e këtyre aseteve, të cilat përdoren si qendra tregtare, e disa prej tyre janë stërshitur dhe përdoren si troje për banim, duke mos pasur as mundësinë më të vogël të jenë profitabile për hapjen e vendeve të reja të punës.

Se sa janë të diskriminuar punëtorët jo vetëm në sektorin privat, por edhe në atë shtetëror, unë do ta ilustroj vetëm një rast.

Dihet që gjatë tetë muajve të fundit në Policinë e Kosovës, në rajonin e Prizrenit, kanë vdekur 6 policë dhe, sipas hulumtimeve, dy prej tyre kanë vdekur si pasojë e padrejtësive që janë bërë ndaj tyre.

Rasti i fundit ishte i Nazmi Jahirit, i cili është përjashtuar nga puna vetëm e vetëm pse e ka dënuar një ministër dhe si pasojë e kësaj gjendjeje, ai ka pësuar një paralizë dhe para dy muajsh ka ndërruar jetë.

Nuk është vetëm ky rast, por ka shumë raste edhe në institucionet publike, po edhe në institucionet private, të cilët vdesin punëtorët dhe askush nuk jep llogari. Faleminderit!

KRYETARI: Mirjeta Kalludra e ka fjalën.

MIRJETA KALLUDRA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ne sot po zhvillojmë këtë debat parlamentar për një temë të një rëndësie të veçantë, e cila pothuajse prek çdo qytetar të Republikës së Kosovës, si ata që janë të punësuar e që ballafaqohen me mosrespektim të të drejtave të tyre, po ashtu prek edhe pjesën tjetër të qytetarëve, të cilët nuk kanë mundësi të gjejnë një vende të punës.

Edhe përkundër faktit se kemi deklarime të shpeshta, edhe nga mediat, edhe organizata të ndryshme se shkelja e të drejtave të punëtorëve po vazhdon e po keqësohet për çdo ditë, duke mos u ofruar fare kontratë pune, si dhe puna zgjat deri në 12 orë brenda një dite.

Punëtorët nuk kompensohen për punën që kryejnë jashtë orarit të rregullt të punës, u mohohet e drejta e shfrytëzimit të pushimit javor dhe vjetor, e që është shkelje e së drejtës për pushim, mosrespektim i pushimit të lehonisë, ndërprerja e marrëdhënies së punës nga punëdhënësi pa paralajmërim. Paga më të vogla se pagat minimale, po ashtu shpeshherë duke iu nënshtruar edhe presionit të punëdhënësit lëshojnë vendin e punës.

Pra, të gjithë po deklarojmë se është evidente se në Kosovë shkelen të drejtat e punëtorëve, kushtet e punës, siguria dhe shëndeti në punë janë ndër brengat kryesore të çdo punëtori. Niveli i ulët i sigurisë në punë, por edhe pakujdesia janë identifikuar si faktorë që kanë ndikuar nga viti në vit të rritet numri i të vdekurve në vendet e punës.

Sipas statistikave nga 1 janari 2018 e deri më sot kanë humbur jetën gjashtë punëtorë në vendet e tyre të punës. Vdekje dhe lëndime të punëtorëve në vendet e punës kryesisht kanë ndodhur në sektorin e ndërtimit. Pra, në pesë vjetët e fundit kanë humbur jetën në vendin e tyre të punës mbi 70 punëtorë.

Ndërkaq mbi 250 të tjerë janë lënduar, ky numër mund të jetë shumë më i madh, sepse ka shumë raste të lëndimeve dhe vdekjeve në punë, e që nuk raportohen fare, kjo është shumë e rëndë dhe shumë shqetësuese për institucionet e Kosovës dhe urgjentisht duhet të merren hapa konkretë për parandalimin e fatkeqësive të tjera.

Të drejtat e punëtorëve vazhdojnë të shkelen, edhe pse në aspektin ligjor të drejtat e tyre mbrohen me ligj, edhe përkundër që kemi ligje të mjaftueshme, të cilat janë miratuar në Kuvend, mirëpo si duket, interesimi që të kemi respektim të të drejtave të punëtorëve dhe siguri në punë nuk është i mjaftueshëm.

Duke mos u angazhuar për zbatimin e Ligjit të punës, e që moszbatimi i tij është kontribuuesi kryesor për rritjen e informalitetit në ekonomi dhe në të njëjtën kohë sponzoruesi kryesor i shkeljes së të drejtave të punëtorëve. Informaliteti në ekonomi, në njërin anë, krijon bazë për shkeljen e të drejtave të punëtorëve, kurse nga ana tjetër, dëmton buxhetin e Kosovës, kjo nënkupton më pak buxhet për zhvillimin ekonomik, më pak buxhet për arsim, më pak buxhet për pensione, më shumë raste sociale, më pak ndihma sociale, më pak inspektorë dhe, në fund, përsëri më pak të drejta për punëtorët dhe më pak punëtorë në tregun e punës.

Kurse sa i përket çështjes së papunësisë në Kosovë, e cila është shumë e lartë, në këtë rast do të veçoja se papunësia e grave dhe e të rinjve është një nga problemet më të mëdha të Kosovës, të dhënat tregojnë se shkalla e papunësisë është mbi 30%, kurse papunësia te të rinjtë është 60%.

Shqetësuese mbetet shkalla e lartë e aktivitetit të grave, ku 80% e grave në moshë nuk janë aktive në tregun e punës. Niveli i lartë i papunësisë ndikon direkt në mirëqenien sociale të tyre.

Unë kërkoj nga Qeveria e Kosovës që të punojë më shumë në krijimin e mundësive për rritjen e punësimit të grave si dhe të rinjve, në zhvillimin e aftësive dhe kompetencave, bazuar në kërkesa të tregut të punës. Të zhvillojë programe për punësim dhe ndërmarrësi, përfshirë krijimin e mundësive për punësimin e të rinjve, duke ofruar trajnime për zhvillimin e shkathtësive jetësore që të përgatiten për tregun e punës.

Gjithashtu të rinjve duhet t'u ofrohen trajnime për edukim dhe aftësim profesional, kjo do të arrihet duke krijuar programin në bashkëpunim me institucionet relevante, në mënyrë që të ndikojnë drejtpërdrejt në punësimin e të rinjve si dhe të krijohet një fond për përkrahjen e të rinjve.

Me qëllim të rritjes së punësimit te kategoria e grave dhe të rinjve, të zhvillohen programe për punësim...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Flora Brovina e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Faleminderit!

Sot po debatojmë për një temë shumë popullore, por njëherësh edhe shumë të rëndësishme sa u përket të punësuarve, qoftë në sektorin publik, qoftë në atë privat.

Debati vërtet ishte dedikuar për festën e punëtorëve, 1 Majin, por aq më mirë që po debatojmë sot më të relaksuar dhe këtu gjerësisht u përmendën shumë çështje që vërtet janë.

Po, ka shkelje të të drejtave të punëtorëve në Kosovë, ka edhe ligje, sikur edhe u tha, janë mjaft të avancuara dhe të mira që u garantojnë të punësuarve të drejtat e tyre.

Kam qenë ndër deputetët që i jam gëzuar shumë Ligjit të punës, sepse kur u aprovua ky ligj, ka qenë një e arritur e madhe për Kosovën, një ligj shumë i mirë, i cili vuri rend për herë të parë në të drejtat dhe obligimet e punëtorëve, qoftë në sektorin, qoftë në atë privat.

Por, pas sa vjetësh, gjatë monitorimit parlamentar shohim se ky ligj tanimë ka nevojë për plotësim-ndryshim, ka nevojë për gjetjen e mundësive që të përmirësohen këto shkelje që u bëhen çdo ditë punëtorëve, sidomos në sektorin privat dhe sidomos në disa sektorë të veçantë që u përmendën, siç janë ndërtimtaria, po edhe sektorë të tjerë.

Gjithashtu gjatë monitorimit u pa se dy pikat më të dobëta, këto janë ligje që dalin nga Ligji i punës, Ligji i Inspektoratit të Punës dhe këtu do të veçoja numrin shumë të vogël, joadekuat të të punësuarve, i cili kurrësi me këtë numër të vogël të inspektorëve nuk mund t'i dalë në ballë monitorimit ose kontrollimit të të drejtave të punëtorëve dhe obligimeve që ata kanë drejtë punës.

U pa gjithashtu se ndihet shumë i nevojshëm sigurimi shëndetësor në punë.

Fuqizimi i Këshillit Ekonomiko-Social, për të cilin kemi menduar se do të jetë strumbullari, i cili do t'i emërojë gabimet dhe do t'i korrigjojë të gjitha ato gjëra që u përmendën edhe në këtë diskutim të gjatë, do të jetë ai i cili do të jetë i zëshëm, qoftë në mbrojtjen e punëdhënësit, por sidomos sa i përket mbrojtjes së punëtorëve ka nevojë për fuqizim, sidomos për rolin e sindikalistëve dhe kjo është ajo pika më e rëndësishme sa i përket mbrojtjes institucionale, e cila do t'i evidentonte të gjitha të metat që ndodhin, përveç pra inspektorit. Këshilli Ekonomiko-Social është ai ku do të debatoheshin veç e veç sektorët e ndryshëm, të drejtat e punëtorëve, por edhe të punëdhënësve sa u përket institucioneve shtetërore.

E kemi evidentuar edhe si parlamentarë se ka shkelje dhe diskriminim në punë, pra shkelje të Ligjit kundër diskriminimit. Këtu u fol për taks-forcën, kujtoj që Komisioni për Punë dhe

Mirëqenie Sociale është taks-forca parlamentare, e cila e monitoron, por mund të marrë edhe obligime shtesë nga Parlamenti që edhe të raportojë për punën që e bën sa i përket monitorimit të ligjeve që dalin, pra prej Ligjit të punës dhe mbrojtjes shëndetësore të punëtorëve. Në kuadër të kësaj, këtu u fol edhe për Ligjin që është në procedurë, Ligjin për ndërmarrjet sociale. Nuk pres që do të bëhet një çudi e madhe në përmirësimin e të punësuarve, ose punëtorëve me këto ndërmarrje, por e konsideroj që është një ndër ligjet shumë të rëndësishme dhe që ka pasur sukses në shtetet ku ai funksionon, por njëherësh e di se të gjitha shtetet e regjionit kanë pasur edhe probleme derisa e kanë amendamentuar dhe derisa e kanë aprovuar këtë ligj...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Salih Zyba e ka fjalën.

SALIH ZYBA: Përshëndetje, qytetarë të dashur!

Të pranishëm deputetë,

Unë do ta tërheq fjalën time nga ky diskutim, por është e pashmangshme t'u referohem dy folësve të mëhershëm. Së pari, kryetarit të Kuvendit, i cili në fjalën e tij i ftoi qytetarët, ankuesit që në mënyrë anonime apo konfidenciale t'i paraqiten Kuvendit me ankesat e tyre. Kjo ftesë, kjo thirrje, përveç që nuk është ligjore, është e rëndë që qytetarët apo të dëmtuarit të shpresojnë në një institucion që nuk është kompetent, siç është në këtë rast Kuvendi, mirëpo janë institucionet tjera.

Ndërsa folësi tjetër është Shkumbin Demaliaj, i cili e përshkroi se për të gjitha këto nevoja janë të përfshira ligjet, e në këtë rast e përjashtoi apo e mohoi, ose e zhvlerësoi një rezolutë si me rëndësi, mirëpo ky megjithatë tha se për inspektorët për të cilët u konstatua këtu se mungojnë si staf profesional dhe si nevojë e këtij sektori, tha se ku të gjenden mjetet për t'i paguar inspektorët. Meqenëse i njëjti, në këtë rast Shkumbin Demaliaj ka qenë kryeinspektor për një periudhë para pak vjetësh, i njëjti do të duhej më së miri të dinte se inspektorët në funksion të kontrollit krijojnë jo vetëm për vete dhe për drejtorinë e vet, apo në këtë rast Agjencinë e Ministrisë së Punës, por krijojnë edhe të hyra për shtetin, duke pasur për bazë konkludimin e secilit prej folësve se po shkelen të drejtat dhe liritë e njeriut nëpërmjet punës dhe punësimit.

Ndërsa meqenëse u fol shumë për sektorin privat, edhe sektori publik nuk është që është më mirë, mirëpo këtu po e bëj një dallim, pra po veçoj diçka. Meqenëse për shërbyesit civilë është një komision që mbikëqyr ose që i pranon ankesat, shqetësimi im është për stafin politik, staf i cili së shpejti për kah numri do ta kalojë numrin e sektorit të stafit civil, domethënë stafi politik me këtë qeverisje në këtë mënyrë. Mirëpo, e konsideroj të nevojshme, sepse në seancat e ardhshme duhet të ketë raportim ashtu siç e ka paraparë kjo rezolutë kaheër para sa muajve dhe nëse aprovohet rezoluta e radhës e Lëvizjes Vetëvendosje. Prandaj, unë do ta ndërpres këtu, sa për argument për kryesuesin, në këtë rast kryetarin e Kuvendit, meqenëse bëri thirrje, unë sot e

kam pranuar një ankesë prej një qytetari, ankesë të cilën mund ta lexoj, por s'kam të drejtë as ta shqyrtoj, e as të adresoj më tutje, sepse nuk është kompetencë e jona. Ndërsa për folësit e tjerë i përgëzoj ata që gjetën vërejtje. Mirëpo, vërejtjet e mia për këtë ligj që nuk po zbatohet do ta kem rastin, do ta gjej çdo mundësi që nëpërmjet pyetjeve parlamentare për ministrin përkatës, jo vetëm ai i Punës, por i gjithë stafi - Kabineti ka munguar sot gjatë gjithë ditës.

KRYETARI: Urdhëro, Shkumbin!

SHKUMBIN DEMALIAJ: Nuk është temë e replikës kjo çka e tha kolegu deputet, por e kisha lutur që kur të shkojë në shtëpia ta dëgjojë fjalimin tim edhe një herë. Nuk e kam anashkuar, nuk e kam nënçmuar rezolutën, përkundrazi i kam dhënë fuqi politike që edhe rekomandimet shtesë që mund të ofrohen nga të gjitha grupet parlamentare të futen në atë rezolutë dhe t'i drejtohen Qeverisë për implementim. Kjo ishte fjala atje, se ku kemi punuar më herët nuk është me rëndësi, por e kisha lutur kolegun të shkojë, se s'e di a ka qenë në seancë kur kam folur, por të shkojë ta dëgjojë edhe një herë fjalimin tim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Prapë kundër-replikë, a po afër iftari, hajt!

SALIH ZYBA: Mirë, do të duhej të parashiheshin edhe pauzat, përkundër fjalimit që e tërhoqa. Unë parafolësit tash i bëj me dije se isha i pranishëm, isha edhe mjaftueshëm vigjilent për të kuptuar edhe qëllimin dhe kundërshtimin që e bën i njëjti, mirëpo ia rikujtoj se gjatë kohës kur i njëjti ka punuar nuk paraqiti diçka ndonjë ndryshim, përveç që e tha që në 2007 e tha një numër të inspektorëve atëherë, po për mua ai numër ka rënë me një arsye, sepse disa prej këtyre zyrtarëve, inspektorëve në këtë rast, janë gjetur shkelës të ligjit dhe të korrumpuar për ç'gjë ende nuk ka mundur as t'i plotësojë ato vende, e lëre më ta shtojë numrin kjo Qeveri.

Jua rikujtoj se si Vetëvendosje në fushatën për këtë mandat që e kemi, kemi pasur në planin tonë në alternativën tonë qeverisëse për dyfishimin e inspektorëve, në këtë rast edhe trefishimin si mundësi me qëllim për ndryshim kësaj mendësie të qeverisjes.

KRYETARI: Muharrem Nitaj, fjala për ju. Edhe dy deputetë i kemi pastaj.

MUHARREM NITAJ: Kryetar!

Nuk është që zoti Zyba e tërhoqi fjalën e tij, realisht gati e shfrytëzoi gjithë kohën e mbetur, unë po provoj që të mos e shtyj këtë debat për shkak se e kemi paralajmëruar përfundimin e kësaj seance përpara iftarit.

Pjesa më e mirë e këtij debati, mund të vërej se është fakti që po përfundon. Realisht, mund të imagjinoj, disa prej debutuesve për këtë temë, gjithsesi të rëndësishme, i japin formulime të tipit - është një temë populiste dhe njëkohësisht të rëndësishme, nuk e kuptoj si mund të jetë, ose

dikush tjetër thotë për shembull duhet të jemi të efektshëm dhe efikas, një tjetër thotë se liberalizimi i vizave është shpresa e fundit për njerëzit, për qytetarët e Kosovës, por nuk është liberalizimi shpresë e askujt për punësim. Realisht, ka një mijë e një arsye që të konstatojmë se janë shkelur të drejtat e punëtorëve dhe dyfishi i tyre për ata që nuk e kanë mundësinë që të jenë të punësuar, por unë nuk po arrij të kuptoj se çka po pretendojmë ne deputetët e Kuvendit të Kosovës me debatin e sotëm. Nëse ka pasur një rezolutë vitin e shkuar, që është miratuar, dhe disa prej kolegëve që kanë qenë pjesë e legjislaturës së kaluar po thonë se teksti i saj ka qenë shumë i rëndësishëm dhe shumë i mirë, atëherë ç'kuptim ka debati dhe një rezolutë tjetër, apo në fakt debati i sotëm është kërkesa për miratimin e një rezolute mbi rezolutën, e cila nuk qenka zbatuar nga viti i shkuar. Faleminderit!

KRYETARI: A të përmendi, Salih? E përmende, Muharrem? Ok! Urdhëro, fjala për ju zoti Zyba, për replikë! Regjia, Salih Zyba e ka fjalën!

SALI ZYBA: Zoti Nitaj, nuk besoj që e di se çka kam pasur për të fol në fjalim. Unë e thashë fjalimin tim drejtuar këtij Kuvendi në mënyrën dhe përgjegjësitë që i kanë në këtë rast ministri dhe Qeveria. Kam pasur edhe pyetje, edhe diskutim, ndërsa u tërhoqa prej parafolësve për të cilët pata shqetësim për mënyrën sesi diskutuan.

KRYETARI: Kundër-replikë!

MUHARREM NITAJ: Kur e dëgjova që do ta tërheqë fjalën, isha i lumtur se thashë nuk po e shpenzon kohën. I shpenzoi katër minutat e tij. Këtu e kisha fjalën.

KRYETARI: Faleminderit! Edhe dy deputetë i kemi për arsye se jemi afër iftarit, po i kryejmë edhe këta dy, pastaj do ta vazhdojmë nga ora 21:30. Hykmete Bajrami!

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

U tha shumëçka, unë do të flas shkurt, do të përpiqem në përgjithësi që të flas për dy-tri gjëra, të cilat nuk janë diskutuar.

Nepotizmi në sektorin publik, investimet e vogla në sektorin privat dhe mungesa e investimeve të huaja direkte kanë ndikuar që papunësia të jetë shumë e madhe. U përmendën kryesisht dy faktorë pse e kemi një gjendje të tillë të shkeljes së të drejtave të punëtorëve, një papunësi të lartë dhe pse në përgjithësi edhe institucionet publike dhe ato private sillen në mënyrën qysh sillen karshi punëtorëve të tyre. Unë bëj përgjegjës edhe për papunësinë, edhe për mosimplementim të ligjeve në të dy rastet shtetin dhe Qeverinë, sepse është krijimi i një ambienti më të mirë të biznesit, që nënkupton edhe zbatim të ligjeve, e cila kishte për të ndikuar në krijimin e vendeve të reja të punës dhe në implementim të ligjeve, gjithsesi edhe atyre që i trajtojnë të drejtat e

punëtorëve në vendin e punës. Unë e përshëndes Lëvizjen Vetëvendosje për iniciativën e tillë, për thirrjen e një debati të këtillë me një temë shumë të qëlluar, me të gjitha, po besoj që pa dashje debati i sotëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës u kthye në debat - Kuvendi kundër sektorit privat. Dhe, unë po besoj që as qëllimi i iniciuesit të debatit dhe as deputetët e asnjë grupi, me përgjegjësi të plotë flas këtu për deputetët e Grupit Parlamentar të LDK-së, qëllimi nuk ka qenë ky. Ne nuk jemi kundër sektorit privat, janë 400 mijë punëtorë që u tha që sot punojnë në 65 mijë ndërmarrje të vogla, të mesme dhe të mëdha në sektorin privat, 220 mijë prej tyre janë sipas Agjencisë së Statistikave dhe 30% prej tyre kanë kontrata afatgjata.

Domethënë, janë 400 mijë familje sot, të cilat ushqehen pikërisht nga sektori privat dhe ne duhet të jemi mirënjohës dhe përpos trajtimit të çështjeve që i kemi diskutuar sot duhet të diskutojmë se çka në fakt po bëjnë institucionet për përmirësimin e ambientit të biznesit, i cili do të kishte nënkuptuar drejtpërdrejt edhe implementimin e ligjeve, siç e thashë, edhe të atyre që merren me të drejtat e punëtorëve në vendin e punës.

Të nderuar kolegë deputetë,

U përmendën aksidentet fatale, aksidenti i fundit i qytetarit nga Drenasi, i cili na ka prekur të gjithëve. Kemi edhe kompani të cilat janë shumë të përgjegjshme, të cilat i trajtojnë mirë punëtorët, të cilët i motivojnë punëtorët. Kemi edhe kompani, të cilat janë të lidhura ngushtë me partitë politike dhe me shtetin dhe u ndodhin aksidente të tilla fatale dhe shpëtojnë pa u ndëshkuar fare. Dhe, i kemi të tjerat të cilat mandej keqmotivohen prej këtyre dhe nuk e zbatojnë ligjin.

Mirëpo, ajo që nuk u trajtua sa duhet besoj janë të drejtat e punëtorëve në sektorin publik. U përmend rasti i qytetarit të Drenasit, mirëpo harruam të përmendim rastin shumë të freskët të dy policëve të cilët e humbën jetën nga aksidenti në lumin Ibër-Lepenc. Është raportuar në medie disa herë që ata në momentin e aksidentit kanë qenë në një veturë, e cila ka pasur shumë defekte. Po besoj që ne si institucione duhet patjetër që t'i trajtojmë të drejtat e punëtorëve në të gjithë sektorët, pa marrë parasysh nëse ata punojnë në sektorin publik, apo në sektorin privat.

Mandej i dimë të gjithë rastet e humbjeve të jetëve në kompaninë Bechtel&Enka, që nuk është një numër i vogël i punëtorëve. Gjithashtu i dimë edhe keqtrajtimet që ju bëhen dhe pagesat shumë minimale. Rastet e tilla të keqtrajtimet të punëtorëve ka sa të doni dhe ka padrejtësi të mëdha. Unë e kam përmendur edhe një herë tjetër që në Fakultetin Ekonomik, në të cilën ligjëroj, janë 10 mijë studentë aktivë dhe janë vetëm 22 punëtorë të Administratës, ndërkohë që në fakultete të njëjta me numër që mezi arrijnë qindra studentë ka pothuajse numër të njëjtë të punëtorëve të Administratës. Gjithashtu, kryetar i Kuvendit, është mirë që të fillojmë nga shtëpia jonë, të shikojmë shërbimin e pastrimit, gra të cilat e pastrojnë Kuvendin e Republikës së Kosovës. Kam pasur dy-tri raste, të cilat më kanë ndaluar në korridor dhe më kanë thënë që duhet ta ngrehni çështjen e trajtimit tonë nga punëdhënësi. Më besoni që nuk e di kush është

kompania, por ajo çfarë kam informata është që paguhen me një pagë më të vogël se paga minimale...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Ministre, faleminderit që e ngrite çështjen e punëtorëve të pastrimit. Jemi marrë me atë çështje, sa për dijeni nuk është kompetencë jona. Është çështje e shërbimit të jashtëm, s'ka të bëjë fare me ne, por si shqetësim jemi marrë.

Jemi marrë, për ta pasur parasysh, por kemi të bëjmë me çështjen e kontratës. Kontratën nuk e përcakton, ke qenë ministre për fat, e di këtë pjesë, as ti as unë. Atëherë, e kemi zotin Ismajl Kurteshi, varet nga mëshira e tij edhe jemi në përfundim të kësaj pjese për pauzë.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Sot këtu përfaqësues të pozitës, ish-pozitës bashkë me opozitën, po konstatojnë se gjendja e të drejtave të punëtorëve në Kosovë është shumë e rëndë dhe kërkojnë ndryshimin e kësaj gjendjeje, thujse kjo çështje është në dorën e një autoriteti të huaj, e jo në dorën e institucioneve të këtij vendi që udhëhiqen nga kjo Qeveri dhe janë udhëhequr nga qeveritë e mëhershme.

Të nderuar deputetë,

Të drejtat e punëtorëve shkelen publikisht. Kush nuk e di se në sektorin privat punëtorët punojnë me orar të zgjatur të punës pa qenë të kompensuar për punën shtesë? Kush nuk e di se shumë punëtorë paguhen më pak se të ardhurat e garantuara me ligj? Besoj se të gjithë e dinë se një numër i madh i punëtorëve nuk ka pushim të javës dhe as pushim vjetor. Të gjithë e dimë se shumë lehonave nuk u njihet e drejta në pushim të lehonisë siç parashihet me ligj. Është bërë praktikë në Kosovë që punëtorët të largohen nga puna pa arsye dhe pa paralajmërim. Mungesa e sigurisë në punë që shpesh përfundon me lëndime ose edhe vdekje të punëtorëve kalojnë me një reagim publik, por jo edhe me ndërmarrjen e masave që mund ta ndryshojnë këtë gjendje.

Inspektorë të punës mund të ketë pak, por edhe shumica e atyre ekzistues janë shndërruar në mbrojtës të interesave të punëdhënësve, e jo të mbrojtjes së interesave dhe të drejtave të punëtorëve të keqtrajtuar. Është në dorën e Qeverisë që këtë qasje të dëmshme, të shumicës së inspektorëve të punës ta pamundësojnë përmes masave legale që Qeveria i ka në dispozicion, por edhe ta rrisë numrin e tyre. Papunësia është problem jashtëzakonisht i madh në Kosovë, të papunësuarit e paraqesin kategorinë më të diskriminuar në vend. Papunësia në shkallën që ka arritur është rezultat i politikave të padrejta që kanë udhëhequr qeveritë e Kosovës njëra pas tjetrës. Me privatizimin kriminal që ka ndodhur në vend në ndërmarrjet prodhuese dhe pasuritë e tjera të këtij vendi kanë lënë papunë qindra mijëra punëtorë me të cilët nuk po merret askush.

Sa u përket gjeneratave të reja, përpjekje e vetme e kësaj qeverie dhe atyre që kanë kaluar është liberalizimi i vizave, sepse shpresën për perspektivë këtu e kanë shuar ata që e kanë udhëhequr këtë vend këtu e 15-16 vjet. Zvogëlimi i papunësisë dhe mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve është obligim i Qeverisë, Kuvendi duhet të bëjë presion mbi Qeverinë për t'i kryer punët që është obligim i saj, por në zvogëlimin e papunësisë mund të kontribuojnë edhe ata deputetë që po i mbajnë nga dy e më shumë vende pune, duke u kënaqur me një vend pune dhe të tjerat t'ua lirojnë të papunëve. Kurse, deputetët që kanë biznese duhet të japin shembull të mirë se si mbrohen të drejtat e punëtorëve, duke i respektuar të drejtat e punëtorëve të punësuar në bizneset e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Lutfi Zharku e ka fjalën.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot në Kosovë i kemi katër klasë punëtore. I kemi shërbyesit civilë, i kemi të punësuarit në shëndetësi dhe në arsim, që paguhen nga Buxheti i shtetit, por të cilët konsiderohen shërbyes publikë, i kemi të punësuarit në ndërmarrje publike dhe të punësuarit e sektorit privat.

Ky rangim apo ndarje është bërë edhe me anë të infrastrukturës ligjore që e rregullon këtë fushë. Shërbyesit civilë e kanë ligjin e tyre, i cili rregullon të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, të punësuarit tjerë, ku bëjnë pjesë të gjitha të tri kategoritë e mbetura janë rregulluar, kjo çështje rregullohet me Ligjin e punës. Më tutje, sa i përket kujdesit shtetëror dhe përfitimeve ligjore klasën punëtore mund ta ndajmë në dy pjesë: të punësuarit që përkrahen dhe mbrohen me ligj, ku bëjnë pjesë të punësuarit që marrin paga nga Buxheti i shtetit dhe të punësuarit në ndërmarrje publike dhe të tjerët ata të punësuarit në sektorin privat, të cilët nuk mbrohen me asgjë, përkundër asaj se Ligji i punës vlen edhe për këta.

Natyrisht, se kjo ndarje e klasave në kuadër të klasës punëtore karakterizohet edhe me përfitime dhe të drejta të ndryshme, që realizohen në përputhje me ligjin. Të punësuarit që paguhen nga shteti përfshirë ata në ndërmarrjet publike, i shfrytëzojnë të gjitha të drejtat që ua jep ligji e në praktikë edhe më tepër. Këta shfrytëzojnë pushim të rregullt vjetor, pushim mjekësor, pushim gjatë ditës për ushqim, kompensim për punë jashtë orarit, punë feste apo natën, pushim të lehonisë, të drejtën për ruajtjen e vendit të punës, kompensim në lartësi 50% në rast të largimit të përkohshëm edhe kur akuzohen për keqpërdorim të detyrës zyrtare, kompensim të menjëhershëm shtesë për largim kolektiv dhe paguhen 30-70% më shumë se sa të punësuarit e sektorit privat.

Në anën tjetër, shumica e të punësuarve në sektorin privat nuk e realizojnë shumicën e të drejtave që i përcakton Ligji i punës dhe për këtë edhe më keq, paguhen edhe më pak. Për ilustrim po e përmend vetëm lëvizjen e pagave neto si indikator i matshëm dhe më i rëndësishëm sa i përket mirëqenies së tyre. Kështu, pagat neto të të punësuarve në sektorin publik nga viti

2012 në vitin 2016 janë rritur prej 353 në 440 euro apo për 96 euro, që është 27%. Ato që janë në ndërmarrje publike ju ka rritur rroga për 121 euro apo për 26%, kurse punëtorëve në sektorin privat u është rritur rroga vetëm 4 euro apo 1% në periudhën 2012 - 2016 apo prej 333 në 337 euro.

Kështu në esencë Ligji i punës zbatohet dhe rregullon vetëm çështje që kanë të bëjnë me shërbyes publikë dhe të punësuar në ndërmarrje publike. Sot nuk konsiderohesh i punësuar nëse nuk je në sektorin publik. Në realitet, e gjithë kjo është pasojë e rregullimit ligjor që e kemi në këtë fushë. Ligji aktual i punës është ligj tipik socialist dhe nuk përputhet me realitetin e ekonomisë sonë. Në sektorin e punësimit në Kosovë funksionojnë dy sisteme: sistemi socialist me të gjitha të drejtat dhe pothuajse pa kurrfarë përgjegjësie, që ua jep Ligji i punës dhe sistemin kapitalist, në të cilin shteti mundohet ta implementojë ligjin socialist të punës e që është e pamundur.

Natyrisht, nuk mund të shihen zi edhe punëdhënësit, sepse është e vështirë që të zbatohen shumë dispozita të këtij ligji në sektorin privat. Duke u gjetur në këtë situatë punëdhënësit po e shfrytëzojnë të drejtën ligjore që të punësuarve të tyre t'u ofrojnë vetëm kontrata me kohë të caktuar dhe atë për afate shumë të shkurta, pa qenë ndesh me ligjin. Kjo është direkt pasojë e dispozitës në Ligjin e punës, që kontratën me kohë të caktuar, nëse zgjatë më shumë se 10 vjet e konsideron apo thjesht shndërrohet në kontratë me kohë të pacaktuar. Punëdhënësi nuk mund të pranojë që sistemimi në vende të punës apo kalimi prej një pune në një punë tjetër të jetë i rregulluar me ligj, nuk mund ta pranojë që t'ia ruajë vendin e punës një politikani i cili shkon të përfaqësojë interesat e shtetit, nuk mund të pranojë që i punësuarit ka të drejtë ta ndërpres njëanshëm marrëdhënien e punës, kurse kjo e drejtë i mohohet punëdhënësit privat, nuk mund të pranojë ta paguajë 50% punëtorin që keqpërdor mjetet e tij që ia janë besuar, derisa të marrë vendim gjykata nëse është fajtor apo jo, nuk mund të pranojë që pushimin në orar të punës ta konsiderojë punë dhe të drejtat tjera, që rëndojnë jo vetëm materialisht por edhe krijojnë vështirësi në menaxhim.

Këto janë arsye që 21,5% e të punësuarve punojnë pa kontratë, kurse kjo përqindje të të rinjtë është 46, por nëse marrim parasysh në sektorin publik pothuajse nuk ka të punësuar pa kontratë, i bie që afër gjysma e të punësuarve në sektorin privat punojnë pa kontratë. Kjo situatë do të vazhdojë derisa nuk ka nxitje për legalizim të punësimit.

Konsideroj se hap kyç në përmirësimin e situatës të të punësuarve në sektorin privat është ndryshimi urgjent i Ligjit të punës dhe i njëjti t'u përshtatet kushteve të ekonomisë së tregut. Lehtësia e hyrjes dhe daljes nga tregu i punës është faktor bazë në rritjen e punësimit. Ligji i punës duhet të jetë i thjeshtë, por që do të garantojë mbrojtje të plotë të të punësuarve duke obliguar punëdhënësin të respektojë obligimet e tij.

Masa të duhura konsideroj se janë që kontrata e punës duhet të konsiderohet edhe marrëveshja me gojë, e jo vetëm me shkrim ndërmjet të punësuarit dhe punëdhënësit dhe në rast të moskzistimit të kontratës me shkrim vlen mbrojtja e minimale e përcaktuar me ligj, obligimin që pagat t'u paguhen vetëm përmes llogarisë bankare, që do të dëshmojë nivelin dhe rregullsinë e pagesës, ndalimi i punës së personave nën moshën 18-vjeçare, pushimi i lehonisë dhe ai mjekësor t'u paguhet nga shteti, përfitimet për papunësi në përputhje me kohën e shërbimit në punë dhe përfitimet tjera të ngjashme.

Në vazhden e ndryshimeve ligjore duhet të bëhet ligji i ri për inspektoratin e punës, i cili përcakton saktë masat për respektim të të drejtave të punësuarve dhe rishikimin e gjobave, që aktualisht janë absurde në dallim prej 500-35 000 euro. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka më diskutues. Tani jemi edhe para një momenti, kur ata që i janë përkushtuar agjërimit, Zoti ua shkroftë kush e ka me shpirt. Unë në këtë pjesë e kisha bërë pauzë, Glauk, pa e biseduar pjesën e me u fut në përfundim të kësaj pike të rendit të ditës. Po ta jap edhe ty fjalën po pastaj edhe të mendojmë, kemi dy mundësi. Një vazhdim kemi mundësi, nuk është shaka, nga ora 10:00 deri në syfyr, nuk është shaka.

I kryejmë këto tri debate që janë, në qoftë se ju pajtoheni, ose duhet të shkojmë deri nesër në orën 10:00 për ta vazhduar këtë seancë. Ju e vendosni tash, shefat e grupeve parlamentare vendosin. Vetëm pak. Urdhëro Glauk, fjala... edhe jepe mendimin për vazhdim të seancës.

GLAUK KONJUFCA: Sa i përket kësaj pike, meqenëse u shter debati dhe ndodhemi në fazën e votimit, në prag të votimit, kjo duhet të shtyhet për shkak se, me sa po e shoh, edhe nuk ka kuorum Kuvendi. Do të thotë, duhet të shtyhet sepse jemi rreth 40 deputetë.

KRYETARI: Edhe, në qoftë se ka mundësi me e harmonizua tekstin e rezolutës pa e sjellë.

GLAUK KONJUFCA: Edhe ajo do të ndodhë, kështu që më së miri është që kjo të ndodh nesër, për arsye se tash deputetët do të ikin dhe unë nuk besoj se do të vijnë më shumë se që janë kaq në... Kurse, sa u përket pikave tjera, nëse pajtohen propozuesit tjerë, që i kanë debatet e radhës, atëherë varet prej tyre se a po duan ta vazhdojnë pas orës 10:00 apo qysh e dhatë ju propozimin. Unë fola vetëm për debatin e Vetëvendosjes.

Më duket që më mirë është nesër me e përfundua.

KRYETARI: Faleminderit! Memli Krasniqi në emër të PDK-së edhe për projektrezolutën e të njëjtën kohë edhe për seancë.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ne në fillim të seancës sot diskutuam që jemi mbrapa dhe u pajtuam parimisht që të vazhdojë çdo ditë seanca dhe jo vetëm ditën, por besoj se edhe në mbrëmje. Mendoj që është e mundshme që të mblidhemi e të vazhdojmë sonte pas orës 21:30.

Nuk mund të them se të gjithë deputetët do të jenë këtu. Nuk do të jenë as të Partisë Demokratike të Kosovës të gjithë deputetët, por nëse angazhohemi si grupe parlamentare bashkërisht ndoshta edhe mund ta kemi kuorumin për të vazhduar edhe për tema tjera, të cilat padyshim janë të rëndësishme. Përndryshe, ky debat ka zgjatur përfaqësisht katër orë. Janë edhe tri debate mesatarisht do të zgjasin nga katër-pesë orë edhe ato. Ndoshta të paktën edhe një debat mund ta kryejmë sonte, pastaj të gjejmë mundësi për ta vazhduar nesër, kështu sa i përket kësaj. Sa i përket projektrezolutës, besoj se duhet përfaqësuesit e secilit grup më u mbledh, siç është rëndom në praktikë dhe me tentua me e harmonizua tekstin, në mënyrë që të votohet pastaj mosharmonizimi potencial. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: I nderuar kryetar!

Për çështje të rezolutës përfaqësuesi ynë shkon në grup punues dhe besoj se e harmonizojnë, në mënyrë që nesër ta votojmë. Po, për çështje të vazhdimit të seancave, tash unë e kuptoj zotin Krasniqi që ka tendencë t'i kryejë debatet edhe me dy-tre deputetë, por qëllimi anë është që të debatojmë për këto çështje. Tash, nëse nuk mbajmë dy javë seanca dhe tentojmë që t'i mbajmë deputetët deri në mëngjes për të kryer debate sa për t'i kryer, unë mendoj se nuk është mënyra e duhur, duke e ditur se më shumë se gjysma e deputetëve edhe nuk rrinë në Prishtinë, udhëtojnë jashtë Prishtinës nëpër komunat e tyre.

Kështu që, besoj se nuk është e udhës që ne sonte të ndalemi deri në mëngjes për të kryer këto debate. Nesër e kemi Kryesinë në orën 9:00. Në 10:00 unë propozoj që ta vazhdojmë seancën, që është e caktuar për nesër në orën 10:00, ndërkaq në Kryesinë e Kuvendit nesër të rendisim në ditët e ardhshme këto debate, sipas dakordimit me grupet parlamentare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Partia Socialdemokrate, Dardan Sejdiu.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryetar!

Në fakt, propozimi i zotit Hoti është propozim me të cilin edhe ne pajtohemi, pra që nesër meqë e kemi kryeministrin në seancë të vazhdojmë me seancën e cila është caktuar për datën e nesërme, pra interpelancat dhe pikat e rendit të ditës. Sa u përket debateve parlamentare që janë këtu, gjithashtu mendoj që nesër në mbledhjen e Kryesisë në orën 9:00 të dakordohemi për datat kur vazhdojmë me këto seanca. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që nesër prezencën e kryeministrit, t'i trajtojmë temat që janë me atë rend dite.

Gjithashtu, meqë dy temat për debate parlamentare janë nga grupi jonë, ne jemi të gatshëm të diskutojmë edhe për datat tjera dhe të vazhdojmë me seancë, siç është e paraqitur për nesër. Faleminderit!

Edhe një shtesë, sa i përket vazhdimit të diskutimeve sonje, pas iftarit, pra deri në syfyr, siç u shprehët edhe ju, mendoj që është mirë që të punojmë ditën edhe mos të mundohemi t'i heqim temat të cilat besoj se janë tepër të rëndësishme, duke i mbajtur në kohë që nuk i ka as hije Kuvendit, sepse nuk janë as urgjente, e as nuk janë tema që nuk mund të trajtohen ditëve tjera.

KRYETARI: Vetëm ta kini parasysh një fakt, këto tre debate edhe nëse mbeten për nesër duhet të jenë nga mëngjesi, pastaj të futemi në seancën tjetër, për arsye se po e krijojmë një ngatërrim, nga i cili pastaj si Kuvend nuk po mund dalim. Të vazhdohet në mëngjes me këto tri dhe pastaj të vazhdohet me vazhdimin e seancës tjetër, kjo është e vetmja mundësi, përndryshe atëherë barten...

E kam këtë hall, zakonisht kur po mbajmë shumë seanca po ka ankesë, kur po mbajmë jashtë ditëve të enjte, po ka ankesë. Me këto kërkesa... pastaj, kemi edhe disa interpelanca tjera. Me këto kërkesa shumë të cilat i kemi 5-6 interpelanca, shumica absolute janë nga opozita edhe debatet, ose duhet me e shkëputë nga renditja e të enjtes tradicionale, ose s'do të mund t'i mbajmë. Në qoftë se, tash i lëmë këto tre debate dhe këtë votim, faktikisht ne nesër futemi në një seancë krejt tjetër, këto mbesin, humbin. Po, ne vazhdojmë të premtën, po ku t'i vendosim, se ne vazhdojmë seancë, sipas të gjitha gjasave, edhe ajo e të së enjtes vazhdon deri të premtën, se jemi...

Vetëm më lejoni të ju theksoj, interpelancë, interpelancë, interpelancë, janë 9 orë. Kine parasysh 9 orë. Nuk e besoj se ne mund t'i kryejmë sa jemi efikas për dymbëdhjetë orë. Kjo vetëm të ju paralajmëroj, kjo është situata në të cilën ne jemi duke punuar, pastaj jo nuk janë deputetët, po e shihni edhe vet. Pastaj, edhe një aspekt, Kabineti qeveritar duhet të jetë i pranishëm dhe do ta bisedojmë bashkërisht, po duhet të jenë të pranishme dikasteret përkatëse.

Po, po, do të bisedojmë së bashku si Kuvend së bashku edhe me Qeverinë, po flas si institucion i Kuvendit, s'jam duke folur pozitë - opozitë. Se për mua pak prish punë kjo pjesë, edhe në qoftë se nuk janë, por pozitë - opozitë duhet të vijmë ministrat. Po shkojmë e Aleanca dhe pastaj do ta rrumbullakojmë një vendimmarrje. Pse po e përmend? Jo se duhet të bëjmë vendimmarrje, po mendojeni edhe ju pak, kjo është ajo në të cilën do të ballafaqohemi. Ahmet Isufi, të lutem!

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Sa i përket rezolutës, ky debat që vërtet u shfrytëzua sot për të folur për të njëjtën temë, për një rezolutë që ka qenë e kaluar, për mendimin tim ka qenë një absurd. E tash, duhet ta nxjerrim

edhe një rezolutë përsëri, me të njëjtat çështje ose me të njëjtat rekomandime që duhet t'i shkojnë Qeverisë.

Nuk e di si mund të procedojmë më tutje, por sa i përket seancave kanë kërkuar debat, po e mbajmë debatin dhe nuk po i shtyjmë seancat, sepse shtyj e shtyj po e shihni që me muaj po na bëhen. Atëherë, të jemi të përgjegjshëm, kur të kërkojmë seancë po i mbajmë seancat edhe natën. Në shumë parlamente punojnë edhe natën, sepse e dinë, janë të përgjegjshëm deputetët para kuvendit të tyre dhe para votës që e kanë marrë nga qytetarët.

KRYETARI: Faleminderit! Nesër, se po e shoh se kemi disa minuta, jemi drejt iftarit. Nesër e kemi në orën 9:00 mbledhjen e Kryesisë. A e lëmë autorizim të Kryesisë?

Bilall, po më vjen keq! Urdhëro, Bilall, mos... Nesër në orën 9:00 kemi mbledhje të Kryesisë.

BILALL SHERIFI: S'është problem, kryetar. E lëmë nesër në orën 9:00.

KRYETARI: Kemi seancë, po ashtu në orën 10:00. Po, urdhëro!

BILALL SHERIFI: Nuk është problem, e lëmë nesër në orën 9:00. Nëse mendon se më mirë është nesër në orën 9:00 ta bisedojmë këtë, e bisedojmë në ora 9:00. Mirëpo, unë mendoj se kjo seancë ka filluar dhe kjo seancë mund të vazhdojë tash, mund të vazhdojë nesër, pa pasur nevojë për 61 deputetë, sepse konsiderohet seancë në vazhdim. Nuk mendoj se nëse nesër e vazhdojmë, do të ketë nevojë për fillim, në fillim siç ka nevojë para çdo seance 61 deputetë, sepse kjo është në vazhdim. Mund ta shpallim pauzën, qoftë një orë e gjysmë, qoftë dymbëdhjetë orë dhe nesër të vazhdojmë, kushdo që dëshiron të marrë pjesë në debat është i mirëseardhur, por nuk mund ne, së paku kjo është bindja ime, që t'i shtyjmë pikat e rendit të ditës sepse nuk ka në sallë deputetë të mjaftueshëm.

Kushdo që është i interesuar, besoj se ka pasur edhe të drejtë edhe mundësi të jetë sot në sallë dhe të vazhdojë të japë kontributin e vet, por në rregull. E bisedojmë nesër në ora 9:00, nuk ka problem.

KRYETARI: Në orën 9:00 nesër, Kryesia merr vendimmarrje. Gjithsesi, në ora 10:00 ne kemi takim.

Sot nuk kemi më seancë. Ata që janë me agjërime, të gjithë besimtarëve urime iftarin! Faleminderit!

* * *

E premte, më 1 qershor 2018

Vazhdimi i mbledhjes, e filluar më 17 dhe 30 maj 2018

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

14. Shqyrtimi i raportit vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017

Në seancën e mbajtur plenare më 17 maj 2018 kanë përfunduar diskutimet e përfaqësuesve të grupeve parlamentare dhe paraqitja e rekomandimeve të Komisionit FunkSIONAL dhe Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me këtë raport. Andaj, sot vazhdojmë..., Po, urdhëro Albulena Haxhiu, e ka kërkuar fjalën. Regjia, fjalën Albulena Haxhiut!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Sa i përket raportit të Avokatit të Popullit nuk qëndron që diskutimet janë përfunduar dhe pritet që vetëm të votohet raporti për shkak se në seancën e kaluar ne diskutuam që në mungesë të Avokatit të Popullit...

KRYETARI: Më fal se po të ndërhyj! Kisha pas dëshirë vëmendje. Jemi duke folur përfaqësuesit e grupeve parlamentare, tash vjen Avokati i Popullit, pastaj hapet diskutimi.

ALBULENA HAXHIU: A është Avokati i Popullit këtu?

KRYETARI: Po, po!

ALBULENA HAXHIU: E, tash është në rregull!

KRYETARI: Veç për sqarim, për këtë reagoval. Pastaj kanë mundësi deputetët edhe të diskutojnë, edhe të pyesin.

ALBULENA HAXHIU: Sepse nuk u njoftuam që Avokati i Popullit është këtu, prandaj ishte reagimi im.

KRYETARI: Jo, atje është, brenda në sallë. Atëherë, a mund të vazhdojmë? E ftoj Avokatin e Popullit, zotin Hilmi Jashari, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017.

I nderuar Avokat i Popullit, foltorja është për ju!

AVOKATI I POPULLIT, HILMI JASHARI: Faleminderit, zoti kryetar!
Të nderuar deputetë,

Institucioni i Avokatit të Popullit e ka dorëzuar në afatin ligjor raportin e vet vjetor për vitin 2017 dhe raporti përmban, përveç rekomandimeve në rastet konkrete, gjithashtu edhe shkeljet të cilat i kemi evidentuar si shkelje sistematike të të drejtave të njeriut për shkak të mosfunksionimit të sistemit të pushteteve në Kosovë, duke përfshirë sistemin ligjor, sistemin gjyqësor dhe sistemin ekzekutiv. Unë do të provoj shkurtimisht të sjell para jush disa prej vërejtjeve kryesore që Institucioni i Avokatit të Popullit ka konsideruar që qytetarëve të Kosovës u shkelen të drejtat dhe liritë e njeriut si pasojë e këtyre problemeve në të tri shtyllat e pushtetit.

E para ka të bëjë me funksionimin e sistemit gjyqësor që sipas raporteve të Avokatit të Popullit përbën më tepër se gjysmën e të gjitha ankesave që janë paraqit në këtë institucion, e që kanë të bëjnë me zvarritjet e procedurave gjyqësore mbi bazën e vlerësimeve tona në mesatare kohëzgjatja e një çështjeje gjyqësore tejkalon 8,5 vjet për ta zgjidhur një çështje gjyqësore, që është proceduar në civile, penale apo tjera.

Problemi i dytë me të cilën ballafaqohet sistemi gjyqësor ka të bëjë me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe prapë mbi bazën e vlerësimeve konstatimeve tona del që mbi 20 mijë raste nuk arrijnë të ekzekutohen nga sistemi gjyqësor, edhe pse të vendosura në mënyrë të plotfuqishme nga ky sistem, e me çka kërcënohet siguria juridike e qytetarëve të vendit dhe me çka mundësohet aplikimi selektiv i së drejtës ndaj qytetarëve të vendit, që përbën një prej shkeljeve të standardeve ndërkombëtare për funksionimin e një sistemi të mirëfilltë të drejtësisë.

Në anën tjetër, gjithashtu sistemi ligjor i vendit është duke u ballafaquar me probleme sistematike, të cilat pastaj prodhojnë pasoja juridike të drejtpërdrejta për qytetarin vendit. E para ka të bëjë me faktin që gjithë sistemi ligjor i vendit vazhdon të ballafaqohet me jokonsistencë juridike, me kolizione të mëdha të dispozitave ligjore edhe me mosharmonizim të ligjeve që janë miratuar në periudha të ndryshme kohore.

Vitin e kaluar ne kemi rekomanduar këtë Kuvend, mirëpo edhe Qeverinë e Kosovës që të fillojë urgjentisht harmonizimin e këtyre pjesëve të legjislacionit, të cilat pastaj po sjellin pasoja juridike, duke u mundësuar organeve ekzekutive që ta aplikojnë në mënyrë selektive ligjin dhe që gjithashtu u mundëson të kenë diskrecion të shtuar me marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Sa i përket funksionimit të sistemit ekzekutiv kemi konstatuar në raportin vjetor gjithashtu se në vend mungojnë dy mekanizmat kryesorë të kontrollit ndaj Qeverisë. E para, Kushtetuta e vendit e cilëson këtë Parlament si autoritet i cili ushtron kontroll të drejtpërdrejtë ndaj Qeverisë dhe në vlerësimet tona, të cilat janë bërë edhe gjatë vitit paraprak, del që nga 94% e gjithë këtij aktiviteti që ju bëni këtu në këtë Kuvend i referohet miratimit të ligjeve dhe procedurave tjera, ndërsa vetëm 6% i referohet kontrollit efektiv parlamentar, e me çka besoj do të dakordoheni që në një demokraci të mirëfilltë nuk siguron llogaridhënie dhe përgjegjshmëri të Qeverisë, e me çka do të sigurohet zbatimi i të drejtave dhe lirive të njeriut ndaj qytetarëve.

Mekanizmi i dytë është sistemi gjyqësor, i cili gjithashtu mundëson një kontroll efektiv të organeve ekzekutive dhe ju e dini gjithashtu që organi i vetëm gjyqësor i cili ka autorizime për të ushtruar kontroll është Gjykata për Konflike Administrative, e cila fatkeqësisht pothuajse në asnjë rast nuk ka arritur që në çështje ose në meritum të vendimeve të organeve administrative të marrë vendime meritore për ta rivendosur të drejtën e shkelur.

Këto janë ato problemet në të tri shtyllat e pushtetit që konsiderojmë që pa një shqyrtim reformues ndoshta është e pamundur të sigurojnë zbatim të së drejtës, sepse vetë sistemi gjeneron raste individuale, pastaj mekanizmat janë duke i trajtuar rastet individuale, mirëpo asses i duke i trajtuar problemet në sistem, e për të cilat deri më tani nuk ka pas asnjë raport që i ka trajtuar në formën e tillë çfarë i keni në raportin vjetor të Avokatit të Popullit për konsideratën tuaj.

Ndërsa, në anën tjetër, do të doja t'i përmendja edhe dy çështje tjera që gjithashtu mendoj që janë jashtëzakonisht serioze për vendin. E para ka të bëjë me të drejtat e fëmijëve. Sot ka rastisur të jetë edhe Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve. Mirëpo, në hulumtimet tona del që problemi numër një i të rinjve në Kosovë është droga.

Në një hulumtim të bërë para ca muajsh mbi bazën e standardeve ndërkombëtare gjithashtu del që shqetësimi kryesor numër një është droga për shkak të mungesës së mekanizmave, politikave të institucioneve, mirëpo edhe të mekanizmave preventivë.

Sa për ilustrim, edhe më brengosës është fakti që mbi 85 raste të vdekjeve i kemi pasur nga mbidoza e të rinjve si pasojë e mungesës së mekanizmave dhe masave preventive, gjë që është indikator jashtëzakonisht shqetësues.

Argumenti i dytë është fakti që nga këta të rinj dhe nga mesatarja e organizatave që janë marrë me trajtimin, moshë 22-vjeçare ka qenë para dy vjetëve moshë mesatare që të rinjtë kanë qenë në varësi të drogës. Për dy vjet, kjo mesatare ka rënë në moshën 16-vjeçare. Domethënë 6 vjet brenda dy vjetëve ka rënë mesatarja e të rinjve të janë në vartësi të drogës, që është një problem jashtëzakonisht serioz dhe që meriton vëmendjen e të gjithë neve, mirëpo sigurisht ju deputetë të nderuar jeni në pozicionin më të mirë për t'i ftuar në përgjegjësi të gjitha autoritetet që janë kompetente, jo veç për politika, mirëpo edhe për preventivë.

Dhe, gjithashtu problemi tjetër që ne kemi konstatuar që është jashtëzakonisht serioz për jetën dhe shëndetin e qytetarëve është mbrojtja e ambientit nga ndotja, qoftë ajo e ajrit, tokës apo ujërave dhe si më brengosëse gjithashtu është vëmendja e autoriteteve që janë të thirrura për ta zbatuar ligjin, e që realisht nuk kanë arritur t'i zbatojnë këto standarde që janë miratuar kaherë nga Kuvendi i Kosovës.

Mjafton ta përmendim rastin e fundit për sasinë edhe masën e azbestit, i cili është në përdorim të gjerë nga popullata e Kosovës dhe ju e dini fort mirë që ky material është përdorim të gjerë mu për faktin që ka qenë ose ka pasur një kosto të lirë të ndërtimit dhe është përdorur si material ndërtimor. Tanimë është e padiskutueshme që ky material është kancerogjen dhe që shumica e qytetarëve të vendit nuk kanë as informatën elementare se çfarë masash duhet të ndërmerren në momentin e kontaktit me këtë material, ose zhvendosjes së tij, ose largimit nga shtëpitë e tyre, ose ambientit ku ata jetojnë. Është kërcënim i drejtpërdrejtë, është kërcënim serioz i jetës së qytetarëve të vendit, për të cilën sigurisht se do të duhej të merreshin masat dhe politikat në nivelin nacional.

Ndërsa sa u përket ujërave mjafton të përmendim vetëm një fakt, në vlerësimet tona dhe në testimet që i kemi bërë së bashku me ekspertë në shumicën e lumenjve vlera e pH-së të ujërave është 12%, e cila është e barasvlershme me sasinë ose masën e acideve që janë në përdorim të gjerë nga konsumatorët, ose, fundi i fundit, edhe amvisëritë.

Këto janë shqetësimet më serioze që Avokati i Popullit i ka konstatuar në raportin vjetor, sigurisht që do të gjeni edhe shumë raporte tjera, të cilat kanë adresuar rekomandime për institucionet përkatëse, mirëpo të cilat fatkeqësisht mbeten ende të pazbatuara. Pra, është një mundësi e mirë që ju ta shfrytëzoni autoritetin, kompetencën dhe mandatin që e keni për t'i ftuar këto autoritete që t'i dalin ndesh dhe t'i dalin përballë zbatimit të këtyre rekomandimeve.

Dhe, për fund të përmend gjithashtu disa fakte: Institucioni i Avokatit të Popullit vitin e kaluar nga barometri i Ballkanit që është mekanizëm i EU-së është shpallur si institucioni më i besueshëm në Ballkan, krahasuar me të gjitha institucionet tjera. Këtë vit, nga Raporti i Progresit është vlerësuar si institucioni më i besueshëm në Kosovë. Me raportin për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit në Kosovë, Institucioni i Avokatit të Popullit është i vetmi institucion, i cili në masën 100% i ka zbatuar të gjitha masat e parashikuara me këtë marrëveshje, ndërsa në anën tjetër për qëndrueshmërinë e këtij institucioni në të ardhmen e afërt kemi arritur një marrëveshje që është jashtëzakonisht e fuqishme në aspektin financiar, sepse siguron një përkrahje për tre vjetët e ardhshme me një vlerë prej 3 milionë euro, me çka siguron qëndrueshmërinë e institucionit për të ardhmen.

Dhe, krejt për fund, gjithashtu kemi arritur një marrëveshje e cila tashmë është nënshkruar nga Qeveria e Kosovës dhe Komisioni Evropian, me të cilën Qeveria e Kosovës obligohet që, në mënyrë që ta marrë këtë ndihmë financiare nga Komisioni Evropian në vlerën prej 20 milionë eurosh, t'i zbatojë rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit. Prandaj, është një alternativë tjetër për ta detyruar Qeverinë që të zbatojë këto rekomandime, mirëpo gjithashtu shpresoj që do të tërheq gjithashtu vëmendjen e juaj që të adresohet shumë më tepër mundësia për të ushtruar kontroll adekuat parlamentar mbi Qeverinë e vendit dhe organeve ekzekutive, që janë drejtpërdrejtë të përfshira në respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)

KRYESUESI: Faleminderit! Tani është radha e deputetëve. Sipas radhës së paraqitjes, fjalën e ka deputeti Memli Krasniqi. Si duket s'është në sallë. Sami Kurteshi, urdhëro!

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë e kam edhe një çështje.

Ne si grup parlamentar, në të vërtetë herën e kaluar nuk e kemi thënë fjalën tonë. Ne kemi kërkuar, e vetmja gjë që kemi bërë në emër të grupit parlamentar ka qenë kërkesa jonë që të respektohet Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe të ftohet Avokati i Popullit, që të raportojë në seancë. Prandaj, unë kisha kërkuar që për shumë çështje të flas edhe në emër të Grupit Parlamentar.

Faleminderit prej Avokatit të Popullit që erdhi edhe raportoi. Që në fillim si grup parlamentar edhe si deputet, unë kisha kërkuar që Avokatit të Popullit t'i lejohet mundësia që të përgjigjet në pyetjet, brengat dhe shqetësimet e deputetëve që i ngritin në lidhje me raportin e Avokatit të Popullit, me pyetjet që i kanë apo paqartësitë. Këtë e kërkoj që në fillim, që të mos mbetemi mandej vetëm të diskutojmë kot dhe në fund ta ngrejë dikush dorën, ose mos ta ngrejë. Mendoj se është punë e mirë. Unë e kam lexuar raportin me shumë kujdes dhe ne si grup parlamentar e kemi trajtuar. Qëndrimi i grupit parlamentar është, se është një raport i strukturuar mirë, me përmbajtje të duhur, me gjuhë të kuptueshme dhe të pastër, i dokumentuar dhe i arsyetuar me fakte e dëshmi dhe me ndarje të qartë lëndore.

Në këtë raport ka gjetje të shumta, një pjesë të së cilave i përmendi vet avokati i popullit. Edhe unë do të bëj përpjekje që nga ato gjetje të ik, të mos i përsëris ato që janë shqetësime të jashtëzakonshme. Të gjitha ishin shqetësime me vend, por shqetësimi kryesor sa i përket Kuvendit të Republikës së Kosovës, në të vërtetë është fakti i moskonsistencës dhe mosharmonizimit të ligjeve një, dhe e dyta mungesa e një kontrolli efektiv të Ekzekutivit nga Kuvendi. Kjo është vërejtje shumë e drejtë. Ka edhe vërejtje tjera të drejta që i ka përmendur Avokati i Popullit në raportin e vet. Një vërejtje tjetër që këtu nuk kishte kohë për shkak të kohës që ndoshta e ka kursyer, është mungesa e një trupi, një organi, një njësie ligjore të fortë brenda Kuvendit të Republikës së Kosovës të përgatitur profesionalisht, që do ta bënte këtë punë, të cilën e kërkoi Avokati i Popullit dhe është detyrë e Kuvendit të Republikës së Kosovës, e Legjislativit, që të nxjerrë ligje të mira.

Këtë nuk duhet komentuar. Unë mendoj se është një rekomandim shumë i drejtë që duhet të respektohet. Ndoshta ka mundësi edhe çështje tjera.

Po kaloj te Ekzekutivi, te Qeveria. Përveç asaj që ka vërejtur Avokati i Popullit për mangësitë e ndryshme, ka nxjerrë vendimet e paligjshme, dështimin e AKP-së dhe të Dhomës së Posaçme të

Gjykatës Supreme në procesin e privatizimit. Një problem i theksuar, që edhe Avokati i Popullit e përmendi këtu, është moszbatimi i rekomandimeve dhe këtu pastaj vjen ajo çështja nga AKP-ja dhe nga Ekzekutivi thekson se këto rekomandime zbatohen më së paku.

Natyrisht që kjo është çështje e rregulluar me ligj. Ka një organ në Republikën e Kosovës që merret me procesin dhe me përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Ai organ është Zyra për Qeverisje të Mirë brenda Zyrës së Kryeministrit. Natyrisht se do të kishte qenë e drejtë që ndonjëherë Qeveria apo Kuvendi ta ftojë këtë zyrë, përfaqësuesin e saj, të raportojë në Kuvend, nëse jo në seancë plenare, në ndonjërin nga komisionet dhe ai është Komisioni për të Drejtat e Njeriut, të raportojë për gjendjen e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, sa i përket së paku Ekzekutivit, por edhe organeve të tjera.

Avokati i Popullit natyrisht se i ka theksuar problemet në mjedisin jetësor. Shumë e drejtë! Ne e kemi pasur një diskutim vitin e kaluar në dhjetor dhe unë e di që ka qenë alarmant në lidhje me ndotjen e ajrit, me masat që janë duke u ndërmarrë, me krejt luftën që bëhet, me krejt përprjekjet, unë po them që këtë vit në dhjetor ne do ta kemi një diskutim edhe më alarmant, sepse nuk ka tendencë të rënies së ndotjes në Kosovë, sepse nuk shihen masat e ndërmarra, po ka tendencë të rritjes së ndotjes dhe nuk duhet të habitemi që është një ndotje aq e madhe e në ditë të caktuara Prishtina është qyteti më i ndotur në krejt Botën, natyrisht në vendet ku maten. Nuk duhet të habitemi nga kjo.

Natyrisht, se një problem që e ka vërejtur Avokati i Popullit me të drejtë dhe që përsëritet me vite të tëra, është në të vërtetë qasja në dokumentet publike. Nuk respektohet Ligji nga shumë institucione, mospasja në dokumentet publike është një defekt i madh që e vëren Avokati i Popullit dhe që ndihmon drejtpërdrejt korrupsionin. Kjo qasja në dokumentet publike mbetet çështje e pavullnetit, sipas Avokatit të Popullit, dhe mëshirës së personave të papërgjegjshëm. Nuk e di a keni çfarë t'iu hiqni, unë mendoj se nuk do të duhej hequr, por do të duhej të nxirrej një rekomandim lidhur me qasjen në dokumentet publike.

Mbrojtjen e fëmijëve e përmendi Avokati i Popullit. Është një gjendje jashtëzakonisht e rëndë, që ka disa forma të shfaqjes, të rrezikut për trajtimin institucional dhe shoqëror të fëmijëve në republikën e Kosovës. Avokati i Popullit nuk e përmendi dhunën ndaj fëmijëve, në mes fëmijëve dhe dhunën në shkolla këtu, po e ka përmendur në raportin e tij dhe është një shqetësim i ngritur me të drejtë nga vet Avokati i Popullit.

Kemi edhe gjendjen e personave me aftësi të kufizuara, e cila nuk ka shënuar asnjë përparim të duhur. E drejta në punë, pensionet e kategorive të ndryshme, sidomos ato të njerëzve, të personave, që kanë më pak se 15 vjet përvojë pune dhe për disa muaj mbeten pa e marrë pensionin, kurse pensioni është e drejtë, është pronë e drejtë e fituar me punë. Vetëm në Kosovë

mohohet e drejta e obligimeve që ka shteti ndaj individit, duke mos ia paguar pensionin. Kemi edhe vjedhjen e Fondit Pensional nga Qeveria e Serbisë e të tjera.

Te barazia gjinore është shumë e drejtë, domethënë diskriminimi që është vërejtur nga Avokati i Popullit natyrisht që unë pres se nga një departament për diskriminimin të nxirren edhe rekomandime shumë më të shumta lidhur me diskriminimin, që megjithatë është një dukuri që shfaqet dhe e shohim, e hasim në shumë shpesh në Kosovë.

Sa i përket Gjyqësorit nuk ka shumë të thuhet. Avokati i Popullit e ka vërejtur me të drejtë, zvarritjet arrijnë në 8,5 vjet, domethënë tetë vjet e gjysmë, në mesatare sa i përket zvarritjes nëpër gjykatat tona. Ky duhet të jetë një alarm yni, kjo është gjendja e gjyqësisë sonë, parashkrimi i mbi 20 mijë lëndëve, rasteve. Ne kërkojmë nga qytetari dhe nga çdokush, që konfliktet çfarëdo natyre qofshin ato, të dërgohen në institucionet kompetente, te personat profesionalistë të shkolluar, që t'i zgjidhin konfliktet dhe zgjidhja e konflikteve të mos bëhet në baza personale, sepse ato mandej çojnë në raste shumë tragjike, deri në vrasje.

Mandej kemi vërejtjen shumë të drejtë, mungesa e një instrumenti që do t'i kompensonte qytetarët për këtë zvarritje, ashtu siç e parasheh Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut. Kemi pastaj një vërejtje shumë të drejtë, që përmendet shumë shpesh, mosrespektimi i nenit 53 të Kushtetutës, interpretimi i vendimeve gjyqësore në Republikën e Kosovës sipas vendimeve të Gjykatës Evropiane të të drejtave të njeriut. Ky nuk do të duhej të ishte obligim formal, po në të vërtetë do të duhej të ishte obligim përmbajtjesor, sepse shumë do të mësohej dhe shumë vendime do të nxirreshin...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka... urdhëro! Ju duhet të kërkonit fjalën, pastaj kur të ju vijë radha keni dhjetë minuta shtesë. Faleminderit!

Atëherë, fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

E falënderojmë Avokatin e Popullit për elaborimin e raportit vjetor të Avokatit të Popullit.

Fillimisht, dua të them se nuk pajtohem me deputetin Sami, i cili tha se Avokati i Popullit të ketë të drejtë të na përgjigjet në pyetjet që do i bëjmë, sepse kjo nuk është e drejtë, meqë Avokati i Popullit mund të thirret në një raport në komisionin e caktuar dhe të raportojë për të gjeturat e këtij raporti.

Unë mendoj se ato të gjetura që i deklaroi Avokati i Popullit, por edhe ato që janë të përfshira në raport, secili komision veç e veç, varësisht prej dikasterit që ka, ka mundësi që gjithë ato rekomandime që kanë dalë dhe që nuk po zbatohen, komisionet e caktuara t'i thërrasin në përgjegjësi ministrat e caktuar, dhe të kërkojnë që të implementohen të gjitha ato rekomandime, në fund të fundit, është e drejtë e komisioneve. Po, është e drejtë që ato rekomandime të harmonizuara dhe të deklaruara të implementohen, sepse raporti i Avokatit të Popullit po votohet në seancën plenare, po votohet në Kuvendin e Kosovës.

Është e vërtetë që ka shkelje të të drejtave të njeriut, ka shkelje të të drejtave të fëmijëve, të gjitha ato qëndrojnë. Ka dhunë në familje. Kemi ekzistimin e drogave nëpër shkolla, konsumimi i drogave dhe shumë gjëra të tjera negative, andaj duhet mobilizim i përgjithshëm. Duhet mobilizim i komisioneve parlamentare, duhet mobilizim i deputetëve, që të gjitha këto çështje të ngritën.

Ndërsa, sa i përket vlerësimit se Qeveria po monitorohet, ose Kuvendi që e ka rolin mbikëqyrës të punës së Qeverisë, është aktiv vetëm 6%, mendoj se nuk qëndron, sepse po ta shohim veç në këtë vit nuk ka pasur çështje që s'kemi kërkuar interpelanca, që s'kemi kërkuar debate, bile-bile duke mos u harmonizuar grupet parlamentare, duke dashur me e marrë primatin e interpelancave dhe debateve, ndoshta e kemi debatuar këtu tri-katër ditë një debat që do të duhej të përmbylej me një debat të veçantë, qoftë për korrupsionin, që ka qenë një temë e lidhur me liberalizimin e vizave. Më pas e kemi pasur korrupsionin si nivel i korrupsionit në Kosovë, pastaj i kemi pasur tri debate me temë të njëjtë që kanë qenë debate për energji, që kanë mundur të fuzionohen, por megjithatë për shkak të marrjes së primatit për këto tema nuk është arritur konsensus që këto debate të fuzionohen dhe vërtet Kuvendi ka ngelur me ditë të tëra duke debatuar për këto çështje.

Është obligim të implementohen këto rekomandime. Ndërsa, meqenëse s'mund të përgjigjet avokati, tha se ka plotë ligje të cilat nuk janë të implementueshme dhe janë ligje që nuk janë të harmonizuara me njëra tjetrën. Puna e komisioneve parlamentare është jo veç amendamenti i ligjeve, po edhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve dhe nëse ka ligje, varësisht prej sferës të cilat nuk janë në harmoni me njëra tjetrën, komisionet parlamentare gjatë monitorimit të implementimit të këtyre ligjeve kanë të drejtë të kërkojnë plotësimin dhe ndryshimin e këtyre ligjeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Duda Balje.

DUDA BALJE: Faleminderit, nënkryetar!

Tash unë do të flas edhe në emër të Grupit Parlamentar 6+ edhe në emër të Komisionit për të Drejtat e Njeriut.

Na osnovu člana 72 Poslovnika Skupštine Komisija za ljudska prava, rodno ravnopravnost, nestala lica i peticije, na sednici od 25 aprila 2018 godine razmatrala je izveštaj sa preporukama o izveštavanju Narodnog Advokata za 2017-u godinu i odlučila je da Skupštini dostavi, odnosno preporuči neusvajanje izveštaja sa preporukama o izveštavanju Narodnog advokata za 2017-u godinu.

Što se tiče saradnje Narodnog Advokata sa Komisijom za Ljudska Prava, ona je na jednom jako velikom i zavidnom nivou. Na kraju krajeva Narodni Advokat jeste jedna od institucija koja je obelila obraz Kosova kao države u raportu Evropske Unije. Preporuke koje su donošene od strane Narodnog Advokata jesu i glasane ovde i one se tiču za trošenje električne energije na severu Kosova.

U raportu Narodnog Advokata se nalazi činjenično stanje onoga kojega mi imamo ovde danas na Kosovu i ono na šta treba da apelujem, jeste da se svi kompetentni organi koji su se našli u ovom raportu da malo više obrate pažnju na to i da ih implementiraju u stvarnosti. Znači, stvari koje nisu dobre da se promene iako moram da budem iskrena, da većinu stvari smo i u komisiji zajedno sa Narodnim Advokatom pokrenuli. Tako da u ime Parlamentarne Grupe 6+, koja će da podrži ovaj raport, molim da i sve druge poslanike glasaju isto. Hvala vam puno!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, ia jap fjalën deputetes Luljeta Veselaj-Gutaj.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Raporti i Avokatit të Popullit paraqet punën dinamike dhe me shumë përkushtim brenda vitit 2017, me të cilën edhe pasqyron gjendjen reale të të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës.

Raporti i detajuar reflekton seriozitetin dhe punën e mirë që ka bërë ky institucion. Avokati i Popullit ka raportuar para Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur, Peticione në Kuvendin e Kosovës dhe gjatë raportimit dhe diskutimeve të përbashkëta që kemi pasur në komision, ne kemi reflektuar për të gjeturat dhe rekomandimet e dala.

Sa i përket besimit të qytetarëve në raport me Institucionin e Avokatit të Popullit është për t'u admiruar besimi i qytetarëve në këtë institucion dhe kjo është dëshmuar edhe në raportin për vendin, që është paraqitur në kohën e fundit. Nga analiza e situatës aktuale dhe të gjeturave reale Institucioni i Avokatit të Popullit ka dalë me rekomandime konkrete, të cilat janë të detyrueshme të zbatohen nga institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës me qëllimin e përbashkët për një shtet ligjor dhe demokratik.

Sa i përket fushës së legjislacionit në raportin e Avokatit të Popullit kërkohet të hartohet një plan i përafritimit ligjor, kodifikimit të ligjit, përkatësisht përmbledhjen e ligjeve që rregullojnë fushën e njëjtë apo të përafërt dhe që i bëjnë më lehtë të zbatueshme këto ligje. Sa i përket mbrojtjes së gjyqësorit të të drejtave, vërehet një ngritje e konsiderueshme në krahasim me vitet e kaluara, por mbetet ende për t'u punuar.

Hap tjetër pozitiv në sistemin e drejtësisë theksohet edhe themelimi i Akademisë së Drejtësisë. Shqetësuese mbetet zvarritja e procedurave gjyqësore, edhe pse në krahasim me vitet e kaluara ka ulje të lëndëve në krahasim me vitin që jemi tani.

Sa i përket punës raportuese të Avokatit të Popullit, këtu shihet si shqetësuese çështja e faturimit të rrymës së shpenzuar në veri e cila përbën shkelje të shumëfishtë, sepse është në kundërshtim me ligjet e energjisë, shkeljen e të së drejtës së qytetarëve për të mos u diskriminuar, të drejtën e pronës dhe të drejtën e konsumatorit. Situatë e njëjtë problematike në veri mbetet edhe çështja e ujit, ku operon një ndërmarrje e palicencuar, që quhet “Vodovod Ibar” dhe e cila e distribuon ujin deri te konsumatori, por shqetësimi mbetet në mungesën e inkasimit në këtë pjesë, në fushën e të drejtave të njeriut, përkundër faktit që kemi një kornizë ligjore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut shumë të mirë, realizimi i tyre në praktikë po mbetet sfidë edhe sot.

Shqetësuese mbetet mospajtimi i qëndrueshëm i kujdesit ditor për trajtim, rehabilitim dhe riintegrim të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe mungesa e gjithëpërfshirjes së tyre në sistemin arsimor, duke përfshirë edhe mungesën e asistentëve dhe mësuesve mbështetës në shkolla.

Shqetësim është edhe rritja e numrit të substancave narkotike, e sidomos të përdoruesve në moshë të re.

Dhe si kërkesë e të gjitha këtyre të gjeturave dhe shqetësimeve del që sa më parë Kuvendi i Republikës së Kosovës të bëjë miratimin e Projektligjit për mbrojtjen e fëmijës.

Nga analiza e raportit vërehet qartë se është e theksuar shkelja e të drejtave të punëtorëve dhe pabarazia në vendin e punës, duke u diskriminuar nga punëdhënësit në sektorin privat, e në veçanti nga ata në ndërtimtari, tregti, hoteleri, industri, ku shpesh punojnë edhe pa kontrata, pa pushime, edhe pa pushime mjekësore dhe kjo del se vjen si pasojë e numrit të vogël të inspektorëve, të cilët e kontrollojnë zbatimin e ligjit në fushën e punës në sektorin privat dhe atë publik.

Pra, nuk ka kapacitet që në mënyrë cilësore dhe të dobishme të përmbushen detyrimet.

Këtu kërkohet të bëhet plotësim-ndryshimi i Rregullores në fushën e inspektimit dhe sanksioneve.

Po ashtu kërkohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të veprojë në përputhje me obligimin kushtetues e ligjor për zbatimin e ligjit për aftësi, riaftësim profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar, ashtu siç parashihet dhe garantohet me ligj.

Po ashtu shqetësim mbeten edhe dyshimet në korrektësinë e punës së Komisionit Mjekësor, se nuk vlerësohen aplikuesit sipas diagnozave të mjekëve profesionistë.

Zbatimi i rekomandimeve të paraqitura në këtë raport nga Institucioni i Avokatit të Popullit është domosdoshmëri e respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, duke tejkaluar të gjitha sfidat me guxim dhe me qëndrueshmëri nga autoritetet përkatëse.

Duke i marrë parasysh të gjitha çështjet e ngritura dhe të gjeturat reale në këtë raport që dalin si shqetësime, ne si grup, po edhe unë personalisht, do të japim mbështetje, duke e përgëzuar këtë institucion për seriozitetin në punën e bërë në raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fatmire Kollçaku e ka radhën.

FATMIRE KOLLÇAKU: Faleminderit, kryesues!

E kisha filluar fjalimin tim me konstatimin e Avokatit të Popullit, kur thotë se kontrollin efektiv parlamentar karshi Qeverisë e ka konstatuar që është vetëm 6%. Ndërsa këtu u tha se jo ne po bëjmë shumë më tepër, po ne po bëjmë shumë, po prodhojmë shumë rezoluta, siç u pa edhe sot këtu, për të cilat me vështirësi dakordohemi, por sa prej këtyre kanë gjetur zbatim, sa prej tyre janë respektuar nga Qeveria, sa rekomandime janë përfillur deri tani dhe sa ne si parlamentarë i kemi përcjellë me këmbëngulësi që ato të realizojnë.

Dhe, në fund, edhe unë pajtohem se vërtet edhe ai 6% po vihet në pikëpyetje, a 6% i kontrollit efektiv dhe këtu qëndroj me Avokatin e Popullit në të njëjtën vijë.

Nuk e fillova rastësisht fjalimin tim kështu, sepse dua të them se tashmë raporti i Avokatit të Popullit sa seriozisht merret. Po, raporti vjen çdo vit, raporton Avokati dhe i themi 'ditën e mirë', i dha do rekomandime, ndërsa ato përsëriten vit pas viti të njëjta pa lëvizur fare asgjë nga vendi.

Institucioni i Avokatit të Popullit paska besueshmëri te qytetarët në Raportin e Progresit, vlerësohet lart, po sa vlerësohet nga institucionet vendore, nga Qeveria, Kuvendi, gjyqësori, sa në fakt përfillen rekomandimet dhe vlerësimet e Avokatit të Popullit?

Ato mbesin në një raport që vendoset në sirtar dhe Avokati i Popullit mbetet plotësisht i pafuqishëm si institucion karshi mbrojtjes së interesave të qytetarëve.

Ndoshta në këtë vend nuk do të duhej të kishte fare opozitë, vetëm nëse lexohet raporti i Avokatit të Popullit shumë më i ashpër është edhe se vetë opozita këtu në Kuvendin e Kosovës. Konstatim pas konstatimi e sheh nuk funksionon Ekzekutivi, nuk funksionon gjyqësori, vetëm 8,5 vjet shqyrtimi i lëndëve, zvarritje, drejtësi selektive, 20 mijë lëndë presin në rishqyrtim dhe askush nuk brengoset.

Ligjet në kolizion, nuk harmonizohen ligjet mes vete dhe gjithnjë për t'i lënë dykuptimësi për t'u zbatuar ligjet ashtu siç u konvenon pushtetarëve dhe kjo vazhdon pafundësisht. Pra, edhe pa opozitë vetëm raporti i Avokatit të Popullit sikur të lexohej çdo ditë, faqe për faqe, ne do ta shihnim ku është situata në Republikën e Kosovës në respektimin e të drejtave të njeriut, e të mos flasim në çdo aspekt tjetër.

Si mjeke e preventivës, si epidemiologe desha vetëm të fokusohem edhe në problematikën e fëmijëve, sepse një 16-vjeçar pa dyshim është fëmijë, është fëmijë që i vijon edhe institucionet shkollore, ndërsa këtu flasim që mosha më e prekur dhe abuzuese me substanca narkotike qenkan 16-vjeçarët, unë këtë e kam ditur, por sot për publik e tha edhe Avokati i Popullit.

Çfarë po bëjmë ne si shoqëri në Ditën Ndërkombëtare të Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve? Kur vetëm disa OJQ sot brengosen dhe merren me këtë problematikë, ndërsa shoqëria në tërësi mbyll sytë para një problemi kaq madhor, ku ne konstatojmë që në përqindje të mëdha këta fëmijë përfundojnë me vdekje, sepse nuk ka institucione të thirrura që fillimisht ta parandalojnë këtë dukuri, bëhen disa fushata ad hoc, edhe unë si mjeke e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike shumë herë më ka rastisur të shkoj në shkolla dhe të mbajmë ligjërata edukative për parandalimin e konsumimit të substancave narkotike. Por këto janë vetëm fushata dhe nuk është një program kombëtar, i cili do të merrej seriozisht me parandalimin, trajtimin dhe rehabilitimin e fëmijëve dhe të gjithë të rinjve që i konsumojnë drogat sot në Kosovë.

Ky është një problem me të vërtetë që është shumë madhor dhe dita-ditës është në rritje dhe askush nuk po merret seriozisht me këtë problem.

Të mos flasim për mbrojtjen e ambientit që e ceku po ashtu Avokati i Popullit dhe këtu u diskutua dhe çfarë kemi bërë më pastaj për të shikuar atë rezolutën që e kemi nxjerrë këtu sa u përket mbrojtjes së ambientit, ndotjes së ujërave, ku u tha që ph-ja është 12 dhe mjafton ta dimë në ç'gjendje janë ujërat sot dhe ato ujëra dikush më vonë edhe i konsumon ose i përdor për ujitjen e tokave dhe produkteve që ne pastaj i konsumojmë.

Prandaj, edhe një herë po them, me keqardhje po e shoh që interesimi është tepër i vogël për këtë raport sot në Kuvend, shumica e deputetëve si doli Avokati i Popullit e lëshuan sallën, le ta dijë edhe opinioni publik që ky raport merret shumë joseriozisht, siç nuk merret seriozisht Institucioni i Avokatit të Popullit, sepse ky është një standard që është dashur ta përmbushim si shtet, por me gjithë respektin për këtë institucion, në fund mbetet vetëm një raport si obligues për

t'u raportuar para deputetëve të Kuvendit dhe të gjitha rekomandimet nuk respektohen, pritët viti tjetër dhe do ta shohim që do të na vijë rekomandimet e njëjta, pa lëvizur pothuajse asgjë fare.

Siç e thashë, edhe pa opozitën që padrejtësisht akuzohet, që vazhdimisht është kritike, vetëm ky raport tregon si është gjendja në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Fjalën time po tentoj të mos e ripërsëris, siç e bënë të gjithë kolegët e mi sot, për të mos i irrituar ata që po e shohin televizorin.

Nënkryetar i Kuvendit, ju si interpretues i saktë i Rregullores së Kuvendit ishte dashur sot ta merrni edhe transkriptin, apo nuk jua ka përcjellë administrata, meqë kryetari nuk është këtu, edhe sekretari gjithashtu. Unë kam reaguuar në seancën kur është diskutua raporti i Avokatit të Popullit dhe e tha kryetari pak më herët, kemi diskutuar sikur kam diskutuar unë në emër të grupit tonë parlamentar dhe kanë diskutuar po të njëjtit deputetë dhe po ta marrim transkriptin, të njëjtat fjalë janë thënë.

Atëherë sa është interesimi edhe vetë këtu, edhe këta kolegë dhe kolege që nuk kanë diskutuar, këta do të duhej ta kenë mundësinë të diskutojnë, jo ne dhe, në fakt po, përsëriten të njëjtat gjëra.

Unë e mora fjalën për të mos i përsëritur ato, janë transkriptet, kur t'i marrim transkriptet, e shohim që nuk kemi thënë diçka të re.

Po dua të them tjetrën, ashtu siç u ndërpre diskutimi, sepse më mirë do të ishte të mos fillonte diskutimi për raportin e avokatit pa qenë avokati, por kemi filluar, kemi dhënë mendimet tona në emër të grupeve parlamentare, që të gjitha grupet, por u përsëriten edhe një herë sot dhe mundësia që kanë qenë atë ditë rreth 5-6 deputetë do të ishte mirë të diskutohej, pse jo të gjithë deputetët e tjerë, por e mora fjalën për këtë pa dashur të di a e keni skenarin, jua la kryetari apo jo, por të tregoj edhe një herë.

Të gjithë e dinë, e mbi të gjitha, më së shumti e di vetë ish-Avokati i Popullit, Sami Kurteshi, se si duhet raportuar në bazë të Kushtetutës, një, në bazë të Ligjit për Avokatin e Popullit dy, dhe në bazë të Rregullores së Kuvendit, tre.

Dhe, nëse në bazë të këtyre tri dokumenteve Avokati i Popullit raporton, unë jam shumë e pajtimit dhe kisha dashur ta kem përkrahjen edhe tuajën, siç e kam përmendur që raporti i avokatit të diskutohet dhe normalisht të ketë mundësi të bëhen pyetje, po nuk e kemi në Rregullore ende.

Në plotësim-ndryshimin e Rregullores së Kuvendit ta kemi edhe mundësinë pse jo t'i bëjmë edhe pyetje këtu, Avokati i Popullit ka qenë shumë i rregullt në të gjitha takimet e komisionit dhe, mbi të gjitha, raportet të cilat jo vetëm që shpërndahej me kohë, por për të treguar si institucion se është për t'u krenuar vetë Republika e Kosovës. Në anën tjetër, rekomandimet janë të shkruara saktë kujt i drejtohen, po problemi kryesor është mosrespektimi i tyre, por mbi të gjitha, edhe një herë po them, po e humbim interesimin, ngase vetë jemi krejtësisht të paimterësuar, sinqerisht dhe t'i ndajmë a po flasim për raportin e Avokatit të Popullit, a po flasim për shumë tema që ka nevojë vendi. Të bëjmë debate të sinqerta që sinqerisht ka nevojë ky vend për shumë tema të tjera, ama për raportin sot po flasim dhe sinqerisht, nënkryetar, pa dashur ta teproj, unë u befasova se çka po ndodh, ama të gjithë kolegët që e morën deri tash, sa unë kuptova, kanë qenë të njëjtë, në transkript janë të njëjtë.

Dhe unë kështu e mendova kur e tha kryetari, kanë diskutuar përfaqësuesit e grupeve parlamentare, edhe debati të vazhdohet tutje, jo të marrim ne edhe një herë fjalën dhe t'i themi të njëjtat gjëra.

KRYESUESI: Faleminderit! Teuta. sipas Rregullores unë jam i detyruar që deputetëve që kërkojnë fjalën, t'ua jap fjalën, domethënë ashtu si është e përcaktuar. Ndërkaq nëse kolegët përsërisin njëri-tjetrin, ajo s'është çështje e Rregullores, unë s'mund të korrektoj diçka të tillë. E kanë marrë fjalën dhe kanë folur përfaqësuesit e grupeve parlamentare, tani janë deputetët sipas radhës, sipas vullnetit t'i thonë ato që mendojnë.

Një deputet nuk mund të flasë dy herë për të njëjtën çështje, po nëse flet një herë në emër të grupit parlamentar, pastaj ka të drejtë që të marrë fjalën edhe një herë në emrin personal si deputet dhe besoj është në rregull.

Atëherë, vazhdojmë, fjalën e ka deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryesues!

Shpresoj që disa prej të gjeturave të këtij raporti do të jenë të gjeturat të cilat vërtet nuk do të përsëriten nga kolegët. Fundja, ne kemi të drejtën si deputetë që të flasim, sepse një pjesë jona besoj që e kanë pasur në dorë këtë raport dhe janë munduar ta analizojnë.

Unë do ta respektoj mendimin e secilit sot këtu, sepse mendoj që është me peshë që të flasim për të gjeturat e raportit të Avokatit të Popullit dhe po e them që në fillim, meqë Raporti për vendin që është publikuar në muajin prill e radhit këtë Institucion të Avokatit të Popullit si institucionin më të besuar në Republikën e Kosovës.

Unë këtu dua të përgëzoj për punën e mirë që po e bën avokati, natyrisht duke u munduar t'i adresojë sfidat me të cilat po përballen institucionet dhe, po ashtu ky institucion ka zbatuar në

përpikëri, në shkallën 100%, Programin Kombëtar për Zbatim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për vitin 2017. Këtë program nuk kanë arritur ta përmbushin institucionet e tjera, prandaj besoj që është një rast i mirë që duhet vlerësohet që mekanizma dhe institucione me peshë të tilla kanë marrë për bazë zbatimin e këtij programi tejet të rëndësishëm.

Edhe 2-3 pika do t'i përmend, meqë i thanë edhe kolegët e mi.

Raporti evidenton një numër të madh të sfidave sa i përket adresimit të shqetësimeve në raport me të drejtat e fëmijëve dhe meqë sot është Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve, besoj që duhet të potencohet, ashtu siç e ka thënë edhe raporti, Kosova po vazhdon që të ketë raste të diskriminimit të fëmijëve në këtë drejtim.

Vetëm nëse përmendim rastin e fundit në Karaçevë të Kamenicës, aktin makabër të një prindi, i cili me mjete të forta godit fëmijën e tij deri në vdekje.

Besoj që secilin deputet, dhe jo vetëm, secilin qytetar të Republikës së Kosovës e ka shqetësuar në së të madhe ky veprim, ky akt makabër, janë shumë e shumë akte të tilla të rënda, ku fëmijët diskriminohen qoftë me punë të rënda, qoftë edhe një pjesë e tyre që janë lypës në Kosovë. Besoj që institucionet duhet t'i marrin me shqetësim dhe t'i adresojnë këto sfida, të cilat janë të publikuara në këtë raport.

Po ashtu edhe diskriminimi gjinor që është përmendur në raportin e Avokatit të Popullit, nëse e shohim vetëm një raport të OSBE-së të publikuar ditë më parë thuhet se 67% të respondentëve, të cilët i janë përgjigjur këtij raporti, thonë që gratë meritojnë dajak, po e them ashtu siç është thënë në këtë raport dhe ky është shqetësim që duhet të adresohet nga institucionet e Republikës së Kosovës kur kemi veçanërisht parasysh numrin e madh të rasteve të dhunës në familje dhe këto veprime, do të thotë këto mesazhe duhen të jenë alarm për institucionet e Republikës së Kosovës, në mënyrë që të punojmë që këto raste të diskriminimit të mos jenë të pranishme në Republikën e Kosovës.

Po ashtu me të drejtë Avokati i Popullit ka adresuar edhe shqetësimin që rekomandimet e avokatit nuk janë marrë parasysh nga Qeveria dhe për kontrollin e dobët që Kuvendi e ka bërë në raport me Qeverinë.

Këtu si deputete ndaj shqetësimin e njëjtë dhe them që Qeveria duhet të jetë e pranishme në seanca plenare, ajo është e pranishme në mbledhje të komisioneve, por duhet të jetë e pranishme veçanërisht kur diskutohen tema që janë me interes për qytetarin, e kur ne si deputetë kërkojmë sqarime.

Besoj që është jo vetëm e domosdoshme, por është obligim i tyre që të përgjigjen në shqetësimet e deputetëve, të cilat nuk janë të pakta.

Po ashtu në bazë të raportit shihen se një numër i madh i ankesave kanë të bëjnë me zvarritjen e procedurave gjyqësore, siç u tha edhe në fillim.

Kështu që, mu për këtë avokati ka lëshuar edhe një raport të detajuar në lidhje me një lidhje efektive të zvarritjes së procedurave gjyqësore, kam pasur rast ta shoh këtë raport dhe besoj që është një raport i mirë që institucionet duhet të adresojnë si duhet, në mënyrë që zvarritja e lëndëve në gjykata të mos ndodhë, fundja është edhe njëri prej shqetësimeve që ka qenë edhe adresim në Raportin për vendin.

Përgjegjësish mendoj që ne si institucione e kemi për obligim t'i trajtojmë me seriozitet dhe e vlerësoj që sot avokati ishte në raportim në Kuvend.

KRYESUESI: Faleminderit! Tani fjalën e ka deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Në fillim më duhet të përmend faktin që një prej institucioneve kushtetuese që përpilon raport më serioz, më të detajuar për Kuvendin e Republikës së Kosovës pa dyshim që është Institucioni i Avokatit të Popullit.

Unë e falënderoj edhe për angazhimin e tij në këtë drejtim. Fakti që ky institucion është ndër institucionet më të besueshme edhe për qytetarët e Republikës së Kosovës, natyrisht që qëndron, për faktin se në qoftë se sot kemi një institucion, të paktën një institucion e kemi që mund të konsiderojmë se merret me shqetësimet dhe brengat që i kanë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Në këtë drejtim unë po ndalem në disa prej çështjeve që përmenden në këtë raport të Avokatit të Popullit, por që u përmendën edhe në deklarinimin e zotit Jashari.

E para, çfarë për mua është shqetësuese që nuk e di pse ministri i Drejtësisë nuk qëndroi këtu për ta dëgjuar fjalimin e zotit Jashari, për shkak se të gjitha deklarinimet e tij në raport me sistemin e drejtësisë janë të kundërta me ato çfarë paraqet raporti i Avokatit të Popullit.

Për mua si deputete dhe si qytetare e këtij vendi është shqetësim kur kuptoj që qytetarët e Republikës së Kosovës duhet të presin 8 vjet e gjysmë për t'iu zgjidhur një rast, qoftë në aspektin penal, qoftë civil apo të tjera. A di çka do të thotë për një qytetar që të presë tetë vjet e gjysmë të marrë drejtësi për një rast, apo që të përfitojë të drejtat e tij. Unë vetëm po dua të përmend nenin 29, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës që thotë që çdokush që arrestohet ka të drejtën që të nxirret në gjykim brenda një periudhe të arsyeshme. A është periudhë e arsyeshme,

në qoftë se flitet për tetë vjet e gjysmë? Por po ashtu kur kemi raste sidomos këto të fundit që po i dëgjojmë, gjashtë vjet qëndron në paraburgim, në fund shpallësh i pafajshëm.

Secili shtet normal do të shqetësohej në qoftë se do të dëgjonte shifra të tilla alarmante. Unë kam kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës një raport se sa janë rastet e personave, të cilët janë dënuar pa arsye apo për personat e dënuar ose arrestuar pa arsye dhe besoni që kjo shifër që ma ka sjellë Këshilli Gjyqësor i Kosovës është tepër problematike. Për shembull, në vitin 2004 kanë qenë 14 raste, pra vetëm për vitin 2004. Për vitin 2017, 153 raste, domethënë 153 persona janë dënuar apo janë mbajtur në burg pa arsye. Kjo nuk ndodh kurrkund përveç në këtë Kosovën tonë, të cilën aq shumë po mundohemi ta rregullojmë, por fatkeqësisht Qeveria aktuale, sikur edhe qeveritë e kaluara, nuk e kanë as vullnetin më të vogël për të bërë diçka në këtë drejtim.

Po ashtu, në raportin e Avokatit të Popullit përmendet një çështje që është e rëndësishme, ka të bëjë me përmbaruesit privatë. Unë po lexoj vetëm disa paragrafë të këtij raporti, për shkak se e pata shprehur shqetësimin edhe në emër të grupit në njërën prej seancave parlamentare. Në këtë raport thuhet që në disa raste përmbaruesit privatë kanë tejkaluar normat ligjore, të cilat përcaktojnë kufizimet lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, duke lëshuar urdhra përmbarimorë për ekzekutimin e vendimeve në bankat komerciale, me ç'rast kanë bllokuar llogaritë bankare të ankuesve. Avokati i Popullit ka vërejtur që ankuesit kanë qenë shfrytëzues të ndihmave sociale, pensioneve të pleqërisë dhe këto të hyra janë bllokuar në procesin e ekzekutimit në kundërshtim me ligjin. Pra, sot kemi përmbarues që bllokun llogaritë bankare të pensionistëve dhe të qytetarëve që jetojnë me ndihma sociale, në kundërshtim me ligjin. Unë do të doja ta pyesja këtu Avokatin e Popullit, a keni vepruar me ndonjë kallëzim për keqpërdorim të detyrës zyrtare? Sepse kur një përmbarues vepron në kundërshtim me ligjin, po e keqpërdor detyrën zyrtare. Pra, është dashur të bëhen kallëzime në këtë drejtim, për faktin se në raport thuhet pastaj pas intervenimeve të Avokatit të Popullit është arritur zgjidhja. Në rregull, është arritur zgjidhja, shumë mirë. Janë zhbllokuar llogaritë bankare të qytetarëve tanë, të cilët jetojnë me ndihma sociale apo pensionistët tanë. Por, çfarë është bërë me atë përmbarues, ai vazhdon përsëri njëjtë. Kemi raste kur përmbaruesit privatë janë bërë milionerë pikërisht duke nxjerrë vendime shpesh të kundërligjshme.

Prandaj, edhe një herë po e them që ka qenë tepër e rëndësishëm që ministri i Drejtësisë të ishte në këtë seancë, gjithashtu zonja Haxhiu e ngriti shqetësimin se a e paraqet Rregullorja e Kuvendit në mund të na përgjigjet neve Avokati i Popullit. Po vetë fakti që Kushtetuta e kërkon që raporti i Avokatit të Popullit duhet të prezantohet këtu në foltoren e Kuvendit, natyrisht që pastaj kjo nënkupton që deputetët mund të ngrenë shqetësimet e tyre dhe pastaj Avokati i Popullit duhet të përgjigjet. Dhe, gjithashtu edhe një çështje është përmendur herën e kaluar, në seancën e kaluar, ka të bëjë se a duhet të votohet apo jo raporti i Avokatit të Popullit. Ne kemi marrë një shkresë nga Institucioni i Avokatit të Popullit që na ka kërkuar që raportet e këtij

institucioni të mos votohen, pra të mos i nënshtrohen votimit, por vetëm rekomandimet për institucionet apo pasqyra financiare, pra, raporti se si është shpenzuar buxheti.

Dhe, Komisioni për Legjislacione e ka pranuar kërkesën e Avokatit të Popullit dhe në draft-rregulloren që ka kaluar në parim, që shumë shpejt do të jetë shqyrtimi i dytë i saj në Kuvend, është paraparë që raporti i Avokatit të Popullit të mos i nënshtrohet votimit, sepse përnjëmend dallon prej institucioneve të tjera, për shkak se ka të bëjë pak a shumë me të drejtat e njeriut, shkeljen e të drejtave të tyre dhe besoj që kështu do të rregullohet në të ardhmen. Mirëpo, nuk ka logjikë që rekomandimet dhe pasqyrat financiare të mos votohen në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Faleminderit, por unë besoj që është e rëndësishme që në këto pyetje, shqetësime që i ngritëm, të kemi përgjigje nga Avokati i Popullit.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, unë besoj që për këto dhe për pyetje ose çështje të tjera do të mund të marrim përgjigje në fund të kësaj pike të rendit të ditës. Fjalën e ka deputeti Muharrem Nitaj. Pse Teutë? Teuta Haxhiu, replikë, dy minuta!

TEUTA HAXHIU: Nënkyetar, dëgjova se ma përmendi emrin dhe kam të drejtë, a po? Unë çka di dhe çka lexoj në dokumente, po them çka nënkupton dhe çka mund të nënkuptojë kushdo qoftë, edhe Albulena në këtë rast, unë nuk e di. Krejt çka shkruan, të nënkuptohet e të kuptohet është krejt diçka tjetër, çka shkruan në dokumente, në debatin e thirrur nga unë dhe mbështetja nga deputetët që ka qenë në mandatin e kaluar për mosrespektimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, një prej rekomandimeve ka qenë edhe kjo që raporti i Avokatit të Popullit të mos votohet.

Çështja e raportit financiar do të duhej patjetër të shkojë nëpër komisione apo të gjendet pikërisht modeli, modaliteti se si do të shqyrtohej ajo çështje, por si raport, edhe një herë them, ka qenë rekomandim i votuar në seancën e Parlamentit të Kosovës kur unë kam thirrur debatin, pra në mandatin e kaluar. Ai është dokument i shkruar. Po flas për diçka që shkruan, e jo për atë që nënkuptohet, apo për atë që dikush mund të shohë ëndrra.

KRYESUESI: Muharrem Nitaj e ka fjalën. Ju lus, Muharrem, më fal një minutë, kolegë, meqë kemi një problem teknik, ata që kanë kërkuar fjalën, të kërkojnë edhe një herë, sepse kemi një problem teknik. Tani është në rregull, urdhëro Muharrem!

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, kryesues!

E dëgjuam në shumicën e diskutimeve të kolegëve deputetë është vlerësuar raporti i Avokatit të Popullit, unë besoj që duhet të thuhet në mënyrë shumë më specifike, një raport i shkëlqyer që ka, besoj, një ekspertizë shumë profesionale, mendoj një ekzemplar shembull se si duhet të përpilohen raportet në rastin konkret dhe rekomandimet, në këtë rast, për të drejtat e njeriut që nxirren për debat, për diskutim dhe eventualisht edhe për votim në Kuvendin e Kosovës.

Zonja Kadrijaj pak më herët foli për kontrollin parlamentar për Qeverinë e Kosovës. Raporti është i vitit 2017, vërtet është për keqardhje pse kontrolli parlamentar për Qeverinë e Kosovës paska qenë vetëm 6%, mirëpo unë besoj, për shembull, që ky raport nuk e ka përfshirë Qeverinë aktuale, ka mbërritur të ketë vetëm tre muajt e fundit dhe jam shumë i bindur që në raportin që vjen për vitin tjetër Avokati i Popullit do ta përfshijë një shkallë tjetër që do të jetë shumë më e kënaqshme e kontrollit parlamentar mbi Qeverinë e Kosovës. Nëse ne nuk do të duhej ta votojmë këtë raport dhe është krejt logjike të mos votohet raporti. Raporti është përpiluar për vitin 2017, por eventualisht vetëm rekomandimet e këtij raporti, atëherë do të duhej të fokusoheshim më tepër në rekomandimet e raportit, e jo të diskutojmë dhe të konstatojmë ato që i ka përfshirë raporti dhe po i përsërisin si papagaj në këtë sallë të Kuvendit.

Unë po e them edhe një herë, e përgëzoj Avokatin e Popullit për një raport të shkëlqyer. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën ia jap deputetes Xhevahire Izma.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Përsëritet, kolegë të nderuar,

Po shihet që kemi mbetur shumë pak në sallë, po kryesisht gratë diskutuan mbi raportin e avokatit, edhe pse do të kërkojë replikë zoti Nitaj, unë detyrohem ta kundërshtoj se hiç nuk besoj që do të dalim më mirë, s'jemi duke e bërë namin as në këtë mandat në raport me Qeverinë, me kontrollin ndaj Qeverisë dhe mendoj në këtë drejtim na kishte kursyer avokati se është dashur të na adresohet edhe neve deputetëve. Thjesht të na sugjeronte të jemi më aktivë, sepse po shihet që pastaj edhe roli ynë po bie, domethënë është shumë periferik në raport me proceset.

Vazhdimisht nuk mund ta trajtojmë në mënyrë profesionale, për arsye që kolegët e mi shumë mirë i thanë që janë në komisionet përkatëse dhe i adresojnë çështjet e caktuara në mënyrë shumë më profesionale, por megjithatë si deputetë kemi interesin edhe nuk ka qenë e vështirë të kuptohet, sepse ka qenë në mënyrë shumë profesionale i punuar. Pra, unë u bashkohen kolegeve të mia që ky raport është me kualitet shumë të lartë dhe është shembull si duhet sjellë edhe nga agjencitë e tjera, sepse na vijnë ka 2-3 fletë, edhe ato janë me germa të vogla e nganjëherë të paqarta, por edhe ne i kursejmë, nuk ua themi me emra, e ishte dashur t'ua themi.

I nderuar Avokat i Popullit,

Unë do të fokusohem vetëm në dy pika, për të cilat edhe pse do të përsëritëm, mendoj që s'ka kurrëgjë të keqe, sepse derisa arrijmë të bëjmë një punë të mirë, kur punët e mira kur s'janë të përmbushura, atëherë të përsëriten deri në fund, deri atëherë kur i shohim që janë kryer, kanë përfunduar pozitivisht. Fillimisht pajtohemi plotësisht me koleget e mia paraprahe që e diskutuan çështjen e përmbaruesve dhe çështjen e votimit të raportit. Pra, askund në shtetet me demokraci të zhvilluar nuk del raporti i Avokatit të Popullit në votim, por njëkohësisht është edhe te çështja

e transmetuesit publik, domethënë ishte veç diskutim sa për sqarim, informacion, por jo të votohet. Po mendoj që herën tjetër do të kemi mundësinë ta rregullojmë këtë me Rregullore, edhe do të diskutojmë, por jo ta votojmë.

Unë e vlerësoj përkushtimin dhe punën e gjithë stafit brenda Institucionit të pavarur të Avokatit të Popullit lidhur me vendosjen si prioritet të raportit mbi gjendjen, pra edhe shëndetin e fëmijëve tanë dhe ato të dhëna që na i dha që me të vërtetë janë shqetësuese, kur e pamë përdorimin e drogave. Po shihet që është një alarm që i adresohet Qeverisë dhe jo vetëm, po shumë institucioneve dhe mekanizmave të tjerë që kanë mundësi për një preventivë, sepse ne kur i shërojmë e kemi shumë më të vështirë se sa të krijojmë instrumente që kishin bërë preventivë, pra të mos i kemi këtu shifra, se edhe ashtu nuk kemi një popull me një numër shumë të madh, e të dalë kjo shifër, kur në krejt botën dihet që e kemi pasur goxha si poentë pozitive mesataren, por kjo është shqetësuese, mendoj që kemi punë veçanërisht Komisioni për Shëndetësi. Konsideroj që duhet pasur shumë të veçantë këtë adresim dhe këtë shqetësim.

Më lejoni të theksoj që kisha dashur që në kuadër të rekomandimeve të më ketë parasysh Avokati i Popullit lidhur me idenë që ka megjithatë një mungesë të informimit lidhur me punën që e bën Avokati i Popullit, kryesisht në nivel më shumë lokal. Pra, qytetarët nuk janë shumë të informuar se Avokati i Popullit e bën punën e vet pa pagesë, edhe kisha pasur dëshirë që në këtë drejtim të fokusohet, pra të ketë një bashkëpunim më të mirë me nivelin lokal. Ta kuptojnë edhe qendrat sociale që për shumë çështje, për të cilat nuk janë kompetente, nuk dinë ku të adresohen, pse jo të kenë më shumë vizita, pse jo të përdoren më shumë për lajmërimë të ndryshme, sepse e kanë pa pagesë, të përdoret transmetuesi publik edhe për një lloj marketingu e fushatat për të cilat ka nevojë në momente të caktuara.

Edhe pse kolegja ime Blerta e përmendi, unë mendoj që nuk është shumë edhe një herë të kthehem te çështja e të drejtave të fëmijëve, veçanërisht kur sot e shënojnë Ditën Ndërkombëtare të tyre. Kush është ai person që nuk u shqetësua me rastin e vdekjes së fëmijës 14-vjeçar nga dhuna e prindit, ku patëm edhe një element ose informacion të rëndësishëm me statistikat, ku në vitin e kaluar në vendin tonë një numër mbi 40% e fëmijëve pranojnë që kanë qenë të abuzuar, ose kanë përjetuar dhunë fizike nga familja. Konsideroj që kur vjen prej Avokatit të Popullit, nuk ka asnjëherë një vlerësim se po i shti hundët politika diku, mendoj që ka mundësi, meqenëse ka mundësi të merren fonde më shumë se institucionet e tjera, pse jo një bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit, pra ku mbi 200 studentët dalin për çdo vit të diplomuar dhe asnjëherë s'kanë mundësi as praktikë të bëjnë. Thjesht të krijohen ekipe mobile, ku bisedohet me fëmijët, informohen, ju tregohet për të drejtat e tyre ku ata e marrin informacionin që askush nuk ka të drejtë të ushtrojë dhunë mbi ta, t'i prekë as fëmijët, as prindërit, as kujdestarët, as mësuesit e tyre dhe mendoj që në këtë drejtim Avokati i Popullit mund të luajë këtë rol, sepse nëse shpeshherë kur fillon të bëjë edhe Qeveria vlerësohet që ne e bëjmë për poenë politikë, edhe nëse nisim një aksion të tillë. Nëse ka mundësi të ndihmohet, atëherë qysh ne i drejtohem avokatit, le të

adresohet edhe ky te ne nëse ne kemi nevojë, domethënë kemi mundësi t'i ndihmojmë në këtë drejtim.

Pra, unë konsideroj që e drejta e njeriut plotësohet, realizohet kur arrihet pak ndryshim edhe te mentaliteti, se ne e kemi këtë problem në vendin tonë. Problemet që ndodhin brenda në familje nuk duam t'i qesim jashtë, edhe këto sigurisht që vjen te një përfundim fatal qysh e patëm rastin e fëmijës 14-vjeçar. Mendoj që në raportin e ardhshëm e kisha sugjeruar me shumë mirësjellje, e kuptoj mënyrën qysh e bëjnë, mirëpo të mos i kursejnë, le t'i adresojnë me emër dhe mbiemër ku ka më shumë atakime në aspektin e mosrealizimit të drejtave të njeriut. Pra, mendoj që duhet të marrë guxim, po them duke u nisur edhe prej nesh, pse jo, mos na kurse. Ju e kenë thënë në raport që nuk e kryeni punën tuaj duke mos monitoruar Qeverinë, por besoj që edhe brenda sjelljes sonë si deputetë, diskursin dhe ambientin krejt është mirë ta bëni, sepse jeni institucion i pavarur dhe na edukoni ku ka nevojë.

Mendoj që as nuk diskutohet çështja a votohet a jo, po shpresoj do të jetë hera e fundit që votoj për raportin, e herëve të tjera veç do ta diskutojmë, nuk do ta votojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Sami Kurteshi dhe i fundit pastaj është deputeti Bekim Haxhiu.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Sami, një minutë, një sqarim për kolegët. Ka folur edhe në emër të Grupit Parlamentar, tani ka të drejtë të flasë si deputet. Urdhëro!

SAMI KURTESHI: Natyrisht që vërejtja e Avokatit të Popullit se Lgjislativi nuk mund, Kuvendi nuk mund ta mbikëqyrë Ekzekutivin, vërtet i ka rrënjët në vetë Kuvendin, sepse këtu kemi njerëz që nuk kanë tolerancë t'i dëgjojnë të tjerët dhe vazhdimisht si papagaj i cilësojnë të tjerët, që është shumë e rrezikshme. Unë nuk kam parë njerëz pa edukatë parlamentare që vazhdimisht i pengon tjetri. Kjo është shqetësuese në këtë rast, dhe unë po e dëgjoj disa herë, po t'i kthehem çështjes.

Megjithatë, kemi çështje që duhet t'i diskutojmë, sepse kishim zëra jo t'i jepet e drejta e Avokatit të Popullit për përgjigje, jo të mos i jepet! Sa i përket çështjes së votimit të raportit të Avokatit të Popullit, unë kam qenë pjesë e Grupit Punues për Rregulloren, ne kemi bërë përpjekje të futet aty që raporti i Avokatit të Popullit të mos votohet. Edhe unë mendoj se krejt deputetët e këtij Kuvendi kanë ndonjë arsye të plotë, po them, që ta përkrahin këtë amendament kur të vijë në Kuvend të votohet. Kjo është shumë e drejtë, në këtë drejtim megjithatë unë mendoj se duhet të thuhet disa gjëra, sepse mbeta te gjyqësori dhe kisha vetëm edhe një çështje për ta theksuar, domethënë moszbatimin e vendimeve të plotfuqishme të gjykatave. Vetëm në vitin 2017 vërehen

rreth 2500 lëndë ose raste, vendime të gjykatave që nuk zbatohen. Domethënë, janë vendime të plotfuqishme dhe kjo e tregon pafuqinë e shtetit.

Dhe zbatimi lidhet me Gjyqësorin, por edhe me Ekzekutivin, sepse asnjë gjykatës nuk e ekzekuton vetë vendimin, por shkojnë forcat e ndryshme dhe e zbatojnë. Sa u përket rekomandimeve, unë këtu e kam edhe një vërejtje, edhe një kërkesë që dua ta ndaj me të gjithë kolegët, në të vërtetë unë kërkoj nga Avokati i Popullit që rekomandimet t'i ndajë, përveç që janë tekst, t'i ndajë si pjesë e veçantë, t'ia sjellë Kuvendit, Kuvendi të diskutojë për rekomandime, për masën e zbatimit të tyre dhe për mundësinë e zbatimit të rekomandimeve. Edhe kjo do të ishte çështja kryesore që Kuvendi t'i diskutojë rekomandimet e Avokatit të Popullit a janë të zbatueshme a s'janë? Pse janë të tilla dhe t'i miratojë si rekomandime të veta e pastaj të kërkojë zbatimin e tyre dhe të përcjellë zbatimin e tyre. Kjo do të ishte ajo çështja kryesore që do të duhej të bëhej, dhe përveç votimit të raportit financiar, Kuvendi të kërkonte zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit me çdo kusht dhe t'i pranonte si të vetat. Unë po e them nga përvoja e shumtë, nga përvoja të shumta në botën demokratike, në të vërtetë për Avokatin e Popullit rezervohet një seancë e vetme ku i gjithë Kabineti qeveritar është i pranishëm dhe janë të pranishëm udhëheqësit e pjesëve, segmenteve të ndryshme të sistemit të drejtësisë, që të ballafaqohen me kritikën, me lëvdatat, ose me punën.

Tash po kthehem te një çështje, përveç rekomandimeve unë kam edhe një vërejtje në raportin e tanishëm. Në kuadër të Avokatit të Popullit në vitin 2015 është krijuar, në fund të vitit 2015, mekanizmi kombëtar kundër torturës, që ka për detyrë në të vërtetë që të trajtojë çdo rast të përdorimit të dhunës, përveç tjerave, në institucionet e mbajtjes sido që të quhen ato, qendra të paraburgimit, burgje apo stacione policore, në çdo vend ku vepron dora e shtetit, kur kemi kufizime të lirisë.

Vërejtja ime, po edhe si grup parlamentar, është që as në raportin e vitit 2016 dhe as në raportin e vitit 2017 nuk trajtohet rasti i Astrit Deharit. Kjo do të ishte një nga detyrat themelore të mekanizmit kombëtar kundër torturës. Nuk trajtohet as rasti i dëshmitarit kryesor, Makolli, që vdes diku në prill të vitit 2017, nga ky mekanizëm. Unë mund ta marr me mend se është numër i kufizuar i njerëzve e gjëra të tilla, mirëpo ky është një obligim. Në të vërtetë është obligim i këtij mekanizmi, që ta trajtojë çdo vdekje në të gjitha hapësirat publike ku ndalen personat nga shteti, në çfarëdo mënyre, me çfarëdo preteksti. Unë pres që në raportin e ardhshëm të mekanizmit kombëtar, që është edhe si institucion i pavarur, domethënë brenda Avokatit të Popullit të trajtohen të gjitha rastet veç e veç të vdekjeve në burgje, pa marrë parasysh arsyen, edhe të çfarëdo tejkalimi të përdorimit të forcës, qoftë ajo e autorizuar, qoftë ajo e paautorizuar apo tejkalim, sidoqoftë, sepse në të vërtetë edhe me Konventën kundër torturës, po edhe me protokollin opsional kundër torturës thelbi i krijimit të mekanizmit kombëtar kundër torturës, në të vërtetë thelbi është te personat që ndalen, të privohen nga liria, për çështje që kanë karakter politik, qofshin ato edhe në rast të grushteve ushtarakeve. Ky ka qenë thelbi që rrjedh prej një

përvoje të tmerrshme historike, natyrisht nga Amerika Jugore dhe kjo kishte me qenë një nga detyrat e këtij mekanizmi dhe unë kërkoj nga Avokati i Popullit, që të gjitha këto raste t'i përfshijë në raportin e mekanizmit kombëtar kundër torturës dhe ky mekanizëm në raportin e ardhshëm të mos ketë karakter përshkrues, po të ketë karakter edhe normativ, në të vërtetë ashtu si e ka, si janë pritjet për këtë mekanizëm.

Unë mendoj se Avokatit të Popullit duhet t'i jepet e drejta për përgjigje në çfarëdo pyetje, sugjerim, përsëri qëndroj pranë kësaj. Unë kërkoj nga të gjithë kolegët, që kur të vijë Rregullorja e punës së Kuvendit, sidomos këtë çështje ta votojnë, të votojnë për që raporti i Avokatit të Popullit si dokument të merret për njoftim, që rekomandimet e Avokatit të Popullit si dokument i veçantë, të pranohen nga kuvendi si rekomandime të Kuvendit, të diskutohen, mund edhe të mos pajtohem me to, por kur të diskutohen të pranohen si dokument i Kuvendit, ashtu siç bëhet në vendet prej nga vjen Institucioni i Avokatit të Popullit dhe atëherë Kuvendi ta marrë përgjegjësinë për përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Kjo do të ishte ndihma më e madhe, që ne ta forcojmë këtë institucion që ka të bëjë me të drejtat e njeriut, që ka të bëjë me sistemin e drejtësisë dhe me gjithë sistemin shtetëror. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar zoti Jashari, zoti Avokat i Popullit,

Do të doja shumë që këtë raport të shkëlqyer të Avokatit të Popullit ta diskutonim në një përbërje shumë më proaktive të deputetëve edhe që debati ynë të mos të fokusohet në atë, se a duhet apo s' duhet Avokati i Popullit të japë përgjigje në çështje të cilat mund të ngritën rreth raportit, rreth rekomandimeve, rreth të gjeturave, por që debati dhe diskutimi ynë si deputetë, të jetë dhe do të duhej të ishte me aktorët përgjegjës, të cilët këto shkelje që i ka paraqitur Avokati i Popullit t'i diskutojmë ne me ta.

Edhe në legjislaturat e kaluara, kur atëherë Avokat i Popullit ishte zoti Kurteshi, kam kërkuar që zoti Avokat i Popullit të ulet këtu, këtu e ka vendin sot, jo në pjesën e mysafirëve, këtu dhe pastaj të jetë bashkë me Qeverinë që edhe interaksioni i debateve të jetë këtu mes nesh, mes aktorëve.

Ta zëmë, një problem që qysh në fillim të punës sime si deputet e kam paraqitur për problemin e çantave të stërngarkuara tek fëmijët shkollorë, problemet shëndetësore që u janë shkaktuar për shkak të mbingarkesës së peshës së rëndë të çantave, nuk është zgjidhur ende. Ai mund të paraqitet raport pas raporti, por ministri i Arsimit ishte këtu dhe shkoi. Do të doja që edhe një herë ta diskutonim bashkë me ministrin e Arsimit këtë problem. Përveç kësaj, problemin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, problemet që ata i kanë për arsimim, përkujdesje shëndetësore, pastaj për sëmundjet e rralla të fëmijëve, të cilët po mbeten pa përkujdesje shëndetësore. Dhe, pa

dalë te ajo pjesa tjetër e diskriminimit etnik, i cili po ndodh në disa shkolla të Kosovës e që mendoj se do të duhej t'i diskutonim bashkë me përgjegjësit dhe me aktorët.

Për çka unë dua ta falënderoj edhe mënyrën se si e ka paraqitur Avokati i Popullit, që dallon në raport me raportet tjera të paraardhësve të tij, që janë shumë profesionale, të argumentuara dhe të radhitura ashtu si duhet, të radhitura shumë mirë. Problemet që kanë rrjedhë edhe nga mosfunksionimi i Gjyqësorit, një brengë jona e madhe, jo vetëm e ministrit aktual, por një problem i trashëguar me stërngarkimin e lëndëve gjyqësore dhe mendoj se do të duhet pastaj që prapë edhe këtë debat dhe këtë problematike ta diskutonim me ministrin e Drejtësisë, ashtu si do të duhej ta diskutonim me ministrin e Shëndetësisë mungesën e sigurimeve shëndetësore dhe jo universalitetin dhe barazinë e trajtimit të pacientëve në institucionet publike të Republikës së Kosovës, sepse ka edhe një mungesë të një sistemi shëndetësor uniform brenda territorit të Republikës së Kosovës, jo vetëm në ato probleme ku ka pasur probleme jashtëzakonisht të mëdha në shtrirjen e sovranitetit të Kosovës, por edhe një mungesë të sistemit shëndetësor edhe në vet kryeqytetin e Republikës së Kosovës, pa përfshi atë pjesën ambientale apo dëmtimin, i cili u është bërë qytetarëve tanë me ndotjen e ambientit.

Problemi i paraqitur nga Avokati i Popullit, i të drejtave të shkelura të punëtorëve të Fabrikës së Tubave në Ferizaj, do të duhej të paraqitej edhe me një problem tjetër dhe mendoj se avokati ndoshta do të na sqaronte, problemin e 480 punëtorëve të ish-ndërmarrjes "Ramiz Sadikut", të cilëve nuk u është paguar 20%-shi dhe të cilët kanë vrapuar institucion më institucion për të realizuar të drejtën e tyre. Mendoj dhe e di që edhe një kërkesë të tyre e kanë paraqitur edhe te Avokati i Popullit dhe mendoj se është një çështje që duhet të trajtohet bashkë me problemin, i cili është edhe me punëtorët e Fabrikës së Tubave në Ferizaj.

Problemet që janë adresuar dhe rekomandimet janë të qëlluara. Unë nuk besoj që ka ndonjë dallim në mes neve deputetëve, nëse duhet apo s' duhet këto rekomandime të votohen. Unë besoj që këtu jemi të gjithë të një mendimi, se ne duhet të diskutojmë për problemet, t'i zgjidhim ato. Sa i përket Avokatit të Popullit ne mund ta shqyrtojmë vetëm aspektin e raportit financiar, por që problemet të cilat Avokati i Popullit i paraqet ne do të duhet t'i marrim shumë më seriozisht me një përkushtim më të madh. Nëse ne për votim marrim pjesë 80 apo 90 deputetë, nganjëherë edhe në mbi 100 deputetë, në zgjedhjen e Avokatit të Popullit, interesimi për të zgjedhur Avokatin e Popullit ka qenë shumë i madh, ndërsa sot jemi 25 - 30 deputetë gjatë diskutimit të raportit të tij, atëherë kjo tregon një joseriozitet, së pari të vetë neve si deputetë, e pastaj edhe të institucioneve tjera, të cilat janë përfshirë në raportin e Avokatit të Popullit.

Edhe një herë, zoti Avokat, uroj të vazhdoni me këtë punë, sepse jeni duke e bërë një punë të mirë e të mrekullueshme. Shpresoj që vërtet të vazhdoni me këtë elan të punës dhe me këtë energji dhe që raportet tjera vërtet të jenë me aktorë që potencohen në raportin tuaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Teuta Haxhiu, urdhëro!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Vetëm se i kisha thënë zotit Kurteshi, të lus t'i marrësh rekomandimet nga debati që e kemi organizuar në mandatin e kaluar dhe në rekomandimet të cilat janë votuar normal dhe janë obligative edhe për institucionet, që tani nuk i kam përpara, por në një prej pikave është edhe koordinimi i komisioneve parlamentare, të cilat do të duhej të merren me fushat ku bien rekomandimet e Avokatit të Popullit, varësisht prej fushave, të takohen së paku në tre muaj.

Asnjëherë të vetme nuk janë mbledhur komisionet parlamentare, prandaj nga ato rekomandime ne jemi të obliguar si deputetë, pra t'i kryejmë edhe detyrat tona, por njëkohësisht me u bë presion edhe të gjitha institucioneve tjera, që nuk po i zbatojnë rekomandimet e Avokatit të Popullit. Pra, rekomandimet që kanë dalë nga debati janë rekomandime që na obligojnë edhe një herë, edhe pse jemi të obliguar t'i kryejmë detyrat në kuadër të fushëveprimtarisë së komisioneve nga jemi ne si deputetë.

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit, deputeti Adem Mikullovc.

ADEM MIKULLOVCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë, të them të drejtën, një gjë po më pengon. Raportin e lexova pak, pak mora vesh, pak s'mora vesh, por po më pengon që Avokati i Popullit ka të drejtë vetëm të sugjerojë, të rekomandojë, të propozojë, të tërheq vërejtjen, po nuk ka të drejtë ekzekutive. Kjo po më pengon.

Unë nuk e di si shkon puna me ligj e me gjyq, por ndoshta kishte qenë mirë të ketë ndërrim edhe në Kushtetutë, që në disa raste kur nuk preken të drejtat penale e thyerja e Ligjit, të ketë të drejta ekzekutive Avokati i Popullit. Kaq, nuk po e zgjas më.

KRYESUESI: Faleminderit! Tani, meqë s'kemi kolegë tjerë të paraqitur për diskutim unë ftoj edhe një herë për fjalën përfundimtare Avokatin e Popullit.

AVOKATI I POPULLIT, HILMI JASHARI: I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar deputetë,

Do të provoj të ju përgjigjem pyetjeve sipas renditjes, në rend të parë lidhur me pyetjen e deputetes Albulena Haxhiu dhe përmbaruesit privat lidhur me atë se çfarë ka bërë Institucioni i Avokatit të Popullit.

Ju njoftoj, se me të marrë këto dy ankesat e para që i referohen kësaj çështjeje ne kemi kontaktuar Odën e Përmbaruesve Privatë, kemi përcjellë një letër ku janë ngritur të gjitha këto shqetësime të shkeljeve ligjore dhe pastaj kemi marrë konfirmimin nga Oda e Përmbaruesve

Privatë të cilët e kanë ndërprerë këtë praktikë, mbi bazën e udhëzimeve që ka dhënë vetë kryetarja dhe vetë Oda e Përmbauesve Privatë.

Sa i përket çështjes së votimit apo jo të raportit të Avokatit të Popullit, më lejoni të shpjegoj praktikën më të mirë të të gjitha institucioneve të Ombucmanëve kudo në Botë, në fakt konsistojnë në faktin që Avokati i Popullit si institucion nuk është asgjë më tepër, se sa mekanizëm i Parlamentit, mekanizëm në duar të Kuvendit, në duar të deputetëve, për të mbikëqyrur të gjitha autoritetet publike, ose autoritetet ekzekutive. E njëjta filozofi është mishëruar edhe në Ligjin për Avokatin e Popullit në Kosovë dhe në fakt, këtu konsiston vet esenca pse nuk do të duhej që avokati i popullit, ose raporti i Avokatit të Popullit të votohej, sepse nuk ka kuptim logjik. Ideja është që përfaqësuesit e popullit pas shqyrtimit të raportit vjetor, pas konstatimit të shkeljeve që ka bërë Avokati i Popullit të hartojnë politika, të nxjerrin vendime, të marrin qëndrime, të hartojnë rezoluta për të rivendosur të drejtën e shkelur.

Pa rivendosjen e të së drejtës nuk mund të flitet për një progres të arritur lidhur me punën e Avokatit të Popullit, sepse është detyrë pastaj e vet përfaqësuesve të popullit për të ndërmarrë veprime. Nëse nuk ka veprime të ndërmarra, atëherë krejt cikli i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në një vend bie dhe nuk mund të pritët, as nuk mund të shpresohet për një përmirësim.

Lidhur me punën promovues të Institucionit të Avokatit të Popullit në pyetjen që u shtrua nga zonja deputete Xhevahire Izmaqi, po, është shumë e vërtetë. Avokati i Popullit tanimë ka një mbështetje të fuqishme financiare që do t'i sigurojë një qëndrueshmëri gjithashtu ende më të madhe këtij institucioni për tre vitet e ardhshme. Me këtë do të sigurohet ngritje e kapaciteteve, por gjithashtu më lejoni të njoftoj se në vitin 2017 është bërë edhe riorganizimi i parë në Institucionin e Avokatit të Popullit prej kohës së themelimit. Ky riorganizim besoj se do të sigurojë këtë qëndrueshmëri të institucionit dhe do të përmbushë këtë pjesë të rëndësishme, që ka të bëjë me promovimin, që është i barasvlershëm edhe me vet mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Lidhur me vërejtjen që pati zoti Kurtoshi do të kisha dashur të lus e t'i rikujtoj një detaj shumë të vogël, por po ashtu të rëndësishëm, zoti Kurtoshi, sepse Kushtetuta e Kosovës, kapitulli 12, neni 132, pika 2, thotë që Avokati i Popullit nuk pranon këshilla, udhëzime, sugjerime, nga asnjë institucion. Prandaj, këtu është në fakt gjithë esenca e pavarësisë që i garantohet këtij Avokati, në mënyrë që të mos politizohet, mos të ndikohet dhe të jetë sa më i pavarur.

Në anën tjetër, sa i përket rastit Dehari, ju siguroj që Avokati i Popullit e ka trajtuar këtë rast dhe po që është një draft raport i përgatitur, jemi në monitorimin e të gjitha seancave që janë mbajtur për këtë rast dhe gjithashtu, besoj se e dini që Avokati i Popullit qysh në momentin e parë ka tri opinione publike, që ka nxjerrë në momentin kur ka ndodhur rasti edhe në momentin kur kemi parë devijim të institucioneve publike, që e kanë trajtuar këtë çështje. Ato deklarime publike sigurisht, se mund t'i gjeni edhe në ueb-faqen e Institucionit të Avokatit të Popullit, mirëpo

vazhdojmë ta monitorojmë sepse konsiderojmë që në rastin Dehari ajo që është më e rëndësishme është i gjithë procesi, sepse sistemi gjyqësor është duke e trajtuar, janë duke u marrë me këtë rast. Mirëpo, detyrë jona për të parë është nëse ky proces gjyqësor i organizuar është në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, përkatësisht me praktikën gjyqësore të Gjykatës së Evropiane të Strasburgut dhe këtu Avokati i Popullit e ka pasur gjithë vëmendjen.

Prandaj, mendoj që për rastin Dehari është shumë më e arsyeshme kjo që ne kemi menduar për të përcjellë rastin prej momentit të parë deri në momentin e fundit, se si do të rrjedhë procesi dhe cili do të jetë verdikti. Mirëpo, për t'i konstatuar të gjitha shkeljet, pason një proces i tillë, që gjithashtu ka pasur një interes të fuqishëm dhe një interes të madh të opinionit publik në Kosovë.

Sa i përket pyetjes që shtroi deputeti zoti Haxhiu, të ju njoftoj se kemi një çështje shumë problematike, sa i përket realizimit të të drejtave të punëtorëve, jo veç të ndërmarrjes “Ramiz Sadiku”, por pothuajse të të gjitha ndërmarrjeve publike që janë privatizuar. Do t'ua jap veç një informatë të shkurtë. Dhoma e Posaçme në Gjykatën Supreme të Kosovës gjithsej përbëhet nga 21 gjyqtarë, kjo mbi bazën e Ligjit për Dhomën e Posaçme. Në bazë të numrit të lëndëve që ka kjo dhomë dhe mbi bazën e kohës që do të duhej të kenë dispozicion këta gjyqtarë për të zgjidhur këto konteste, realisht figuron se do të duhej të kenë në dispozicion dhjetë vjet në total edhe kjo, realisht mbi standardet që ka tanimë kjo gjykatë nuk premtan zgjidhje efektive të të drejtave të këtyre punëtorëve.

Ne e kemi ngritur si shqetësim mu për faktin që përbëjnë pjesën më të cënueshme të shoqërisë së Kosovës, sepse janë punëtorë që pjesa më e madhe e tyre jetojnë nga ndihmat sociale dhe nuk arrijnë të realizojnë kurrsesi kontributet që i kanë bërë gjatë gjithë kohës sa kanë qenë në marrëdhënie pune dhe presin me vite të tëra për të realizuar një të drejtë elementare, që shpeshherë kjo shumë nuk tejkalon ndoshta vlerën monetare diku prej 2 000 - 3 000, ose 4 000 euro. Prandaj, detyrohen të presin kaq vite të gjata. Nuk mund të pritet përmirësim.

Ne kemi rekomanduar që Dhoma e Posaçme dhe Ligji për Dhomën e Posaçme të ndryshohet, në mënyrë që të angazhohen gjyqtarë shtesë për të shpresuar që gjithë këta punonjës të marrin të drejtat që u garantohen me Ligj dhe me Kushtetutë.

Edhe dy vlerësimet e fundit, që u dhanë nga deputetët. Sa u përket vërejtjeve të zonjës Teuta Haxhiu dhe sugjerimit që ajo pati, unë mendoj që po, jemi shumë dakord. Institucioni i Avokatit të Popullit të gjitha raportet e veta, për secilin rast, në momentin e parë kur ato i dërgohen autoritetit përgjegjës, i dërgohen po të njëjtën kohë edhe komisioneve përkatëse parlamentare, në mënyrë që komisionet parlamentare të jenë në dijeni dhe në mënyrë që këto raporte të shfrytëzohen pastaj për të ushtruar kontroll dhe për të ngritur përgjegjësinë e autoriteteve përgjegjëse.

Dhe, krejt për fund, në pyetjen e zotit Mikullovcit dhe shqetësimin që ai ka, që mandati i Avokatit të Popullit konsiston në rekomandime dhe nuk ka fuqi ekzekutive, është një standard ndërkombëtar dhe këtë standard e ka përfaqësuar edhe Kosova. Ne do të donim që në raste të caktuara ndoshta të kemi edhe mundësi të tilla, për të ndikuar te autoritetet e papërgjegjshme që nuk kanë zbatuar rekomandimet e Avokatit të Popullit, që kjo të ndryshojë, mirëpo megjithatë, mekanizmi i fundit që mund t'i dalë në ndihmë jeni pikërisht ju, deputetë të nderuar, e për këtë arsye edhe sot ne raportojmë para jush, në mënyrë që pastaj ju t'i dilni në ndihmë vet Institucionit të Avokatit të Popullit, se ju jeni ata që keni miratuar këtë ligj, ju jeni ata që më keni zgjedhur mua dhe keni zgjedhur Avokatin e Popullit, i keni falur besimin për të ju njoftuar juve mbi të gjitha shkeljet që bëhen në Kosovë, që në momentin e fundit pastaj ju të intervenoni për atë që u tha më herët, vendimeve, qëndrimeve rezolutave apo edhe opinioneve të ndryshme që mund të nxirni nga kjo, ose për të thirrur në përgjegjësi institucionet përgjegjëse. Faleminderit edhe një herë për vëmendjen!

KRYESUESI: E falënderojmë Avokatin e Popullit për raportin, për paraqitjen e tij dhe për përgjigjet konkrete që dha.

Tani ne kemi përmbyllur punën me këtë pikë të rendit të ditës. Sipas procedurës, sipas Rregullores, ne do të duhej të vijonim me procesin e votimit, por në sallë janë vetëm 48 deputetë. Kjo do të thotë që ne s'kemi kuorum. Kemi në rend të ditës edhe katër pika tjera, por sipas praktikës dhe parimit që kemi vënë, nëse s'votohet pika që diskutohet, nuk mund të kalojmë në pikën tjetër. Kështu që unë jam i detyruar ta ndërpres seancën dhe Shërbimi i Kuvendit do të ju njoftojë për kohën e vazhdimit të saj. Mirupafshim!

* * *

E hënë, 4 qershor 2018

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 17, 30 maj dhe 1 qershor 2018

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

I hap punimet për vazhdimin e seancave plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Fillojmë me pikat e papërfunduara nga seanca plenare më 16, e vazhduar më 17, 18, 20, 26 prill, 31 maj e 1 qershor 2018, si në vijim.

I kemi njëmbëdhjetë pika, të cilat janë të bartura nga këto seanca, në momentin kur kemi kushte për votim, do të futemi drejtpërdrejt në votim.

21. Debat parlamentar lidhur me zbatimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë për unifikimin e pikave doganore ndërmjet tyre, sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri, mbështetur edhe nga 11 deputetë

Po shoh nuk është edhe Visari, ne po e mbajmë deri sa të vjen Grupi Parlamentar i PSD-së. Po, urdhëro zoti Hoti, edhe na ndihmon, bile, pak. Administrata, ju lutem, boni një zile, mirë është të vijnë në vazhdim të seancës.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Unë kam qenë në seancën e fundit javën që shkoj, deri të premten vonë, kryesuesi i seancës e ka mbyllur seancën në mungesë të kuorumit.

Sot të gjithë deputetët, së paku grupi ynë parlamentar është përgatitur për seancë të re, sepse është kuptuar kur është mbyllur seanca nuk është thënë që vazhdon sot në orën 10:00, por është nënkuptuar që mbledhja e ardhshme e Kryesisë e cakton kohën se kur vazhdon seanca e ndërprerë.

Andaj pritjet tona dhe sipas rendit të ditës që ju e keni dorëzuar është që sot të fillojë seancë e re me pikat e rendit të ditës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, kryetar i grupit parlamentar.

Është e vërtetë, përfundimi i seancës ka ndodhur nga nënkryetari i Kuvendit, për fat të mirë qenka i pranishëm, por edhe Administrata po e konstaton se nuk është konstatuar me mbledhjen e Kryesisë mbeten këto, po është mbyllur seanca për shkak të mungesës së kuorumit, s'ka mundur të vazhdojë pika e radhës. Këtu e kemi nënkryetarin, në të njëjtën kohë unë e ftoj administratën të sjellë procesverbalin e përfundimit të seancës së kaluar. Urdhëro!

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë po përpiqem të them edhe një herë atë që e kam thënë atë ditë dhe verifikojeni te procesverbali. Formulimi im i asaj dite është paka shumë kështu: “Me që ne s’kemi kuorum që të vazhdojmë me procesin e votimit sipas praktikës që kemi vendosur nuk mund të vazhdojmë më tutje me këtë seancë, që unë jam i detyruar të ndërpres seancën, ndërkaq për kohën e vazhdimit të saj do të njoftoheni”. Kjo është paka shumë ajo çka kam thënë unë.

KRYETARI: Do të thotë, s’ka nevojë të shikohet, kjo është, po korrespondon, e njëjta është.

Vetëm se pikat e papërfunduara nga seancat plenare 16, 17, 18, 20, 26 prill, 31 maj dhe 1 qershor janë, e shihni.

Arsyeja pse i vej prapë në rend të ditës është pikërisht situatën të cilën e kemi në Kuvend, pastaj me të drejtë po marrim edhe nga pak kritika nga organizatat të cilat na monitorojnë dhe, në të njëjtën kohë në publik nuk po e krijojnë figurën e duhur. Të përfundojmë këto pikat e papërfunduara, pastaj vazhdojmë.

Fjalën ia jap çdo deputeti, derisa e ka zgjedhur populli, nuk është përgjegjësia ime, flasin çka të donë. Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Të premten e kaluar seanca ka përfunduar, por jo edhe të gjitha pikat, për shkak se nuk kishte kuorum. E tha nënkryetari i Kuvendit që atë ditë na është thënë që do të vendoset, në fakt, është theksuar që vendoset në Kryesi se kur do të vazhdojë seanca e mbetur.

Ne këtu sot jemi ftuar me një rend të ditës, të cilën e ka paraparë Kryesia e Kuvendit dhe për ne si Grup Parlamentar është e papranueshme që tash në moment të fundit të na ndryshohet rendi i ditës.

Pra, ne si Grup Parlamentar kërkojmë që seanca të mbahet sipas ftesës për të cilën edhe jemi ftuar. Pra, që nga pika e deklarimeve jashtë rendit të ditës, pyetjeve parlamentare, interpelancave dhe projektligjeve të tjera që janë të parapara në seancë.

Për ne është e papranueshme se si po tentohet në vazhdimësi që t’i humbë rëndësia Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Shumë prej ne deputetëve gjatë ditëve të shkuara kemi qenë në mëdyshje se cila pikë po shqyrtohet, pikërisht për shkak të kësaj krahure të Kadri Veselit.

Prandaj, ne kërkojmë që seanca të vazhdojë sipas ftesës zyrtare nga Kryesia e Kuvendit.

Për pikat që kanë mbetur të premtën, vendos Kryesia se kur do të shqyrtohen. Faleminderit.

KRYETARI: Faleminderit! Është shumë i mirëseardhur ky debat. Është mirë që të largohet monotonia e përfitimit nga çdo moment vetëm për konsum politik, tash publiku mendon çka janë duke bërë kështu kur rendi i ditës si po e cenuaka opozitën ose dikë, dhe çka po përfiton kryetari që po i vendos këto pika të rendit të ditës.

Më lejoni për hir të publikut të jem pak më i qartë.

Ne jemi futur në një agjendë të stërngarkuar, nga e cila produktiviteti i punës së Kuvendit pothuajse është minimal për atë çka është i thirrur, për vendimmarrje. Po në të njëjtën kohë obligative është që në këtë Kuvend edhe diskutohet, qoftë edhe zbrastë. Ajo të cilën jam duke e bërë unë së bashku me Kryesinë, në të njëjtën kohë edhe zonja Albulena Haxhiu në shumicën e këtyre vendimmarrjeve ka qenë e pranishme, vendimmarrja pikërisht ka ndodhur në Kryesi.

Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës ka marrë vendim për të gjitha këto pika të cilat janë për t'u mbajtur seancat.

Po e ripërsëris edhe një herë. Seanca e datës 16 ka mbetur hapur, 17, 18, 20, 26 prill, 31 maj e 1 qershor, të njëjtën kohë nga të njëjtë zëra pothuajse merr qëndrime publike se Kuvendi nuk po punon, se Kryesia e Kuvendit nuk po e menaxhon situatën, se kryetari i Kuvendit po i bllokoi proceset, debatet e interpelancat. Të gjitha këto kërkesat të cilat janë pika të rendit të ditës nga 1 deri 11 në masën mbi 50% janë kërkesa pikërisht të opozitës, në mesin e tyre edhe të grupit të juaj parlamentar.

Tani kjo situatë, ju keni marrë vendin, nuk kam marrë unë. Asnjë vendim për mbajtjen e seancave nuk merret, edhe pse është e drejtë kushtetuese, nuk e merr kryetari i Kuvendit me përjashtim një rast të fundit kur i kemi thirrur të gjitha grupet parlamentare, keni pranuar dhe e kemi mbajtur. Por çdo herë është vendimmarrja juaj.

Tani ju e vendosni vetë në seancë, në qoftë se dëshironi t'i largoni këto pika të rendit të ditës, për mua nuk është problem dhe shkojmë menjëherë me seancën e re. Ja, unë e bart në seancë, nuk më duhet autoriteti arbitrar, edhe pse Kushtetuta ma lejon. Seanca të vendosë, bëhuni 60-61 deputetë, përndryshe unë do t'i bindem vetëm vendimmarrjes së Kryesisë dhe autoriteti që më jep Rregullorja dhe Kushtetuta. Kjo është situata. Urdhëro, Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Së pari nuk mund të mos e përmend faktin që gjatë kohës kur ishte kryetar Kuvendi zoti Jakup Krasniqi, seancat parlamentare mbaheshin të enjten më 5, 6 apo 7 pika të rendit të ditës, ka pasur mundësi që vazhdonte të premtën. Mbledhjet e komisioneve ishin të hënën, të martën, grupet punuese ishin të mërkurave dhe prej se jeni ju kryetar Kuvendi, ju po

e degradoni Kuvendin e Republikës së Kosovës, për shkak se edhe agjendat e komisioneve parlamentare për të cilat pastaj po kritikohemi, po shtyhen për shkak të agjendës tuaj partiake.

Ju zoti Veseli, po e shihni Kuvendin jo si puna primare jotja, nëse je kryetar Kuvendi, duhesh t'i kushtosh Kuvendit të Republikës së Kosovës kohën tënde dhe kur të mbetet kohë, pastaj partisë politike, të cilën ti e përfaqëson dhe jo e kundërta.

Unë mendoj që duhet të marrin fund këto abuzime që po bëhen me Kuvendin e Republikës së Kosovës. Seanca e kaluar është ftuar me i mail, nuk është e vërtetë që ka vendosur Kryesia e Kuvendit.

Andaj ne si Grup Parlamentar po kërkojmë respekt, jo për grupin tonë parlamentar, se prej teje s'presim respekt, por duhet ta respektosh Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe qytetarët e Republikës së Kosovës. Ne jemi ftuar këtu për diçka tjetër dhe nuk keni të drejtë që të na vendosni para aktit të kryer me tema të cilat kanë mbetur dhe që është thënë që vendos Kryesia për të njëjtat. Faleminderit!

KRYETARI: Politika është art, po në të njëjtën kohë është manipulim, ama bash kaq nën sy, para publikut të të hedhet syve, për besë nuk është e moralshme. Agjenda personale e kryetarit është vetëm e kryetarit, i kam edhe nja 4-5 nënkryetarë, kështu që asnjëherë nuk e lë agjendën, ndonjëherë edhe mund të jetë, se unë nganjëherë si kryetar i partisë shkoj pas partisë, është normale, të gjithë vrapojmë, ama i kam 5 nënkryetarë.

Po sido që të jetë, është mirë kjo, po më pëlqen kjo pjesë. Vendimmarrja është juaja, zoti Hoti, vendimmarrjen ju do ta merrni në këtë seancë. Për mua të gjitha pikat e rendit të ditës i anulohem, por do ta nxjerr në votim, po flas për këto pika të cilat janë. Ju e vendosni, Jakup Krasniqi, kolegu i cili e ka udhëhequr Kuvendin, ka qenë akademik, e unë jam polik.

Urdhëro, zoti Hoti.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit! Unë mendoj që kjo çështje është krejt teknike, siç e shpjegoi nënkryetari i Kuvendit, Shala, seanca është mbyllur në mungesë të kuorumit dhe është thënë tekstualisht që do të njoftoheni për vazhdimin e asaj seance. Pra, deputetët nuk janë njoftuar që vazhdimi i asaj seance është sot nga ora 10:00, deputetët e kanë rendin e ditës për seancë të re sot nga ora 10:00, unë propozoj që pa pasur nevojë të bëjmë asnjë votim këtu në sallë, të vazhdojmë me seancën e re. Ne nuk kemi asnjë kundërshtim që të vazhdojmë edhe me seancën e kaluar, por nuk është vendosur kështu.

Ne mund t'i diskutojmë të gjitha pikat, por deputetët sot janë të përgatitur për seancën e re. Unë propozoj të vazhdojmë me këtë seancë, e ju si kryetar i Kuvendit ta vendosni vetë ose në

konsultim me Kryesinë, ato kompetenca i keni se kur vazhdon ajo seancë e ndërprerë. Po, si fakt është që deputetët nuk kanë pranuar njoftim që seanca e ndërprerë vazhdon sot nga ora 10:00. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Hoti, faleminderit, zoti Nitaj veç ta bëjë një qartësim në kuadër të aktiviteteve.

Ditën të cilën e kam lëshuar seancën, e kam bërë edhe publike, ka qenë një rast vdekjeje familjare, nuk ka qenë aktivitet partiak, ndjesë pastë, daja Halil ka vdekur, kjo është, ka qenë shkrimtar, prozator.

Sido që të jetë, ju e vendosni, unë të jem shumë i sinqertë, administrata ka vepruar në bazë të Rregullores, edhe fare as nuk është konsultuar me mua për këto që i ka sjellë dhe e përgëzoj për profesionalizmin. Por në qoftë se ju dëshironi t'i largoni, unë i largoj menjëherë, nuk po insisto. Bilall ti për bacin Jakup flet më vonë pastaj, po veç t'i lexoj pikat e rendit të ditës. A ka mundësi t'i lexoj dhe ju vendosni a dëshironi të vazhdoni a jo?

Pikat e papërfunduara të datës 16, 17, 18, 20, 26 prill e 31 maj e 1 qershor 2018, janë si në vijim:

- Votimi i Projektligjit numër 06/L-061 për ratifikimin e traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë mbi transferimin e personave të dënuar, kjo është nën një.
- Votimi i propozim-rezolutës nga debati parlamentar në lidhje me Raportin e Progresit për Republikën e Kosovës, kush e ka propozuar, duhet ditur, zonja Fitore Pacolli nga Vetëvendosja.
- Votimi i rekomandimeve nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për KOSTT-in, do të thotë dy janë të opozitës.
- Votimi i rekomandimeve nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, zoti Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate.
- Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar po ashtu të Lëvizjes Vetëvendosja.

Të gjitha qenkan kërkesa të opozitës. E po të ketë reagim pse e largon kryetari agjendën e opozitës?

Po duan t'i tërheqin sipas të gjitha gjasave për Aida Dërgutin, se është për shkarkim, kjo qenka.

Edhe raporti i Avokatit të Popullit, kjo na takon të gjithëve, kjo konsensuale, se edhe avokatin e kemi konsensual.

Edhe votimi i Projekt-rezolutës nga debati parlamentar në lidhje me të drejtat e punëtorëve dhe adresimin e papunësisë, edhe kjo pjesë e opozitës.

Këto kanë qenë pikat, i thashë për publik.

A po e vendosni a kalojmë drejt në seancë të re. Po ma kanë sjellë, Avdullah, tash si agjendë, nuk e kam sjellë unë, beso. Po ta kisha ditur se e bëni problematike, s'e kisha sjellë fare.

A shkojmë në votim, a bën në mënyrë arbitrare t'i largojë kryetari. Avdullah, fjala jote, ose në votim, ose i largoj në mënyrë arbitrare, pres qëndrimin tuaj.

AVDULLAH HOTI: Kryetar!

Unë s'kam të drejtë ta bëj atë punë, besoj që as ju s'keni të drejtë.

Deputetët kanë marrë njoftimin që sot në orën 10:00 fillon seanca e re, dërgoni kur doni ju, jeni kryetar i Kuvendit, njoftimin për vazhdimin e asaj seance dhe ne do jemi këtu në seancë. Kjo është çështja.

KRYETARI: Po shoh reagimin, zoti Nitaj, edhe Bilalli, zoti Nitaj nga AAK-ja.

MUHARREM NITAJ: I nderuar kryetar!

Janë shtatë seanca që i kemi nisur e i kemi lënë përgjysmë, s'ka asnjë kuptim kjo që po ndodh në Kuvend. Hajde t'i hapim edhe nja 4-5 seanca të tjera, t'i nisim dhe të mos e përfundojmë asnjë!

Nëse ju keni kompetenca, vazhdojeni punën me seancat që kanë mbetur përgjysmë ose vazhdojeni me seancën e re.

KRYETARI: Bilall, të lutem!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Unë desha t'i nge dy çështje.

E para është që ky Kuvend, pastaj edhe Kryesia ka marrë vendim që seanca e filluar një herë të përfundojë, deri sa të përfundojë ajo, të mos hapet e re, ka qenë vendim i Kryesisë, kurdo që të përfundojë. Prandaj e kemi mbajtur tri ditë rend seancën...

KRYETARI: Zoti Bilall, keni qenë këshilltar kryesor i referencës për punën e Kuvendit, edhe një herë mendimi juaj është shumë i vlefshëm, se baca Jakup njëjtë do të kishte vepruar.

BILALL SHERIFI: Kryetar!

Mendoj që është mirë unë dhe ti të mbajmë njëfarë armëpushimi, të mos hyjmë andej, le të vazhdojmë këtu ku e kemi sot temën.

Mendoj që nëse ju kujtohet tri ditë rend kemi mbajtur seancë me idenë që t'i përfundojmë pikat e seancave të mbetura, të hapura, para se të fillojmë seancën e re. Pra, deputetët sot nuk kanë pasur nevojë të informohen për pikat e rendit të ditës nga seancat e mbetura, sepse ata kanë qenë të përgatitur edhe të premtën të vazhdojmë me ato pika.

Kështu që është një vendim në Kryesi që seancat e mbetura të vazhdojnë deri sa të përfundojnë, e reja është caktuar për sot, por me kushtin që pasi të përfundojnë pikat e mbetura, të vazhdojmë me të renë. Shiheni stenogramin në Kryesi, shiheni procesverbalin e Kryesisë, kështu ka qenë. Pra, nëse sot nuk mund t'i përfundojmë pikat e mbetura, atëherë vazhdojmë nesër me seancën e re, në parim ky ka qenë vendimi.

Nëse dëshirojmë tash ta hapim seancën e re dhe t'i lëmë këto të papërfunduara anësh, e vazhdojmë, po kjo është logjika, të cilën, me sa di unë, javën e kaluar morëm vendim ta lëmë prapa nesh, të mos vazhdojmë kështu me seanca të mbetura në gjysmë dhe të hapim të reja. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Sherifi!

Unë të falënderoj për korrektësinë, unë nga kjo foltore asnjëherë nuk do të mundohem ta mund askënd. Ajo çka jemi marrë vesh, kemi qenë të pranishëm pikërisht këta çka folën, të gjithë kemi qenë të pranishëm. Ku po më prek më së shumti, për hir të publikut është se të ndërrosh bash ashqare, në sekondë, edhe për çdo gjë të tentosh veç të përfitosh, kjo po më vjen pak keq. Sido që të jetë, nga pak kryetari qimen e egër po, në publik jemi bërë edhe më të egër. Po shkojmë në votim.

Urdhëro Ahmet, edhe ti s'ke folur dhe shkojmë në votim. Ju e vendosni.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Unë mendoj që duhet të vazhdojmë me seancat e mbetura për t'i përmbyllur dhe po ashtu seanca e cila është paraparë me rendin e ditës si seancë e re ta mbajmë ditën e enjte.

Njëkohësisht po ju paralajmëroj se dy pikat e rendit të ditës, interpelancat që janë të caktuara për rendin e ri të ditës, kryeministri nuk është këtu, të premtën është i gatshëm t'u përgjigjet deputetët të Parlamentit të Kosovës.

Kam propozim konkret, kryetar, seancat e rregullta që kanë të bëjnë me ligje, me vendime, të mbahen në një ditë të posaçme, debatet dhe interpelancat, në një ditë të posaçme, të gjitha,

ndërsa votimi i të gjithave të jetë në një ditë të posaçme. Shumë më mirë e kishim thjeshtuar problemin, se sa që po i grumbullojmë e po i bëjmë nga 7-8 seanca që po ndërpriten në gjysmë.

KRYETARI: Shtatë ditë i ka java, zoti Isufi, njërën duhet gjetur, cila është tamam, e enjtja është.

Memli Krasniqi, po e shoh nga grupet parlamentare, Dardan Molliqaj nga Partia Socialdemokrate të bëhet gati, shkojmë në votim.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Janë dy çështje këtu që u diskutuan dhe dy të vërteta, e para është që deputetët sot është e vërtetë që kanë ardhur për një seancë të re, me një ftesë dhe me një rend të ditës të cilën e kemi para vetes.

Por e vërteta që e tha zoti Sherifi dhe për çka unë e pata marrë fjalën fillimisht është që në të njëjtën kohë ne në Kryesinë e Kuvendit jemi marrë vesh dhe kemi votuar unanimisht që të vazhdojmë deri në përfundimin e pikave të mbetura të seancave të lëna përgjysmë, e që janë shtatë. Që do të thotë nuk shoh ndonjë përjashtim ndërmjet propozimit që keni bërë ju sot që t'i vazhdojmë ato pika, sepse nuk arritëm t'i kryejmë as javën e kaluar.

Ndoshta kemi mundur të mos e caktojmë për sot këtë seancë, por të vendosim kur t'i përfundojmë ato. Përndryshe, nëse ka abuzim në këtë Kuvend, abuzime është duke u bërë me këto seanca që po i lëmë në gjysmë.

Edhe këto pika, siç i lexuat një nga një, që kanë filluar prej para një muaj e gjysmë janë propozime të opozitës, është e drejtë e tyre, por e vërteta është që kur po mbeten këto seanca prapë për gjysmë për shkak të mungesës së kuorumit, edhe për shkak të mosvotimit dhe çështje të tjera. Ne tash kemi hyrë në një vorbull, prej së cilës është e vështirë të dalim, sepse shtatë seanca të mbetura përgjysmë, të shtyra prej ditës në ditë, një seancë po e fillojmë sot që s'ka asnjë shans të kryhet pa tri ditë Kuvend. Nëse e fillojmë këtë seancë dhe unë s'kam kurrgjë kundër, nëse e fillojmë, ne këtë seancë sot do ta lëmë në gjysmë prapë, dhe do ta shtojmë edhe një seancë të re të lënë në gjysmë, se janë 27 pika, ndërmjet të cilave prapë dy interpelanca, e kryeministri s'është këtu. Prapë ka debate, prapë ka tema për të cilat na duhet goxha shumë kohë.

Me këtë qasje, ne prapë s'kemi për të arritur që ta kryejmë asnjë seancë. Unë besova që në mbledhjen e fundit të Kryesisë, kur u pajtuam që të vazhdojmë deri në përmbylljen e pikave të mbetura, ndoshta duhet t'u japim një rend seancave të tjera. Por, nëse vazhdojmë prapë me këtë seancë, që mund ta bëjmë, se ftesa ka ardhur për këtë, të paktën ta dimë që secili me vetëdije po hyjmë për ta lënë edhe një seancë tjetër në gjysmë. Mendimi im është që do të duhej të merremi vesh, ndoshta unë s'di, s'besoj që ka nevojë, por nëse duhet të tërhiqet edhe Kryesia dhe ta marrë një vendim dhe të thotë "po shkojmë, me rend të gjitha pikat që i kemi". Ka votime që s'kanë

mundur që të realizohen më shumë se një muaj, debati, interpelanca, projektligjet që kërkojnë ratifikim ndërkombëtar, e pastaj edhe 27 pika të sotme, të cilat janë po ashtu shumë të rëndësishme, që s'kanë mundur që të hyjnë, në rend të ditës për shkak të vonesave me seancat tjera.

Realisht, unë mendoj që do të ishte mirë që t'i përfundojmë ato që na kanë mbetur dhe pastaj të vazhdojmë me seancën tjetër, por nëse insistohet nga kolegët e opozitës që të tërhiqet Kryesia për një vendim formal, nëse s'u duket i mjaftueshëm vendimi i kaluar, i cili absolutisht është në fuqi, sepse kemi vendosur t'i përfundojmë ato e të fillojmë me të tjerat, atëherë edhe këtë mund ta bëjmë. Përndryshe, e fillojmë këtë seancën e sotme, e lëmë në gjysmë sot dikur kah ora 19:00, se prapë s'ka për të pasur kuorum, ose prapë ka për të pasur mungesë të deputetëve, ose veç do të bëhet vonë dhe ne duhet të shkojmë, e pastaj s'dimë çka të vazhdojmë nesër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Molliqaj, fjala për ju!

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit, kryetar!

Mua po më duket që në mënyrën qysh keni vendosur në mbledhjen e fundit të Kryesisë, ku kanë qenë edhe përfaqësuesit e grupeve parlamentare, keni llogaritur që deri të hënën në parim kryhen seancat që kanë mbetur. Dhe, e keni vendosur një seancë të re orientimisht për të hënën. Tash, ky është fakt i kryer dhe propozimi im është që edhe kjo seancë, meqenëse është thirrur dhe jemi përgatitur për këtë seancë, ta vazhdojmë me kushtin që sot Kryesia mblidhet dhe vendos t'i trajtojë krejt seancat e mbetura, përfshirë edhe këtë, dhe që nuk thërret seancë të re, përveç nëse ka diçka urgjente derisa të përfundojnë krejt seancat e mbetura. Po më duket që kjo është zgjidhja më e mirë në situatën e krijuar, që është krijuar për arsye edhe objektive të mungesës së deputetëve, edhe të kohës.

Pra, propozimi ynë është që le të vazhdojmë me seancën që e keni thirrur, duke e pasur parasysh qysh e keni thirrur, dhe Kryesia e Kuvendit sot të vendosë për vazhdimin e krejt seancave të mbetura derisa të përfundojnë të gjitha. Faleminderit!

KRYETARI: Lista serbe dhe 6+, të na japin qëndrimin.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče!

Mi isto smatramo da smo ušli u jedan krug iz kojeg teško izaći, ali smatramo koliko smo se dogovorili na prošlom Predsedništvu da ne počinjemo novu sednicu dok ne završimo onu započetu, da se danas nastavi sednica koje započeta u četvrtak, a da na Predsedništvu danas odlučimo kad će biti sednica koja je zakazana za danas.

Jer, ako nastavimo ovako kao što smo do sada radili, ja mislim da sednicu koju smo zakazili za danas nećemo završiti do Nove godine. S toga smatram da bi trebali da nastavimo sednicu koju

smo započeli, a da novu zakažemo kada završimo ovu, i da ne zakazujemo druge sednice dok ne završimo sednicu koja je zakazana za danas. Hvala!

KRYETARI: 6+? Urdhëroni, Albert Kinolli!

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qëndrimi i Grupit Parlamentar 6+ është duke pasur parasysh se sot në agjendë i kemi 28 pika dhe është e pamundshme që të përfundojnë të gjitha sot, ne mendojmë që të vazhdojmë me pikat e mbetura, të cilat nuk janë kryer ende nga seancat e mbetura dhe pastaj të fillojmë me seancën e re. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë për hir të korrektësisë do ta vërë në votim, nuk kam alternativë tjetër, por para se ta bëj këtë kam dëshirë të them diçka për publik. Lufta politike është një alternativë dhe është legjitime që me çdo kusht ngarkohet agjenda parlamentare për hir që të krijohet opinioni se po dështon kryetari i Kuvendit, Kryesia, e sido që të jetë. Ajo çka është kryesore është se mbajeni në mbamendje se po frikësohem se po dështon kjo legjislaturë e tërë edhe 120 deputetë.

Unë jam në gjendje çdo ditë nga 18 orë të qëndroj në Kuvend derisa t'i përfundojmë, por thirrja e seancave, e interpelancave, e debateve, vetëm tash çka kemi në agjendë, na duhen minimalisht me këtë gjendje, të cilën është Kuvendi, meqë lodhen shumica prej tyre pas 3 orë seance, edhe shtatë ditë seancë çdo ditë, për t'i përfunduar këto çka kanë mbetur dhe këto çka të vijjnë. I kemi tri debate, dy interpelanca, të cilat janë në pritje. Shtatë ditë pune! Do të thotë, kjo e tregon si ne ajo që e tha kolegu atje, deri në vitin e ri na zënë vetëm këto që i kemi këtu, pa i futur fare ligjet. Kjo është vendimmarrja juaj, ju kisha lutur përgatitemi. E kemi këtë opsion: A do të vazhdoni me pikat e papërfunduara që të vazhdoni trajtimin e tyre deri në përfundim, për t'i dhënë mundësi pastaj futjes në seancë të re, apo dëshironi që menjëherë të futemi në seancë të re në këtë moment? Në qoftë se votohet "po", për të vazhduar me pikat e papërfunduara, atëherë vazhdohen pikat e papërfunduara dhe pas kësaj shkojmë në seancë të re. Në qoftë se votoni "jo", atëherë do të thotë drejtpërdrejt, edhe një herë, të mos jem konfuz, drejtpërdrejt shkojmë me seancën e rregullt, me seancën plenare.

Vetëm pak, se e ka sjell Administrata protokollin e mbledhjes, siç jemi marrë vesh e mbajtur, më 31 maj 2018, mbledhja e Kryesisë së Kuvendit me kryetarët e grupeve parlamentare. Kanë qenë të gjithë këta deputetë, të cilët folën, po e them përfundimin. Është në protokoll, po e citoj: "nga seanca e djeshme janë pesë pika të papërfunduara. Pasi të përfundojë kjo seancë, të cilën e kemi sot derisa të përfundojë, në qoftë se vazhdon edhe nesër, derisa të përfundojë. Pastaj, vazhdojmë

menjëherë me këto pesë pikat”. Është ajo çka e tha edhe zoti Molliqaj, por ne mendonim se deri të hënën do ta përfundojmë. Kjo ka qenë edhe ideja.

Shkojmë në votim, më duket isha i qartë. Votoni, vendimmarrja është juaja, unë ju bindem juve. Faleminderit!

A jemi të qartë, çka do të thotë “po” e çka “jo”? Edhe një herë pra, kisha pasur dëshirë vëmendje: në qoftë se votojmë për jo, nuk ka pika tani të papërfunduara po shkojmë drejtë në seancë tjetër. Në qoftë se votojmë për po, pa i përfunduar pikat, të cilat janë të mbetura nga këto seanca gjatë të përmendura, nuk shkojmë në seancë të re. Do të thotë, në qoftë se votoni për po, do të thotë jeni për vazhdimin e seancës. Në qoftë se votoni jo, shkojmë drejtpërdrejt, largohet vazhdimi i seancës, mbetet për mbledhjen e Kryesisë dhe kalojmë pastaj në seancën e rregullt.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

81 deputetë kanë votuar, 46 për, 32 kundër, 3 abstenime.

14. Votimi i raportit vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017

Në seancat plenare të mbajtura më 17 maj dhe 1 qershor kemi përfunduar diskutimet për këtë raport, por në mungesë kuorimit të mjaftueshëm për vendimmarrje nuk u procedua për votim.

Shkojmë në votim drejtpërdrejtë. Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Me 89 vota, 87 në mënyrë elektronike edhe 2 me ngritje dore, 77, përkatësisht 79, janë për. Dy deputetë me dorë janë për. Atëherë, 80 deputetë janë me votim për. 90 kanë votuar gjithsej, 3 me ngritje dore, 87 në mënyrë elektronike, 7 kundër, 3 abstenime.

Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017.

20. Votimi i propozim-rezolutës nga debati parlamentar në lidhje me të drejtat e punëtorëve dhe adresimin e papunësisë në Republikën e Kosovës

Edhe këtë debat e kemi përfunduar më 30 maj dhe 1 qershor. Jemi tek votimi i projektrezolutës. Votojmë tash!

78 deputetë kanë votuar, 67 për, 6 kundër, 5 abstenime.

Kuvendi e miratoi rezolutën e propozuar nga Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes.

Përfunduar pikat e papërfunduara. Jemi në seancën e re.

21. Debat parlamentar në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë për unifikimin e pikave doganore ndërmjet tyre

Sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri mbështetur edhe nga 11 deputetë.

Zoti Mikullovc, fjala për ju. Urdhëro!

ADEM MIKULLOVCI: Xhav xhav qe xhav qe xhav dav shpejt e ma shpejt.

Eh po, zoti kryetar, fola sikur ju. Shumë shpejt po lexoni, vëlla, s'po ju kuptojmë. S'po di çka po votoj, s'po di çfarë po flisni.

KRYETARI: Unë më së pari jam i gëzuar, se unë u frikësova se nuk je mirë. Të falënderoj shumë që ma bërë me dije se unë s'qenkam mirë. Faleminderit shumë! Shumë mirë! Ke të drejtë plotësisht. Do të shkoj më ngadalë. Ka të drejtë, zoti Mikullovc.

Deputeti Visar Ymeri, mbështetur edhe nga 11 deputetë, ka parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me zbatimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë për unifikimin e pikave doganore ndërmjet tyre.

Zoti Faton Topalli, në vend të Visar Ymerit, e paraqet çështjen për të cilën është kërkuar debat. Urdhëro!

FATON TOPALLI: Në fakt, nuk po e paraqes çështjen.

Zoti Ymeri ka menduar që sot do të kemi një rend tjetër të ditës dhe nuk është për momentin këtu. Prandaj, ju kisha lutur që ta zëvendësoni pikën e rendit të ditës me atë për Kartonin e Gjellbër për momentin.

KRYETARI: OK, propozuesi ka kërkuar vet. E lëmë për një seancë të radhës. E ndërrojmë debatin. Në qoftë se, arrin zoti Ymeri që të vijë gjatë këtij debati, pa e përfunduar këtë seancë, ne e fusim. Atëherë, mbetet pezull.

22. Debat parlamentar lidhur me Kartonin e Gjellbër, sipas kërkesës së deputetit Faton Topalli, mbështetur edhe nga 11 deputetë tjerë

Faton Topalli, është fjala për ju, që në emër të propozuesit ta paraqisni çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar tani.

FATON TOPALLI: I nderuar kryesues i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar mërgimtarë,

Tashmë kanë kaluar më se 19 vjet prej përfundimit të luftës, ndërsa Republika e Kosovës vazhdon të mos jetë anëtare e Byrosë Evropiane të Kartonit të Gjellbër.

Kjo ka për pasojë që qytetarët e Kosovës janë të detyruar të paguajnë shuma të larta të sigurimit për kohë të caktuar, sa herë udhëtojnë jashtë vendit. Qindra e mijëra mërgimtarë, edhe pse paguajnë polisa të sigurimit në vendet prej të cilave vijnë, kur hyjnë në Kosovë janë të detyruara të paguajnë për të njëjtën çështje edhe një herë.

Shuma e paguar për polisat kufitare prej përfundimit të luftës e deri më sot arrijnë shifrën rreth 200 milionë euro, ndërsa shpenzimet e bëra për dëmet e shkaktuara rreth 10%, pra gjithsej 20 milionë euro. Mendoj që ky nuk është një trajtim dinjitoz i atyre që në formën remitencash sjellin para gati sa gjysma e Buxhetit të Republikës së Kosovës. Vetëm në vitin 2017 mërgata e Kosovës ka sjellë 786 milionë euro në formë remitencash. Kjo shumë është shumë më e madhe, se të gjitha mjetet e paguara për të gjitha rrogat në sektorin publik dhe në të gjitha skemat sociale në vendin tonë.

Çështjen e Kartonit të Gjellbër e kam shtruar prej vitit 2013 deri më tani, së paku 6 herë. Uroj që ky të jetë debati i parë dhe i fundit për Kartonin e Gjellbër. Fillimisht, dua të shtroj pyetjen pse Kosova nuk e ka Kartonin e Gjellbër?

Për të ju përgjigjur kësaj pyetjeje dua të bëj këto konstatime. Në vitin 2001 dhe vitin 2002 pati përpjekje serioze nga UNMIK-u për zgjedhjen e Kartonit të Gjellbër, pra të kësaj çështjeje dhe marrëveshja ishte gati se e gatshme, por nuk u firmos. Deri në vitin 2010 - 2011 nuk ka pasur ndonjë përkushtim të veçantë të qeverive të Kosovës për arritjen e marrëveshjes me Byronë Evropiane të Kartonit të Gjellbër. Fillimisht, nga Këshilli i Byrove në Bruksel është kërkuar që Kosova duhet t'i plotësojë këto parakushte para se të fillojë procedurat e aplikimit të saj në Këshillin e Byrove. Pra, aprovimin Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto-përgjegjësia, themelimin e Byrosë Kosovare të Sigurimit dhe Qendrës informative të sigurimeve, si dhe fondin garantues prej 4 milionësh.

Ligji për sigurimin e detyrueshëm nga auto-përgjegjësia hyri në fuqi më datën 14 korrik 2011. Byroja Kosovare e Sigurimit është themeluar më 7 shtator 2011, ndërsa së fundmi Fondi Garantues në vlerë prej 4 milionësh është krijuar më vonë dhe është deponuar në njërin prej bankave komerciale të Kosovës.

Sikur të kishte pasur interesim për anëtarësim më herët, atëherë këto kushte do të ishin plotësuar më herët, duke krijuar bazën e nevojshme ligjore për anëtarësim. Në anën tjetër, Qeveritë e deritashme të Kosovës do të ishte dashur të ushtronin presion mbi byronë e sigurimeve për ta

rregulluar këtë çështje, gjë që si duket nuk është bërë. Të dy kryeministrat e fundit, Hashim Thaçi dhe Isa Mustafa, premtuan se do ta zgjidhnin këtë problem, por zgjidhja nuk u arrit deri më sot asnjëherë. Kryeministri Haradinaj është kryeministri i tretë me radhë, shpresoj që të ketë gatishmërinë, mundin dhe zellin për ta zgjidhur këtë problem.

Konstatimi i dytë është, se Byroja Kosovare e Sigurimeve nuk kishte interes që të arrihej ndonjë marrëveshje, kjo për faktin se kompanitë e sigurimeve fitonin milionë euro përmes shitjes së polisave kufitare. Konsiderohet se prej përfundimit të luftës e deri më sot janë inkasuar rreth 200 milionë euro, ndërsa shuma e shpenzimeve për shkak të dëmeve në total nuk është më e lartë se 10%. Kështu për shembull, në vitin 2008 kanë hyrë, janë inkasuar 10.9 milionë, ndërsa janë shpenzuar për dëme vetëm 1 milion. Në vitin 2010 janë inkasuar 9 milionë, ndërsa janë shpenzuar vetëm 1.072 milionë. Në vitin 2011 janë inkasuar 8 milionë, është shpenzuar vetëm 1.1 milion e në vitin 2013, 13 milionë janë inkasuar, ndërsa janë shpenzuar vetëm 1.1 milion. Në vitin 2014 janë inkasuar 14 milionë, ndërsa janë shpenzuar për dëme vetëm 1.2 milionë.

Është interesante që vitin 2015, '16 dhe '17 kemi ngritje të dëmeve, por kjo çështje duhet të shqyrtohet edhe një herë, për arsye se ka probleme të cilat në raportin që na është dhënë nuk janë të dukshme.

Zgjidhja e këtij problemi do të nënkuptonte uljen e fitimit për kompanitë e sigurimeve, prandaj edhe ka konflikt interesi. Në këtë kuptim, interesi i kompanive të sigurimeve ishte më i madh për të mos e zgjidhë këtë çështje, sesa për ta zgjidhur.

Konstatimi i tretë është, se Kuvendi i Kosovës përkundër mandatit mbikëqyrës mbi BQK-në nuk u tregua, as i interesuar e as bëri ndonjë përpjekje që të kanalizojë zgjidhjen e këtij problemi. Fakti që po zhvillohet për herë të parë gjatë kësaj legjislature një debat parlamentar flet për vetveten. Në këto kushte ishin qytetarët e Kosovës brenda dhe jashtë vendit ata që pësuan nga mosarritja e kësaj marrëveshjeje. Tashmë, Kosova ka plotësuar tri kushtet kryesore për anëtarësimin në Byronë Ndërkombëtare të Kartonit të Gjelbër, ka krijuar bazën ligjore, ka themeluar Byronë e Sigurimeve dhe Fondin rezervë prej 4 milionësh.

Shtrohet pyetja, pse Kosova megjithatë nuk mund të jetë pjesë e Kartonit të Gjelbër?

Byroja Kosovare e Sigurimeve thotë se ka dy kushte tjera, të cilat duhet të plotësohen. Numri i makinave të paregjistruara, të cilat qarkullojnë në Kosovë është jashtëzakonisht i madh dhe pritet që ky numër i makinave të paregjistruara të bie së paku në 5% dhe kushti i dytë është, që Kosova të jetë pjesë e OKB-së.

Përderisa kushti i parë mund të plotësohet pa implikime ndërkombëtare, kushti i dytë është për momentin i vështirë për t'u realizuar. Vlen të theksohet, se Byroja Evropiane e Sigurimeve nuk

është pjesë e OKB-së dhe nuk qëndron nën ombrellën e kësaj organizate, aq më shumë që ka edhe organizata tjera rajonale, që kanë bërë zgjidhje të ngjashme, si për shembull, Kartoni i portokalltë i disa shteteve arabe.

Ka disa argumente që rrëzojnë kërkesën e Zyrës Evropiane për Kartonin e Gjellbër. Zvicra u bë anëtare përkundër faktit që tek në vitin 2002 hyri në OKB. Një përjashtim i tillë do të duhej të bëhej edhe për Kosovën.

Republika e Kosovës është i njohur nga 108 shtete, pa qenë pjesë e OKB-së, pasaportat e Kosovës pranohen dhe njihen gjithashtu në Botë, pa qenë Kosova pjesë e OKB-së. Jemi pranuar në FIFA, FMN dhe BERZH, pa qenë pjesë e OKB-së. Kemi marrëveshje bilaterale me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Serbinë, respektivisht memorandume mirëkuptimi për çështjen e lëvizjes së makinave, pa qenë pjesë e OKB-së. Kemi marrë numrin tonë të swicht-it, pa qenë pjesë e OKB-së. Kemi prefiksin tonë telefonik, pa qenë pjesë e OKB-së.

Këshilli i Byrove të Kartonit të Gjellbër në Bruksel nuk ka ndonjë lidhje me OKB-në përveç rekomandimeve që u ka dhënë OKB-ja për të siguruar lëvizjen e lirë. Pjesëmarrje e Republikës së Kosovës në të gjitha këto institucione që përmenda më lartë përveç që ka kërkuar realizimin e pengesave teknike dhe ligjore, është përcjellë me veprime politike të cilat në rastin e Kartonit të Gjellbër, si duket kanë munguar. Detyrë e Kuvendit mbetet t'i përcaktojë përgjegjësitë dhe të bëjë hapat konkretë për realizimin e përkohshëm dhe të përhershëm të çështjes së polisave kufitare dhe anëtarësimit të byrosë nacionale të Kartonit të Gjellbër në Këshillin Evropian të Kartonit të Gjellbër.

Unë besoj që zgjidhja është e mundur, është vetëm çështje e vullnetit tonë si Kuvend, si Qeveri dhe si institucione të pavarura të angazhohemi për një zgjidhje. Në bisedat që kam pasur me përfaqësues të grupeve parlamentare, por edhe me kryeministrin, duket sikur ekziston një vullnet i mirë, për t'i dhënë rrugë zgjidhjes së këtij problemi. Besoj se të gjithë e kuptoni se heqja e polisës kufitare është më shumë një shenjë respekti dhe sinjali pozitiv i Institucioneve të Kosovës ndaj qytetarëve që jetojnë jashtë vendit, se një ngarkesë e lartë për buxhetin e tyre.

Moszgjidhja e problemit të Kartonit të Gjellbër është më shumë se një ngarkesë ekonomike për qytetarët që jetojnë në Kosovë dhe që udhëtojnë jashtë vendit në vendet perëndimore. Ky problem do të jetë shumë më i theksuar me rastin e liberalizimit të vizave, prandaj edhe mendoj që sot duhet të hapim rrugë për të ardhur deri tek një zgjidhje përfundimtare. Ne si grup parlamentar kemi përgatitur rekomandimet për Kuvendin. Natyrisht, që jemi të gatshëm t'i bisedojmë së bashku me të gjitha grupet parlamentare dhe pastaj t'i kemi rekomandimet e përbashkëta të Kuvendit. Unë tani po i lexoj rekomandimet e Kuvendit. Njëkohësisht, dua të ju them se po flas edhe në emër të Grupit Parlamentar të PSD-së, prandaj edhe e lus regjinë, që të vazhdojmë, të mos më ndërpritet koha.

REKOMANDIMET

1. Kuvendi i Kosovës obligon krijimin e një komisioni të përbashkët me emërtimin “Komisioni për Kartonin e Gjellbër”, në vazhdim vetëm komisioni, i cili përbëhet nga përfaqësuesi i Byrosë së Sigurimeve, ministri i Punëve të Brendshme, një zëvendëskryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës, guvernatori i BQK-së, kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe iniciuesi i këtij debati.

2. Komisioni për Kartonin e Gjellbër drejtohet nga iniciuesi i këtij debati i këtij debati parlamentar, i cili është përgjegjës për t’i thirrur mbledhjet e komisionit të përbashkët dhe të njoftojë Kuvendin me shkrim një herë në dy muaj për rezultatet e punës.

3. Komisioni për Kartonin e Gjellbër ka për detyrë ndarjen e detyrave që i takojnë Qeverisë, Byrosë së Sigurimeve, guvernatorit të BQK-së dhe ministrin të punëve të brendshme. Krahas ndarjes së detyrave përcakton veprimet konkrete brenda fushëveprimit të secilit aktor dhe afatet kohore për implementim dhe raportim.

4. Procesi i anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Byrove të Kartonit të Gjellbër mund të marrë kohë, për këtë arsye obligohet Byroja e sigurimeve në Kosovë, që deri më 31 dhjetor 2018 me mbështetjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës të gjejë një shtet, i cili merr përsipër mbulimin e territorit të Kosovës me polisën e Kartonit të Gjellbër, si një zgjidhje e përkohshme deri në anëtarësimin përfundimtar. Krahas kësaj të fillojnë bisedimet për zgjidhje bilaterale në vendet, me të cilat Republika e Kosovës ka mërgatë të theksuar.

5. BQK-ja në rolin e saj mbikëqyrës mbi Byronë e Sigurimeve të Kosovës të kërkojë nga Byroja e Sigurimeve të Kosovës deri më 31 dhjetor 2018 ta analizojë lartësinë e primit të polisës kufitare për të shikuar mundësinë e uljes së çmimit të saj prej 1 korrikut të vitit 2018. Kjo mes tjerash edhe për të hequr atraktivitetin e shitjes së policës kufitare, e cila u bë ndoshta shkak jozyrtar për moszgjidhjen e problemit.

Lartësia e primit duhet t’i mbulojë shpenzimet administrative dhe ato të dëmeve deri më 31 dhjetor 2018, pa u shkaktuar dëme dhe humbje kompanive të sigurimeve.

6. Nëse Byroja e Sigurimeve, në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës dhe Komisionin për Kartonin e Gjellbër nuk arrin ndonjë zgjidhje të përkohshme apo të përhershme deri më 31 dhjetor, atëherë prej 1 janarit të vitit 2020 Republika e Kosovës njeh njëanshëm Kartonin e Gjellbër të vendeve evropiane.

Kuvendi i Kosovës merr për obligim që me rastin e ndarjes së buxhetit për vitin 2020 të ndajë 5 milionë euro për mbulimin e shpenzimeve të shkaktuara nga dëmet që bëjnë në shtetin e Kosovës ata që jetojnë jashtë vendit.

Ky buxhet ndahet për dy vjet me radhë, për sa llogaritet që mund të arrihet anëtarësimi i plotë në Këshillin e Byrove të Kartonit të Gjellbër në Bruksel.

Ashtu siç thashë, këto janë propozime të grupit parlamentar, ne pas debatit mund t'i diskutojmë me grupet e tjera parlamentare, konsideroj që ekziston një vullnet i madh i të gjitha grupeve parlamentare për ta zgjidhur këtë çështje, ekziston vullneti edhe i kryeministrit për të bashkëpunuar rreth kësaj çështjeje.

Jam i bindur se të gjithë kemi konsideratë për mërgimtarët, ju kisha lutur që mundësisht t'i lëmë çështjet e konsideratave e fjalëve të mira për mërgimtarë, sepse kemi thënë vazhdimisht prej përfundimit të luftës e deri më tani, por të diskutojmë kryesisht për rekomandimet dhe për zgjidhjen, në mënyrë që sa më shpejt ta përfundojmë këtë debat dhe të dalim me qëndrime të përbashkëta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Lumir Abdixhiku, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës,

Unë nuk besoj që ka ndonjë temë tjetër në Kosovës që gjen më së shumti përkrahje politike në vend se sa tema e Kartonit të Gjellbër, për arsye krejt të pashpjegueshme logjike së paku nuk arrin të marrë zgjidhje pothuajse dy dekada.

Unë sot do të flas në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, por në të njëjtën kohë do të flas edhe në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Komisioni i cili ka nisur tash e sa kohë të merret me këtë problematikë.

Duhet t'ju njoftoj të gjithëve mbi punën që e kemi bërë, kemi vendosur të bëjmë dhe me hapat që kemi vendosur të ndërmarrim.

Siç e dini, në janar të këtij viti ne kemi vendosur çështjen e Kartonit të Gjellbër si çështje prioritare brenda komisionit tonë dhe këtë e kemi paraqitur edhe në agjendën vjetore të punës së këtij Kuvendi, e cila është votuar prej të gjitha partive politike. Deri më tani kemi marrë mbështetje prej secilit grup parlamentar në trajtimin e çështjes në fjalë.

Dhe, ne e kemi konsideruar dhe e konsiderojmë ende si krejtësisht absurde e krejtësisht të dëmshme faktin se 20 vjet pas luftës, Kosova nuk është pjesë e Kartonit të Gjelbër dhe kosovarët s'mund ta ë blejnë këtë karton në vend.

Mbi të gjitha, e konsiderojmë krejtësisht të turpshme faktin që Diaspora jonë është e detyruar të paguajë dhjetëra milionë euro sa herë vjen kënde.

Natyrisht se në thelb të këtij paradoksi mund të gjenden arsye të shumta, por për bindjen tonë, interesat financiare janë kryesore.

Sa për njoftim, unë po ju prezantoj një hulumtim parlamentar, prezantuar këtij Kuvendi në legjislaturën e kaluar dhe në këtë hulumtim citohen të dhënat e Bankës Qendrore mbi policën kufitare.

Për vitet 2001-2014, pra për 15 vjetët e shkuara Diasporës i janë shitur 131 milionë euro polica kufitare.

Për këto 15 vjet i janë marrë Diasporës 131 milionë euro dhe dëmet e paguara për këto polica kanë qenë vetëm 11 milionë. Pra, ka një diferencë, zonja dhe zotërinj, prej plot 120 milionë eurove dhe për këto 15 vjet fitim i bërë mbi paratë e Diasporës dhe në këto interesa, në këtë 120 milionë, nga 8 milionë në vit, qëndron edhe arsyeja e moszgjidhjes së problemit në fjalë.

Tash, javë më parë ne formuam grup punues në përbërjen time, të zonjës Hadërgjonaj, zotit Naser Osmani dhe zotit Blerim Kuqi, i falënderoj të gjitha partitë politike e të tjera dhe në komision që e kanë mbështetur grupin në fjalë, pra si grup i takuam institucionet relevante, takuam bashkë Bankën Qendrore të Kosovës, Byronë Kosovare të Sigurimeve, Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Në këtë takim dhe në takime të tjera që i vazhduam më pas, na u thanë disa gjëra që konsideroj se i ndihmojnë këtij Parlamenti të marrë konkluzat të nevojshme.

1. E para, na u tha nga Byroja se Kosova nuk mund të bëhet anëtare e Kartonit të Gjelbër pa qenë pjesë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Për habinë tonë, ne e shtruam një pyetje ndaj BQK-së se si është e mundur që ne kemi marrë SFIFT kodin pa qenë anëtar i OKB-së, jemi anëtarësuar në shumë organizata ndërkombëtare pa qenë anëtar të OKB-së, përgjigja na u tha se duhet angazhime politike të nivelit të lartë, jo vetëm vendore, por edhe ndërkombëtare, për të marrë këtë anëtarësim.

Dhe, meqenëse anëtarësimin e Kartonit të Gjellbër mund të vonojë, ajo mbetet e paalternativë, pra në periudhën afatgjatë Kosova duhet të jetë anëtare me të drejta të plota të Kartonit të Gjellbër. Po deri atëherë neve na duhet një grithje alternative.

Ne nuk mund t'i lëmë qytetarët tanë të blejnë polica të sigurimit në Bullgari, siç bëjnë tani, me kosto jashtëzakonisht të larta. Ne duhet fillimisht qytetarëve tanë t'i japim një zgjidhje, ta blejnë këtë Karton të Gjellbër në Kosovë.

2. Duhet t'i bëjmë një zgjidhje Diasporës kosovare që vazhdon të paguajë miliona sa herë që vjen në Kosovë.

Dhe, në kërkim të kësaj alternative, deri më tani janë identifikuar dy rrugë.

E para, që do të ishte mjaft e përshtatshme, mbështetet në mbulueshmërinë e Kosovës nga një shtet tjetër.

Në fakt, kemi konsideruar se brenda Kartonit të Gjellbër janë katër shtete që mbulohen prej shteteve të tjera, s'janë anëtare, por gjejnë mbulueshmërinë e shteteve të tjera.

Me siguri disa prej juve mund t'u shkojë mendja në mbulueshmërinë e Kosovës nga Shqipëria, por aq sa morëm informacione, Shqipëria ka probleme të veta financiare brenda Kartonit të Gjellbër.

Një vend i Evropës Qendrore, ku ka shumë Diasporë Kosova, do të ishte një zgjidhje e mirë, por edhe Sllovenia që ka shprehur gatishmërinë, mund të jetë një zgjidhje e mirë.

Rruga e dytë është ndarja e problemit në dy pjesë:

Në pjesën e parë, sigurimin e Kartonit të Gjellbër për qytetarët e Kosovës dhe Pjesën e dytë, zgjidhja e problemit të Diasporës.

Siç edhe thashë në fillim 1,8 milion kosovarë sot e 18 vjet nuk mund të pajisen me Karton të Gjellbër në Kosovë dhe, për çudinë tonë të madhe, Kosova ka pasur një mundësi të shesë kartonë të gjellbër që nga viti 2001. Ky është një dokument që na është bërë publik në takimin tonë punues, është ekstrakt nga Asambleja e Përgjithshme e Kartonit të Gjellbër më qershor 2001, në të cilën ka një vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Kartonit të Gjellbër që thotë se siguresit kosovarë kanë të drejtë të blerjes nga cilado Byro që është e gatshme të kartonëve të gjellbër.

Pra, kompanitë tona të sigurimit kanë pasur të drejtë që prej vitit 2001 të blejnë dhe të shesin kartonë të gjellbër në Kosovë. Një gjë të tillë nuk e kanë bërë, e tëra çfarë është dashur, të gjejnë një kompani dhe ta njoftojnë Asamblenë e Përgjithshme.

Mbi këto premisa ne do të zhvillojmë një takim këtë javë me guvernatorin e Bankës Qendrore, me njëri prej kompanive potenciale, për të gjetur një alternativë që t'u shesin kosovarëve kartonë të gjelbër.

Unë po besoj që zgjidhja për këtë fushë është afër shumë, por kjo zgjidhje nuk e prek, dorën në zemër, çështjen e Diasporës, pra e zgjidh problemin e kosovarëve që të blejnë polica të sigurimit nëpër Kosovë, me çmim besa më të lirë se sa që e blejnë tani, por për Diasporën nuk jep zgjidhje.

Dhe, zgjidhja tjetër është ose mbulueshmëria e Kosovës prej një vend që e njeh Kartonin e Gjelbër, ose njohja unilaterale e Kartonit të Gjelbër nga Kosova.

Në rastin e dytë, në njohjen unilaterale, ne duhet t'i ndajmë diku rreth 2-3 milionë euro në vit për të mbuluar dëmet eventuale që i shkakton Diaspora jonë në Kosovë.

Por, asnjëra prej këtyre zgjidhje nuk mund të implementohet pa zgjidhjen e një problemi të fundit, e më vjen mirë që ministri i Punëve të Brendshme është këtu.

Në Kosovë sot janë 20% të automjeteve të peregjistruara, përkthyer në numër, i bie 65 mijë automjete janë të peregjistruara, pra çdo e pesta veturë që e shihni në rrugë është e peregjistruar dhe nuk mundësi që me këtë numër kaq të lartë të veturave të peregjistruara të zgjidhet çështja e Kartonit të Gjelbër dhe sigurimi i këtyre veturave, sepse dëmi që ato shkaktojnë në Kosovë kap diku shifra rreth 4-5 milionë euro në vit.

Ka edhe vetura të institucioneve të Kosovës që janë të peregjistruara. Pra, ka edhe institucione të Kosovës që nuk i kanë veturat të regjistruara. Ne na duhet një periudhë e shpejtë, prej Ministrisë së Punëve të Brendshme na është thënë se kjo problematikë mund të zgjidhjet për dy vjet, konsideroj se nuk kemi kohë dy vjet të presim, vende si Sllovenia dhe Kroacia e kanë zgjidhur këtë problem për më pak se dy muaj.

Prandaj, kërkoj që edhe pjesë e kësaj rezolute dhe do të bëhet pjesë e kësaj rezolute kërkesa që Ministria e Punëve të Brendshme brenda afatit 2-3 muaj të zgjidhë problemin e këtyre veturave dhe ta sjellë numrin nga 20%, në vetëm 5%.

LDK e mbështet iniciativën, ne i mbështesim disa nga rekomandimet, nuk i mbështesim rekomandimet e kthimit të një komisioni të ri, siç e thashë, kjo është kompetencë e Komisionit për Buxhet e Financa, ku të gjitha partitë politike i kanë të deleguarit e vet.

Komisioni ka bërë grupe punuese, është në fazë të avancuar të diskutimeve. Prandaj e tëra çfarë na duhet është mbështetja për komisionet e tanishme dhe grupet punuese, po them edhe një herë,

në të cilat marrin pjesë të gjitha partitë politike në vend dhe jemi të hapur që këto konkluzat t'i diskutojmë brenda rezolutës së ardhshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Abdixhiku! Fjalën e ka zoti Zenun Pajaziti, a e ke në emër të grupit? Jo! Zoti Lushtaku e ka fjalën në emër të grupit. Më fal, se ishte në renditje i pari Zenuni.

MËRGIM LUSHTAKU: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Pasi edhe vetë emrin e kam Mërgim, sigurisht që kam një përkushtim më të madh për mërgimtarët. Partia Demokratike e Kosovës gjithëherë është angazhuar për zgjidhjen e shumë problemeve, njëri ndër to edhe të çështjes së Kartonit të Gjellbër.

Sa i përket çështjes së Kartonit të Gjellbër përpjekjet për anëtarësim në Këshillin e Byrosë kanë qenë një proces i gjatë, i cili është karakterizuar me sfida të ndryshme. Fillimisht Këshilli i Byrove ka kërkuar që të plotësohen disa parakushte, para fillimit të aplikimit të Kosovës në Këshillin e Byrove.

Këto parakushte kryesore për anëtarësim të Kosovës në Këshillin e Byrove kanë qenë Ligji për sigurimin e detyrueshëm nga auto-përgjegjësia, i cili ka hyrë në fuqi më 14 korrik 2011.

2. Byroja Kosovare e Sigurimit është themeluar më 7 shtator 2011.

3. Qendra informative e sigurimeve, në kuadër të Byrosë Kosovare të Sigurimit ka organizuar funksionimin e Qendrës Informative të Sigurimit.

4. Fondi garantues prej 4 milionë eurosh është themeluar, është investuar dhe bllokuar në njëri nga bankat komerciale të Kosovës, e licencuar nga BQK-ja.

Duke plotësuar këto kushte të kërkuara nga Këshilli i Byrove, Byroja Kosovare e Sigurimit ka plotësuar dhe ka dorëzuar aplikacionin për anëtarësim në Këshillin e Byrove në vitin 2011.

Pas dorëzimit të aplikacionit, përfaqësuesit e Këshillit të Byrove kanë deklaruar se anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Byrove në Bruksel tani për tani nuk mund të ndodhë, për arsye të klauzolës në Kushtetutën e saj që Kosova të jetë anëtare e Kombeve të Bashkuara.

Një gjë e tillë e ka deklaruar edhe nga zonja Glet Flori, në konferencën e dytë ndërkombëtare të sigurimeve, të mbajtura në Prishtinë.

Sigurisht që ne do të mundohemi të gjejmë ndonjë zgjidhje, pasi që kemi anëtarësime edhe në organizata të tjera ndërkombëtare.

Duke pasur parasysh rëndësinë e lëvizjes së lirë të qytetarëve si dhe trafikut ndërkufitar për zhvillimin e ekonomive të një vendi, Këshilli i Byrove ka shprehur gatishmërinë në asistimin e Kosovës për arritjen e marrëveshjeve të mirëkuptimit me vendet fqinje të Kosovës. Përmes këtyre marrëveshjeve është bërë njohja reciproke e sigurimeve nga auto-përgjegjësia për palë të treta, TPL dhe Kartonit të Gjelbër ndërkombëtar, si dhe procedurat e procesimit dhe trajtimit të dëmeve.

Me qëllim të përshpejtimit të shitblerjes së Kartonit të Gjelbër presim që BQK-ja të angazhohet në gjetjen e një zgjedhje të përkohshme deri në anëtarësimin e plotë të Kosovës në Këshillin Byrove, duke zhvilluar takime me disa nga vendet e rajonit me qëllim të hapjes së një zyre në Kosovë nga një sigurues i jashtëm për sigurinë kufitare, i autorizuar nga Këshilli i Byrove. Nëpërmjet kësaj do t'i mundësohet që ky sigurues të ketë mundësinë e shitjes së Kartonit të Gjelbër që i mbulon vendet e Bashkimit Evropian, e me këtë që edhe Kartoni i Gjelbër të përfshijë territorin e Republikës së Kosovës.

Në këtë drejtim pala kosovare ka diskutuar edhe me Slloveninë, në mënyrë që ndërmjet Byrosë Sllovene të Sigurimit të mundësohet shitja e Kartonit të Gjelbër për qytetarët e Kosovës, gjithmonë shteti i Kosovës duke garantuar përmbushjen e obligimeve që dalin nga shtija e Kartonit të Gjelbër. Kjo kërkon kohë, derisa Këshilli i Byrove të pajtohet me mënyrën e tillë të shitjes së Kartonit të Gjelbër.

Megjithatë, përkundër angazhimeve të anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Byrove, një gjë e tillë deri më tani nuk ka qenë e mjaftueshme, duke pasur parasysh rëndësinë e jashtëzakonshme të pranimit në këtë institucion për të mundësuar lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe efektin pozitiv që mund të ketë në ekonominë e vendit.

Megjithatë, vlerësoj se duhet të përfshihen institucionet e Kosovës në bisedimet e Këshillit të Byrove, përmes të cilave do të bëhet shitja e Kartonit të Gjelbër në Kosovë.

Në këtë drejtim rekomandojmë që institucionet e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Punëve të Brendshme përmes Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, BQK-së dhe BKS-së të kërkojnë nga Këshilli i Byrove kriteret që Kosova duhet t'i plotësojë për anëtarësim në këtë institucion, duke përdorur si argument anëtarësimin e institucioneve të tjera ndërkombëtare pa qenë anëtare të Kombeve të Bashkuara, si Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, SFIFT, UEFA, FIFA, gjithashtu jemi të anëtarësuar edhe në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar si anëtar me të drejtë vote.

Gjithashtu duhet shikuar mundësinë që përmes garantimit të institucioneve qendrore të Kosovës të gjendet një zgjidhje e pranueshme për Këshillin e Byrove të shitjes së Kartonit të Gjelbër në Kosovë, qoftë përmes ndonjë shteti mik, siç e përmenda Sllovenisë ose Austrisë, marrëveshjes

me shtetet veç e veç, apo hapjen e një zyre të Këshillit të Byrove në Prishtinë, e cila do të merrej ekskluzivisht me shitjen e Kartonit të Gjellbër.

Përndryshe, është në interes të BQK-së, të siguruesve dhe shtetit të Kosovës, edhe të mërgimtarëve, që të aplikohet Kartoni i Gjellbër. Me qëllim të eliminimit dhe sigurimit kufitar për bashkatdhetarit tanë, të cilët presin me orë të tëra për të hyrë në atdheun e tyre për t'i vizituar familjet e tyre.

Në fund, edhe si anëtar i Komisionit për Buxhet dhe Financa i kemi shqyrtuar të gjitha rekomandimet, por besoj që nuk është e domosdoshme të bëhet një komision ad hoc dhe pajtohem me mendimin që Komisioni për Buxhet e Financa të vazhdojë me këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Lushtaku! Fjalën e ka zoti Sami Kurteshi, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues, për fjalën e dhënë!

Të nderuara kolege edhe kolegë deputetë,

Çështja e Kartonit të Gjellbër tani është bërë një çështje, unë i përgëzoj edhe ata që e kanë filluar, por edhe punën që është bërë edhe në komision, mirëpo siç duket, kjo punë po na shkon sikur 'Ura e fshejtë', fillo, e mandej shembu, fillo e shembu prej qershorit të vitit 2001, kur megjithatë ka qenë një vendim i Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit të Byrove në Gjenevë dhe është interesant, ata kanë kërkuar që të instalohet një model i veçantë për Kosovën për Kartonin e Gjellbër dhe është interesant kjo mundësi kurrë nuk është shfrytëzuar dhe kjo çështje kurrë nuk është bërë publike tash e 17 vjet. Kjo është një çështje.

Po ashtu edhe në vitin 2011 ka pasur diskutime me Byronë e Kartonit të Gjellbër, nuk ka ndodhur asgjë, në fillim të muajit prill të vitit 2014 edhe Këshilli i Byrosë Evropiane është pajtuar të lejohet shitja e Kartonit të Gjellbër për Kosovën, mirëpo marrëveshja nuk është finalizuar për shkak të refuzimit nga kompanitë e sigurimit në Kosovë.

Nëse përpjekja për ta nxjerrë problemin jashtë, për t'i fajësua të tjerët se nuk po bën, nuk po lejojnë, siç i dëgjuam argumentet, duhet të jetë Kosova pjesë e OKB-së! Po çfarë loje është kjo me OKB-në që bëhet për çdo dështim, qoftë të Ministrisë së Punëve të Jashtme, dikujt tjetër apo ndonjë institucioni përgjegjës të Kosovës për ta kryer një punë ashtu siç është e mundur dhe e paraparë me ligj fajësohet domethënë një instancë apo një çështje që nuk ka të bëjë fare me këtë. OKB-ja nuk ka asgjë të bëjë me Kartonin e Gjellbër. Nuk e di qysh kanë mundur të gënjëjnë në këtë mënyrë që vetëm anëtarësimi në OKB bën njohjen e Kartonit të Gjellbër.

Me sa mbaj mend, diku në maj të vitit 2015, me kërkesën e Lëvizjes Vetëvendosje në Kuvendin e Kosovës, edhe në BQK u arrit që këto polica të sigurimit për mërgimtarët tanë të zbriten 50%, ka qenë e mundur, ka qenë çështje e monopolit që e ka mbajtur dikush dhe vazhdimisht është i interesuar të gjejë probleme, të shkaktojë probleme që të vazhdojë kjo gjendje e pagesave që janë realisht të paligjshme.

Ne e dëgjuam edhe kryetarin e Komisionit Funkcional që i sqaroi disa gjëra, edhe iniciuesi i sqaroi disa gjëra, të mos i përsëris unë.

Është çështja se ky monopol i kompanive të sigurimeve, që janë vetëm dy, është pengesa kryesore. Ne kemi edhe pengesa dytësore, edhe të shkallës së tretë, po pengesë kryesore vërtet është monopoli i dy kompanive, sepse fitimi, ashtu siç e dëgjuam të gjithë, është jashtëzakonisht i madh.

Këtu tregon dy dështime të institucioneve tona, për të cilat ne nuk po duam të flasim, ose nuk po dimë a nuk po guxojmë ose diçka tjetër.

Ku është Autoriteti i Konkurrencës që është institucion shtetëror dhe që e ka këtë detyrë, ta iniciojë këtë çështje dhe të shohë pse ngjan kjo, pse ky monopol, edhe pse lejohet kjo zhvatje e kundërligjshme që 17-18 vjet, e Autoriteti i Konkurrencës që nuk është aq i vjetër, nuk vepron, as sot e atë ditë nuk vepron.

Unë mendoj se këtu ka çështje të ndryshme, nuk është vetëm një çështje, përsëri ajo që do të duhej të ngrihej në këtë Kuvend, sepse ka të bëjë me secilin prej nesh si shfrytëzues i automjetit, qoftë në emër të institucioneve apo qoftë privatisht, ka të bëjë me mërgimtarët tanë, po me numrin më të madh ka të bëjë me qytetarët e Republikës së Kosovës që shfrytëzojnë automjetet e tyre, t'i trajtojnë disa pyetje që vërtet janë shumë të rëndësishme. Ato pyetje janë: Kush janë aktorët përgjegjës? Të thuhet me emër e mbiemër pas analizave, kushdo që të jenë atë, që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë pengojnë çështjen e Kartonit të Gjellbër në Kosovë. Të nxirren përgjegjësitë e tyre, të saktësohen ato dhe një herë dikush të merret në përgjegjësi.

Ne nuk kemi sot ende një gjendje reale, përveç atyre që i dëgjuam, cila është gjendja reale me Kartonin e Gjellbër në Kosovë? Përmendën me përqindje ose në shifra absolute 25% ose 65 mijë automjete që bredhin nëpër rrugët e Kosovës e nuk kanë sigurim. Në të vërtetë ato me gjasë nuk janë as teknikisht në rregull dhe përveç që paraqesin rrezik për Kartonin e Gjellbër, paraqesin rrezik të drejtpërdrejtë edhe real për jetën e njerëzve, sepse ato automjete nuk janë teknikisht në rregull. Dikush edhe s'ka mundësi të paguajë, po do ta shfrytëzojë luksin dhe në emër të tjerëve i shfrytëzon këto.

Mandej çështja: Cili është roli i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës në lidhje me këtë çështje? Cilat janë përpjekjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme?

Një çështje tjetër që duhet ngrihet: Cili është roli i Ministrisë së Punëve të Brendshme në këtë çështje?

Zoti Abdixhiku tha se kemi automjete të institucioneve pa sigurime, ne kemi policë që shfrytëzojnë edhe veturat e Policisë, po edhe veturat private pa sigurime!

Po e përmend policin jo për një arsye tjetër, po ai është vërtet zbatues i ligjit, dhe nëse ai e shkel, natyrisht as të drejtën morale, as ligjore madje nuk ia njeh vetit për ta penguar tjetrin që të bredhë rrugëve me vetura pa sigurime.

Po ashtu duhet të diskutohet cilat janë rezultatet e veprimeve të ndërmarra nga aktorët përgjegjës në lidhje me Karton e Gjellbër me Këshillin e Byrove në Gjenevë, nuk kemi asnjë raport në këtë drejtim. Askush nuk e informon as Kuvendin, askush sepse ajo ta themi kështu zhvatja, marrja e mjeteve në mënyrë të paligjshme vazhdon, janë fitime të mëdha, prandaj dikush, sikur në atë fjalën popullore, është bërë sikur “ujku ka interes për mjegull”. Të mos dihet asgjë, të mos ketë përgjegjësi. Askush të mos japë përgjegjësi, kurrkush nuk dinë çka po bëhet, mjegulla vazhdon, ujkit i grahin punës së tyre.

Unë po i quaj “ujq” këto kompanitë e sigurimeve se vërtet nuk e arsyetojnë në asnjë mënyrë mënyrën e zhvatjes që bëhet edhe me Kartonin e Gjellbër, por edhe me sigurimet që bëhen në kufi për mërgimtarët tanë. Edhe në fund duhet të bëhet një pyetje, vërtet kujt i pengon shitja e Kartonit të Gjellbër për shtetasit e Kosovës, që udhëtojnë jashtë? Edhe kujt i pengon domethënë njohja e sigurimeve jashtë për mërgimtarët këtu? Të pyeten konkretisht dhe ata njerëz të nxirren. Deri atëherë unë mendoj që puna do të jetë keq. Ne i kemi marrë rekomandimet nga iniciuesi i debatit, do t’i shohim me shumë kujdes dhe unë mendoj se të gjithë deputetët e Parlamentit të Kosovës, meqenëse të gjithë jemi të prekur, asnjë prej neve nuk përjashtohet nga kjo, përjashtojta ata që mund të kenë përfitime nga Kartoni i Gjellbër që shitet nga ky monopol, do ta votojnë një dokument, mocion, rezolutë apo çfarëdo qoftë, që të fillon ta trajtojë këtë çështje në mënyrë të drejtë, pa shtrembërime, pa mashtrime, pa ikje nga përgjegjësia dhe ne ta fillojmë së paku lëvizjen e lirë, që është një ndër kërkesat kryesore të botës demokratike, pa zhvatje nga askush. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Salih Salihu e ka fjalën, në emër të PSD-së.

SALIH SALIHU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Pra, është e padrejtë që qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët punojnë jashtë vendit, ende po vazhdojnë t’i vjelin në kufi me taksën e Kartonit të Gjellbër.

Ne ata nuk i shohim si qytetarë dhe kontribuues të mëdhenj në bruto-produktin vendor rreth 1 miliard në vit që i sjellin si remitenca, të cilët po e mbajnë gjallë sektorin e konsumit dhe të ndërtimit, por si një mundësi për t'i vjelë në rrugë dhe atë duke filluar që nga kufiri. Është e pakuptimtë që fjala e parë që u thuhet mërgimtarëve tanë ende pa ardhur në pikën e kontrollit policor “shko bëje pagesën e Kartonit të Gjellbër për ta siguruar veturën”. Ndërsa, ata askush nuk i pyet për sigurimin shëndetësor të tyre dhe të fëmijëve të tyre, për çka themi se ata e kanë sigurimin shëndetësor, domethënë të jashtëm. Pra, më e rëndësishme është që të sigurohet vetura e tyre në Kosovë sesa sigurimi shëndetësor i tyre dhe i fëmijëve të tyre.

Pra, të gjitha qeveritë e dinë këtë problem dhe asnjëherë nuk u bë asnjë përpjekje nga Byroja e Sigurimeve në Kosovë që të gjendet një zgjidhje apo një formë që edhe Kosova të bëhet pjesë e organizatës së Kartonit të Gjellbër.

Pra, mjaft i kemi vjelë ata ne, gati se 8 milionë euro për çdo vit, dhe atë për gati 2 dekada, që bëjnë rreth 160 milionë euro nga mërgimtarët tanë, dhe mendoj se ka ardhur koha që sot të vendosim në Kuvend dhe thjesht ta ndalim më tutje vjeljen, sepse është pjesa më e ndershme dhe më kontributore në Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe ne vazhdojmë ata t'i vjelim në kufi dhe kjo është padrejhtësisht për shkak të interesave të kompanive të caktuara që deri më tash u pa e u diskutuan edhe nga kolegët tjerë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Me kërkesë të tij, ia kaloj fjalën Naser Osmanit, e ka një punë urgjente dhe po ia jap fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Unë dola vetëm t'i them edhe nja dy-tri fjalë për atë që konsideroj që mirë e ka thënë kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa në mënyrë shumë të artikuluar dhe konsideroj me gjithë respektin për deputetin që e ka ngrehur këtë çështje që vazhdimisht në këtë kohë, edhe vitin e kaluar më duket ka qenë, e kuptoj që e ndjen, i ndjen bashkatdhetarët.

Është mirë që komisioni që është ngrehur ta vazhdojë punën dhe kush do t'i bashkëngjitet është i mirëseardhur në komision, por komisioni ka ardhur në përfundim të një ideje për ta konkretizuar çështjen e Kartonit të Gjellbër, dhe konsideroj që është një çështje praktike tani. Ajo çka është me rëndësi ta përmend është që ne e kemi gjetur një rrugë alternative të përkohshme deri në anëtarësimin e plotë, duke u thirrur në vendimin e pestë të Asamblesë së Përgjithshme të Kartonit të Gjellbër, që është mbajtur në Gjenevë, në vitin 2001. Ajo çka është e rëndësishme tash për neve është që makinat që qarkullojnë në Kosovë, 25 deri 30%, 65 mijë makina përafërsisht, të bëjmë përpjekje ta zvogëlojmë. Kjo është çështje e Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe kam dalë këtu sot vetëm që t'i them ministrit të Punëve të Brendshme ndihmoje procesin dhe mos e vështirëso procesin. Procesi ndihmohet nëse pezullohet përkohësisht vendimi apo kushti për regjistrimin e automjeteve me pagesën e tatimit në pronë dhe që e ka vështirësuar këtë

çështje është hyrja në fuqi në 1 qershor i vendimit të Policisë për të mos mund të regjistrohet asnjë veturë nëse nuk paguhet gjoba. Domethënë, numri do të shkojë duke u rritur.

Gjoba është çështje gjyqësore, polici ka për obligim ta shqiptojë gjobën, ndërsa çështja gjyqësore është nëse paguhet edhe kur paguhet. Asnjëri prej neve nuk mund ta detyrojë gjykatësin ta përshpejtojë procedurën tonë, ta sjellë vendimin, ta paguajë gjobën për të mundur ta regjistrojë automjetin. Prandaj, është e domosdoshme që të suspendohen përkohësisht dhe urgjentisht këto dy vendime, të cilat e pengojnë regjistrimin e automjeteve dhe, në anën tjetër, Policia duhet të bëjë përpjekje maksimale që t'i grumbullojë të gjitha tabelat e automjeteve, të cilat nuk janë në qarkullim. Automjetet, të cilat qëndrojnë nëpër 'pllace' me regjistrime, automjete të cilat kanë dalë jashtë përdorimit dhe automjetet e paregjistruara nën limitin që e lejon Byroja e Kartonit të Gjellbër ndërkombëtar dhe ajo është deri në 5%. Po nuk e sollëm në gjendje, vetëm mund të flasim, por nuk kemi rezultat konkret dhe përpjekja e komisionit që të bëhet zgjidhje e përkohshme një kompanie që ka për ta dhënë Kartonin e Gjellbër është gjysmë pune, por është punë e mirë. Ndërsa mbetet që me vullnetin e Qeverisë, nëse Qeveria do të ndajë një fond në rishikim që ta mbulojë pjesën e dëmeve, të cilat mund të shkaktohen nga bashkatdhetarët tanë në kohën sa qëndrojnë në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Naser, për replikë është lajmëruar zoti Faton Topalli.

FATON TOPALLI: Në fakt, desha të sqaroj diçka, por është më së miri ta lë këtë për fund të debatit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në rregull! Atëherë, zoti Kuçi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së fjalën.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesues!

Edhe pse pak me vonesë, me dy vonesa, megjithatë faleminderit!

Për këtë temë është debatuar kohë të gjatë, ka 17 vjet që është debatuar edhe në Kuvend, edhe në medie, nëpër shtëpitë tona, e më së shumti është debatuar te mërgimtarët. Dhe, debati është formë e shterur më, por tash na duhet zgjidhja dhe, për fat të mirë, ajo që po e shohim ne ka vullnet politik për të ardhur deri te zgjidhja e kësaj çështjeje. Por, jo veç vullnet politik, por edhe mekanizmat shtetërorë janë të gatshëm për ta zgjedhur këtë çështje, qoftë Qeveria, qoftë BQK-ja.

Kryetari i komisionit, zoti Lumir Abdixhiku, foli edhe në emër të komisionit dhe në njëfarë forme foli edhe në emrin tim, se është bërë një punë, së paku ka filluar dhe kjo punë e ka marrë një kah edhe nëpërmjet komisionit, jo veç komisionit, por edhe grup punues të veçantë për ta zgjidhur këtë çështje. Ne kemi biseduar me të gjithë aktorët, e tha edhe zoti Abdixhiku, e pashë që edhe me Grupin Parlamentar të PSD-së në rekomandime kemi shumë gjëra të përbashkëta. Unë propozoj që rekomandimet patjetër të harmonizohen me këtë grup punues, sepse të dy këta

mekanizma janë mekanizma të Kuvendit dhe s'ka kuptim që seanca të bëjë rekomandime të veçanta, e rekomandime të veçanta edhe komisioni. Po ju propozoj kolegëve në përgjithësi, por sidomos shefave të grupeve parlamentare që ta rregullojnë këtë çështje, që rekomandimet të harmonizohen konform bashkë me Grupin Punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa, sepse është bërë një punë, kemi bërë disa hapa dhe nuk ka kuptim të kthehemi mbrapa. Ose të bëjmë rekomandime, të cilat mund të mos jenë të zbatueshme. Shpesh ne kemi rekomandime në këtë Kuvend dhe ato nuk zbatohen në kohë, sepse janë të pazbatueshme.

Ky grup punues ka punuar, e kisha lutur edhe zotin Topalli që bashkë me këtë grup sot të ulen dhe t'i harmonizojnë rekomandimet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sherifi e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të Nismës.

BILALL SHERIFI: Faleminderit zoti nënkryetar, kryesues i seancës!

Kjo çështja e Kartonit të Gjelbër, nëpërmjet të cilit mërgimtarët taksohen në kufi për të qenë të siguruar në territorin e Republikës së Kosovës, për mendimin tim dhe besoj edhe për shumë kolegë, të cilët folën deri tash, e ka pasur veç një qëllim: sigurimin e stabilitetit financiar, apo sigurimin e profiteve të mëdha të kompanive të sigurimit, të cilët e mbulojnë territorin e Kosovës.

Pra, kurbetçinjtë, mërgimtarët, ashtu sikur kontribuojnë nëpërmjet mbështetjes financiare në familjet e tyre në stabilitetin financiar të vendit, kontribuojnë edhe në stabilitetin financiar të kompanive. Pra, ky është qëllimi, nuk ka asnjë shpjegim tjetër pse deri më tani nuk është zgjidhur kjo çështje. Edhe unë jam shumë i sigurt që asnjë nga mërgimtarët, të cilët i japin ato para në kufi nuk do t'i konsideronte shumë para sikur ato të shkonin në funksion të rritjes së buxhetit të vendit, por kur ato shkojnë në pak duar, natyrisht që edhe ata i irriton, besa do të duhej të na irritonte edhe neve.

Mirëpo, tash unë do të ndalem të përpiqem të shpjegoj apo ta jap këndvështrimin tim, jo pse ndodh kjo, sepse ky është qëllimi kryesor, por mënyra sesi arsyetohet kjo. Për shembull, një nga mënyrat më klasike është se e kemi një numër të madh të veturave të peregjistruara. Unë shtroj pyetjen: A di kush të më tregojë se si e nxjerr këtë statistikë? Çdo veturë e peregjistruar nuk është po ashtu çdo veturë që del në komunikacion. Ligji, Rregullorja apo si është e rregulluar te ne nuk thotë që nga momenti kur ti, se nuk gaboj, nuk e paguan duhet t'i dorëzosh tabelat, siç është e rregulluar në shumë vende. Nuk mund të mbash tabela nëse nuk i ke paguar, sepse asnjë vend nuk ka kapacitete aq të mëdha policore sa t'i shkojë çdo njeriu në shtëpi dhe t'ia marrë librezat, por statistikën konsideroj që duhet të nxirren nga numri, përqindja e saj duhet të nxirret nga numri i veturave, të cilat Policia i kap në rrugë gjatë kontrolleve qoftë të rregullta, qoftë aksidentale të herëpashershme.

Dhe, me sa unë di, numri i veturave që janë kapur në qarkullim nuk është më shumë se 5%. Le të flasim edhe autoritetet e Policisë, të cilat besoj i kanë këto statistika, nuk është më shumë se 5%. Mirëpo, këtu bëhet lojë fjalësh, apo lojë argumentesh. Çdo veturë e doganuar konsiderohet e peregjistruar. Natyrisht që mund të jenë shumë të peregjistruara, por shtrohet pyetje a dalin në komunikacion? Ne jemi dëshmitarë që dalim çdo ditë në rrugë dhe shohim vende ku shiten vetura me nga 100, 200, 1 000, e besa bëhet një numër jashtëzakonisht i madh i tyre që mbahet në vende të caktuara që quhen “garazhe”, vende ku shiten veturat dhe ato nuk mund të konsiderohen vetura të peregjistruara. Janë të doganuara, gjithçka është e regjistruar që ka hyrë në Kosovë, por me automatizëm e futin te veturat e peregjistruara dhe e marrin këtë shifër si shifër të mirëqenë të veturave, të cilat dalin në komunikacion.

Kjo fare nuk është as serioze, as shkencore, as e rregullt, mirëpo përdoret nga kompanitë e sigurimeve, nga lobuesit e tyre për ta paraqitur gjendjen alarmante në këtë drejtim. Unë nuk e pranoj këtë si fakt. Pastaj, nëse e kemi parasysh faktin se kohëve të fundit është marrë një vendim që të mos regjistrohen veturat nëse nuk e kanë bërë pagesën e gjobave, pikërisht atë që e tha zoti Osmani, kjo shkon në funksion të rritjes së kësaj shifre te veturat e peregjistruara. Në vend që të kontribuojmë që ta tregojmë të vërtetën, ne marrim vendime, të cilat i kontribuojnë kësaj, rritjes kësaj shifre në mënyrë të padrejtë.

Pra, sepse njerëzit, nuk është se nuk duan ta paguajnë, por e lidhin me gjobat dhe njëherë, me sa e di unë, një vendim nga Gjykata Kushtetuese, që do të ishte analoge, me këtë është marrë, që nuk mund të marrësh një masë për një çështje tjetër për të ndihmuar që të paguhet një masë tjetër. Kjo është e papranueshme, nuk di tash, nuk më kujtohet më saktë vendimi, më duket ka pasur të bëjë me KEK-un, i cili merrte para nga Radiotelevizioni i Kosovës, nëse ju kujtohet kjo. E ka rrëzuar një herë Gjykata Kushtetuese. Ky vendim i Ministrisë është pak a shumë e njëjta gjë dhe duhet menjëherë, pajtohem që kjo duhet menjëherë të shfuqizohet, është totalisht e padrejtë, sepse vetura mund të jetë e pronarit, i cili mund t’i ketë dy-tri gjoba, por aty ka rrugë tjera, janë gjyqet, janë format tjera administrative kundërvajtëse, që e rregullojnë këtë çështje.

Dhe, ne duhet t’i ngremë kapacitetet administrative për t’i mbledhur këto gjoba, por jo të mos pranojmë të marrim para për regjistrim, sepse nuk po na jepen paratë për gjoba. Pra, humbje e dyfishtë, edhe nuk merren para për regjistrimin e veturave, veturat vazhdojnë të qëndrojnë nëpër oborret e tyre, apo besa edhe mund të dalin pastaj në qarkullim nëse rritet shumë numri, por nëse ministria nuk ka kapacitete të shkojë t’ua marrë tabelat, apo t’i detyrojë në një mënyrë që t’i dorëzojnë tabelat të gjithë ata që nuk i kanë të regjistruar, natyrisht që nuk ka mundësi me masa gjysmake të tentohet të rregullohet kjo çështje.

Por, për fund, ne në kuadër shpresoj të një konsulte që do ta kemi edhe komisioni, edhe propozuesi i kësaj çështjeje, të ulemi të bisedojmë, t’i nxjerrim disa përfundime të përbashkëta, të cilat nuk do t’i kishin për qëllim parësor përfitimet politike, por të kenë për qëllim parësor

zgjdhjen e kësaj çështjeje, në mënyrë që kurbetçinjtë, mërgimtarët kur të vijnë këtu të mos ndeshen me telashet që i kanë dhe të mos kenë nevojë të bëjnë pagesa, të cilat i kanë bërë. Sepse, të gjithë e dimë që Kartoni i Gjellbër është thjesht pjesë e polisës së sigurimit në vendet nga vijnë kurbetçinjtë. Ata atë e marrin falas, por Kosova nuk figuron në hartën e tyre dhe, meqë nuk figuron në hartën e tyre, pastaj shteti i Kosovës detyrohet që këtu t'ua taksojë për aq sa e kanë taksuar deri më tani. 8 apo 10 milionë në vit, siç thuhet, janë marrë nga ata. Shikuar në përgjithësi si shumë në raport me atë 1-miliardëshin që e e sjellin ata në vendin tonë, nuk është shumë, por është i padrejtë.

Nuk bëhet fjalë për shuma të mëdha. Asnjë nga mërgimtarët nuk thotë është shumë e madhe, por është e padrejtë, sepse nuk shkon në funksion të zhvillimit të vendit, apo nuk shkon në funksion të së mirës së përgjithshme publike, por shkon vetëm në funksion të pasurimit të padrejtë të disa individëve, apo disa grupeve të caktuara të interesit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Zemaj, nuk qenka këtu. Atëherë Korab Sejdiu.

KORAB SEJDIU: Të dashur qytetarë!

Kryesues, kolegë të nderuar,

Para pak ditësh patëm nderin që pikërisht në këtë sallë ta presim një numër të madh të përfaqësuesve tanë nga Diaspora, të cilët ishin mysafirët tanë dhe natyrisht gjatë atij qëndrimi edhe një herë e treguan gatishmërinë e tyre që t'i ndihmojnë Kosovës, në shumë aspekte, qoftë në aspektin zhvillimor, institucional, e kështu me radhë. Mirëpo, natyrisht përçuan te ne edhe shqetësimet e tyre, veçanërisht sa i përket trajtimit që kanë nga vendi i tyre amë.

Unë besoj që nuk është e nevojshme të shpenzohet kohë duke biseduar dhe duke folur për kontributin e jashtëzakonshëm që Diaspora jonë e ka dhënë për këtë vend, sepse është e ditur nga të gjithë ne, dhe shumë rrallë na jepet mundësia që Diasporës sonë t'ia kthejmë, si të themi, "të mirën me të mirë". Fatkeqësisht, me çështjen e cila po debatohet sot këtu, në vazhdimësi ua kemi kthyer të mirën me të keqe. Kur flasim sot për këtë çështje, kjo duhet të ndahet ndoshta në dy aspekte: një është trajtimi i Diasporës gjatë qasjes së tyre në territorin e Republikës së Kosovës, veçanërisht me vetura, mjete motorike, por edhe aspekti i qytetarëve tanë, të cilët e pësojnë sa i përket mospranisë tonë në Kartonin e Gjellbër.

Unë e kam ngrehu këtë çështje në fakt para disa ditësh shkurtimisht pas takimit tonë me Diasporën duke ia drejtuar një pyetje parlamentare edhe ministrit për Diasporë dhe shpresoj në përgjigjen e tij sa u përket hapave që do t'i ndër marrë ai për ta shtyrë përpara njërën nga këto dy çështje që i përmenda sot, veçanërisht këtë pjesën e Diasporës. Unë e mirëpres përgjigjen e tij brenda afateve kohore, edhe pse nganjëherë nuk është se po na përgjigjet Kabineti qeveritar dhe të tregoj të drejtën deri më tani kjo çështje është lënë në duart e Byrosë së Sigurimeve dhe unë sot thërras institucionet e vendit që kjo çështje të adresohet në nivele pak më të larta, pra edhe

Ministria e Financave, edhe BQK-ja, e përgëzoj edhe Komisionin për Buxhet dhe Financa që kanë ndërmarrë veprime në këtë drejtim, përfshirë edhe Ministrinë e Diasporës dhe të mos lihet pra kjo çështje vetëm në duart e Byrosë, por në fakt brenda një afati kohor të gjendet zgjidhje.

Unë besoj që sot janë përmendur vetëm disa nga alternativat e mundshme për ta tejkaluar çfarëdo pengese eventuale që mund të ketë kjo çështje. U përmend çështja e veturave të paregjistruara, e unë kam përvojë për shembull prej Amerikës, ku çdo veturë e policisë është e pajisur me një skaner, i cili në vazhdimësi i skanon tabelat e veturave që qarkullojnë dhe e paralajmëron policin në veturë për çfarëdo shkelje të mundshme që ka bërë ajo veturë ose vozitësi i asaj veture, përfshirë këtu edhe mungesën e regjistrimit. Kështu që nuk është çështje problematike dhe kushton shumë më pak të bëhet kjo se sa të vazhdohen me qasjen e Administratës tonë ndaj shkaktimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut që po u bëhet në vazhdimësi, përfshirë këtu edhe vendimin e fundit për mosregjistrimin e veturave si pasojë e gjobave të papaguara, të cilat edhe mund të jenë në procedura gjyqësore.

Ose ka edhe shumë alternativa tjera, edhe shumë çështje tjera, por prapë po them që ne e kemi obligim edhe kushtetues, edhe ligjor, që problemet e qytetarëve tanë t'i adresojmë, përfshirë këtu çfarëdo problemi edhe sa i përket Kartonit të Gjellbër. Por, e kemi edhe një obligim shtesë moral ndaj Diasporës që trajtimin, ose siç u tha sot, fjalët e para që i dëgjojnë nga ne të mos jenë edhe një ngarkesë shtesë financiare mbi të gjitha ato që i kanë bërë deri më tani.

U përmend edhe çështja e tarifave dhe shpërputhjes ndërmjet të hyrave dhe pagesave që janë bërë, shpërputhje ekstreme, pse nëse veç nuk po eliminohen këto tarifa, pse të mos zvogëlohen në akordancë me pagesat që janë bërë. Kështu që thërras edhe një herë që brenda një afati shumë të shkurtër institucionet tona përgjegjëse t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme që të adresohet ky problem, që besoj të gjithë pajtohemi se e ka kaluar çdo kufi kohor të mundshëm si çështje që është lënë pas dore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryesues!

Jam njëri prej atyre që gati çdoherë, punë sezonale është bërë kjo temë, çdoherë në qershor, në fillim të qershorit, kur fillojnë të vijnë bashkatdhetarët tonë, të gjithë kujtohemi që ata e kanë një problem, e që është një problem yni, Kartoni i Gjellbër.

Edhe është mirë që u tha këtu vullneti politik, është mirë që po debatohet, është mirë të ketë reagime, është mirë të ketë rezultat. Sa herë që kemi pasur debat këtu, ka vazhduar një diçka që ka pasuar me zbritjen e çmimit të këtyre tarifave të Kartonit të Gjellbër. Domethënë ka pasur njëfarë reagimi, por me vite të tëra është kërkuar heqja, e ne e dimë që kjo heqje nuk mund të bëhet derisa ne nuk jemi pjesë e asociacionit të Kartonit të Gjellbër. Por, vullneti politik nuk

mund të justifikohet vetëm me kaq, me një kërkesë të një grupi të deputetëve, me një debat në Parlament dhe kaq.

Një vullnet real politik do të ishte sikur ne pas kësaj kohe t'i kishim ministrat që do të duhej të na pajisnin me informata të sakta këtu, ministri i Brendshëm, ministri i Jashtëm, për përpjekjet që janë bërë, për të qenë ne pjesë e Kartonit të Gjellbër dhe ministri i Financave, që mbulon këtë dikaster që të na japë informacione më të sakta që vijnë nga asociacioni ynë i Byrosë së Kartonit të Gjellbër e disa u thanë nga deputetët këtu në Parlament. Po ashtu, të kishim një informatë, se ku është kjo çështje edhe në procesin e dialogut, sepse ne e dimë që ka pasur kjo temë ka qenë edhe në dialog. Ne nuk i kemi këto, nuk mund të themi se kemi një seriozitet të duhur politik, ose një vullnet të plotë politik që të merremi me këto.

Por, ajo që mund të rezultojë, mund të rezultojë prapë sivjet shpejt me një zbritje të çmimit të tarifës. Para disa vjetësh, kur unë e kam shtruar këtë temë edhe deputetët tjerë po ashtu, unë kam pas marrë një informacion se diku rreth 10 milionë atëherë, sot u përmend 8 milionë, grumbullohen nga kjo taksë, nga ky Karton i Gjellbër nga bashkatdhetarët dhe diku 20%, atëherë thuhej, diku rreth 2 milionë janë ato që shpenzohen, pra nga dëmet, aksidentet e ndryshme gjatë kësaj kohe sa qëndrojnë ata. Domethënë, rreth 80% ish mundësia e uljes së kësaj tarife. Sot, nuk mund ta kërkojmë saktë, sepse nuk i kemi informatat e sakta sa para janë grumbulluar vitin e kaluar, sa janë shpenzuar për dëmet dhe sa eventualisht, në rast se nuk mund ta heqim krejt, mund ta bëjmë një zbritje prapë të kësaj tarife.

Unë mendoj që edhe komisioni përkatës i Kuvendit, meqenëse paska një interesim të shtuar që po shihet, mund të bëjë punën e vet dhe dakordohem që të ketë edhe nga iniciuesi, grupi i deputetëve dhe komisioni një koordinim, në mënyrë që rezoluta që do të dalë këtu, të ketë ndikim më të madh këtë vit, se sa vitin që shkoi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Mikullovc i ka fjalën.

ADEM MIKULLOVCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë mendoj se pak tepër po komplikohet kjo puna e Kartonit të Gjellbër. E keni mbushur me ligje, nene e fatura, s' di çfarë... ai nen, ai shtet, Kombet e Bashkuara... Kjo punë, vëlla, zgjidhet shumë lehtë e shumë... çka ka këtu Ministria e Financave?

Unë e kam një propozim, ndoshta s'është i ligjshëm, se s'jam jurist, por kur bëhet regjistrimi i makinës, ai nuk mund të bëhet pa regjistrim teknik, të jetë obligativ edhe kartoni i Gjellbër. Qytetari në atë moment e siguron Kartonin e Gjellbër, edhe e paguan. Me rëndësi është që kosi mos të jetë i shtrenjtë dhe çdo qytetar e ka Kartonin e Gjellbër. Të gjendet mënyra me Diasporën atyre qysh t'u bëhe kartonët e gjellbër, sa për qytetarët e Kosovës kjo punë është fare e thjeshtë. Faleminderit! Vetëm kaq!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Daut Haradinaj e ka fjalën. Zoti Nitaj, ti me radhë e ke fjalën.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, kryesues i Kuvendit!

Mirë që po flasim për këtë temë, por nëse kjo tematikë, kjo materie është sezonale, siç tha zoti Pajaziti, atëherë është shqetësuese, sepse ne rikthejmë në debat çdo fillim të sezonit kur vijnë njerëzit e Diasporës. Në fakt, janë masa të tmerrshme diskriminuese ndaj njerëzve që shfrytëzojnë makina e që vijnë nga Diaspora, mirëpo edhe ndaj atyre që shfrytëzojnë makina e jetojnë në Kosovë.

Unë nuk arrij të kuptoj, për shembull, si mund të funksionojë ky sistem? Kosova është një shembull shumë origjinal. Nuk mund të regjistrohen veturat nga njerëz që nuk kanë patentë shoferi. Unë nuk e di ku e kanë marrë këtë model edhe si mund t'i godasin qytetarët e këtij vendi deri në këtë masë. Nuk mund të regjistrohen veturat pa u paguar tatimi në pronë, pa u paguar edhe taksa ndëshkuese prej 10 eurove në komunat përkatëse. Tash paska hyrë në fuqi edhe vendimi se nuk mund të regjistrohen veturat pa u paguar gjrobat e trafikut, ose pa u paguar faturat e ujit apo edhe të bërllokut. Unë nuk di se ky vend çka ka me trillua akoma më shumë, në mënyrë që t'ua nxijë jetën këtyre njerëzve, që veturën e kanë mjet të funksionimit.

E përcolla me vëmendje, edhe kolegun Osmani, edhe kolegun Sherifi, për këto vendime diskriminuese të cilat ndoshta dalin pak edhe jashtë asaj gamës që lidhet ngushtë me Kartonin e Gjellbër, por nëse ky Kuvend mund të diskutojë dhe nëse ky Kuvend mund të marrë çfarëdo vendimi që i eliminon këto masa diskriminuese ndaj qytetarëve të Kosovës, mirë, shyqyr, hajde po flasim edhe po vendosim. Nëse kjo është një temë politike, qysh zakonisht nxirren këto materiet për interesa politike, klienteliste, për interesa të votave, është marre e faqja e zezë për ne. Faktikisht, unë e kuptoj shqetësimin e qytetarëve, mirëpo besoj se duhet t'u thuhet qartë se Kartoni i Gjellbër sot është shndërruar në një instrument për përfitime të kompanive dhe të individëve të caktuar.

E përmendi zoti Pajaziti, tha se kjo materie nuk mund të rregullohet, sepse nuk është vetëm çështje e vullnetit politik, sepse Kosova nuk është anëtare e mekanizmave që rregullojnë këtë çështje. Unë kam një pyetje publike, pse nuk është Kosova anëtare e Byrosë së Kartonit të Gjellbër, por vazhdon të jetë si “zorë qorre” dhe ne në emër të saj t'i zhveshim sa herë vijnë njerëzit nga Diaspora në Kosovë t'u marrim sa më shumë të mundemi dhe Kartoni i Gjellbër si koncept të mos vlejë as për vetë qytetarët e Kosovës, sepse përpos Shqipërisë nuk ka fuqi bash në asnjë vend tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zeka e ka fjalën.

MILIAM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

E para, po e vazhdoj ku e la Muharremi.

Masat diskriminuese, antikushtetuese, që shkelin në mënyrë flagrante të drejtën e çdo qytetari të Kosovës. Janë pikërisht ato masa që fillimisht i kishte marrë komuna e Prishtinës, për të paguar tatimin, me e pagua gjobën 10 euro e pastaj me e regjistrua makinën. Kjo, zoti kryesues, është identike sikur çdo deputeti të Parlamentit të Kosovës me ia ndalua regjistrimin e makinës, në qoftë se mungon në një seancë parlamentare. Absolutisht, identike është, s'ke ardhur në seancë, nuk mund ta regjistroshe makinën. Dhe, çka po bën shteti i Kosovës? Shteti i Kosovës i ka dhënë mundësi qytetarit të shkretë, të dalë me makinë të pasiguruar në komunikacion dhe të mbysë atje njeriun duke pasur makinën e pasiguruar. Kjo është e para.

E dyta, krejt kjo që po diskutojmë sot, shtrihet në dy autostrada. Autostrada e parë është me fitua ne vota prej Diasporës, domethënë këtu po bëhet hipokrizi ndaj Diasporës, sepse ne e dimë fort mirë se gjë s'do të dalë prej këtij debati dhe e tha shumë mirë Sami Kurteshi, që në fillim kur kanë mundur të zgjedhin në vitin 2001 nuk kanë dashur ta bëjnë atëherë. Ky është problem kryekëput politik numër një dhe interesi financiar, numër dy.

Autostrada e dytë, është që ne nuk po guxojmë të themi cilat janë klanet e ndryshme politike, që po pengojnë realizimin e kësaj pune dhe po vazhdojmë me e plaçkitë qytetarin e Kosovës, mërgimtarët që vijnë këtu. Prej një budallallëku politik, Edi Rama, pa u konsultuar fare me Qeverinë e Kosovës, pa i shikuar fare interesat e qytetarëve të Kosovës, pa i parë qytetarët e Kosovës sikur të ishin qytetarë të Durrësit, mori vendim për tarifën 10 euro, sepse po të analizonte ai mirë pasojat e atij vendimi nuk do ta merrte ai një vendim të tillë. Po mblidhen rreth njerëzve tonë politikë nja 7-8 harambashë atje dhe thonë, ky është interesi ynë, mëshoj ti, merre këtë vendim. Sepse, me vendimin e tij ai ka dëmtuar mbi 800 mijë turistë kosovarë që japin milionë e milionë Republikës së Shqipërisë.

Me vendimin absurd Kartonit të Gjellbër, që ne i plaçkitim mërgimtarët tanë që 17 vjet, ne po i largojmë ata, sepse kanë filluar të shkojnë edhe t'i kalojnë pushimet nëpër Turqi, në Dubai e në çdo vend të botës. Ne po harrojmë, se çdo mërgimtar që hyn në territorin e Kosovës, i lë gjatë pushimit të tij, minimum 3 000 - 5 000 euro. Kjo fare nuk është në interesin e atyre qarqeve që përfitojnë milionë nga Kartoni i Gjellbër.

Një drejtor i një kompanie të sigurimeve ka pas deklaruar dikur publikisht me emër e mbiemër ka pas thënë, se filani është pengesë për Kartonin e Gjellbër, e ka pas thënë me emër. Dhe, çfarë ndodhi? Ky person u gradua hop në një post më lartë edhe u bë anëtar kryesor i delegacionit në Bruksel për të udhëhequr bisedimet e Kartonit të Gjellbër. Nëse doni, në ndonjë debat tjetër ua them edhe me emra, por sot kam vendosur të mos flas me emra.

Sali Mekaj e ka thënë deklaratën e vitit, ish-kryetari i Gjykatës së Lartë të Kosovës. Ka thënë, se në Kosovë është ndërtuar sistemi prokurorial, ku me një telefonatë, me një bisedë merresh në pyetje dhe ta shkatërrojnë jetën. Për një bisedë, për një debat këtu në Parlament, për shembull,

ose për një deklaratë televizive prokurori i shtetit thërret me dhjetëra deputetë nëpër hetuesi, nëpër marrje në pyetje, e tjera, e tjera, sikur ne të ishim, jo deputetë të Parlamentit të Kosovës, po me qenë ne njerëz që shesim fara atje në treg. E kanë marrë Rexhep Selimin në pyetje, më kanë marrë mua, për shembull, për një deklaratë televizive, e kanë thirrur Jakup Krasniqin në pyetje, që po ua them me emra. S'po kallëzoj që e kanë thirrur edhe Haxhi Shalën, e tjerë...

Tani, çfarë kërkojnë mërgimtarët prej nesh? Ata e dinë që do të vijnë këtë verë. Nuk kërkojnë këtë heqjen e kartonit, se e tha shumë mirë Bilalli, me e ditë ata që këto 15 euro shkojnë në ndërtimin e çerdheve të fëmijëve, në ndërtimin e azilit të pleqve, në ndërtimin e spitaleve, ata vetë thonë na i merrni nga 50. Është çështje e menaxhimit, prandaj ne do të duhej të hetonim kah kanë shkuar 130 milionë. Qysh janë shpenzuar 130 milionë. Kush i ka përbirë këto para? Kjo do të ishte interesant për Parlamentin, se ne do të nxjerrim rezolutë edhe kurrgjë hiç, do të 'vringëllatim' aty në një vend e s'do të asi...

Mërgimtarët tanë, që çka kërkojnë. Është vendim politik i Republikës Popullore të Shqipërisë që ne gjatë sezonit veror nuk na kontrollojnë në kufi, shkojmë pa radhë. Atëherë, ne duhet të kërkojmë nga ministri i Punëve të Brendshme, që kur të vijnë mërgimtarët të mos kontrollohen, nën një. Nën dy, a e dini bre çka u bëjnë në aeroport mërgimtarëve tanë të shkretë. 20 kg. t'i merr çdo kompani e aeroplanëve. Hajde, të thotë, fute këtu çantën, e mban aty 5 minuta duke ia kontrollua parfumet, ku i ke ble, çka i ke ble... Pse? Sepse, shtetet diktatoriale jetojnë prej doganave.

Ne po themi: duam të hyjmë në Evropë. Në Evropë hyjmë vetëm kur të hiqen doganat. Po, ne krejt buxhetin e sigurojmë prej doganave. Atëherë, çka bëjmë. Çnduki mërgimtarët e shkretë me këtë Kartonin e Gjelbër, futi edhe në rëntgenin e doganës.

Po ua marr një shembull konkret, për ta ditur deri ku shkon absurditeti i doganës ndaj mërgimtarëve tanë. Besoj, e dini shumica e deputetëve që ti mundesh në Londër, ose në Stokholm, ose kudo qoftë, ta sigurosh vlerën e valixhes tënde 1 0000 dollarë. Dhe, çka u bëjnë këtu kur vijnë, doganierët tanë? A, thotë, e ke siguruar ti 10 000 dollarë çantën, duhet të paguash tatim për këto 10 000 dollarë. Dhe, po e marr një shembull konkret që ia kanë bërë një artistes, po them me emër e mbiemër, rrafsh një muaj ditë e kanë sorollatë nëpër dogana, këngëtaresh Dafina Zeqiri për këtë punë. E ka siguruar ajo çantën atje në Australi, kur ka ardhur, në rast se të humb valixhja ti duhet të kesh një sigurim. Dhe, kur ka ardhur këtu, i kanë thënë jo, ti e ke vlerë 10000 dollarë, duhet të paguash tatim. Këtë kanë nevojë mërgimtarët tonë që t'ua heq shteti i Kosovës.

Dhe fare në fund, i bëj thirrje ministrit tonë Pal Lekaj, meqenëse është këtu, mërgimtarët tanë kanë shumë nevojë, i dashur ministër, për sinjalistikë. Në çdo vend të botës, ku hapet një grupë e

të bie makina, e dëmton gomën e s'ka sinjalistikë, shteti duhet t'ia paguaj dëmet e makinës. E jo, të vijnë mërgimtarët tonë të shkretë, që s'dinë kah të orientohen dhe të bëjnë aksidente.

Këto dy çështje i ngrita ministër, meqenëse je këtu. Sa i përket Kartonit të Gjelbër kemi me e ringritë këtë çështje vitin e ardhshëm, kur do të jemi në prag të zgjedhjeve të lira, se në vjeshtën e ardhshme do t'i kemi zgjedhjet. Kështu që, prapë dalim e bëjmë fushatë kështu, ndoshta na votojnë ata mërgimtarë, edhe po na bien para. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Islam Pacolli e ka fjalën.

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, kryesues!

Po më vjen mirë që po vjen edhe një herë kohë pas kohe me u trajtua edhe çështja e Kartonit të Gjelbër.

Me të vërtet, unë e di më së miri qysh është, se vazhdimisht e paguaj këtë taksë të dyfishtë edhe pse e kam Kartonin e Gjelbër të Bashkimit Evropian, prapë më duhet ta paguaj për të hyrë në Kosovë. Kjo është shumë e padrejtë. Absolutisht është e padrejtë, për arsye se edhe kur është një taksë e caktuar ata janë të përkohshëm këtu dhe sot do të ishte mirë nëse s'ka mundësi fare me u tërheq, ishte dashur që të jenë shumë simbolike. Por, unë mendoj ndryshe. Të gjithë ata njerëz që punojnë e merren me këtë çështje dhe gjithë ai buxhet që mblidhet, ku përfundon dhe kujt i shërben? Do të thotë, është edhe kjo që lë për të dëshiruar.

Diaspora vazhdimisht ka kontribuar për republikën e Kosovës, për qytetarin e Kosovës, qoftë në Kosovë, qoftë jashtë vendit, por asnjëherë nuk është shpërblyer. Deri kur kishte për të qenë kjo çështje kështu të mos trajtohet Diaspora që ka një kontribut jashtëzakonisht të madh. Nuk e di çfarë zgjidhje teknike apo juridike mund të zgjidhet, por unë kisha bërë thirrje që kjo një herë e përgjithmonë të merret seriozisht dhe të shteren të gjitha mundësitë, që të zgjidhet kjo çështje. Përpos dikush që vjen nga Diaspora, kur të vijë nga Diaspora kur të vijë në kufi ka për të humbur ende kohë për me pagua do të thotë atë taksë.

Tani është edhe një pjesë elektronike, që jep dhe një mundësi pak më shumë, po megjithatë unë e di dhe ka raste që edhe kur kanë pasur ndonjë ndeshje a diçka është vështirë me iu përgjigj. Ata nuk janë fajtorë pse janë të Kosovës, por ne jemi fajtorë që nuk i zgjidhim ligjet këtu dhe t'ua mundësojmë të vijnë me dëshirë dhe të mos bëjnë taksa të dyfishta, se fundi i fundit ne ua marrim atyre dhe i çojmë diku tjetër. S'e di a hyjnë në shërbim definitivisht, në shërbim të vendit gjithë ajo taksë që mblidhet. Unë nuk i di detajet, pasi që nuk merrem me financa shtetërore, por në bazë të rrethanave dihet që asnjë rrugë as një diçka nuk është ndërtuar prej atyre taksave. Prandaj, është mirë, ose është mirë që ato taksa që mblidhen t'i shkojnë ministrisë direkt, Ministrisë së Financave, meqë duhet të përgjigjemi a jemi shtet a çka jemi na? Është mirë kjo të

merret parasysh dhe të trajtohet njëherë e përgjithmonë, se është e dhembshme dikush me vite e krejt jetën e vet ka kontribuar për vendin e vet dhe në fund vjen i zhgënjyer në kufi.

Pse duhet me qenë ashtu? Qoftë në një shtet tjetër, s'po di me e gjet zgjidhjen, alternativën, po aty është mos vet. Mos harroni, një po ua tregoj, që ka sigurime të Bashkimit Evropian, që mbulojnë edhe Kosovën. Kështu që, ai mërgimtar që vjen këtu e paguan të dyfishtën është e padrejtë. Prandaj, është mirë që të shqyrtohet dhe të hiqet përfundimisht. Send nuk jemi kah fitojmë. Qytetari i Kosovës nuk ia ka pa hairin kurrgjë asaj takse. Më shumë ka shkuar diku si në "zorrë qorre". Prandaj, është mirë që të merret një herë vendimi përfundimisht dhe të zgjidhet kjo çështje. Ka qenë kërkesë edhe më herët që të reduktohen ende më shumë. Nuk është aprovuar. Nuk i di arsyet pse. Sigurisht, ata që janë kompetentë duhet me u marrë, po ne si deputetë fuqishëm e kundërshtojmë taksën e qytetarëve, bashkatdhetarëve tanë që vijnë nga Diaspora në Kosovë.

Ne kërkojmë që këto definitivisht të hiqen këto taksa dhe ata të vijnë lirshëm, të ndjehen komodë në vendin e tyre dhe investimet dhe të gjitha ato të mira që sjellin, të vijnë të lumtur e të mos vijnë të zhgënjyer. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Tema e Kartonit të Gjelbër është një temë që pothuajse çdo vit ka pasur rëndësinë e vet të trajtimit nga deputetët. Edhe iniciuesi i këtij diskutimit sot ka për qëllim të mirë për ta zgjidhur këtë problematikë, por është një problem që tejkalon vullnetin dhe dëshirën tonë, sepse janë rregullat ndërkombëtare ato që përcaktojnë këtë në mënyrë të funksionimit. Jo me dëshirën tonë, asnjëherë si shtet nuk do të donim t'i vendosnim taksa në hyrje asnjë qytetari tonë në Diasporë, porse më e dëmshme do të ishte sikur ata të lëviznin pa sigurim në Republikën e Kosovës. Në cilindo aksident që do ta shkaktonin, atëherë dëmtimi për ta do të ishte, në aspektin material dhe njerëzor, shumë më i madh se sa mënyrën aktuale të funksionimit, në të cilën po ashtu kemi vërejtje se si ajo po funksionon.

Por, do të ishte edhe më e dëmshme nëse ata nuk i mbulon, që është më se e vërtetë, sepse Kartoni i Gjelbër çdonjëri që e merr në shtetet e Bashkimit Evropian, prapa saj e ka një klauzolë ku shkruan, sepse nuk vlen për Republikën e Kosovës. Pra, ata janë të pambuluar pastaj me sigurim të automjetit në Republikën e Kosovës dhe sigurisht që dëmtimi që do t'u shkaktohej pastaj në Kosovë në rast të aksidenteve, do të duhej t'i bartnin personalisht.

Çfarë duhet të bëjmë sot? Derisa nuk jemi pjesë e Kartonit të Gjelbër, atëherë sigurisht se duhet të ndërmarrim disa masa për të evituar në veçanti pritjet. Qytetarët tanë që jetojnë në Diasporë sigurisht që ndoshta do na e falnin edhe atë pagesën prej 15, 20 apo 30 euro që ua marrim në kufi, mos t'i lenim të presin. Më e lodhshme, më e mundimshme, pas mijëra kilometrash që bëjnë për të ardhur në vendin e tyre, për të pritur në radhë të gjata në hyrje të kufirit të Kosovës.

Pra, mendoj që pasi që është bërë një grumbullim i fondit në kuadër të Agjencisë së Sigurimeve Shëndetësore të Republikës së Kosovës, atëherë është mirë që mos t'i lëmë të presin, por mundësinë që ata ta paguajnë këtë sigurim ta kenë brenda 48 orëve kur të mbërrijnë në Kosovë, për ditët që do t'i kalojnë brenda, që të evitohen ato radhët e gjata të pritjes, sepse në fakt kur ata po vijnë në Republikën e Kosovës edhe po duhet të presin që në dyer të kufirit t'i japin ato 15, 20 apo 30 euro për sigurim, sigurisht se është e pakëndshme dhe jo e mirë, sepse ende pa hyrë në vendin e tyre po detyrohen në njëfarë forme të presin për çështje tjera.

Mendoj se këtë duhet me e rregullua edhe duhet shikuar tash edhe këtë aspektin tjetër. Nëse duhet të kemi ne informata të sakta se sa është grumbulluar, sa është vlera e fondit? Nëse ka mjete të mjaftueshme atje, do të thotë ne edhe mund ta zvogëlojmë këtë pagesë për ditët që ata qëndrojnë në Republikën e Kosovës, që të mos i lëmë pa sigurim të mbuluar, do të thotë të jenë të mbuluar në aspektin e sigurimit, por edhe të shikojmë nëse ka mjete të mjaftueshme, atëherë nuk ka nevojë që kjo shumë të jetë e lartë, por të jetë sa për të mbuluar pjesët që do të duhej, në aspektin e sigurimit.

Për ta rritur sigurinë në komunikacion unë nuk mendoj me disa parafolës këtu që ne duhet të zvogëlojmë dhe të ulim kriteret për regjistrimin e automjeteve. Nëse në Republikën e Kosovës janë 65 000 automjete të paregjistruara, ne duhet të shkojmë të zvogëlojmë numrin e automjeteve të paregjistruara duke i rritur masat dhe kriteret për ato automjete që qarkullojnë në trafik të paregjistruara. Pra, ne nuk mendojmë se duhet, ose është e pa akceptueshme nëse mendojmë me i heq ndëshkimet ne do ta rrisim sigurinë në komunikacion. Nëse ne i zvogëlojmë ose i heqim kriteret e ndëshkimeve në regjistrim të mjeteve, ne do të krijojmë edhe më shumë pasiguri në komunikacion, jo vetëm nga automjetet e pasiguruara, po nga ata vozitës, të cilët janë të papërgjegjshëm, sepse kur e dinë që gjykatat nuk po funksionojnë ose e gjejnë dikë që vendimet e ndëshkimeve ua mbulojnë në gjykatë, e ka ndoshta ndonjë vozitës, i cili ka dhjetë a pesëmbëdhjetë ndëshkime, të cilat nuk i ka paguar kurrë, atëherë sigurisht edhe papërgjegjësia e tij në komunikacion do të rritet dhe nuk mendoj që ne duhet të shkojmë me këto kritere të zvogëlimit të tyre në regjistrim të automjeteve, por duhet të shkojmë nga ajo që të rritet përgjegjshmëria, e në veçanti kur një gjobë e policit të jetë valide, atë duhet ta kuptojë çdo ngasës që duhet paguar, sepse në momentin që e di që duhet paguar, edhe sjellja e tij pastaj në komunikacion do të jetë më e përgjegjshme.

Po nëse ne u themi se nuk ka problem, pas 15-20 vjetësh do t'u vijë rendi ta paguajnë një gjobë të komunikacionit, atëherë sigurisht edhe papërgjegjësia e tij në komunikacion do të rritet, do të jetë më e madhe.

Unë kërkoj që të nxjerrim rekomandime, të cilat do të jenë në shërbim të asaj që qytetarët tanë, të cilët vijnë ta vizitojnë vendin tonë, të kenë mundësi qasjeje më të lehta, fillimisht në hyrje të tyre në kufij dhe pastaj edhe policën e sigurimit ta bëjmë edhe më të lirë, por edhe më të qasshme që ajo të mos jetë në aspekte procedurale e ngarkuar, sepse është absurde nëse hyn nga Shqipëria dhe sheh radhë të gjata të automjeteve me targa të shteteve të Bashkimit Evropian, të cilat ndahen në dy apo tri kolona në pritje, është nonsens nëse e lejojmë, të paktën në aspektin procedural mund të bëjmë diçka të mirë për ta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ismajl Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryesues!

Nga të gjithë folësit e gjertanishëm u pa se të gjithë janë kundër taksës, përfshirë këtu edhe partitë që janë në pozitë.

Kundër taksës kemi qenë edhe vitin e kaluar, edhe para dy vjetësh, edhe para pesë a dhjetë vjetësh, po asnjëherë nuk e kemi hequr taksën.

Po shihet se nuk ka pengesa edhe nga faktorët e jashtëm, nuk lidhet kjo as me të qenit anëtare e Kombeve të Bashkuara dhe kështu me radhë, tregime që janë përsëritur me vite të tëra.

Mundësitë ose variantet për zgjidhjen e këtij problemi u thanë edhe sot këtu nga disa deputetë, po këtu po shihet se ndikim i përfituesve me të padrejtë nga kjo taksë që po i dënon qytetarët tanë, është më i madh në këtë Kuvend ose një pjesë e disa deputetëve, se sa vullneti i atyre deputetëve që vërtet kanë vullnet që ta heqin këtë taksë.

Kjo taksë do të hiqet kur shumica e deputetëve të këtij Kuvendi sinqerisht e kanë vullnetin që ta heqin dhe jo vetëm deklarativisht, e që nuk po bëjmë asgjë.

Natyrisht që këtu duhet një vullnet i sinqertë i Qeverisë, në mënyrë që t'i lehtësojmë qytetarët tanë që po kontribuojnë shumë, pra mërgimtarët, në vend se të vajtojmë për ta. Vërtet kjo çka po dëgjohet është hipokrizi dhe dyfytirësi, thua që kjo është në dorën e dikujt që ne s'mund të arrijmë kurrsesi, e në të vërtetë kjo varet nga vullneti politik që ne e përfaqësojmë në këtë Kuvend.

Prandaj, lus që ky vullnet politik të konsolidohet dhe që t'i lejojmë njerëzit të vijnë në shtëpitë e tyre ashtu siç duhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Pajtohem plotësisht me kolegun Kurteshi tash së fundi, sepse nuk është hera e parë që po debatohet diçka e tillë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, qoftë si kërkesë, qoftë si paraqitje problematike dhe duket që, tash pa dashur të hyj në aspektin më shumë profesional, më duket se dikush është më i fuqishëm se sa vullneti i Kuvendit dhe kërkesat e qytetarëve tanë që të mos ndëshkohen nga kjo policë sigurimi.

Nëse edhe e lexojmë kërkesën e parashtruesit, është theksuar qartë që ka qenë afër të arrihet kjo marrëveshje, që të eliminohet apo edhe të pranohet Kartoni i Gjellbër dhe këtu shkruan decidivisht që është refuzuar për shkak të ndikimit që kanë kompanitë e sigurimit në Kosovë.

Dhe, ajo që është e njohur, dihet edhe kush qëndron prapa shumicës së këtyre kompanive të sigurimit.

Sigurisht njerëz të lidhur me politikën, qoftë në mënyrë direkt biznesore, qoftë edhe në atë joformale indirekte.

Andaj, Kuvendi duhet ta marrë seriozisht, duhet të provojë me mekanizmat e tij që të eliminojë këtë defekt dhe qytetarë tanë, sidomos ata që jetojnë jashtë vendit të mos ndëshkohen, sepse po duket si një lloj plaçke e tepruar, e stërngarkuar dhe e padrejtë në raport me hyrjet, të cilat i shfrytëzojnë edhe në kohën e pushimeve, sidomos ata që vijnë më së shumti me makina.

Andaj, në këtë formën se si po flasim, edhe me këto rekomandime që tentohen të dalin, besoj që do të përsëritet e njëjta këngë, ta quaj kështu, një zë i shterur i Kuvendit, një vullnet i deputetëve, e në tërësi pa ndonjë efekt në praktikë.

Asnjë rezultat deri më tani nga viti në vit nuk është rreth kësaj çështje, nuk e di, shumica e deputetëve, prej se mbaj mend unë, po besoj njerëz me emra e mbiemra i kanë ngritur këto çështje, e dikush jo vetëm në mënyrën e vet, por me të drejtë, me një shqetësim të drejtë, edhe duke i artikuluar edhe më mirë se sa unë që po e paraqes këtë problem, qoftë edhe grupi politik, i cili e ka risponzorizuar apo riaktivizuar temën e Kartonit të Gjellbër.

Nëse më kishe lejuar, zoti kryesues, nja tre minuta jashtë kësaj teme. M'u kanë drejtuar shumë qytetarë të pjesës së Vushtrrisë dhe kanë paraqitur një problem që është më tepër se sa shqetësues, është ndërprerja e ujit për ujitje, i cili ka prekur shumë zona, shumë fermerë, shumë toka bujqësore nga uji i cili rrjedh nga Gazivoda, domethënë nga Leposaviqi, që shfrytëzohet jo vetëm për komunën e Mitrovicës, po edhe të Vushtrrisë, deri te pjesa që ndërlidhet me Prishtinën.

Vetëm këto ditë kur është ndërprerë nga një person, i cili duhet që e ka çelësin aty, i pjesëtarit të komunitetit serb dhe arsyeja e tij është që ka shkuar në Beograd për interesat e tij personale, por me këtë teke i ka dëmtuar mijëra hektarë, të cilët janë të rrezikuar, si ata që kanë mbjellë misër, edhe ata që kanë mbjellë patate.

Zonat më të atakuara janë Dobërlluka, Postova, Nadakovci, Stanovci e Druari, Mihaliqi, Pantina e shumë zona të tjera, si edhe pjesa tjetër që kanë të mbjella perime, serra, etj.

Kështu që unë mendova ta shfrytëzoj rastin, sikur e pashë këtu ministren e Ambientit, e cila ndoshta mund të interferonte në Qeveri, por po i drejtohem të vetmit ministër këtu, zotit Pal Lekaj, që së paku ta ngre këtë çështje në nivel të Qeverisë, kuptohet edhe në mungesë të ministrit të Bujqësisë, të cilin asnjëherë nuk e kemi këtu të pranishëm, kuptohet cilat janë arsyet dhe Qeveria urgjentisht të ndërmarrë masa e të mos lejojë këtë person apo atë menaxhment që ta ndërpresë ujin, sepse dëmet që do t'u krijohen këtyre bujqve dhe fermerëve do të jenë të mëdha dhe nuk e di a do të kenë kapacitet institucionet tona që t'ua mbulojnë apo t'i kompensojnë.

Kështu që e pashë të arsyeshme që me këtë rast, kërkoj falje që e ndërrova temën, por duke marrë për bazë që ishte një shqetësim, i cili për shkak të konotacionit edhe politik, edhe të papërgjegjësisë të këtij individi që është i komunitetit serb, dhe duket që aty e ka çelësin kur do e lëshon ujin dhe kur do nuk e lëshon, kjo ka shkakuar dëme të mëdha, dhe nëse vazhdon kështu, bujqit dhe fermerët tanë do të dëmtohen skajshmërisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Zemaj! Fjalën e ka zonja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Të nderur kolegë deputetë,

Meqenëse jam anëtare e Komisionit për Buxhet, e pashë të arsyeshme t'i them edhe unë pak fjalë në lidhje me Kartonin e Gjellbër, një temë e cila po diskutohet sot.

Dhe, për fatin e keq debati për Kartonin e Gjellbër është debat sezonal, zakonisht në qershor e debatojmë dhe pas qershorit nuk merret kush me këtë çështje.

Ne duhet ta gjejmë mënyrën, të mos e heshtim këtë problem derisa ta gjejmë zgjidhjen, derisa përfundimisht ta zgjidhim problemin e Kartonit të Gjellbër.

Në Komisionin për Buxhet dhe Financa jemi marrë me çështjen e Kartonit të Gjellbër, jo vetëm në këtë muaj, por edhe më përpara, jemi angazhuar meqenëse e tërë rregullativa ligjore që ka të bëjë me Kartonin e Gjellbër bie në punën e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Ne kemi formuar një grup punues në kuadër të komisionit për t'u marrë me zgjidhjen e këtij problemi dhe jo vetëm për të bërë debat dhe për të bërë zhurmë në Parlamentin e Kosovës, sa për t'i thënë diasporës që ne po merremi me problemin me të cilin ju po ballafaqoheni.

Bashkëvendësit tanë, të cilët jetojnë jashtë Kosovës, tani e 20 vjet pas lufte dhe një dekade shtet ende vazhdojnë të paguajnë në momentin kur hyjnë në vendin e tyre dhe kjo është një ndjenjë e keqe, është një gjë që duhet t'i vijë fundi dhe të mos paguajnë një gjë, të cilën nuk duhet ta paguajnë, por të bëjmë zgjidhe ne këtu.

Grupi punues, i cili është formuar në kuadër të Komisionit për Buxhet, i ka takuar të gjithë personat kompetentë apo institucionet kompetente, të cilat duhet të merren më seriozisht dhe të zgjidhin problemin e Kartonit të Gjellbër.

Ne kemi debatuar edhe me Byronë e Sigurimeve, kemi debatuar edhe me ministrin e Financave, Bakën Qendrore që mbikëqyr Byronë e Sigurimeve, por njëkohësisht edhe Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Nga takimi të cilin e kemi pasur në Komisionin për Buxhet dhe Financa kanë dalë se janë dy faktorë, të cilët e pengojnë Kartonin e Gjellbër në Kosovë, janë edhe faktorët e brendshëm, por është edhe faktori i jashtëm.

Ne, më kujtohet shumë mirë, në vitin 2011, pikërisht në muajin qershor kemi kërkuar që të miratojmë me procedurë të shpejtuar Ligjin për sigurime të detyrueshëm nga autopërgjegjësia, sepse na është thënë atëherë që duhet ta miratojmë me shpejtësi, në mënyrë që të mos na ikë mbledhja, e cila do të mbahej dhe ne të aplikojmë për të qenë pjesë e Kartonit të Gjellbër.

Dhe, për fat të keq, ligji është miratuar, i ka plotësuar edhe standardet ndërkombëtare, ka qenë i harmonizuar edhe me legjislacionin e Bashkimit Evropian, por që nuk u bëmë pjesë e Kartonit të Gjellbër.

Mua më befason ministri i Punëve të Brendshme, i cili nuk qëndron këtu kur debatohet për këtë çështje, për arsye se një nga problemet e brendshme që duhet zgjidhur i takon pikërisht ministrit të Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Sot ministri, i cili ishte këtu dhe nuk është tani, është dashur të raportojë çka ka bërë ai si ministër, ata 5-6 zëvendësministra, të cilët janë në kudër të kësaj ministrie dhe çka ka bërë stafi i kësaj ministrie që nga dita e 16 majit, kur ne kemi debatuar dhe e kemi ngarkuar me punë Ministrinë e Punëve të Brendshme për të zgjidhur problemin e makinave të paregjistruara, sepse edhe po t'i kishim mundësitë nesër të jemi pjesë e Kartonit të Gjellbër, ne nuk do të na jepnin këtë mundësi pikërisht për shkak të problemeve të cilat nuk i kemi zgjidhur brenda vendit.

Prandaj, ministri është dashur të qëndrojë këtu dhe duhet të raportojë kohë pas kohe në Komisionin për Buxhet, por edhe në Kuvend se çka ka bërë në këtë drejtim për ta zgjidhur këtë problem.

Në këtë takim po ashtu kanë qenë problematikë faktorët e jashtëm, si u diskutuan këtu më përpara, unë nuk dua t'i përsëris prapë, të cilët ishin SFIFT kodi, mandej mosbërja e shtetit tonë anëtar të Organizatës së Kombeve të Bashkuara e probleme të tjera, megjithatë ka zgjidhje alternative, për të cilën jemi të angazhuar si grup punues në kuadër të Komisionit për Buxhet dhe si komision që derisa të krijohen mundësitë për të qenë pjesë e Kartonit të Gjelbër, ne të gjejmë zgjidhjen alternative dhe po besoj se do ta gjejmë nëse ne nuk e ndërprejmë punën me këtë debat, por vazhdojmë tutje.

Unë nuk jam të nxjerrim rezoluta për gjithçka. Për një punë, e cila ka filluar në Komision dhe është i formuar grupi punues, nuk di çfarë nevojë kemi që të nxjerrim prapë rezoluta.

Unë kam një shqetësim në lidhje me këto rezoluta, të cilat po miratohen në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe mendoj se duhet t'i vijë fundi një forme të tillë të miratimit të rezolutave, kur ne deputetët nuk jemi të njoftuar as në formën elektronike të daljes në Kuvendin e Kosovës të një rezolute, as me kopje fizike. Del një deputet dhe i lexon 2-3 fjali aty, hajde tash ta miratojmë rezolutën. Unë ju them, po qe se nuk e kam në formën elektronike dhe po qe se nuk e kam kopjen fizike të vërtetuar nga Kuvendi, nga administrata e Kuvendit, që është protokolluar në rezolutë e tij në Kuvend, unë nuk do ta votoj, edhe nëse gypi im parlamentar inicion një rezolutë të tillë.

Nëse rezoluta vjen në Kuvend, harmonizohet, le të shkojë tek administrata, të protokollohet dhe të na vijë të gjithë deputetëve e të dimë çka po votojmë, përndryshe ne po votojmë gjëra përmendsh dhe unë nuk jam të votohen gjëra përmendsh në Kuvendin e Republikës së Kosovës, t'i japim fund kësaj.

Unë nuk jam që të bëhet ndonjë rezolutë sot, jam që në fund të këtij debati t'i miratojmë disa rekomandime që komisioni dhe grupi punues në kuadër të Komisionit për Buxhet të vazhdojë punën intensivisht deri në zgjidhjen alternative të problemit të Kartoni të Gjelbër. Deri të bëhet zgjidhja alternative për Kartonin e Gjelbër të shikohet mundësia e uljes së primit të sigurimit për bashkatdhetarët tanë, të cilët që nga ky muaj fillojnë të hyjnë të në Kosovë dhe të vazhdojmë me punë deri në zgjidhjen përfundimtare të kësaj problematike e të mos bëjmë thjesht një debat, ta shuajmë këtë problem e të mos vazhdojmë tutje.

Unë jam për zgjidhje dhe për zgjidhje jam e gatshme të punoj derisa ta gjejmë zgjidhjen përfundimtare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Daut Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Po mundohem të mos i përsërit fjalët, edhe pse unë e mora rekomandimin e Faton Topallit me propozimet, në shumicën prej pikave pajtohem, një pjesë e mirë e tyre janë shqetësime të të gjithë deputetëve.

Ka pika, të cilat mendoj se janë krejt të panevojshme, për shembull, të kryesohet komisioni nga iniciuesi i seancës, që të bëhet një komision i ri, përderisa ne e kemi një komision, i cili po e trajton këtë temë.

U fol që duhet marrë një shtet të dytë ose të tretë, i cili do ta pranonte Kosovën si anëtare e Kartonit të Gjellbër, nuk kemi nevojë ta mashtrojmë askënd, përderisa i kemi 61 mijë deri 63 automjete pa regjistruar, kjo punë vështirë bëhet.

Nëse flasim për të hyrat, e dëgjova kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, tha i kemi për 15 vjet, 131 milionë, ndërsa dalje ose investim, kthim mbrapa tek automjetet e dëmtuara, ose cila do formë që është, është vetëm 11 milionë, gjë që është shumë shqetësuese, po i bie rreth 120 milionë nuk dihet ku janë.

Pajtohem me pikën e fundit, kur thotë që ndahet një buxhet për vitin e ardhshëm, për shembull, prej 5 milionëve, po ashtu pajtohem me Islam Pacollin që tha pyetja është ku po shkojnë këto mjete, se është shumë interesant, kishte qenë mirë ta dimë ku po shkojnë këto mjete?

Por, a mendoni ju që vetëm qytetarët e diasporës trajtohen jo mirë në hyrje-dalje të Republikës së Kosovës. Jo. Ju e dini që qytetarët e Kosovës trajtohen keq duke ardhur prej diasporës në hyrje me Malin e Zi, edhe në hyrje me Kosovën, vonesa të panumërta, ka një tendencë për të bërë një sistem elektronik të aplikimit për Kartonin e Gjellbër.

Por ne e patëm edhe një tendencë për romingun me Shqipërinë për t'u hequr, Kosovë-Shqipëri.

Ne e kemi pasur edhe një kontroll, si është quajtur, bashkimi i pikave, zoti ministër, meqenëse je këtu, është mirë ta ngresh këtë shqetësim. Para një jave kam qenë në Shkup, kolona në hyrje të Kosovës ka qenë mbi 5 kilometra, absolutisht është e panevojshme dhe ju e dini mirë që po që se ka interesim, për shumë pak minuta kjo zgjidhet.

Ministri i Punëve të Brendshme e di që ka punë shumë, se është duke i selektuar kush do të përzgjidhet polic i ardhshëm, por do të ishte mirë të vinte e të dëgjonte këtu, sepse ka shumë vërejtje edhe në këtë aspekt, se kështu qysh po i zgjedhim policët e papërgjegjshëm, po na kushtojnë më vonë, siç u cek më herët, kontrolli i një çante ku është doganuar.

Nuk është mirë të sulmohen doganierët, nuk është mirë të sulmohen policët, se në fund të ditës ata veç e zbatojnë ligjin, por ekzekutivi e ka për detyrë t'i mbikëqyrë zbatuesit e ligjit, të shohë a janë duke u sjellë mirë a s'janë, a janë konform rregullave dhe procedurave ligjore në hyrje-dalje të Republikës së Kosovës, për shkak se me një individ nuk mund t'i quajmë krejt policët ose krejt doganierët të papërgjegjshëm.

Kështu që ka shumë gjëra që kishim mundur t'i bënim, për shembull, nuk pajtohemi se për shkak të sinjalizimit një veturë po dëmtohet në gropë, e Qeveria duhet paguar, se ju e dini që ajo është sistem i rregulluar, paguaje kasko, kasko e mbulon.

Patëm edhe shumë tema, të cilat unë kisha pasur dëshirë t'i diskutojmë sot, por po duket që më shumë po tingëllon si një debat elektoral para ardhjes së diasporës.

Mirë kishte qenë të thirrej edhe ministri i Diasporës të na informonte ai se çka ka bërë me këtë digjitalizimin e aplikimit për Kartonin e Gjelbër.

Ndërsa sa i përket anëtarësimit në Byronë e Sigurimeve, ju e dini që është vendim politik, ju e dini që Kosova nuk është anëtarësuar as në Interpol, as në Byronë e Sigurimeve, as në Kombet e Bashkuara, por është në rrugë e sipër. Shpresoj që me një angazhim maksimal edhe të komisionit, edhe të Ekzekutivit, edhe të BQK-së, edhe të Byrosë së Sigurimeve që edhe në Bruksel të rrisim pak presionin që sa më shpejt të japin një epilog për të mirën e qytetarëve tanë, të cilët jetojnë jashtë Kosovës që edhe ne të jemi të barabartë si shtetet e tjera.

U tha më herët se Shqipëria nuk mundet, është shumë e vërtetë që Shqipëria i tejkalon rreth 37% të automjeteve që nuk janë të regjistruara.

Ndërsa për automjetet që nuk janë të regjistruara në Kosovë, zoti kryesues, është shumë e lehtë, të gjitha automjetet janë në data-bazën e serverit qendror të Policisë së Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme i ka të gjitha të dhënat me emër, mbiemër, ku u regjistrua, kur i ka dalë afati, është një problem krejtësisht teknik, që po që se ka vullnet, brenda 5 ditësh kjo histori përfundon, tjetër është që nuk janë të interesuar, por nëse donë, mund ta bëjnë.

E kemi Fatmir Xhelilin këtu, ka qenë ministër, e kemi edhe Zenunin atje, që foli më herët. Po të ishim të interesuar, të gjitha automjetet që janë në Kosovë, nëse kanë hyrë në sistemin doganor dhe janë regjistruar një herë, ato kanë emër e mbiemër, dihen dhe s'kemi ne çka të bisedojmë gjatë, vetëm se duket që nuk ka qenë askush i interesuar të merret me këtë temë.

E di që kjo është shqetësuese, sidomos për pjesët malore, sepse ata i përdorin automjetet, sidomos sezonin e dimrit, por ju e dini që kemi pasur rast të vdekjeve të shumta. Zoti ministër,

për shembull, në bjeshkët e Dukagjinit ka pasur rast kur një familje nga diaspora ka ardhur prej Zvicrës, automjetin e kishte regjistruar pra 10 vjetësh dhe katër anëtarë të familjes kanë vdekur.

Kështu që është mirë ta trajtojmë këtë temë më seriozisht, komisioni le ta bëjë punën e vet, le t'i harmonizojnë qëndrimet ose rekomandimet dhe ne do të jemi të gatshëm t'i përkrahim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Para se t'ia jap fjalën përfundimtare zotit Topalli, unë desha të ndërlihem në diskutim.

Dihet që çdo vend që fillon të hyjë në rrugën e sigurisë së vet, fillojnë të hyjnë bankat dhe sigurimet, por paraprakisht hyjnë në sigurime shoqërore.

Ne kemi një situata jo shumë të këndshme dhe shumë të mirë të rregulluar, për shkak se sigurimet në përgjithësi nuk kanë mbikëqyrje, nuk kanë mbikëqyrje parlamentare dhe unë nuk e di pse, pse po flasim ne, përderisa nuk kemi një agjenci, e cila i mbikëqyr sigurimet shoqërore në Kosovë dhe do të na raportonte për gjendjen, për situatën dhe do të ngarkohej me detyrë nga ne.

Ne kemi një byro, është e vërtetë, por unë për vete nuk e di se kujt i jep llogari ajo, Byroja për Siguri.

Prandaj, mendoj që për ta evituar së pari evazionin fiskal, së dyti, patriotizmin me elektoratin, respektivisht diasporën, janë disa çështje të cilat duhet t'i rregullojmë, përfshirë këtu edhe lojërat e fatit që shteti duhet t'i kontrollojë dhe jo të jenë pa mbikëqyrje të shtetit.

Mendoj që sigurimet në përgjithësi në Kosovë janë të vetërregulluara dhe kjo nuk e besoj ose këtë mënyrë të funksionimit të sigurimeve nuk e besoj që e ka ndonjë vend as në Evropë, por as diku më larg se Evropa. Faleminderit!

Zoti Topalli, e keni fjalën përfundimtare.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Ju falënderoj të gjithëve për një angazhim bukur konstruktiv sa i përket çështjes së Kartonit të Gjelbër. Unë jam pak i befasuar me atë që çështja e Kartonit të Gjelbër është çështje e sezonit, dhe për këtë dua të jua ofroj disa argumente. Unë dua të falënderoj para së gjithash Lëvizjen Vetëvendosje që gjatë kohës që kam qenë atje ma ka ofruar hapësirën e nevojshme që ta shtroj këtë çështje, kam vazhduar ta shtroj prapë edhe tani.

Unë e kam shtruar çështjen e Kartonit të Gjelbër për herë të parë në vitin 2013, pastaj në Kuvendin e Kosovës më 5 maj 2014, pastaj më 21 maj 2015, më 9 qershor 2016, më 30 nëntor

2017, më 14 dhjetor 2017 dhe më 7 maj, në kuptimin e debatit të cilin po e shtrojmë sot. Pra, deri më tani ka pasur deklarime për Kartonin e Gjellbër edhe të tjerëve, por mendoj që pak ka pasur prej deputetëve që kanë qëndruar afër kësaj çështjeje dhe ky, po ju përkujtoj, që është debati i parë në Kuvendin e Kosovës prej përfundimit të luftës e deri më tani, që është zhvilluar. Pra, nuk është çështje elektorale, është debati i parë. Ne kemi mundur, e kemi trajtuar si çështje kështu gjatë mbledhjeve nëpër seanca të ndryshme, por si debat është i pari.

Para se të zhvillohej ky debat, unë e kam kontaktuar guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës, kam diskutuar për këtë çështje edhe me ministrin aktual të ekonomisë, e kam kontaktuar Byronë e Sigurimeve të Kosovës, edhe gazetarin Adriatik Kelmendi, i cili është marrë me këtë çështje, prandaj mendoj që jam i informuar bukur mirë. Arsyeja pse kam kërkuar ta drejtoj këtë komision mbiinstitucional është thjesht për faktin që e kam trajtuar gjatë këtë temë edhe kam dashur t'i qëndroj afër si temë. Pra, që të mos mbetet prapë në mëshirën dhe pamëshirën e fatit, dhe kjo çështje të mos diskutohet. Unë nuk ndiej më shumë për mërgimtarët se sa që ndieni ju dhe mendoj që e thatë kështu edhe gjatë këtij debati, por jam shumë i interesuar që ky debat të përfundojë me një zgjidhje konkrete, respektivisht me përcaktimin e aktorëve, me përcaktimin e përgjegjësive dhe me afatet kohore për të mos mbetur ky një debat i përjetshëm.

Arsyeja pse ne nuk e kemi Kartonin e Gjellbër është shumë e thjeshtë, s'ka pasur interes qeveritar deri në vitet 2010-2011, te në ato vite i kemi bërë ligjet e nevojshme dhe e kemi siguruar fondin. Pra s'ka pasu rinteres, kjo është e para. E dyta, Byroja e Sigurimeve, e cila ka mandatin për t'u marrë me Kartonin e Gjellbër, ka pasur konflikt interesi, kanë fituar miliona euro dhe kështu që nuk kanë qenë fare të interesuar që kjo çështje të zgjidhet. Shifrat që jua përmenda, nuk janë shifra të cilat po i them thjesht këtu, por i kam kërkuar nga BQK-ja dhe jo vetëm këtu, por i kam kërkuar edhe para 2-3 vjetëve, kështu që i kam në varësi. Prej vitit 2008 deri në vitin 2017 janë mbi 100 milionë euro, në dhjetët vjetët e fundit, që janë inkasuar, ndërsa shpenzimet janë diku 10%. I kam të sakta, por nuk po dua të ju lodh.

Pra, arsyeja pse s'e kemi është konflikt i interesit, sepse byrotë e sigurimeve nuk kanë pasur interes ta zgjidhin këtë çështje, nuk kanë as tani, sepse fitojnë prapë miliona euro. E treta është edhe kjo që e tha zoti Haliti, që nuk kemi asnjë mekanizëm kontrollues mbi Byronë e Sigurimeve. U përmend këtu ministri i Ekonomisë, Qeveria. As ministri i Ekonomisë as Qeveria nuk kanë kurrfarë mandati. As Banka Qendrore e Kosovës nuk ka mandat për ta kontrolluar, ka mandat tjetër për shembull për ta përcaktuar primin, nuk mund ta përcaktojë BQK-ja, por BQK-ja mund të kërkojë nga Byroja e Sigurimeve dhe Byroja e Sigurimeve e cakton primin prapë sipas dëshirës së vet. Pra, është pikërisht ky Kuvend, respektivisht të gjitha kuvendet prej luftës e këndeje, e sidomos atë që e kanë bërë ligjin, që i kanë lënë byrotë e sigurimeve pa asnjë kontroll, as qeveritar, as të Kuvendit. Pra, karshi zgjidhjes së problemit të Kartonit të Gjellbër duhet ta zgjedhim edhe çështjen e kontrollit mbi sigurimet.

Tjetra është që u përmend që Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave është marrë me këtë temë. Po, është marrë, veç dorën në zemër, është marrë pasi është iniciuar debati dhe në rregull është. Unë i thashë arsyet pse kam pasur dëshirë ta udhëheq këtë komision, por nuk kam asnjë problem që ta harmonizojmë këtë nen dhe komisioni përkatës t'i marrë edhe detyrat, edhe meritat për këtë çështje. Me rëndësi është që çështja e Kartonit të Gjellbër të zgjidhet për qytetarët e Kosovës dhe për mërgimtarët që jetojnë jashtë vendit. Në fund, i kisha lutur përfaqësuesit e partive politike në Kuvend që ta përcaktojnë nga një përfaqësues, mendoj që jemi afër sa i përket harmonizimit, e këtë e pashë edhe gjatë debatit për harmonizim, pra ju propozoj që menjëherë, posa të përfundojë debati, të ulemi shpejt dhe t'i harmonizojmë qëndrimet, të cilat po mendoj deri në masë të caktuar veç po dihen dhe mendoj që këtë punë do ta kryejmë shumë shpejt.

Ju kisha lut që t'i përcaktoni deputetët, të cilët do të marrin pjesë në takimin për harmonizimin e këtyre që i biseduam. Atëherë, kaq! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, merret vendin ku e caktoni, debati u krye. Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, a po doni që të shkoni në pauzë? Në pauzë! Atëherë, po shkojmë në pauzë deri në orën 14:30. Ju komisioni vazhdoni dhe ejani tani pak më vonë, s'ka problem. Këta le ta caktojnë, secili grup, unë s'mund t'i caktoj.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Atëherë, po vazhdojmë me pikat e rendit të ditës. Pika që u kapërcye herën e parë, është:

21. Debat parlamentar në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë për unifikimin e pikave doganore ndërmjet tyre sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri, mbështetur nga 11 deputetë

Deputeti Ymeri, i mbështetur edhe nga 11 deputetë, ka parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë për unifikimin e pikave doganore ndërmjet tyre. E ftoj zotin Ymeri që në emër të propozuesit ta paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar. Zoti Ymeri, e keni fjalën!

VISAR YMERI: Të nderuar deputetë!

I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës që po na përcillni,

Më 11 mars 2014, Presidenti i Republikës e ka dekretuar ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare për bashkëpunim në nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, e cila ishte nënshkruar në Prizren, më 11 janar 2014.

Marrëveshja e atillë u arrit në kuadër të një strategjie ku marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve do të shtrihen edhe në shumë fusha tjera të ekonomisë, tregtisë, energjisë, transportit, mjedisit, kulturës, shkencës, artit, arsimit, sportit, drejtësisë e tjera, si dhe të zbatimit të ligjit dhe bashkëpunimit të shoqërisë civile. Por, qëllimi kryesor për të cilën palët u dakorduan, pra unifikimi i doganave nuk u arrit asnjëherë. Për mendimin tonë, të dy vendet janë të vonuara për rezultatin që do të sillte unifikimi doganor, duke marrë parasysh numrin e lartë të bizneseve të dy vendeve dhe numrin e lartë të punonjësve të Kosovës në Shqipëri dhe anasjelltas.

Qeveria e Kosovës duhet të na tregojë se ku ka mbërritur procesi i unifikimit të pikave doganore ndërmjet dy shteteve. Qeveria duhet të raportojë se çka është bërë më shumë në lidhje me aspektin ligjor të këtyre marrëveshjeve dhe ku ka mbërritur zbatimi i marrëveshjeve të nënshkruara nga të dyja shtetet respektive. Qeveria po ashtu duhet të tregojë se deri në cilën kohë ka planifikuar që marrëveshjet e nënshkruara ta përbëjnë një bazë të plotë rregullimi për unifikimin doganor me Shqipërinë, meqenëse marrëveshjet e nënshkruara më herët më shumë shprehin vullnetin sesa detyrimin. Deri më tani, të dyja shtetet më shumë e kanë pasur një angazhim ad hoc sesa një politikë të qartë sistematike, institucionale dhe të saktë të arritjes së marrëveshjeve të duhura.

Konsiderojmë që të dyja republikat tona kanë potencial më të madh për të arritur deri te marrëveshjet e duhura e deri te ekzekutimi i tyre sesa arsyetimi në publik. Vetëm pak për të jua kujtuar, struktura e ekonomisë ndërmjet të dy republikave është pothuajse e ngjashme. Sipas statistikave zyrtare, bujqësia zë 10% të strukturës së bruto-prodhimit vendor në Kosovës dhe në Shqipëri mbi 23%. Sektori i industrisë zë më shumë se 10% të bruto-produktit vendor në Kosovë, ndërsa në Shqipëri 11%. Ndërkohë, që ai i tregtisë zë 12% në Kosovë dhe po kaq edhe në Republikën e Shqipërisë. Konsideroj se një bashkëpunim ekonomik ndërmjet dy vendeve, që është i nivelit të tretë ose të mesëm i integritimit ndërmjet dy a më shumë shteteve do të ishte i dobishëm jashtëzakonisht shumë për ekonominë tona, si dhe do ta krijonte një situatë të tërheqjes dhe të përmirësimit e zmadhimit të vëllimit tonë ekonomik e tregtar, veçanërisht në sektorët e prodhimit, duke pasur parasysh që një unifikim i mirëfilltë doganor do ta rriste tregun e fragmentuar tashmë që e kemi mbi 7 milionë konsumatorë dhe kështu të dyja ekonominë tona, e veçanërisht prodhuesit në këto dy ekonomi do të kishin edhe treg më të madh, por edhe mundësi,

që është jashtëzakonisht e rëndësishme në industri, që ta krijojnë ekonominë e shkallës dhe kështu edhe të fuqizohemi, por njëkohësisht edhe pavarësohemi ekonomikisht.

Aktualisht, dihet edhe botërisht, por veçanërisht në këto dy rastet tona, jo vetëm që do të fitonim e përfitonim ekonomikisht nga unifikimi doganor, por kjo do ta rriste në anën tjetër edhe qarkullimin e njerëzve e të punëtorëve ndërmjet dy vendeve tona dhe sidomos do ta rriste konkurrueshmërinë dhe konkurrencën e produkteve në një treg më të madh, gjë që do t'i bënte pastaj këto produkte edhe shumë më konkurruese në rajon, e edhe në tregun e Bashkimit Evropian, ku edhe Shqipëria, edhe Kosova gradualisht janë duke hyrë si partnerë të barabartë.

Mendoj që po të ndodhte unioni doganor, ose po të unifikoheshin të dyja tregjet, atëherë përpos tregtisë të lirë do t'i unifikonim edhe detyrimet doganore për mallrat e vendeve që nuk janë të përfshira në unifikimin doganor dhe edhe një gjë që është e rëndësishme jashtëzakonisht shumë, e që natyrisht ndërlidhet me ekonominë po kalon edhe në rrafshin gjeostrategjik dhe politik. Ne e kemi parë që prej se ka filluar Procesi i Berlinit, çdo herë e më shumë janë shtuar zërat e krijimit të një zone ekonomike në rajon, ku do të futeshin të gjitha shtetet e asaj që quhet Ballkani Perëndimor, pra edhe Republika e Kosovës, edhe Republika e Shqipërisë. Dhe, këta zëra të krijimit të një zone ekonomike kanë shkuar deri aty sa të flasin edhe për një treg të përbashkët të rajonit, të cilin disa e quajnë “treg i përbashkët”, e disa e quajnë “një treg”.

Në këtë dy lloj emërtimeve natyrisht që ka një dallim jashtëzakonisht të madh. Për shembull, Bashkimi Evropian ka arritur që ta krijojë tregun e përbashkët shumë më herët dhe tash ka lëvizur në modusin e operimit, që e quan “treg” ose “një treg”. Në anglisht thuhet “common market” dhe “single market”. Dhe, konsideroj që është jashtëzakonisht e rëndësishme edhe në këtë drejtim që ta kemi parasysh që dy ekonomitë tona, pra Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë përballen gjithsesi me një tendencë në rritje të hegjemonisë ekonomike që e ka Serbia karshi rajonit, në të cilën një treg i përbashkët rajonal do t'ia mundësonte natyrisht më së shumti Serbisë, por edhe vendeve tjera që e kanë një bazë më të fuqishme industriale dhe të prodhimit që të fitojnë më së shumti nga ky përbashkim i tregjeve. Aq më tepër, nëse Kosova dhe Shqipëria futen në këtë treg të përbashkët sikur dy njësi të veçanta.

Prandaj, unifikimi i tregut që do të fillonte, por nuk do të përfundonte me unitetin doganor, nënkupton që si treg i përbashkët në praktikisht të funksionojmë si një njësi ekonomike përbrenda këtyre zhvillimeve rajonale dhe kështu të kemi mundësi shumë më të madhe që t'i bëjmë ballë hegjemonisë ekonomike të Serbisë, në mënyrë që ekonomitë tona, ose në këtë rast një treg yni i përbashkët ta ketë mundësinë dhe të ketë produkte më konkurruese, dhe të ketë ekonomi më të qëndrueshme e cila do ta kishte pastaj mundësinë që të përkthehej në mirëqenie për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe për qytetarët e Republikës së Shqipërisë.

Për ne, ky zhvillim i marrëdhënieve do të krijonte jo vetëm mirëqenie, por edhe integrim më të thellë ekonomik, social dhe natyrisht edhe politik, dhe do ta krijonte një ekonomi të shkallës, rritje të investimeve dhe përmirësim të konkurrencës në sektorët e biznesit veçanërisht, por, në anën tjetër, edhe te secili agjent ekonomik që është në tregjet tona. Pra, unifikimi i tregut, njërën anë, dhe pastaj unifikimi i sistemit energjetik, në anën tjetër, do ta krijonte një mundësi jashtëzakonisht të madhe dhe një fuqi jashtëzakonisht të madhe të dy shteteve në rajon dhe përgjithësisht në përballjen tonë, do ta quaj, me ashtu “ndërsymjen” ekonomike të Serbisë karshi të dyja shteteve.

Po ashtu, duhet të kemi parasysh që po të krahasohen zhvillimet ekonomike në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës, ne pak a shumë ndodhemi në një stad gati se të ngjashëm të zhvillimit ekonomik, dhe është vërtetuar edhe shkencërisht, edhe me metodën e krahasimit historik, por edhe në aktualitet, që kur shtetet të hyjnë në tregti plotësisht të lirë, e që janë në një stad të ngjashëm të zhvillimit, atëherë ka mundësi që të dyja shtetet të përfitojnë gati në mënyrë të barabartë nga kjo tregti. Ndërkohë që tregtia e lirë ndërmjet të dy shteteve që kanë stade të ndryshme të zhvillimit, ta zëmë ndërmjet një shteti me një ekonomi shumë të zhvilluar të shkallës dhe me një shtet i cili nuk ka ekonomi të zhvilluar, atëherë natyrisht që përfitojnë vetëm ata që tashmë e kanë ekonominë e zhvilluar.

Pra, po ta marrim si shembull, nga tregtia plotësisht e lirë, unifikimi doganor ndërmjet të Kosovës dhe Shqipërisë do të përfitonin të dyja vendet barabarësisht, ekonomikisht nga ky unifikim. Por, po të ndodhte e njëjta gjë, ta zëmë me një shtet shumë më të zhvilluar, po e marrim Gjermaninë nga Bashkimi Evropian, atëherë natyrisht që shumë më shumë do të përfitonte ekonomia e Gjermanisë nga një unitet i tillë, sesa që do të përfitonte ekonomia e Kosovës me stadin e zhvillimit në të cilin jemi.

Pra, ne e kemi të domosdoshme, në mënyrë që të kemi mundësi që të krijojmë vende pune dhe në mënyrë që ta kemi mundësinë që rritjen ekonomike ta përkthejmë në mirëqenie të qytetarëve, domosdoshmërisht duhet të kemi ekonomi të shkallës, dhe ekonomi të shkallës nuk mund të ndërtojmë me këtë treg të vogël e me këtë fuqi blerëse jashtëzakonisht të ulët që e kemi.

Prandaj, uniteti doganor si hap i radhës ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë do ta sanonte këtë problem madhor që e kemi me ekonominë tona, dhe pastaj natyrisht që ky trend duhet të jetë pozitiv, pra drejt integritit e jo të ndalet këtu. Dhe, një integrim i mirëfilltë ekonomik ndërjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, përveçse do t’u sillte mundësi mirëqenie dhe mundësi shumë më të mëdha ekonomike qytetarëve të të dyja vendeve, do t’u sillte pastaj mundësi ekonomike edhe vendeve të rajonit. Sepse, një ekonomi e fuqishme në rajon do të nënkuptonte mundësi për zhvillim ekonomik edhe për tërë rajonin.

Për këto arsye, nga ju deputetë të nderuar kërkoj që në mbështetje të nenit 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6.1 të Rregullores së Kuvendit me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate, Kuvendi i Republikës së Kosovës ta miratojë këtë:

REZOLUTË

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria e Republikës që t'i nisë menjëherë procedurat e nevojshme ligjore për arritjen e marrëveshjes ndërkombëtare për unifikimin e doganave me Republikën e Shqipërisë.

2. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet marrëveshjen bilaterale, e cila i unifikon doganat ndërmjet të dyja shteteve respektive.

Pra, dy pika i kam shkruar në këtë rezolutë, sepse kam dëshirë dhe jam i interesuar që kjo rezolutë të plotësohet edhe me propozimet që mund të vijnë nga deputetët, të cilët do të bëhen pjesë e këtij debati. Edhe një herë, do të kishte qenë shumë mirë që ta plotësojmë këtë rezolutë me ato idetë që i keni dhe gjithsesi ta miratojmë këtë rezolutë në mënyrë që ekonomisë sonë t'i hapet një perspektivë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e kryesuesve, respektivisht përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Zoti Zharku, në emër të Partisë Lidhja Demokratike e Kosovës.

LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ashtu siç ceket edhe në kërkesën për debat, Qeveria e Kosovës ka nënshkruar disa marrëveshje me Qeverinë e Shqipërisë me qëllim të rritjes së bashkëpunimit ekonomik ndërmjet vendeve tona në fusha të ndryshme. Këto marrëveshje bashkëpunimi, ndër tjera, parashohin masat që duhet të ndërmerren nga të dyja palët për zvogëlimin dhe lehtësimin e procedurave administrative, të cilat nga ana e bizneseve konsiderohen pengesa serioze në rritjen e bashkëpunimit.

Ndër të tjera, këto marrëveshje përfshijnë bashkëpunimin dhe ndihmën reciproke në çështjet doganore në lidhje me harmonizimin e legjislacionit dhe standardeve, krijimin e mekanizmave të informimit dhe lajmërimit reciprok, shkëmbimin e informacionit, harmonizimin dhe thjeshtëzimin e procedurave doganore, zhvillimin dhe përmirësimin e sistemit të deklarimit në Doganë, si dhe projektin e përbashkët për ndërtimin e një godine të vetme që do t'u shërbejë të dy administratave doganore.

Fatkeqësisht, deri sot pak është bërë në këtë aspekt. Nëse analizohen shifrat për marrëdhëniet tregtare ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, pa dyshim që nxirret konkluzioni mbi rritjen

pothuajse të përditshme të tyre, e nxitur fillimisht nga infrastruktura e shkëlqyeshme rrugore në të dyja vendet. Shkëmbimet tregtare në veçanti janë intensifikuar viteve të fundit, kështu në vitin 2017 eksportet e Kosovës kanë arritur shumën prej 60 milionë euro, kurse importet shumën prej 152 milionë euro. Shkalla e mbulimit të importeve me eksporte është afër 40%, që është më e favorshme nga shkëmbimet që i bëjmë me cilindo shtet.

Përkundër këtyre zhvillimeve pozitive në fushën e shkëmbimeve tregtare, që është meritë e bizneseve të të dyja vendeve, është evidente se qeveritë po ngecin në ofrimin e lehtësirave të ndryshme administrative duke u bërë pengesë në zhvillimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit ekonomik. Një ndër kërkesat tanimë disavjeçare të bizneseve të të dyja vendeve është unifikimi i pikave doganore, si dhe implementimi i procedurave të thjeshtuara doganore, të cilat do të eliminonin nevojën për zhdoganimin e mallrave në kufi dhe qëndrimin në terminale të mallrave.

Unifikimi i pikave doganore do të kursente kohën e pritjes nëpër pikëkalimet kufitare dhe do të zvogëlonte koston e mallrave në të dyja vendet. Ky zvogëlim i koston së importeve dhe eksporteve do t'i bënte më konkurruese mallrat e të dyja vendeve në krahasim me mallrat e shteteve tjera e që në mënyrë indirekte paraqet nxitje për rritje të mëtutjeshme të shkëmbimeve tregtare.

Duke i marrë parasysh të gjitha këto, konsiderojmë se unifikimi i pikave doganore është hap me rëndësi në rritjen e shkëmbimeve tregtare të vendeve tona dhe vërteton vazhdimësinë e projekteve nga Qeveria e udhëhequr nga LDK-ja, prandaj edhe do ta përkrahim këtë proces. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Zharku. Fjalën e ka zonja Hadërgjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Çfarëdo hapi të ndërmarrë për të hequr barrierat ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë të gjithë ne kemi mirëpritur, ashtu siç është mirëpritur edhe nënshkrimi i marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë për unifikimin e pikave doganore në mes dy vendeve.

Ne si grup parlamentar vlerësojmë çfarëdo marrëveshje që lidhet në mes dy shteteve tona, po ashtu vlerësojmë edhe të arriturat që janë bërë me qëllim të realizimit të marrëveshjeve që janë nënshkruar e që kanë të bëjnë me unifikimin e pikave doganore. Nënshkrimi i marrëveshjes ishte një lajm i mirë, sidomos për bizneset që për çdo ditë përballen me procedura burokratike në kufirin në mes dy vendeve. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike mbështet çdo veprim që është bërë për eliminimin e barrierave dhe që promovon zhvillimin e biznesit, si dhe çdo hap që ndikon në bashkëpunimin ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. Por, ne nuk mund të

pajtohemi asnjëherë në hapat që bëhen shpeshherë kur bëhen këto marrëveshje, shpeshherë sa për të bërë marketing me to, për hapa të politizuar sa për të thënë se po bëhet diçka e në fakt gjithçka mbetet në vend dhe pa u realizuar për shkak të mos konkretizimit të gjërave apo për shkak të mosveprimit për t'i bërë realitet ato.

Në mes Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë janë lidhur disa marrëveshje në fusha të ndryshme në takime të përbashkëta në mes dy qeverive, por cili është niveli i realizimit të marrëveshjeve të tilla nuk kemi ndonjë raport konkret zyrtar nga Qeveria dhe më shumë kemi raporte mediale, të cilat në njëfarë mënyre nuk e pasqyrojnë edhe realitetin në lidhje me atë se sa ka pasur zbatueshmëri të këtyre marrëveshjeve.

Ne në Kosovë po pretendojmë që të jemi pjesë e Bashkimit Evropian, prandaj ne duhet të bëjmë më shumë në drejtim të unifikimit të pikave doganore, në mënyrë që të mos mbetemi në nivelin e tregtisë, së zonës së tregtisë së lirë, por të ecim më tutje, në mënyrë që të ketë tregti të lirë në mes shteteve, sidomos me shtetin e Shqipërisë dhe të kemi detyrime doganore të unifikuara.

Marrëveshjet si kjo dhe të tjerat duhet të bëhen pjesë të politikave qeveritare, duhet të përcaktohen mirë institucionet që bartin përgjegjësinë për realizimin e marrëveshjeve të tilla., duhet të caktohen institucionet, respektivisht ministrinë, të cilat duhet të rregullojnë legjislativin, domethënë t'i rregullojnë ligjet që bëjnë të mundur zbatimin e këtyre marrëveshjeve, si dhe të përcaktohen saktësisht se cilat institucione duhet të bartin iniciativën dhe përgjegjësinë për t'i konkretizuar marrëveshjet e tilla. Ne presim hapa pozitivë edhe në unifikimin e politikave fiskale, sepse jemi në pritje të tri projektligjeve, të cilat rregullojnë këto politika fiskale, që në këto ligje të rregullohet edhe problematika e unifikimit të politikave fiskale, në mënyrë që janë parakusht për unifikimin doganor dhe bashkë të dy vendet t'u qasen më seriozisht sfidave të integritit në tregjet evropiane.

Sipas të dhënave që i kemi parë nga institucionet përkatëse, sidomos nga Agjencia e Statistikave, vërejmë se eksporti i Kosovës në drejtim të Shqipërisë është rritur diku 50% të vlerës, kurse po ashtu ka pasur rritje edhe të eksporteve të Shqipërisë në drejtim të Kosovës, që do të thotë se këto shifra janë shpresëdhënëse se do të bëhet edhe më shumë në këtë drejtim, që shkëmbimi i mallrave ndërmjet dy vendeve të jetë shumë më i mirë se sa ka qenë në të kaluarën.

Synimi ynë është që Kosova edhe Shqipëria të kenë një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Në këtë drejtim, ne duhet të angazhohemi shumë në rritjen e ekonomisë së dy vendeve, të ketë më shumë investime në të dy vendet, të ketë më shumë prodhimtari vendore në të dy vendet, në mënyrë që shkëmbimet tregtare në mes vendeve tona të bëhen në masën më të madhe dhe të mos ketë barriera në këtë drejtim.

Ne rekomandojmë që institucionet qeveritare të intensifikojnë veprimet e tyre në drejtim të unifikimit të pikave doganore me Kosovën dhe Shqipërinë, me qëllim që kjo veprimtari të ketë efektivitet më të lartë në ekonomi dhe të dy vendet tona, qoftë Kosova, qoftë Shqipëria, të përfitojnë nga përparësitë që i jep procesi i unifikimit të doganave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Safete. Fjalën e ka zoti Rexhaj.

ARBËR REXHAJ: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Unifikimi doganor në mes Kosovës dhe Shqipërisë mbetet larg si qëllim dhe si iniciativë. Jemi dëshmitarë se ende nuk ka një hap vendimtar, siç është ai i unifikimit të politikave fiskale në mes dy vendeve tona.

Veprimtaritë e dy ministrive të financave e të dy vendeve tona në unifikimin e pikave doganore, si proces teknik e operacional është e mangët dhe nuk ka krijuar premisat e një bashkimi doganor të shpejtë ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. Nuk është hedhur hapi vendimtar, unifikimi i politikave fiskale, si parakusht për sigurimin e bashkimit doganor, i cili përbën një potencial për rritjen e shkëmbimit të mallrave, rritjen ekonomike të dy vendeve tona, si dhe parapërgatitje për proces maturimi për institucionet tona për t'u bërë ballë sfidave që parashtron integrimi në tregun evropian.

Qeveritë shqiptare, përkatësisht ajo e Kosovës dhe e Shqipërisë, në ato mbledhjet e përbashkëta më shumë i kanë zhvilluar për reklamim e agjitacion politik, se sa për ndonjë nënshkrim e zbatim të ndonjë vendimi për të mirën e qytetarëve. Në pikën kufitare Vërmicë-Morinë, që lidh Kosovën me Shqipërinë, ka vetëm një dritare kontrolli, mirëpo kjo nuk paraqet ndonjë unifikim doganor të theksuar, ose që do të kishte ndonjë rol të madh me të cilin do të mund të mburrëshim.

Marrëveshjet e nënshkruara në mes dy qeverive tona mendojmë se karakterizohen nga një formë e shprehjes së vullnetit të mirë, por nuk janë pasqyruar në politika të mirëfillta qeveritare, që do të realizonin me përgjegjshmëri dhe me sukses bashkimin doganor të dy shteteve vëllazërore shqiptare. E meqenëse nuk është kështu, atëherë është demagogji dhe është mashtrim. Nga konstatime të mendimeve të fundit prej rrjedhojave të ekonomisë dhe tregtisë, konstatohet se nuk ka asnjë angazhim institucional bazuar në një strategji të posaçme për unifikim doganor, gjë e cila ka dëmtuar dukshëm besimin e bizneseve në të dy anët e kufirit.

Shqipëria dhe Kosova kanë lidhur një marrëveshje të tregtisë së lirë, por bashkimi doganor është një shkallë më e lartë, jo vetëm si ndërveprim ekonomik, por edhe si një sinkronizim ekonomiko-fiskal që kërkon vendosjen e tarifave të përbashkëta karshi vendeve të treta. Ne sigurisht që do të kërkonim hartimin e një strategjie të posaçme për bashkimin doganor me Shqipërinë, si dhe në grupe të përbashkëta punuese midis Kosovës dhe Shqipërisë të përfshihen edhe bashkimi i

dhomave të tregtisë dhe industrisë, pra edhe ato të Shqipërisë dhe Oda Ekonomike e Kosovës, e cila së fundmi është mobilizuar që ta ofrojë më shumë Serbinë në Kosovë e të bashkëpunojë me bizneset serbe, se sa ta ofrojë Shqipërinë dhe vendet mike të Kosovës.

Në takimet e Haradinajt dhe Ramës në Shqipëri është thënë se Porti i Durrësit dhe ai i Shëngjinit është port i shqiptarëve të Kosovës, e kam fjalën në aspektin doganor ekonomik. Premtime të dhëna nga dy kryeministrat shqiptarë nuk u realizuan e siç po shihet nuk do të realizohen. Operimi i Doganës së Kosovës në Portin e Durrësit do të fillonte në muajin dhjetor të vitit të kaluar, mirëpo e cila nuk u funksionalizua edhe sot e kësaj dite. Fakti që Zyra Doganore e Kosovës nuk u hap në dhjetor të vitit 2017 tregon një tërheqje nga projekti, duke qenë se pala shqiptare nuk ka marrë asnjë masë për të plotësuar kriteret e operimit, kurse pala e Kosovës asnjëherë nuk tregoi arsyet reale të sakta të mosveprimit të këtij operimi të pikës doganore të Kosovës në Portin e Durrësit.

Kujtojmë se nga operimi i plotë i Doganës së Kosovës në Portin e Durrësit bizneset tona do të përfitonin një ulje të kostos aktuale me rreth përafërsisht 2 milionë euro në vit, e si rrjedhojë edhe të shkurtimit të kohës së operimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Është e vërtetë se takimi i dy qeverive është pritur me entuziazëm nga qytetarët, qoftë në Kosovë apo Shqipëri, duke ditur se ka nevojë për lehtësim të mundësisë së lëvizjes së lirë, edhe të qytetarëve, edhe të mallrave, por edhe arritjet e marrëveshjeve të cilat mund të bëjnë një unifikim të përgjithshëm në të gjitha planet çfarë janë planifikuar.

Por, konsideroj se tani është koha kur duhet të bëhet një kontroll, ose një analizë, e këtyre marrëveshjeve se sa kanë mundur të zbatohen dhe cilat do të mund të ishin ato angazhimet tona si qeveri, në mënyrë që të mund t'i realizojmë të gjitha ato marrëveshje që janë arritur.

Edhe marrëveshjet për unifikimin e pikave doganore mund të bëhen shumë lehtë, nëse ai vullneti i mirë që është treguar në takime të kalojë në zbatim praktik. Në këtë drejtim mendoj që edhe dy kuvendet e dy shteteve tona mund të ndihmojnë në këtë proces, duke u shërbyer edhe me angazhimet në komisionet përkatëse, të cilat nëpërmjet harmonizimit të ligjeve mund të bëjnë një praktikë të re të ecjes përpara në arritjen e kësaj marrëveshjeje.

Po ashtu, konsideroj se është e domosdoshme që tani e tutje të jemi më aktivë edhe sa u përket marrëveshjeve tjera, që kanë qenë të lidhur me Shqipërinë e që të mos i lëmë vetëm si takime të cilat nuk prodhojnë efektet e duhura, por përkundrazi, që bëjnë një unifikim të vërtetë të

Shqipërisë dhe Kosovës. Prandaj, harmonizimi i legjislacionit, marrja e modeleve më të mira të shteteve të Bashkimit Evropian, unifikimi i të gjitha sferave që neve mund të na çojnë përpara duhet të jenë objektiv yni. Prandaj, ne si grup parlamentar e përkrahim këtë debat duke i dhënë edhe sugjerimet tona lidhur me detajet, që do të mund të jenë pjesë e një rezolute që mund të dalë nga ky debat. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zafir Berisha, urdhëro!

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Debati që është iniciuar nga Visari mendoj se është një debat i qëlluar, por unë që në fillim dua të shpreh diçka që neve na ka përcjellë si Kuvend dhe si politikë në Kosovë, që ky debat të mos mbetet vetëm retorikë fjalësh boshe dhe në fakt të mos ketë kurrfarë ndikimi në institucionet ekzekutive në të dy anët, edhe në Shqipëri, edhe në Kosovë.

Debati për unifikimin doganor mendoj se duhet të përcillet edhe me një sqarim të çështjeve të cilat kanë filluar që nga mbledhja e përbashkët e dy qeverive në Prizren, e cila atëherë është parë si njëfarë shkëndije shprese për bashkëpunim në të gjitha sferat e jetës. Mirëpo, koha po tregon se këto takimet e përbashkëta të Qeverisë kanë qenë më shumë takime për reklamë politike, se sa takime që kanë dhënë, ose prodhuar, efektet e veta në fushat për të cilat janë marrë vesh.

Mendoj se përcaktimi tashmë i të dy vendeve për tregti të lirë duhet të kalojë nga fjalët në vepra, sepse thjesht rrjedhat e zhvillimeve po tregojnë të kundërtën. Debati i sotëm duhet të jetë edhe një sinjal për ekzekutivin, që në këtë drejtim të mendojë më sinqerisht. Ne kemi ngecur në të gjitha fushat, jo vetëm në tregti por edhe në bashkëpunim në sferën e arsimit e të kulturës, por që këtyre ngecjeve u dalin edhe pengesa të tjera, të cilat janë shqetësim i qytetarëve. Shfrytëzoj momentin që t'i shpreh publikisht shqetësimet e lëvizjeve të qytetarëve nga Kosova për Shqipëri, por edhe anasjelltas. Në këtë rast më lejoni të shpreh shqetësimin e qytetarëve nga Kosova që lëvizin në drejtim të Shqipërisë, për shkak të disa rregullave që janë çështje të brendshme të Shqipërisë, por që natyrisht janë pengesë për qytetarët kosovarë, veçanërisht rregullat në komunikacion, ku qytetarëve kosovarë u merret leja, ndoshta me të drejtë, por procedurat që përdoren aktualisht në Shqipëri ndodh që shumë qytetarë të Kosovës, të cilët nëpërmjet Shqipërisë lëvizin për Perëndim, të kenë probleme në udhëtim deri edhe në vonesa për punë e që thjesht, këtë debatin për unifikim të doganave ma merr mendja e lë nën hije.

Natyrisht, edhe një çështje tjetër që është shqetësim gjithashtu, është çështja e taksës në Rrugën e Kombit, rrugë e cila është ndërtuar nga taksat e qytetarëve të Shqipërisë dhe mendoj se Qeveria e Kosovës edhe e Shqipërisë duhet ta gjejë një gjuhë të përbashkët, që kjo taksë të mos jetë pengesë edhe e lëvizjes së qytetarëve, por veçanërisht edhe e lëvizjeve që bëjnë bizneset në të dy anët. Llogaris se çështjet që janë në interes të të dy vendeve, në këtë rast Kosovës dhe Shqipërisë, duhet të unifikohen në të gjitha sferat, jo vetëm në kabinat në Vërmicë apo në pikat

tjera doganore, sepse kjo mund të jetë vetëm një gjë dytësore, karshi çështjeve tjera jetike, që kemi ne qytetarët e Kosovës dhe të Shqipërisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Në parim e mbështes këtë iniciativë dhe konsideroj që Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të debatohet për procedura të lehtësimit të qarkullimit të lirë, të njerëzve, të mallrave, të bizneseve e ideve. Por anash kësaj, Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe ne si përfaqësues të popullit duhet të jemi të informuar për rezultatet praktike të qeverive, domethënë të mbledhjeve të dy qeverive dhe duhet ta lëmë anash marketingun politik dhe pompozitetin dhe realisht të shikojmë se çfarë po u ndihmojmë qytetarëve të dy vendeve, bizneseve, qarkut kulturor-krijues, atij akademik. Ende nuk e kemi hartuar një abetare të përbashkët, që do të ishte si hap inicial, që ne si dy shtete dhe si një komb thjesht, sepse këto i kanë bërë edhe shtetet më të zhvilluara, me demokraci më të zhvilluara e që tani janë edhe anëtare të BE-së, pastaj kutikulat e përbashkëta, organizimet kulturore e sportive.

Unë e mora fjalën që t'i ngre këto shqetësime të qytetarëve. Tani jemi në prag të sezonit turistik, kur edhe një fluks i shtuar i mërgimtarëve tanë qarkullon në Rrugën e Kombit dhe ballafaqohet me këto barriera, qofshin teknike, administrative dhe procedurale. Në këtë kuptim, dua të ngre edhe një shqetësim të mjaft qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilët policia rrugore apo e trafikut të Republikës së Shqipërisë gjatë shqiptimit të gjobave po ua konfiskon patentë-shoferët apo edhe kartat e identitetit. Konsideroj, që një polic trafikur i cilitdo shtet nuk ka të drejtë t'ia konfiskojë dokumentin personal apo patentën e shoferit një qytetari të Kosovës. Janë ankuar edhe mjaftë njerëz që vijnë nga mërgata. Shembull konkret, dikush mund ta shfrytëzojë si transit Republikën e Shqipërisë dhe të shkojë në një vend tjetër. Si do të gjendet ai edhe pasi ta paguajë gjobën, që t'i konfiskohet patentë-shoferi. Si do ta arsyetojë ai atë, po qe se ballafaqohet me të njëjtën procedura nga Policia Rrugore apo e trafikut të një shteti tjetër.

Le të jenë këto apele publike për ministrin e Punëve të Brendshme, për drejtorët homologë relevantë të dy policive të të dy shteteve, që vërtet këto gjëra të rregullohen dhe të lehtësojnë qarkullimin e lirë të njerëzve, po edhe të mallrave dhe nevojat e ndryshme që i kemi në bashkëpunimin bilateral me republikën e Shqipërisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në parim biseda apo diskutimi për çështjen e doganave do të duhej të përfundonte në të gjitha ato mbledhjet e qeverive, të cilat janë organizuar nga dy qeveritë tona dhe ne vetëm do të mund, si deputetë, të monitoronim mbarëvajtjen, ose mbikëqyrjen e zbatimit të atyre marrëveshjeve.

Për fat të keq të qytetarëve tanë, një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Ka rastisur që për shkak të pengesave, ose vështirësive që i kemi disa nga ne, për të mos arritur të qarkullojmë rrugëve që qytetarët tjerë kanë mundësi të kalojnë përmes Serbisë dhe vendeve tjera dhe sigurisht se destinacioni ynë i rrugëtimit dhe i shumë qytetarëve tjerë, ish-pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët kalojnë nëpërmjet Italisë dhe Shqipërisë në Kosovë, qoftë me mallra, qoftë me automjete, janë të diskriminuar në raport me qytetarët tjerë, të cilët kalojnë nëpërmjet Serbisë.

Një qytetar yni, i cili hyn në pikën doganore në Durrës, përmes portit, detyrohet të paguajë fillimisht një shpedicion në vlerë 140 deri në 160 euro dhe pastaj edhe një pagesë ekstra, varësisht prej mallit të cilin duhet ta doganojë, nëse është mall mbi 1000 euro, duhet bërë edhe një kontroll shtesë në pikat e kontrollit doganor, e shpeshherë atë shërbim as nuk e marrin, por paguajnë për të.

Një shqetësim të cilin e kam ngritur edhe në Qeverinë e kaluar, edhe përmes pyetjeve parlamentare, sepse në vend se bashkëpunimi ynë me Shqipërinë në aspektin ekonomik dhe të zhdoganimit të mallrave të lehtësohej, në fakt, pas takimeve të dy qeverive është vështirësuar.

Pra, qytetarët tanë, të cilët dëshirojnë të kalojnë përmes Shqipërisë për të arritur në Kosovë, detyrohen të paguajnë edhe për shpedicion, edhe për kontroll, në raport me ata të cilët mund të kalojnë nga Mali i Zi ose nga Serbia, ku nuk paguajnë as shpedicion e as kontroll shtesë, por drejtpërdrejt zhdoganimin e bëjnë në pikat kufitare të Republikës së Kosovës.

Kërkoj edhe një herë nga ministri i Financave, në këtë rast, edhe nga vetë zyrtarët doganorë që këtë çështjen e problematikës së doganës ta zgjidhin me homologët e tyre nga shteti shqiptar. Realisht do të duhej që këto lehtësira doganore të krijoheshin në favor të zhvillimit të bizneseve, në favor të qytetarëve tanë, e jo të jenë pengesë për një bashkëpunim dhe për një shtrirje ekonomike, ku ne do të ishim një treg i përbashkët me Shqipërinë dhe vetëm kështu mund të jemi konkurrent edhe në rajonin, edhe me botën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muharrem Nitaj e ka fjalën.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit, zoti Haliti,
Po të varej prej Kosovës, ky union doganor ishe hequr moti. Thuhet që menjëherë pas luftës në Kosovës një grup i qytetarëve të Kosovës, kryesisht njerëz nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, kishin pasur një takim me shkrimtarin e madh shqiptar, Ismail Kadare dhe i kishin shpalosur atij idenë e bashkimit urgjent me Shqipërinë.

Ndërkaq përgjigjja e këtij të fundit kishte qenë: Po, a e keni pyetur ju Shqipërinë, nëse ajo është e gatshme të bashkohet me Kosovën?

Interesante ideja e propozuesit, po kam përshtypjen që nuk është në mandatin e deputetëve të Kuvendit të Kosovës ose në fuqinë e tyre që të ndryshojnë çka do qoftë në këtë fushë.

Për fatin e keq, bashkimi i pikave doganore, sikur edhe shumë nisma të tjera, e kam thënë edhe para disa ditëve me propozimin e heqjes së romingut me Republikën e Shqipërisë, për fatin e keq për të gjitha këto çështje ekzistojnë dy palë dhe unë nuk jam shumë i sigurt që ka një gatishmëri nga pala shqiptare që të përfillë qoftë edhe këtë insistimin ose rekomandimet e Kuvendit të Kosovës.

Ndoshta zoti Milaim Zeka mund të ketë informata më shumë se sa funksional është ky bashkimi i Kosovës me Shqipërinë dhe se sa i efektshëm ose sa të efektshme janë kërkesat tona të vazhdueshme për segmente të caktuara që të unifikohet që nga tregu, dogana, pikat doganore, vendkalimet e deri te heqja e romingut. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Unë po e vazhdoj ku e la Muharremi, ky tha janë dy palë, e unë mendoj që janë madje tri palë, është Prishtina që nuk na pyet askush, se jam një milion për qind i bindur që po ta pyeste dikush Qeverinë e Kosovës, nesër do të hiqeshin doganat.

Por faktorë kryesorë janë Tirana dhe Brukseli. Kështu që mbi bazën e kësaj për momentin, nëpër një fazë nëpër të cilën ne jemi duke kaluar si shtet, ku kemi përpara edhe bisedimet me Serbinë e një milion probleme të tjera, unë mendoj që do të jetë shumë problem edhe kjo, do jetë vetëm fontanë dëshirash, kështu që do të arkivohet në Arkivin e Parlamentit të Kosovës.

Ne nuk po arrijmë të heqim kontrollin, prej Prishtinës e deri në Morinë shkojmë për 40 minuta, pastaj të premtën në Morinë duhet prituri dy orë për të hyrë në Shqipëri, me familje, me fëmijë, aty na sakatojnë, na djersitin, domethënë një diçka shumë, shumë e thjeshtë. Dhe, në anën tjetër, nuk kemi arritur ne si shtet të bëjmë një bankë kombëtare, për shembull, Kosova nuk ka bankë të veten.

Prandaj, unë mendoj edhe një herë që disa kolegë deputetë kur shprehin dëshira të tilla, do të ishte mirë pak të shikohen edhe rrethanat ndërkombëtare, të konsultohen juristët, sepse ne mund të sjellim propozime për rezoluta të ndryshme, por nuk varen prej nesh.

Pandeli Majko pati thanë që prej 1 janarit të këtij viti do të hiqej kontrolli mes Kosovës edhe Shqipërisë, kush e ka përcjellë, e di, madje doli ai dhe u lavdërua bajagi shumë me atë punë, e sot e këtë dite nuk është bërë një gjë e tillë.

Një koleg tha për maltretimet që i bën policia në Shqipëri, duke u marrë patentë shoferët njerëzve, kjo është shumë e saktë dhe shumë e vërtetë. Ne si deputetë mund t'i bëjmë thirrje Qeverisë shqiptare që një njeri që vjen prej Zvicre, e mua më ka ndodhur personalisht, më kanë thënë sot është e premtë, eja të hënën merre në Gjykatë të Lezhës patentë shoferin. Domethënë, ndonjë propozim të lehtë mund t'ia dërgojmë Tiranës, po këto janë propozime të rënda për unifikimin e doganave, nuk ma merr mendja që do të pranonte Tirana, numër një dhe nuk ma merr mendja që do të pranonte bizneset e Kosovës edhe të Shqipërisë.

Kështu që edhe unë e shoh këtë vetëm si fontanë dëshirash, asgjë më shumë, dhashë Zoti realizohet, mbase së pari nuk na kontrollojnë aq gjatë, pa u bërë unifikimi, do të bashkohemi në Bashkimin Evropian edhe me Shqipërinë pas nja 10 vjetësh me kështu të Zotit.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka diskutues të tjerë të paraqitur. Atëherë fjalën e ka propozuesi i çështjes, zoti Visar Ymeri, i cili ka kërkuar deklarinë me votim për rezolutën e propozuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate. Zoti Ymeri e keni fjalën.

VISAR YMERY: Faleminderit, kryesues!

I falënderoj të gjithë deputetët që morën pjesë në këtë debat.

Dua të përpiqem të sqaroj disa prej gjëra që i dëgjova këtu, veçanërisht këtë, ta quaj kështu, skepticizmin nëse Shqipëria është e gatshme ta pranojë një gjë të tillë.

Së pari, duhet ta kemi parasysh që në një numër të deklarimeve publike që vijnë prej kryeministrit Edi Rama e te përfaqësues të tjerë të Republikës së Shqipërisë, ata përherë janë shprehur shumë më të gatshëm se ne në Kosovë që ta bëjnë një gjë të tillë, pra që ta kemi një unifikim të dy, t'i quaj këtu sistemeve të territoreve doganore dhe mendoj që në këtë drejtim Shqipëria, të paktën është shprehur ashtu, që është e gatshme për një gjë të tillë. Problemi, po supozoj tash, ka qenë në anën e Kosovës shumë më shumë për shkak të moskryerjes së detyrave, unifikimeve, ndryshimeve, reformimeve politike institucionale e ligjore për ta bërë një gjë të tillë. Pra, është e domosdoshme që për të arritur një unifikim të plotë doganor, siç edhe kemi nevojë, duhet ta kemi edhe atë që e përmendi më herët edhe deputeti i Vetëvendosjes, Arbër Rexhaj, për unifikim të politikave fiskale.

Dhe mendoj që përveç dobive ekonomike, kjo gjë na sjell edhe një dobi tjetër, e që është shumë e shprehur këtu ose e nevojshme, të them ashtu në Kosovë.

Pra, po ta bënim një unifikim të tillë doganor, atëherë kjo do të na shtynte edhe më shumë drejt obligimit që të fillojmë ta mbledhim TVSH-në, tatimin në vlerë të shtuar, brenda vendit, e jo aktualisht siç e bëjmë nëpër pika doganore në kufij dhe kjo do ta ndihmonte edhe përmirësimin e punës të Administratës Tatimore, edhe në përgjithësi do t'u ndihmonte bizneseve për shkak të kohë së ndryshme të pagesës të TVSH-së që do t'ua rriste atyre mundësinë e likuiditetit, për të cilin vuajnë kaq shumë sot.

Pra, përveç se unifikimi doganor ndikon në rritjen e tregut, kjo ndikon edhe në avancimin e institucioneve tona sa u përket mbledhjes së tatimeve, në këtë rast në takimin në vlerë të shtuar.

Unë konsideroj që Kuvendi i Republikës së Kosovës është e domosdoshme që sot ta shprehë edhe një vullnet politik, mirëpo ta nxisë Qeverinë e Republikës së Kosovës që të përqendrohet në këtë fushë dhe të përshpejtojë procesin e unifikimit doganor.

Natyrisht që nuk pretendoj që kjo rezolutë do ta kryejë këtë, unë mendoj që kjo rezolutë as nuk është nisje e kësaj, sepse siç u tha edhe këtu, ka nisur me marrëveshje të ndryshme që janë nënshkruar deri tash, disa janë zbatuar më shumë e disa më pak, po as nuk është fundi i procesit.

Mirëpo është e domosdoshme që Kosova dhe Shqipëria të kalojnë në një stad të ri të marrëdhënieve ekonomike e tregtare, e stadi i ri i marrëdhënieve ekonomike tregtare është të kalojmë nga ideja e tregtisë së lirë, në një unifikim të plotë doganor që do të nënkuptonte jemi për bashkim të tregjeve, e cila do të mundësonte përdorim shumë më efikas të të gjitha resurseve ekonomike që i kemi në të dyja anët e kufirit për zhvillim ekonomik e për mirëqenie të qytetarëve.

Prandaj, edhe një herë, meqenëse nuk pati, me sa e pashë, propozime nga deputetët për sa i përket rezolutës si të tillë, atëherë ju ftoj që ta votojmë këtë rezolutë dhe pastaj natyrisht që si Kuvend të fokusohemi në mbikëqyrjen e punës së Qeverisë, veçanërisht karshi kësaj ose këtyre marrëveshjeve, karshi kësaj rezolute. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në sallë janë vetëm 51 deputetë.

Po e përfundojmë edhe pikën e katërbëdhjetë të rendit të ditës, ora është 15:45, ta lëmë që në orën 17:00, po besoj e kryejmë edhe këtë debatin për rininë dhe në orën 17:00 i votojmë të tri rezolutat njëherësh. Nuk ka akoma numër të mjaftueshëm, duhen edhe dy.

23. Debat parlamentar në lidhje me gjendjen jo të mirë të rinisë kosovare, sipas kërkesës së deputetit Fidan Rekaliu, i mbështetur edhe nga pesë deputetë

Deputeti Fidan Rekaliu, i mbështetur edhe nga pesë deputetë, ka parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me gjendjen jo të mirë të rinisë kosovare.

Ftoj deputetin Rekaliu që në emër të propozuesit ta paraqesë çështjen, për të cilën është kërkuar debati parlamentar. Zoti Rekaliu, e keni fjalën.

FIDAN REKALIU: Faleminderit, i nderuar kryesues,

Fjala ime është edhe në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në periudha status quo apo transicioneve të tejzgjatura, gati në kufij të një bllokimi total, siç ndodhet Kosova sot, gjithmonë është një grup shoqëror vital dhe me energji që bën presion të zhblllokohen situata të tilla. Ata janë rinia e një vendi, e cila gjithmonë në këso rastesh reagon.

Për fatin tonë të keq, edhe rinia jonë po reagon ndaj një situatë të përgjithshme në të cilën ndodhemi si shoqëri dhe si shtet.

Siç po shihet çdo ditë e më shumë, të nderuar kolegë deputetë, ky reagim i rinisë sonë është as më pak e as më shumë se sa largim. Largim nga Kosova, si e vetmja rrugë që i nxit sot ata të kërkojnë shpëtim nga papunësia, paperspektiva, që sot pa asnjë dyshim ka prodhuar në gjendje psikike kolektive të rënduar.

Unë besoj, të nderuar kolegë deputetë, se ju të gjithë zhvilloni kontakte me qytetarët e shumtë, pra me grupet të ndryshme sociale.

Jam i bindur që të gjithë jeni ndeshur me prindër, të cilët është zhgënjyer, për të mos thënë të thyer moralisht, ne përballemi me një fjali tejet të vështirë: “Nuk paska më keq se sa të rrisësh fëmijët me aq mundime, e në fund t’i humbasësh diku larg në botën e jashtme”.

Pra, gjendja nuk ka si të jetë ndryshe, veçse alarmante.

Të gjithë kemi thënë se arsimi në Kosovë është në një gjendje të papranueshme.

Për këtë jemi fajësuar të gjithë, pra, kemi bërë politikë me njëri-tjetrin dhe asgjë më shumë. E përveçse kemi thënë shumë fjalë, punë kemi bërë pak apo aspak.

Aty ku ndërtohet e ardhmja jonë, situata vazhdon të jetë e njëjtë.

Të gjithë kemi thënë se politikat rinore nuk janë zbatuar fare apo janë keqzbatuar.

Të gjithë kemi thënë se përkrahja e bizneseve të reja ka munguar. Standardet e karrierës në shërbimin publik janë zhvendosur nga nevoja për promovimin e më të mirëve, në zbatimin e kriterit partiak, klanor e familjar.

Pa asnjë dyshim, të gjitha këto bashkë kanë sjellë veç zhgënjim dhe mungesë të shpresës.

Për çdo ditë ne shohim të rinj të shumtë që largohen nga Kosova legalisht dhe ilegalisht.

Kush do ta kishte menduar nga prindërit në Kosovë të viteve '90 se 19 vjet pas çlirimit qeverisja e keqe, korrupsioni, promovimi i paditurisë në institucione, nepotizmi, klientelizmi që buron nga politika jonë të nxiste largimin masiv të fëmijëve të tyre nga Kosova, as pesimistët më të mëdhenj nuk do ta kishin menduar një skenar të tillë.

Të dashur kolegë deputetë,

Sot është momenti që Kuvendi të thotë fjalën e vet dhe të merret seriozisht me këtë temë.

Qeveria e Republikës së Kosovës, njerëzit që mbajnë funksione udhëheqëse në institucione ndodh të mos u bëhet vonë për situatën e pashpresë, në të cilën ndodhet rinia jonë.

Mirëpo, fatkeqësisht situata në terren është aq dëshpëruese, sa kushdo që ka minimumin e përgjegjësisë, nuk do ta mund ta ndiente veten rehat.

Sot edhe për fajin e politikës, të qeverisjes, rinia jonë nuk lëviz lirshëm sikurse bashkëmoshatarët e tyre të rajonit.

Për fajin e politikës dhe qeverisjes së keqe, nëse ata do të vareshin thjesht nga cilësia e shkollimit dhe studimeve në Kosovë, pra të mos ishte vetiniciativa, kreativiteti dhe inovacioni i rinisë tonë, ata sot do të përballëshin me disavantazhe të theksuara në formimin profesional akademik në raport me vendet e rajonit, e të mos flasim për vendet e Bashkimit Evropian.

Për fajin e politikës dhe të qeverisjes së keqe, sot ne kemi fare pak ose aspak programe modele të suksesshme të nxitjes dhe të promovimit të ndërmarrësish të rinjtë si një mundësi e pafundme e punësimit.

Burimet statistikore japin të dhëna se mbi 20 mijë të rinj të diplomuar sot janë pa punë në vendin tonë, në mos më shumë.

Sot ky Kuvend e ka për detyrë të merret seriozisht me këtë çështje.

Sipas vlerësimit tonë, Kuvendi dhe Qeveria duhet të veprojnë sa më shpejt në këtë drejtim.

Të gjithë e dinë se është në dorën e politikës të merren masa konkrete për të nisur përmirësimin e gjendjes në fusha që prekin interesin e rinisë.

Ne duhet të jemi të fuqishëm në ndërmarrjen e reformave të nevojshme dhe të thella për ndryshimin e gjendjes së pjesës më vitale të shoqërisë tonë.

Ne nuk kemi nevojë për popullizëm, përkundrazi, duam veprime konkrete që na nxjerrin nga kjo situatë.

Programi ynë arsimor duhet të jetë në shërbim të nevojave të tregut të punës.

Duhet të fokusohemi drejt dhe qartë në objektivat të tilla për ta ndryshuar gjendjen në afat të mesëm kohor.

Bizneset duhet të inkurajohen apo të mbështeten me lehtësira fiskale, në ngritjen e kapaciteteve të punëtorëve të rinj.

Duhet të krijohen kushte për rritjen e shërbimeve outsourcing si mundësi e vetëpunësimi për të rinjtë.

Qendra inovative duhet të përkrahen dhe të shtohen edhe në komuna të tjera.

Reforma në arsim duhet të jetë në shërbim të epokës së re, në të cilën kemi hyrë dhe për të gjitha këto nevojitet para së gjithash vullnet politik.

Rezoluta reflekton në masë të madhe segmentet e identifikuara qartë, ku Kuvendi do të mund ta detyronte Qeverinë për të ndërhyrë sa më shpejt me qëllim të përmirësimin të gjendjes së përgjithshme.

Ne besojmë se këto masa dhe ndërhyrje emergjente do të zbusin gjendjen aktuale.

Prandaj, të nderuar kolegë deputetë,

Duke mirëpritur kontributin tuaj në këtë debat parlamentar shpresoj se nga kjo seancë do të dalim me rezultate konkret për të mirën e kësaj kategorie që pa asnjë dyshim është potenciali më i madh dhe më i vlefshëm që ka Republika e Kosovës.

Në vazhdim do t'i lexoj pikat e rezolutës, të cilën e kam përgatitur dhe të gjitha grupet parlamentare e kanë nga një kopje:

REZOLUTË

1. Të miratohet sa më shpejt Strategjia për Rini dhe t'i sigurohet e gjithë mbështetja e Qeverisë së Republikës së Kosovës;
2. Të realizohet në afatin sa më të shkurtër plotësim-ndryshimi i Ligjit nr. 03/L-145 për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë brenda vitit 2018;
3. Obligohet Qeveria e Kosovës që ta zbatojë në përpikëri planin e veprimit: Rritja e punësimit të të rinjve 2018-2020;
4. Qeveria e Kosovës t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për ndalimin e ikjes së trurit dhe të kthehen të rinjtë me kualifikime të larta nga diaspora në Kosovë gjatë vitit 2018;
5. Obligohet Qeveria e Kosovës që të krijojë lehtësira për të rinjtë ndërmarrës;
6. Qeveria e Kosovës ta krijojë një program të veçantë për kategorinë e të rinjve që nuk janë në punë, në shkollë apo në trajnime;
7. Të krijohet një program social nga Qeveria e Kosovës për ndihmë studentëve nga familjet me të ardhura të ulëta për mbulimin e shpenzimeve të banimit gjatë kohës së kryerjes së studimeve;
8. Të krijohen një program nga Qeveria e Kosovës për praktikë njëvjeçare me pagesë në institucionet publike si dhe të njihet puna vullnetare si përvojë e punës dhe të fillojë të zbatohet sa më shpejt nga Ministria për Kulturë, Rini e Sport;
10. MASHT-i të fillojë me reforma të plan-programeve arsimore për përshtatjen e tyre me nevojat e tregut të punës për të rinjtë, si dhe stimulimin e drejttimeve deficitare me bursa shtesë;
11. Ministria e Punëve të Brendshme dhe ministrinë e tjera të linjës t'i luftojnë fuqishëm dukuritë negative të të rinjve në Kosovë, siç janë droga, prostitucioni, dhuna në shkolla, alkooli, etj.;
12. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Integritimeve Evropiane, si dhe ministrinë e tjera të linjës të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme që të rinjtë e Kosovës të jenë pjesë dhe përfituese të të gjitha programeve të bashkëpunimit ndërkombëtar, në veçanti programet e BE-së;
13. Të mbështeten në mënyrë obliguese nga institucionet qeveritare, qendrore dhe lokale, strukturat e të rinjve të garantuara nga ligji për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë, dhe pika e fundit;

14. Ministritë e linjave të krijojnë lehtësime në fushën e shitjes së shërbimeve për të rinjtë ndërmarrës.

Faleminderit dhe ju lus të gjithëve që ta jepni kontributin tuaj gjatë këtij debati parlamentar dhe në fund të dalim bashkërisht ta propozojmë rezolutën përfundimtare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Rekalju! Sipas radhës, tani fjalën e ka zoti Andin Hoti, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

ANDIN HOTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

E dashur rini,

Them të drejtën, një prej pikave më të rëndësishme për mua prej që jam deputet në Kuvendin e Kosovës e konsideroj pikërisht këtë pikë, pra shqetësimin për gjendjen e rinisë në Kosovë.

Jo pak herë e kam ngritur zërin për çështjen e rinisë, për rolin e rinisë në shoqërinë tonë, të ardhmen e tyre në Kosovë, e të tjera.

Jo vetëm sepse ka qenë premtim imi i fushatës, por edhe se e ndjej obligim moral e kombëtar.

Por angazhimi i Kuvendit dhe i Qeverisë në këtë drejtim është ende i vogël.

Prandaj, ka qenë shumë e nevojshme krijimi i një rezolute të tillë, ku i bën të qartë hapat që duhet të ndërmerren për t'u dalë në ndihmë të rinjve tanë. Kuvendi dhe Qeveria duhet të kenë strategji për rininë dhe me këtë strategji ne duhet të inkurajojmë të rinjtë që në Kosovë ta shohin të ardhmen e tyre e jo diku tjetër, Kosova duhet të jetë atdheu i tyre i vetëm.

Qeveria duhet të ndërmarrë masa urgjente për krijimin e kushteve për punë, për mbështetjen e studentëve, për krijimin e lehtësirave për programe të ndryshme studentore, për rolin e rinisë në shoqërinë tonë, për avancimin e saj në vendimmarrje, për sistemin arsimor që i plotëson nevojat e tregut dhe për stimulim në këtë fushë, për mbështetje të të rinjve ndërmarrës, të nxisë investime në sektorin privat.

Të rinjtë tanë kanë shumë talent dhe shpirt sipërmarrës, por për të ardhur në shprehje kjo, Qeveria duhet të sigurojë kushte, pra duhet të luftojë informalitetin e monopolin, të hartojë politika që nxisin zhvillime të perspektivave të rinisë në vendin tonë.

Jemi dëshmitarë të rastit të fundit, kur është hapur konkursi për punësim në Policinë e Kosovës, mbi 16 mijë të rinj kanë aplikuar për 300 vende pune.

Ky është indikator që ne kemi rini të shëndoshë, të aftë dhe të nevojshme për punë.

Rini që alternativë të saj e ka Kosovën, por që ky rast tregon faktin që të rinjtë tanë nuk kanë vende pune.

Unë ju ftoj që ta përkrahini, ju ftoj që ta harmonizojmë këtë rezolutë nga të gjitha partitë politike që janë këtu në këtë sallë.

Por, përveç kësaj rezolute dhe rezolutave të tjera që i kemi dhe po i hartojmë në vazhdimësi edhe shumë e shumë letra të tjera. Unë ju ftoj që seriozisht ta kthejmë kokën kah rinia jonë. Fatmirësisht, në të kaluarën, gjatë kohës sa kam qenë deputet, kam hasur në mirëkuptim edhe me ministrin e Kulturës, zotin Kujtim Gashi, dhe kemi arritur që t'i iniciojmë disa prej projektligjeve, siç është atë që e përmendi zoti Rekalju, vullnetarizmi, siç është mosha, platforma për punësim e tjera, por besoj që do të kemi bashkëpunim edhe më të thellë, bashkëpunim edhe më të mirë me Qeverinë e Kosovës, në mënyrë që Kosova, Qeveria dhe Kuvendi ta kthejnë kokën kah rinia jonë.

Nëse nuk bëhen këto, nëse shteti ynë nuk mendon seriozisht pa humbur kohë për shfrytëzimin e potencialit të të rinjve tanë, atëherë s'do të mund t'i ndalim ata në kërkim të perspektivës në vendet e tjera. Atëherë, ne po i tradhetojmë ata. Po ua vrasim shpresën dhe vetë po i shtyjmë të ikin nga Kosova. Nuk dua të besoj që vendi ynë është i pajetueshëm. Një shtet pa rini është një shtet pa të ardhme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hoti! Fjalën e ka zoti Adem Mikullovc, i pari është në radhë dhe e ka kërkuar fjalën.

ADEM MIKULLOVCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshtendës të gjithë deputetët,

Dua të them që të flasësh sot për gjendjen e rinisë të Kosovës, të debatosh për të, është e dhimbshme. Është e rëndë. Sa është plagë e thellë të zhdukesh në luftë, sa është plagë e thellë për të pagjeturit e luftës, mendoj që është akoma ndoshta edhe më e thellë plaga e rinisë së Kosovës.

Të tërheq një paralele ndërmjet rinisë sime së gjeneratës time, e të disave pas meje, nuk mund të krahasohen. Ne kur i kemi kryer shkollat që i kemi kryer, që e kemi pas ndërmend t'i kryejmë, e i kemi kryer, e kemi zgjedh vendin e punës, "s' dua këtu, por dua atje; s' dua atje, por dua këtu". Sot punësimi është bërë një emër i imagjinuar. A e dini që mosperspektiva e rinisë së Kosovës ndikon direkt në natalitetin e kombit. Njëherë rinia s'po mund të martohen e të krijojnë familje. Si të martohet një djalë i ri, të dalë nga banesa e babës, të marrë banesë me qira, të krijojë familje, e papunë? Si do ta bëjë ai këtë? Është shumë tragjike, shumë e mjerë dhe ç'është më e zeza, unë personalisht nuk di as të tregoj me gisht e të them këtu është faj, ose këtu është

perspektiva, këtu është mënyra, këtu është rruga. Thjesht, e pashpresë, rrugë pa dalje, rrugë qorre! Mua kjo po më dhemb më së shumti mbi të gjitha. Ky djali tha para meje, ky bashkëbiseduesi Andini a si e ka emrin, pika kryesore prej që jam në Kuvend, edhe unë mund të them që kjo është një nga pikat kryesore në këtë Kuvend.

Unë për përfundim dua ta them vetëm një shembull. Para 2-3 muajve Policia ka shpallur konkurs për 200-300 vende pune. Dhe, a e dini çfarë? Kanë konkurruar rrumbullak 17 000 kandidatë. 17 000 të rinj, të aftë, të shëndoshë kanë konkurruar për 200 vende pune. 70%, qysh ma dha informatën një inspektor, janë me fakultet në xhep. Do ta kemi Policinë më të arsimuar në Evropë, diku po i bie 85 kandidatë për një vend pune. Shikoni ku na ka ardhur puna!

Hyni në cilëndo kafene, restorant, shitore, do të ju shërbejë juristi, ekonomisti, e çka e di unë, politologu, krejt njerëz të arsimuar, krejt papunë, krejt me duar në xhepa. Unë nuk e di me të vërtetë s'kam qejf të flasë fjalë të kota, por vërtet nuk di ku të tregoj me gisht, nuk di të tregoj, të them këndeje është zgjidhja, ky është problemi, kështu mund ta zgjidhim këtë problem. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Frashër Krasniqi, e ke fjalën.

FRASHËR KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Një shoqëri mund të vlerësohet bukur shumë nga qëndrimi dhe gjendja në të cilën e ka rininë dhe shtresën më të moshuar të saj, sepse e para flet për aktualitetin se çfarë kushtesh ekonomike ka, sociale, arsimore e tjera në vendin, në të cilin po jetojmë, kurse e dyta flet për perspektivën se çfarë kushtesh krijohen për ata njerëz që kanë vendosur të qëndrojnë e të plaken në Republikën e Kosovës.

Dhe, fatkeqësisht, shteti ynë dhe shoqëria jonë kanë dështuar në të dy këto pikat. Ne nuk kemi as kushte elementare për rini të shëndoshë, energjike e të punësuar, dhe as kushte për pleqëri, për njerëzit të cilët vendosin të plaken në shtetin tonë dhe të cilët lihen në kushte jashtëzakonisht të rënda me pensione fyese dhe që nuk i mbulojnë as kushtet elementare të jetës së tyre. Dhe, nëse flasim për rininë, pikërisht këtu qëndron problemi që ta parashtrijmë çështjen thjesht si debat për rininë, sepse nuk mund të flasim për rininë pa folur për ekonominë, pa folur për papunësinë, për gjendjen e arsimit, rrjedhimisht pra pa folur për shtetin tonë në përgjithësi - kah po shkon ky shtet, në përgjithësi? E kemi një shtet, i cili e ka papunësinë më të madhe në rajon dhe këtë e dimë të gjithë, por nuk punon askush për ta rregulluar këtë punë. Asnjë qeveri nuk bën diçka për ta rregulluar këtë punë dhe pastaj ankohen që po na ikën rinia, po na ikën pjesa më e arsimuar e vendit.

Normal që ikën pjesa më e arsimuar e vendit, normal që ikën rinia, nëse nuk ia ke krijuar kushtet për të gjetur vend punës për ta pasur një jetë më të mirë. E kemi një shtet i cili është pranë kolapsit sa i përket sistemit të arsimit. Me universitetet ku diplomat blihen, ku nuk ka cilësi, ku nuk ka literaturë, ku nuk ka ligjërues, ku ligjëruesit më të mirë faktikisht po ashtu ikin nga ky vend. Pra, po dua të them që ikja e të rinjve është problem i shpartallimit të përgjithshëm të shoqërisë në vendin tonë. Nuk ka shoqëri funksionale, nuk ka shtet funksional këtu, prandaj njerëzit e shohin zgjidhje të ikin nga Kosova. Në këtë kuptim, unë mendoj që problemet e rinisë janë problemet e të gjithë qytetarëve të Kosovës, janë probleme që është zor të shtrohen dhe të zgjidhen nga një qeverisje, nga një mendësi qeverisëse, e cila nuk është e orientuar kah zhvillimi ekonomik dhe kah mirëqenia sociale.

Ne mund të flasim, ne mund të bëjmë rezoluta, normalisht që Grupi Parlamentar i PSD-së do ta miratojë, do të votojë për këtë rezolutë, mirëpo duhet ta kemi parasysh që pa një shtet të orientuar kah zhvillimi ekonomik, socialdemokracia, mirëqenia sociale, nuk do të ketë perspektivë këtu për asnjë kategori shoqërore, qoftë për rininë, qoftë për pensionistët, qoftë për gratë, qoftë për burrat e këtij vendi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Teuta Haxhiu, në emër të AAK-së, e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë e kolege deputete,

Në këtë debat të thirrur sot, edhe pse nuk është për herë të parë, do të kishte mirë të ishte këtu ministri i Kulturës, sepse ka kaluar saktë një vit, më 13 shkurt 2017, kur ne në Kuvendin e Republikës së Kosovës e kemi pasur raportin e Komisionit për Arsim e Kulturë për monitorimin e Ligjit për rininë, e që në atë raport që e ka nxjerrë komisioni dhe ia ka sjellë Kuvendit janë miratuar gjithsej 11 rekomandime. E në këto 11 rekomandime, sikur të ishim ndalur ne si deputetë, e sidomos ne anëtarët e Komisionit për Arsim, ku është edhe kolegu Rekaliu anëtar, në secilin prej rekomandimeve veç e veç, të ndalemi dhe ta shohim se çfarë ka bërë Ministria e Kulturës në këtë drejtim.

Pa dashur të ndalem në të gjitha pikat me vëmendje, i shikova, sepse personalisht nuk i kam ato rekomandime, por e dëgjova zotin Rekaliu, janë pak a shumë të përgjithshme, por në fund të fundit është shumë me interes, edhe nëse për çdo vit ne mbajmë debate për rininë, asnjëherë nuk është mjaft.

Mirëpo, për t'i bërë monitorim më të saktë secilit prej rekomandimeve, e në këtë rast edhe Qeverisë, kur të them të Qeverisë - ministrisë përkatëse, sepse rekomandimi i parë, e që ka qenë kërkesë e vazhdueshme e shumicës, por në veçanti pas një debati që e kemi pasur me të rinjtë nëpër shumë komuna, kërkesa e tyre e vazhdueshme ka qenë që të nxirret një ligj i veçantë për vullnetarizmin, e që me propozimin tim ka qenë pika e parë e këtyre rekomandimeve. Pra,

Qeveria e Republikës së Kosovës të hartojë ligj të veçantë për punën vullnetare. Prandaj, në këtë drejtim, e kisha lutur secilin që të bëjmë më shumë kur flasim për këtë ligj, flasim për praktikën që të rinjve tanë nuk u mundësohet, pra nuk u njihet si përvojë pune, që i pamundëson, ose në fakt në start i diskriminon kur ata aplikojnë edhe me kualifikime, të mos të them që ndodh shumë shpesh që i kanë mbi 2 fakultete të përfunduar, por nuk u lejohet mundësia e punësimit, ngase në start ata diskriminohen se kërkohen 3 vjet përvojë pune.

Dhe, në këtë drejtim, ne mund t'u ndihmojmë të rinjve, ndryshe jo, prandaj ejani të punojmë në këtë drejtim të gjithë që ta hartojmë edhe ligjin, nëse Qeveria ose ministria nuk na e sjellin.

E dyta, Qeveria e Republikës së Kosovës të nxjerrë akt nënligjor sipas nenit 6, paragrafi 2, me të cilin përcaktohen ministrinë përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të ligjit për rini. Nënkrjetari i Kuvendit, normalisht që e di shumë më mirë këtë pikë sidomos, por sinqerisht janë shumë rekomandime me bazë, të cilat secila veç e veç, në qoftë se ndalemi dhe i bëjmë presion ministrisë, ne do të mund ta bënim hapin më konkret sesa rekomandimet e përgjithshme që u thanë pak më herët.

Nën tre, Ministria e Kulturës ta themelojë Komisionin për punë vullnetare sipas nenit 11 të Udhëzimit Administrativ 01/2016, për punën vullnetare të të rinjve. Pra, edhe në këtë drejtim ende nuk e dimë se çka ka ndodhur me këto pika, me këto rekomandime. Ministria e Kulturës ta themelojë komisionin e përhershëm për edukim joformal të të rinjve, sipas nenit 7 të Udhëzimit Administrativ 12/2010 për edukimin joformal të të rinjve.

Pastaj janë edhe shumë ministri të tjera që atakohen dhe, mbi të gjitha, janë qendrat rinore, që janë në komuna, të cilat nuk janë të financuara apo komunat nuk kanë buxhet për t'u ndarë dhe ne do të duhej të punojmë shumë më shumë që kur të vijë rishikimi i buxhetit të ndajmë, edhe pse ka ndarje, domethënë ka buxhet më shumë në këtë Qeveri për të rinjtë, mirëpo ne do të duhej që bashkërisht të punojmë që të kërkojmë buxhet për rininë gjatë rishikimit të buxhetit.

Pastaj, në bashkëpunim me këta këshilla, vetë ministria ta organizojë konferencën vjetore për rininë sipas Udhëzimit Administrativ 9/2010 për përgjegjësitë dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të këshillave të veprimit rinor në Kosovë. Do të thotë, të gjitha këto informata ne do të duhej t'i dimë dhe mbi të gjitha përgjegjësia jonë kryesore vjen në Komisionit për Arsim, e ku është edhe zoti Rekalju.

Pastaj, pika 8, që problemi kryesor që e kanë këto organizata, mbi të gjitha të rinjtë nëpër komuna, janë vetë komunat, pra sigurojnë financim të rregullt për qendrat rinore dhe këshillat e veprimit. Mirëpo, komunat nuk mund të kenë buxhet aq sa kërkohet në qoftë se nuk e kemi buxhetin që mund t'i delegohet nga ministria apo të kemi kod të veçantë, që do të ishte si pasojë, ose si presion yni si deputetë të Parlamentit të Kosovës, në veçanti për rininë.

Pastaj, lidhjet që kanë komunat me ministritë përkatëse në mënyrë që të kemi shumë më shumë prej projekteve rinore, të jenë prioritet. Mirëpo, sinqerisht, nuk është që rinia jonë është që sot, ose para një viti që janë bërë të rinj, por fluksi më i madh fatkeqësisht që ka ndodhur më 2015, kur e kanë lëshuar krejt Kosovën mbi 100 000 qytetarë, e shumica prej tyre të rinj, fatkeqësisht shumica prej tyre po bredhin rrugëve edhe sot si pasojë e atij fluksi. Mirëpo, kisha dashur që kurrë të mos ndodhë, as të mos e kemi një tendencë të tillë kurrë në Republikën e Kosovës, mirëpo për të bërë shumë më shumë për të rinjtë, edhe një herë po them, do të duhej që në radhë të parë t'u japim mundësi punësimi. Kur them mundësi punësimi, do të duhej të heqim dorë nganjëherë edhe prej privilegjeve që mund të kemi edhe ne si njerëz të politikës, me 2 e më shumë vende pune dhe moslejimit shumë herë të hapjes së vendeve të punës kur dikush punon në dy apo tri vende, ngase nuk jemi supermen, e nuk lejohet pra që t'i jepet mundësia një të riu që është i kualifikuar dhe normal që pamundësia e hapjes së vendeve të punës, përderisa ne tentojmë të i uzurpojmë shumë vende tjera të punës, do të duhej të japim shembull në radhë të parë ne si Parlament i Republikës së Kosovës. E kam thënë edhe një herë, po e them në vazhdimësi.

Pastaj, do të duhej pra të shohim edhe te profesorët, sinqerisht profesorët nëpër universitete dhe kolegje private, të cilët janë të angazhuar në shumë prej këtyre institucioneve dhe sinqerisht po e them që pasojat më të mëdha i kanë vetë studentët, ngase profesorët nuk mund të jenë të rregullt, por gjithë ligjëratat mbeten të mbahen nga asistentët dhe ç'është më e keqja sipas informatave që kam, edhe nga asistenti i asistentit, ose ndihmës/asistent. Është një diçka, të mos them, e zbuluar së fundmi, por edhe kjo po ndodh. Edhe asistenti nuk ka shumë kohë se është i një profesori dhe është i angazhuar në shumë kolegje apo degë të tjera në universitetet, cilado qofshin, dhe në këtë rast ia lejon mundësinë ndihmës/asistentit. Kjo po ndodh pra me studentët tanë.

Pra, edhe një herë, Ligji për punën vullnetare dhe për t'ia njohur të riut praktikën që të mos e diskriminojmë në start kur hapet një konkurs, është prioritet yni si Kuvend i Republikës së Kosovës. Buxheti i ndarë gjatë rishikimit të buxhetit për të rinjtë, ejani të punojmë bashkë, ta bëjmë amendament dhe ju them që jo vetëm si deputete, por edhe në emër të grupit, që do të ju përkrahim. Pra, në veçanti për rininë dhe të kemi buxhet më shumë për rininë dhe normalisht t'u ndahet edhe komunave dhe pastaj të rinjtë, në radhë të parë, së pari aplikojnë me shumë projekte nëpër komuna, por pse jo edhe në ministri. Pra, të jemi bashkë, jo vetëm për të bërë debat, por edhe kur vjen rishikimi i buxhetit, të kemi buxhet për rininë.

Megjithatë, duke i përmendur këto rekomandime, unë synoj që disa prej këtyre të jenë shumë më të forta në fund të debatit nga zoti Rekalii, t'i fuzionojmë të gjitha së bashku dhe t'i nxjerrim dy apo tri që janë me më shumë prioritet, e të mos bëjmë vetëm numër të rekomandimeve, sepse e kemi përvojën që kur janë në numër shumë më të madh vërtet po mbeten vetëm diçka, të mos them buqetë dëshirash. Pra, jam këtu për t'i harmonizuar rekomandimet në fund të debatit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Berisha, e keni fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Çështja për të cilën po debatojmë, unë mendoj që nuk duhet të shikohet si e ndarë nga problematika e përgjithshme në të cilën po kalon Kosova dhe shoqëria në përgjithësi, por meqë në fokus është rinia, unë do t'i them 2-3 fjalë natyrisht për rininë, edhe për respekt të iniciuesit të këtij debati, pasi është vetë i ri, dhe natyrisht është edhe i ri edhe në Kuvend, edhe kjo iniciativë i duhet për CV-në në të ardhmen. Por, sido që të jetë, mendoj se problemi duhet të shijohet në thelb. Kur thashë problematika e rinisë nuk duhet të shikohet si e ndarë nga problematikat që i ka shoqëria, desha të dal te ajo se ne që nga paslufta si shtet i ri, veçanërisht pas shpalljes së pavarësisë nuk e kemi pasur një qasje serioze në fenomenet që kanë filluar të kulmojnë dhe të bëhen shqetësuese në Kosovë, fenomene të cilat fillimisht e prekin rininë, por gjithsesi edhe gjeneratat tjera.

Duke heshtur, ose duke u bërë të verbër karshi fenomeneve shqetësuese në Kosovë, ne e kemi situatën alarmante në përgjithësi, por veçanërisht gjeneratat e reja me fenomenin e drogës për të cilën kam folur në njërin nga seancat e kaluara, me prostitucionin, me alkoolin e dukuritë tjera, për çka mendoj se Ekzekutivi i vendit, e në përgjithësi klasa politike, duhet t'u rikthehen si probleme bazë për zgjidhjen e shumë problemeve tjera në shtigje afatgjate, sepse llogaris që nëse tash nuk ndërhyjmë, dyshoj që dikur do të bëhet vonë dhe shtetit do t'i kushtojë shumë shtrenjtë mosmarrja e masave ndaj disa fenomeneve për të cilët fola.

Largimi i të rinjve vërtet është jo vetëm shqetësues, por edhe pikëllues, sepse i ka prekur të gjitha familjet dhe unë do ta bëj një krahasim nga largimi i të rinjve në kohën e viteve '80-'90 dhe largimi tash që po ndodh. Atëherë, kur ne jemi larguar kanë qenë disa arsye tjera, ndërsa tash nuk ka kuptim që të rinjtë të largohen për shkak të papunësisë, të gjendjes së rëndë sociale, të pamundësisë për shkollim adekuat, e për çështje tjera. Mendoj që 14 pikat që zoti Rekalu i tha janë pika, të cilat e kanë burimin te ligjet të cilat nuk po zbatohen, ose te ligjet, të cilat duhet rishikuar me urgjencë. Unë mendoj se ndalja e fenomenit të largimit duhet të bëhet nëpërmjet ligjeve, e jo nëpërmjet rezolutave. Më vjen keq, por duhet ta them diçka që e kam thënë edhe në mandatin e kaluar, rezolutat në shumicën e rasteve, ose 99,9% janë rezoluta koti, se as që i lexon kush, e jo më dikush të ndihet obligues ndaj tyre. Duke e ditur këtë gjendje, mendoj që më mirë është që t'u rikthehem ligjeve, të cilat e prekin rininë, por edhe shoqërinë në përgjithësi. Domethënë, Ligji për sportin, Ligji për arsimin, Ligji për kulturën, Ligji i punës, me të cilat do t'u jepet përparësi gjeneratave të reja dhe kur jemi te Ligji i arsimit, ne mendojmë që si shoqëri duhet të rikthehem në atë që u bë gabim strategjik që nga paslufta, sepse kemi nxjerrë në mënyrë serike të rinjtë me diploma, të cilët në fakt nuk kanë vend në shoqëri, sepse nuk është bërë planifikimi sa duhet dhe edukimi i të rinjve veçanërisht në fushën e profesioneve, për të cilat shteti i ri i Kosovës ka nevojë.

Gjithsesi, për ta inkurajuar, do ta mbështetim zotin Rekaliu, por dyshoj se edhe kjo rezolutë me këto 14 pika ka për t'u pluhurosur diku në sirtarët e Kuvendit, apo edhe të Qeverisë, dhe plagët për të cilat po flasim të gjithë deputetët, që e përfshijnë edhe rininë, do të vazhdojnë të lëngojnë edhe në të ardhmen dhe ne si shoqëri gjithsesi do ta paguajmë shumë shtrenjtë këtë gjendje. Vetë fakti kur flasim për një çështje shumë të rëndësishme dhe mungon i gjithë Kabineti qeveritar, ky është një tregues sesa do të trajtohet nga Ekzekutivi dhe sa Ekzekutivi do të merret seriozisht me këtë çështje që po e debatojmë.

Prandaj, të nderuar kolegë deputetë,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,

T'i rikthehem vetvetes, shtetit për të cilin është bërë shumë dhe disa nga gjërat dytësore të mos i vëmë prioritet i prioriteteve, sepse duke mos u marrë me atë që është fundamentale në shoqëri, ka rrezik që shoqëria të degjenerojë deri në skajshmëri dhe ky degjenerim do t'u kushtojë edhe shumë gjeneratave pas neve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! LDK-ja nuk keni paraqitur listë, sipas renditjes është Korab Sejdiu i pari.

KORAB SEJDIU: Të nderuar qytetarë,
Kolegë të nderuar,

Ne fillimisht duhet ta falënderojmë Fidanin për ngritjen e kësaj teme jashtëzakonisht të rëndësishme, por më duhet të them se kur flasim për rininë, ne shpeshherë flasim sikur të flasësh për diçka që është një grup i marginalizuar, do të thotë një 2-3%-sh, 4%-sh... të popullatës. Po gjë që qëndron e vërtetë, është fakti se pjesa dërrmuese e popullatës sonë konsiderohen të rinj dhe në asnjë mënyrë nuk mund të diskutojmë për rininë duke folur me teori, ose duke folur për diçka të skajshme, pra duhet të flasim më shumë për veprime konkrete, që ne duhet t'i ndërmarrim në të gjitha sferat që prekin popullatën tonë, përkatësisht rininë si pjesë shumicë e popullatës së Kosovës.

Nuk e di sa keni pasur ju rastin të flisni me të rinj dhe sa i pyetni ata, mirëpo shpeshherë kur takohem me ta i pyes se ku e shohin veten pas disa vitesh, 4-5 viteve a 10 viteve, dhe është një fatkeqësi e madhe që shumica prej tyre përgjigjen e kanë pothuajse të menjëhershme, që e shohin veten diku jashtë Kosovës. Nëse ky trend vazhdon besoj që ne nuk do të kemi më problem me rini, sepse do të zhduket rinia, do të shkojë diku tjetër dhe ne do të mbetemi një vend pa perspektivë.

Prandaj, unë besoj se duhet të ndërmerren masa urgjente në të gjitha sferat, përfshi këtu veçanërisht ato që në mënyrë të menjëhershme prekin rininë tonë e ato janë arsimi, shëndetësia, por edhe sundimi i ligjit, pasi që të gjitha tjerat janë të pamundshme nëse nuk kemi së paku një

rregullativë, e cila zbatohet dhe i jep rinisë sonë gjasa fer dhe gjasa të drejta, sa i përket qasjes, qoftë në punësim apo edhe çfarëdo mundësie tjetër.

Unë vërtet jam i shqetësuar që ne vazhdojmë të debatojmë për shumë gjëra, mirëpo nuk po shihet se vërtet vendimmarrësit tanë janë të fokusuar dhe të përkushtuar që të përmirësohet gjendja e qytetarëve tanë në përgjithësi, përfshi këtu edhe rininë. Kjo qasje jo serioze besoj se do të na kushtojë shumë. Ne kemi mundësi të shumta, qoftë nga Parlamenti, nga ekzekutivi, apo edhe institucionet tjera, që të bëjmë kontributin tonë. Dua të përmend një nismë të cilën kohëve të fundit jam duke e punuar dhe shpresoj që kur të jetë e gatshme që të vijë këtu para juve, kolegë, të gjejë edhe përkrahjen e juve. Ajo është themelimi i një qendre që do t'i mbështesë të rinjtë tanë që janë të interesuar për studime jashtë vendit, që atyre t'u jepet mundësia ta kenë atë qendër si udhëzues, jo vetëm për procesin e aplikimit, por edhe për bursa, që janë në tregun arsimor nëpër Evropë dhe Botë. Pikërisht në bashkëpunim me KDI-në kemi bërë një studim dhe jemi tash në fazën tjetër, pra që shpresojmë të vijë në formë të një projektligji me të cilin do të arrihet kjo çështje.

Besoj se do të ketë edhe përkrahjen e juaj, prandaj besoj se secili prej nesh ka mundësi të kontribuojë nga këndvështrimi dhe nga pozita që mbajmë. Unë shpresoj që të gjithë e marrim këtë si një çështje shumë serioze, pra të ardhmen e rinisë sonë para se të bëhet tepër vonë, dhe i shohim ata e gëzohemi për të arriturat e tyre, siç po gëzohemi për shumë prej tyre, por të cilët fatkeqësisht ato të arritura i kanë mbërrirë vetëm pasi që kanë dalë prej Kosove dhe i kanë shfrytëzuar kushtet që ua ofrojnë shtetet tjera, ndërsa kemi një numër të madh të tyre që nuk mund t'i arrijnë ato suksese, sepse vendi ynë nuk u ofron asgjë. Faleminderit!

Edhe një herë, ju thërras për një mobilizim të përgjithshëm, që të ndihmojmë rininë tonë dhe natyrisht, si një fillim, edhe të jetë përkrahja e atyre pikave që i propozoi Fidani. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Evgjëni Thaçi.

EVGJËNI THAÇI-DRAGUSHA: Faleminderit, i nderuar kryesues Haliti!

Përsëritje për të gjithë!

Në fakt, në një mënyrë ose tjetër, ne këtu flasim shpesh për rininë, sepse shumë shpesh flasim për temat që i përkasin edhe rinisë, si për arsimin, ekonominë, papunësinë, shëndetësinë, kulturën, artin, sportin, e të tjerë.

Është mirë që sa herë që flasim për zhvillimin në përgjithësi ne e krahasojmë vendin tonë me vendet më të zhvilluara ekonomikisht, si në Evropë, ashtu edhe në Botë. Ata janë në një shkallë të zhvillimit e ne jemi në një shkallë tjetër. Kjo të thotë se megjithatë diçka është bërë, mirëpo për këtë më kompetentë janë kolegët tanë deputetë, që kanë qenë ministra të Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Megjithatë, do të ishte mirë që ne të jemi realistë dhe të flasim duke pasur parasysh një

serë rrethanat që ndikojnë në gjendjen e rinisë dhe të çdo pjese të popullsisë në përgjithësi dhe të marrim si krahasim edhe vendet e rajonit ku ne bëjmë pjesë.

Kosova është vendi i dalë nga lufta dhe pasojat e saj, sigurisht se do të vërehen edhe për një kohë të gjatë. Është vend, shtetësia e të cilit sfidohet çdo ditë në mënyra të ndryshme dhe kjo do të thotë, se temat e përditshmërisë sonë, siç është kjo që po debatohet sot, nuk po mund të gjejnë përkushtimin e duhur nga institucionet përgjegjëse. Megjithatë, duke pasur parasysh këtë fakt, pra si vend i dalë nga lufta dhe në proces të shtetndërtimit, ne nuk mund të mohojmë faktin se është bërë shumë në disa drejtime që lidhen me mirëqenien e rinisë. Për shembull, është bërë shumë lidhur me infrastrukturën shkollore. Secili nga ne edhe nëse nuk i përkasim lëmit të arsimit e dimë se Kosova nga një vend me sistem të arsimit të rrënuar totalisht tash ka një infrastrukturë të mirë shkollore, qoftë të arsimit të ulët apo të lartë.

Tash ne flasim për problemet tjera, të cilat i kanë edhe shtetet që kanë një traditë të gjatë të zhvillimit të arsimit dhe nuk kanë kaluar nëpër sfidat që i kemi kaluar ne.

Unë pajtohem plotësisht se ekziston deficit në sektorin e arsimit, deficit i cili ndikon në aftësinë e studentëve, që suksesshëm të konkurrojnë në tregun e punës dhe për këtë duhet një strategji afatgjatë, në mënyrë që shkollat tona të mos prodhojnë më shumë të diplomuar nga disa profesione të caktuara, për shembull, juristë ose ekonomistë, sesa që tregu i punës ka mundësi të absorbojë në të ardhmen. Do të duhej që profesionet deficitare të forcohen dhe përkrahen në mënyrë që të arrihet një lloj balance dhe stabiliteti në marrëdhëniet arsim-vende të punës. Pra, sistemi edukativ arsimor duhet t'i përshtatet tregut të punës.

Është konstatuar tashmë që papunësia është shqetësim kryesor i të rinjve. Niveli i lartë i papunësisë së të rinjve shihet si pasojë direkte e kontekstit ekonomik të vendit. Jemi të vetëdijshëm se gjendja e rëndë ekonomike çon kah kriminaliteti, përdorimi i substancave narkotike, demobilizimi dhe emigrimi i njerëzve inteligjentë dhe me kualifikim të lartë nëpër vende tjera, që u ofrojnë mundësi, pra ajo që quhet brain-drain. Besoj se të gjithë ne jemi të lindur dhe të rritur në një sistem, gjatë të cilit jemi mësuar se shteti e ka për obligim të na ofrojë vende pune. Shteti modern ofron një numër të caktuar vendesh pune, aq sa i duhen për funksionimin e tij, mirëpo më shumë duhet të merret me ofrimin e lehtësirave për sektorin privat, në mënyrë që ky sektor të jetë punëdhënës kryesor në vend. Mendoj se forcimi i sektorit privat është çelësi në këtë moment. Lehtësirat fiskale dhe zbatimi i Ligjit të punës do të mund të drejtonte vëmendjen e të rinjve në fusha të ndryshme të ekonomisë, të cilat zhvillohen nga ky sektor, vëmendje e cila për momentin është kryesisht e drejtuar kah sektori publik.

Shumë të rinj mbarojnë shkollimin, po nuk janë shumë të trajnuar sa për të qenë konkurrentë në tregun e punës, një fakt ky që komplikohet akoma më shumë me diskriminimin që u bëhet grupeve të caktuara, sidomos grave. Nga 44,9% e popullsisë së punësuar, vetëm 12,5% e tyre

janë femra, ose gra dhe kjo është mjaft shqetësuese. Në këtë përqindje të lartë të papunësisë së grave ndikon edhe numri i vogël i kopshteve publike, si dhe kushtet e pranimit të fëmijëve në këto kopshte. Është përmendur disa herë nga kolegët e mi nga Prizreni se ky qytet i dyti për nga popullsia në Kosovë nuk ka çerdhe publike dhe kjo në përgjithësi ndikon direkt në papunësinë e nënave të reja, sepse ato duhet t'i përkushtohen plotësisht vetëm kujdesit ndaj fëmijëve dhe familjes, edhe pse janë të kualifikuara për vende të ndryshme të punës dhe punësimi i tyre do të ishte shumë domethënës në rritjen e prosperitetit të familjes dhe të shoqërisë në përgjithësi.

Sot rinia kosovare duhet të inkurajohet, që të jetë shumë më krijuese dhe më sipërmarrëse për të krijuar mundësi për vetëpunësim dhe punësim të tjerëve. Qeveria e Kosovës dhe ministrinë përkatëse duhet t'i kushtojnë kujdes të veçantë këtij aspekti dhe të mbështesë të rinjtë krijues me idetë e biznesit, të cilët do të krijojnë vende të qëndrueshme të punës.

Në fund, dua të theksoj, dua të përmend, që rishtazi Kuvendi i Kosovës, nëse s'është përmendur nga kolegu Rekaliu, pra Kuvendi i Kosovës ka themeluar grupin e deputetëve të rinj, të kësaj legjislature ku bëj pjesë edhe unë dhe besoj e shpresoj, se të gjithë pa dallim politik do të ndikojmë dhe të ndihmojmë që të paktën shqetësimet e të rinjve t'i sjellim në Kuvend dhe në këtë mënyrë, sado pak, të ndikojmë në të mirë të të rinjve tanë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Pacolli, urdhëro!

FITORE PACOLLI: Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Kjo kërkesa për debat për gjendjen jo të mirë të rinisë po lë pak mundësinë të mendojmë se gjendja qenka jo e mirë. Pra, në vend të asaj se gjendja është shumë e rëndë. Do të duhej të ndërrohej, jo shumë e mirë, por gjendje e rëndë dhe shumë e rëndë, pra duhet t'i ndryshojmë fjalët.

Sido që të jetë, është mirë që po debatohet për rininë, por para se të debatojmë është mirë që të ndalemi dhe të pyesim, se çfarë kemi bërë brenda këtyre njëzet viteve për rininë, për të rinjtë, pra çka ka bërë kjo Qeveri e ky Kuvend dhe çka kanë bërë qeveritë tjera dhe kuvendet tjera që kanë udhëhequr në këtë vend.

Edhe sot, sikurse në plot debate tjera, do të mund të dalin kërkesa konkrete për Qeverinë, por Qeveria në këtë Kuvend i ka kukullat e veta, të cilët do të votojnë kundër dhe jo për të mirën e qytetarëve, por për interesat dhe të mirën kësaj qeverie të pakicës dhe për të mirën e tyre personale. Hiç më larg se sot, 39 deputetë të PDK-së, Nismës, AAK-së, votuan kundër politikave për të krijimin e vendeve të reja të punës përmes investimeve direkte në zhvillimin e prodhuesve vendor, duke e ditur që papunësia në këtë vend është shumë e lartë dhe ka prekur veçanërisht të rinjtë. Kosova vazhdon të mbetet vendi më i varfër në rajon.

Zonja Thaçi, posa tha se shteti modern nuk ka për detyrë të krijojë vende të reja të punës, i ka vetëm disa sektorë dhe duhet të krijojë politika. Mua më vjen keq prej qytetarëve që kanë votuar për partinë demokratike dhe partitë tjera që përbëjnë koalicion, sepse gjatë zgjedhjeve kanë premtuar 200 mijë deri në 300 mijë vende të reja të punës. Atëherë, kush po krijuaka vende të reja të punës? Atëherë, kjo qenka gënjeshtër që ju po ua bëni qytetarëve. Votuat edhe kundër Ligjit për mbrojtjen e prodhimeve vendore, po ashtu votuat edhe kundër sigurimeve shëndetësore, që kërkuam që të gjithë qytetarët e Kosovës të kenë mundësi në këto sigurime.

Rreth 30% e popullsisë nuk arrijnë të marrin shërbime të nevojshme shëndetësore, edhe këtu janë të rinjtë. Një numër i madh i të rinjve na vdesin nga leukemia çdo vit dhe asgjë nuk bëhet nga kjo Qeveri për t'i shpëtuar këta, ose për të investuar në shëndetësi, për të pasur kushte të nevojshme për shërimin e tyre. Votuat edhe kundër investimeve për hapjen e çerdheve të reja të nevojshme, votuat edhe kundër investimeve në shkolla profesionale dhe ndërlidhjen e tyre me nevojat e tregut vendor dhe ndërkombëtar, e tani po flasim për gjendjen e rinisë!? E tani po premtoni mënyrën se si do të bëhen këto investime dhe çfarë do të duhet të bëhet!?

Pra, duhet të marrim hapa konkretë që sot, që sot ju morët hapa kundër rinisë. Që sot votuat kundër çerdheve, kundër investimit në shkolla profesionale, kundër sigurimeve shëndetësore, kundër krijimit të vendeve të reja të punës.

Po flasim në këtë kuvend dhe po i drejtohem, kujt? Qeverisë? Pra, kur kryeministri, presidenti, kryetari i Kuvendit, disa ministra e disa deputetë, të cilët marrin vendime për të rinjtë dhe fëmijët e këtij vendi, nuk dërgojnë fëmijët e tyre në shkollat fillore dhe të mesme publike të këtij vendi, por zgjedhin shkollat private dhe universitetet në shtete të jashtme. Pra, është çudi se si vetëm fëmijët e politikanëve arrijnë të fitojnë bursa dhe të shkojnë jashtë shtetit!

Ish-kryeministri britanik David Cameron në vitin 2016, i cili pati deklaruar se është çmenduri nëse një politikan dërgon fëmijët e tyre në shkolla private, sepse shteti duhet të investojë që të kenë shkolla të mira publike, por këtu tek ne vetëm politikanët i dërgojnë fëmijët në shkolla private, jo në ato publike. E këtu, edhe një herë do ta demantoj zonjën Thaçi, e cila tha se kemi shkolla shumë të mira dhe infrastrukturë të mirë. Atëherë, më trego pse kryeministri, pse presidenti, pse zyrtarët e juaj të partisë suaj, i dërgoni fëmijët në shkolla private, nëse shkollat publike qenkan kaq të mira?

Pra, ky është një mesazh i qartë, edhe për presidentin, edhe për kryeministrin dhe kryetarin e Kuvendit, ministrat e deputetët, që duhet të tërheqin sa më parë fëmijët e tyre nga shkollat private e nëse u dhimbset e ardhmja e fëmijëve të tyre, dorëhiquni nga postet politike. Pra, lërinin njerëzit që mendojnë për të mirën e të gjithë fëmijëve, të gjithë të rinjve, të investojnë në shkolla publike. Është hipokrizi kjo, për sa i dërgoni fëmijët e juaj në shkolla private, në të njëjtën kohë merrni vendime për reformat në shkolla publike dhe për përgatitje të të rinjve për përfshirjen e

tyre në tregun e punës. Si mund ta përmirësojmë cilësinë e edukimit dhe kushtet e të rinjve në shkolla e universitete, kur fëmijët e tyre i mbajmë larg. Ata të cilët marrin vendime, kjo qeveri e pakicës, nuk ka më as legjitimitet të ndërmarrë vendime për edukimin e të rinjve të këtij vendi. Në të vërtetë, të gjithë prindërit sot do të duhej të ngritën dhe të kërkojnë përgjegjësi nga këta politikanë.

Është e pasinqertë të flisni këtu për të ardhmen e rinisë, kur shumica këtu kanë mundësi të zgjedhin shkollat alternative, ndërsa 90% e fëmijëve dhe të të rinjve duhet të ndjekin shkollat dhe universitetet, të cilat i keni shkatërruar ju. Ju e dini më së miri, se në çfarë gjendje janë shkollat publike, prandaj nuk u besoni shkollave publike dhe nuk i dërgoni fëmijët e juaj e pse të interesoheni në shkollat publike, kur ju u keni siguruar fëmijëve tuaj tiketën në shkollat dhe universitetet më të mira, si dhe tiketën për të ardhmen e tyre.

Shkollat publike nuk janë të mira për familjet tuaja, por janë të mira për fëmijët e prindërve, të cilët nuk kanë mundësi tjetër. Shkollat publike janë për të varfrit, ndërsa shkollat private janë për fëmijët tuaj, pra për të pasurit. Këtu kemi deputetë që kanë përkrahur dhe votuar ndërtimin e shkollave pa infrastrukturë themelore, pa sallë të edukatës fizike, pa hapësira rekreacioni, pa biblioteka e kënde leximi dhe pa kuzhina, e të mos flasim për ndryshimet pa plan në kurrikula, nëpërmjet të cilave e keni shkatërruar tutje arsimin.

Këtu kemi deputetë që kanë votuar kundër edukatoreve, pra të shtojmë numrin e edukatorëve për fëmijët me nevoja të veçanta dhe sot investuat kundër investimeve në çerdhe. Numri i fëmijëve që ndjekin mësimin parashkollor mbetet shqetësues, këtë edhe raporti i vendit e thotë, vetëm 18% të fëmijëve janë të sistemuar nëpër çerdhe e ky është izolimi i vërtetë. Pra, ky është izolimi që ua kemi bërë ne vet si shtet të rinjve tanë.

Unë u fokusova kryesisht në shkolla dhe në çerdhe. Ju mund të thoni, se çerdhet janë për fëmijë, jo për të rinj, por janë shkollat dhe çerdhet ato të cilat nëse nuk ofrojmë përmes tyre edukim cilësor, nga momenti kur fëmijët hedhin hapin e parë, nuk do të kemi edukim cilësor të tyre, as në nivelin fillor, as të mesëm e as atë universitar. Pa edukim cilësor nuk kemi, as zhvillim ekonomik e as vende të reja të punës për të rinjtë tanë. Këtë e kemi parë për njëzet vjet radhazi. Nuk di si nuk e mësuam këtë mësim tani!

Edukimi në Kosovë duhet të jetë prioritet, ndërsa as 5% e Buxhetit, paramendoni, më pak se 5% e Buxhetit ndahet për edukim dhe kjo shumë është vetëm për ta mbajtur në këmbë këtë sistem tashmë të rrënuar. Po, s'i intereson Qeverisë të rrisë buxhetin në këtë fushë, sepse fëmijët e tyre i kanë akomoduar në shkolla private dhe në universitete private dhe ato ndërkombëtare. Pra, unë kërkoj nga iniciuesi i këtij debati, që të fusë një rekomandim, pra rekomandimi kryesor është që të kërkojmë dhe ta bëjmë ligj dhe rregull në këtë vend, që të gjithë zyrtarët e lartë publikë, duke filluar nga presidenti, kryeministri, ministrat, deputetë, kryetarët e komunave e të gjithë me

radhë, t'u ndalohej dërgimi i fëmijëve në shkolla private, sepse këta politikanë nuk mund të investojnë dhe të vendosin për shkollat publike, përdërisa nuk e provojnë tek fëmijët e tyre. Ky është një rekomandim.

I dyti rekomandim që duhet të dalë tani, është shuma e buxhetit e cila ndahet për rininë dhe edukimin e rinisë, duhet jo të dyfishohet, po të pesëfishohet, sepse ndryshe ne kot flasim. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Fisnik Ismajli. Po, replikë!

EVGJENI THAÇI-DRAGUSHA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar, Kujtim Shala!

E nderuar kolege Pacolli,

Unë nuk do të bie në nivelin e juaj të diskutimit asnjëherë e as sot.

Unë vetëm si replikë do të ju bëj disa pyetje. Shpresoj që të më përgjigjeni.

E para, sa shkolla ka ndërtuar Komuna e Prishtinës në mandatin e kaluar, kur ju keni qenë pjesë e stafit të kryetarit të Komunës, dorë e djathtë e Shpend Ahmetit, tanimë nuk jeni? Sa nxënës kanë mësuar dhe mësojnë në të njëjtën klasë? E treta, a kanë shkuar fëmijët e kryetarit të komunës në shkolla e kopshte publike apo private? Dhe e katërta, më thuaj në cilin universitet publik ju e keni mbaruar masterin, universitet publik kosovar? Faleminderit!

KRYESUESI: Kundër-replikë, deputetja Pacolli.

FITORE PACOLLI: Niveli im i diskutimit është që të fokusohemi dhe të kërkojmë gjëra konkrete për qytetarët tanë, për fëmijët e këtij vendi, të kërkojmë shkolla, çerdhe dhe edukim cilësor.

Edukimin tim fillor dhe të mesëm e kam përfunduar në Prishtinë në shkollë publike. Edukimin universitar e kam përfunduar në Universitetin e Prishtinës për gjuhë dhe letërsi angleze, nëse po doni tu tregoj krejt? Universitetin bachelor dhe master i kam përfunduar në Angli, me para të cilat i kam fituar vetë, jo me bursë nga shteti. Këtu e përfundoj.

Sa shkolla ka ndërtuar komuna e Prishtinës? Për këtë arsye edhe kërkova që buxheti të trefishohet apo të pesëfishohet, sepse komunave nuk u ndahen mjaftë para për të ndërtuar shkolla, sado që duhet. Numri i fëmijëve nëpër klasë - kemi arritur që të kufizojmë numrin e fëmijëve nëpër klasë. Kemi krijuar kënde leximi, kemi hapur gjashtë çerdhe me bazë në komunitet, të cilat janë shumë më të mira edhe më të mirat ndoshta në vend. Dhe për pyetjen që

ia drejtuar, pyetët për kryetarin, është mirë që kryetari i Prishtinës ta japë përgjigjen, por mesa di unë, i ka dërguar në çerdhet publike. Faleminderit!

Edhe vetëm një shtesë, këtu tek çerdhet publike. Pasi që komunat nuk kanë mjaftë çerdhe publike, propozimi im ka qenë qysh nga fillimi, që të gjithë ata që kanë poste të larta dhe kanë paga të larta t'u kufizohet dërgimi i fëmijëve në çerdhe publike, të sigurohen vendet për fëmijët e prindërve të cilët nuk kanë mundësi të paguajnë në çerdhet private, sepse këtu kemi ministra dhe deputetë që e kanë përdorur çerdhen publike, i kanë dërguar fëmijët e tyre dhe kanë paguar vetëm 50 euro, ndërsa prindërit që nuk kanë pasur pagë, kanë marrë diku 300 euro në muaj kanë paguar 200 e më shumë para për çerdhet private. Pra, këtu duhet... e kemi bërë diskriminimin dyfish tek fëmijët, aty ku juve ju konvenon. Fëmijët e prindërve që kanë më pak para, që të jetojnë dhe të shkojnë në çerdhe publike nuk kanë mundësi të shkojnë as në këto çerdhe, sepse i keni zaptua ju.

KRYESUESI: Fisnik Ismajli, nuk është. S'ke të drejtë. Sali Salihu, urdhëro!

SALI SALIHU: Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës, Kosova ka një rini të shkëlqyer, inteligjente dhe të ndërgjegjshme, të shëndoshë dhe me moshë mesatare më të re në Evropë. Ajo përbën grupin më të madh demografik me një potencial të jashtëzakonshëm për t'u bërë faktor i ndryshimit.

Por, cila është perspektiva e rinisë sonë në Kosovë? Sa jemi duke punuar në arsimimin e mirëfilltë të tyre, në promovimin dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrje, në promovimin e punës dhe ndërmarrësisë së tyre, në parandalimin e diskriminimit të tyre, në promovimin e jetës së shëndetshme dhe stimulimin e talenteve në sport e kulturë?

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot rinia e Kosovës gjendet në një udhëkryq të vështirë. Të studiojë pa shpresë për t'u punësuar apo të qëndrojnë në shtëpi për të mos rrezikuar, sepse në mungesë të bursës bëhet barrë financiare për familje. Të punojë falë, kinse duke u trajnuar, sepse konkursi kërkon tre vjet përvojë pune dhe këtë përvojë duhet plotësuar duke punuar falas apo të ikin nga ky vend me shpresën që diku larg të punësohen.

Pra, të pashpresë për një perspektivë të shpejtë, bursë jo, punë jo, sigurim shëndetësor jo, banesë jo, mbështetje sociale jo, vizë jo dhe shumë 'jo' të tjera edhe 20 vjet pas luftës.

Mbas se të gjithë kanë dëshirë për të studiuar, por gjasat për të gjetur një vend pune pas mbarimit të studimeve janë të pakta, e disa që kanë pak fat përfundojnë kamerierë, shitës në market, punëtor fizik apo edhe frizer.

Rinia jonë është rast unik në botë dhe kjo është për t'u admiruar, sepse duke ditur që nuk kanë gjasa për një vend pune, megjithatë gjejnë vullnet dhe motiv për të studiuar.

Kjo nuk ndodh në asnjë vend tjetër të Evropës. Pra, ata duan të shkollohen, duan të arrijnë, ata kanë ëndrra e ambicie, por ata nuk kanë ku të veprojnë e të punojnë.

Sot një i ri, edhe sikur të punësohet e ka vështirë për të krijuar familje nëse është i vetmi i punësuar.

Më thoni, një i ri me 300 euro pagë a mund të sigurojë dhomë gjumi, të blejë banesë apo të ndërtojë shtëpi, të blejë veturë apo të rritë fëmijë.

Kosova sot ka 10 mijë ekonomistë, e nuk ka ekonomi, ka 10 000 juristë, e nuk ka drejtësi, kemi pasuri nëntokësore, por kemi varfëri mbi tokë, e për këtë nuk mund të themi që është fajtor rinia, por këtu qartë fajtor është Qeveria.

Pra, ne jemi ata që po shkatërrojmë të ardhmen e tyre, ne i keqpërdorim ata i duke përdorur vetëm për dekor në takimet tona politike, por jo edhe duke i futur në organet vendimmarrëse.

Ne i përçajmë ata me dhjetëra organizata studentore që në ditën e parë kur të bëhen studentë, për të mos i lënë të bashkuar për interesat e tyre, sepse qeveritë i shohin si rrezik ata.

Sot ata janë të shtypurit e së tashmes, po janë shpresa e së ardhmes.

Të nderuar kolegë,

Sot të votojmë këtë rezolutë dhe vazhdimisht t'i bëjmë presion Qeverisë që të zbatohen këto rekomandime që dalin nga kjo rezolutë për ta përmirësuar gjendjen e të rinjve tanë në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Më la përshtypje një diskutim i një deputetes, po e shoh, tash dal me emra unë, ngadalë-ngadalë, do ta pyes edhe Armendin që ka qenë në shkollë private, e si quhet, "publiko privat" a si quhet shkollimi, nëpër shtëpitë private.

Po krijohet një filozofi duke e ditur që pjesa dërmuese e qytetarëve të Kosovës janë fukarenj, të papunë, të paardhura, të kërkohet vota pikërisht te fukaraja.

Unë për vete e mbështes çdo iniciativë, çdo propozim që është kundër keqpërdorimit të parasë publike.

Në vendim më social-demokrat të botës, në Suedi, ku barazia është në nivelin më të lartë në krahasim me krejt botën, ka edhe shkolla private, ka edhe miliarderë, ka edhe milionerë dhe njerëzit paguhen në bazë të vlerave që i kanë.

Njerëzit nuk diferencohen në asgjë tjetër, pos në bazë të vlerave. Tani në qoftë se deputetët këtu kanë mundësi t'i dërgojnë fëmijët në shkolla private edhe me helikopter, le t'i çojnë, more. Unë për veti e kam pasur fëmijët në çerdhe publike, edhe vajza ime shkon në shkollën "Faik Konica", që janë 32 nxënës në një klasë, që nuk kanë as ku i vendosin çantat, janë dy ndërrime, prej orës 13:00 deri në orën 18:00 qëndron në shkollë.

Prandaj, më duket që debati ishte rreth rinisë, me sa unë e kuptova. Përndryshe, si kategori të mjerueshme e 'zibidi', që e tha edhe baci Adem atje, janë të rinjtë, po janë edhe pensionistët. Në qoftë se ju shihni të rinj nëpër kafe në Kosovë, ky është treguesi më i mirë se këta njerëz janë të papunë.

Në vendet perëndimore nuk sheh njerëz të rinj nëpër kafe deri në mbrëmje dhe shpeshherë kam dëgjuar arsyetimin e disa politikanëve si thonë: "Jo, bre, po këqyri të rinjtë tërë ditën po rrinë nëpër kafe, kah po i marrin këto para".

Këta të rinj po të mos rrinë nëpër kafe dhe po të mos ua jepte prindi një euro për një makiato, këta veç të bëjnë vetëvrasje.

Megjithatë, edhe një herë po them, nuk duhet të krijohet një lloj mendimi ose një farë lloj fryme që ne duhet të jemi të gjithë fukarenj, për arsye se jo të gjithë njerëzit bien në burg përnjëherë, jo të gjithë njerëzit luftojnë, tash nuk bën që disa që kanë luftuar të na thonë e pse ti nuk ke luftuar unë kam luftuar, e pse unë kam qenë në burg e ti nuk ke qenë në burg, e pse ti e ke rrogën, për shembull, 2000 euro, ai tjetri thotë pse unë e kam 500. Kështu që përtej barazisë sociale, mendoj që ju deputetë që keni para t'i çoni fëmijët privatisht, le t'ju vazhdojë kështu fati, po paratë publike nuk është mirë të vidhen.

Dhe do të jem iniciator që të bëhet një kontroll edhe brenda Parlamentit për keqpërdorimin e parasë publike.

Po e përsëris edhe një herë, ka anëtarë të Kryesisë të Parlamentit të Kosovës që udhëtojnë pafundësisht dhe e keqpërdorin paranë publike.

Janë miliona që përdoren për dreka e për darka. Janë milionë që keqpërdoren nëpër hotele, sidomos grupi i negociatave që ka qenë në Bruksel të kaluarën, këto janë gjëra interesante. Përndryshe, vazhdoni me avazin e vjetër dhe nuk ka kurrfarë problemi që rinia është në gjendje shumë të mjerë, këtë e dimë të gjithë dhe pajtohemi në mënyrë absolute me fjalimin e Adem Mikullovcit.

KRYESUESI: Faleminderit! Fitore, për replikë, apo? I është drejtuar përmbajtjes së fjalimit, kështu referenca është e saktë, ka të drejtë për replikë. Urdhëro!

FITORE PACOLLI: Faleminderit, nënkryetar!

Zoti deputet, nuk ka shkelje më të madhe nga një zyrtar publik, i cili vjedh në çdo kontratë që ka mundësi dhe pastaj me ato para ka mundësi të paguajë shkollimin privat për fëmijët e tyre në shkollat private dhe, në të njëjtën mënyrë shkatërron dhe merr vendime të dëmshme për shkollat publike të këtij vendi. Pra, kjo është shkelja më e rëndë që iu ka bërë këtij vendi nga zyrtarët publikë. Kjo është arsyeja pse kërkoja që asnjë zyrtar të mos ketë të drejtë t'i dërgojë fëmijët e tyre në shkolla private, por në ato publike që të investojnë direkt në ato, sepse këta nuk i shohin tualetet dhe kushtet në të cilat mësojnë fëmijët e 90% të popullsisë në shkollat e shtetit. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Milaim Zeka, kundër-replikë!

MILAIM ZEKA: Fitore, unë në parim pajtohemi me ty në mënyrë absolute, veç në qoftë se ti më gjen ndonjë mundësi hipotetike që ne mund t'ua ndalojmë njerëzve t'i dërgojnë fëmijët nëpër shkolla private, atëherë nxirre atë rezolutë dhe unë do ta votoj.

Ne aq kemi bërë bajat me rezoluta, sa që unë do të propozoj një rezolutë që t'i shfuqizojë krejt rezolutat e tjera, kjo është bërë hajgare, more.

Ne në vend që të merremi me votimin e ligjeve, jemi marrë që dy muaj ditë veç me rezoluta, herë njëri, herë tjetri, veç kur të marrim një ditë ndonjë farë iniciative, për shembull, që të nxjerrim një rezolutë koti.

Prandaj, po them edhe një herë, parimisht e ke shumë të drejtë, parimisht e ke të drejtë se je duke folur për barazi sociale, por praktikisht nuk mund t'ia ndalosh asnjë deputeti, asnjë njeriu në këtë botë se ku e çon fëmijën e vet.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Valentina Bunjaku-Rexhepi.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: I nderuar nënkryetar,
Të nderuar kolegë deputetë,

Të respektuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot kur po debatojmë për rininë, realisht nuk po flasim vetëm për një kategori të veçantë nga popullsia e përgjithshme, por për gjithë popullin dhe qytetarët e Republikës së Kosovës, sepse të rinjtë në vendin tonë, sikurse e dimë të gjithë, janë shumicë demografike. Kjo për vendet e zhvilluara evropiane dhe të tjera, do të konsiderohej aset i fuqishëm i zhvillimit të gjithmbarshëm ekonomik të shtetit, e lëre më të vihej në pikëpyetje punësimi i tyre. Por, fatkeqësisht, në vendin tonë të rinjtë vazhdojnë të mbesin pa shpresë, pa motivim dhe pa perspektivë për të ardhmen. Krejt çfarë presin të rinjtë tanë janë liberalizimi i mundshëm i vizave dhe ndonjë mundësi për të gjetur ndonjë kontratë pune ose përmes ndonjë forme tjetër, për t'u larguar nga Kosova drejt Evropës.

Rinia në Kosovë problemin numër një e ka papunësinë, pasigurinë për të filluar jetën në vendin tonë. Nëse hyni në Entin e Statistikave të Kosovës dhe shënoni papunësinë e grupmoshës 15 deri në 24 vjeç, është përqindje shumë brengosëse. Por edhe këta të rinj që mbarojnë studimet, apo edhe gjatë studimeve sa janë, shpesh e thonë se janë të dëshpëruar për të ardhmen, se edhe përkundër diplomimit, do të mbesin pa punë. Jo rastësisht, edhe shifrat e papunësisë për grupmoshat 25 deri në 34 vjeç, janë në kulm alarmuese pasi nuk kanë gjetur një vend pune, edhe pas përfundimit të studimeve.

Qeveria e Kosovës e ka reduktuar rininë vetëm në një Departament të Rinisë, në kuadër të Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport. Realisht, rinia nuk mund të shndërrohet në objekt të MKRS-së, vetëm për disa grante për edukim joformal dhe aktivitete të lira. Rinia duhet të jetë në program dhe agjendë, në vizion të çdo ministrie, e jo vetëm MKRS-së.

Të rinjtë kosovarë, të dëshpëruar, ose po e mendojnë ikjen nga Kosova për në vendet evropiane, ose po bëhen pjesë e sjelljeve devijante të keqpërdorimit të duhanit, drogës, alkoolit. Rinia jonë, për të cilën jemi lavdëruar për aq shumë kohë, se e kemi “rininë më të shëndetshme”, sot është në një fazë të ndjeshme të përfshirjes në aktivitete devijuese, duke e dëmtuar shëndetin e tyre me abuzim të drogave, alkoolit, lojërave të fatit dhe menaxhimin joefikas të kohës në internet, pa u marrë me gjërat që i çojnë në një të ardhme më të mirë. Krejt këto janë shkak i demotivimit të tyre.

Buxheti për të rinjtë duhet të ndryshojë edhe në shifra, edhe në mënyrat se si dhe ku shpërndahet. Rinia duhet të jetë prioritet i kësaj Qeverie.

Shumë çifte të reja duan të kenë një jetë të pavarur sikur në Perëndim dhe në vende të tjera të zhvilluara, me banesa apo shtëpi personale, të ndarë nga bashkësia familjare, por nuk arrijnë dot, me një papunësi masive. Edhe ata dhe ato që punojnë, e sidomos në sektorin privat, kanë paga të ulëta. Qeveria e Kosovës duhet t'i ofrohet rinisë dhe këtyre çifteve të reja, t'i ndihmojë në realizimin e synimeve të tyre për jetë të pavarur, qoftë edhe për banim më të përballueshëm. Kjo

do ta zvogëlonte edhe më shumë mentalitetin farefisnor e patriarkal, duke u dhënë më shumë hapësirë të lirë dhe vetiniciativë të rinjve. Me këto politika, prej të rinjve nuk mund të presim rezultate të mira në arsim.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ka ardhur koha që rininë të mos e shohim si objekt për mbledhjen e votave dhe elektorat në çdo katër vjet, por të marrim veprime konkrete për ta ndihmuar dhe fuqizuar atë. Ta shtojmë buxhetin për bursa, t'i japim prioritet në grante qeveritare, t'ia lehtësojmë marrjen me zanate dhe kurse profesionale, t'i japim me prioritet subvencione, nëse duan të merren me ferma dhe ndërmarrje të vogla prodhuese, etj.

Në rast se nuk e bëjmë këtë, Kosova do të mbetet pa rini, e sidomos pas liberalizimit të vizave.

E shfrytëzoj rastin ta përgëzoj për këtë iniciativë, sepse në këtë debat numri i deputetëve të lajmëruar është dashur të jetë shumë më i madh, sepse ky debat është një ndër debatet më të arsyeshme në këtë Kuvend, sepse pa një rini të shëndoshë, nuk do të kemi edhe shtet të shëndoshë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, ia jap fjalën deputetes Xhevahire Izma.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Kisha dashur t'i përhëndes ministrat, por po shihet që nuk i kemi këtu.

Më lejoni të shpreh po ashtu keqardhje dhe një reagim për mungesën së paku të ministrit të Arsimit dhe atij të Kulturës, që është ministër i partisë time. Mendoj që nuk ka asnjë justifikim të mos jetë sot së paku t'i dëgjojë të gjitha këto diskutime, të cilat sigurisht që unë mendoj do të kenë një prodhim pozitiv në fund të këtij debati.

Normalisht që edhe unë pres që shumicën e debateve do të vijnë nga mosha më e re e deputetëve që i kemi sot në sallë këtu, mirëpo edhe ne të tjerët mund të kontribuojmë në këtë drejtim, sepse konsiderojmë që një prej debateve më të rëndësishme që janë zhvilluar, unë e përgëzoj Fidanin Rekaliu për iniciativën dhe mendoj që përherë ka nevojë të bëhen debate të tilla, sepse ne duhet të japim një sqarim, nuk debatojmë që fjalët të mbesin brenda këtyre mureve.

Mirëpo qëllimi ynë është që pas këtyre debateve Qeveria t'i marrë më seriozisht dhe të përmirësojë mekanizmat që mund ta ndryshojnë një sferë, pra sot e kemi fjalën për çështjen e rinisë dhe mënyrën se si mund të ndihmojmë perspektivën e të rinjve.

Prej pasluftë na kanë përcjellë situata emergjente si vend: çështjet sociale, infrastruktura, ndërtimi i shtëpive, shkollave, shëndetësia, për të cilat e dimë dhe jemi vetë dëshmitarë se u deshën vite që të rifillojë një jetë që t'i ngjajë pak normales.

Pas pavarësisë sigurisht që u desh shumë energji që të bëjmë maksimumin për të konsoliduar shtetin e ri dhe në këtë drejtim, me vetëdije të plotë e ndaj pjesën e krenarisë për periudhën e reformave të mëdha që u bënë në periudhën kur tani presidenti Thaçi ishte në pozitën e kryeministrit. Po, pra, është e vërtetë që në mandatin e kryeministrit Thaçi u bë një ndryshim i madh, reforma dhe përmirësim i cilësisë së jetës, rritja e pagave dhe përmirësimi shumë i madh zhvillimor në infrastrukturë. Por, tani nuk do të bëj edhe rolin e hipokrites, do të marr edhe përgjegjësinë edhe do të pranoj që nuk është bërë mjaftueshëm për rininë.

Pra, nuk është mjaftueshëm kontributi që u dha në aspektin e zhvillimit dhe përmirësimit të një jete më kualitative, një shkollimi më kualitativ, të një punësimi më kualitativ për të rinjtë tanë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Të gjitha këto debate që i nxisim dhe i përkrahim, i ndërmarrim vetëm me qëllimin që të bëhen masa më specifike në fushat ku po debatojmë. Pra, për këtë arsye, po e përsëris edhe një herë, kisha dashur të kemi përpara, së paku bile të kemi informacione të sakta për disa statistika nga ministrat, për të cilët mendoj që do t'u dedikohen kryesisht shumica e kërkesave nga rezoluta që do të nxjerrim pas debatit.

Kur po diskutojmë për rininë, sigurisht që nuk është një pozicion që jep komoditet që të flasim për kushtet, të cilat sot i kanë të rinjtë tanë, po mundësi racionale e punësimit në raport me numrin e atyre që kanë një diplomë ose kanë një zanat.

Mundësi praktike racionale në raport me numrin e atyre që diplomojnë çdo vit dhe kanë nevojën që dijen ta materializojnë në praktikë.

Ne si Kuvend, në të gjitha mandatet, kemi bërë ligje të mira, por këto ligje a arritën që të krijojnë politika të mirëfillta që përfshijnë mekanizma të mjaftueshëm shtetërorë që të bëhet fuqizimi i të rinjve? Jo, sigurisht që jo!

Ende mbetemi si vend në rajon që kemi mesataren e moshës më të re, por kjo nuk guxon të mbetet i vetmi element pozitiv si një faktor që na lë të mburrem pa pjesën tjetër.

Më lejoni të theksoj që ligjet e mira dhe një sistem arsimor, i cili kritikohet, përpjekjet tona duhet të jenë të gjitha unike që të bëhen këto reforma mbi drejtime të cilat duhen të promovohen.

Meqenëse ka vetëm dy muaj që isha i pranishëm me një delegacion nga Kuvendi i Kosovës në konferencën globale parlamentare në Uashington, po jua risjell vetëm një praktikë ose porosi që ne e morëm nga organizatorët e konferencës.

Duke parë që ishim pesë deputetë, ndër ta mendoj që më e vjetra kam qenë unë me moshë, ata u befasuan, sepse shumica e deputetëve ishin mbi moshën 55-vjeçare dhe gjatë pauzave kur kemi diskutuar kanë marrë informacione nga ne, statistika për numrin e të rinjve që diplomojnë dhe drejtimet.

Realiteti ishte që në vendin tonë diplomojnë kryesisht në fushat e ekonomisë dhe juridikut. Na u dha një sugjerim që të bëhet shumë racional më tutje pranimi në këto universitete, që t'u jepet mundësi profesioneve të reja, pra profesioneve inovative.

Pra, që të bëhen këto, ne duhet të sigurojmë edhe të fuqizojmë sektorin privat, sepse shihet që kërkesa e të rinjve, dëshirat e tyre fatkeqësisht ende janë shumë të motivuara që të koncentrohen vetëm në sektorin publik, sepse në raport me mbrojtjen e ligjshmërisë, ne diskutuam edhe dje, nuk është e vërtetë, kolegja tha që ne e votuam kërkesën edhe debatin që e iniciuat ju si subjekt parlamentar, e votoi PDK-ja, domethënë për të drejtat e punëtorëve, ku në këtë drejtim është edhe, më falni, fuqizimi në sektorin privat, po mendoj që një përfaqësim i mirë u jepet edhe të rinjve.

Duke qenë real që ta pranojmë këtë gjendje, ne sot debatojmë me qëllimin më të mirë që të kontribuojmë në këtë drejtim. Pra, ne kemi nevojë që të unifikojmë kërkesat më emergjente për politika që mund të zhvillojnë një perspektivë shumë më të shpejtë.

Konsideroj që krejt në fund, pas të gjitha debateve, nuk do të mendojmë që ky debat ka qenë i kotë, por ne do të kujdestarojmë që këto rezoluta të përcillen edhe të implementohen. Pra, jo të shuhemi, mendoj që debate të tilla duhet të iniciohen përsëri dhe kushdo që i inicion, ne do t'i përkrahim edhe si subjekt politik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Arbër Rexhaj.

ARBËR REXHAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Para se t'ia nis artikullimit për temën e caktuar, në fakt dua të përmend një hulumtim të KDI-së, i cili është bërë kohëve të fundit, ku sot politikani model në Kosovë për rininë merret Albin Kurti dhe, siç po duket, ai pra po jep shembullin e modestisë, të diturisë dhe të përkrahjes popullore. Prandaj, për këtë edhe ndihemi krenarë me shembullin e tij.

Edhe një element tjetër dua ta them para se të filloj. Këtu u tha edhe një e pavërtetë, u tha që në qytetin e Prizrenit, pra, nuk ka pasur çerdhe publike, kjo shumë e vërtetë, në dy mandatet e kaluara të qeverisjes së Partisë Demokratike të Kosovës përnjëmend asnjë çerdhe publike nuk ka pasur. Ndërsa para ca ditësh qeverisja e Lëvizjes Vetëvendosje e ka nisur çerdhen e parë publike dhe e ka vënë gurthemelin.

Tash po vazhdoj të flas për rininë. Në procesin e adoleshencës të rinjtë përballen me ndryshime shoqërore që shkaktohen edhe në dukuri jo të mira dhe sigurish kjo vije si shkak i edukimit dhe ambientit social.

Adoleshenca njihet edhe si kohë e turbullimit të stresit, ajo ndeshet në disa probleme që kanë lidhje me vetëdijen, kontradiktat prindërore, kodet morale ose konformimin ndaj normave sociale.

Në këtë periudhë zakonisht zhvillohet ajo që e quajmë ne ‘ndjenja e identitetit’, proces që ndeshet me kontradiktat mes aftësive, mundësive dhe dëshirave të tyre fizike, mendore, psikologjike dhe kufizimeve për të mos i realizuar ato.

Pikërisht për këto arsye bota e qytetëruar i kushton rëndësi të veçantë edukimit të adoleshentëve.

Një fidan i shëndoshë, në fakt, i ka të gjitha gjasat të jetë një pemë e shëndoshë, prandaj është nevojë e veçantë, sidomos e prindërve, të kenë kujdes gjatë edukimit të tyre, sepse siç dihet, fëmija bazën e shëndoshë të edukimit e merr në fëmijëri.

Dhe për këtë sot gjatë gjithë kohës është debatuar që të kemi sa më shumë çerdhe publike, sa më shumë shkolla publike, të kemi edukim bazik dhe tejet përmbajtjesor.

Shpeshherë, qoftë nga familja apo institucionet shkollore, këtij procesi nuk i kushtojnë vëmendjen e duhur që për një numër të rinjsh mund të jetë periudhë vendimtare për edhe jetën e tij. Në fakt, psikologët këtë e quajnë si një tranzicion nga faza e varësisë në atë të pavarësisë, pra edhe kjo kalon me ndryshime të dukshme.

Në këtë periudhë të tranzicionit, sidomos në kohën e pubertetit, të rinjtë kanë ndryshime fizike. Sigurisht që për mbarëvajtjen e gjithë këtij etablimi psikologjik përgjegjës janë shkollat tona publike, të cilat duhet të marrin masa edukate jo vetëm për procese mësimore, por realisht të krijojnë siguri për fëmijët edhe në ambientet, pra, në afërsi të tyre.

Edukimi dhe mënyra e të kontrolluarit të duhur nga faza e varësisë te ajo e pavarësisë, qoftë nga familja apo shkolla, janë të një rëndësie të veçantë.

E rëndësishme është edhe risocializimi i të rinjve, qoftë nga familja, shoqëria apo institucione qeveritare dhe ato qeveritare.

Bazuar në shënimet e institucioneve, një numër i të rinjve, të cilët nuk kanë përkrahjen e duhur, gjatë këtij procesi përballen edhe me vepra delikuede, të cilat kanë edhe pasoja ligjore. Mjaft prej tyre i gjen të regjistruara në evidenca të vjedhjeve, të përdoruesve të drogave, prishjes së

rendit e tjera, e tjera. Në fakt, unë do t'i përmend edhe disa statistika, të cilat edhe i kam hulumtuar me një gjetje shumë të lehtë. Pra, për 13 vjet, në Kosovë, si shkak i pasojës socio-ekonomike, janë evidentuar 786 raste të vetëvrasjes dhe 2 494 raste të tentim-vetëvrasjes. Ky fenomen, sipas Policisë së Kosovës, po merr përmasa të gjera nga viti në vit. Psikologët dhe sociologët sugjerojnë që ky fenomen nuk ka qenë pjesë e traditës së Kosovës, pra e kosovarëve shqiptarë, por ka ardhur në shprehje për shkak të faktorëve të ndryshëm, në radhë të parë gjendjes jo të mirë ekonomike dhe sociale, gjendjes emocionale dhe për shkak të tranzicionit të çakorduar.

Në kuadër të Policisë së Kosovës, më saktësisht në kuadër të sistemit të bazës së të dhënave të Policisë së Kosovës, janë evidentuar të gjitha rastet që raportohen në Policinë e Kosovës, e kam fjalën sa i përket temës. Ndërsa, në këtë rast, nëse u referohemi statistikave të tentim-vetëvrasjeve dhe vetëvrasjeve në Policinë e Kosovës që nga themelimi, pra nga viti 1999 deri në vitin 2012 janë evidentuar 2 494 tentim-vetëvrasje dhe 786 raste të vetëvrasjeve. Si moshë e përfshirë në rastet e tilla të veprave penale janë nga mosha 18 deri në moshën 40 vjeç. Dhe, për këtë e keni edhe deklaratën e zëdhënësit të Policisë së Kosovës.

Faktorët më të rrezikuar që shpijnë deri te vetëvrasja janë problemet të shëndetit mendor dhe të çrregullimeve të ndryshme. Dhe, sipas këtyre statistikave, aty kemi grupmoshat që përfshijnë moshën nga 18 deri në moshën 30-vjeçare dhe kjo kryesisht vjen si pasojë e elementeve socio-ekonomike në shoqërinë tonë. Në vendin tonë, ne e kemi një trend të ndryshëm në krahasim me vendet tjera, ku numri i vetëvrasjeve fatkeqësisht është më i lartë ndërmjet grupmoshave, pra një statistikë tjetër, nga mosha 25 deri në 45 vjeç, që njihet si mosha më produktive njerëzore. Mendoj që pos problemeve, të cilat u cekën këtu, institucionet e Republikës së Kosovës duhet t'i kushtojnë pra një rëndësi shumë të veçantë edhe shëndetit të të rinjve, sepse janë dy baza kryesore, të cilat ne i njohim. Pra, arsimi dhe shëndeti ky mendor dhe ai fizik, i cili duhet ta shprijë përpara rininë tonë, dhe ai më kryesori, pra baza socio-ekonomike. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Muharrem Nitaj e ka fjalën.

MUHARREM NITAJ: I nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Ndoshta është hera e parë që ka ardhur një tekst i rezolutës, i cili pothuajse është i harmonizuar me të gjitha grupet parlamentare. Tash po e shoh se numri i deputetëve është shumë i madh, që janë paraqitur, dhe debatet pak a shumë ndoshta janë në sferën e promovimeve, nuk e di politike, por po e shoh që teksti është i harmonizuar, të paktën nga zoti Rekaliu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ia jap fjalën deputetit Bilall Sherifi.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Nëse më lejon, para se të hyjë në temë, ta bëj një koment rreth asaj që së paku mua më duket më korrekte, i vetmi nga drejtuesit e seancave për mendimin tim që interpreton drejt Rregulloren

rreth replikës jeni ju, sepse replika nuk nënkupton vetëm kur të përmendet emri, por edhe kur i referohet fjalës, në të cilën flasin deputetët paraprakë. Prandaj, desha të të sanksionoj dhe sikur të ndiqej kjo linjë, asnjëherë nuk do të kishim telashe në Kuvend. Kjo është ajo që desha të them.

Se lehtë është t'i ikësh përmendjes së emrit, por të hedhësh gurë mbi parafolësin dhe ai të mos ketë mundësi që ta japë mendimin e vet, vetëm pse s'i është përmendur emri, apo t'i përmendet emri lidhje-palidhje, dhe pastaj të kërkojë replikë vetëm sa për ta marrë fjalën, edhe pse askush asgjë nuk ka replikuar me idetë e tij, apo me atë që ai ka thënë. Këtë desha ta them.

Tash po dal te tema në fjalë. Nuk besoj që këtu dikush i do më shumë apo dikush i do më pak të rinjtë. Të gjithë i duam njëjtë, sepse në fund të fundit të gjithë kemi, qoftë fëmijë, qoftë vëllezër, qoftë motra, që në një mënyrë apo një tjetër të gjithë jemi të lidhur drejtpërdrejt, kemi edhe interesa të drejtpërdrejta që të rinjtë, për fëmijët, për ta të bëjmë më shumë në përgjithësi. Për aq sa unë e pashë këtë projekt-rezolutë, e cila do të hidhet në votim, ka gjëra të mira, për të cilat shpresoj që, megjithëse kolegu Nitaj tha se është harmonizuar, unë nuk e di kush ka qenë nga Nisma në procesin e harmonizimit, Albulenën e kemi në komision, dhe kjo s'paska qenë, nuk e di që është harmonizuar. Pra, nëse ende nuk është harmonizuar, ne i kemi disa propozime që këto 14-15 pika të përmbliken në 5-6 pika si në formë të rekomandimeve, pa hyrë në detaje siç hyn shpeshherë projekt-rezoluta. Për shembull është pika e parë e rezolutës, e cila flet për miratimin e një strategjie dhe mendoj që shumë nga pikat që janë në rezolutë e kanë vendin në strategji, por jo në projekt-rezolutë, e cila besoj shumë se do të shndërrohet, sepse këtu ka vullnet nga të gjitha grupet parlamentare e deputetët që të japin mendime, të japin ide se çka të kërkohet, jo vetëm nga Parlamenti, por edhe nga Qeveria si ekzekutuese e politikave të Parlamentit për të rinjtë.

Dhe, më së paku kjo pikë e rendit të ditës do të duhej të jetë apo të shfrytëzohet për përplasje brenda grupeve parlamentare, brenda partive apo ndërmjet grupeve parlamentare, apo ndërmjet partive politike, duke pasur parasysh faktin se të gjithë lidhemi në një mënyrë, apo në tjetër. Do të kisha pas dëshirë që fëmijët tanë të jenë brezi i fundit që po përgatitet për ta kërkuar të ardhmen e tyre jashtë vendit, jashtë Kosovës. Shpresoj shumë, edhe pse fatkeqësisht në këto 70 vjetët e fundit gjënë që më së miri kemi ditur ta bëjmë është të lindim, të rritim dhe të edukojmë breza për t'i nxjerr pastaj në Evropë, apo në shtetet tjera. Shpresoj që ky të jetë brezi i fundit dhe të fillojmë të veprojmë, të krijojmë hapësirë që ata, jo vetëm ta shohin të ardhmen e tyre këtu, jo vetëm të qëndrojnë këtu, sepse e kërkon interesi i vendit, por të qëndrojnë këtu sepse e kërkon edhe interesi i vendit, edhe interesi i tyre.

Ne jemi një brez apo disa breza që shpeshherë kemi thënë, apo moto udhëheqëse në jetë e kemi pasur të luftojmë për vendin, sepse vendi ka nevojë për neve. Por, mendoj që ky brez i cili po rritet e po edukohet, së paku ne nuk do të duhej më të kërkojmë nga ata që të udhëhiqen nga një e njëjta moto "vendi ka nevojë për ta". Edhe ata duhet të kenë nevojë për vendin dhe vendi duhet

të fillojë të ofrojë perspektivë për ta. Pra, duhet të jetë e dyanshme. Jetojmë në kushte krejt tjera, jetojmë në kushte të lirisë dhe arsimimi i duhur, arsimimi i drejtë, arsimimi që i bën ata të aftë dhe konkurrues në kushtet e ekonomisë të tregut do të ishte parakusht që vendi ta marrë një drejtim zhvillimi, vendi ta marrë një drejtim kur vendi do të ketë nevojë për të rinjtë dhe të rinjtë për vendin. Unë nuk dua që këtu të bëhem pjesë e përplasjes me asnjë grup, me asnjë deputet. Besoj shumë në sinqeritetin e secilit kur e merr fjalën këtu se vërtet po i dhemb për këtë kategori të popullsisë, e cila është jo vetëm e tashmja, por edhe e ardhmja e vendit tonë, e popullit tonë, dhe le të ulen përfaqësuesit e grupeve, le të shohin që të bëjmë një rezolutë me disa pika, me të cilat do të ishte si udhërrëfyes e Qeverisë se si Parlamenti, deputetët e Kuvendit të Kosovës e shohin mbështetjen konkrete për këtë kategori të shoqërisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Emilija Rexhepi.

EMILIJÀ REDŽEPI: Poštovani predsedavajući!

Kolege poslanici,

Poštovani građani,

Danas govorimo ili debatiramo o položaju naše omladine u kosovskom društvu. Ja ću govoriti u položaju mladih Bošnjacke nacionalne Zajednice koja ima svoje specifičnih problema. Počev od predškolskog uzrasta ili vrtića, gde je sve privatizovano i na drugom jeziku. Nemamo javnih vrtića po našim gradovima, zatim osnovne škole, koje nemaju nikakvih uslova za rad, počev od infrastrukture, kombinovanih odeljenja, lošeg kvaliteta redovne nastave, učitelja i nastavnika koji odrade 2-3 sata nastave i bave se drugim zanimanjima van školske aktivnost i ne postoje uopšte kako bi stimulisali našu decu preko raznih kulturno-sportskih aktivnosti, a da ne govorim o vaspitnom obrazovnom procesu pomoćnog osoblja, kao što su pedagog ili psiholog.

Ovde želim izneti problem jedne osnovne škole u Prizrenu, "Motrat Qiriazhi", gde direktor te škole nije dozvolio da deca u nastavi na bosanskom jeziku učestvuju na školskoj priredbi, zbog čega su naši roditelji oštro reagovali. Ovo nisu nacionalistički postupci direktora, nego fašistički istup, i ja mu za ovom govornicom poručujem da poštuje Bošnjacku decu u nastavi na bosanskom jeziku, ili će se suočiti za organima pravde po pitanju diskriminacije naroda, koji žive u gradu Prizrenu. Takođe problematika srednjoškolskih ustanova i nedostatak udžbenika na bosanskom jeziku, i dalje naša Vlada, odnosno Ministarstvo obrazovanja nema sluha čak ni da te udžbenike prevede sa albanskog na bosanski jezik po kurikulumu plana i programa Republike Kosova. O visokom školskim ustanovama i da ne govorim više, dupliranje istih smerova godinama unazad da bi se odrađeni profesor zadovoljili na uštap studenata na javnom univerzitetu "Ukshin Hoti" u Prizrenu i "Haxhi Zeka" u Peči, i ovde zahtevam hitnu intervenciju ministra Obrazovanja i novih rektora da zaustave ovaj organizovani kriminal.

Ukoliko naši studenti žele studirati neke druge smerove, moraju fakultete završavati u zemljama u regionu, a kada završe pod jako teškim uslovima, onda njihova diploma nije priznata, traži se

nostrifikacija diplome i oni ne mogu konkurisati za bilo koju vrstu posla, dok na primer pripadnici Srpske zajednice sa istom takom diplomom slobodno se zapošljavaju u svim javnim institucijama širom Kosova, i rade godinama unazad.

Poštovani građani,

Sve sam ove podatke iznela kao glavne indikatore koje direktno utiči na razvoj i život Bošnjačke omladino u društvu, i nadam se da će lokalne i centrale vlasti imati više sluha da se ovo stanje na terenu popravi, kako bismo sa određenim grantovima i subvencijama raznih ministarstava podržali projekte nevladinih organizacija, studentska udruženja, kulturno-umetnička društva, kao i razna druga udruženja mladih, stvorili im prostor za rad i delovanje u društvu, sklonili od devijantnih pojava u društvu, kao što su alkohol, droga, prostitucija, kocka, i ovim putem delimično promenili njihovo mišljenje da na Kosovu nema ništa i da svoju budućnost vide negde drugde, u nekoj drugo i zemlji. I žalosno je kolege poslanici, vi koji iste is Prizrena, što danas niko ovde ne govori o nesreći, odnosno samoubistvu dve srednjoškolve medicinske škole “Lucijano Matroni” u Prizrenu, a to je za naš grad jako za obronjavajući fenomen i o njemu se treba otvoreno govoriti. Hvala!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

KRYESUESI: Një minutë, Naser! Nait Hasani e ka kërkuar fjalën për një ndërhyrje pak më specifike, me sa duket. Urdhëro, Nait!

NAIT HASANI: Faleminderit, kryesues!

Deputetja Emilija për debatin dhe diskutimin që e pati për Prizrenin, t'i quash drejtorët edhe fashistë, edhe veprime fashiste, po më duket që është e padrejtë. Është ndoshta mendimi i saj agresiv, por nuk duhet në Kuvendin e Kosovës t'i gjykojë njerëzit të cilët merren me edukimin e nxënësve në forma të tilla. Unë nuk besoj që ka në Prizren një drejtor me sjellje fashiste, prandaj ajo duhet të kërkojë falje për formën e formulimit të fjalisë dhe të shprehjes si “fashizëm” për arsimin dhe edukimin në Prizren.

Nëse ka ndonjë diskriminim që u është bërë boshnjakëve, është absurde se asnjë diskriminim nuk ka në Prizren. Prandaj, thënia e saj që ka diskriminim të tillë, mua më duket një gjë të cilën duhet ta gjykojë ndërgjegjja e saj, e jo veç ne të reagojmë.

KRYESUESI: Deputetja Emilija Rexhepi, kundër-replikë!

EMILIA REDŽEPI: Gospodine Hasani, kako biste vi ko roditelj, da vam dece idu u školu, u toj školi nazvali direktora koji ne želi da pristup vaših učenika, odnosno vaše dece bude na školsku priredbi. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Naser Rugova e ka fjalën, vazhdojmë sipas radhës.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Unë e përgëzoj iniciuesin e këtij debati, deputetin Rekalii, për një iniciativë vërtet të qëlluar që organi më i lartë legjislativ i vendit të debatohet, të identifikohet, të hartohet politika, të marrë vendime, të miratohet rezoluta me përmbajtje konkrete për fokus-grupin më të rëndësishëm dhe më të shumënumërt në Republikën e Kosovës.

Unë do të kontribuoj në këtë debat me disa propozime që konsideroj që rekomandimeve të kësaj rezolute që është në disa pika do t'i hyjnë në punë dhe në fund me një konsensus të plotë dhe bëj apel që kemi konsensus për tema të tilla, të dalë një rezolutë vërtet konkrete, specifike dhe e zbatueshme në praktikë. Prandaj, çka na nevojitet që thjesht ta ndalim këtë degradim, që ka të bëjë me rininë, me politikën rinore dhe vërtet nga ai termi "fuqizim i rinisë", të kalojnë në një mbështetje konkrete institucionale dhe që shteti i Kosovës thjesht të merret në mënyrë pragmatike dhe konkretisht me qasjen ndaj fokus-grupit më të rëndësishëm dhe më të vlefshëm në shoqërinë tonë. Një koncept pragmatik konsensual për një strategji veprimi për rini, me limite kohore dhe me kosto buxhetore. Thjesht, duhet të hartohet politika, plane të veprimit, por edhe strategji sektoriale me kohë të përcaktuar dhe me kosto buxhetore se sa i kushton shtetit dhe institucioneve relevante kostoja buxhetore e realizimit të këtyre strategjive.

Dy, të rinjtë ndërmarrës të mbështeten nga institucionet relevante të Kosovës me start up-e. Një i ri që ka filluar të punojë në biznes në një ndërmarrje, qoftë nëse i punëson 2-3, e në veçanti 5 e më shumë punëtorë, vërtet ka nevojë dhe meriton që dora e shtetit të jetë prapa tij dhe ta mbështesë atë në iniciativën e tij biznesore dhe në rritjen e kësaj ndërmarrjeje. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të fillojë me fizibilitetin e kurrikulave dhe programeve të studimeve në akordancë të përafërt me kërkesat e tregut të punës në Kosovë, rajon, Bashkim Evropian, por edhe më gjerë. Vërtet është e nevojshme një fizibilitet i bazuar në statistikat zyrtare të institucioneve relevante, në bazë të të cilave pastaj edhe një komision, një task-forcë ndërministrorë që përfshin Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, e në veçanti Ministrinë e Financave dhe partnerë të tjerë, fokus-grupe të caktuara, të biznesit, të korporatave, partnerë ndërkombëtarë, që këto politika sektoriale dhe këta mekanizma si plane veprimi të jenë në harmoni të plotë me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, që një shtet normal i parashikon këto limite kohore, të mbështetura me buxhet.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Kulturës, Rinisë, Sporteve, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, të koordinohen në krijimin e mundësive dhe lehtësimin e qasjes së rinisë sonë, në veçanti të rinjve të talentuar, që i mbarojnë shkollat e mesme në fondet nga qeveritë dhe institucionet, apo edhe mekanizmat relevantë që t'u mundësojnë këtyre të rinjve të studiojnë në universitete prestigjioze, për ata studentë që natyrisht e meritojnë. Kemi ngecje në këtë aspekt, ka një lloj anemie dhe një lloj skepticizmi. Vendet e rajonit kanë përfituar shumë fonde, shumë bursa, shumë mundësi, nganjëherë edhe me një participim modest, por që të rinjtë e tyre, thjesht në dhjetë vjetët e fundit tani kanë mbaruar bachelor, e kanë mbaruar nivelin master dhe kanë marrë përgjegjësi dhe po udhëheqin me sukses dikastere të rëndësishme, në veçanti në ekonomi, ndërmarrësi, në integritime evropiane dhe në menaxhim.

Të inkurajohen institucionet e arsimit të lartë në të dy sektorët për shkëmbim të studentëve. Pse të mos fillohet me Shqipërinë. Jo vetëm institucionet publike apo universitetet publike, por edhe institucionet e arsimit të lartë privat dhe shteti thjesht ta monitorojë respektimin e këtyre marrëveshjeve dhe cilësinë e “Student Exchange”, që është një trend sot, në veçanti për vendet që sapo janë anëtarësuar në Bashkimin Evropian, apo për vendet e Ballkanit Perëndimor, sikur vendi ynë që aspiron të jetë pjesë e Bashkimit Evropian.

Dhe, krejt në fund, hapja dhe funksionalizimi, avancimi dhe një qasje më konkrete e shtetit, e shkollave profesionale, është absurd i kohës, i llojit të qeverisjes që më shumë kemi universitete publike sesa shkolla profesionale në vendin tonë. Prandaj, me këtë qasje, një numër i madh i të rinjve që e mbarojnë shkollën e mesme mund të aftësohen në këto shkolla profesionale, bie kërkesa për arsimin e lartë universitar dhe i jep mundësi shtetit që t'i profilizojë këto programe të studimeve që të jenë në përputhshmëri me trendët modernë të tregut të punës.

Dhe, në fund, kërkoj që të gjithë maturantët që janë në shkolla profesionale dhe studentët që janë absolventë në vitin e fundit, institucionet shtetërore, institucionet publike, publiko-private, të bëjmë apel që edhe ndërmarrjet private t'ua mundësojnë që ta mbarojnë praktikën një vit dhe pastaj kur të hapet mundësia e konkurrimit në cilado institucione qofshin ato, ndërmarrje, kompani publike, apo private, këta maturantë dhe këta studentë që janë të gatshëm për tregun e punës të mos kenë barriera procedurale, ku kërkohet praktika, apo edhe të bëhet apel te Ministria e Administratës Publike që të mos vërë barriera procedurale, “të rinj dhe me shumë vjet përvojë”. Në këtë formë ne e bëjmë një koordinim edhe funksional, edhe racional, ku shteti e ka në kornizë një kontroll të tillë ndaj politikave rinore dhe është një koncept i realizueshëm. Kjo e amortizon edhe papunësinë në shifra më të ulëta dhe kthen shpresën e të rinjve, e sidomos atyre që kanë potenciale edhe krijuese, edhe akademike, edhe shkencore dhe kapacitete tjera, që të qëndrojnë në vendin e tyre dhe ta ndihmojnë avancimin e mëtejshëm dhe zhvillimin ekonomik të shtetit tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: I nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar iniciues i këtij debati të rëndësishëm shumë për rininë, por qysh në fillim do të thotë ka filluar që të krijohet, dua ta bëj një digresion, njëfarë praktike që ndoshta për ta fituar një pjesë të elektoratit kemi filluar shumë të merremi me vajtime dhe kush më shumë e do rininë, ose njëri grup parlamentar ta atakoj tjetrin grup parlamentar se ai grup s'ka bërë kurrgjë, por ne bëjmë.

E në fakt, pa dallim, rinia në Kosovë pothuajse në të gjitha qytetet e saja është në gjendjen e njëjtë. Edhe shpërndarja politike e pushtetit është mirë që është bërë në mënyrë të ndryshme, parti të ndryshme udhëheqin komuna të ndryshme dhe gjendja e rinisë nuk dallon në Prishtinë me Prizrenin, e as në Gjilan me atë në Skenderaj apo në Mitrovicë është e njëjtë. Nuk mund të diskutoj pa i thënë disa gjëra që ne duhet t'i bëjmë edhe t'ia tërheq vërejtjen edhe vet iniciuesit të debatit.

Pasi që në mandatin e kaluar kam qenë në Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport ne e kemi monitoruar Ligjin për rininë dhe ne kemi nxjerrë disa rekomandime në të. Udhëheqësi i grupit punues dhe për monitorimin e atij ligji ka qenë Sali Morina, ish-deputeti i LDK-së. Mendoj se do të duhej iniciuesi përpara se të nxirrte këto propozimet për rezolutë, ta konsultonte të paktën Sali Morinën, i cili ka bërë një punë. Vjosa po thotë, "s'është deputet, s'vlen më". Në rregull, Vjosë.

Mendoj që këto dy rezoluta duhet me rekomandimet e komisionit të votuara më datë 13 shkurt 2017 në Kuvend janë në fuqi, këto rekomandime janë në fuqi. Unë do t'i lexoj, që ta dimë çka kemi votuar atëherë, për të gjithë deputetët që s'kanë qenë pjesë e asaj legjislature.

Pra, Kuvendi në fakt i ka miratuar këto rekomandime:

- Qeveria e Republikës së Kosovës të hartojë ligj të veçantë për punën vullnetare;
- Qeveria e Republikës së Kosovës nxjerr akt nënligjor, sipas nenit 6, paragrafi 2, me të cilin përcaktohen ministrinë përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të këtij ligji;
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të themelojë komision për punë vullnetare, sipas nenit 11 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2016 për punë vullnetare të të rinjve;
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të themelojë komision të përhershëm për edukim joformal të të rinjve, sipas nenit 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 12/2010 për edukim joformal të të rinjve;
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të bashkëpunojë me Këshillin Qendror të Veprimit Rinor, të organizojë konferencën vjetore për rininë e Kosovës, sipas Udhëzimit Administrativ nr.

9/2010 për përgjegjësitë dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të këshillave të veprimit rinor në Kosovë;

- Ministria e Financave në bazë të kërkesave të komunave të ndajë kod të veçantë buxhetor për rininë;
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe komuna të harmonizojë strategjinë e planit dhe veprimit për çështje rinore, me qëllim të fuqizimit të rinisë;
- komunat të sigurojnë financim të rregullt për qendrat rinore dhe këshillat e veprimit rinor;
- komunat të bëjnë licencimin e së paku një qendre rinore;
- komunat të shpallin konkurs për projekte rinore;
- komunat të themelojnë komision të pavarur për vlerësimin e projekteve të organizatave rinore.

Këto janë rekomandimet që ne i kemi votuar si Parlament i Republikës së Kosovës më 13 shkurt 2017. Pra, një vit më herët ne i kemi nxjerrë disa rekomandime, e tash e kemi edhe një rezolutë. E miratojmë edhe këtë rezolutë dhe pastaj, kur ta thërrasim në interpelancë ministrin, ose në komision, ai thotë “Çka me veprua unë? A t’u përmbahem rekomandimeve që i kemi votuar para një viti apo këtyre tani?”. Është mirë që këto të harmonizohen bashkërisht me ato rekomandime. Nëse kemi harruar diçka ta bëjmë para një viti, atëherë sigurisht që ato duhet të përmirësohen. Pra, të ketë njëfarë kontinuiteti edhe të punës edhe të veprimit tonë, sa u përket këtyre çështjeve.

Për të mos kaluar në çështje shumë politike, po më shumë të merremi me strategji dhe me monitorim, në veçanti të merremi me projekte zhvillimore ku do ta mbështesim rininë, atëherë ne duhet nga pakë t’u ikim disa debateve apo diskurseve publike, të cilat po paraqiten këtu.

Unë nuk mund të pajtohem me një fakt, është një gjë e vërtetë që në të kaluarën, në pushtetin e kaluar, pushtetin serb, një pjesë e të rinjve posa e kanë kryer shkollimin kanë hyrë në punë, shumë e vërtetë. Ama, kanë qenë fëmijët e pushtetarëve, njerëz të lidhur me pushtetin. Mua më befasoi Milaimi, që tha e mbështes atë idenë, ose diskutimin, e Adem Mikullovcit, se po një pjesë e rinisë si e kanë kryer shkollimin kanë hyrë në punë. Po, vetë Milaimi e ka lëshuar Kosovën për shkak se s’ka pasur perspektivë këtu në kohën e pushtetit. Po, sa ka qenë numri i atyre të rinjve që janë dergjur burgjeve të ish-sistemit jugosllav? Më herët diskutoi Andin Hoti, djali i Ukshinit. Edhe Ukshini e ka kryer shkollimin edhe të mirë, po mundësi për të punuar në Kosovë nuk i është dhënë, veç në burg ka ndenj.

Të mos harrojmë se për shkak të përfitimit të disa votave këtu ne ta mohojmë të kaluarën. E kaluara për rininë tonë ka qenë shumë e dhembshme. Ai është dergjur burgjeve të ish-Jugosllavisë dhe të Serbisë. Prandaj, ne mund të diskutojmë tutje, nuk mundemi as të kalojmë në atë nivel të diskutimit, me e krye vet shkollimin jashtë vendit, që numri i atyre fëmijëve e të rinjve sot në Kosovë që shkollohen jashtë vendit është i vogël, me thënë “Këta tjerët e kanë fajin, se këta po i çojnë fëmijët nëpër çerdhe e nëpër shkollime private, e unë bën të shkoj, bën edhe vet me shkua me e krye fakultetin, ose masterin, jashtë vendit!”.

Të mos kalojmë në këtë nivel të debatit, sepse nuk mund të përfitohen vota në këtë formë. Ne mund të përfitojmë vota edhe përkrahje si politikanë të rinia, nëse bëjmë projekte dhe strategji zhvillimore për ta dhe ua hapim perspektivën këtu, pa bërë krahasime me të kaluarën e hidhur të popullit tonë. Në veçanti të tillë kanë qenë mbi 90%, që nuk kanë pasur atë mundësi t'i gëzojnë të mirat e pushtetit në të kaluarën dhe të punojmë për të ardhmen e rinisë sonë, e cila është shumë e mirë. Në raport me të gjitha vendet e Bashkimit Evropian, rinia jonë është një rini e mrekullueshme, e cila më së paku është e atakuar me dukuri devijimi dhe kjo na bën të ndihemi mirë. Por, t'i japim mundësi dhe perspektivë zhvillimit të rinisë sonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Drita Millaku.

DRITA MILLAKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar qytetarë dhe ju kolegë deputetë,

Të flasim dhe të diskutojmë për problemet, sfidat, trajtimet e rinisë kosovare kërkon një kohë, sepse është temë sa e ndjeshme, aq edhe e gjerë si për nga rëndësia, ashtu edhe për nga kompleksiviteti problemeve dhe shqetësimeve socio-ekonomike që i ka rinia.

Hulumtime të shumta të bëra mbi strukturën demografike kosovare tregojnë se rinia përfaqëson mbi 60% të shoqërisë sonë. Pra, jemi shoqëri me plot energji, sepse vetë rinia përfaqëson boshtin kurrizor të një shoqërie me perspektivë dhe zhvillim në të gjitha fushat. Ne kemi fituar besimin për të përfaqësuar qytetarët tanë, në mesin e të cilëve hyjnë edhe të rinjtë.

Çfarë perspektive jemi duke u ofruar? A jemi duke bërë mjaft për të qëndruar afër dhe për t'i përkrahur në vështirësitë që po hasin në ndërtimin e një të ardhmeje, ashtu siç ëndërruan ata? Çdo i ri në këtë vend kërkon një vend pune, një vendbanim ku do t'i krijohet mundësia për krijimin e një familjeje, të kenë qasje të integrohen në fusha të ndryshme profesionale, për të cilat janë kualifikuar dhe kanë potencial ta bëjnë.

Gjendja aktuale është e mjerueshme të kjo kategori pasi që jo vetëm që numri i tyre është mjaft i madh, që figurojnë të papunë apo edhe kërkues pune në një vend. Sistemi i arsimit që kemi në vend ofron mundësi të shumta për arsimim dhe nxjerrje kuadrosh të diplomuara të të rinjve, mirëpo problemi qëndron në faktin se kjo pjesë e të rinjve të diplomuar nuk po arrijnë të jenë konkurrentë dhe të aftë të futen në tregun e punës, pasi që kualiteti i studimit që marrin nga shumë institucione arsimore, duke filluar nga niveli i ulët e deri tek ai i lartë, siç thanë edhe koleget e mia, lë shumë për të dëshiruar, sepse nxjerrim gjenerata të diplomuara por jo të afta për t'u futur në treg pune. Pjesa tjetër e shoqërisë, e cila ka arritur të studiojë në një vend jashtë vendit apo edhe nëpër kolegjet më me renome të shteteve evropiane ankohen se nuk kanë mundësi të gjejnë vende pune në fushat të cilat kanë kualifikim përkatës apo adekuat, pasi që në konkurset e punës që hapen sistemimi bëhet në bazë të nepotizmit dhe selektiviteti duke u dhënë

përparësi të madhe personave që janë militantë politikë, edhe pse nuk janë adekuatë për atë vend pune.

Shkalla e lartë e pesimizmit, si dhe gjendja adekuate socio-ekonomike po i shtyn shumë të rinj që të bien në gjendje depresioni dhe stresi, duke i shtyrë që ata të marrin vendime mjaftë të vrazhda për jetën e tyre, duke u munduar të vetëvriten, pasi që nuk po kanë trajtim adekuat dhe më se të nevojshëm për problemet me të cilat po ballafaqohen ata për çdo ditë.

Rasti që vërteton një gjendje të këfillë është argumentues edhe ngjarja mjaftë e hidhur dhe e vrazhdë që ndodhi para disa ditësh në Prizren, ku dy vajza të reja brenda shtatë ditësh u vetëvranë duke u hedhur nga lartësi të mëdha. A nevojitet edhe shumë raste të tilla që të ndërmerren hapa konkretë për t'u marrë më seriozisht me të rinjtë tanë apo është koha dhe momenti më i duhur për t'i përmbushur kërkesat e tyre dhe sadopak që mund të merremi ne me të rinjtë, t'u hapim pra vende të reja të punës dhe perspektivën për avancimin e tyre.

Institucionet tona qeverisëse në vend se të punojnë shumë në këtë drejtim, që rinia jonë, që është energjia, potenciali për zhvillim ekonomik, ndodh e kundërta. Ajo mendon se zgjedhja e vetme për zgjidhjen dhe ofrimin e perspektivës së të rinjve kosovarë është hapja e kufijve dhe lëvizja e lirë në zonën shenjen duke u dhënë mundësi të integrohen të gjithë këtë energji të tyre dhe të investojnë nëpër Evropë.

Pra, duhet të mundohemi me mish e me shpirt që të punojmë të gjithë për rininë tonë, që ta mbajmë atë për vete, sepse ata janë e ardhmja dhe shpresa e vendit tonë, sepse ua kemi borxh që t'u hapim rrugët, t'u krijojmë mundësi të reja për ndërtimin e ëndrrave të tyre dhe perspektivën e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Fisnik Ismajli.

FISNIK ISMAJLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë, kolegë,

Këto debatet për rininë me vite të tëra po përsëriten vazhdimisht. Rinia nuk po ka perspektivë, nuk po arsimohet, po shikojnë të ikin nga Kosova. S'po mund të gjejnë punë e vitet po shkojnë.

Kjo rini, herët a vonë, do të jetë ajo që do ta udhëheq këtë Kosovë, jo shumë larg prej sot. E si do të mund kjo gjeneratë ta udhëheq këtë vend më mirë, nëse sot nuk ka as shkollim adekuat, as përvojë profesionale të mjaftueshme, as njohuri për aktualitetet në Botë, sepse është i izoluar brenda kufijve të vetë. Nëse nuk ndryshon kjo gjendje menjëherë nuk po duket se në të ardhmen paskemi me pas Kuvend dhe Qeveri më ndryshe se ky sot, ku shumica që po udhëheqin janë pa shkollim adekuat, pa përvojë profesionale të mjaftueshme e pa njohuri për aktualitetet në Botë.

Për s'e di të satën herë, sot prapë po flitet për probleme me të cilat po përballet rinia kosovare. Po, të dashur kolegë, po e dimë shumë mirë, që rrafsh 19 vjet. A e dini sa janë 19 vjet? Një periudhë ku një i ri që nis shkollën e mesme, arrin moshën kur më nuk është i ri, po ka krijuar familje dhe bartë barrën e një personi të rritur. Në ndërkohë i ka kaluar rinia pa u përgatitur se si duhet të përballet me krejt ato obligime, s'ka as përgatitje profesionale e as punë të mirëfilltë. E pastaj po çuditeni pse po ikin krejt prej këtu!

Nëse pretendoni ta ndaloni krimin dhe përdorimin e drogës nga të rinjtë, nëse doni mos me i pa ata duke e çuar krejt rininë e tyre nëpër kateteri, atëherë duhet të gjeni një zgjidhje shumë shpejt. Sot, unë s'po dua ta bëj atë që e bën opozita tërë kohën, ta kritikoj e fajësoj udhëheqjen e vendit prej paslufte, por dua sot të propozoj një zgjidhje për këtë çështje, e cila jo vetëm se do të rehabilitonte rininë kosovare, por edhe do të kontribuonte në zhvillimin ekonomik dhe në mirëqenien e secilit qytetar të Republikës së Kosovës, pa dallim moshe.

Sot, teknologjia po ndryshon me aq dinamikë të shpejtë, sa që nuk mund të presim as Ministrinë e Arsimit e as katër vjet shkollim nëpër universitete për të aftësuar të rinj në fushën e teknologjisë informative. Teknologjia aq shpejtë po ndryshon nëpër Botë, sa që edhe në fund të studimeve një i diplomuar del me dituri të vjetruara në këtë fushë.

E kemi një ministri të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë e nëse kjo ministri nuk merret pikërisht me këtë çështje, atëherë absolutisht nuk duhet as të ekzistojë. Madje, prej ditës që është hapur mua më mundon ta di se çfarë funksioni saktë ka kjo ministri.

Janë shembuj të panumërt nëpër Botë, duke filluar prej Indisë e tash edhe në Ballkan, ku janë hapur kompani që ofrojnë shërbime të teknologjisë informative për kompani të ndryshme në botën perëndimore. Aplikacionet që ju i përdorni në telefonat e juaj e që duket se janë të ndërtuara prej kompanive amerikane, faktikisht ka gjasa, shumë gjasa, që i ka programuar një i ri në Indi apo në Bullgari. E me paratë që amerikanët e paguajnë një programet në Amerikë, më shumë kanë llogari të paguajnë një ekip programorësh në një shtet në zhvillim. Kjo mënyrë e punës quhet "business progress outsourcing" dhe sot në Kosovë janë disa kompani të suksesshme, të cilat krejt të ardhurat e tyre i vjelin prej shteteve perëndimore.

Janë para të pastra, pa shumë shpenzime, që hyjnë në Kosovë pa u dashur investime kapitale e pa u dashur të ndërtohet fabrika të shtrenjta dhe të gjitha mbeten në Kosovë. Thjesht, është një mundësi për të eksportuar mendjen, meqë me prodhime s'po mund të shtyhem me shtetet tjera. E, për ta eksportuar këtë mendje kjo Qeveri, në veçanti Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, duhet të luajë një rol shumë kyç në gjetjen e mënyrave inovative, me i aftësua të rinjtë kosovarë në teknologjinë edhe në asistimin e hapjes së ndërmarrjeve të reja dhe mbështetjen e atyre ekzistuese që tashmë janë në Kosovë.

Nuk duhet shumë inovacion, kolegë të dashur, për ta certifikuar një të ri për t'u bërë, po e zëmë, programer. Një kurs intensiv prej 6 - 9 muajsh me trajnerë të huaj e aftëson për ta filluar punën në një kompani menjëherë. Kjo vetëm i kushton një të riu diku rreth 5 mijë euro, por për të është një investim jetësor, që mund t'i kthehet ekonomisë së vendit pas pak vitesh shumëfish. Prandaj, mundësimi i trajnimeve të tilla për të rinj, duka ua lehtësuar atyre shpenzimet dhe duke i nxitur të merren me këtë fushë, duhet të jetë prioritet për Qeverinë qysh prej ditës së nesërme. Paralelisht, ndërmarrjet që ofrojnë shërbime të teknologjisë informative për kompani jashtë vendit duhet të përkrahen, duka ua mundësuar atyre infrastrukturën që më së shpeshti nënkupton një lidhje e shpejtë e internetit dhe e sigurt edhe sigurimin për pajisje, lirim nga tatimet për kompanitë fillestare, si dhe përkrahjen shtetërore nëpër vendet botërore, ku këto kompani i kryejnë këto shërbime.

Kolegë,

Jemi vendi me më së shumti të rinj për kokë banori në kontinent, jemi vendi me fuqinë më të lirë punëtore në Evropë, jemi vendi me rininë më entuziaste e më të aftë për t'i folur disa gjuhë të huaja, jemi gjeografikisht të pozicionuar në të njëjtën zonë kohore me krejt Evropën, një orë dallim prej Britanisë së Madhe, gjashtë orë dallim prej Shteteve të Bashkuara të Amerikës edhe s'po dimë ta shfrytëzojmë këtë rast aq madhor, që nuk i jepet gjithkujt.

Eksportimi i mendjes duhet për një kohë të shkurtër, jo veç të ndryshojë dukshëm, po të krijojë revolucion ekonomik në një vend kaq të vogël si Kosova. Shembuj ka në Botë e ka edhe këtu në Prishtinë, vetëm vullneti po mungon. E nëse nuk keni as vullnet, as dituri, për ta shtyrë këtë punë përpara, atëherë ju nuk jeni as të aftë për të udhëhequr një shtet të shekullit XXI, i cili mbi të gjitha duhet të jetë në hap me teknologjinë. Nëse ky është rasti, atëherë lëshojani rrugën atyre që dinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Fisnik! Tani ia jap fjalën deputetit Blerim Kuçi.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesues!

Tash ne si deputetë e kemi para vetes edhe një rezolutë. Rezoluta i ka jo më pak se 14 pika, më shumë ngjanë me një lloj plani të veprimit, se me një rezolutë.

Pika e parë e rezolutës është të krijohet strategji për rini.

Pika e tretë thotë, të bëhet plani i veprimit,

Këtu kemi edhe kryesuesin, që ka qenë ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe ai në kohën e vet e ka bërë një strategji, nja dy plane veprimit i mbaj në mend që i ka krijuar si ministër. Kemi edhe, momentalisht nuk është këtu, zotin Memli Krasniqi, ka krijuar në kohën e vet si ministër edhe Qeveria e tij, kanë krijuar strategji për rini edhe nja dy-tri plane të veprimit.

Pra, ne me rezolutë e me këso strategji e plane të veprimit kemi me bollëk. Plane të veprimit me vagonë, por zbatim të planeve dhe strategjive kemi me biçikletë. Pra, ne po vuajmë prej zbatimit të planeve të strategjive dhe planeve të veprimeve. Edhe me këto rezoluta, me kopjua edhe ato punën e ministrive nuk ka kuptim. Veç po e lodhim Kuvendin. Më mirë do të ishte me marrë ndonjë vendim, me thënë Vendim. Buxheti i Kosovës ndahet 10% e tërë buxhetit, në qoftë se është aq me rëndësi edhe unë jam i sigurt që është me rëndësi, me thënë, po, buxheti i Kosovës do të ndahet për përkrahje të rinisë 10% e buxhetit, që është 200 milionë, 300 milionë... kjo ka kuptim. Këto vendime kanë kuptim.

Me thënë do të krijojmë shkolla profesionale, ose shkolla të zanateve, po. Ose, një plan konkret ishte ideja e koleges sime Haxhiu, që prapë edhe ajo nuk është këtu sot në këtë moment, që tha të ju njihet praktika si përvojë e punës. Këto janë gjëra konkrete që ne duhet të merremi, ose ta detyrojmë Qeverinë të merret. Në fakt, ne nuk kemi nevojë ta detyrojmë, Qeveria e ka vullnetin e mirë për këtë punë, vetëm duhet paraparë me buxhet.

Nuk ka prioritet pa buxhet. Cili është prioriteti për rininë, kur nuk përmendet buxheti?

Po e them edhe një herë, strategji krijojmë sa të doni, plane të veprimit sa të doni, po vendime të cilat implementohen dhe për mua është vendim, në qoftë se dëshiron me e ndalë rininë mos me shkua jashtë edhe mos me e lëshua Kosovën, atëherë duhet me thënë: 3% e buxhetit, 7% e buxhetit apo 10% e buxhetit, në qoftë se ka nevojë edhe 15% e buxhetit është e kuptueshme.

Pra, këto janë vendime që ne mund t'i marrim, ose ta detyrojmë Qeverinë, në qoftë se e kemi përnjëmend, në qoftë se jo, atëherë i krijojmë edhe do plane strategji dhe zakonisht strategjitë po janë sa mandati i një ministri, katër vjet, ose planet e veprimit shumë afatshkurtra, por ne duhet të marrim një vendim. Vendimi ynë është me thënë 10% e buxhetit dhe unë po propozoj 10% e buxhetit 2019 të shkojë për ndaljen e rinisë, për perspektivën e tyre, për krijimin e bizneseve për të rinj, për shkollimin e tyre, atëherë ka kuptim. Kurse, me strategji, me plane të veprimit nuk ka kuptim.

E tha shumë mirë Baci Adem, tha: Nuk e di ku është faji, po diku është. E faji është marrja e vendimeve, jo krijimi i strategjive dhe planet e veprimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Blerim. Për shkak se strategjitë dhe planet e veprimit kanë afate, prandaj kërkohet që të bëhen të rehat, ndërkaq Buxheti vërtet është kostoja e strategjive dhe e planit të veprimit. Domethënë, është mjeti që përtej mjetit ligjor, është mjeti që shoqëron implementimin e tyre, ndërkaq puna praktike ligjërish njihet si përvojë, por duhet të implementohet. Faleminderit! E dëshironi fjalën? Po, Blerim Kuçi, urdhëro!

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesues!

Ka të bëjë me rezolutën. Rezoluta është në njëfarë forme e detyrueshme për Qeverinë. Po thotë: krijimi i strategjisë për rini. Çdo ministri, edhe ministri aktual, edhe ju kur keni qenë ministër, keni krijuar një strategji. Rezoluta po thotë me bë plan të veprimit. Po ajo dihet, ministri aktual është i obliguar dhe duhet ta bëjë planin e veprimit, domethënë nuk është zgjidhje kjo, diçka që e kemi provuar në këtë proces dhe s'do të mund ta ndalim rininë, nuk ka kuptim të bëhet një rezolutë e tillë. Për këtë po them që më mirë është një vendim, kur e ke buxhetin e caktuar, atëherë strategjia është e lehtë e implementueshme, se ke buxhet adekuat. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë ju diskutojeni përmbajtjen e rezolutës dhe përpiquni ta harmonizoni. Fjalën e ka deputeti pa grup parlamentar, Islam Pacolli. Urdhëro, Islam!

ISLAM PACOLLI: Faleminderit, kryesues!

Sigurisht që është një temë e rëndësishme dhe mendoj se rinia është jetike për Republikën e Kosovës. Po çka kemi bërë ne për rininë? Rinia është e rëndësishme të trajtohet që nga koha parashkollore, gjatë shkollimit, t'i krijohen kushtet adekuate, universitetet me cilësi të lartë, ajo është baza, themeli i rinisë sonë, ne aty kemi çaluar dhe ende çalojmë, kjo vazhdon tutje.

Çka është bërë për rininë? Një shembull shumë i thjeshtë: a është krijuar infrastruktura sportive e kulturore? Jo. Rinia sot për sot nuk ka kushte që të gjendet në të gjitha këto, për arsye që kostot janë të larta, sot nuk kemi asnjë pishinë publike, asnjë sallë sportive publike që ua mundëson njerëzve me një kosto ndoshta të vogël apo falas, sidomos për studentët, nuk kemi asnjë.

Qysh po mendojmë ne të thirremi në rini, kur nuk krijojmë kushte.

Pastaj nëse rinia kryen shkollimin, a kanë ku të bëjnë praktikën? Unë them jo. Praktikën mund ta bëjnë vetëm ata që kanë 'muskujt e fortë', është pjesë e një politike së caktuar, asnjëherë dikush tjetër.

Pastaj kurset që shpallen për punësim, thotë duhet me i pas pesë vjet përvojë pune në menaxhim, po ai posa i ka përfunduar studimet, ku i merr ato pesë vjet, qysh do të punësohet? Do të thotë, që në start humb mundësia e atij.

Ne duhet ndërruar këto kritere, duhet dhënë qase më shumë për rininë, nëse ne me të vërtetë e duam një të ardhme, e ardhmja nuk bëhet vetëm me ngjyra politike, e ardhmja bëhet me cilësi.

Ne duhet të përkushtohemi aty dhe pastaj të themi që do të arrijmë dikur apo do të bëjmë diçka për rininë.

Është e keqe sot për sot që dikush është me një notë mesatare 9 apo ka edhe 10-she kur vjen dikush me një 6 dhe ai punësohet e ky tjetri jo, do të thotë është zhgënjim dhe pa tjetër e ke dëshpëruar. Ne nuk krijojmë as kushte, po edhe ato që janë, nuk i krijojmë kushtet e barabarta, për arsye se harrojmë që këta të rinj janë qytetarë të Republikës së Kosovës, pastaj nuk duhet me i nda me ngjyra, po ne duhet përkrahur të barabartë dhe është mirë të ndahet në të gjitha dikasteret edhe buxheti adekuat që t'u japim kushte dhe mundësi, e pastaj të thirremi në rini. Po deri më sot i kemi të gjitha kërkesat vetëm folklorike dhe politike, më së paku janë ato që ne ju krijojmë kushte. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Kolegë deputetë,

Ndoshta nuk është e paktë të flasim për një temë, e cila jo rrallë në mënyrë individuale dhe debatohet edhe në bazë të brengave që paraqesin edhe deputetët, edhe strukturat e tjera individuale.

Deputeti me nismën e tij sigurisht ka paraparë që të kemi një konsensus të përgjithshëm dhe të dakordojmë jo vetëm në aspektin e një rezolute, po të përcjelljes së këtyre rekomandimeve dhe unë ndoshta në kuadër të kësaj e kisha shtuar edhe një paragraf, i cili e obligon Komisionin e Arsimet që ka të bëjë edhe me rininë që në këto periudha kohore të kërkojë edhe shqyrtim, edhe implementim se ku ka mbërritur Qeveria e Republikës së Kosovës, eventualisht nëse kalojnë si të tilla, sepse përndryshe atëherë mbesin në sirtarë edhe të ministrisë së caktuar, por edhe te dikasteret të tjera që kërkojnë implementimin e tyre.

Sepse teksti është shumë i qartë, mbi të gjitha është më shumë se domethënës dhe përfshin pothuajse të gjitha brengat që mund të arrihen përmes plotësim-ndryshimit të ligjeve, por edhe planeve të tjera që kanë të bëjnë me sjelljen e një statusi të rinisë sonë, e cila në numër është e madhe, e begatshme, po në pjesën tjetër lidhet me qeverisjen në vend dhe tash te qeverisja në vend ka sjellë Kosovën, të mos e quaj kështu, 'në fund të pusit'. E më së keqi po e pësojnë të rinjtë tanë. Tash pse? Sepse nëse i pyet çdo i dytë do të jepte gjithçka nga vetja për të ikur nga ky vend për një jetë më të mirë dhe kjo flet shumë.

Ata tash nuk duhet të kthehen në një dhembje tonën, po një kërkesë që Qeveria e Republikës së Kosovës, me kapacitetet e saj, të jetë prioritare e zgjidhjes së problemeve të tyre.

Sot të gjithë të rinjtë, të cilët kryejnë fakultet, master a doktoraturë, mbesin pothuajse në shtëpi dhe paramendon për çdo të ri, për ta, është fundi i botës, duke e parë veten apo duke i parë moshatarët të tyre se si sigurojnë vende pune me intervenime si parashutist dhe pa i pasur dy

lidhje me krye, e kjo ndodh për çdo ditë në institucionet tona të kapura nga individë dhe grupe të caktuara dhe këto edhe i proklamojnë si suksese.

Kjo ka të bëjë me dëshpërimin dhe nëse neve na dëshpërohet rinia në tërësi, me këto padrejtësi, atëherë cila do të jetë edhe kërkesa jonë e ardhshme për të dalë para tyre për të kërkuar votën dhe besimin, në tërësi kështu si deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku jo rrallëherë tentojmë apo tentohet të ketë edhe banalizime të temave, gjuajtje në mënyrë individuale që problemet mbesin brenda kësaj dhome këtu dhe asnjëherë të mos kërkojmë zgjidhje.

Andaj, mendoj që fatkeqësia e radhës në këto interpelanca është mungesa e Qeverisë, mungesa e ministrave të linjës, sepse këtu shihet që nuk janë në gjendje të ballafaqohen me sfidat, të cilat i kanë qytetarët e Republikës sonë, e në këtë aspekt po flasim për rininë.

Nuk mund t'u mbytet ambicia për të ardhmen nga këto sfida dhe Qeveria dhe institucionet në tërësi ta kenë kujdesin minimal për rininë tonë.

Ne duhet t'u ofrojmë zgjidhje, Qeveria duhet t'u ofrojë zgjidhje dhe ata ta vazhdojnë rrugëtimin e tyre për një jetë më të mirë, të begatshme, si të gjithë të rinjtë dhe bashkëmoshatarët e tyre anëmbanë botës.

Andaj, të nderuar kolegë deputetë,

Mendoj që rinia kosovare është duke u gjendur në një udhëkryq, duke u përballur me sfida të ndryshme, duke filluar prej edukimit, arsimimit, punësimit, mirëqenies ekonomike dhe shumë fusha të tjera.

Kjo nuk duhet të jetë thirrje vetëm për kurajë dhe për punë, por duhet të jetë reflektim në të gjitha këto, të cilat neve sot po i bisedojmë, po i kërkojmë dhe propozuesi, deputeti ynë i ka parashtrua në mënyrë shumë të saktë, në konsultim edhe me forcat e tjera politike, por mbi të gjitha në konsultim me kërkesat e të rinjve në Republikën e Kosovës.

Unë uroj që në këtë vend të ndryshojë diçka, sidomos në interes të të rinjve, por nga qeverisje e keqe, e cila po udhëheq me shtetin dhe deri te parregullsitë e tjera, mbetem skeptik që me këtë logjikë rinia jonë mund të ketë një jetë më të mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Hajdar Beqa nuk është në sallë. Fjalën e ka deputeti Mërgim Lushtaku.

MËRGIM LUSHTAKU: Faleminderit!

I nderuar kryesues,
Të nderuar deputetë,

Tema që është para nesh sot është e rëndësishme së veçantë, sigurisht që rinia është aseti më vital i një shoqërie dhe si e tillë duhet të trajtohet me përgjegjësi.

Unë i kam parë edhe rekomandimet dhe pikat e rezolutës dhe besoj që këto pika, në bashkëveprim me Fidanin, i cili është edhe iniciator, mendoj se janë shumë të mira, nuk dua të përsëritem, pasi që shumica e deputetëve e kanë vënë theksin në shumicën e dukurive dhe problemeve që i ka rinia, e ato në Kosovë janë të shumta, por kisha veçuar disa pika, të cilat mendoj që ia vlen të ritheksohen.

Besoj që në fokus të veçantë të të gjithë deputetët, po në veçanti edhe unë, mendoj që është alternativa për studim me vizion të punësimit.

Pasi që ne e dimë shumë mirë që në fund të vitit shkollor maturantët ballafaqohen me dilema të shumta se çka të studiojnë dhe nga t'ia mbajnë. Ata ndjejnë që duhet të bëjnë diçka, por nuk e dinë saktësisht se çka, edhe pse ata janë konfuz totalisht, përveç një pakice të vogël, që e dinë qartë se çfarë duan, askush nuk merret me ta, as shkolla, as familja, as shoqëria, as Qeveria.

Nën pretekstin se ne jemi shoqëri e lirë dhe le të bëjnë çfarë të duam, por në moshat e tyre është i tillë që ata nuk e dinë shumë, këtë e thotë edhe një autor i famshëm, siç është Henri Ford, kur e ka zbuluar prodhimin masiv të veturave dhe ka thënë se po t'i pyeste klientin se çfarë do të donte, ai do të thoshte se e do një kali më të shpejtë.

Pra, ata nuk e dinë se çfarë donë dhe në këtë formë, unë e kam marrë vizionin e tyre dhe e kam zbuluar veturën. Kësi soji besoj që edhe Qeveria e Kosovës, pa marrë parasysh që i takoj Partisë Demokratike të Kosovës, e di që në formimin e saj, nën udhëheqjen e saj Partia Demokratike e Kosovës ka udhëhequr me shumë segmente dhe ka çuar përpara asete të mëdha të Kosovës, deri te pavarësia e vendit, zhvillimi i saj ekonomik, ka bërë investime në infrastrukturën shkollore, spitalore, po sigurisht që kurrë nuk është e mjaftueshme të investohet edhe më tutje për rininë e Kosovës.

Në këtë segment do të fokusohem më shumë që të koncentrohemi në tregun, se çfarë kërkon tregun dhe, në këtë aspekt të koncentrojmë edhe plan-programet që të hapim më shumë vende të studimeve në fushat e ndryshme, siç janë, për shembull, në shkencat kompjuterike, në infermieri apo në shkolla profesionale, e të tjera.

Kam një propozim konkret që shqiptarëve të Medvegjës, Bujanovcit, Preshevës dhe Malit të Zi t'u mundësohen studimet në universitetet publike, me kushte të barabarta me ata të Kosovës.

U diskutua edhe për çështjen e financimit të rinisë, sigurisht që buxheti i Departamentit të Rinisë është rreth 300 mijë euro, çka do të thotë se nuk është i kënaqshëm, nuk është i mjaftueshëm dhe është i kufizuar.

Ju e dini se mbi 50% e popullatës sonë është e re, nga mosha 0 deri 35 vjeç dhe mund të kalkulojmë shpejt se sa cent janë ndarë për një kokë banori ose për kokë të rinjve.

Bëhet fjalë për cent, pra shuma të imta, çka nënkupton se vërtet është shumë problem të trajtohet kjo çështje. Edhe unë mendoj si shumë deputetë këtu se është mirë të rrisim buxhetin për rininë, jo vetëm në aspektin e kulturës, rinisë dhe sportit, por edhe në aspektin e arsimit dhe të bursave të ndryshme.

Një propozim konkret është të zvogëlohet diskriminimi moshor ndaj rinisë, duke ofruar stimuj financiarë për firma që angazhojnë punëtorë të rinj.

Programi duhet të shënjestrojë kryesisht rininë të pafavorizuar 16 deri 24 vjeç, që kërkon punësim, po nuk ka një përvojë paraprake në sektorin formal, si dhe që ndjek shkollimin fillor apo të mesëm.

Ofrimi i stimujve për punëdhënës për të angazhuar të rinj dhe për t'u dhënë mundësi për praktika pune, do të luftonte besimin e punëdhënësve që rinia është e papërvojë apo e papjekur.

Stereotipat negativë të këtyllë shpesh kanë ndikim të madh te rinia.

Pastaj Ligji për fuqizimin e rinisë e vlerëson punën vullnetare si përvojë pune, megjithatë, puna vullnetare nuk pranohet si përvojë pune nga sektori privat.

Shteti duhet të mbështesë qendrat rinore që ato të bëjnë më shumë në promovimin e punës vullnetare, e gjithashtu të jenë në gjendje ta dokumentojnë përvojën e punës, e jo vetëm në kohën e kaluar si vullnetarë.

Dokumentet e përvojës vullnetare duhet të përfshijnë aftësitë e fituara, trajnimet e kryera dhe arritjet e suksesshme.

Ne e dimë se gjithashtu ka nevojë të mbështetet rinia në 'start up' dhe në zhvillim të bizneseve. Në këtë drejtim vlerësoj shumë iniciativën e Ministrisë së Inovacionit, e cila ka një mbështetje të veçantë në këtë fushë. Sigurisht që edhe ne si deputetë kemi bërë tonën, duke e mbështetur financiarisht me rreth 7 milionë euro për të mbështetur të rinjtë dhe inovacionin në këtë drejtim.

Ndërmarrësia dhe vetëpunësimi: ndërmarrësia është zgjidhje reale e rritjes së punësimit në Kosovë, megjithatë për të nxitur ndërmarrësit duhet të ketë përmirësim në mjedisin dhe mundësinë e biznesit, promovimin e programeve ndërmarrëse si dhe për të mësuar për ndërmarrësinë.

Të dizajnojmë më mirë shuma të granteve për të mbuluar koston e krijimit dhe investimeve të nevojshme të bizneseve, si dhe të afrojmë veprimtari të vazhdueshme për të siguruar qëndrueshmëri të bizneseve.

Kjo bëhet besoj lehtë, pasi që ne kemi tash edhe këtë mbështetje, besoj që është mirë edhe të trajnohen të rinjtë se si të startojnë me biznese, si të bëjnë biznese dhe si të jenë të suksesshme ato biznese.

Në fund kisha përmendur edhe disa shqetësime të rinisë, besoj që edhe ne si politikanë kemi shqetësime, është vetë fenomeni i migrimit, është mjaft shqetësuese, pasi që pritet shumë shpejt edhe liberalizimi i vizave, duhet një sensibilizim të rinjtë se çfarë përfitojnë me liberalizim të vizave, cilat janë mundësitë e mira, po edhe disavantazhet, pasi që ne nuk jemi të interesuar si shtet t'i humbim të rinjtë në qorrsokakët e Evropës, por jemi të interesuar që rinia të shkojë atje, të studiojë dhe të kthehet me perspektivë në Kosovë.

Problemet e familjes dhe martesës përbëjnë gjithashtu një tjetër çështje polemizuese të rinjtë. Besoj që ata duken se nuk e preferojnë martesën në këtë moshë, por gjithsesi nuk janë të sigurt për pasojat e fenomeneve të tjera të realizimit të saj, megjithëse përpiqen të japin një mendim lidhur me to.

Në këtë drejtim besoj që ia vlen të mbështeten, si çdo kund në Evropë që mbështeten të rinjtë në krijimin e familjeve të reja, duke u mundësuar dhe stimuluar edhe për rritjen e fëmijëve, kjo besoj që do të krijonte një pavarësi të rinjtë dhe besoj që në këtë drejtim do të kemi një qëndrueshmëri më të madhe të familjes, e cila është qelizë bazë e shtetit tonë. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Janë edhe shtatë deputetë, në qoftë se dëshironi, mund të diskutojmë nga 5 minuta të gjithë që ta përfundojmë sot diskutimin. Atëherë po shkojmë, regjia, të gjithë që e kanë kërkuar fjalën po pranojnë. Fatmire Kollçaku, fjala për ju.

FATMIRE MULHAXHA-KOLLÇAKU: Faleminderit!

Ne sot po flasim për rininë dhe shumica preferojnë t'i referohen si 'e ardhmja', sepse e tanishmja është e rezervuar për dikë tjetër, ndërsa harrojmë që po flasim për shumicën e popullatës, pjesën më të madhe, të cilët janë, në fakt, do të duhej të ishin bartës të proceseve që sot, e jo vetëm në të ardhmen.

Flasim për një rini shumë tolerante, e cila në kushte të një pabarazie të thellë, qoftë në shkollim, në punësim, e të mos flasim edhe për qasjen në trajtim shëndetësor, që është shumë e pabarabartë. Prandaj, megjithatë, është për t'u habitur sesi nuk kemi shumë më tepër trazira sociale me një situatë të tillë, por unë këtu e ftoj rininë që të jenë shumë më aktive, t'i denoncojnë të gjitha rastet e punësimeve në mënyrë të parregullt, prandaj ajo çka duhet t'ia ofrojmë rinisë, fillimisht janë shanset e barabarta, mundësitë e barabarta, që së paku në këto kushte që nuk ka mundësi të punësohen të gjithë, së paku të punësohen ata që e meritojnë dhe t'u mundësohet shkollimi, t'u jepen bursa atyre të rinjve që e meritojnë dhe vetëm sadopak ta zbutim këtë pabarazi, sepse po flasim për të kaluarën, por është për t'u habitur sesi tani i morëm ato modele nga e kaluara dhe a ka hipokrizi më të madhe që dikush këtu sot të thotë se sot ka barazi në punësim, se sot të gjithë ata që e meritojnë punojnë, por vetëm ata që jetojnë në Kosovë e dinë vërtet realitetin.

Mirëpo, unë këtu desha ta ngre vetëm një çështje, po flas për të rinjtë me aftësi të kufizuara, përveç të rinjve që janë të shëndoshë dhe kanë kaq shumë barriera, atëherë çka të flasim për të rinjtë që janë me nevoja të veçanta dhe kanë shumë barriera tjera që të marrin pjesë në jetën sociale, ekonomike, kulturore dhe politike. Është një ligj që u miratua, Ligji për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me nevoja të veçanta dhe këtu e kam obligim moral që të flas për të rinjtë, të cilët kanë qenë edhe në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, për shembull të rinjtë që janë të verbër dhe me të pamë të dëmtuar, të cilët kanë paraqitur shqetësime në komisionin tonë për diskriminimin gjatë punësimit, sepse nuk zbatohet së paku ligji i cili kërkon që një institucion, qoftë privat, qoftë publik, që punëson së paku 50 punëtorë, në çdo të 50-tin ta punësojë një person me nevoja të veçanta.

Shumë të rinj, të cilët me vështirësi shumë të mëdha, vetëm duke iu falënderuar familjeve këmbëngulëse që i ndihmojnë këta të rinj që të shkollohen, në fund dekurajohen, sepse nuk zbatohet minimumi i kërkesës që këto institucione t'i punësojnë, e lëre më institucionet tjera që nuk janë të obliguara me ligj. Është e qartë që bizneset duhet të favorizohen dhe të kenë lehtësira, qoftë edhe tatimore nëse i punësojnë këta të rinj, mirëpo ne duhet të bëjmë shumë më tepër si shoqëri që këta të rinj, edhe në këtë debat sot, të mos ndihen të diskriminuar, sepse shumë herë harrojmë që janë pjesë dhe duhet të jenë pjesë e barabartë e shoqërisë.

Prandaj, mendoj që propozuesi i rezolutës, edhe pse nuk jam fare optimiste që këto rezoluta do të zbatohen, sepse nuk janë obligative për Qeverinë, dhe vetëm nga ky Kuvend dhe nga këta deputetë varet sesa do të gjejë zbatim rekomandimet nga këto rezoluta duke bërë presion te

Qeveria dhe duke i shikuar afatet kohore, të cilat ne sot gjatë nxjerrjes së rezolutave i afatizojmë dhe asnjë nuk interesohemi, siç u tha këtu, në një rezolutë që është miratuar më herët, çfarë është bërë me ato rekomandime, pothuajse asgjë, dhe lus propozuesin e rezolutës që ta ketë parasysh që në njërin nga pikat të futet edhe zbatimi i Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me nevoja të veçanta, që së paku ta bëjnë minimumin për këta të rinj që sot, krahasuar me të rinjtë e tjerë që janë të shëndoshë dhe nuk kanë nevoja, nuk kanë kufizime, t'u jepet një mundësi që edhe ata të jetojnë, së paku pak ta dinë që janë qytetarë të barabartë të këtij vendi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ganimete Musliu, fjala për ju!

GANIMETE MUSLIU: I nderuar kryetar!

I nderuar ministër, i vetëm që jeni në sallë,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Meqë në debatin për rini sot u diskutua edhe për çerdhet. edhe për gjërat tjera, po i jap edhe unë të drejtë vetes që ta bëj një pyetje: Për cilën rini po flasim? Për atë gjeneratë që u dogj pas luftës me shpresën që të paktën fëmijët e tyre ta kenë një të ardhme? Apo për gjeneratën e këtyre fëmijëve që u rritën pas luftës, po ashtu me shpresë që kjo klasë politike ta ndërtojë një shtet me perspektivë. Edhe ky debat sot na bën të kuptojmë se si klasë politike, agjendë kryesore e kemi interesin tonë personal, elektorat dhe imazhin fejsbukian.

Nëse vërtet si klasë politike brengosemi për rininë e këtij shteti, atëherë duhet të dëshmojmë duke e reformuar këtë sistem politik, e që kjo arrihet vetëm duke bërë reforma të guximshme, duke filluar nga këtu ku po flasim sot. Rinia e Kosovës nuk duhet të humbë kohë me premtime boshe, por ta ngrejë zërin kundër çdo degjenerimi, që kosto e ka të ardhmen e saj. Rinia e Kosovës duhet të jetë shumë më e zëshme në artikullimin e kërkesave, përndryshe do të kalojnë edhe 20 vjet me shpresa dhe premtime të kota. Ne si klasë politike duhet të krijojmë stabilitet politik në vend, i cili si rrjedhojë sjell forcimin ekonomik të vendit, e zhvillimi ekonomik do ta rriste mundësinë e të rinjve për ta shprehur kreativitetin dhe të tregojnë aftësitë e veta në vendin e tyre, e të mos e shikojnë të vetmen mundësi largimin nga Kosova.

Rinia e Kosovës po përballet me vese të rëndomta nga më të llojllojshmet, si: droga, prostitucioni, alkooli e tjera. E këto vese janë si rezultat i situatës së rëndomtë shpirtërore dhe ekonomike që po kalon shoqëria në përgjithësi, e rinia në veçanti. Sa herë flasim për rininë, më krijohet përshtypja se fokus e kemi vetëm rininë urbane, pa u ndalur ta shohim rininë e fshatrave, të cilët përkundër të rinjve në qytetet, të cilëve rrethanat e mjedisit ku jetojnë u ofrojnë më shumë mundësi për rekreacion e aktivitete, ata në fshatra bëjnë një jetë pasive, për të mos thënë depressive, dhe çdokush që u ofrohet ata mundohen ta shohin si mundësi për të lëvizur, sepse mungojnë qendrat kulturore sportive, qendrat e rekreacionit dhe janë larg vëmendjes së shtetit, prandaj fatkeqësisht shumë nga ata kanë përfunduar edhe në luftën në Siri.

Është e lehtë të flasim e të thurim vargje për rininë sot, por duhet të jemi të kujdesshëm kur flasim, sepse po flasim për atë rini që po na vdesë në vende pune, për shkak se nuk respektohet Ligji i punës dhe nuk garantohet siguria e tyre në punë. Nuk jemi të gatshëm as t'i monitorojmë ligjet që miratohen në këtë Kuvend dhe në mungesë të zbatimit të ligjeve bastardohet edhe sistemi, dhe rrezikohet jeta e kësaj rinie. Rinia e Kosovës përballet me sfida prej më të ndryshmeve, si: sfida e arsimimit, punësimi, krijimi i familjes, e kështu duhet të jemi të gjithë të vëmendshëm dhe të veprojmë konkretisht pa u marrë me njëri-tjetrin.

Sot u fol shumë se kur po diskutojmë për rininë e Kosovës, mungon në sallë ministri për Kulturë, Rini e Sport. Është e vërtetë që mungon, por ministri tani në këto momente është në Bruksel duke e nënshkruar një marrëveshje që ka të bëjë pikërisht me perspektivën e të rinjve të Republikës së Kosovës. Unë e inkurajoj ministrin Gashi që të vazhdojë me entuziazmin që e ka dhe thjesht le të vazhdojë me investimet për rini, që të kemi më shumë qendra sportive, qendra kulturore, mos t'i atakojmë të rinjtë tanë, të cilët pa dëshirën e tyre po radhiten nganjëherë edhe pas atyre që nuk ia duan të mirën këtij vendi. Rinia e Kosovës duhet të ketë vëmendje më shpesh sesa në fushata zgjedhore, prandaj si klasë politike duhet ta harrojmë zhargonin politik dhe thjesht rininë ta shohim si pjesë e jetës sonë të përditshme dhe jo vetëm kur neve na duhet për të marrë ndonjë poen politik, siç po ndodh edhe sot në këtë Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Saranda Bogujevci e ka fjalën.

SARANDA BOGUJEVCI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Sot u fol shumë për probleme të ndryshme, me të cilat ballafaqohen të rinjtë tanë në vend dhe mund të diskutojmë dhe shumë më gjatë se me çka ballafaqohen të rinjtë. Unë desha të përqendrohem me një rast specifik rreth një peticioni që ka ardhur në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione.

Janë disa studentë të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, të cilët i shprehin shqetësimet dhe problemet e tyre që i kanë rreth një lënde brenda universitetit. Ky peticion dhe këto probleme me të cilat po ballafaqohen studentët në universitet tregojnë sesi është gjendja aty. Për shkak që nuk kanë gjetur përkrahje dhe nuk kanë gjetur vend brenda universitetit ku të dëgjohet zëri i tyre, u është dashur që ta dërgojnë peticionin në Komision, domethënë brenda Kuvendit. Pas shqyrtimit të peticionit kemi kërkuar që nga Dekanati të dërgohet me shkrim rreth çështjes që janë ndërmarrë sa i përket peticionit dhe për problemin që ekziston. Më vjen keq kur e lexoj shkresën nga dekani, në të cilën në një pjesë thotë se ky shqetësim i studentëve është tani e disa vite dhe vazhdon në pjesën tjetër, që dua ta citoj: “Që nga koha kur është trajtuar rasti paraprak dhe deri më rastin e ankesës nr. 1044/18, datë 2. 3. 2018, nuk kemi pasur asnjë vërejtje apo ankesë të studentëve”. Domethënë, bie komplet ndesh me çka thotë më herët.

Problemet që i kanë pasur studentët është kur thuhet se literatura bazë në gjuhën shqipe është e rregulluar. Kjo ka ndodhur në fakt pas ankesës dhe petitionit të studentëve. Menaxhmenti i fakultetit ka marrë vendim për kërkesën bazuar në dy pjesë: këshillat nga komisioni dhe tjetrin nga raporti i profesorit, që në fakt nuk është valid dhe nuk përmban të dhëna korrekte. Tjetra, që është shumë me rëndësi, është që kur studentët kanë kërkuar të kenë qasje në informacion për të dhënat se sa studentë e kanë kaluar provimin e sa jo, dhe sa studentë janë regjistruar në semestrin që janë të bllokuar në këtë lëndë, nuk kanë marrë asnjë përgjigje. Domethënë, përveç që as “po” as jo”, në fakt komplet janë injoruar.

Tjetra që për mua ka qenë shqetësuese është që ky rast ka qenë edhe në medie dhe kur Rektori është pyetur për këtë çështje, kanë thënë se nuk janë në dijeni. Në fakt, janë në dijeni. Studentët janë takuar me Rektorin, e kanë dorëzuar shkresën dhe shkresa nuk u është protokolluar, domethënë e kanë anashkaluar komplet pjesën procedurale dhe nuk kanë lënë gjurmë të ankesës së studentëve. Jam tejet e shqetësuar me mënyrën sesi po udhëhiqen universitetet dhe nëpër çfarë po kalojnë studentët. Në vend se në universitet domethënë të punohet shumë më shumë, që këta studentë të ngrihen dhe t’i ngremë kapacitetet e vendit nëpërmjet këtyre studentëve, studentët po trajtohen si të jenë fëmijë, e jo të rritur.

Tjetra që është shqetësuese, e që është në dijeni në fakt edhe vetë Dekanati, është që për shkak të ankesës që kanë bërë studentët tani profesorët u hakmerren studentëve kur ata i paraqesin provimet. Në petitionin ku janë të nënshkruar studentët, njëri ndër ta e ka paraqitur provimin 23 herë dhe është shumë e çuditshme qysh Dekanati nuk e merr si shqetësim dhe nuk ndërmerr masa për të parë se cilat janë problemet brenda kësaj lënde, kur studentët duhet t’i paraqesin provimet kaq shumë herë. Ky është vetëm...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Në qoftë se insiston, ti ke të drejtë për 10 minuta. Jepja edhe një minutë, të lutem regjia!

SARANDA BOGUJEVCI: Faleminderit!

Vetëm desha ta përfundoj, ky është vetëm një shembull se çka është duke ndodhur në Universitetin e Prishtinës dhe duhet të ndërmerret diçka që të ndryshojë kjo qasje ndaj studentëve të vendit, për shkak që kjo pastaj i shtyn shumë studentë që edhe t’i ndërpresin studimet për shkak të mënyrës sesi trajtohen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Arbërie Nagavci e ka fjalën.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryetar!

Duke qenë nga fundi, domethënë u dëgjuan shumë fjalë sot për rininë dhe për atë se çfarë ne duhet të bëjmë, por besoj se të gjithë jemi dëshmitarë se rina jonë, ndryshe nga ajo sesi e kërkon mosha, entuziazmi dhe vrulli i tyre rinor, ballafaqohen me një gjendje depresive, me një brengë për të ardhmen, me një gjendje, ku ata nuk shohin perspektivë për veten e tyre.

Dhe sot, me të drejtë u fol këtu për angazhimin e Qeverisë, për obligimin institucional për të krijuar kushte e mundësi për të rinjtë tanë, për të krijuar hapësirë për aktivitete të shumta kulturore e artistike, për zhvillim të sportit, të përkrahjes së iniciativave e ideve të shumta. Por, mbi të gjitha, shteti sot duhet ta ofrojë një edukim e arsimim të mirëfilltë, që të mos kemi gjenerata që vërtet e kanë një diplomë më tepër, por nuk janë konkurrentë në tregun e punës. Edhe pse vajzat e djemtë tanë në raste individuale e na bëjnë krenarë, na entuziazmojnë me arritjet e tyre, jo vetëm në vend, por gjithandej në botë në të gjitha fushat, në sport, në art, në kulturë, në shkencë e në inovacion, nuk mund e nuk duhet të jemi të kënaqur me gjendjen që e kemi.

Të rinjtë tanë, ashtu sikur edhe shtresat tjera të shoqërisë këtu te ne ballafaqohen me pabarazi të shumta, me shkollim që dallon nga shkolla në shkollë, nga qyteti në fshat, nga komuna në komunë, e madje edhe nga klasa në klasë. Por, të rinjtë tanë, përkundër pabarazisë në shkolla, ballafaqohen me pabarazi gjithandej, edhe në përfshirje në aktivitete, në garën e padrejtë për punësim, e po ashtu me shumë moshatarë e qytetarë gjithandej në institucione, të cilët thjesht pse kanë rastisur të jenë të njohurit e dikujt, nga një rajon i caktuar, ose pse janë militantë partiakë, kanë arritur të jenë në pozita me rëndësi, të jenë këshilltarë të ministrave, e më shumë se kaq, dhe jo rrallë, mjaft prej tyre kanë probleme bazike në lidhje me arritjet e tyre në arsimin dhe në edukimin e tyre.

Andaj, sot të gjithë ne, përkundër diskutimeve, duhet të insistojmë në monitorimin e ligjeve në fuqi, në rritje të buxhetit për rininë dhe në aktivitete që e promovojnë kreativitetin dhe shpërblimin e bazuar në meritokraci, jo në militantizëm e në nepotizëm. E, mbi të gjitha, e përsëris, duhet urgjentisht ta përmirësojmë cilësinë në arsim në të gjitha nivelet, në të gjitha drejtimet, si në mësimdhënie e mësimnxënie, ashtu në infrastrukturë, qoftë fizike e ligjore. Është botërisht e njohur se pa një arsimim të mirëfilltë nuk mund të ketë as përmirësim të gjendjes së të rinjve, e as zhvillim të shoqërisë. Nëse ne vazhdojmë të krijojmë alfabetë funksionalë, të rinjtë tanë do të vazhdojnë të ballafaqohen me mendime për t'u larguar sa më parë nga ky vend.

Dhe, në fund, ndryshe nga shumë kolegë të mi sot këtu, unë nuk bëj thirrje për ministrin e Kulturës e të Rinisë, as për atë të Arsimit, madje as për Qeverinë e vendit, sepse tashmë është e qartë se ata nuk kanë as vullnet, e as kompetenca për t'i bërë ndryshimet kaq të nevojshme për të rinjtë tanë dhe për vendin. Unë sot nga këtu dua të ju bëj thirrje intelektualëve, mësimdhënësve e profesorëve të përgatitur e të ndershëm që të bëjnë sa më mirë punën e tyre, t'i përkrahin të

rinjtë, ta zhvillojnë mendimin kritik tek ata, t'i motivojnë e të gjejnë mundësinë që ta ruajnë entuziazmin e vullnetin e tyre.

E, mbi të gjitha, sot ju bëj thirrje të rejave e të rinjve tanë: mësoni e punoni sa më shumë, shfrytëzoni mundësitë që jua jep mosha, koha dhe zhvillimi i teknologjisë dhe arrijeni maksimumin për veten tuaj, e duke arritur ta avanconi ju vetën tuaj, uroj e besoj se do ta përmirësoni e ndryshoni edhe këtë shoqëri e këtë vend që aq shumë ka nevojë për ndryshime.

Sot ne nuk duhet t'u premtojmë të rinjve tanë, atyre që ua shkatërruam arsimin andaj dhe të ardhmen, sot duhet të gjejmë forcë të kërkojmë falje dhe të kërkojmë ndihmë nga të rinjtë tanë, sepse vetëm ata mund ta nxjerrin këtë vend nga vorbulla ku është futur, ku kemi shume tituj e pak vlera, shumë fjalë e pak punë.

Andaj, unë uroj që të rinjtë ta arrijnë maksimumin e tyre duke e zhvilluar veten e tyre me entuziazmin dhe vullnetin që ua jep mosha dhe shpresoj që ata do të na ndryshojnë edhe këtë shoqëri, edhe këtë vend. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Xhelal Sveçla, mbeten edhe Ismajl Kurteshi dhe Nezir Çoçaj, në qoftë se nuk ka tjerë.

XHELAL SVEÇLA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Deri tash u fol nga kolegët e mi për vështirësitë, sfidat e potencialin e rinisë. Unë dua të flas për një ide që duhet futur edhe si kërkesë në këtë rezolutë që po përgatitet, e kjo kërkesë është që pragu i votimit për të rinjtë të zbrësë nga mosha 18-vjeçare në moshën 16-vjeçare.

Në ditët e sotme, të rinjtë janë mjaftueshëm të pjekur dhe me kapacitet intelektual që të vendosin për fatin e vendit tonë nëpërmjet votës.

Te ne të rinjtë me 16 vjet me lejen e prindërve mund të martohen, por nuk mund të votojnë. Të rinjtë sot janë më të interesuar, motivuar dhe informuar se kurrë. Rreth 40 mijë të rinj në Kosovë në mes moshës 16-18-vjeçare duhet të fuqizohen, jo me fjalë miradije, por me të drejtën për të votuar. Austria, Argjentina, Skocia, Ekuadori, Brazili si dhe disa lande gjermane kanë këtë të drejtë për të rinjtë. Edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës është një diskutim i gjerë shoqëror për këtë të drejtë për të rinj.

Prandaj, unë thërras që të futet në rezolutë kjo, në mënyrë që të thirret Qeveria për një punë përgatitore, që kjo të realizohet në një të ardhme sa më të afërt. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nezir Çoçaj, ose Ismajl Kurteshi. Smajl, dëshiron ti i fundi, apo tash përpara? Ti e vendos, ke përparësinë, i fundit mund ta përfundosh ti. Ismajl Kurteshi, atëherë. Faleminderit, Nezir!

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryetar!

U fol shumë sot për pozitën e rëndë në të cilën gjendet rinia, prandaj po ashtu u përmendën edhe shumë gjëra sesi do të mund të nxirret rinia nga kjo gjendje e rëndë.

Edhe unë në vazhden e propozimeve po i them disa mendime, se si do të duhej ta ndihmojmë rininë dhe ta nxjerrim nga gjendja, në të cilën është.

Së pari, shteti duhet të investojë në shkollimin cilësor të të rinjve dhe në rikualifikimin e tyre, duke pasur për bazë nevojën e tregut të punës. Pastaj, shteti duhet të krijojë kushte për hapjen e vendeve të reja të punës. Punëdhënësit duhet të obligohen që ta respektojnë Ligjin e punës dhe kështu të rinjtë që punojnë t'i kenë kushtet më të mira për punë. Në vazhdim, duhet të pengohet me ligj mosrespektimi i Ligjit të punës, pra duhet të obligohen punëdhënësit që ta respektojnë Ligjin e punës.

Po ashtu, duhet të pengohet me ligj mbajtja e dy e më shumë vendeve të punës. Për të ju ndihmuar të rinjve, që të orientohen drejtë profesionit të tyre, duhet të bëhet orientim i hershëm profesional bazuar në nevojën e tregut dhe të prioritetëve të të rinjve. Po ashtu, mendoj se duhet të themelohet një agjenci në nivel të vendit, që do të hulumtojë tregun e punës dhe të rekomandojë përgatitjen e kadrove për fusha të caktuara. Është shumë me rëndësi që të rinjtë tanë, sidomos në moshë adoleshence, t'i ndihmojmë që të mos bien pre e dukurive negative, siç është droga, prostitucioni, bixhozi, e të tjera... Natyrisht, që edhe shumë propozime të tjera, të cilat u dëgjuan sot, nëse i jetësojmë ato do të ndihmojnë që rinia jonë ta shohë perspektivën e vet në Kosovë dhe jo me çdo kusht të kërkojë rrugëdalje dhe ikje nga vendi, që do të ishte keq, edhe për rininë, e sidomos për vendin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nezir Çoçaj, urdhëro!

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Fillimisht, dua ta falënderoj iniciuesin e kësaj pike diskutimi dhe hartuesin e kësaj rezolute me disa pika shumë interesante. Unë e di se shumë kolegë kanë thënë shumicën e gjërave që po përpiqem që të mos i përsëris. Do të jem shumë konkret, pasi që e kemi edhe minutazhin e caktuar, unë do t'i preferoj që të jetë si pikë në rezolutë, pra të hiqet kriteri 3-vjeçar për përvojë pune në rast të konkurseve, sepse kjo është e pamundur për ata të rinj që sot po kryejnë studime e fakultete, masterë apo shkallë tjetër të shkollimit dhe nuk kanë të drejtë, gjegjësisht në konkurs

mund të bien për shkak të kriterit të 3 vjet përvojë pune. Unë shpresoj që do të jetë në rezolutë kjo gjë.

Po ashtu, sa i përket voluntarizmit, unë e di që ka filluar të funksionojë mirëpo nuk mund të jemi të kënaqur me mënyrën si funksionon, andaj kisha kërkuar që sa më shumë të gjitha institucionet në Kosovë të kenë të rinj që mund edhe të përfitojnë nga përvoja që e bëjnë në këtë punë përkatëse.

Është shumë e vërtetë që kemi të rinj në Kosovë dhe është një fat i madh që janë të rinj të shkolluar, të përgatitur, por fatkeqësia qëndron se ata nuk kanë vende pune. Unë mendoj se është shumë e mirë të kemi të përgatitur dhe të shkolluar e po shpresojmë, që vendet e punës, në mos në Kosovë, kemi edhe mundësinë në vende të tjera, që ata të punësohen.

Besoj se të gjithë jemi të vetëdijshëm për vlerësimin që kanë bërë edhe liderët evropianë, ndër ta edhe kancelaria Merkel, për përgatitjen e tyre profesionale dhe arsimore, si dhe për inteligjencën e të rinjve shqiptarë. Pasi që jam si deputet i Ministrisë së PDK-së unë kam punuar në Institutin Pedagogjik, që është në vartësi të Ministrisë së Arsimit dhe kam qenë pjesë e Ministrisë së Arsimit dhe disa kolegë nga opozita kanë theksuar disa herë PDK-në dhe mendoj se më takon pak a shumë të merrem, pasi që kam qenë konkretisht dhe kam punuar konkretisht atje.

Sot, edhe pse ishte për rininë, rinia nënkupton moshën 18-vjeçare e tutje, jemi marrë edhe me çerdhe. Një deputete nga Vetëvendosja potencoi se sot kanë të përfshirë 18% në çerdhe të fëmijëve tanë. Është e vërtetë, unë e them në 2007 ka qenë 3%, të paktën 15% kemi një avancim. E përmendi shumë punë të PDK-së po dua t'i them, se ndoshta edhe i ke harruar edhe s'ka qenë fare me politikë, ke qenë në Angli. Sinqerisht, ka pasur katër ndërrime në shkollat tona në Kosovë, sot kemi dy ndërrime dhe disa shkolla, për fat të mirë, janë edhe me një ndërrim. Por, besoj e dini edhe për rroga sa kanë qenë dhe sa kanë marrë rrogë apo ndihmë mësuesit në Kosovën e pasluftës. E dini çfarë niveli të shkollimit kanë. Kur po ju them shumë sinqerisht, profesorët universitarë në Bullgari i marrin sa marrin mësimdhënësit tanë në shkolla fillore dhe në shkolla të mesme.

Nuk po flas sa janë ndërtuar, sa shkolla, sa çerdhe, sa qendra të kompetencave, sa shkolla profesionale, si është paguar apo si janë paguar librat për mbi një numër shumë të madh të fëmijëve në Kosovë, e tjerë, e tjerë...

E di që s'kam hapësirë dhe kohë, por m'u desh t'i përmend. Ajo që ishte më shqetësuese për mua, kur parafolësja nga Vetëvendosje tha janë marrë disa vendime që e kanë shkatërruar shkollën publike. Sinqerisht, unë nuk e di. Do të doja ta di, por pasi që s'është kjo këtu, nuk e di kur do të më jepni përgjigje, cilat janë ato vendime, sepse ne duhet këto vendime t'i eliminojmë dhe të marrim vendime që me të vërtetë, edhe shkollat publike, edhe private, do t'i avancojë. E

potenoi kolegia, ka pasur dhe ka deputetë që i çojnë fëmijët në çerdhe publike në Prishtinë. Unë e di që ka deputete të Vetëvendosjes që e ka pasur fëmijën në çerdhe publike në Prishtinë. Besoj se drejtoresha e arsimit e di kush është ajo deputete.

Unë pyes, pasi që s'është ajo, nuk kam çka të them. Unë besoj se të gjithë qytetarët e dinë, sa shkolla, pasi që është edhe drejtoresha komunale e arsimit, sa shkolla publike apo sa shkolla i kanë ndërtuar në periudhën sa ka udhëhequr Vetëvendosje në Prishtinë? I ka, është fakt, gjashtë çerdhe të partneritetit publiko-privat, po asnjë shkollë publike nuk e ka ndërtuar. Po ashtu në Prizren, është fakt, unë e përgëzoj kryetarin, mirëpo duhet ta dinë të gjithë, edhe qytetarët, edhe kryetari, se ajo shkollë buxheti ka qenë i ndarë paraprakisht dhe ka qenë i paraparë nga ish-kryetari, përkatësisht për çerdhe e kam fjalën, nga ish-kryetari Muja.

Po ashtu, një deputet e tha që Kurti është model i rinisë, sipas KDI-së. Sinqerisht, më vjen mirë. Mirëpo, si ka mundësi një lideri model një rini kaq e madhe, një numër kaq i madh i rinisë e t'i shkojë në parti tjetër? Pastaj, si ka mundësi një model i rinisë, që familja e ngushtë mos t'i jetojë në Kosovë, t'i jetojë në një vend tjetër. Po ashtu, u potencuan edhe shkollat private. Sinqerisht, të gjithë e dinë, sidomos ajo që është shkolluar në Britani, po edhe në Amerikë e çdo kund në Botë, shkollat private edhe fillore edhe të mesme e sidomos, universitetet janë elitare dhe kanë kontribuar në zhvillimin e shkencës, nëse i hyjmë edhe prej mesjetës e në vazhdimësi dhe besoj se do të kontribuojnë. Nuk mendoj se është mirë, që për shkak të popullizmit ne të jemi që të mos avancohet edhe shkollimi privat, pavarësisht cili nivel. Ne duhet ta përkrahim dhe ta mbështesim, pavarësisht se mund të ketë një deputet, dy a dhjetë deputetë apo edhe shumë qeveritarë dhe figura të larta të Qeverisë apo edhe të shtetit, t'i çojnë fëmijët e tyre. Është mirë që ato para të jenë që i kanë fituar me djersë edhe unë kështu konsideroj, jo vetëm në Kosovë, por mund t'i shkollojnë edhe në shtetet që kanë sistem më të avancuar, një sistem më cilësor të arsimit.

Shpresoj shumë, që edhe Qeveria sa e ka udhëhequr PDK-ja, besoni të gjithë e dini, sa ka qenë dhe si ka qenë niveli i shkollave profesionale dhe përgatitja profesionale e të rinjve tanë. Sot kemi mundësi me këtë përgatitje të fëmijëve tanë, që këta fëmijë të tregojnë rezultate dhe të tregojnë një kulturë të punës dhe të jenë të aftë e të përgatitur siç e kanë dëshmuar. E përmenda zonjën Merkel, e kemi pasur edhe liderë të shteteve tjera dhe të ndërmarrjeve tjera. Shkoni në Zvicër, shkoni në Gjermani dhe shikoni të gjithë ata qytetarë shqiptarë, ose me origjinë shqiptare, kanë sukses, janë të çmuar dhe të vlerësuar maksimalisht nga organizatat ku punojnë.

Nuk po dua të hy te kultura, te sporti, e të tjera, që ne ndjehemi krenarë, por unë shpresoj shumë, që këto institucione dhe ne si institucion, nuk duhet asnjëherë të kënaqemi me nivelin e arsimit dhe të kulturës, e sidomos me rininë.

KRYETARI: Faleminderit! Arbërie Nagavci, urdhëro!

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit! M'u referua, jo me emër, por m'u referua dhe tha drejtoresha e Arsimit në Komunën e Prishtinës dhe i pati disa çështje konkrete.

Sa i përket ndërtimit të shkollave, është e vërtetë që janë ndërtuar shkolla dhe shumë mirë që janë ndërtuar, por për cilësinë e ndërtimit të shkollave ka shumë për t'u folur dhe në komunën e Prishtinës personalisht jam ballafaquar me shkolla të reja, të cilat në shiun e parë që binte, vinin njoftimet nga shkollat sepse pikonin çatitë, sepse sallat e edukatës fizike gjatë tërë kohës kanë pasur probleme me dysheme dhe në çdo shkollë, edhe pse të reja, ka pasur cilësi shumë të dobët. Pra, ajo lë shumë për të dyshuar, se përse janë ndërtuar ato shkolla, e para.

E dyta, u përmend pagesa e mësimitdhënësve. Shumë mirë, që pagesat e mësimitdhënësve janë rritur. Duhet të kemi shumë konsideratë për këtë kategori të shoqërisë sonë, por duhet po ashtu të punohet në vlerësimin e performancës së tyre dhe pagesat e mësimitdhënësve të rriten konform edhe të punës që ata e kanë.

I përmendën librat. Po, Nezir, janë shpërndarë libra falas të cilët fatkeqësisht, kanë shumë po ashtu për të dëshiruar, sa i përket përmbajtjes së tyre. Korridoret e shkollave janë të mbushura, kanë qenë të mbushura, për vite të tëra me ekzemplarë që janë shpërndarë thjesht, sepse edhe aty kanë qenë tenderët.

I përmendët vendimet në shkollat publike, të cilat janë bërë ato vendime. Po, sot në shkolla, fatkeqësisht, ne kemi pasur mësimitdhënës dhe profesorë që kanë marrë tituj dhe diploma brenda natës dhe ata kanë ndikuar në këtë cilësi të dobët të arsimit që ne e kemi. Pra, besoj që gjendja në arsim flet vet dhe në lidhje me fëmijët e deputetëve në çerdhet publike, po unë e di se Albulena e ka djalin në çerdhen publike dhe është shumë mirë. Ne inkurajojmë edhe personalisht fëmijët e mi i kam pasur në shkollë publike, sepse besoj që institucionet tona duhet të ofrojnë një edukim dhe barazi për të gjithë fëmijët, që nga çerdhet e deri te...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Dardan, 2 minuta!

DARDAN SEJDIU: Unë do të flas shkurt, do të mundohem.

Meqë, e përmendi qeverisjen e Prishtinës e meqë kam qenë pjesë e ekipit qeverisës në Prishtinë për tri vjet e gjysmë, në fakt në Prishtinë sot po ec përpara projekti me IFC-në sa i përket ndërtimit të pesë shkollave me konceptin e financimit privat. Mendoj se është model i mirë, që mund të merret, Nezir, për bazë që të rritet numri i shkollave jo vetëm në Prishtinë, po në gjithë Kosovën.

Por, në anën tjetër, mendoj që me pullë nuk mund ta zëvendësojmë cilësinë në arsim dhe mendoj që numri i shkollave nuk është zëvendësim për mungesën e cilësisë së mësimdhënies në Republikën e Kosovës dhe këtu besoj se duhet të jetë debati. Pra, jo numri i shkollave, por cilësia në shkolla. Besoj shumë, që kjo është një prej sfidave kryesore që na presin neve, edhe si Kuvend, edhe si shoqëri, që të jemi të gatshëm të ofrojmë, edhe kurrikulë, edhe infrastrukturë adekuate për llojin e shoqërisë, e cila po na vjen dita-ditës më shumë. Përderisa, sot në Botë flasin për avancime të jashtëzakonshme teknologjike, ne ende kurrikulën dhe metodat e mësimdhënies i kemi jo në hap me kohën. E këtu kisha propozuar që ndoshta të organizojmë një debat në Kuvend të Kosovës për digjitalizimin e gjithë literaturës dhe digjitalizimin e mjeteve të mësimdhënies në Republikë të Kosovës, duke e pasur parasysh edhe aftësinë dhe kapacitetet e gjeneratave tjera, posaçërisht fëmijëve tanë, që të marrin informacion me anë të teknologjisë më shumë se sa që mund të marrin me një metodë, të themi kështu, që jemi duke e përdorur që një kohë të gjatë.

Edhe një herë po e përsëris, në Prishtinë sot po ecim përpara me ndërtimin e pesë shkollave të reja, me modelin e BFI në përkrahje të IFC-së, por këtu nuk është, besoj unë, çalimi në arsim, por është në mësimdhënie e jo në infrastrukturë.

KRYETARI: Nezir, kundër-replikë! Dy minuta e i ke, të lutem!

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, kryetar!

Dua t'i falënderoj të dy kolegët. Sinqerisht, kam respekt për të dy, se kam punuar, sidomos me Arbërinë kemi punuar bashkë. Sinqerisht, unë nuk mund të them asnjë send për aspektin teknik të shkollave. Kërkesat e qytetarëve kanë qenë: duam hapësirë, duam klasë, duam kthina... edhe i kemi bërë. Se çfarë i kanë bërë, mund të ndodhë që nuk e kanë cilësinë e duhur dhe po besoj që ndoshta nuk është veç një rast në Prishtinë, a dy a tre, por mund të ketë edhe në Kosovë, është diçka tjetër.

Vlerësimi i performancës së tyre, të mësimdhënësve, besoj se ish-drejtoresha e di shumë mirë, ka qenë drejtoreshë, veç ka filluar si proces dhe shumë shpejt do të fillojë edhe kanë qenë të interesuar të gjithë aktorët, por nuk ka mundur të bëhet për një periudhë shumë të shkurtë. Për përmbajtjen e teksteve edhe dardani u kyç. Është shumë interesant, ne kërkuam, sepse një tekst kur të hartohet, hartohet në 2018 dhe shfrytëzon literaturë para dhjetë viteve e të 15 viteve. E tha edhe deputeti Fisniku sistemin digjital. Sot po shkrove diçka pas 15 sekodave shiko në internet, se ka me të vërtetë diçka të ngjashme. Unë jam për atë me u bë. Unë e përgëzoj edhe komunën aktuale të Prishtinës për këto shkolla private dhe modele.

Sa i përket asaj që titujt brenda natës i kanë marrë mësuesit, sinqerisht këtu është një proces që mund të merret policia dhe prokuroria nëse janë legjitime, por nuk e di që ka nxjerrë Ministria e Arsimit një vendim që këta me të vërtetë të punësohen, ose të avancohen. Besoj se edhe Arbëria

pajtohet me këtë. Mund të ketë ndodhur një rast, mund të kenë ndodhur dy raste, por nuk është çështje që mundet. Unë besoj, Dardan, se Ministria e ka kurrikulën më të re. Ka qenë një kurrikulë e vlerësuar edhe nga instituti i Londrës. Instituti i Londrës është ndër dhjetë institutet më të vlerësuara, më kredibile të Botës, por e kemi problemin të mësimdhënësit dhe të ata që përgatisin mësimdhënës.

A duhet të punohet më shumë? Është shumë e vërtetë, jo vetëm që duhet të punohet më shumë, por duhet shumë-shumë më tepër. Shikoni modelin e vendeve skandinave, i gjithë populli, e gjithë struktura, e gjithë politika, ka ndihmuar mësuesit dhe...

(Ndërprerje na regjia)

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë, ju falënderoj të gjithë juve që jeni ende të pranishëm për durimin dhe gatishmërinë që të përfundoni disa seanca të hapura, shumë në fakt.

Dua të ju përgëzoj. Të njëjtën kohë, tani i kemi këto pikat e rendit të ditës, të cilat s'kemi mundur të arrijmë t'i vëmë në votim. Këto do të vihen në votim ditën e nesërme, pasi në... sa veta janë aktualisht? 46. Vetëm pak! Ta kini parasysh, nesër-pasnesër unë do të ju pyes juve. Do të ju pyes prapë ju, edhe pse nuk ka kuorum unë si vendimmarrje pastaj e shfrytëzoj në bazë të shumicës së juve të pranishëm, e vendosi edhe autoritetin në bazë të rregullore-kushtetutës së Kryetarit.

Po kjo, votimi do të bëhet në momentin kur mbajmë seancë, ose nesër, propozimi do të jetë, ose në qoftë se ju vendosni me shumicë, pasnesër. Pastaj, menjëherë vazhdojmë me seancën e re, me pikat të cilat i kemi të seancës së re, e cila është dashur të fillojë sot.

Po shkojmë vetëm me shefat e grupeve parlamentare. Ma thoni qëndrimin, në bazë tuaj edhe pastaj ta marr një vendim. Zoti Hoti, Avdullah Hoti, nesër shumica në qoftë se është e grupeve parlamentare, një më shumë me ata shkoj, nesër-pasnesër.

AVDULLAH HOTI: Për ne në rregull është, sikur nesër, sikur pasnesër, në fakt nesër me sa di edhe ne kemi komision në Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike, kështu që për ne jemi sikur nesër si pasnesër, cilëndo që pajtohemi, ne jemi dakord.

KRYETARI: Faleminderit! Memli Krasniqi, qëndrimi i grupit tonë.

MEMLI KRASNIQI: Edhe për ne është njëjtë, si nesër, si pasnesër, si të enjten. Mundemi edhe nesër pasdite, ose pasnesër paradite. Kryetar, preje punën, ta ka dhënë këtë të drejtë Kushtetuta, vendos vetë. Ne vijmë, nëse do nesër në 10:00, nëse do nesër në 12:00. Unë mendoj që boll i kemi shtyrë seancat, sa më herët që të vazhdojmë më mirë. Na kanë mbetur veç katër votime. I dimë që i kemi tri interpelanca me një që na ka mbetur edhe dy që janë të planifikuara. I kemi 27

pika të rendit të ditës edhe me fillua nesër seancën nuk prish punë, përkundrazi, se janë 27 pika, minimumi kanë me na marrë 2 ditë. Ta kini parasysh që të premtën i lamë interpelancat edhe për shkak të kërkesës së kryeministrit. Na duhen dy ditë minimumi për këtë pjesën tjetër. Është e mundur edhe të mërkurën dhe të enjten, por edhe me fillua nesër, s'është problem. Kështu që, njëjtë si Avdullahu, edhe unë, në daç nesër, në daç pasnesër.

KRYETARI: Jo, pa vazhduar më tutje, vetëm pak. Dy ditë nuk kemi mundësi t'i përfundojmë pikat që kanë mbetur këto të seancës së re, ta keni parasysh. Pastaj, ditën e enjte udhëton një delegacion i madh i kuvendarëve në Austri, ditën e enjte. Vetëm me e pas parasysh. Udhëtojmë sa veta jemi? 7-8 veta jemi deputetë që udhëtojmë. Ismajl, urdhëro në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, pastaj shkojmë te PSD-ja.

FATMIRE KOLLÇAKU: Po, edhe ne jemi për t'i vazhduar punimet seanca, se vërtet edhe këto seanca që po thirren në orët e pasdites, asnjë nuk po japin rezultat, se asnjë çështje nuk po arrin të votohet. mirëpo, po paraqitet problem se për nesër shumica kemi takime të komisioneve të caktuara qysh më herët, jo vetëm nesër, po edhe pasnesër. Kështu që, duhet të merret një vendim i përbashkët, po si duket nesër shumica kanë komisione dhe të mbetet për pasnesër, nuk di!

KRYETARI: Dardan, Partia Socialdemokrate një qëndrim, se jemi afër vendimmarrjes.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryetar!

Unë dhe grupi i Partisë Socialdemokrate është që të vazhdojmë me seanca nesër, t'i përfundojmë të gjitha temat dhe të fusim Kuvendin në një orar të të enjteve, në mënyrë që të martave e të mërkurave të punojmë në komisione. Nuk na kushton asgjë nëse këtë javë jemi pak më të angazhuar në Kuvend e futemi në dy javët e ardhshme në një sesion të rregullt. Mendoj që kjo është rruga më e mirë për të hequr këtë, të themi, numër të temave që i kemi të akumuluar, normalisht varet edhe prej kryeministrit a vjen për interpelanca.

KRYETARI: Faleminderit! Muharrem Nitaj nga Aleanca.

MUHARREM NITAJ: Zoti kryetar, edhe Avdullahu ehe Memli thanë, në daç nesër, në daç pasnesër. Kështu që duaj nesër, të lutem, në ora 10:00 caktojeni seancën. Edhe ashtu, kemi shumë pika, edhe ashtu po na thonë që jemi shumë dembelë, që nuk është e vërtetë, u lodhëm, na doli shpirti në këto seanca, kështu që vazhdojmë derisa t'i kryejmë komisionet dhe mund të shtyhen për një ditë tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Bilall, në qoftë se e thua për nesër në orën 10:00, nesër është.

BILALL SHERIFI: Nesër, kryetar!

KRYETARI: Nesër në orën 10:00. Atëherë, shumica edhe qëndrimi juaj, e vazhdojmë. Urdhëro! Avdullah Hoti vetëm se dëshiroi, pati reagim.

AVDULLAH HOTI: Veç ta kemi parasysh, që nesër janë dy interpelanca, ku kërkohet prania e kryeministrit. Nëse nuk është, atëherë ta keni parasysh, seancën kot vijmë pa praninë e tij.

KRYETARI: Do ta bisedojmë nesër, por me këtë paralajmërimin që e patëm sot, nesër nuk do të jetë kryeministri. Kështu që... prej dhjetëve, a e lëmë në orën 11:00. Në orën 11:00, se në 10:00 paskan komisionet, në orën 11:00.

Në orën 11:00, ju lutem kolegë deputetë, e vazhdojmë nesër seancën, këtë që u ndërpre sot dhe pastaj të renë nesër. Faleminderit!

* * *

E martë, më 5 qershor 2018

Vazhdimi i mbledhjes, e filluar më 17, 30 maj dhe 1, 4 qershor 2018

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

21. *Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar në lidhje me zbatimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë për unifikimin e pikave doganore ndërmjet tyre*

Zoti Ymeri, e dëshironi edhe një herë fjalën? Jo!

Propozuesi do ta dërgojë drejtpërdrejt në votim deklaratën, përkatësisht tekstin e propozim-rezolutës.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash.

Ju kisha lutur, ndaleni procesin e votimit!

Zoti Kurteshi, në moment kur propozuesi nuk ka një qëndrim, ne tash jemi në proces të votimit në bazë të Rregullores. Po të ishte inkuadruar propozuesi, unë ia kisha dhënë fjalën.

Shkojmë në votim drejtpërdrejt, po më vjen keq, zoti Kurteshi. Shkojmë në votim.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Kanë votuar 69 deputetë, 67 për, një kundër dhe një abstenim.

Kuvendi e miratoi rezolutën e propozuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Social Demokrate, të harmonizuar nga grupet parlamentare.

22. *Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar në lidhje me Kartonin e Gjelbër*

Zoti Faton Topalli i ka paraqitur rekomandimet e harmonizuara me grupet e tjera parlamentare, po shoh Frashër Krasniqi është i deleguar për ta marrë fjalën nga Faton Topalli. Urdhëroni!

FRASHËR KRASNIQI: Për shkak që zoti Topalli nuk është brenda vendit, e mora përsipër që t'i lexoj rekomandimet që do t'i votojmë më tutje.

1. Kuvendi i Kosovës mbështet Komisionin për Buxhet dhe Financa, si Komision FunkSIONAL, që të koordinojë hapat mbikëqyrës dhe organizativë të institucioneve kompetente në vend, në radhë të parë të Bankës Qendrore të Kosovës, Byrosë Kosovare të Sigurimeve, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Financave, me qëllim të zgjidhjes së shpejtë të çështjes në fjalë, duke mos përjashtuar zgjidhjet alternative deri në anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Byrove të Kartonit të Gjelbër.

2. Komisioni për Buxhet dhe Financa si dhe grupet punuese që derivojnë nga ai ka për detyrë të koordinojë dhe të ndajë detyrat për institucionet relevante në vend si dhe të përcaktojë veprimet konkrete brenda detyrave për secilin aktor.

3. BQK në rolin e saj mbikëqyrës mbi Byronë e Sigurimeve të Kosovës të kërkojë nga Byroja e Sigurimeve në Kosovë që deri më 30 qershor 2018 të analizojë lartësinë e primit të policës kufitare, për të shikuar mundësinë e uljes së çmimit të saj prej datës 31 korrik 2018.

4. Brenda një muaji Ministria e Punëve të Brendshme obligohet të dalë me plan veprues mbi reduktimin e automjeteve të përgjithshme që qarkullojnë brenda Republikës së Kosovës.

5. Brenda periudhës tremujore Ministria e Punëve të Brendshme të reduktojë numrin e automjeteve të përgjithshme nga 20% në 5%.

6. Komisioni për Buxhet dhe Financa si dhe grupet punuese që dalin nga ai, më së largu deri më 1 dhjetor 2018 t'i paraqesin Kuvendit raportin mbi ecurinë e angazhimeve të secilit institucion. Nëse deri atëherë nuk arrihet zgjidhje e përkohshme apo e përhershme për Kartonin e gjelbër, t'i paraqesë Kuvendit koston financiare të njohjes së njëanshme të Kartonit të gjelbër si dhe rekomandimin për këtë njohje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit. A shkojmë në votim. Ka diçka Sami Kurteshi, po e shoh. Urdhëro, zoti Kurteshi, insistues je, shpejt, të lutem.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Megjithatë ne e kemi marrë këtë tekst, po teksti nuk është harmonizuar, unë nuk e di, unë nuk kam biseduar, prej grupit kam qenë i caktuar dhe askush nuk na ka thirrur për ta harmonizuar, këtu e kam problemin, nuk kam asnjë problem tjetër. Nuk jemi kundër rezolutës, po jemi për harmonizimin, ju mund ta qitni, po nuk është i harmonizuar teksti, këtë e kam. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Po e shoh reagimin e propozuesit, do ta nxjerr në votim, shkojmë në votim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, kështu si është teksti, Frashër Krasniqi e lexoi, votojmë tash:

Kanë votuar 80 deputetë, 78 për, një kundër dhe një abstenim.

Konstatohet se Kuvendi e miratoi këtë rezolutë.

23. Votimi i propozim-rezolutës nga debati parlamentar në lidhje me gjendjen jo të mirë të rinisë kosovare

Deputeti Fidan Rekaliu nuk po e kërkon fjalën.

Atëherë do të shkojmë drejtpërdrejt në votimin e propozim-rezolutës.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, urdhëro Fidan, dëshiron veç një sqarim të shkurtë ta japë. Fjala për ju!

FIDAN REKALIU: Faleminderit, kryetar!

Unë vetëm desha të lexoj një harmonizim që e kemi bërë edhe me grupet tjera parlamentare. Nëse jeni për, atëherë po e lexoj. Ok!

1. Të miratohet sa më shpejt Strategjia për Rini dhe t'i sigurohet e gjithë mbështetja e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Të realizohet në afatin sa më të shkurtër plotësim-ndryshimi i Ligjit nr. 03/L-145 për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë, brenda vitit 2018.
3. Obligohet Qeveria e Kosovës që ta zbatojë në përpikëri Planin e Veprimit: Rritja e punësimit të të rinjve, 2018-2020.
4. Qeveria e Kosovës t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për krijimin e kushteve të favorshme për punësim për kuadrot cilësore në Republikën e Kosovës, si dhe për kthimin e trurit të mërgatës në Kosovë brenda vitit 2018.
5. Obligohet Qeveria e Kosovës që të krijojë lehtësira për të rinjtë ndërmarrës.
6. Qeveria e Kosovës ta krijojë një program të veçantë për kategorinë e të rinjve që nuk janë në punë, në shkollë apo në trajnim brenda vitit 2018.
7. Të krijohet programi nga Qeveria e Kosovës për mbështetje financiare për punën praktike të të posadiplomuarve në institucionet publike dhe private, të njihet puna vullnetare si përvojë pune dhe të fillojë të zbatohet nga institucionet përgjegjëse brenda vitit 2018.
8. MASHT-i të fillojë me reforma të planprogrameve arsimore për përshtatjen e tyre me nevojat e tregut të punës për të rinjtë, si dhe stimulimin e drejtimeve deficitare me bursa shtesë, brenda vitit 2018.
9. Qeveria të krijojë mekanizma që t'i luftojë fuqishëm dukuritë negative të të rinjve në Kosovë, siç janë droga, prostitucioni, dhuna në shkolla, alkooli etj. si dhe të krijojë mekanizma në rehabilitimin e tyre brenda vitit 2018.
10. MPJ, MIE, si dhe ministritë tjera të linjës t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme që të rinjtë e Kosovës të jenë pjesë dhe përfituese të të gjitha programeve të bashkëpunimit ndërkombëtar, në veçanti programet që lidhen me BE-në.
11. Në të gjitha institucione publike të krijohen kushtet për pavarësimin e të rinjve me aftësi të kufizuara.

12. Ministritë e linjave të krijojnë lehtësira në fushën e shitjes së shërbimeve për të rinjtë ndërmarrës.

14. Shqiptarët nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci dhe Medvegja të kenë të drejtën e studimeve në universiteteve publike me kushte të barabarta me studentët kosovarë.

15. Të bëhet një hulumtim nga Qeveria për ndërtimin e një programi për mbështetjen e të rinjve për krijimin e familjeve të reja, si dhe të ndahet një shumë e mjaftueshme buxhetore për këtë kategori shumë të rëndësishme të shtetit brenda vitit 2018.

Kjo është rezoluta, të cilën do t'ia propozojmë Kuvendit të Kosovës dhe unë besoj shumë që Kuvendi dhe deputetët ta miratojnë këtë rezolutë, njëkohësisht dua t'i falënderoj të gjithë deputetët për kontributin, të cilin e dhanë dje gjatë debatit të nismës sime për rininë e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar deputet! Tani deputeti “më i ri” në Republikën e Kosovës, Adem Mikullovcit e ka fjalën.

ADEM MIKULLOVCI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kam pak vërejtje në këtë rezolutë. Së pari, është pak shumë e gjatë dhe, e dyta, janë do gjëra që nuk flenë, s'e kanë vendin.

Po shkojmë me rend. Pika e katërt është e aplikueshme, e përealizueshme, është utopi. Thotë “Obligohet Qeveria t'i kthejë njerëzit e kualifikuar nga jashtë në Kosovë”. Kush ka dalë jashtë, e ka gjetur punë, e ka kualifikimin, fshije që mund ta kthesh mbrapa, as me polici.

Pika e gjashtë është konfuze, s'është e përcaktuar. Ndërsa, pika më e mirë dhe e vetmja që vlen, e që s'e kisha shtuar asnjë pikë tjetër është pika e tetë. Faleminderit!

KRYETARI: Glauku më herët tregoi çka janë rezolutat. Zafiri po do ta plotësojë pak si i ri dhe shkojmë në votim.

ZAFIR BERISHA: Kryetar, faleminderit!

Unë mendimin për këtë iniciativë e kam dhënë dje në emër të Nismës, por me gjasë që ju ashtukështu i zënë kështu me konsultime të vazhdueshme s'e përcollët se çka ka lexuar, por ndërmjet tjerash ishte edhe një shprehje “me e kthye trurin”. Unë mendoj se po dalim shumë qesharakë. A jemi duke e ditur, krejt OK, krejt do ta mbështetim, dhe dje e kam thënë se ideja e kësaj iniciative, problem është që të gjitha këto 15 pika, dje kanë qenë 14, qenkan bërë 15, kanë vend dhe hapësirë nëpër ligje, por të miratohet një rezolutë ku thuhet “do ta kthejmë trurin në Kosovë”, ishte fjala për mërgimtarët, ku mbetet trupi atëherë? Kështu që me një fjalë, të jemi më seriozë dhe, në fund të fundit, jemi Parlament, të mos biem në atë nivel. Ne e dimë që këto rezoluta, siç thashë dje, kanë për të mbetur në sirtarë të Kuvendit dhe të Qeverisë, do të

pluhurosen, por së paku mos të mbetet në arkiv që dikush më vonë, kur t'i kontrollojë këto gjëra, të bëhemi shumë qesharakë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E kemi një shembull që ka ndodhur në Kosovë, e kemi në Kuvend. Tash e merr fjalën zoti Sami Kurteshi, është kthyer nga Zvicra.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë megjithatë dua ta ngre në aspektin procedural një çështje. Rezolutat janë dokumente edhe të OKB-së, por nuk janë të obligueshme. Rezolutat janë pjesë e ëndrrave të njerëzimit, pa ëndrra nuk ka përparim. Shpeshherë janë utopike. Por, ekziston një procedurë që duhet të ndiqet dhe kjo mua po më shqetëson, sepse unë jam për rezoluta. Ne e kemi këtu një rezolutë, një tekst që është protokolluar dhe u ka ardhur gjithë deputetëve të Kuvendit, u është nxjerrë përpara dhe nuk futet në votim për arsye se ka nevojë të diskutohet, edhe pse është me nënshkrime.

Këtu e kemi! Në anën tjetër, votohen rezoluta, mocione, rekomandime që nuk i kemi përpara. Kjo nuk do të thotë që nuk pajtohemi me to, por këto janë të paharmonizuara. Ne si Kuvend duhet ta ndjekim një procedurë, të mos na vijnë tekste që nuk janë protokolluar dhe nuk e dimë çka jemi duke votuar. Unë pajtohem plotësisht me diskutimin, më duket të zonjës deputete dje, që tha “unë nuk e votoj asnjë tekst nëse nuk është i protokolluar dhe nuk më ka ardhur përpara”. Unë nuk kam asgjë kundër, ne mund të votojmë. Këtu e kam për Kartonin e Gjelbër dhe këtu e kam për rininë. Unë me tekstin pajtohem në përgjithësi, por nuk e kam për shembull për Unionin Doganor, vetëm është lexuar. Unë po ju pyes juve, a e dini saktësisht çka keni votuar sot? Mirë! Veç unë po them që keni votuar tekste që nuk janë protokolluar, kurse nuk e keni votuar një tekst që është i protokolluar. A jemi Kuvend dhe a jemi institucion që shkon në rregull, apo s’jemi? Vetëm kjo është pyetja ime. Ne mund të nxjerrim sa të doni, por është një minimum i respektimit të procedurave dhe të institucioneve. Kjo është çështja ime. Ju mund ta zgjatni sa të doni.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit, Sami! Unë mendoj që vërtet në çdo Parlament, kudo që të shkojmë, praktika është që teksti i rezolutës i propozuesit të jetë të paktën një javë ditë përpara i propozuar, i protokolluar, ta ketë secili deputetë, secili grup parlamentar paraprakisht dhe të diskutohen çështjet edhe në grupe parlamentare.

Kështu qysh po funksionojmë ne rezoluta ad hoc, vërtet jam dakord me Samiun që tha në OKB ka rezoluta që miratohen, por s’janë obligative. Ne s’e kemi me Rregullore se cila është obligative dhe cila s’është obligative, qysh propozohet obligativja dhe qysh propozohet rezoluta me dëshira. Por, sidoqoftë, ne e kemi një projekt që është bërë.

Zoti Visar Ymeri e ka kërkuar fjalën, unë s'e di, po më duket është hapur debati për këtë punë para se të votohet. Vazhdoni!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Vetëm një sqarim për deputetin Kurteshi, rezoluta për Unionin Doganor është protokolluar më 4 maj 2018, bashkë me kërkesën për debat, dhe nuk ka pasur harmonizim meqenëse nuk ka pasur as kërkesë, e as propozime shtesë për rezolutën nga debati i djeshëm, dhe u votua ashtu siç është dorëzuar. Pra, është e protokolluar dhe e keni me kërkesën e debatit, prapë po e përsëris më 4 maj 2018. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! S'ka dikush tjetër që është paraqitur për të diskutuar lidhur me rezolutën. Atëherë, hyjmë në votim.

E ftoj regjinë dhe deputetë të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Kanë votuar 76 deputetë, 73 janë për, asnjë kundër, 3 abstenime.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi rezolutën e propozuar nga deputeti Fidan Rekaliu, të harmonizuar nga grupet parlamentare.

Me këtë mbyllet seanca paraprake dhe vazhdojmë me seancën plenare sipas rendit të ditës që ka qenë e paraparë për datën 4 qershor 2018. Mirupafshim

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*